

# ENVER HOXHA

VEPRA

15



PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

# ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V Ë L L I M I

15

KORRIK 1957 - QERSHOR 1958

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TIRANË, 1973



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 15

*Në vëllimin e 15-të të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen shkrime të periudhës korrik 1957 — qershor 1958. Në këtë vëllim hyjnë: Fjala e mbylljes në Plenumin VI të KQ të PPSH (12 korrik 1957), Fjala e mbylljes në Plenumin VIII të KQ të PPSH (5 shkurt 1958), Fjala në Konferencën e 8-të të Partisë të rrethit të Fierit (4 mars 1958), Tezat «Mbi intelektualët» (Mars 1958), Fjala në Plenumin V të KQ të BRPSH (31 mars 1958), Fjala e mbylljes në Plenumin IX të KQ të PPSH (2 prill 1958), Fjala e mbajtur para zgjedhësve të zonës elektorale Nr. 158 të Tiranës (29 maj 1958), diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, artikuj, biseda, letra e telegrame përshëndetjeje. Disa nga këto shkrime botohen për herë të parë.*

*Periudha në të cilën shkruhen këto Vepra karakterizohet nga zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese në vendin tonë, nga perspektiva për lulëzimin ekonomik e kultural, nga përmirësimi i mirëqenies materiale të popullit tonë, nga forcimi i pozitave ndërkombëtare të RPSH, nga qëndrimi konsekuent e i vendosur i Partisë sonë ndaj çështjeve themelore të marksizëm-leninizmit. Është periudha e kthesës rrënjësore në kolektivizimin*

e bujqësisë dhe në të gjithë ekonominë tonë popullore në përgjithësi.

Këto shkrime bëjnë fjalë për mobilizimin e përgjithshëm të Partisë e të masave të popullit, për zbatimin e vendimeve të Kongresit III të PPSH, për plotësimin e detyrave të planit të dytë pesëvjeçar.

Në këto shkrime spikatin përpjekjet për ta bërë vitin 1958, vit të rritjes së mëtejshme të mirëqenies së masave, të masivizimit të arësimit, të mobilizimit të madh për përgatitjen e kuadrove. Veprat e mëdha të pesëvjeçarit, forcimi i kooperativave bujqësore dhe zgjerimi i numrit të tyre e bënë domosdoshmëri këtë.

Lidhur ngushtë me detyrat e mëdha që shtronte ndërtimi me sukses i socializmit në vendin tonë, Partia dhe shoku Enver i kushtonin një rëndësi të madhe edukimit marksist-leninist të komunistëve dhe të të gjithë punonjësve.

Në shkrimet e kësaj periudhe del në pah lufta e vendosur e PPSH kundër revizionizmit modern për çështjet kryesore të marksizëm-leninizmit, të revolucionit socialist, të diktaturës së proletariatit, të rëndësisë së partisë komuniste e punëtore si udhëheqësja e klasës punëtore etj.

PPSH ndiqte me vëmendje veprimtarinë e revizionizmit ndërkombëtar dhe rrezikun e madh që për bënte ai për kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ajo ishte e vetmja Parti në Evropë që kishte një vijë të qartë, konsekuente, ndërsa PK e BS dhe parti të tjera ndiqnin një vijë oportuniste. Megjithëse në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957 revizionizmi u dënua si rreziku kryesor i lëvizjes komuniste e punë-

tore ndërkombëtare, udhëheqësit e këtyre partive ndiqnin një politikë afrimi me SHBA e me revizionistët jugosllavë. Në këto kushte PPSH duke luftuar kundër revizionizmit jugosllav, në të njëjtën kohë, synonte të godiste edhe politikën e lëshimeve që ndiqnin udhëheqësit revizionistë hrushovianë në BS dhe në parti të tjera. Njëkohësisht e me të njëjtën ashpërsi e forcë ajo luftonte edhe kundër imperializmit amerikan.

Partia jonë luftonte kundër manevrave, që synonin shkatërrimin e kampit socialist nëpërmjet kundërrevolucionit paqësor, që përgatitnin armiqtë e klasës punëtore nëpërmjet liberalizimit të partisë e të pushtetit dhe dobësimit të diktaturës së proletariatit në vendet socialiste. Ndërsa në vendet ku në krye të partive kishin ardhur elementët oportunistë që po u vinin kazmën fitoreve të socializmit, PPSH, përkundrazi, merrte masa për forcimin organizativ të radhëve të saja, të pushtetit popullor, për sqarimin politik e ideologjik të masave, për rritjen e mëtejshme të vigjilencës.

Qëndrimi konsekuent i PPSH ndaj marksizëm-leninizmit, demaskimi i imperializmit e revizionizmit, ishte një kontribut i madh në mbrojtjen e socializmit e të internacionalizmit proletar.

Materialet e shokut Enver të kësaj periudhe janë shprehje e qartë e forcës së marksizëm-leninizmit krijues, e përvojës së pasur të Partisë sonë. Ato ushqyen e frymëzuan komunistët dhe masat tona punonjëse në luftën e tyre për ndërtimin e socializmit.



## FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VI TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH<sup>1</sup>

12 korrik 1957

Shokë, po i japim fund këtij Plenumi të Komitetit Qendror. Të gjithë besojmë se ky plenum ka qenë i vlefshëm dhe shumë i dobishëm e do të ketë patjetër rezultate të mira në ecjen përpara të punës sonë, jo vetëm në këto dy drejtime që morëm në shqyrtim, por në gjithë zhvillimin e ekonomisë sonë. Studimi i këtyre dy problemeve ka për qëllim kryesor çështjen e përmirësimit të ekonomisë sonë, realizimin e planeve të shtetit dhe përmirësimin e jetës së popullit që është qëllimi i parë i Partisë.

Tani ka rëndësi që direktivat e këtij plenumi të zbatohen dhe për këtë të mobilizohet e tërë Partia në krye të popullit, sepse në këtë drejtim, siç e shihni edhe

---

<sup>1</sup> Plenumi VI i KQ të PPSH i mbajtur nga 10-12 korrik 1957 diskutoi: 1) Raportin «Mbi tregëtinë shtetërore e kooperativiste dhe masat për zhvillimin e saj», mbajtur nga sekretari i KQ të PPSH shoku Haki Toska. 2) Raportin «Mbi gjendjen e kuadrit në RP të Shqipërisë dhe detyrat për të ardhshmen», mbajtur nga sekretari i KQ të PPSH shoku Rita Marko.

ju dhe siç e konstaton përditë Partia, rezultate kemi, por ne kemi pasur edhe mjaft të meta. Është pozitive që paskëtaj këto të meta që janë vërtetuar në zhvillimin e ekonomisë dhe në përgatitjen e kuadrove do të na shërbejnë që të mos i përsëritim në të ardhshmen.

Është fakt se të gjithë shokët që diskutuan, si për pikën e parë dhe për të dytën, treguan interesimin e madh të Partisë për këto dy çështje të mëdha të vendit tonë. Kjo tregon gjithashtu edhe faktin që kuadrot tanë janë ngritur nga ana politike, teorike, teknike dhe duke luftuar përditë me vështirësitë, kanë arritur që jo vetëm të kenë rezultate, por edhe t'i shohin këto të meta e gabime që bëhen në punë dhe të bëjnë propozime për ndreqjen e tyre, pavarësisht se organizimi i punës për të zhdukur këto të meta nuk është në lartësinë e duhur. Duke parë dobësitë që ekzistojnë plenumi mund të konkludojë që në të ardhshmen Partia duhet të forcojë organizimin e punës, sepse ne jetojmë në momente të cilat Komiteti Qendror duhet t'i ketë parasysh, qofshin këto momente që kanë të bëjnë me politikën e brendshme ashtu edhe me të jashtmen.

Përsa u përket çështjeve tona të brendshme ne kemi mjaft suksese. Mirëpo ngjarjet ndërkombëtare të kohëve të fundit të mos mendojmë se nuk kanë reperkusione në vendin tonë. Parullat e imperialistëve, të revizionistëve, përpjekjet e tyre të hapëta ose të fshehta, parullat që hidhen në momentet që krijohen ose që shfrytëzohen prej tyre, nuk mbeten pa efekt në zhvillimin e gjendjes sonë të brendshme. Me këtë dua të them se megjithëqë tensioni ndërkombëtar është ulur, puna e Partisë dhe vigjilenca nuk duhet të ulen. Partia

duhet të luftojë për realizimin e detyrave të saja dhe të jetë shumë vigjilente.

Dua të theksoj gjithashtu se në këto momente organizatat e Partisë dhe udhëheqja duhet gjithashtu të mendojnë se populli do dhe përpiqet që të përmirësohen kushtet e jetesës. Ne duhet të mendojmë se metodat e punës sonë me masat, mënyrat me të cilat kemi punuar deri tani duhet edhe të evoluojnë. Në momentet kur situatat ishin më të vështira, kur populli duhej të bënte edhe më shumë sakrifica, masat dhe metodat e punës së Partisë duhej të ishin pak më të shtërnguara, por në situatat që janë krijuar tani metodat duhet të ndryshojnë deri diku. Kështu p.sh. të marrim çështjen e mobilizimit të teknikëve. Përpara një masë e tillë ishte e nevojshme, sepse në fillim ne kishim pak teknikë, por me kalimin e kohës kjo masë bëhej e panevojshme dhe tani nuk është e domosdoshme të marrim masa të tilla sepse kështu në fakt mbetemi në vend. Çështja është të gjenden forma dhe metoda të tjera për të mobilizuar popullin dhe teknikët në mënyrë që këta t'i kryejnë si duhet detyrat e tyre. Çështja është se ne duhet të ndryshojmë metodën e punës, t'u përshtatemi situatave dhe të armatosim njerëzit me vijën e drejtë të Partisë sonë, pa bërë lëshime, por edhe pa qenë shumë të ngurtë dhe sektarë.

Zhvillimi i ekonomisë dhe realizimi i planeve, natyrisht, do të kryhen nga masat punonjëse, por kjo kërkon edhe kuadro të pregatitur mirë. Siç thuhet edhe në raportin e Byrosë Politike, në radhë të parë duhet t'i vëmë rëndësi çështjes së përgatitjes së kuadrove të Partisë. Për këtë qëllim në të gjithë rrjetin e shkollave

të shtetit, në rrjetin e shkollave të Partisë, anëtarët e Partisë duhet të jenë të parët dhe të shquhen, të mos qëndrojnë në bisht, por të jenë shembull dhe në krye të gjithë kuadrove të tjerë. Prandaj përpjekjet nga ana e anëtarëve të Partisë në këtë drejtim duhet të jenë akoma më të mëdha. Që kjo të bëhet si duhet, çështja shtrohet që qysh nga Komiteti Qendror, aparatet e tij dhe komitetet e Partisë në bazë duhet të interesohen më shumë se deri tani për edukimin dhe përbërjen e Partisë, në radhë të parë për forcimin e disiplinës në Parti, për ngritjen ideologjike të komunistëve, për ngritjen e tyre teknike. Por këtë ngritje kulturele e ideologjike duhet ta lidhim mirë me jetën praktike. Për këto çështje në plenum u bënë mjaft propozime e sugjerime, të cilat do të merren patjetër në shqyrtim nga ana e Byrosë Politike dhe do të vendoset zgjidhja e tyre, po ato nuk duhet të jenë shkak për mosorganizimin më të mirë të punës në të ardhshmen, sepse p.sh. problemi t'i prishim ose të mos i prishim qarqet, nuk duhet ta pengojë Komitetin e Partisë për qarkun e Gjirokastrës që ta organizojë punën si e ka organizuar ai i Korçës, i cili nuk e bën këtë propozim por që ka rezultate të mira në lidhje me drejtimin e qarkut.

Kur u ngritën qarqet ka pasur disa arësye dhe nuk u nisëm nga parimi që të dobësojmë rrethet, përkundrazi t'i forcojmë, për të pasur poshtë një udhëheqje me kuadro më të kualifikuar, më afër bazës nga sa është Komiteti Qendror ose qeveria. Tani në rast se ata vijnë rrotull dhe janë bërë pengesë, duke qenë edhe kuadro të kualifikuar, atëhere të mos gjejmë shkak vetëm në format e organizimit, po çështjen duhet ta shohim pak



më thellë në këta kuadro. Këta kuadro e meritojnë këtë besim, a janë ata organizatorë të tillë që t'i kryejnë si duhet detyrat, u është dhënë atyre ndihma e duhur për ta kryer detyrën apo jo? Të kesh kaq kuadro në qark, nuk do të thotë që ata të rrinë të gjithë brenda në Gjirokastër, por ta organizojnë mirë punën që të jenë në terren dhe ta ndihmojnë mirë rrethin e bile edhe bazën. Asgjë nuk i pengon shokët e qarkut ta bëjnë këtë kur shohin që ekipe të organizuara që vijnë nga Komiteti Qendror dhe qeveria rrinë nga 10-12 ditë dhe shkojnë jo vetëm në rajone po edhe në kooperativat bujqësore e në organizatat bazë, ku kontrollojnë e ndihmojnë bazën në punë. Atëhere në shembullin e këtyre si është e mundur që qarku me 70 kuadro të mos e organizojë punën si duhet për t'u dhënë një ndihmë efikase rretheve dhe bazës?

Unë akoma nuk jam i bindur nëse forma e organizimit me qarqe duhet hequr ose jo, vetëm them që këto propozime duhet t'i studjojmë, por të mos na bëhet sëmundje duke menduar se kështu si është organizuar puna nuk ecet mirë, se nuk është e thënë që edhe po ta heqim këtë formë organizimi do të punohet mirë. Ne mund ta bëjmë këtë për Gjirokastrën, por për Korçën jo derisa punët shkojnë mirë.

Pastaj ka edhe probleme të tjera që u ngritën si për institutet dhe për çështjen e shkurtimeve. Kjo çështje natyrisht është në rendin e ditës dhe po me këtë forcë e kemi shtruar edhe në plenumet e tjera. Vetëm shohim se për faj të qendrës organikat nga muaji në muaj po na fryhen. Për këtë problem nuk është nevoja të formohen çdo vit komisione. Mua më duket se inisia-

tivat që marrin çdo vit komitetet e Partisë poshtë, si ai i Peshkopisë, duhet të merren nga të gjithë dhe t'i bëhen propozime konkrete Komitetit Qendror dhe qeverisë. Besoj se jemi të gjithë dakord që duhet të bëhen pa hezitime shkurtime, t'i shkurtojmë sa më shumë aparatet e panevojshme burokratike që pengojnë më shumë punën. Në këtë çështje unë mendoj që inisiativa duhet të jetë e plotë, të vijnë propozime nga poshtë sa më parë dhe të mos pritet të krijohen komisione. Në qendër mund të krijohet ndonjë komision, po ky problem të jetë kudo në rendin e ditës.

Çështja e transferimeve të shumë kuadrove nga qendra në bazë këtu u ngrit drejt, kjo duhet bërë dhe jo vetëm për kuadrot administrative po dhe për ata teknikë. Qendra sigurisht për të bërë konkluzionet e duhura mbi një problem ka nevojë edhe për kuadro specialistë për të gjitha aktivitetet po, kur u studjua kjo çështje dy-tre vjet më parë, ka pasur një tendencë, e cila, më duket, është marrë shablon, që mjaft teknikë të lartë, si inxhinierë, agronomë, veterinerë janë mbajtur në qendër, kjo është e dëmshme dhe, siç u tha këtu, Komiteti Qendror, Byroja Politike e qeveria këtë problem duhet ta marrin sa më parë në shqyrtim dhe të vendoset që më shumë kuadro teknikë të venë poshtë.

Pra, pa i shkundur fare ministritë, të lëmë këtu në qendër kuadrot e domosdoshëm dhe të tjerët të venë në bazë, puna e atyre që do të mbeten këtu mua më duket se do të bëhet edhe më e lehtë. Me të drejtë u kritikua Ministria e Bujqësisë në lidhje me ndihmën që duhet t'i japë bazës dhe është për t'u kritikuar. Ne i kritikojmë njerëzit që rrinë në zyra në qendër, po ata i

kritikojnë gjithashtu kur shkojnë poshtë dhe largohen si era. D.m.th. të dyja këto metoda janë të gabuara dhe duket qartë se as shokët e Ministrisë së Bujqësisë nuk kanë gjetur karar me metodën e punës së tyre. Prandaj duhet t'u mësojmë si duhet të punojnë dhe të punojnë mirë. Një pjesë e teknikëve të tyre duhet të venë në bazë të japin ndihmë konkrete në mënyrë të organizuar dhe të vijnë të sqarohen nga udhëheqja e të kërkojnë prej saj udhëzime të reja.

Nga punimet e këtij plenumi kuptohet që ne, me gjithë sukseset e arritura, jemi akoma shumë prapa në lidhje me përgatitjen e kuadrit dhe të mos kënaqemi me këto që kemi bërë. Ne në shumë sektorë kemi mungesë kuadrosh, po më shumë na mungojnë në sektorin e bujqësisë ku jemi shumë prapa në përgatitjen e kuadrit. Prandaj, pa ulur kujdesin dhe interesin për kuadrot e sektorëve të tjerë, për kuadrot e bujqësisë Partia duhet të interesohet veçanërisht, pse me kolektivizimin e bujqësisë janë krijuar ekonomi të mëdha të cilat është e pamundur të drejtohen me kuadrot ekzistues. Prandaj duhet të përgatitim kuadrot kryesorë për kooperativat bujqësore edhe nga ana politike, ndryshe do të kemi vështirësi serioze.

Partia duhet t'i edukojë mirë nga ana politike kuadrot për fshatin e në radhë të parë komunistët. Është e vërtetë që ne po bëjmë një hap të madh drejt kolektivizimit, po duhet të ecë paralel me këtë edhe kuptimi i drejtë i detyrave që punonjësit e fshatit kanë për ndërtimin e socializmit. Përpara, kur punët nuk na shkonin mirë në bujqësi, mund edhe të thoshim: s'kemi ç'të bëjmë se shumica janë ekonomi individuale dhe nuk

bindet lehtë fshatari me ekonomi individuale. Mirëpo tani fshati po kolektivizohet, prandaj duhet që të realizojë planet, ndryshe do të kemi vështirësi të mëdha.

Tani ne kemi mundësi të shumta që ta çojmë përpara ekonominë tonë për arsye të sukseseve që ka pasur vendi ynë në të gjitha fushat në saje të luftës dhe të punës që ka bërë populli i udhëhequr nga Partia. Të gjitha këto na japin mundësi të heqim para afatit trisakat dhe të hedhim kështu edhe një hap më përpara në drejtim të rritjes së mirëqenies materiale e kulturele të popullit. Por, në rast se kënaqemi vetëm me sukseset e arritura dhe me ndihmat që na dha BRSS dhe nuk e organizojmë mirë punën, do të gabojmë. Prandaj ne nuk duhet të lëmë që rezervat e grumbulluara të konsumohen në një vit, ndryshe do të pësojmë dëme të pallogaritshme. Kjo kërkon që ta organizojmë mirë punën dhe të mos ndodhë që të kërkojmë nga shteti çdo gjë që nga kreditë fshatarësisë e deri te pagat për pregatitjen e kryetarëve e të kuadrove të tjerë të kooperativave. Kjo tregon se nuk jemi realistë dhe kështu nuk mund të dalim nga kjo situatë.

Nuk është puna se fshatarësia jonë që ka kaluar vështirësi tani rron në bollëk, po është fakt se fshatarësia ka krijuar kushte më të mira jetese. Me këtë nuk dua të them që fshatarësinë ta ngarkojmë, ne t'i japim ndihmë, por edhe fshatarësia duhet të kuptojë që të mobilizohet për të shtuar prodhimin dhe për t'i kthyer shtetit detyrimet që ajo ka për ndërtimin e socializmit. Për të nxjerrë bujqësinë nga prapambetja Partia duhet të tregojë një kujdes të madh për edukimin e kuadrove të këtij sektori, sidomos të kooperativave bujqësore.

Nga lart duhet të marrim masa, sepse, me gjithë ato që janë marrë, ka shumë hezitime dhe burokraci. Duhet një punë më e organizuar dhe nga ana e qeverisë duhet më shumë kontroll që të mos ekzistojnë në Ministrinë e Bujqësisë pikëpamje të tilla si «ne jemi shumë kompetentë dhe çdo gjë që bëjmë është e drejtë». Nuk është kështu. Prandaj nga ana e qeverisë dhe e organeve të Komitetit Qendror si dhe e komiteteve të Partisë duhet të kihet më në kontroll Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj. Punonjësit e bujqësisë vendimet e Komitetit Qendror dhe të qeverisë t'i zbatojnë, po edhe baza të mos mendojë se realizimi i planeve dhe i detyrave për çështjen e kuadrove varet vetëm nga ministria ose nga qeveria.

Nuk do të hyj në hollësira se shokët folën, por çështja është se komitetet e Partisë në radhë të parë dhe komitetet ekzekutive nuk interesohen si duhet për edukimin e kuadrove, ose interesohen shumë pak. Kjo është përshtypja ime. Pra, sekretarët e Partisë ta kenë si detyrën e tyre kryesore të venë e të shohin si funksionojnë kurset, si zgjidhen njerëzit, si jepen mësimet dhe si dalin nxënësit, si lidhet teoria me praktikën.

Mua më duket se përveç programeve, formave dhe udhëzimeve nga lart duhet parë edhe si zbatohen ato poshtë. Çështja nuk varet vetëm nga dy inspektorë të Ministrisë së Arësimit. Rëndësia më e madhe e punës qëndron në bazë, prandaj në rast se nuk interesohet udhëheqja në bazë puna nuk do të vejë mirë. Po të interesohet si duhet baza jo vetëm çështja e kontingjenteve të bursave dhe numri i vajzave do të sigurohen, por edhe çështje të tjera si fanatizmi etj., nuk do të bëhen

pengesë, se do të luftohen. Pengesë mund të na bëhen disa investime të mëdha për të cilat duhet të merret me të vërtetë ndonjë vendim.

Përshtypja ime është se ne kemi me të vërtetë një rrjet të gjerë për të edukuar kuadrot. Në rast se interesohe mi konkretisht që arësimtarët ta bëjnë mirë punën e tyre duhet të marrim edhe një numër masash siç janë shtypja e teksteve, çështje të cilën duhet ta shohë qeveria se ka mundësi të sigurohen, ose çështja e laboratorëve etj. Pra të gjitha mundësitë i kemi. Tani duhet interesimi i Partisë dhe i pushtetit në bazë.

Nga të gjitha diskutimet del qartë se interesimi nuk është në nivelin e duhur, prandaj këto dobësi duhen korrigjuar, ndryshe nuk ecim dot përpara. Po nuk duhet të alarmohemi se shumë njerëz që mësojnë një profesion edhe na largohen, disa lënë edhe shkollën përgjysmë. Kjo ndodh e do të ndodhë, po tani ndodh edhe se kërkesat tona janë të mëdha e kushtet e jetesës nuk janë si duhet. Nuk jemi si në vitin e parë të çlirimit, po kemi 13 vjet dhe në vitin 1960 do të kemi 16 vjet që në historinë e një populli nuk janë gjë, po bëjnë shumë në jetën e njeriut. Pra duhet të ndryshohet mentaliteti dhe gjendja në këtë drejtim. Të shihet pse duan njerëzit të rrinë në Tiranë. Jo se kushtet këtu janë më të mira nga banesa, po këtu ka bulevardë, dritë, kinema, teatro etj., ka pak a shumë më tepër pastërti. Të gjitha qytetet nuk mund të bëhen dot si Tirana, po e vërteta është se ka ardhur koha të krijojmë kushte më të mira edhe në qytetet e tjera, të bëjmë pak më tepër investime. Po puna nuk varet vetëm nga investimet sepse pastërtia e nikoqirllëku në shkolla, internate, dyqane

etj. varet nga njeriu. Pastërtia e rrugëve, rregullimi i kopshteve e i parqeve ka mundësi të bëhen që t'i ngrohet zemra atij tekniku të lartë që nuk do të vejë në Krujë. Në Tiranë ai mund të jetë vështirë me banesë, por ka një vjehërr që ka dy dhoma dhe nuk do të vejë në Krujë se ka dëgjuar që njerëzit në Urën e Zezë nuk kanë ku flenë, në Krujë nuk gjen as maqina, nuk ka një vënd të zbukuruar ku të qëndrojë me kënaqësi. Këto ai i kërkon se ka parë jashtë dhe do të rrojë më mirë. Pra ka mundësi për të krijuar disa kushte më të mira për punonjësit dhe shumë drejt u ngrit këtu se nuk mund të ecet kështu si po vazhdohet të ecet dhe punëtorët të jetojnë në qendrat e punës si në kazerma, po jo si në kazermat e ushtrisë sonë, se atje të jetosh është një gjë e bukur, po në kuptimin e kazermave të ushtrisë së vjetër.

Pra nuk është e drejtë t'i mbash teknikët të jetojnë me vite të tëra në kushte të tilla se mundësitë për të bërë gjërat e nevojshme janë, vetëm duhet një mobilizim dhe kontroll më i mirë. Prandaj shumë që akordohen nga shteti të përdoren si duhet, po çështja është se nuk ka interesim.

Sektorin e tregëtisë këtu e kritikua dhe është për t'u kritikuar si gjithë sektorët e tjerë, po tani që heqim triskat duhet akoma më shumë kujdes. Në punonjësit e tregëtisë duhet të ndërrohet mentaliteti se nuk mund të bëhet tregëti si përpara, kur i thuhet tjetrit: kjo është, po deshe merre, po deshe mos e merr. Po të vazhdohet me këtë frymë do të falimentojmë. Këtu ka detyrë jo vetëm Ministria e Tregëtisë por e gjithë Partia se organet e tregëtisë dhe ato të konsumit varen nga lart

dhe kurdoherë nga lart do të varen, po unë nuk mund ta kuptoj si mund të thonë komitetet ekzekutive dhe ato të Partisë se nuk kanë asnjë kompetencë për të kontrolluar punën e kooperativave të konsumit. Është më mirë të thuhet që nuk interesohemi, se po të nisemi nga ky parim gjendja do të bëhet shumë serioze, disa nga punonjësit e tregëtisë do të mendojnë se kështu është mësuar populli ynë, siç dëgjojmë të thuhet edhe tani që do të heqim triskat, që mund të prodhojmë një lloj buke se mjaft është për popullin, se ai është mësuar të hajë një lloj buke. Kjo nuk është e vërtetë. Edhe në kohën e Zogut ka pasur simite, franxholla, hase, bukë të zezë etj. Natyrisht këto nuk mund t'i blinte kushdo, por kush kishte i gjente. Po kush i bënte gjithë këto lloje buke atëhere? Furrxhinjtë tanë, Dimkua me shokë dhe me ato furra që janë edhe sot. Unë nuk jam kundër që të mos bëhen furra të reja, po është skandaloze të thuhet që të bëjmë vetëm një lloj buke derisa të bëhen furrat e reja.

Prandaj duhet të ndërrohet mentaliteti në të gjithë punonjësit e në radhë të parë në ata të Partisë, ndryshe këto detyra që vëmë në këto situata të jashtme e të brendshme që janë krijuar nuk mund t'i zgjidhim si duhet. Prandaj nuk duhen përdorur metodat e përshtatshme të 4-5 vjetëve përpara, duhet të ecim me kohën. Në çështjen e ligjeve e të parimeve të jemi të palëkundur, kurse në këto çështjet e tjera të jemi pak elastikë, ndryshe do të kemi shumë vështirësi.

Këto çështje i shtruar këtu, tani puna është t'i zbërthejmë dhe kjo nuk është një punë aq e lehtë. P.sh. çështja e kuadrove nuk është punë e një ose e dy



ditëve dhe me ta shtruar në rreth mbaroi puna. Problemi i kuadrove kërkon një punë të gjatë, kuadri pregtitet pas shumë vjetëve. Çështja është që ne të interesohe mi vazhdimisht, përditë, për të gjitha këto probleme që të kemi rezultate dhe jo vetëm një interesim të njëanshëm shtetëror ose partie vetëm nga ana e kuadrove udhëheqës, po ky duhet të bëhet problem i tërë Partisë dhe i popullit. Me atë që do të bëhet ndihmësmjek Partia duhet të ketë punuar më parë, t'i thuhet që ai do të mbarojë këtë shkollë jo vetëm që të marrë rrogën, por sepse ka një detyrë shumë të madhe humanitare, shërimin e popullit. Kështu t'u hapen perspektiva edhe atyre që mbarojnë për agronomë etj. që të mos largohen. Disa prej këtyre edhe mund të largohen, po këto raste nuk duhet të na alarmojnë se jetë është kjo. Po edhe që të shtuhet nuk e lëmë gjendjen, prandaj duhen përdorur forma të reja si ajo e kontraktiveve që është praktikuar kurdoherë dhe është një gjë e drejtë. Prandaj kontrata të ketë pika të tilla që në rast se largohet ai që del agronom, të detyrohet t'i kthejë shtetit bursën që ka harxhuar. Atëhere ai do të vijë në vete. Këto forma janë të ligjshme dhe duhen marrë.

Çështja është që të krijojmë edhe në disa vende të tjera kushte që njeriu të vejë të punojë me qejf. Në radhë të parë të edukojmë dashurinë për fshatin në njerëzit e qyteteve, se Manushi e tha drejt që në bujqësi do të venë jo vetëm nga fshati po edhe specialistë nga qyteti.

Shumë propozime që u bënë mua m'u dukën të drejta. Keni parasysh se përpara kemi një plan që është

mjaft i ngarkuar. Mund të marrim edhe masa të tjera, po puna është se faktet dhe gjërat që po bëhen tregojnë se te ne ka mundësi të mëdha për shtimin e prodhimit. Puna që është nisur, duke rishikuar planet në kooperativat bujqësore për të shfrytëzuar mundësitë e mëdha që janë, duhet të përgjithësohet sa më parë në të gjithë vendin dhe ta realizojmë. Mund që disa shokë të qeshin pak me shokun e Korçës se ato që tha këtu i ka thënë edhe në qeveri edhe në një mbledhje tjetër, po nuk prish punë se edhe unë që po flas këtu nuk po them gjë të re, bile e kam zor edhe për këto që them sepse këto u thanë nga të gjithë shokët. Po duhet të jemi realistë, çështja është që në Korçë bujqësia ka marrë një hov të madh. Për këtë të mos u rritet mendja shokëve të Korçës. Kjo gjë atje nuk është bërë në një ditë, po shohim se çështja e shtimit të prodhimit sipas direktivave të Partisë atje ka marrë një hov të madh. Prandaj të mos mërzitemi pse ai i përsëriti tri herë. Ato duhen thënë edhe njëmijë herë dhe të na rrinë si çekan që të mund të bëhen. Por në fakt në Korçë ai dhe shokë të tjerë venë konkretisht në kooperativat bujqësore, ulen, marrin masa dhe vendime dhe pastaj shkojnë e i kontrollojnë. Kjo punë sigurisht nuk bëhet në mënyrë të përsosur, po atje ka një gjallëri më të madhe nga vendet e tjera. Me këtë nuk dua të them se nuk bëhet gjë në rrethet e tjera, atje ne kemi shumë gjëra për të kritikuar, po kuadrot tanë kanë edhe shumë gjëra pozitive.

Edhe në rrethet e tjera ka gjëra pozitive, ka përparime, vullnet, inisiativa dhe të mos kënaqen kuadrot tanë në rrethe e qarqe nga kjo, puna është se poshtë

nuk ka vetëm gjëra negative dhe shokët udhëheqës, kur venë poshtë, duhet t'i vënë mirë këto gjëra në dukje se kuadrot tanë nuk janë kryelartë. Prandaj atyre duhet t'u thuhet edhe anët e mira që të inkurajohen, po jo të fluturojnë.

Nganjëherë ne, udhëheqësit, duke marrë një vendim kërkojmë të zbatohet menjëherë dhe ju themi pse nuk u bë kjo e pse ajo, ju keni faj etj. Po pa zbrit edhe vetë poshtë të të shohim se sa të vlen lëkura? Prandaj unë jam dakord që duhet të kërkojmë llogari, po edhe atje ku ka suksese, atje ku kuadrot dallohen, duhet bërë që edhe kuadri të ecë përpara dhe jo t'u japim gjithnjë dru, ndryshe kuadrot do të thyhen. Këtë ne duhet ta kemi parasysh ndaj jush dhe ju pastaj kundrejt atyre më poshtë, sepse çështja e punës me kuadrin është shumë e zorshme dhe të tërë kemi të meta. Kuadri është njeri, ai ka ndjenja, prirje, mendime e pikëpamje. Nuk janë të tërë njerëzit njëlloj, kallëp, nuk i kuptojnë të tërë çështjet, nuk punojnë, nuk ndjejnë dhe nuk binden të gjithë njëlloj. Në qoftë se çështjet i shohim kështu atëhere do të gabojmë, mund të ngremë kuadro kot, mund edhe të humbasim edhe të tjerë që kanë mundësi të japin më shumë. Prandaj politika me kuadrin duhet të jetë e drejtë, e zgjuar, elastike. Për një çështje mund edhe të mos shkosh drejtpërdrejt, po mund t'i heqësh edhe veshin në një rast, po kur kjo bëhet me takt kuadri kënaqet.

Mua më duket se kuadrot tanë janë në gjendje ta bëjnë këtë. Shumë herë puna, lufta, hallet, e bëjnë kuadrin të mërëzitet. Të gjithë nuk i kuptojnë vërejtjet dhe këshillat, por sa të jetë e mundur kuadrot të mbajnë gjakftoh-

tësinë. Prandaj të kemi mjaft kujdes me kuadrin se mund të thyhet fare lehtë, atë e kap armiku pastaj dhe e bën rezervën e tij. Këtë ne nuk duhet ta lejojmë.

Ne kemi thënë shumë herë që të gjithë të përjashtuarit nga Partia nuk janë armiq, po ata nuk trajtohen si miq, si njerëz të afërt të Partisë. Ata që kanë bërë gabime në të kaluarën duhet të ndreqen, të edukohen, qoftë brenda ose jashtë Partisë, me ngadalë. Sipas situatës dhe mundësive t'u jepet edhe përgjegjësia dhe besimi, po jo të qëndrojnë në pozitë e vjetra se njerëzit ndryshojnë, bëjnë evolucion, i kuptojnë më mirë gabimet dhe pas 5-6 ose 10 vjetëve duan të punojnë, po përpara gjejnë një mur, atëhere trullosen, nuk dinë ku të venë dhe bien te armiku. Kjo nuk do të thotë që të mbyllim sytë ndaj shokëve që kanë bërë gabime; të mos biem në oportunizëm, i cili është shumë i rrezikshëm, por të mos harrojmë se edhe sektarizmi është i rrezikshëm. Prandaj të punojmë mirë me kuadrat dhe të mos i lëmë të infektohen më shumë e të bëhen rezervë e armikut.

Rëndësi për ne ka ajo që këto detyra t'i vëmë në zbatim dhe së dyti të realizojmë planet dhe të shtojmë mundësitë e prodhimit bujqësor dhe industrial. Çështja e tretë është që të mos shkojmë nga parimi se tani që heqim triskat, po të mos merren këto masa në tregëti dhe në kooperativat e konsumit, të mos kujtojmë se me rezervat dhe ndihmat e vendeve miq do të kemi suksese, por të merren masa radikale. Ato që na u dhanë nga BRSS janë një gjë plotësuese, kështu duhet të konsiderohet. Baza e heqjes së triskave është prodhimi i bukës në vend, kështu i vajit, gjalpiti, mishit, bulme-

trave. Në qoftë se ata nuk realizohen dhe nuk marrim masa urgjente që të shtohet prodhimi atëhere nuk mund të kemi suksese.

Mbi të gjitha ne duhet të ruajmë pastërtinë e radhëve të Partisë dhe unitetin e saj. Kjo është një nga detyrat kryesore të komunistëve, sepse, megjithëqë tensioni është duke u ulur dhe situata me siguri do të ecë në favor të kampit tonë, kjo nuk përjashton që elementët armiq, të hapët ose të fshehtë, të godasin unitetin e Partisë sonë i cili është i çelniktë, të godasin Komitetin Qendror për ta përcarë ose për të krijuar një pykë apo të çarë, sepse vetëm atje armiqtë synojnë të realizojnë qëllimet e tyre të poshtra. Prandaj ne duhet të jemi vigjilentë e të zgjuar për të demaskuar parullat e armikut dhe përpjekjet e tija për të na dëmtuar. Këtu nuk është çështja vetëm ta futësh në burg atë që ka hedhur parullën, ne nuk duhet të ecim kurdoherë në këtë rrugë se nuk është e drejtë dhe Partia në këtë çështje ka qenë kurdoherë korrekte, nuk ka bërë gabime, pavarësisht ç'është armiku. Partia jonë ka qenë shumë e durueshme ndaj elementëve antiparti, deviatorë, trockistë, spiunë etj., por ajo ka marrë masa të studjuara dhe të drejta; çështja është që njerëzit e Partisë duhet të dinë mirë të zhvillojnë një luftë kundër këtyre elementëve dhe jo të regjistrojnë pastaj të raportojnë. Komiteti i Partisë duhet t'i thërresë këta njerëz, t'i këshillojë dhe t'i mbajë afër, kurse ndodh p.sh. unë që jam anëtar partie, edhe kur ma thotë në një rreth të gjerë, nuk e hap gojën ta demaskoj atë njeri, pavarësisht se atë e thotë dikush që është ose jo spiun i amerikanëve. Këtij njeriu duhet t'i jepet përgjegje

konkretisht dhe ta demaskosh duke i thënë që këtë që po na e thua ti ne e dëgjojmë përditë nga «Zëri i Amerikës». «Zërit të Amerikës» ne nuk i përgjigjemi po ty kemi mundësi të të përgjigjemi dhe përgjegjen që i jepet e dëgjojnë të gjithë të pranishmit. Dhe pastaj i flasim konkretisht se sa toka janë hapur, se si janë rritur rendimentet, si janë zhvilluar bimët industriale, pse akoma ne nuk kemi arritur ta bëjmë bukën në vend. Po të mos i përgjigjesh dhe të mjaftohesh vetëm duke shkuar në komitetin e Partisë për t'i thënë që ai tha kështu e ashtu ose ai duhet të mbahet afër, kjo është boshe.

Shokët e Partisë poshtë të jenë luftëtarë, kjo nuk do të thotë që njerëzit të demaskohen kot, po në mbledhje mund të dalin shumë pyetje që i lind situata. Të mos mendojmë se të gjithë njerëzit me parti ose pa parti i kanë të qarta të gjitha çështjet. Kanë mjegull njerëzit, atëhere njerëzit e Partisë t'u përgjigjen drejt këtyre pyetjeve me qëllim që t'i sqarojnë dhe t'i sjellin në rrugën e drejtë, në vijën e drejtë të Partisë.

Këta njerëz duhet të ndreqen, të ndihmohen. Por kur njerëz si S.L. që është mbajtur aq afër nga Partia, bën ku mund pyetje e vërejtje me qëllim të keq, atëhere në këtë rast të merren edhe masa të tjera deri në masën më të rëndë. Prandaj Partia duhet të luftojë kundër parullave të armikut se ai do të përdorë gjithfarë metodash. Ne e kemi thënë dhe herë të tjera se armiqtë revizionistë me qëllim e kritikojnë udhëheqjen tonë se është «staliniste». Prandaj Partia të luftojë drejt, të shpëtojë ata që mundet dhe të jemi të vendosur kundrejt atyre që kanë qëllime të këqia.

Me një politikë të tillë dhe të vendosur kundër armikut do të kemi suksese; qëllimi është që të mos e lejojmë armikun të bëjë fole. Iku tradhëtari Panajot Plaku, armik i poshtër, agjent i vjetër, po janë tre vëllezër të gruas së tij, anëtarë partie, që i shkruajnë Partisë se jemi me Partinë etj. Këtë gjë e di Partia, atëhere përse ata t'i shkruajnë Komitetit Qendror. Po, tradhëtoi Panajot Plaku, po ata ç'kanë? Po këtë ata e bëjnë se në zemrën e tyre konsiderojnë se kanë deri diku faj ndaj Partisë që s'e zbuluan. Në rast se udhëheqja e Tiranës bën ndonjë gabim ndaj tyre, i theu këta njerëz, qoftë edhe ndonjë kritikë e pamatur ndaj këtyre njerëzve do të krijojë një të çarë te ata ndaj Partisë. Prandaj duhet pasur shumë kujdes në punën me kuadrin.

Ne shpresojmë se situata do të përmirësohet në rrugën tonë marksiste-leniniste. Në perspektivë thuhet se do të bëhet një takim i të gjitha partive tona me LKJ për të shpjeguar këto çështje. Se ç'rezultate do të arrijmë do ta shohim, po sidoqoftë kjo do të jetë një gjë pozitive edhe për ne edhe për ata. Në qoftë se jugosllavët kanë diçka marksiste tani është momenti të kthejnë rrugën. Por fakti është që ne e kemi vijën të qartë, kemi unanimitet të plotë dhe asnjë lëshim nuk bëjmë në çështjet parimore, në drejtim të mbrojtjes së parimeve marksiste-leniniste, si në çështjen e rolit të partisë, të diktaturës së proletariatit, në çështjet e ndërtimit të socializmit etj., dhe natyrisht këtu udhëheqësit jugosllavë do të gjenden një çikë në pozita të vështira. Po edhe po të mos kenë qëllim të ndreqen prapë kjo është në favorin tonë. Po kjo gjë ata mundet t'i ndihmojë në mos direkt, indirekt se populli jugos-

llav do të fillojë të thotë: mirë kanë gabuar përpara vendet e kampit të socializmit por ato tani po na japin dorën, ato ndjekin parimet marksiste-leniniste që janë të drejta, atëhere përse Jugosllavia të ketë lidhje me amerikanët, përse të ketë pikëpamje të tilla ndaj kampit të socializmit, përse të mbahen këto qëndrime të palejueshme ndaj vendeve socialiste, përse të bëhen këto veprime spiunazhi ndaj Shqipërisë dhe vendeve të tjera socialiste?

Të gjitha këto e vënë udhëheqjen jugosllave në pozita shumë të vështira, d.m.th. përpara opinionit të popullit dhe komunistëve jugosllavë ata nuk janë në rregull, po edhe përpara të gjithë kampit të socializmit.

Edhe sikur të arrihet një farë rregullimi i disa çështjeve, elementët armiq, revizionistë, në Jugosllavi nuk janë zhdukur se ata kanë punuar dhe punojnë prej një kohe të gjatë. Prandaj çështja e vigjilencës për të mbrojtur Partinë, unitetin e saj, sovranitetin e Shqipërisë duhet të mbahet vazhdimisht lart se në fund të fundit e gjithë puna qëndron te sovraniteti në lidhje me jugosllavët. Ata këtë çështje, përveç problemeve që rrjedhin nga devijimi ndaj marksizëm-leninizmit, jo vetëm nuk e kanë të qartë, po janë në rrugë antimarksiste. Shqipëria do të rrojë e pavarur dhe sovrane, kurse ata mendojnë që të rrojë në kuadrin e RFPJ. Këtë gjë kurrë nuk e ka pranuar populli ynë. Ai ka luftuar gjithë jetën, po kështu mendon edhe Partia dhe këtë gjë e dinë mirë jugosllavët se me kë kanë të bëjnë.

Natën e fundit kur ishim në BRSS, në Kremlin doli se kur kishte vajtur Titua në Greqi, duke shëtitur me mbretin e Greqisë në Korfuz, ky i kishte thënë Ti-



tos: «sikur ta copëtojmë Shqipërinë», po mbretëresha u hodh menjëherë dhe u tha: «mos hapni muhabetë të tilla se janë të rrezikshme». «Po Titua si iu përgjegj?» — e pyeti Mehmeti, por ambasadori nuk u përgjegj fare. Unë i thashë atij se kjo nuk është shaka, se ju keni vepruar gjithnjë kundër nesh dhe ne kemi dokumenta që vërtetojnë se jugosllavët e kishin futur Shqipërinë në kuadrin e Jugosllavisë si republikë të shtatë dhe ky dokument është firmosur nga Boris Kidriçi, anëtar i byrosë politike. «Po një njeri është ai — tha Miçunoviçi — pastaj ai është një dokument i vjetër». Po pikërisht për këto të vjetrat flasim edhe ne. Po kjo e Greqisë që është e re? Pastaj me cilët bëhen këto shakara? Me monarko-fashistët grekë që tërë jetën janë përpjekur dhe akoma luftojnë që të copëtojnë vendin tonë.

Pastaj rreth kësaj çështjeje lidhet e gjithë veprimtaria e tyre armiqësore. D.m.th qëllimi i tyre është të përçajjnë udhëheqjen, të sjellin në fuqi Tuk Jakovën e Bedri Spahiun etj., që Shqipëria të ecë në kuadrin e RFPJ. Po në këtë drejtim ata kurrë nuk do të kenë suksese se Partia dhe populli ynë qëndrojnë të fortë.

Çështja është se shpresojmë të kemi dhe do të kemi marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, në rrugën marksiste-leniniste, po duhet të ndërpritet i tërë aktiviteti i tyre armiqësor, sidomos nga legata e tyre në Tiranë. Kështu ne jemi dakord të zhvillojmë marrëdhënie të mira. Dhe po të arrihet kjo do t'u thuhet hap-tazi. Po si këto fakte nuk kemi vetëm ne, po kanë edhe të tjerët dhe ato nuk kanë si të mohohen.

Fundi i fundit ç'kemi bërë ne ndaj tyre? Apo kemi prishur gurët e varreve të ushtarëve të krajlit të Ser-

bisë, të vrarë gjatë Luftës së parë botërore, ose pse polici ynë ndalon agjentin jugosllav që shkel rregullat e qarkullimit dhe i kërkon për këtë patentën etj.? Këto nuk janë serioze nga ana e tyre, po qëllimi është gjetkë dhe ne do të luftojmë që ata të mos kenë suksese në këtë rrugë.

Çështja është të jemi vigjilentë, ta mbajmë ngri-tur këtë dhe kuadrin ta edukojmë për mbrojtjen e Partisë, të shpjegojmë mirë situatën dhe t'ia bëjmë të qartë cilat janë metodat e luftës së armikut kundër nesh dhe cila është vija jonë. Të veprosht kundër Partisë, kundër unitetit të saj dhe sovranitetit të vendit tonë ne nuk do të lejojmë.

Ka rëndësi që në radhë të parë të sqarohen kuadrot e Partisë edhe ata që kanë paqartësi në kokë. T'i afrojmë kuadrot e njerëzit pa parti që të jenë të qartë për këto çështje dhe të kemi të tërë parasysh në radhë të parë detyrën e realizimit të planeve dhe të të gjitha detyrave që u shtruan këtu.

Tani, duke përfunduar, ne propozojmë që për çështjen e tregëtisë të nxjerrim një vendim, kurse për raportin e dytë propozimi i Byrosë Politike është që të mos nxjerrim rezolutë, po të aprovohet vetëm raporti. Në rast se jemi dakord me këto propozime atëhere t'i japim fund.

*Aprovohet propozimi i Byrosë Politike që të dalë vendim i plenumit vetëm për problemet e tregëtisë, kurse për çështjen e kuadrit të aprovohet raporti.*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR URIMI DËRGUAR AMBASADORIT TË RP TË  
KINËS NË TIRANË ME RASTIN E 8-VJETORIT  
TË SHPALLJES SË RP TË KINËS**

**1 tetor 1957**

I dashur shoku ambasador,

Më lejoni t'Ju transmetoj urimet më të nxehta dhe miqësore me rastin e 8-vjetorit të shpalljes së Republikës motër Popullore të Kinës, atdheut Tuaj të madh, mik i dashur i vendit tonë.

Populli shqiptar dhe Partia jonë e Punës ushqejnë një dashuri dhe simpati të veçantë për popullin heroik dhe punëtor të Kinës që me luftën e tij të gjatë dhe plot sakrificë korri më së fundi fitoren përfundimtare mbi imperialistët dhe vendosi një herë e përgjithmonë pushtetin e tij popullor.

Populli dhe Partia jonë kanë ndjekur dhe ndjekin me admirim të thellë punën e madhe krijuese të popullit që Ju përfaqësoni në vendin tonë dhe krenohemi sinqerisht që miqtë tanë të largët, vëllezërit tanë kinezë, të udhëhequr nga Partia e tyre e urtë me shokun e dashur Mao Ce Dun në krye, po e kthejnë me ritme të shpejta vendin e tyre në një qopësht të lulëzuar.

Ne, shoku ambasador, vëmë re me kënaqësi të madhe se lidhjet miqësore që janë krijuar prej kohësh mi-

dis vendeve dhe popujve tanë janë kthyer në lidhje nga më të sigurtat dhe më vëllazëroret që mund të ekzistojnë midis dy popujve. Nuk ka dyshim, që këto lidhje do të vijnë duke u forcuar dhe kalitur çdo ditë, sepse ne na bashkojnë të njëjtat qëllime, të njëjtat ideale, idealet për të cilat kanë derdhur gjakun e vet dhjetëra e qindra mijëra nga bijtë dhe bijat më të mirë të popujve tanë.

Mamai Kurgani në Stalingrad, kodra Juhuatai në Nankin, kodrat e Tiranës e të qyteteve të tjera të Shqipërisë, që u skuqën me gjakun e kulluar të vëllezërve dhe motrave tona, na kujtojnë gjithnjë detyrat e larta që qëndrojnë para nesh: të mbajmë lart dhe me dinjitet flamurin e shenjtë të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, të ruajmë të pastra radhët e partive tona, të punojmë pa u lodhur për realizimin e qëllimeve tona të shenjta, për mbrojtjen e paqes, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Edhe një herë, shoku ambasador, Ju uroj Ju, si përfaqësues i popullit vëlla kinez në vendin tonë, dhe gjithë shokët Tuaj të Ambasadës së Republikës motër Popullore të Kinës, suksese në punën Tuaj fisnike për forcimin e mëtejshëm të miqësisë së pathyeshme midis popujve tanë.

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **MBI DISA NGA PROBLEMET QË DALIN ME HEQJEN E PLOTË TË SISTEMIT TË TRISKËTIMIT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**8 tetor 1957**

Edhe unë jam dakord me vendimin që po marrim për heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit. Por me këtë rast, mendoj se duhet të mbajmë parasysh disa probleme që na dalin në këto kushte. Një nga çështjet që mua më preokupon është ajo e grumbullimit të tepricave nga fshatarësia. Ngritja e çmimeve për detyrimet e fshatarësisë është një gjë e mirë dhe një kënaqësi për fshatarësinë, por për uljen e çmimit të tepricave më duket se duhet të mendohemi. Natyrisht, blerjen e tepricave me një çmim më të ulët, fshatari nuk do ta mirëpresë në këto kushte. Edhe me çmimet e tanishme të tepricave, ne shpeshherë vështirësohemi, nuk realizojmë parashikimet tona, po më vonë, sikur të ulen çmimet e tyre, si do t'i realizojmë ato? Prandaj t'i kemi mirë parasysh këto gjëra, të jemi të ndërgjegjshëm se do të kemi edhe vështirësi të mëdha, të cilat duhet t'i kapërcejmë duke përmirësuar më shumë furnizimin e

fshatit, që fshatari të gjejë çdo gjë që kërkon dhe t'i japë shtetit teprica. Në rast se ne nuk çojmë në fshat, për shembull lëndë druri, çimento etj. nuk kemi se si të grumbullojmë grurë.

Heqja e plotë e sistemit të triskëtimit është një masë me rëndësi të madhe ekonomike dhe politike. Kur kishte triska mund edhe të mungonte ndonjë gjë në furnizimin e popullit, kurse tani që triskat hiqen, ne marrim angazhim që popullin të mos e lëmë pa furnizuar si duhet, që në dyqan ai të gjejë çdo gjë. Ndryshe edhe nevojat e fshatarit nuk do t'i plotësojmë, edhe teprica nuk do të grumbullojmë sa duhet.

Këto llogari ne mund t'i bëjmë mirë, por mund të na dalin në rast se realizojmë jo vetëm planin e importit, por edhe planin e prodhimeve industriale, bujqësore e blegtorale, me qëllim që të kemi edhe mallra industriale të konsumit të gjerë, edhe drithëra, yndyrna e mish. Por edhe këtu të bëjmë mirë dallime, sepse mungesën e mishit, për shembull, ne mund ta zëvendësojmë edhe me zarzavate e me peshk, ndërsa bukën dhe yndyrën nuk kemi me se t'i zëvendësojmë dhe kjo ka rëndësi të madhe. Kjo kërkon që të kemi vazhdimisht rezerva dhe, sipas situatave, të manevrojmë si duhet. Këto rezerva të jenë më shumë nga sa kemi parashikuar, sepse fshatarësisë rreth qyteteve do t'i interesojë të vijë të blejë bukë në furrat e qytetit.

Nga ana tjetër, ka rëndësi se kur do të fillojmë t'i zbatojmë këto masa që po vendosim, tani apo në sezonin e ardhshëm. Po t'i zbatojmë tani, nuk do ta kemi lehtë për realizimin e planit të tepricave. Me detyrimet fshatari ynë u mësua, ai i ka bërë ato si ligj dhe i jep,

po me tepricat puna qëndron ndryshe, ato ne nuk i kemi realizuar asnjëherë. Prandaj, mendoj që këto masa ne mund t'i shpallim edhe në 1 janar ose në 1 shkurt të vitit që vjen dhe në vendim të përmenden që, duke filluar nga 1 shkurti, detyrimet do të ngrihen kaq dhe tepricat do të kenë këto çmime, në mënyrë që të kemi mundësi të grumbullojmë teprica me çmimet aktuale. Ndryshe, në qoftë se mendohet se fshatari do të na i sjellë tepricat e misrit, atëhere këtë masë mund ta marrim që tani.

Çështja tjetër është ajo e artizanatit. Mendimi im është se ky sektor nuk ecën si duhet, në punën e tij ka burokratizëm. Mund të themi se nga pikëpamja e organizimit, artizanati më duket se është ca i rëndë. Në qoftë se është hallkë e tepërt bashkimi i artizanatit në rreth ose në qark, kjo të shikohet, pse hallkat e tepërta presin iniciativën, hovin dhe përpjekjet që duhet të bëjnë vetë kooperativat e artizanatit në bazë. Drejtimi nga qendra duhet të organizohet mirë, ashtu sikurse edhe furnizimi i kooperativave të artizanatit me materiale kryesore, që ka leverdi të madhe, kurse vetë kooperativat e artizanatit duhet të bëjnë përpjekje të mëdha që të kënaqin kërkesat e klientëve.

Në artizanat ka edhe çështje edukative dhe të kuartrit të cilat janë të rëndësishme. Për këto çështje duhet të ndihmojë më mirë edhe Bashkimi Qendror i Artizanatit, i cili duhet të rishikojë detyrat e veta dhe të mendojë gjithashtu se si duhet të zhvillojë edhe baza iniciativën e saj.

Spektori i artizanatit duket sikur është një industri. Fakti është se shumica e tij punon me materialet e shte-

tit të ardhura nga importi dhe pak me materiale të vendit. Është krijuar një situatë që nuk prodhohet asgjë po të mos japë materiale shteti. Ndryshe është me artizanët privatë që s'janë kooperuar akoma, të cilët prodhojnë pavarësisht se shteti nuk i furnizon. Atëhere si është e mundur që artizanati i kooperuar që është sektor socialist, të mos prodhojë edhe më mirë, edhe më lirë, kur i ka të gjitha forcat? Derisa privati bën mallra duke i gjetur vetë materialet, si nuk e bëjnë dot këtë punë kooperativat e artizanatit që i kanë të tëra mundësitë për t'i konkurruar privatët? Këtu ka disa arsye dhe kjo situatë duhet ndryshuar rrënjësisht. Prandaj këto janë probleme që duhen analizuar me kujdes në kongresin e ardhshëm të artizanatit.

Në kushte të caktuara, kur artizanët e kooperuar kishin edhe vështirësi ekonomike, shteti u dha atyre edhe triska, duke i konsideruar kështu si punëtorë. Tani ne i heqim triskat, prandaj është e domosdoshme që të merren masa të tilla që artizanati të ecë me këmbët e veta, por kjo nuk do të thotë që ky sektor të mos ndihmohet nga shteti. Është e vërtetë që artizanati duhet të përballojë situatën me fondet e tij, por ne mund të subvencionojmë një ose dy vjet, derisa këto organizata të vihen në rrugën e përforcimit të mëtejshëm. Mund të ketë edhe çështje, të cilat duhen parë. Për shembull, ne mund të subvencionojmë të gjithë ata artikuj të artizanatit që janë për eksport. Ne do të kemi humbje në rast se do t'i subvencionojmë tërë jetën artikujt e artizanatit. Një gjë e tillë nuk është aspak e drejtë, sidomos në një kohë kur ata nuk bëjnë më shumë përpjekje. Ka artizanë që, megjithëse janë të koo-



peruar dhe punojnë në organizatën e tyre, pas orarit shkojnë e punojnë si privatë në shtëpi dhe nxjerrin prodhim me një cilësi shumë të mirë, që shpeshherë ia kalon prodhimit të kooperativave të artizanatit. Këto gjëra ne duhet t'i shikojmë. Ne jemi dakord me artizanët e kooperuar që të punojnë dhe të rrojnë mirë, po jo të na krijojnë stoqe të prodhimeve që s'shiten, për shkak të cilësisë së dobët të tyre.

Një problem tjetër që do të na dalë është ai i vendosjes në punë të artizanatit i shumë grave. Punimet prej xunqthi për shembull janë një zanaat i lehtë dhe i përshtatshëm për to, prandaj të hapen punë të tilla, ku të futen gra e të punojnë.

Edhe çerdhet e fëmijëve në situatën e tanishme janë të favorshme, pse nga njëra anë ato ndihmojnë për edukimin e fëmijëve, nga ana tjetër lehtësojnë nënat, që këto të jenë më të lira për të marrë pjesë më gjerësisht në punë. Prandaj, pa sjellë dëme financiare, të ngremë çerdhe e kopshte aq sa janë mundësitë tona.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## INFLUENCA E REVOLUCIONIT TË MADH SOCIALIST TË TETORIT NË SHQIPËRI<sup>1</sup>

Tetor 1957

Revolucioni i Tetorit, epoka e re në zhvillimin e  
njerëzimit

Në ditët e sotme, kur Revolucioni i madh socialist i Tetorit mbushi 40 vjet, kuptohet më mirë dhe më qartë ajo që thoshte V.I.Lenini në përvjetorin e katërt të revolucionit, se

*«Sa më shumë largohet prej nesh kjo ditë e madhe, aq më e qartë bëhet rëndësia e revolucionit proletar në Rusi...»<sup>2</sup>*

Sot e gjithë bota është dëshmitare e kësaj të vërtete të madhe.

Revolucioni socialist i Tetorit, i cili shënon ngjarjen më të madhe në historinë botërore, shkatërroi në

---

<sup>1</sup> Ky artikull është botuar në Moskë nga «Gospolitizdat» në serinë e broshurave: «Revolucioni i Tetorit në Rusi dhe lëvizja nacional-çlirimtare botërore».

<sup>2</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 37.

një të gjashtën e botës pushtetin e kapitalistëve e të çifligarëve dhe në vend të tij vendosi pushtetin politik të klasës punëtore, diktaturën e proletariatit, formën më të lartë të demokracisë për masat e gjera të popullit. Për herë të parë në histori populli u bë zot i vendit të vet. Revolucioni i Tetorit çoi në zhdukjen e çdo forme shfrytëzimi të njeriut prej njeriut, të çdo forme skllavërimi dhe mosbarazie kombëtare në Bashkimin Sovjetik. Në këtë mënyrë ai hapi epokën e shkatërrimit të kapitalizmit dhe të triumfit të socializmit.

Që nga dita e Revolucionit të madh socialist të Tetorit dhe deri sot në botë kanë ndodhur ndryshime rrënjësore në dobi të socializmit, nga njëra anë, dhe në dëm të kapitalizmit, nga ana tjetër, gjë që tregon rritjen dhe përparimin e pandalshëm të sistemit socialist drejt ngadhënjimit të plotë dhe dekompozimit përfundimtar të sistemit botëror kapitalist.

Brenda kësaj kohe në Bashkimin Sovjetik, në shtetin e parë që krijoi Revolucioni i Tetorit, u krye industrializimi socialist dhe kolektivizimi i bujqësisë, u bë një revolucion i vërtetë kultural, u zhdukën klasat shfrytëzuese dhe u ndërtua shoqëria e parë socialiste në botë. Sistemi politik dhe ekonomik i Bashkimit Sovjetik u bëri ballë të gjitha provave të vështira, sulmeve të egra të armiqtve të brendshëm dhe të imperializmit botëror. Në mënyrë të veçantë forca e pathyeshme e këtij sistemi u provua në Luftën e dytë botërore, kur Bashkimi Sovjetik me fitoren e vet historike mbi fashizmin shpëtoi jo vetëm veten e tij, por të gjithë njerëzimin nga rreziku i skllavërisë fashiste.

Bashkimi Sovjetik është bërë një fuqi botërore

shumë e madhe dhe e fortë socialiste, një vend me industri të fuqishme, me bujqësi të klasit të parë, me teknikë, shkencë dhe kulturë të përparuar. Por sot Bashkimi Sovjetik nuk është e vetmja fuqi socialiste në botë. Rrugën që çau Revolucioni i Tetorit e ndoqën dhe po e ndjekin qindra miliona njerëz të tjerë në botë, ashtu si parashikonte Lenini. Pas Luftës së dytë botërore shumë vende të Evropës e të Azisë u shkëputën nga sistemi kapitalist dhe së bashku me Bashkimin Sovjetik krijuan kampin e madh e të fuqishëm të socializmit në më tepër se një të katërtën e botës, që përmbledh më shumë se 35 për qind të popullsisë së përgjithshme të lëmshit tokësor. Socializmi është shndërruar në një sistem botëror.

Duke asgjësuar zgjedhën e rëndë të shtypjes kombëtare të popujve të Ruisë, duke shpallur paqen pa aneksime dhe kontribucione, të drejtën për vetëvendosje për të gjitha kombet deri në shkëputje të plotë dhe në krijimin e shteteve nacionale krejt të pavarura, Revolucioni socialist i Tetorit i dha një grusht për vdekje sistemit kolonial të imperializmit. Nën influencën e Revolucionit të Tetorit lufta nacional-çlirimtare e popujve koloniale u rrit dhe u zhvillua me një forcë të veçantë, që sot e ka vënë sistemin kolonial në një gjendje shthurjeje të pandalshme dhe përpara vdekjes së sigurtë. Pas Luftës së dytë botërore dhe deri sot janë shkëputur nga varësia koloniale dhe gjysmëkoloniale duke u çliruar nga prangat e imperializmit më tepër se një miliard e dyqind milion frymë, që përbëjnë gati gjysmën e popullsisë së lëmshit tokësor. Grushtin më të fuqishëm dhe dërmues sistemit kolonial ia dha Re-

volucioni Popullor Kinez. Ky revolucion i madh përfundoi me fitoren e plotë të masave të gjera popullore, të cilat krijuan shtetin e fuqishëm të demokracisë popullore në Kinë, të udhëhequr nga klasa punëtore dhe të bazuar në aleancën e punëtorëve dhe të fshatarëve. Pavarësinë kombëtare e fitoi edhe një vend tjetër i madh aziatik, India. Pavarësinë kombëtare e kanë fituar, veç Indisë, edhe shumë popuj të tjerë në Azi dhe në Afrikë, që në të kaluarën ishin koloni të imperialistëve anglezë, francezë etj. Popujt e Azisë dhe të Afrikës, që kanë fituar pavarësinë, duan paqen, duan të zhvillojnë ekonominë e tyre të pavarur, duan të realizojnë reforma demokratike. Prandaj ata po shprehën gjithnjë e më shumë në mënyrë të vendosur për marrëdhënie me Bashkimin Sovjetik, me RP të Kinës dhe me të gjitha vendet socialiste, sepse në këto lidhje ata shohin forcën për të siguruar fitoret e arritura dhe për të korrur fitore të reja ekonomiko-shoqërore.

Revolucioni socialist i Tetorit është një revolucion vigan jo vetëm në lëmin e marrëdhënieve ekonomike dhe politiko-shoqërore, por është edhe një revolucion në mendjen, në ideologjinë e klasës punëtore. Ai shënoi fitoren më të madhe të marksizëm-leninizmit mbi ideologjinë borgjeze, ideologjinë e oportunizmit dhe të reformizmit, ai u dha një grusht dërmues revizionistëve të marksizëm-leninizmit, socialshovinistëve dhe nacionalizmit reaksionar. Revolucioni i Tetorit ua çorri maskën socialdemokratëve të Internacionales së dytë, që u kthyen në shërbëtorë të borgjezisë së vet e të imperializmit botëror dhe në armiq të egër të proletariatit dhe të lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Revo-

lucioni i madh socialist i Tetorit është mishërimi i parimeve të pavdekshme leniniste të internacionalizmit proletar.

Sot idetë ngadhënjimtare dhe jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit kanë zënë rrënjë të thella, janë përhapur dhe po përhapen gjithnjë e më shumë në të gjithë punonjësit dhe të shtypurit e botës. Triumfin e tyre as kanë mundur, as do të mund ta ndalojnë armiqtë e ndryshëm të marksizëm-leninizmit me goditjet e tyre të hapëta ose të maskuara.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar, që sot gëzon lirinë dhe pavarësinë e plotë dhe ndërton jetën e re, socializmin, shikojnë në fitoret e vendit tonë triumfin e mësimeve të mëdha të Revolucionit socialist të Tetorit, triumfin e ideve të marksizëm-leninizmit.

### **Influenca e ideve të mëdha të Tetorit në zhvillimin e lëvizjes nacional-çlirimtare në Shqipëri**

Për shekuj dhe shekuj me radhë e kanë pasë marrë nëpër këmbë popullin e vogël shqiptar pushtuesit e ndryshëm, e kanë shfrytëzuar deri në palcë së bashku me klasat e pasura sunduese të vendit. Heroike ka qenë qëndresa dhe lufta që ka bërë populli ynë gjatë historisë së tij kundër pushtuesve të huaj për të mbrojtur nderin, gjuhën, zakonet, lirinë dhe pavarësinë e tij. Por si popull i vogël, pa mbrojtje dhe përkrahje, përpjekjet e tija kurdoherë kanë qenë shtypur nga agresorët, të cilët nuk e kishin lënë asnjëherë Shqipërinë të lirë dhe të pavarur. Vetëm me fitoren e Revolucionit të

Tetorit, vetëm pas krijimit të shtetit të madh e të fuqishëm të punëtorëve dhe fshatarëve të lirë të Ruisë lindën për popullin shqiptar shpresat e çlirimit nga zgjedha e rëndë e bejlerëve dhe e kapitalistëve, nga zgjedha shekullore e pushtuesve të huaj imperialistë.

Në kohën kur u krye Revolucioni i Tetorit, Shqipëria ndodhej në një gjendje jashtëzakonisht të mjeruar.

Nga njëra anë vendin e kishte pllakosur një prapambetje shumë e madhe, e trashëguar nga pushtimi pesëqindvjeçar otoman. Shqipëria ishte vendi më i prapambetur në Evropë. Industria gati nuk ekzistonte fare, bujqësia ishte krejt primitive me mbeturina të forta feudale, komunikacioni ndodhej në gjendje të mjerueshme. Si rrjedhim, nga një prapambetje e tillë karakterizohej edhe gjendja shoqërore-politike dhe kulturele e vendit. Shkollat në Shqipëri numëroheshin me gisht: edhe ato të pakta që ishin, pas pushtimit të vendit nga ushtritë e huaja imperialiste, shumica u mbyllën. Lart nga 90 për qind e popullsisë ishte analfabete. Klasa punëtore ishte fare e vogël, fshatarësia ndodhej në hapat e parë të diferencimit kapitalist, borgjezia ishte e dobët dhe nuk qe e zonja të drejtonte shtetin e ri shqiptar të porsalindur, ndërsa çifligarët, që sundonin akoma në lëmin ekonomik dhe politik, luftonin me të gjitha mënyrat për të ruajtur pozitat e tyre të privilegjuara. Nga ana tjetër, i gjithë vendi ndodhej i pushtuar nga fuqitë ndërluftuese imperialiste, të cilat e kishin shndërruar pa asnjë të drejtë Shqipërinë në një shesh lufte. Të parët, që sollën ushtrinë e tyre në Shqipëri, ishin imperialistët italianë. Në tetor 1914 ata pushtuan ishullin e Sazanit, kurse në dhjetor e shtrinë

pushtimin e tyre në gjithë rrethin e Vlorës. Po në këtë muaj forcat greke pushtuan Korçën dhe Gjirokastrën, duke masakruar pa mëshirë popullsinë dhe duke djegur e shkatërruar fshatra të tëra.

Në këtë kohë në Shqipërinë e Mesme ziente kryengritja fshatare. Fshatarët kryengritës me Haxhi Qamilin në krye luftonin për të çliruar fshatarësinë nga zgjedha e feudalëve dhe e imperialistëve, për t'u rrëmbyer tokat dhe pasuritë bejlerëve dhe për t'ua kthyer ato fshatarëve të varfër, për të shkatërruar pushtetin e ngritur nga imperialistët dhe feudalët. Kryengritja fshatare u bë një pengesë serioze për imperialistët italianë, serbë etj. që donin të pushtonin gjithë vendin tonë. Prandaj ata u dhanë të gjitha ndihmat feudalëve për të shtypur lëvizjen fshatare. Qeveria shoviniste e Serbisë mendoi se kishte ardhur rasti i volitshëm për të realizuar qëllimet e saj pushtuese dhe në qershor të vitit 1915 ushtria serbe pushtoi Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, duke vendosur kudo një regjim të egër vrasjesh dhe grabitjesh. Më vonë, më 1916, vendin e ushtrisë serbe e zunë trupat e imperialistëve austro-hungarezë, kurse në Shqipërinë e Jugut, përveç forcave italiane, u futën edhe ato franceze.

Imperialistët i kishin sjellë ushtritë e tyre në Shqipëri në mënyrë arbitrare, pa e pyetur fare popullin shqiptar, duke shkelur në këtë mënyrë zotimet e tyre hipokrite në Konferencën e Londrës më 1913, kur u njoh Shqipëria si shtet më vete dhe u caktuan kufitë e sotëm të saj. Këtë imperialistët e bënë nga lakmia e tyre e hershme për të skllavëruar Shqipërinë, e cila ishte dhe një qendër me rëndësi të madhe strategjike



mbi detin Adriatik. Në planet e imperialistëve Shqipëria prej kohësh figuronte si një plaçkë tregu. Poshtërsia e imperialistëve kundrejt Shqipërisë arriti kulmin me Traktatin e fshehtë të Londrës, që u nënshkrua në prill të vitit 1915 midis fuqive imperialiste të Antantës dhe imperialistëve italianë. Në bazë të këtij traktati Italisë i jepej, si shpërblim për hyrjen e saj në luftë kundër fuqive qendrore evropiane, pjesa Jugperëndimore e Shqipërisë me qendër Vlorën, nga ana e saj Italia merrte përsipër që «të mos kundërshtojë dëshirën e Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë (cariste) për të ndarë krahinat veriore dhe jugore të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë». Traktati i Londrës ishte një traktat që e shkelte në mënyrë brutale pavarësinë dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë, duke marrë nëpër këmbë të drejtat e ligjshme të popullit shqiptar.

Ushtritë e huaja dhe luftimet që u zhvilluan në tokën e Shqipërisë i sollën vendit tonë rrënimë akoma më të mëdha. Si rezultat i luftës, i zisë së bukës dhe i epidemive iu shkaktuan popullit shqiptar 70 mijë të vdekur, përveç shkatërrimeve të shumta. Dhe të gjitha këto vetëm për interesat grabitqare të imperialistëve.

Fitorja e Revolucionit socialist të Tetorit i dha një kurs të ri zhvillimit të ngjarjeve politike në Shqipëri. Përhapjen e dritës së tij edhe në këtë kënd të largët të Ballkanit nuk mundën ta ndalonin, me gjithë fushatën e tërbuar antisovjetike që shpërthyen në atë kohë në vendin tonë imperialistët e huaj, çifligarët dhe klerikët reaksionarë shqiptarë.

«Lumtërisht, ose si ndonjë bekim prej zoti doli

në botë xhaxha Lenini... — shkruante gazeta shqiptare «Koha» — Lenini nuk do vetëm lirimin e popullit rus, po të gjithë botës, do që çdo njeri të rrojë për njeri në botë edhe kurrë rob, prandaj që nga të katër çipat e dheut bashkohen me qëllimet e tij të larta e të shënjtja duke iu lutur zotit t'i falë një jetë të gjatë»<sup>1</sup>.

Për kushtet ekonomike, politike dhe shoqërore që ekzistonin në atë kohë në Shqipëri detyrat themelore që qëndronin përpara vendit ishin: çlirimi kombëtar, ruajtja e tërësisë tokësore të Shqipërisë, zgjidhja e çështjes agrare dhe demokratizimi i vendit. Prandaj edhe influencën që ushtroi Revolucioni socialist i Tetorit në vendin tonë e shohim në radhë të parë në zgjidhjen e këtyre detyrave.

Me fitoren e Revolucionit të Tetorit iu dha fund diplomacisë së fshehtë imperialiste, e cila i përdorte popujt e vegjël si monedhë shkëmbimi. Një nga aktet e para të qeverisë së re sovjetike në këtë drejtim ishte botimi i traktateve të fshehta të fuqive imperialiste, sipas vendimit të Kongresit II të Sovjetëve të 8 nëntorit 1917. Dolën kështu në shesh përpara gjithë botës kompletet grabitqare, që kishin kurdisur imperialistët në kurriz të popujve të vegjël.

Midis traktateve që botoi qeveria sovjetike ishte dhe Traktati i fshehtë i Londrës i prillit 1915, me anën e të cilit imperialistët e copëtonin dhe bënëin tregëti me vendin tonë. Lajmi mbi botimin e traktatit

---

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 83.

hidhte dritë mbi qëllimet e vërteta të armiqve të Shqipërisë. Ky lajm u përhap shumë shpejt në të gjithë vendin, duke ngjallur një valë të fuqishme zemërimi, duke ndezur zjarrin e luftës për çlirimin kombëtar dhe për tërësinë tokësore të atdheut. Kurrë më parë nuk ishte parë një lëvizje kaq e gjallë dhe e fortë kundër imperializmit në vendin tonë, kurrë nuk ishte arritur një bashkim kaq i shëndoshë i popullit tonë, siç u arrit pas Revolucionit të Tetorit dhe nën influencën direkte të tij. Në të gjitha anët e vendit dhe jashtë atdheut shqiptarët ngritën zërin me forcë kundër copëtimit të Shqipërisë dhe kundër qëndrimit të mëtejshëm të forcave ushtarake të pushtuesve të huaj në Shqipëri.

Më kot u munduan pushtuesit imperialistë italianë që të zvogëlonin efektin e madh që ushtroi botimi i Traktatit të fshehtë të Londrës në Shqipëri. Shqiptarët të indinjuar u bashkuan dhe filluan luftën e armatosur me anë të njësiteve guerrile që godisnin autokolonat ushtarake dhe postkomandat e karabinierisë italiane. Më 28 Nëntor të vitit 1918 dhe të vitit 1919, ditën e pavarësisë së Shqipërisë, në qytetin e Vlorës, të cilin italianët e quanin si qytetin e tyre, shpërthyen manifestime të fuqishme patriotike kundër politikës imperialiste të qeverisë italiane.

Populli shqiptar, që ia kishte çelur sytë Revolucionit të Tetorit, ishte ngritur i gjithë kundër imperialistëve. Në të gjitha anët e Shqipërisë kërkonin me këmbëngulje rrëzimin e qeverisë tradhëtare proitaliane të Durrësit dhe krijimin e një qeverie antiimperialiste. Për këtë qëllim u mblodh në janar të vitit 1920 Kongresi i Lushnjës, ku morën pjesë përfaqësues nga të gjitha

anët e vendit. Kongresi u shpreh me forcë kundër imperializmit dhe dënoi në mënyrë të vendosur Traktatin e Londrës mbi copëtimin e Shqipërisë.

Në vitin 1920 Franca, pas një viti e gjysmë që kishite mbaruar Lufta e parë botërore, u detyrua më në fund t'i hiqte trupat e saj nga Shqipëria, ndërsa qeveria italiane kërkonte t'i mbante me këmbëngulje dhe t'i aneksonte Italisë krahinat e bregdetit jugor të Shqipërisë. Ndërkaq edhe shovinistët serbë, pas largimit të ushtrive austro-hungareze, ishin futur në Shqipërinë e Veriut dhe kishin pushtuar një pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar. Në Jug shovinistët grekë kërkonin edhe ata me çdo mënyrë që të merrnin nga Shqipëria pjesën që «u takonte» në bazë të Traktatit të Londrës. Në Konferencën e Paqes në Paris vazhdonin pazarllëqet e imperialistëve për të vënë në jetë traktatin famëkeq të demaskuar.

Një rrezik i madh e kanoste Shqipërinë. Populli shqiptar nuk mund të priste asnjë të mirë, asnjë përkrahje nga imperialistët për të shpëtuar nga ky rrezik. Për këtë atij i duhej të vepronte vetë dhe me vendosmëri. Kur qeveria shqiptare e asaj kohe ngurronte të merrte masa të vendosura për dëbimin e italianëve nga Shqipëria, duke shpresuar në zgjidhjen e çështjes me rrugë diplomatike, vetë masat e revoltuara të popullit i dolën zot kësaj çështjeje. Me inisiativën e masave u krijua Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare për drejtimin e luftës kundër pushtuesve italianë. Në ultimatumin që ai i drejtonte komandës së trupave pushtues italianë në qershor 1920 thuhej: «... populli shqiptar e quan të papranuar ndarjen e Shqipërisë sipas Traktatit të fsheh-

të 1915. . .»<sup>1</sup>. Kur komanda italiane nuk iu përgjegj ultimatumit për largimin e trupave të saj nga Shqipëria, Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare urdhëroi fillimin e kryengritjes. Faqe të shkëlqyera heroizmi shkroi populli ynë në Luftën e Vlorës më 1920 kundër ushtrisë italiane, të armatosur deri në dhëmbë me mjetet më moderne të luftës. Por vullneti i çelniktë dhe vetëmohimi i shqiptarëve për të çliruar me çdo kusht atdheun e tyre, bëri që armiqtë të thyheshin me turp dhe lufta të përfundonte me fitoren e patriotëve shqiptarë. Push-tuesit u hodhën në det dhe qeveria italiane u detyrua më në fund të lëshonte Vlorën me gjithë rrethin e saj, duke mbajtur në dorë vetëm ishullin e Sazanit. Vetëm pak ditë pas disfatës së pësuar, ministri i jashtëm italian Konti Sforca ishte i detyruar të pranonte: «... nuk mund të qëndronim të sigurtë dhe të qetë në Vlorë dhe njëkohësisht të shkaktonim pakënaqësinë dhe keqardhjen e shqiptarëve me pakte ndërkombëtare që duhej të ishin të fshehta por që nuk mbetën të tilla»<sup>2</sup>.

Me luftën e popullit liridashës shqiptar për çlirimin e Vlorës u solidarizua edhe proletariati italian, i cili, nën influencën e Revolucionit të Tetorit, ishte ngritur për të mbrojtur interesat e klasës së tij dhe kundër intervencionit të imperialistëve në Rusinë Sovjetike.

Pas mbarimit fitimtar të Luftës së Vlorës, populli ynë e vazhdoi luftën për tërësinë tokësore të vendit

---

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 40.

<sup>2</sup> Po aty, f. 61.

kundër shovinistëve serbomëdhenj, për t'i dëbuar ata nga Shqipëria e Veriut. Njësitë e armatosura shqiptare, të udhëhequra nga Bajram Curri, luftuan heroikisht për mbrojtjen e vatrave të tyre. Lufta e popullit shqiptar e detyroi më në fund qeverinë serbe që në vitin 1921 të tërhiqte trupat e saj nga toka shqiptare.

Si rezultat i Luftës së tij nacional-çlirimtare, që u ndez nën influencën e Revolucionit të Tetorit, populli shqiptar e çliroi vendin e tij nga pushtesit e huaj. Po të mos ishte fitorja e Revolucionit të Tetorit, po të mos ishte qeveria sovjetike dhe Lenini, që botuan traktatet e fshehta dhe zbuluan në këtë mënyrë fytyrën e vërtetë të bishave imperialiste, nuk do të qe kurrë e mundur që populli ynë të korrte këtë fitore.

«Të mos qe Lenini, — shkruante gazeta përparimtare «Politika», — nuk do të kishte fuqi në botë që të mund të prishte këtë traktat [Traktati i Londrës]. Kështu pra themelet e shtetit tonë janë vënë që atëherë prej Leninit»<sup>1</sup>. Lenini dhe Bashkimi Sovjetik u bënë dy emrat më të dashur për popullin shqiptar, i cili i konsideronte ata shpëtimtarë të atdheut të vet. Kur imperializmi ndërkombëtar ishte vërsulur për ta mbytur Republikën e re Sovjetike, populli shqiptar i drejtonte sytë nga Bashkimi Sovjetik dhe, duke ndjekur me simpati luftën e punëtorëve dhe të fshatarëve rusë kundër imperialistëve grabitqarë, shprehte bindjen se

---

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 86-87.

çështja e drejtë e Leninit dhe e bolshevikëve do të triumfojë: «Ne jemi plotësisht të bindur, i drejtohej qeverisë sovjetike në vitin 1920 patrioti Bajram Curri, në emër të popullit shqiptar, se e larta qeveri sovjetike do të bëjë që e gjithë bota të gëzojë parimet e drejtësisë... Populli shqiptar pret prej Rosisë Sovjetike që të vendosë në Ballkan një paqe të drejtë, fisnike dhe të vërtetë»<sup>1</sup>. Patrioti revolucionar Mihal Grameno po në këtë vit shkruante:

«Çakejtë e gjakpirësit e botës përnjëherësh u bashkuan që të gjithë për të ndaluar dritën e vërtetë dhe për këtë qëllim satanik nuk lanë asgjë pa përdorur... po më kot u munduan, se u dërmuan përpara së drejtës e së vërtetës. Ranë dhe do të bien përmbys ata që i kundërshtojnë xhaxha Leninit edhe bolshevikëve»<sup>2</sup>.

Pas çlirimit të Shqipërisë nga të huajt çështja agrare dhe në përgjithësi çështja e demokratizimit të vendit u bënë çështjet kryesore në jetën politike të vendit.

Me formimin e shtetit shqiptar çifligarët jo vetëm i ruajtën por edhe i forcuan pozitat e tyre të klasës, duke marrë në dorë edhe drejtimin e shtetit. Për këtë arsye lufta e klasës midis fshatarësisë dhe çifligarëve përbënte boshtin e gjithë jetës së vendit. Por në kushtet e Luftës nacional-çlirimtare, kur detyra kryesore ishte çlirimi i vendit nga të huajt, lufta për tokën dhe për të drejtat demokratike nuk mori përpjesëtime të mëdha.

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë 1957, f. 62.

<sup>2</sup> Po aty, f. 83.

Fill pas çlirimit të vendit fshatarët filluan të kërkonin tokën e bejlerëve dhe përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike. Në shumë krahina të vendit ata pushtuan tokat e çifligarëve, kundërshtonin t'u jepnin të tretën dhe detyrimet e tjera bejlerëve, rrahën ose vranë tagrambledhësit e qeverisë, bënë protesta për të zbritur taksat dhe për të hequr të dhjetën etj. Në krahinat e Veriut të Shqipërisë lëvizja fshatare, e udhëhequr nga Bajram Curri, e detyroi qeverinë që të hiqte taksat dhe të dhjetën për ato krahina. Lufta për tokën mori një karakter të theksuar politik.

Të gjitha grupet dhe partitë politike, edhe ato borgjeze, ishin të detyruara të kishin në programet e tyre si një pikë kryesore mbrojtjen e interesave të bujqve, zbatimin e reformës agrare. Por ndërsa partitë borgjeze donin të zgjidhnin çështjen e tokës në mënyrë paqësore, kërkonin reformë agrare të moderuar, fshatarët kërkonin t'i merrnin me forcë dhe pa shpërbllim tokat e bejlerëve.

Ndërkaq qeveria reaksionare e Tiranës nuk bënte asgjë për të lehtësuar gjendjen e vështirë ekonomike të fshatarësisë. Ajo, përkundrazi, mori masa për t'i dëbuar fshatarët nga tokat e rrëmbyera të bejlerëve, të cilët i ishin ankuar qeverisë, duke u dhënë çifligarëve të gjithë ndihmën dhe përkrahjen kundër fshatarësisë.

Lufta për zgjidhjen e çështjes agrare e acaroi akoma më tepër atmosferën politike të vendit. Si në parlament dhe jashtë tij filloi një luftë e ashpër mbi mënyrat e zgjidhjes së çështjes agrare: mbi mënyrën «bolshevike» dhe mbi mënyrën «jobolshevike». Sipas dokumentave historike, në Shqipëri, në atë kohë bolshe-



vizëm kuptohej në radhë të parë marrja pa shpërblim e pronave të çifligarëve dhe dhënia e tokave falas fshatarëve, ashtu si kishin vepruar bolshevikët në Rusi. «Në Shqipëri është lindur bolshevizmi»<sup>1</sup>, shkruante gazeta «Koha». Në zjarrin e debateve rreth reformës agrare në parlamentin shqiptar, kur një deputet thoshte se në Shqipëri nuk mund të ekzistojë bolshevizmi, një deputet tjetër përparimtar i përgjigjej: «Bolshevizmi ekziston në Shqipëri»<sup>2</sup>. Kur një çifligar nga rrethet e Vlorës, i ankohej qeverisë se bujqit i kishin rrëmbyer tokat, i quante fshatarët «një turmë e tërbuar e ushqyer me principe bolshevizmi»<sup>3</sup>. Rrethet borgjeze, duke parë se fshatarësia i kërkonte tokat pa shpërblim, dhanë alarmin se në Shqipëri kishin filluar të dukeshin «tendenca bolshevike» dhe bërtitnin: «...jo të merren fare çifliqet e bejlerëve, se atëhere bëhet alla bolshevikshe»<sup>4</sup>. Rrethet konservatore borgjeze i këshillonin çifligarët që «të mos kundërshtonin një reformë agrare «të arësyeshme», sepse nuk ishte çudi që një ditë t'i zgjonte nga gjumi, që i kishte zënë, një tragjedi e papritur»<sup>5</sup>.

Lëvizja demokratike kundër bejlerëve dhe qeverisë në Shqipëri mori një hov më të madh, pasi u krijua më 1922, me inisiativën e patriotit të njohur revolucionar

---

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë 1957, f. 81.

<sup>2</sup> Po aty, f. 97.

<sup>3</sup> Po aty, f. 94.

<sup>4</sup> Po aty, f. 95.

<sup>5</sup> Po aty, f. 96.

Avni Rustemi, organizata demokratike «Bashkimi», e cila grumbulloi në gjirin e saj të gjithë patriotët demokratë, punëtorë, fshatarë, rininë patriotike, inteligjencien përparimtare borgjeze. Programi i «Bashkimit», që parashikonte reforma demokratike në interes të popullit, gjeti përkrahjen e masave të gjera të fshatarëve, punëtorëve dhe të patriotëve shqiptarë. Nën udhëheqjen e organizatës «Bashkimi» populli po përgatitej për kryengritjen e armatosur kundër feudalizmit dhe qeverisë reaksionare proimperialiste të Tiranës. Organi i punëtorëve të mërguar, «Dielli», më 19 mars 1923 i drejtohej popullit shqiptar: «Zgjohuni shqiptarë, merrni mësimë prej rusëve dhe shpëtoni atdheun tuaj, veten dhe fëmijët tuaj!».

Pikërisht në një kohë kur lëvizja e popullit shqiptar për të drejtat demokratike dhe tokën po arrinte kulmin nën influencën e Revolucionit Socialist të Tetorit, në Moskë vdiste Vladimir Iliç Lenini, themeluesi i Partisë së lavdishme Bolshevike dhe i shtetit të parë socialist, miku më i madh i popullit shqiptar dhe i gjithë popujve të vegjël e të robëruar. Populli ynë e ndjeu shumë thellë hidhërimin për vdekjen e «revolucionarit më të madh të shekujve»<sup>1</sup> për njeriun që «shkuli përgjithnjë rrënjët e zezave të absolutizmit të carëve dhe që ngriti në shkallën e duhur emrin e popullit»<sup>2</sup>, për shpëtimtarin e shtetit tonë të ri, të pavarësisë dhe tërësisë tokësore të atdheut tonë. Vetëm pak ditë nga vdekja e

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 86.

<sup>2</sup> Po aty, f. 85.

njeriut gjenial, Kuvendit Kushtetues Shqiptar i propozojë që të mbante pesë minuta zi për Leninin. Dhe kur deputetët reaksionarë e pritën këtë propozim me përbuzje, u ngrit patrioti Avni Rustemi:

«Më vjen shumë keq, tha ai, që kur përmendet emri i Leninit, dëgjohej qeshje nga ana e disa përfaqësuesve të kombit. . . po për principet e larta njerëzore duhet që me një respekt të zihet në gojë emri i tij.

E dini fare mirë zotërinj, se qysh ai mbroi principet e larta të njerëzisë e se që i pari që denoncoi Traktatin e fshehtë të 1915-s, që ishte për copëtimin e Shqipërisë. . . e kemi për detyrë të propozojmë që të bëhen pesë minuta pushim si shenjë hidhërimi për vdekjen e tij»<sup>1</sup>. Me këmbënguljen e deputetëve përparimtarë, kuvendi u detyrua që të mbante pesë minuta zi për Leninin e madh. Në asnjë parlament të ndonjë shteti tjetër nuk ngjau një gjë e tillë.

Por klika reaksionare e qeverisë e vrau tradhëtisht revolucionarin demokrat dhe konsekuent, Avni Rustemin, pse ajo shikonte te ai një armik të betuar të saj. Vrasja e Avni Rustemit i dha edhe më tepër zjarr hovit revolucionar të masave që po rritej. Që pas vrasjes së Avni Rustemit një sërë krahinash të Shqipërisë nuk e njohën më qeverinë e Tiranës. Hovi revolucionar i popullit u rrit aq shumë sa në qershor të vitit 1924 shpërtheu në kryengritje të armatosur, që përfshiu gjithë

---

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 84-85.

vendin. Kryengritja drejtohej kundër regjimit të çifligarëve. Shumë shpejt forcat e armatosura të kryengritësve mundën të pushtonin një nga një qytetet dhe qendrat e ndryshme të Shqipërisë. Më 10 qershor ra në dorë të kryengritësve kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, dhe po këtë ditë kryengritja fitoi në të gjithë vendin.

Menjëherë pas përmbysjes së regjimit feudal u formua qeveria demokratike, e cila ishte në atë kohë qeveria më përparimtare në Ballkan. Qeveria shpalli programin e saj, pikat kryesore të të cilit ishin: çrrënjosja e feudalizmit, çlirimi i popullit dhe vendosja përfundimtare e demokracisë në Shqipëri, kryerja e reformave radikale në të gjitha degët e administratës shtetërore, sigurimi i pavarësisë së gjyqeve, ndërrimi i sistemit të taksave për të lehtësuar popullin, përmirësimi i gjendjes së bujkut dhe çlirimi i tij ekonomik, përmirësimi i komunikacioneve, shëndetësisë, arësimit, vendosja e marrëdhënieve miqësore me të gjitha shtetet dhe veçanërisht me fqinjët.

Programi i qeverisë demokratike u prit mirë nga populli. Në të gjitha anët masat popullore shprehnin në mitingje të gjera përkrahjen dhe aprovimin e programit të qeverisë dhe bënë propozime për demokratizimin e plotë të vendit. Bujqit e shtypur të fushave tona kërkonin konfiskimin e tokave të çifligarëve të mëdhenj dhe ndarjen e tyre fshatarëve. Gazeta shqiptare «Drita» në qershor 1924 shkruante: «Çrrënjosja e feudalizmit është një konditë themelore për qytetërimin e Shqipërisë. Feudalët përfaqësojnë vetëm e vetëm hajdutllëkun. Një klasë e tillë s'ka të drejtë të rrojë më... Pra lisin nga rrënja. Çdo hezitim është... një

tradhëti e rëndë kundër historisë shqiptare... Ktheni bujktut tokën, atë tokë, që e vaditi me djersë e me gjak, dhe feudalizmi humbi».

Filloi fushata për zgjedhjen e parlamentit të ri. Kudo flitej për nevojën e një qeverie të punëtorëve dhe fshatarëve. Kurrë ndonjëherë më parë lëvizja demokratike e masave nuk ishte zhvilluar në një mënyrë kaq të gjerë e kaq të thellë. Federata Komuniste Ballkanike dhe Partia Komuniste Italiane, në një thirrje që u drejtonin me këtë rast punëtorëve dhe fshatarëve të shteteve ballkanike dhe të Italisë si dhe popullit punonjës të Shqipërisë, e konsideronin kryengritjen e qershorit 1924 në Shqipëri si një «... kryengritje popullore... që lufton për ta zhdukur feudalizmin mesjetar në Shqipëri, për ta shkatërruar fuqinë ekonomike të bejlerëve, për të konfiskuar çifliqet e mëdha dhe për ta ndarë tokën midis masave pa tokë... që lufton për vendosjen e lirive politike për të gjithë popullin shqiptar dhe për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë kundër synimeve imperialiste të Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë»<sup>1</sup>.

Përsa u përket marrëdhënieve me shtetet e tjera, qeveria demokratike, duke shprehur dëshirën e masave revolucionare të popullit tonë, filloi të bënte një politikë të jashtme të pavarur, antiimperialiste. Ajo i drejtoi sytë nga mbrojtësi i interesave të popujve të vegjël, nga Bashkimi Sovjetik. Vetëm disa ditë pas formimit të saj qeveria mori vendim për të vendosur marrëdhënie të rregullta diplomatike me Bashkimin e Repu-

<sup>1</sup> Shih librin: «Mbi influencën e Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Shqipëri» (1917-1924). Tiranë, 1957, f. 110.

blikave Socialiste Sovjetike. Qeveria shqiptare ishte nga të parat qeveri që njohën Bashkimin Sovjetik dhe, nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik ishte i pari dhe i vetmi shtet që njohu Qeverinë Demokratike të Shqipërisë. Duke përshëndetur vendimin e qeverisë shqiptare dhe në përgjegje të notës së saj drejtuar qeverisë sovjetike për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike miqësore midis popullit sovjetik dhe shqiptar, komisar i punët e jashtme të BRSS përgjigjet: «Po përmbush me kënaqësi detyrën e ngarkuar për t'Ju njoftuar se qeveria e Bashkimit Sovjetik dëshiron të vendosë tani e tutje marrëdhënie diplomatike normale me qeverinë shqiptare.

Duke i drejtuar qeverisë së re shqiptare urimet tona më të mira, unë shpreh besimin e patundur se miqësia midis popujve tanë, duke u zhvilluar dhe duke u forcuar, do të sjellë frute të shumta për të mirën e njëri-tjetrit». Firmuar «G.Çiçerin»<sup>1</sup>. Kjo ishte një provë tjetër për ta bindur popullin shqiptar se i vetmi mik i vërtetë dhe aleat e tij i sigurtë ishte Bashkimi Sovjetik.

Politika e qeverisë demokratike nuk u pëlqeu aspak fuqive imperialiste të Perëndimit dhe qeverive shoviniste të shteteve fqinje të Jugosllavisë dhe Greqisë. Ata filluan menjëherë t'i jepnin ndihmë dhe përkrahje reaksionit të brendshëm për të përmbysur Qeverinë Demokratike të Shqipërisë. Kjo e fundit, e frikësuar nga kërcënimet e reaksionit të brendshëm dhe të fuqive të

---

<sup>1</sup> Dokumenta të politikës së jashtme të BRSS. Bot. rusisht, vëll. 7, f. 437-438, 1963.

mëdha imperialiste, u lëkund dhe nuk e vazhdoi me këmbëngulje zbatimin e programit të saj. Ndërsa masat e popullit protestonin me forcë kundër qëndrimit të ngathët të qeverisë, reaksioni shfrytëzonte lëkundjet e qeverisë dhe organizohej për të filluar kundërrevolucionin, i cili shpërtheu në dhjetor të vitit 1924, me përkrahjen direkte të forcave ushtarake jugosllave dhe të bandave mercenare bjellogardiste të Vrangelit. Nga mungesa e drejtimit dhe e organizimit të shëndoshë të forcave demokratike revolucionare, këto të fundit u shtypën shpejt dhe ushtria jugosllave me bandat reaksionare mundën të përmbysnin qeverinë demokratike dhe në vend të saj të vendosnin regjimin më tiranik feudalo-borgjez të Ahmet Zogut. Ky regjim i likuidoi të gjitha liritë demokratike të fituara nga masat popullore në revolucionin e qershorit dhe u hapi portat e Shqipërisë imperialistëve të Perëndimit. Por ai nuk mund të likuidonte shpresën e popullit shqiptar të lindur pas Revolucionit të Tetorit, se një ditë Shqipëria do të fitonte plotësisht lirinë dhe pavarësinë kombëtare dhe se pushteti i çifligarëve e i kapitalistëve do të përmbysej për t'ia lëshuar vendin pushtetit popullor.

### **Lufta çlirimtare e popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe tradhëtarëve**

Krahas me rritjen e lëvizjes së përgjithshme demokratike dhe antiimperialiste në Shqipëri, si rezultat i influencës së Revolucionit socialist të Tetorit, filloi të

rritej, të zgjerohej dhe të merrte një karakter më të organizuar dhe të ndërgjegjshëm edhe lëvizja punëtore. Punëtorët e përparuar, si brenda vendit ashtu edhe në mërgim, filluan të propagandonin nevojën e luftës së klasës punëtore kundër kapitalizmit. Por klasa jonë punëtore ishte akoma e vogël. Ajo nuk kishte parti të sajën. Për këtë shkak ajo nuk mundi të arrinte të luante rolin udhëheqës në lëvizjen revolucionare nacional-çlirimtare dhe demokratike gjatë periudhës 1918-1924 dhe mbeti si një rezervë e borgjezisë. Megjithkëtë kurrë më parë në vendin tonë lëvizja punëtore nuk kishte parë një gjallërim të tillë, si në vitet pas Revolucionit të Tetorit. Kjo gjë u duk në grevat që u organizuan në këtë periudhë nga klasa punëtore nëpër qendrat e ndryshme industriale të vendit dhe në parullat politike nën të cilat u zhvilluan këto greva. Greva më e madhe dhe më e organizuar në këtë kohë ka qenë ajo e punëtorëve të Minerës së Bitumit në Selenicë të Vlorës, që u bë në vitin 1923 dhe që përfundoi me fitoren e punëtorëve. Punëtorët fituan të drejtën për shtimin e mëditjeve nga 30 deri në 50 për qind, u hoq sistemi i punës qesim, u siguroa ndihma mjekësore për punëtorët dhe u morën masa për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetesës. Në këtë periudhë u organizuan edhe disa shoqëri profesionale të punëtorëve dhe të nëpunësve të vegjël në disa qytete të vendit tonë si në Shkodër, Korçë, Gjirokastër dhe gjetkë. Bile u bënë përpjekje për të krijuar edhe një «parti socialiste», por inisiatorët nuk mundën t'ia arrinin qëllimit pse akoma nuk ekzistonte një bazë e shëndoshë sociale për krijimin e një partie të klasës punëtore. Punëtorët hynë në radhët e



organizatës «Bashkimi», më përparimtarja dhe më e madhja e asaj kohe në vendin tonë.

Regjimi i Zogut, që erdhi në fuqi pas vitit 1924, zbatoi politikën e «portave të hapura», duke e vënë gati gjithë ekonominë e vendit tonë në vartësi të kapitalit të huaj dhe në radhë të parë atij italian. Gjatë këtij regjimi Shqipëria ishte kthyer në fakt në një gjysmëkoloni italiane. Duke pasur pozitat kyçe në ekonominë e vendit tonë, imperializmi italian, nëpërmjet regjimit të Zogut dhe të «Bankës Kombëtare», që ndodhej krejt në duart e kapitalistëve italianë, pengoi në çdo mënyrë zhvillimin e industrisë kombëtare në Shqipëri. Prandaj edhe gjatë sundimit të mbretit Zog, vendi ynë ngeli si më parë një vend i prapambetur agrar, që i siguronte Italisë fashiste lëndë të parë për industrinë e saj me çmim të lirë dhe një treg për shitjen e mallrave industriale italiane. Prodhimi i të gjitha degëve të industrisë në vitin 1938 zinte vetëm 9,8 për qind të prodhimit të përgjithshëm të vendit, kurse prodhimi bujqësor zinte 90,2 për qind. Me gjithë mbështetjen që u dha regjimi i Zogut feudalëve dhe kapitalistëve të huaj, ai nuk qe në gjendje ta ndalonte zhvillimin kapitalist të vendit, sado që ky zhvillim ishte i ngadalshëm. Si rrjedhim i zhvillimit kapitalist, klasa punëtore u rrit në krahasim me të kaluarën, por prapëseprapë ajo ishte shumë e shpërndarë. Të pakta ishin ato ndërmarrje që kishin mbi 25 punëtorë. Numrin më të madh të punëtorëve të grumbulluar e gjejmë në minierat që shfrytëzoheshin nga kapitalistët italianë dhe nëpër kantieret e ndërtimeve për qëllime strategjike, që kryheshin sipas planit të Italisë fashiste. Gjendja e punëtorëve kudo

ishte e mjeruar, kushtet e punës ishin aq të rënda sa nuk kishin ndonjë ndryshim nga ato që ekzistojnë në vendet koloniale. Punëtorët punonin 12 dhe 14 orë në ditë dhe në disa raste deri në 16 orë.

Sado i egër që të ishte dhe sado shtypje që të ushtronte, regjimi tiranik i Zogut nuk mund të pengonte influencën e fitores së revolucionit të madh proletar në Shqipëri, zhvillimin e luftës së klasës sonë punëtores për të drejtat e saja, nuk mund të pengonte depërtimin dhe përhapjen e lajmeve mbi jetën e lirë dhe punën krijuese të punëtorëve dhe të fshatarëve në Bashkimin Sovjetik. Që në vitet e para pas vendosjes së regjimit feudalo-borgjez të Zogut, nëpër qendrat kryesore të vendit, ku ishin grumbulluar një numër më i madh punëtorësh, si në Korçë, Kuçovë (sot Qyteti «Stalin»), Tiranë e Shkodër, filluan të përhapen gjithnjë e më shumë idetë komuniste dhe lajmet mbi jetën në Bashkimin Sovjetik. Nëpër këto qendra u bënë përjekje për të krijuar edhe shoqëri të punëtorëve.

Në Korçë që nga viti 1928 krijohen celulatat e para komuniste dhe deri në vitin 1929 krijohet atje grupi i parë komunist në Shqipëri, që njihet me emrin grupi komunist i Korçës. Në pjesën më të madhe grupi përbehej nga punëtorë dhe zanatçinj të varfër.

Për zhvillimin e mëtejshëm dhe veçanërisht për orientimin e drejtë të lëvizjes komuniste në vendin tonë, kanë dhënë një kontribut të çmueshëm Ali Kelmendi, në radhë të parë, dhe shokë të tjerë komunistë, që, pas disfatës së forcave demokratike në vitin 1924, shkuan në Bashkimin Sovjetik, mësuan dhe u edukuan atje me idetë marksiste-leniniste, e pastaj u kthyen në

Shqipëri nga vitet 1930-1933. Njëpërmjet shokut Ali Kelmendi dhe më vonë, pas vdekjes së tij, njëpërmjet shokëve të tjerë, grupi komunist i Korçës mbante lidhje dhe merrte direktiva nga Kominterni.

Nga viti 1936 në Shqipëri filloi të organizohej edhe një grup tjetër komunist, ai i Shkodrës.

Grupet komuniste në vendin tonë, me gjithë të metat e shumta që kishin, me gjithë kushtet e terrorit të egër, në të cilat ishin të detyruara të ushtronin aktivitetin e tyre, kanë bërë një punë të madhe për përhapjen e ideve komuniste në Shqipëri, për organizimin e klasës punëtore dhe për drejtimin e luftës së saj kundër kapitalistëve, regjimit feudalo-borgjez dhe imperializmit fashist italian. Ato bënë përpjekjet e para për lidhjen e socializmit me lëvizjen punëtore në vendin tonë. Me inisiativën e grupeve komuniste u krijuan në Shqipëri shoqëri profesionale të punonjësve si shoqëria «Puna», shoqëria e rrobaqepësve, shoqëria e këpuçarëve në Korçë, shoqëria «Puna» në Kuçovë, e cila kishte lart nga 3 000 anëtarë, shoqëria e tipografëve dhe shoqëria e marangozëve në Tiranë etj. Këto shoqëri të punonjësve kanë organizuar dhe drejtuar grevat, protestat dhe demonstratat e punëtorëve, midis të cilave nga më të mëdhatë mund të përmendim grevën e punëtorëve të Kuçovës në vitin 1936 dhe demonstratën e bukës në Korçë po në vitin 1936, veprime këto që ushtruan një efekt të madh në jetën politike të vendit. Grupet komuniste kanë ditur të shfrytëzojnë mundësitë legale për të ngjallur urrejtjen kundër regjimit dhe kundër fashizmit italian, për të zgjuar dhe forcuar ndërgjegjen e masave punonjëse në luftën për liritë demokratike.

Në ilegalitetin më të madh ato kanë mundur të përkthejnë vepra të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, të cilat qarkullonin dorë më dorë dhe lexoheshin nga punëtorët fshehurazi në dritën e kandilave.

Komunistët e grupeve tona i karakterizonte një dashuri e flaktë për vendin e parë socialist që krijoi Revolucionin i Tetorit, Bashkimin Sovjetik, dhe këtë dashuri ata e kishin rrënjosur edhe në zemrat e punëtorëve tanë.

Nëpër revistat që botonin grupet komuniste shkruhej me admirim mbi jetën në Bashkimin Sovjetik: «Në Rusinë Sovjetike, shkruante buletini «Përpara» i grupit komunist të Korçës, Revolucionin socialist është kryer. Proletariati është në fuqi i shoqëruar prej shumicës dërmuese të katundarëve. . . Rusia Sovjetike mund të quhet vendi ku demokratizimi në interes të popullit punëtor ka arritur formën më të përsosur. . . Atje punëtori dhe katundari e ndjen veten zot dhe çdo masë që merr shteti e studjon nga pikëpamja e interesit të popullit punëtor»<sup>1</sup>. Kurse në një numër tjetër po të këtij buletini shkruhej se Rusia Sovjetike kurdoherë ka ndihmuar pa interes popujt e shtypur dhe ka dhënë shembullin se punëtorin mund të ndërtojë socializmin dhe të jetë zot në vendin e vet.

Komunistët dhe punëtorët dëgjonin fshehurazi nëpër bodrumet Radio Moskën dhe pastaj lajmet mbi Bashkimin Sovjetik shkonin gojë më gojë dhe përha-

---

<sup>1</sup> Shih: «Dokumenta e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941». Tiranë, 1959, f. 420-421.

peshin në masat e shtypura të vendit tonë. Shumë herë këto lajme nuk ishin të plota, dhe as që mundej në kushtet e terrorit dhe të ndjekjeve të egra të regjimit të Zogut populli ynë të mësonte gjithshka që ngjiste në Bashkimin Sovjetik, por një gjë ishte e sigurtë: njerëzit e varfër të popullit tonë e ndjenin dhe e dinin se në Rusi kishte ndodhur një gjë e jashtzakonshme, se atje nuk ishin më zotër çifligarët dhe kapitalistët, por ishte zot vetë populli, punëtorët dhe fshatarët, të cilët bënin çudira në ndërtimin e jetës së re. Duke parë gjendjen e mjeruar në të cilën i kishte zhytur regjimi feudalo-borgjez, thoshin me ankth dhe me shpresë: «Do të vijë dita patjetër që edhe në Shqipëri të përmbysen bejlerët dhe kapitalistët ashtu si në Rusi». Shumë anëtarë të grupeve komuniste, punëtorë, studentë të shkollave dhe intelektualë u burgosën, u internuan dhe u persekutuan për propagandën kundër regjimit dhe fashizmit, për përhapjen e ideve komuniste dhe për propagandën mbi Bashkimin Sovjetik, por asnjë lloj terrori nuk mund ta thyente dashurinë dhe besimin që kishin njerëzit tanë ndaj Bashkimit Sovjetik. Ky besim u forcua akoma më shumë në ditët e vështira për popullin tonë, kur Italia fashiste në prill të vitit 1939 e sulmoi dhe e pushtoi në një mënyrë të egër vendin tonë. Ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca dhe Anglia, prej të cilave populli shqiptar nuk ka parë veçse të këqia, i linin dorë krejt të lirë Italisë duke deklaruar se «nuk kishin interesa të posaçme» në Shqipëri, kur shtetet fqinje e shikonin me buzëqeshje pushtimin e Shqipërisë nga fashistët, vetëm Bashkimi

Sovjetik e ngriti zërin dhe dënoi agresionin kundër vendit tonë.

Populli shqiptar i priti me pushkë pushtuesit fashistë. Në Durrës dhe në portet e tjera të Shqipërisë patriotët shqiptarë, në kundërshtim me urdhërin, bënë një rezistencë të vendosur kundër invaduesve. Përpara invadimit i tërë populli shqiptar u çua më këmbë duke kërkuar armë për të luftuar pushtuesin, por regjimi i Zogut në asnjë mënyrë nuk mund t'i jepte këto armë, kështu që populli ynë i paarmatosur, i tradhëtuar dhe pa asnjë përkrahje, u mposht dhe vendi u pushtua. Por megjithkëtë populli shqiptar për asnjë çast nuk u përkul dhe nuk e pranoi okupacionin. As demagogjia as terrori dhe as politika e shkombëtarizimit dhe e kolonializimit që përdorën fashistët italianë në vendin tonë, nuk patën asnjë sukses. Urrejtja e thellë e popullit shqiptar kundër armikut të tij të vjetër erdhi gjithnjë duke u rritur, dhe kjo urrejtje u shfaq në forma të ndryshme politike deri në veprime të hapëta kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve shqiptarë. Nën udhëheqjen e komunistëve masat punonjëse, patriotët dhe rinia shqiptare filluan demonstratat, grevat, protestat, sabotazhet, atentatet, filloi propaganda për demaskimin e fashizmit; populli shqiptar po bënte me guxim hapat e parë të rezistencës së armatosur kundër armiqve.

Besimi i patundur dhe dëshira që kishin komunistët dhe shtresat e varfëra të popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik, u duk me një forcë akoma më të madhe kur Gjermania hitleriane e sulmoi tradhëtisht vendin e Sovjetëve në qershor të vitit 1941 dhe vuri në rrezik fi-

toret e Revolucionit të Tetorit dhe të punës paqësore heroike njëzetvjeçare të popullit sovjetik.

Hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftë i dha hov rezistencës së popullit shqiptar kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve dhe i vuri në lëvizje të madhe grupet komuniste të Shqipërisë. Që në ditët e para ato dhanë kushtrimin për luftën e popullit tonë kundër pushtesve fashistë. Ato i drejtoheshin popullit:

«Imperializmi fashist gjerman dhe italian, i pangopur me gjak dhe me krime në kurriz të popujve të vegjël dhe të mëdhenj, po i vërsulet si një bishë e tërbuar edhe Bashkimit Sovjetik, atdheut të punëtorit dhe të bujkut, djepit të lirisë së popujve... Popull shqiptar! Ardhi koha të luftojmë fashizmin e poshtër dhe të vëmë në litar këlyshët e tij, bejlerët dhe spiunët. Në këmbë, me armë në dorë, luftë kundër fashizmit, kundër bejlerëve dhe fajdexhinjve...»<sup>1</sup>.

«Bisha fashiste, — thuhej në një thirrje tjetër, — pasi shkretoi me luftën e saj imperialiste popujt e të gjithë Evropës, tani ka vënë synë në të vetmin vend që do paqen, Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike, atdheun e lirë të punëtorëve dhe fshatarëve sovjetikë... Popull shqiptar! Sot erdhi dita të çlirohemi nga zgjedha e dyfishtë e imperializmit fashist dhe e çifligarëve shqiptarë, qehajallarë të fashizmit.

Të gjithë pra, punëtorë, fshatarë, intelektualë, ushtarë të ndershëm, pa dallim feje e krahine, të bash-

---

<sup>1</sup> Thirrje e një grupi komunist, 28 qershor 1941. Arkivi Qendror i Partisë.

kojmë fuqitë tona për një Shqipëri të lirë, e cila do t'i sigurojë gjithë popullit bukën, paqen dhe drejtësinë. Rroftë populli shqiptar! Rroftë Unioni Sovjetik! Rroftë Ushtria e Kuqe, çliruese e popujve të shtypur!<sup>1</sup>

Dhe me të vërtetë, vetëm pas hyrjes së Bashkimit Sovjetik në luftën kundër fashizmit, ishin krijuar kushtet objektive dhe perspektivat e qarta për çlirimin e vendit tonë. Këto kushte përcaktuan edhe formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Përpara një gjendjeje të tillë, komunistët internacionalistë shqiptarë i detyruan udhëheqësit e grupeve komuniste që të pushonin grindjet midis tyre dhe të mblidheshin së bashku për të diskutuar dhe për të krijuar një parti të vetme të klasës punëtore. Në mbledhjen që u organizua për këtë qëllim me përfaqësuesit e grupeve kryesore komuniste, pas një lufte të ashpër, ku u shkatërruan pikëpamjet trockiste dhe anarkiste të elementëve antimarksishtë, u formua më 8 Nëntor Partia Komuniste Shqiptare, në përvjetorin e 24 të Revolucionit të madh socialist të Tetorit. Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës), lindi dhe u krijua si rezultat i forcimit të lëvizjes punëtore dhe i përhapjes së ideve komuniste në vendin tonë nën influencën e Revolucionit të Tetorit dhe të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Që në ditët e para të krijimit, Partia shpalli në mënyrë të qartë programin e saj dhe i bëri thirrje popullit shqiptar për t'u ngritur më këmbë dhe për

---

<sup>1</sup> Thirrje e një grupi komunist, gusht 1941. Arkivi Qendror i Partisë.



të organizuar luftën e armatosur dhe pa kompromis kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe në vendosjen e një regjimi demokratik popullor.

Thirrjes së Partisë iu përgjegj i madh dhe i vogël. I tërë populli ynë, punëtorët, fshatarët, inteligjencia patriotike, rinia dhe gratë e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, rrokën armët dhe luftuan me heroizëm dhe vetëmohim, si kurrë ndonjëherë më parë. Partizanët e lavdishëm të Shqipërisë për vite me radhë, në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe krejt të pabarabarta me forcat e armikut, zhvilluan luftime të përgjakshme dhe në saje të luftës dhe të fitoreve historike të Ushtrisë Sovjetike, që shkatërroi hordhitë hitleriane, i mundën pushtuesit fashistë italianë e gjermanë së bashku me tradhëtarët e vendit, duke e çliruar atdheun nga robëria shekullore dhe duke i dhënë popullit tonë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin. Më 29 Nëntor 1944, në Shqipërinë e lirë e të pavarur, populli ynë për herë të parë e ndjente veten zot të vendit të tij.

Pas çlirimit të atdheut, Ushtria jonë Popullore, e krijuar në Luftën e madhe nacional-çlirimtare të popullit shqiptar, e vazhdoi luftën kundër pushtuesve hitlerianë edhe përtej kufive, në tokat e Jugosllavisë, duke kryer në këtë mënyrë një detyrë të lartë internacionaliste. Luftëtarët shqiptarë luftuan dhe derdhën gjak krah për krah me partizanët jugosllavë në Mal të Zi, Bosnjë, Hercegovinë, Kosovë e Metohi, duke ndihmuar kështu në çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Në luftën pesëvjeçare që bëri populli shqiptar kun-

dër pushtesve fashistë dhe tradhëtarëve, u shkaktoi atyre dëme të konsiderueshme në njerëz dhe në materiale luftarake; dëmet e armiqve në Shqipëri arrijnë në afër 70 mijë të vrarë, të plagosur dhe robër.

Por edhe populli shqiptar pësoi dëme të rënda nga okupatorët fashistë: 7,3 për qind e popullsisë mbeti e vrarë, e humbur ose e plagosur, 21 për qind e shtëpive në fshatrat u dogj ose u rrëzua, 1/3 e bagëtisë u asgjësua, të gjitha qytetet u dëmtuan rëndë, fabrikat dhe komunikacioni mbetën të shkatërruar.

Por me gjithë këto, populli shqiptar kishte arritur fitoren më të madhe në historinë e tij shekullore. Këtë fitore atij ia kishte siguruar Partia Komuniste Shqiptare.

### **Rruga e popullit shqiptar është rruga e çarë nga Revolucioni i madh i Tetorit**

16 vjet kanë kaluar nga dita që është krijuar Partia e Punës e Shqipërisë. Kjo është një kohë mjaft e shkurtër. Por brenda kësaj kohe populli shqiptar ka arritur fitoret më të mëdha gjatë historisë së tij mijëvjeçare. U çlirua atdheu nga pushtesit e huaj dhe populli ynë fitoi për herë të parë lirinë dhe pavarësinë e tij kombëtare, u krye dhe triumfoi revolucioni popullor, u përmbys pushteti i bejlerëve dhe i kapitalistëve dhe u vendos për herë të parë pushteti i punëtorëve dhe i fshatarëve punonjës, tani populli shqiptar po ndërton me sukses socializmin.

Si ka qenë e mundur që brenda një kohe kaq të

shkurtër një Parti e re e një vendi kaq të vogël si Shqipëria të mund t'i siguronte popullit tonë fitore kaq të mëdha? Ne vazhdimisht e kemi thënë dhe e përsëritim se sukseset tona janë bërë të mundura, në radhë të parë, sepse Partia e Punës e Shqipërisë ka zbatuar me besnikëri dhe në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin dhe mësimet themelore të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, sepse ajo është mbështetur në eksperiencën e Partisë mëmë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në eksperiencën e shtetit të parë socialist në botë, BRSS, dhe ka pasur ndihmën dhe përkrahjen e gjithanshme të tij, sepse vendi ynë po ndërton socializmin në epokën e shkatërrimit të sistemit kapitalist botëror dhe të triumfit të socializmit, epokë që e çeli Revolucionin i Tetorit.

Praktika e luftës revolucionare dhe e ndërtimit të socializmit në Shqipëri vërtetojnë në mënyrë shumë bindëse fjalët e V.I. Leninit në lidhje me rëndësinë ndërkombëtare të Revolucionit të Tetorit, se:

*«...disa tipare kryesore të revolucionit tonë nuk kanë një rëndësi lokale, të veçantë nacionale, vetëm ruse, por një rëndësi ndërkombëtare»<sup>1</sup>,*

vërtetojnë se eksperiencia e Bashkimit Sovjetik në revolucion dhe në ndërtim ka një rëndësi universale, është e vlefshme për të gjitha vendet e mëdha dhe të vogla, në të gjitha rrethanat. Rruga e Revolucionit të Te-

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 5.

torit dhe e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik pasqyrojnë ligjet e përgjithshme të revolucionit dhe të ndërtimit socialist.

Ligjet e përgjithshme, mësimet themelore që nxjerrim nga Revolucioni i Tetorit, që kanë një rëndësi universale janë: vetëm partia e klasës punëtore, ku bëjnë pjesë njerëzit më të ndërgjegjshëm, që udhëhiqet në gjithë veprimtarinë e saj nga shkenca marksiste-leniniste, një parti me unitet të çelniktë, një parti që vendos dhe mban lidhje të ngushta me masat punonjëse dhe i edukon këto masa me marksizëm-leninizmin, është në gjendje që të udhëheqë me sukses klasën punëtore dhe të gjitha masat punonjëse në përmbysjen e kapitalizmit dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste; vetëm proletariati nën udhëheqjen e partisë së tij, duke bashkuar me vete gjithë punonjësit dhe në radhë të parë fshatarësinë, është në gjendje që t'ia marrë nga duart borgjezisë pushtetin politik dhe se kjo gjë mund të arrihet vetëm me rrugë revolucionare; për ndërtimin e shoqërisë socialiste nevojiten: pushteti politik i klasës punëtore, d.m.th. diktatura e proletariatit mbi çifligarët dhe borgjezinë, e mbështetur në një aleancë të shëndoshë të klasës punëtore me fshatarësinë, shtetëzimi i industrisë dhe kolektivizimi gradual i bujqësisë, duke vendosur në këtë mënyrë pronën shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit, zhvillimi i planifikuar i ekonomisë dhe i kulturës socialiste dhe mbi këtë bazë ngritja graduale e mirëqenies së popullit; shteti socialist, i udhëhequr nga partia mbron me vendosmëri fitoret e revolucionit nga përpjekjet e ish-klasave shfrytëzuese sunduese dhe nga shtetet imperialiste, njeh

barazinë e të gjithë popujve dhe u përmbahet me besnikëri parimeve të internacionalizmit proletar.

Të largohet një parti e klasës punëtore nga këto mësimet themelore, do të thotë të hyjë në një qorrsokak dhe të humbasë.

Mësimet themelore të Tetorit, të përbashkëta për të gjitha partitë komuniste dhe punëtore dhe për të gjitha vendet, të mëdha dhe të vogla, nuk mohojnë në asnjë mënyrë format, metodat dhe ritmet e ndryshme të kalimit në socializëm që mund të përdorë çdo vend, sipas kushteve të tij të veçanta, që krijohen nga gjendja e brendshme dhe e jashtme e tij. Çdo parti, çdo vend sjell eksperiencën e vet të çmueshme në thesarin e përgjithshëm të marksizëm-leninizmit. Asnjë marksist nuk pretendon se çdo gjë e eksperiencës sovjetike duhet të zbatohet në mënyrë dogmatike, mekanike, kudo dhe në çdo rrethanë. Bile kauza e socializmit mund të triumfojë në një vend, vetëm në qoftë se partia komuniste e këtij vendi do të dijë të zbatojë në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, mësimet themelore të Revolucionit të Tetorit dhe eksperiencën e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik, në përshtatje me kushtet e veçanta dhe karakteristikat kombëtare të vendit në fjalë. Marksizëm-leninizmi nje, pra, se çdo lëvizje komuniste në vendet e ndryshme ka patjetër karakteristikat e veta kombëtare. Por kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se çdo lëvizje nuk ka tipare themelore të përbashkëta, të domosdoshme për të gjitha vendet, tipare, të cilat u përmendën më sipër. Vetëm armiqtë e komunizmit, vetëm revizionistët e sotëm të marksizëm-leninizmit, nën pretekstin e kundërshtimit të kopjimit mekanik të

eksperiencës sovjetike, nën pretekstin e kushteve specifike të çdo vendi dhe me teorinë e tyre të «komunizmit nacional», e mohojnë rëndësinë universale të eksperiencës sovjetike, përpiqen me qëllim ta diskreditojnë këtë eksperiencë.

Edhe në vendin tonë Lufta nacional-çlirimtare dhe ndërtimi i socializmit kanë karakteristikat e tyre të veçanta. Por ne nuk mund të themi kurrë që rruga, në të cilën kemi ecur dhe po ecim sot, është një rrugë që nuk e ka çarë njeri më parë. Rruga që kemi përshkuar ne dhe përshkujmë sot është rruga e çarë më parë nga Revolucioni socialist i Tetorit, nga Bashkimi Sovjetik. Partia e Punës e Shqipërisë ka zbatuar në mënyrë krijuese, jomekanike, në rrethanat tona konkrete, mësimet e Tetorit dhe eksperiencën e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Le të shohim shkurt si i ka zbatuar Partia e Punës e Shqipërisë mësimet themelore të Revolucionit të Tetorit dhe eksperiencën universale sovjetike në kushtet konkrete të revolucionit popullor dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë që në fillim u krijua si parti marksiste-leniniste, parti e tipit të ri, si parti e vetme e klasës punëtore dhe e masave punonjëse në Shqipëri, në shembullin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në rezolucionin e parë të Partisë, të aprovuar në mbledhjen e grupeve komuniste për themelimin e Partisë thuhej:

*«... partia nuk do të bëhet parti e tipit të vjetër, parti e ngjashme me ato të Ndërkombëtares së dytë socialdemokrate, në të cilën mbretëronte brejtja, mos-*

*punimi, tarafllëku, fraksionazhi dhe tradhëtia e intereseve të klasës punëtore. Duam një parti të disiplinuar... parti e cila do të jetë e zonja të udhëheqë klasën punëtore në luftë deri në fitim, e cila do të jetë ngushtësisht e lidhur me të gjitha turmat punonjëse të qytetit dhe të fshatit»<sup>1</sup>.*

Që të mund të kryente me sukses detyrat historike që i shtroheshin përpara, Partia jonë, duke mbajtur parasysh eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i ka kushtuar vazhdimisht një vëmendje shumë të madhe forcimit organizativ të saj në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, i ka shtuar radhët e saja me elementë të sprovuar dhe të vendosur nga radhët e shtresave të varfëra të qytetit dhe të fshatit, ka bërë një punë këmbëngulëse për edukimin e anëtarëve të saj me teorinë marksiste-leniniste.

Në mënyrë të veçantë dhe me forcë të madhe Partia i ka vënë rëndësi çështjes së ruajtjes dhe forcimit të unitetit të saj, të cilin Lenini e ka quajtur si një nga kushtet më themelore që partia të mund të kalojë vështirësitë dhe të udhëheqë me sukses proletariatin dhe të gjitha masat punonjëse në përmbysjen e kapitalizmit dhe në ndërtimin e socializmit. Për të siguruar një unitet të tillë, Partia ka luftuar pa ndërprerje për të farkëtuar në radhët e anëtarëve një disiplinë të çelënikte dhe të vetëdijshme dhe ka luftuar në mënyrë të vendosur kundër çdo shfaqjeje që synonte të shthurte

---

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 23.

disiplinën dhe të mbillte anarkizmin dhe konfuzionin në radhët e Partisë. Një luftë të vendosur dhe parimore, për ruajtjen e unitetit të radhëve të saja, Partia ka bërë kundër armiqve të brendshëm, fraksionistëve, oportunistëve, kapitullantëve dhe gjithë tradhëtarëve që janë munduar ta largojnë Partinë nga rruga e drejtë e marksizëm-leninizmit dhe ta shkatërrojnë atë, duke likuiduar pastaj edhe të gjitha fitoret e popullit tonë të arritura me gjak e sakrifica të shumta. Në këtë drejtim ka punuar banda tradhëtare e Koçi Xoxes, që me krimet e saj është përpjekur të shkatërrojë unitetin e Partisë, ta kthejë Partinë tonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze dhe ta zhdukë në këtë mënyrë regjimin e demokracisë popullore. Këto qëllime kanë pasur gjithashtu edhe Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Bedri Spahiu, Tuk Jakova, Liri Gega, Dali Ndreu e të tjerë armiq të Partisë dhe të socializmit. Por Partia e Punës e Shqipërisë i ka goditur pa mëshirë të gjithë këta armiq dhe ka ruajtur si sytë e ballit unitetin e saj, i cili sot është më i fortë se kurdoherë dhe u bën ballë me sukses të gjitha orvatjeve të armiqve të jashtëm e të brendshëm që kërkojnë të dëmtojnë interesat jetike të popullit shqiptar.

Revolucioni socialist i Tetorit dhe socializmi triumfuan në Bashkimin Sovjetik, sepse në krye të tyre kanë pasur Partinë e madhe Bolshevike, e cila me politikën e saj të drejtë ka ditur të krijojë lidhje të çelnikta me masat e gjera punonjëse. Duke u mbështetur në këtë eksperiencë, Partia jonë gjithnjë është mbështetur në masat e gjera të popullit, ka adoptuar kurdoherë një politikë të atillë që t'u përgjigjet intere-



sive dhe aspiratave të masave punonjëse dhe në këtë mënyrë ajo ka mundur të farkëtojë dhe të mbajë lidhje shumë të forta e të pathyeshme me masat. Në momentet më të vështira, si gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ashtu edhe në periudhën e rindërtimit dhe ndërtimit socialist të vendit, Partia u është drejtuar masave dhe ato e kanë mbështetur në mënyrë të fuqishme politikën e drejtë të Partisë sonë. Ndryshe nuk mund të shpjegohen fitoret e revolucionit tonë popullor dhe sukseset e arritura në ndërtimin e socializmit.

Partia jonë krijoi lidhje të forta me masat sepse nuk harroi asnjëherë që forca e saj qëndron pikërisht te ato. Ajo luftoi kundër çdo gjëje që dobësonte këto lidhje, kundër mosbesimit në masat, kundër nënvleftësimit të rolit të tyre, kundër sektarizmit dhe mendjemadhësisë që shfaqeshin herë pas here në disa nga kuadrot tanë. Kongresi III i PPSH vuri si detyrë kryesore ruajtjen dhe forcimin e traditës së shkëlqyer të lidhjes së Partisë sonë me masat, forcimin akoma më shumë të këtyre lidhjeve, duke luftuar pa pushim kundër formalizmit, sektarizmit dhe burokratizmit, që i ndrydhin energjitë krijuese dhe iniciativën e masave.

Nga analiza që i kemi bërë në rrugës së Partisë sonë që prej themelimit të saj dhe deri në ditët e sotme, kemi nxjerrë si konkluzion se programi dhe vija politike e Partisë kanë qenë të drejta dhe se Partia në çështjet themelore të marksizëm-leninizmit nuk ka gabuar.

Partia Komuniste e Shqipërisë u krijua në një situatë, kur shtrohej në mënyrë urgjente detyra e mo-

bilizimit të popullit shqiptar dhe e organizimit të luftës kundër pushtuesve për çlirimin e atdheut. Koha nuk priste, duhej vepruar menjëherë. Dhe megjithëse Partia jonë sapo ishte krijuar, ajo diti t'i bëjë një vlerësim të drejtë marksist-leninist situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit dhe në bazë të këtij vlerësimi adoptoi që në fillim një program luftarak dhe një politikë, që u përgjigjeshin plotësisht interesave të vendit tonë, interesave të masave punonjëse dhe interesave të luftës së përgjithshme antifashiste, që kryesohej nga Bashkimi Sovjetik.

Në programin e vet Partia vuri si detyrë kryesore luftën e paprerë dhe pa kompromis kundër pushtuesve fashistë italianë dhe gjermanë dhe kundër tradhëtarëve për çlirimin e atdheut. Në të njëjtën kohë, krahas me detyrën e parë, ajo vuri edhe detyrën tjetër: shkaktërrimin që nga themeli të pushtetit të vjetër të feudo-borgjezisë dhe ngritjes në vend të tij të pushtetit të këshillave nacional-çlirimtare, të pushtetit demokratik popullor. Gjithashtu në programin e Partisë parashikohet që pas çlirimit të vendit të zbatoheshin reforma të mëdha shoqërore dhe ekonomike për popullin, në radhë të parë reforma agrare.

Ky program i Partisë gjeti menjëherë përkrahjen e shëndoshë të masave të gjera të popullit tonë, të cilat e njohën dhe e pranuan me gjithë zemër drejtimin e Partisë, sepse panë që vetëm Partia Komuniste kishte shpallur një program konkret, që u përgjigjej aspiratave të tyre, dhe se vetëm ajo zbatonte një vijë politike të drejtë dhe konsekuente në interes të popullit. Kjo përkrahje e shëndoshë që gjeti Partia në masat e po-

pullit bëri që ajo t'ia arrinte shumë shpejt qëllimit për krijimin e një Fronti të përbashkët Nacional-Çlirimtar të popullit shqiptar. Në luftë e sipër u organizuan forcat e armatosura të popullit, Ushtria Nacional-Çlirimtare, e cila në vitin 1944 numëronte 70 mijë vetë.

Përsa i përket klasës së çifligarëve dhe borgjezisë së madhe të vendit tonë, ato u lidhën më fort me okupatorët dhe i shpallën hapur luftë Partisë Komuniste dhe lëvizjes nacional-çlirimtare, që drejtonte Partia. Me përkrahjen direkte materiale dhe morale të okupatorëve fashistë, nga njëra anë, dhe të imperialistëve anglezë dhe amerikanë, nga ana tjetër, klasat sunduese të vendit ngritën organizatat e tyre tradhëtare «Balli Kombëtar», «Legaliteti» etj. si dhe bandat e tyre të armatosura. Nga fundi i vitit 1943 përkrah okupatorëve luftonin kundër lëvizjes sonë nacional-çlirimtare edhe tradhëtarë shqiptarë. Klasat sunduese ishin hedhur me të gjitha forcat kundër popullit. Ato luftonin për të ruajtur pozitat e tyre të privilegjuara ekonomike dhe politike, duke u bashkuar me armiqtë më të egër të popullit dhe të kombit shqiptar si dhe të gjithë njerëzimit, me agresorët fashistë. Në këto kushte Lufta nacional-çlirimtare që bënte populli ynë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, përveç karakterit nacional-çlirimtar merrte dhe një karakter të theksuar klase. Në lidhje me këtë çështje Partia Komuniste Shqiptare asnjëherë nuk ka ngurruar që të veprojë në mënyrë të vendosur duke demaskuar të gjitha manevrat e reaksionit dhe duke bërë një luftë të pamëshirshme deri në shkatërrimin e plotë të organizatave dhe bandave reaksionare të klasave shfrytëzuese. Ush-

tria Nacional-Çlirimtare që u krijua dhe drejtohej nga Partia, duke luftuar ushtrinë e okupatorit, godiste dhe shkatërronte njëkohësisht edhe bandat e armatosura të tradhëtarëve shqiptarë.

Pushteti i klasave sunduese dhe i okupatorit shkatërrohej dora-dorës me çlirimin e vendit. Në çdo krahinë dhe në çdo fshat e qytet, që çlirohej nga pushtuesit e tradhëtarët, puna e parë që bëhej ishte shkatërrimi i pushtetit të vjetër dhe ngritja nga masat e popullit të këshillave nacional-çlirimtare, të cilat përbënin bërthamën e pushtetit të ardhshëm popullor.

Që gjatë Luftës nacional-çlirimtare Partia Komuniste mori masa jo vetëm për organizimin e pushtetit popullor lokal e krahinor, por edhe për organizimin e pushtetit popullor qendror. Që në vitin 1942 u krijua Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar si organ për mobilizimin e popullit në luftë dhe për organizimin e këshillave nacional-çlirimtare, kurse në maj të vitit 1944 u mbajt në qytetin e lirë të Përmetit Kongresi Antifashist Nacional-Çlirimtar, ku merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha krahinat e vendit dhe nga repartet e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Në kongres u vendos njëzëri që të ndalohej me çdo mënyrë kthimi i regjimit tiranik të Zogut dhe të mos njihej asnjë pushtet tjetër në Shqipëri, përveç pushtetit të këshillave nacional-çlirimtare. Në këtë kongres u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm Antifashist dhe Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar Shqiptar me atributet e një qeverie të përkohshme demokratike popullore për gjithë Shqipërinë. Në prakun e çlirimit të vendit, tetor 1944, Komiteti Antifashist u kthye në Qeveri Demokratike

të Shqipërisë. Kështu pra pushteti popullor në vendin tonë u themelua që përpara çlirimit të vendit nga pushtuesit fashistë, ndërsa menjëherë pas çlirimit ky pushtet u vendos në gjithë Shqipërinë.

Në krye të Luftës nacional-çlirimtare dhe të pushtetit ka qenë pa ndërprerje Partia Komuniste, e cila përfaqësonte interesat e klasës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse të vendit tonë.

Si e ka zgjidhur Partia jonë çështjen e hegjemonisë së klasës punëtore në revolucionin tonë popullor dhe çështjen e aleancës së klasës punëtore me shtresat e tjera të punonjësve, në radhë të parë me fshatarësinë? Dihet që kur u krijua Partia jonë Komuniste në vendin tonë fshatarësia përbënte shumicën dërmuese prej më se 80 për qind të popullsisë, kurse klasa punëtore ishte fare e vogël dhe e shpërndarë. Partia e ka pasur kurdoherë parasysh këtë karakteristikë të veçantë të vendit tonë dhe në këto kushte ka mundur të farkëtojë në Luftën nacional-çlirimtare një aleancë të çelniktë të klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Klasa jonë punëtore vërtet ishte e vogël, por ka qenë klasa e vetme në vendin tonë që ka pasur eksperiencën e organizimit të luftës kundër klasave shfrytëzuese dhe kundër fashizmit. Ajo kishte krijuar prej kohësh organizatat e veta profesionale dhe ishte hedhur në luftë kundër punëdhënësve kapitalistë dhe kundër regjimit shtypës të Zogut. Klasa punëtore, nën drejtimin e grupeve komuniste, që e para që u hodh në luftë të hapët kundër okupatorëve fashistë italianë. Ajo ishte klasa më e përparuar e vendit, më

e ndërgjegjshme dhe më e gatshme për revolucionin. Pastaj, me krijimin e Partisë Komuniste, klasa punëtore kishte udhëheqjen e saj të shëndoshë marksiste-leniniste. Një udhëheqje të tillë asnjë klasë tjetër nuk e kishte. Por përveç këtyre klasa jonë punëtore kishte edhe një mbështetje tjetër shumë të madhe, proletariatin e fuqishëm ndërkombëtar dhe në radhë të parë kishte ndihmën e shtetit të madh sovjetik, ku proletariati ishte prej kohësh në fuqi dhe ku ishte ndër-tuar socializmi. Tani ky shtet udhëhiqte luftën vigane kundër fashizmit. Pra, klasa jonë punëtore, megjithëse e vogël, i kishte të gjitha mundësitë dhe duhej të bëhej udhëheqëse e shtresave të tjera punonjëse në Luftën nacional-çlirimtare dhe në plotësimin e detyrave të revolucionit popullor.

*«Ju punëtorë dhe punëtore të Shqipërisë — bënte thirrje Komiteti Qendror i PKSH në prill të vitit 1942 — duhet të zini vendin e parë në radhët e para luftarake, në luftën e sotme të shenjtë të popullit tonë për çlirimin kombëtar»<sup>1</sup>.*

Për ta ngritur klasën punëtore në vendin udhëheqës të luftës, Partia jonë ka bërë përpjekje shumë të mëdha dhe të vazhdueshme dhe në këtë mënyrë, duke qenë kurdoherë vetë në krye, arriti që të siguronte rolin udhëheqës të proletariatit.

Në të njëjtën kohë Partia jonë, me politikën e saj të drejtë, ka ditur të shfrytëzojë deri në fund energjitë

---

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 74.

shumë të mëdha dhe traditat luftarake dhe patriotike të fshatarësisë sonë të shtypur dhe të vuajtur, duke farkëtuar një aleancë të çelnihtë luftarake midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse. Asnjëherë nuk e nënvleftësoi Partia forcën e madhe të fshatarësisë sonë. Ajo vazhdimisht i porosiste komunistët që punës në fshat t'i jepej një rëndësi e veçantë dhe se fshatarësia duhej të bëhej burimi kryesor i forcave për Luftën nacional-çlirimtare. Duke gjetur te Partia Komuniste të vetmen udhëheqëse që do t'ia siguronte realizimin e ëndrrave shëkullore, do t'i jepte lirinë dhe tokën, fshatarësia jonë punonjëse u lidh ngushtë dhe u bë një mbështetje kryesore e Partisë për realizimin e programit të saj, u bë forca kryesore sulmuese në luftën e armatosur kundër armiqve.

E kundërta ngjau me shtresën e pasur të fshatarësisë. Megjithëse parulla e Partisë në lidhje me fshatarësinë gjatë Luftës nacional-çlirimtare ka qenë që e gjithë fshatarësia, pa bërë dallimin midis të varfërve dhe të pasurve, të tërhiqej në luftën kundër okupatorëve, fshatarët e pasur, kulakët, nuk iu përgjegjën thirrjes së Partisë, ata morën anën e kundërt të Luftës nacional-çlirimtare dhe u bënë mbështetje kryesore në fshat e organizatave tradhëtare «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti».

Ky diferencim që u bë qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare në radhët e fshatarësisë sonë e përforcoi akoma më shumë karakterin revolucionar të kësaj lufte.

Pas çlirimit të vendit të parët që fituan nga përfundimi ngadhënjimtar i Luftës nacional-çlirimtare dhe i revolucionit popullor ishin fshatarët punonjës. Nga

masat që mori Partia menjëherë pas çlirimit, më kryesorja ishte zbatimi i reformës agrare, e cila përbën një revolucion të vërtetë agrar në vendin tonë. Një reformë agrare, kaq e thellë dhe revolucionare, si ajo që u bë në Shqipëri, mund të bëhet vetëm atëhere kur pushtetin e ka në dorë klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse. Me parullën «toka u takon atyre që e punojnë», Partia ua mori tokat dhe mjetet e punës pa shpërblim çifligarëve, tregëtarëve dhe të gjithë atyre që nuk e punonin vetë tokën, kurse kulakëve u la vetëm 5 hektarë tokë për familje. Toka dhe mjetet e punës të shpronësuara iu ndanë falas fshatarëve pa tokë ose me pak tokë. Me ligjin e reformës agrare, megjithëse toka nuk u nacionalizua për arsye të kushteve historike të veçanta të vendit tonë, u ndalua kategorikisht shitja dhe blerja e tokës si dhe jetërsimi i saj. Në këtë mënyrë u likuiduan një herë e përgjithmonë mbeturinat e feudalizmit në ekonomi, të cilat ishin aq të mëdha në fshatin tonë. Nga ana tjetër u prekën thellë edhe bazat e kapitalizmit në fshat. Me zbatimin e reformës agrare, fshatarët tanë punonjës u lidhën akoma më shumë me Partinë, u forcua akoma më tepër aleanca e tyre me klasën punëtore.

Me përfundimin e reformës agrare, nga gjysma e dytë e vitit 1946, merrte fund edhe zgjidhja e detyrave të revolucionit demokratiko-borgjez. Është karakteristike për vendin tonë kalimi nga revolucioni demokratiko-borgjez në revolucionin socialist. Etapa e parë e revolucionit është gërshetuar me etapën e dytë. D.m.th. përpara se të merrte fund etapa e parë, bile edhe paralelisht me masat që kanë të bëjnë me zgjidhjen e detyrave të revolucionit demokratiko-borgjez, u reali-



zuan një sërë masash të dorës së parë, që kanë të bëjnë me revolucionin socialist, me krijimin e bazës ekonomike të socializmit. Kështu, për shembull, që përpara se të merrte fund zbatimi i reformës agrare që kishte për qëllim kryesor likuidimin e mbeturinave të feudalizmit, në vitin 1945 u nacionalizuan banka, nëntoka, pyjet, ujërat, financat, transporti, të gjitha ndërmarrjet e mëdha industriale, të cilat ndodheshin në duart e kapitalistëve të huaj dhe të gjitha pasuritë e armiqve të popullit. Kurse nacionalizimi i ndërmarrjeve të tjera industriale që ndodheshin në duart e kapitalistëve të vendit filloi të kryhej që nga prilli i vitit 1946.

Këto masa u zbatuan në vendin tonë për këto arsye: gjatë Luftës sonë nacional-çlirimtare ishte bërë një diferencim i theksuar i klasave, borgjezia si klasë sunduese ishte përmbysur që me përfundimin ngadhënjimtar të Luftës nacional-çlirimtare së bashku me klasën e bejlerëve dhe me pushtetin e okupatorëve. Para çlirimit pozitat kyçe në ekonominë e Shqipërisë i kishin kapitalistët e huaj, kryesisht kapitalistët e vendeve që kishin pushtuar Shqipërinë; ata zotëronin të gjitha ndërmarrjet kryesore industriale dhe bankën në vendin tonë. Pra, revolucioni ynë, si revolucion me karakter të theksuar antiimperialist, pas çlirimit nuk mund të lejonte në asnjë mënyrë që kapitalistët e huaj të mbeteshin zotër të ekonomisë sonë popullore. Më në fund gjithë këtë punë e drejtonte Partia Komuniste, e cila ishte e vetmja forcë udhëheqëse e pushtetit të ri popullor dhe zbatonte një vijë të caktuar për zhvillimin deri në fund të revolucionit, sipas mësimave të marksizëm-leninizmit.

Në janar të vitit 1946 Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore dhe në mars të këtij viti aprovoi Kushtetutën e parë të shtetit të ri shqiptar. Që prej kësaj pushteti i demokracisë popullore në vendin tonë, i cili, si u tha më sipër, u themelua që në Luftën nacional-çlirimtare, kryen funksionet e diktaturës së proletariatit, që mbështetet në aleancën e shëndoshë midis klasës punëtore dhe shtresave të tjera punonjëse, në radhë të parë në aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore. Çështja e ruajtjes dhe e forcimit të diktaturës së proletariatit, e pushtetit të demokracisë popullore në vendin tonë, ka qenë kurdoherë në qendrën e vëmendjes së Partisë së Punës të Shqipërisë. Partia ka goditur dhe ka dërmuar pa mëshirë të gjitha orvatjet e armiqve për ta dobësuar, për ta «liberalizuar» pushtetin popullor, si dhe të gjitha moskujdesitë dhe tendencat e çorganizimit në punët e administrimit shtetëror. Në të njëjtën kohë Partia ka luftuar vazhdimisht për ta bërë pushtetin tonë sa më demokratik, ka luftuar kundër çdo shkelje të të drejtave që u janë garantuar qytetarëve me Kushtetutën e RPSH dhe me ligjet tona me përmbajtje socialiste, ka luftuar kundër burokratizmit dhe të gjitha të metave të tjera që janë shfaqur në funksionimin e aparatit shtetëror. Shteti i demokracisë popullore, që kryen funksionet e diktaturës së proletariatit, ka qenë arma më e fortë që i ka siguruar vendit tonë sukseset e mëdha që janë arritur në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në RPSH.

Pas nacionalizimit të industrisë dhe krijimit të sektorit socialist të ekonomisë Partia e Punës e Shqipërisë

vendosi drejtimin e centralizuar të të gjithë ekonomisë kombëtare nga ana e shtetit. Në fillim u hartuan plane njëvjeçare dhe dyvjeçare, kurse në vitin 1951 u vu në jetë plani i parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së RPSH. Si rezultat i zbatimit me sukses të pesëvjeçarit të parë Shqipëria u shndërrua nga një vend agrar i prapambetur që ishte më parë në një vend agraro-industrial. U ndërtua industria e re moderne socialiste, e cila është bërë bazë e shëndoshë për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha degëve të ekonomisë kombëtare. Në vitin 1955 prodhimi i përgjithshëm industrial u rrit gati 11 herë më shumë se në vitin 1938. Ajo çka prodhohej në 12 muajt e vitit 1938 prodhohej vetëm në një muaj të vitit 1956. Ndërsa në vitin 1938 prodhimi industrial përbënte vetëm 18 për qind dhe prodhimi bujqësor 82 për qind të prodhimit të përgjithshëm të vendit, më 1955 prodhimi industrial përbënte 43,5 për qind dhe prodhimi bujqësor — 56,5 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial e bujqësor të Republikës sonë.

Në mënyrë të veçantë janë rritur disa degë të industrisë, si ajo e qymyrgurit, e cila në vitin 1955 realizoi një prodhim vjetor 53 herë më të madh se në vitin 1938, e mineralit të kromit që realizoi një prodhim 16 herë më të madh, industria elektrike, që është rritur 9 herë më shumë, industria e drurit, që është rritur 3,5 herë në krahasim me 1938 etj. Në vitin 1955 Shqipëria prodhonte qymyrguri, naftë, mineral bakri dhe mineral kromi për frymë më tepër se sa Greqia, Turqia dhe Italia. Gjithashtu rritje të madhe në krahasim me të kaluarën ka industria e lehtë në vendin tonë, e cila më

1955 prodhoi 25 herë më tepër se sa prodhonte kjo lloj industrie në vitin 1938.

Karakteristikë e zhvillimit të industrisë në vendin tonë është se gati të gjitha lëndët e para prodhohen në vend. Zhvillimi i industrisë në Shqipëri ka perspektiva të mëdha, sidomos industria e minierave, sepse nëntoka jonë është e pasur në minerale. Me rritjen dhe zhvillimin e industrisë është rritur dhe forcuar klasa jonë punëtore, e cila qëndron në krye të ndërtimit socialist të vendit.

Suksese janë korrur gjithashtu në zhvillimin e bujqësisë. Prodhimi i drithërave të bukës, në krahasim me vitin 1938, në vitin 1955 ishte 167 për qind, kurse sipërfaqet e mbjella ishin 170 për qind. Pas çlirimit të vendit në Shqipëri u zhvilluan kultura të reja bujqësore, industriale që nuk mbilleshin më parë, me gjithëse në vendin tonë klima për rritjen e këtyre kulturave është e favorshme. Të tilla kultura janë pambuku dhe panxhari i sheqerit. Gjithashtu është zgjeruar mjaft kultura e duhanit. Të gjitha këto vlejné për të siguruar me lëndë të parë industrinë tonë të lehtë.

Partia dhe Qeveria e RPSH kanë bërë përpjekje për ta modernizuar dhe për ta mekanizuar bujqësinë tonë. Në të gjitha qendrat kryesore bujqësore të vendit janë ngritur SMT, të cilat e rritin nga viti në vit kapacitetin e tyre; gjatë pesëvjeçarit të parë puna e bërë nga to u rrit 370 për qind.

Mbi bazën e zhvillimit të industrisë dhe bujqësisë është përmirësuar vazhdimisht gjendja materiale dhe është rritur niveli arësimor e kultural i punonjësve tanë. Në pesëvjeçarin e parë paga reale e punonjësve u rrit

20 për qind kurse të ardhurat e fshatarësisë u shtuan 35 për qind. Për të treguar përmirësimin e gjendjes materiale në vendin tonë pas çlirimit po sjellim një shembull sinjifikativ: ndërsa në vitin 1938 rritja natyrale e popullsisë në Shqipëri ka qenë 16 frymë për çdo 1 000 banorë, sot kjo është 29 frymë për çdo 1 000 banorë të popullsisë.

Për herë të parë pas çlirimit të vendit u ngrit Teatri qendror i Operës dhe i Baletit dhe teatro të tjerë profesionalë nëpër rrethe, u ndërtua kinostudioja, u shtuan kinematë, muzeumet, shtëpitë e kulturës, bibliotekat etj. Në vitin 1955 u zhduk analfabetizmi në vendin tonë për moshat 40 vjeç e poshtë. Numri i nxënësve në shkollat fillore, shtatëvjeçare dhe të mesme tani është 3,3 herë më i madh se në vitin 1938. Për herë të parë nën pushtetin popullor u hapën institutet e larta në vendin tonë. Në shkollat e larta, në teknikutet dhe kurset e ndryshme të vendit dhe në shkollat e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore janë përgatitur mijëra kuadro të rinj, inxhinierë e teknikë, agronomë, mjekë, pedagogë dhe specialistë të ndryshëm.

Që nga viti 1956 në RPSH ka filluar realizimi i planit të dytë pesëvjeçar, direktivat e të cilit u dhanë në Kongresin III të PPSH. Në fund të këtij plani, d.m.th. më 1960, prodhimi i përgjithshëm industrial në vendin tonë do të jetë më tepër se 21 herë më i madh se në vitin 1938.

Përsa i përket bujqësisë, plani i dytë pesëvjeçar shtrun si detyrë kryesore sigurimin e bukës në vend, sigurimin e industrisë me lëndë të parë dhe nxjerrjen e

bujqësisë nga prapambetja. Për të kryer me sukses këtë detyrë të vështirë, Partia ka zgjedhur të vetmen rrugë të drejtë të treguar nga V.I.Lenini dhe të provuar në Bashkimin Sovjetik, rrugën e bashkimit të ekonomive të vogla fshatare në ekonomi të mëdha kolektive. Kjo është rruga që ka zgjedhur Partia për ndërtimin e socializmit në fshat. Kolektivizimi gradual i bujqësisë, sipas eksperiencës sovjetike, ka filluar në vendin tonë që nga viti 1946 dhe eksperiencia jonë e deritanishme në lëmin e kolektivizimit të bujqësisë na ka dhënë rezultate shumë të mira, dhe kjo tregon se nuk ka rrugë tjetër për ndërtimin socialist në fshat veç rrugës së treguar nga Lenini. Kjo nuk do të thotë se ne e kemi zbatuar mekanikisht eksperiencën sovjetike në këtë drejtim, por i jemi përmbajtur me besnikëri parimit themelor.

Që nga viti 1956 bujqësia jonë, në bazë të vendimit të Plenumit të KQ të PPSH, që u mbajt në dhjetor të vitit 1955, dhe të Kongresit III të PPSH, ka hyrë në etapën e kolektivizimit me ritëm të shpejtë. Në këtë mënyrë, brenda vitit 1956 numri i kooperativave bujqësore u rrit tri herë në krahasim me numrin e kooperativave bujqësore të krijuara që nga viti 1946 deri në fund të 1955-s. Kjo tregon se direktiva që ka dhënë Kongresi III i Partisë për të kolektivizuar deri në fund të pesëvjeçarit të dytë, mbi bazën e kooperativave bujqësore të tipit të artelit, 70 për qind të sipërfaqeve të mbjella të Republikës, do të arrihet dhe do të tejkalohet. Kooperativat bujqësore në vendin tonë janë krijuar mbi baza të shëndosha duke respektuar me përpikmëri parimin leninist të vullnetit të lirë.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke zbatuar me besnikëri marksizëm-leninizmin dhe eksperiencën e Bashkimit Sovjetik, e ka ndjerë kurdoherë të nevojshme mbajtjen dhe forcimin e diktaturës së proletariatit edhe për të mbrojtur fitoret e revolucionit popullor, për të shtypur përpjekjet e ish-klasave sunduese të shpronësuarra dhe ato të shteteve imperialiste, që së bashku janë munduar dhe mundohen me mënyra të ndryshme të shkatërrojnë regjimin e demokracisë popullore dhe të kthejnë në fuqi çifligarët dhe kapitalistët.

Partia jonë gjithnjë e ka mbajtur parasysh tezën leniniste që thotë se në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm lufta e klasave është e pashmangshme. Kjo luftë klasash është një realitet objektiv, që është e lidhur me ekzistencën e klasave shfrytëzuese apo mbeturinave të tyre, me ekzistencën e agjentëve të imperializmit, me ekzistencën e sektorit të gjerë të prodhuesve të vegjël, me ekzistencën e mbeturinave kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve dhe, më në fund, me vetë ekzistencën e imperializmit, pra të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare.

Populli shqiptar e ka provuar në kurrizin e tij se si armiqte e klasës në vendin tonë, të përkrahur direkt nga imperialistët amerikanë, anglezë e të tjerë, janë përpjekur shumë herë për të përmbysur me forcë pushtetin popullor; ata kanë kryer sabotime, vrasje, diversione të hapura dhe të tjera veprime armiqësore. Shtetet imperialiste, dhe në mënyrë të veçantë imperialistët amerikanë dhe anglezë, janë munduar me të gjitha forcat që të pengonin triumfin e revolucionit popullor dhe vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore në

vendin tonë. Me intriga, kërcënime dhe me të gjitha mjetet kriminale, ata janë përpjekur të sabotonin Luftën nacional-çlirimtare të popullit shqiptar dhe, duke u dhënë të gjithë përkrahjen materiale dhe morale bandave dhe organizatave tradhëtare, kanë dashur që të sjellin në fuqi regjimet e kaluara dhe të urryera nga populli shqiptar. Pas çlirimit të vendit ata s'kanë lënë gjë pa bërë që të pengojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe të organizojnë reaksionin e brendshëm kundër regjimit të demokracisë popullore. Janë të panumërta provokacionet tokësore, ajrore dhe detare të organizuara nga imperialistët kundër RPSH, pa përmendur propagandën e shfrenuar armiqësore me anë të radiove dhe fletushkave. Për vite me radhë imperialistët janë përpjekur që t'i mohojnë Shqipërisë vendin e merituar në OKB. Por të gjitha përpjekjet e armiqve janë dërmuar përballë kundërveprimeve të vendosura të popullit tonë, të edukuar nga Partia me frymën e vigjilencës së mprehtë revolucionare, të Ushtrisë sonë Popullore, të organeve të sigurimit dhe të gjykatave tona popullore. Partia dhe populli ynë kanë mundur t'i mbrojnë fitoret e revolucionit popullor dhe të dërmojnë përpjekjet e armiqve të RPSH me ndihmën dhe përkrahjen që kanë pasur nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e tjera të kampit socialist.

Sot raporti i forcave të klasave në vendin tonë ka ndryshuar shumë. Me forcimin e shtetit të demokracisë popullore, me forcimin e bazave të socializmit në Shqipëri, armiqtë janë dobësuar. Por ky fakt nuk mund ta çojë kurrë Partinë tonë në konkluzionin e gabuar të mohimit të luftës së klasave, tezë kjo false që mendo-



hen ta përhapin sot revizionistët e marksizëm-leninizmit. KQ i PPSH ua ka bërë të qartë gjithë komunistëve dhe popullit tonë se në periudhën tranzitore lufta e klasave nuk zhduket, bile ka faza në këtë periudhë kur lufta e klasave ashpërsohet. Këtë e vërtetojnë më së miri ngjarjet e viteve të fundit: provokacioni i Berlinit në vitin 1953, ai i Poznanit në vitin 1956, dhe sidomos kundërrevolucioni fashist në Hungari. Duke pasur parasysh këtë mësim të madh, Kongresi III i PPSH theksonte edhe një herë «...vigjilenca nuk duhet kurrësi të dobësohet; se është gabim të mendohet që lufta e klasave po shuhet dhe klasat e përmbysura do të heqin dorë vullnetarisht nga lufta».<sup>1</sup>

### Miqësia e popujve vëllezër të Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik

Partia e udhëhoqi popullin shqiptar në rrugën e lidhjeve të miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Vetëm te Bashkimi Sovjetik, mësonte Partia, populli ynë mund të mbështeste shpresat shekullore të tij për liri dhe pavarësi. Vetëm Bashkimi Sovjetik do ta ndihmonte atë të çlirohej dhe të vendoste pushtetin popullor.

Që në vitin 1942, Komisariati i Popullit për Punët e Jashtme të BRSS deklaronte zyrtarisht: «Bashkimi Sovjetik, duke parë me simpati të thellë luftën burrë-

---

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. II, bot. i dytë, f. 609.

rore të patriotëve shqiptarë kundër pushtesve italianë, nuk njih asnjë pretendim të imperializmit italian mbi tokën shqiptare dhe dëshiron ta shohë Shqipërinë të çliruar nga zgjedha e pushtesve fashistë dhe pavarësinë e saj të rivendosur». Nuk gjen dokument të Partisë, qoftë vendim, direktivë apo thirrje që të mos tregohet roli çlirimtar dhe pararojë i Bashkimit Sovjetik në luftën e madhe antifashiste, që të mos bëhet thirrje për të forcuar gjithnjë e më shumë lidhjen me Bashkimin Sovjetik:

*«Luftën tonë nacional-çlirimtare — thuhej në thirrjen e parë të KQ të Partisë menjëherë pas krijimit, drejtuar popullit shqiptar, — duhet ta lidhim ngushtë me luftën heroike të popujve të Unionit Sovjetik, që gjenden në ballë të luftës çlirimtare kundër fashizmit. Ta kuptojmë dhe ta forcojmë sa më tepër këtë lidhje»<sup>1</sup>.*

Por Partia jonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare nuk e popullarizoi Bashkimin Sovjetik vetëm si pararojë të luftës antifashiste dhe si aleatin tonë më të sigurtë, por edhe si vendin ku ishte ndërtuar një sistem i ri shoqëror, ku ishte zhdukur shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, ku njerëzit rronin të lirë, të begatshëm.

*«Të popullarizohet në çdo anë Bashkimi Sovjetik... — shkruhej në një qarkore të KQ të PKSH drejtuar Partisë — Por popullarizimi të mos mjaftohet vetëm duke thënë se është e vetmja forcë që theu armatat e Hitlerit etj., por se Bashkimi Sovjetik është udhëheqësi i masave punonjëse dhe që u dha këtyre kolektivitetin*

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 31.

*e lirë vëllazëror të njerëzve të lirë, një shoqëri të lulëzuar dhe jetë të begatshme. Vetëm rendi socialist mundi të krijojë atë forcë të pathyeshme që është Ushtria e Kuqe, e aftë për me përballue të gjitha vështirësitë»<sup>1</sup>.*

Partia i lidhi komunistët dhe popullin tonë me mish e me shpirt me popujt e Bashkimit Sovjetik. Për herë të parë në histori populli i vogël shqiptar gjeti një mik të singertë në popullin e madh sovjetik.

Lufta nacional-çlirimtare e popullit shqiptar ka qenë një luftë heroike, lufta më e madhe ngadhnjimtare që ai ka bërë në të gjithë historinë e tij. Por ai mundi ta fitojë këtë luftë sepse kishte ndihmën e Ushtrisë Sovjetike që shkatërroi ushtrinë dhe shtetin hitlerian dhe u sollti popujve lirinë. Pikërisht për këtë ne themi që Bashkimi Sovjetik është çlirimtari ynë dhe për këtë populli shqiptar i është mirënjohës atij përjetë.

Pas çlirimit të vendit u forcuan akoma më shumë lidhjet dhe miqësia midis popullit shqiptar dhe popullit sovjetik. Bashkimi Sovjetik e njohu menjëherë Qeverinë Demokratike Shqiptare, dhe që në vitin 1945 u vendosën marrëdhënie të rregullta midis shtetit të madh socialist dhe Shqipërisë. Këto ishin marrëdhënie të një tipi të ri. Këto marrëdhënie u mbështetën mbi parimet leniniste të barazisë së plotë të të dy palëve, të ndihmës shoqërore njëri-tjetrit, të respektimit të sovranitetit kombëtar dhe të mosndërhyrjes në punët e

---

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 281-282.

brendshme, ato u mbështetën në parimet e internacionalizmit proletar, në parimet e marksizëm-leninizmit.

• Dhe në ditët më të vështira të pasluftës, kur vendi dhe populli ynë ishin në mjerim, pa bukën e gojës dhe pa veshje në trup, dhe kur pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, të fituar me gjak e sakrifica, kërcënoheshin nga armiqtë, ishin KQ i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe qeveria sovjetike që i shtrinë dorën vëllazërore popullit shqiptar dhe e ndihmuan atë të kapërcente vështirësitë, të ndërtonte industrinë dhe të rimëkëmbte bujqësinë.

Miqësia që lidh popullin shqiptar me popullin sovjetik u shpreh edhe një herë në bisedimet që u zhvilluan dhe në marrëveshjet që u arritën midis delegacionit të qeverisë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nga njëra anë dhe delegacionit të qeverisë dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë nga ana tjetër, gjatë vizitës në Bashkimin Sovjetik në prill të 1957-s.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë është shumë i rëndësishëm vlerësimi që i bëri asaj Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik për veprimtarinë gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe pas çlirimit të vendit, për besnikërinë e saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit, për eksperiencën e saj në çështjen e krijimit të Frontit të gjerë antifashist Nacional-Çlirimtar në vitet e Luftës së dytë botërore si dhe në realizimin me sukses të detyrave të revolucionit demokratiko-popullor dhe të ndërtimit të socializmit në kushtet e veçanta të një vendi të tillë të prapambetur dhe gjysmëfeudal siç ishte Shqipëria. Ky vlerësim marksist-leninist i punës së Partisë sonë ngjall në zemrat e komunistëve dhe të

gjithë popullit shqiptar ndjenjën e gëzimit dhe u jep atyre forca të reja për të luftuar me vendosmëri të patundur për çështjen e madhe të socializmit.

Besnikëria e Partisë dhe e popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik është besnikëria ndaj parimeve të internacionalizmit proletar.

Parimet e internacionalizmit proletar janë një tipar i pandarë i doktrinës marksiste-leniniste. Me krijimin e kampit socialist, vendet e të cilit ndërtojnë jetën e tyre mbi bazat e marksizëm-leninizmit, këto parime kanë marrë një zhvillim të mëtejshëm.

Uniteti i pikëpamjeve politike dhe uniteti ideologjik i vendeve të kampit socialist përbëjnë një bazë të fuqishme për fitoret e vendeve tona, ato janë një garanci e madhe për pavarësinë e vendeve tona, janë një faktor vendimtar për ruajtjen e paqes në gjithë botën.

Pikërisht këtu i kanë drejtuar goditjet e tyre armiqte e socializmit, të cilët janë të interesuar shumë dhe mundohen me çdo mënyrë të përçajnë kampin e socializmit, me qëllim që të realizojnë më lehtë planet e tyre grabitqare.

Ndryshimet e mëdha në raportin e forcave midis socializmit dhe imperializmit, në favor të socializmit, dalja e socializmit nga kuadri i një shteti të vetëm në një sistem botëror, e kanë tronditur nga themelet sistemin kapitalist botëror. Realizimet e Bashkimit Sovjetik, sukseset e mëdha dhe të shpejta që kanë arritur të gjitha vendet e tjera socialiste në bashkëpunim të ngushtë e vëllazëror me njëri-tjetrin kanë treguar epërsinë e pakundërshtueshme të sistemit socialist mbi atë ka-

pitalist. Politika leniniste e paqes dhe e miqësisë midis popujve e ndjekur me këmbëngulje nga vendet e kampit socialist, ka gjetur përkrahjen e të gjitha shteteve dhe forcave paqedashëse në botë.

Të gjitha këto ushtrojnë një influencë të fuqishme në masat punonjëse dhe të shfrytëzuara në vendet kapitaliste, në popujt e shtypur nga imperialistët, në vendet e pazhvilluara dhe në të gjithë njerëzit përparimtarë e paqedashës në botë. Kjo influencë duket çdo ditë e më tepër në rritjen e luftës së punonjësve për të drejtat demokratike dhe lirinë, për një jetë më të mirë dhe të lumtur në përhapjen gjithnjë e më shumë të ideve të socializmit, në rritjen e lëvizjes koloniale kundër imperializmit, në zgjerimin dhe forcimin e lëvizjes për paqen dhe bashkëpunimin midis popujve.

Të gjitha këto ngjallin egërsinë e shfrenuar të imperialistëve me Shtetet e Bashkuara në krye, të cilët u shmangen me çdo mënyrë dhe i luftojnë propozimet dhe përpjekjet e vendeve socialiste dhe të shteteve të tjera paqedashëse për sigurimin e paqes dhe të bashkëpunimit midis popujve.

Politika «nga pozitat e forcës» që ndjekin imperialistët, në të gjitha shfaqjet e saja: kundërshtimi për çarmatimin dhe për ndalimin e armëve atomike dhe bërthamore, gara e armatimeve, krijimi i bloqeve ushtarake si NATO, SEATO, Pakti i Bagdatit etj., krijimi i bazave ushtarake në tokat e huaja, militarizimi i Gjermanisë Perëndimore, ndërhyrjet në punët e brendshme të vendeve të tjera, 100 milion dollarët e senatit amerikan, përpjekjet për të penguar zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare tregëtare dhe kulturele, «doktrina Aj-

zenhauer», të gjitha këto e të tjera kanë vetëm një qëllim: të pengohet zhvillimi i vendeve socialiste, të ruhen pozitat e imperializmit. Sulmi anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit dhe kundërrevolucioni në Hungari, vërtetojnë në mënyrë akoma më të qartë synimet e imperialistëve. Kjo politikë që ndjekin imperialistët krijon një rrezik serioz për paqen dhe sigurinë e popujve.

Përballë kësaj gjendjeje përpara partive tona del si një detyrë jetike forcimi i vigjilencës, forcimi i unitetit të kampit socialist, forcimi i fuqisë ekonomike dhe ushtarake të këtij kampi.

Fushata e tërbuar e imperializmit, që shpërtheu pas Kongresit XX të PK të BS kundër kampit të socializmit dhe kundër ideologjisë marksiste-leniniste në përgjithësi, ka qenë sulmi më i madh pas Luftës së dytë botërore.

Në sulmin e përgjithshëm kundër socializmit u bashkuan me të gjitha forcat edhe revizionistët e marksizëm-leninizmit. Revizionistët mundohen të mbjellin konfuzion ideologjik në radhët e partive komuniste dhe punëtores, të përçajnë unitetin e kampit socialist, të mohojnë rëndësinë universale të eksperiencës sovjetike, të revizionojnë çështjet themelore të marksizëm-leninizmit, doktrinën mbi partinë e klasës punëtores, mbi diktaturën e proletariatis, mbi luftën e klasave.

Revizionistët i maskojnë teoritë e tyre nën flamurin e marksizmit, bile i paraqitin si fjala e re e fundit e marksizmit. Por në fakt ata veprojnë kundër marksizmit, ata veprojnë në mënyrë shoviniste dhe në dëm

të lëvizjes punëtore dhe komuniste ndërkombëtare dhe qoftë me dashje ose pa dashje u shërbejnë armiqve të socializmit, imperializmit.

Partia jonë dhe populli shqiptar, si kurdoherë, të udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe eksperiencia e Bashkimit Sovjetik qëndruan me vendosmëri të patundur dhe i dërmuan orvatjet e imperialistëve dhe të revizionistëve, duke mbrojtur si gjërat më të shtrenjta lirinë, socializmin, paqen, miqësinë me Bashkimin Sovjetik, duke mbrojtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit. Në të njëjtën kohë Partia dhe populli ynë mbajtën një qëndrim marksist-leninist në lidhje me ngjarjet e Hungarisë, ata dënuan me vendosmëri aventurën fashiste që organizuan imperialistët, forcat e brendshme kundërrevolucionare dhe revizionistët e marksizëm-leninizmit, ata aprovuan dhe përshëndetën ndihmën vëllazërore dhe internacionaliste që Ushtria Sovjetike, me kërkesën e qeverisë hungareze, i dha popullit të Hungarisë për të shtypur kundërrevolucionin.

Partia e Punës e Shqipërisë ka luftuar dhe do të luftojë edhe në të ardhshmen me vendosmëri për të zbatuar në mënyrë krijuese mësimet e pavdekshme të Revolucionit socialist të Tetorit, dhe atë eksperiencë të Bashkimit Sovjetik që ka karakter universal, ajo do të ruajë si gjënë më të shtrenjtë besnikërinë ndaj doktrinës marksiste-leniniste dhe do të mbajë kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar, duke e edukuar popullin tonë me frymën e miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të forcimit të vazhdueshëm të unitetit e të bashkëpunimit vëllazëror të po-



pujve të vendeve socialiste, me frymën e miqësisë dhe të paqes në mes të gjithë popujve.

\*

\* \* \*

Sado që të çirren dhe të shpifin armiqtë e socializmit, sado që të thurin përralla «mbi krizën e komunizmit», «mbi krizën e internacionalizmit», nuk ka forcë në botë që të pengojë shkatërrimin e sistemit të plakur kapitalist, s'ka forcë në botë që të pengojë zhvillimin historik të njerëzimit drejt komunizmit. Kauza e Revolucionit të madh socialist të Tetorit ka triumfuar dhe do të triumfojë kurdoherë. Shteti i madh socialist që krijoi Revolucionin i Tetorit, u bë një shtet i fuqishëm dhe i lulëzuar dhe si një far i shkëlqyeshëm u ndrit rrugën gjithë popujve që luftojnë për një jetë të lirë e të gëzuar. Vendet që kanë këputur vargojtë e skllavërisë kapitaliste po korrin dita-ditës suksese gjithnjë më të rëndësishme në rrugën për ndërtimin e socializmit. Kampi i fuqishëm i socializmit është forcuar dhe forcohet në luftën kundër imperializmit ndërkombëtar dhe gjithë armiqtë të socializmit. Idetë e socializmit po pushtojnë çdo ditë e më tepër zemrat dhe shpirtin e miliona njerëzve në të gjitha anët e botës. Kudo në popujt e shtypur të Azisë dhe të Afrikës vlon vala e urrejtjes dhe e luftës kundër sistemit të urryer kolonial të imperializmit, që ka hyrë me kohë në procesin e shthurjes së shpejtë dhe të plotë. Klasa punëtore dhe të gjithë

punonjësit e botës, në krye me pararojat e tyre të sprovuara, partitë komuniste dhe punëtorë, po ecin me vendosmëri në rrugën që ka çarë Revolucioni i madh socialist i Tetorit, drejt fitoreve të reja të kauzës së paqes, demokracisë dhe socializmit. Partitë komuniste dhe punëtorë të të gjitha vendeve po e ngrënë lart e më lart flamurin e lavdishëm të marksizëm-leninizmit, flamurin ngadhënjimtar të Revolucionit socialist të Tetorit.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit» Nr. 247 (2834), 13 tetor 1957*

*Botohet me disa shkurtime sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit» Nr. 247 (2834) 13 tetor 1957*

**LETËR PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PK  
TË BS ME RASTIN E LËSHIMIT ME SUKSES TË  
SATELITIT TË PARË ARTIFICIAL TË TOKËS**

**19 tetor 1957**

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE  
TË BASHKIMIT SOVJETIK**

*M o s k ë*

Lëshimi me sukses të plotë i të parit Satelit Artificial të Tokës ka mbushur plot gëzim dhe entuziazëm zemrat e popullit shqiptar. Kjo fitore e madhe e mendjes dhe e punës njerëzore mbi forcat e natyrës, që më përpara konsiderohej vetëm një ëndërr, ka një rëndësi të papërshkruar për shkencën botërore.

Ne, në këtë fitore të madhe të shkencës sovjetike, të shkencës që vazhdimisht lufton për mirëqenien e lumturinë e njeriut, shohim superioritetin e shkencës socialiste ndaj asaj të vendeve kapitaliste, shohim superioritetin e sistemit socialist, ne e konsiderojmë atë si një fitore të madhe të kampit socialist. Populli shqiptar, ashtu si gjithë popujt përparimtarë të botës, kre-

nohet për këtë fitore të madhe të shkencës sovjetike.

Lëshimi i Satelitit të parë Artificial rreth Tokës është rezultat i punës paqësore të popujve sovjetikë, i punës krijuese të shkencëtarëve sovjetikë, i rendit shoqëror sovjetik nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që u krijua si rezultat i Revolucionit socialist të Tetorit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të popullit shqiptar, u dërgon urimet më të përzemërta dhe më të nxehta, për këtë fitore të madhe historike, popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik, shkencëtarëve sovjetikë, frymëzueses së tyre të lavdishme, Partisë Komuniste, të themeluar nga Lenini i madh.

Rroftë shkenca sovjetike!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i Popullit»,  
Nr. 253 (2840), 20 tetor 1957*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

SHËNIME TË NXJERRA NGA TAKIMI ME  
NJË SHQIPTAR TË KTHYER  
NGA AUSTRALIA

31 tetor 1957

*Pasi përshëndeten, shoku Enver i thotë Eqrem Gjatës:* Ne e dimë se shqiptarët e Australisë kanë qëndruar si patriotë të vërtetë, se ata kanë simpatizuar dhe përkrahur me të gjitha forcat e tyre luftën e popullit tonë për liri. Për këtë çështje ne jemi fare mirë në dijeni dhe ia kemi bërë të njohur popullit se shqiptarët e Australisë, Argjentinës, SHBA-së etj. kanë simpatizuar luftën e popullit tonë për liri. Shqiptarët që kanë qënë në Australi, në Amerikën e Jugut etj. kanë qënë njerëz më shumë punëtorë dhe i kanë rezistuar influencës shkatërruese të propagandës së imperialistëve. Por, siç e dini, siç e keni provuar në kurrizin tuaj, imperialistët përpiqen me të gjitha forcat për të penguar popullin të vijë në fuqi dhe të ndërtojë jetën e tij të lumtur. Ata i duan popujt të jenë kurdoherë të skllavëruar dhe të robëruar që të mbushin xhepat e tyre.

*EQREM GJATA:* Unë kam ardhur t'Ju falenderoj

në emër të shqiptarëve të Australisë për të gjitha ato që keni bërë për popullin dhe atdheun. Detyrat tonë atje kanë qenë shumë të mëdha, po ne që kemi shkuar atje kemi pasur nivel të ulët kultural. Megjithatë, me ato mundësi që kishim, u përpoqëm t'i shërbejmë luftës që bënte populli ynë kundër pushtesve fashistë dhe tradhëtarëve, e në këtë drejtim gjenim përkrahje edhe nga klasa punëtore e vendit.

*SHOKU ENVER:* Kështu, pak të ditur ishim të tërë, po forca, dituria dhe eksperiencia e popullit, bëri që zotësia e njerëzve, që ishin gjoja të mësuar dhe të ditur, të përmysej.

E dini ju ç'thoshin ata kur ne filluam luftën? Ju ishit larg atdheut dhe nuk i dini të gjitha ato që ngjanë në vendin tonë. Njerëzit e «Ballit Kombëtar» thoshin se ne komunistët i kemi shkelur traditat heroike të popullit tonë. Po si mund t'i shkelnim ne ato? Partia jonë në ditën e 28 Nëntorit të çdo viti, kur ishin këtu okupatorët, e ngrinte lart flamurin tonë dhe mobilizonte popullin në demonstrata e në luftë për liri. Pa i ruajtur dhe pa i mbajtur lart këto tradita Partia jonë nuk mund ta ngrinte dhe ta udhëhiqte popullin tonë në fitore.

Që kur filloi lufta, këta njerëz reaksionarë, politikanë e bejlerë tradhëtarë thoshin: «Ç'janë këta kalamanë, nga dolën këta rjepacukë». Mirëpo ne ua vumë atyre dyfekun si dhe italianëve e gjermanëve. Ishin këta «rjepacukë» që ua morën topat dhe armët gjermanëve dhe italianëve e që përballuan më vonë edhe intrigat e anglezëve. Edhe kur ne, pas çlirimit, filluam të riorganizonim jetën e vendit, ata thoshin

se komunistët i kanë ditët të pakta, ata nuk kanë haber nga puna e drejtimit.

Por këta zotërinj e nënvleftësuan diturinë e popullit, forcën e tij dhe të Partisë që është pjella e popullit tonë. Kur u çlirua vendi ynë ishte i djegur e i rrënuar me fshatra dhe krahina të tëra, me fabrika e qytete. Kurrë nuk kishte ngjarë në vendin tonë që brenda dy vjetëve të ndërtoheshin të gjitha gjërat e shkatërruara nga lufta, punë që u bë me thonj e me dhëmbë. Populli nuk kishte as bukë as veshmbathje, po u mobilizua dhe tha se duhet të ndërtohet atdheu dhe e ndërtoi. Heroizmat e popullit tonë të kohës së pasluftës mund t'i shohësh tani vetëm në fotografi e filma. Unë mendoj se do të të bjerë rasti të shohësh se si ka punuar populli ynë gjatë kësaj kohe. Të gjitha urat që shkatërroi okupatori u rindërtuan duke aktivizuar në këto punime 4-5 inxhinierë që disa nga ata nuk ishin aq të vendosur për pushtetin tonë. Por me kohë bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve u bënë inxhinierë, shoferë, traktoristë dhe iu vunë punës për ndërtimin e vendit.

Ju jeni larguar nga atdheu gati para 20 vjetësh. Sa ndryshim ka vendi ynë me atë kohë. Tani në të gjitha qytetet ka fabrika të reja, në të gjitha fshatrat ka shkolla, janë shtuar shumë shkollat e mesme bile kemi edhe universitet, kurse Fejzi Alizoti në kohën e tij, me ato fare pak shkolla që kishim atëhere, thosh-te: «Ç'i duam gjithë këto shkolla».

Gjatë gjithë regjimit të Zogut, bile që përpara, që kur u ngrit flamuri në Vlorë, Shqipëria kishte rreth 160 mjekë, inxhinierë, agronomë etj., kurse tani kemi

me mijëra kuadro të lartë të të gjitha degëve. Vetëm këtë vit dolën 360 kuadro të lartë, kurse vitin që vjen do të dalin 600, përveç atyre që kemi dërguar për të mësuar në BRSS dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Shihni, pra, ç'bën forca e popullit dhe drejtësia e vijës së Partisë.

*EQREM GJATA:* Në saje të dëshmorëve që kanë rënë në luftë për lirinë e popullit, në sajën Tuaj, të ushtrisë sonë të lavdishme dhe të Bashkimit Sovjetik ne patëm fatin që u kthyem edhe një herë në atdhe, ndryshe do të kishim mbetur në vend të huaj. Të gjitha këto të mira që thoni, ne iua dedikojmë Juve, Partisë, qeverisë, pushtetit popullor, ushtrisë sonë dhe gjithë rinisë e popullit tonë.

*SHOKU ENVER:* Rininë ne e kemi shumë të fortë, heroike. Ajo mëson dhe punon, ajo e do shumë popullin dhe atdheun. Të shikosh tani sa përpara është fshatari ynë. Megjithkëtë Partia nuk kënaqet me ato që janë arritur. Ato që janë bërë deri tani janë kolosale në krahasim me të kaluarën, por puna është se ku do të vemi, dhe në këtë drejtim perspektivat janë të shkëlqyera.

Kam lexuar kohët e fundit një shkrim të Luigj Gurakuqit, patriotit të vjetër. Ai më 1924 ishte kundër dhënies së koncesioneve shoqërisë «Anglo-Persian Oil kompani» si dhe shoqërive amerikane dhe tregon se për ç'qëllime robëruese anglo-amerikanët kërkonin të hidhnin në dorë pasuritë e popullit tonë. Pastaj ai thotë se kishin vendosur të shponin 5 000 metra; në atë kohë kjo dukej një gjë e madhe, kurse gjatë pushtetit tonë janë shpuar deri tani 800 mijë metra nga



kemi nxjerrë vajguri. Të gjitha këto tani janë pasuri e popullit dhe jo e bejlerëve dhe e agallarëve. Tani çdo gjë është e popullit.

Ne do të dëshironim që të gjithë shqiptarët që janë në mërgim, të cilët varfëria i detyroi të linin atdheun dhe familjen dhe të punonin si robër në fabrikat e huaja, tani që atdheu i tyre lulëzon, të vijnë, po të dëshirojnë, dhe këtu do të krijohet për ta një jetë e mirë, e gëzuar. Shumë fjalë thonë jashtë armiqtë e popullit tonë kundër nesh, po neve aq na bën, tymi të na vejë drejt. Vendi ynë ecën përpara, forcohet. Shqipëria është lidhur ngushtë me miq të fortë. Shqipëria ka 13 vjet që rron e lirë, atë tani askush nuk guxon ta sulmojë, planet e armiqve kundër saj janë të destinuara të dështojnë.

*EQREM GJATA:* Ne, me anë të përfaqësive shqiptare jashtë, të shtypit dhe të institucioneve të tjera, kemi marrë dijeni mbi përparimet që kishte arritur vendi ynë si në fushën ekonomike dhe në fushën kulturele. Jo vetëm kaq, këto përparime unë i kam mësuar edhe nga shtetet e tjera demokratike që kanë përfaqësitë e tyre dhe klube atje. Shoqëritë demokratike atje e kishin gjithnjë në gojë Shqipërinë.

*SHOKU ENVER:* Sa shqiptarë janë në Australi?

*EQREM GJATA:* Atje janë rreth 4 000 frymë. Statistika të sakta nuk ka, po afërsisht të gjithë këta janë të shpërndarë në pesë shtete të Australisë. Gjithsejt si familje janë nja 400-500, shumica bujq dhe punëtorë. Ka ndonjë që është më i mëkëmbur, si për shembull, njëri ka një fabrikë alumini, në kallamat e sheqerit janë disa që kanë fermat e tyre, ka disa që kanë lopë,

bahçera me fruta dhe zarzavate. Në përgjithësi shqip-tarët e Australisë janë nga Korça, një pjesë nga Gjirakastra.

*SHOKU ENVER:* Po ju ç'punë bënit?

*EQREM GJATA:* Isha shitës. Pastaj hapa edhe unë një dyqan, po nuk më lanë ata të mëdhenjtë.

*SHOKU ENVER:* Po sa kohë ke që je kthyer?

*EQREM GJATA:* Kam 25 ditë që jam kthyer. Këtu kam edhe gruan.

*SHOKU ENVER:* Po ç'punë do të bëni tani?

*EQREM GJATA:* Ç'të doni më jepni. Po të jetë në dëshirën time dhe të familjes dëshiroj të rri këtu, në Tiranë, të punoj në tregëti se kam qenë shitës në një dyqan manufakture, në një dyqan këpucësh dhe në një dyqan vogëlsirash.

*SHOKU ENVER:* Do të rekomandojmë të punosh në tregëti. Po ç'fëmijë ke?

*EQREM GJATA:* Dy vajza, njëra ka mbaruar dhe është mësuese në Vlorë dhe tjetra është studente në vitin e tretë të mjekësisë dhe për dy vjet, del doktore. Kam edhe një djalë po ai nuk ka bërë shkollë.

*SHOKU ENVER:* Është kënaqësi për ty kur shikon se nga të dy vajzat njëra mbaroi shkollë të lartë në vend dhe tjetra po ashtu për dy vjet del mjekë. Ne do të të gjejmë edhe ty punë edhe gruas po të duash. Këtu në Tiranë kemi edhe kooperativë rrobaqepësish dhe, po të dojë, grua mund të vejë atje të punojë, pasi thua se mund të punojë si rrobaqepëse. Qëllimi i Partisë është që t'i shërbehet popullit sa më mirë dhe populli të rrojë mirë.

*EQREM GJATA:* Tani si është bërë vendi ynë nuk

do të këmi nevojë të dalim më jashtë për të gjetur punë.

**SHOKU ENVER:** Përkundrazi vendi ynë me gjithë këto që bëhen ka nevojë për njerëz të punës.

**EQREM GJATA:** Kur bëhesha gati të ikja, më pyeti një gazetar se përse largohesha nga Australia. I thashë se do të vete në vendin tim të lirë, se atje ka barazi dhe të ardhshme më të mirë se sa në Australi. Si më bëri edhe pyetje të tjera i thashë se tani nuk është Shqipëria e parë, ajo tani prodhon vetë shumë gjëra që i nevojiten.

Dhe vërtet nuk të rrihej atje. Kur vajta për herë të parë atje, si gjithë të huajve të tjerë, na thoshin me përbuzje «dago»<sup>1</sup> ashtu siç përbuzeshin këtu më parë evgjitet. Po më e keqja ishte se gratë e vendit na thoshin: Përse keni ardhur këtu, të hani bukën tonë?

**SHOKU ENVER:** Shqipëria përpara nuk bënte asgjë. Tani prodhohen shumë gjëra si sheqer, konserva të ndryshme, prodhohet krom, qymyr, naftë, çimento, pastaj sa do të bëhet në të ardhshmen.

**EQREM GJATA:** Kam bërë një artikull dhe ia dhashë revistës «Shqipëria e Re» për ta botuar, përveç kësaj unë do t'u shkruaj gjithnjë atyre në Australi.

**SHOKU ENVER:** U shkruaj realitetin ç'ke parë se ata kanë shumë mall për Shqipërinë.

*Pasi Eqrem Gjata i jep disa fotografi nga ato të shqiptarëve të Australisë, shoku Enver i thotë:*

Unë mendoj të botohen disa nga këto fotografi

---

<sup>1</sup> Dago (deygou - angl.) — term poshtërues që përdoret në Australi për spanjollët, portugezët, italianët e emigrantët në përgjithësi.

në gazetën «Bashkimi» me rastin e 45-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së vendit tonë. Prandaj unë do t'ju lutesha që me rastin e 45-vjetorit ju të pregatitni një artikull për aktivitetin patriotik të kolektivit shqiptar në Australi dhe bashkë me të në një faqe të gazetës «Bashkimi» të botohen edhe këto fotografi dhe t'ua dërgojmë vëllezërve tanë në Australi për t'i parë këto gjëra.

Aktivitetin tuaj ne e dimë dhe ju me këtë aktivitet keni bërë detyrën ndaj atdheut. Ju do t'i shihni vetë me sytë tuaj përparimet e atdheut tonë. Vendi ynë është fuqizuar në mënyrë të tillë sa që në disa vjet do t'i ndryshojë akoma më shumë faqja, do të krijohet mirëqenia se tani ne nuk mund të themi se vendi ynë ka arritur bollëkun. Jo, vëlla, po këtë udhë kemi zënë. Në punën tonë ne kemi akoma shumë të meta, po kryesorja është se kemi zënë udhën e socializmit.

**EQREM GJATA:** Kjo është, është zënë udhë e mirë.

**SHOKU ENVER:** Me këtë duam që populli të ketë më shumë të hajë, të vishet mirë dhe të marrë kulturë. Ne kemi arritur shumë rezultate po kemi edhe vështirësi. Po këto gjëra nuk na frikësojnë se ne nuk na trembi lufta kur koka ishte në rrezik dhe populli tha: «Ja vdekje, ja liri!» e jo më tani që punojmë të qetë për të mirën e popullit.

Tani që Shqipëria e ka fituar luftën, që ka miq të fortë, të sinqertë dhe vetëqeveriset, vështirësitë i kapërcejmë. Së shpejti në vendin tonë do të inaugurohet një hidrocentral i madh. Në Delvinë do të bëhet edhe një tjetër. Përveç këtyre fusha e Vurgut do të

thahet. Brenda një kohe të shkurtër në vendin tonë nuk do të ketë kënetë. Maliqi u tha, Tërbufi po thahet, do të thahet së shpejti edhe kënetë e Durrësit, e Roskovecit dhe e Thumanës. Popullin ne e kemi shumë të fortë, patriot, punëtor dhe të thjeshtë. Populli ynë është internacionalist. Ai luftoi me tërbim kundër italianëve, u gjakos, fashistët italianë na dogjën krahina të tëra, por, kur kapitulloi Italia, ne menduam se ç'do të bëhej me ushtrinë italiane që mbeti në Shqipëri. Menduam: jo, nuk duhet që gjithë këta italianë të armatosur t'ua lëmë gjermanëve t'i marrin dhe t'i ndërsejnë kundër nesh, ose t'i lëmë që t'i çojnë nëpër kampe përqëndrimi. Kështu ne bëmë një shpallje dhe u thamë të gjithë ushtarëve italianë që gjendeshin në Shqipëri të hidheshin në mal; ata që donin le të luftonin me ne kundër pushtuesve gjermanë, të tjerët do t'i merrte populli shqiptar në mbrojtjen e tij.

Me dhjetëra mijë italianë erdhën me ne në male, po nga këta pak luftuan. Për të tjerët u thamë fshatarëve se këta janë njerëz, këta na vranë, po tani të mos ua lëmë gjermanëve në dorë. Kështu nga fshatarët kush mori dy, kush tre dhe i vunë në punë. Kështu populli shqiptar vërtetoi edhe një herë se është një popull me virtyte të larta. Kur të ka armik të merr gjak në vetull, por, po të munda, nuk hakmerret; në rast se do të jetosh e të punosh me nder, ai të hedh dorën dhe nuk të vret kurrë.

Ç'fituam ne duke bërë këtë gjë? Përveç faktit që duke i çarmatosur ata morëm shumë armë nga italianët, fituam edhe një gjë tjetër, mirënjohjen e gjithë këtyre njerëzve që tani janë në Itali dhe thonë se shqip-

tarët na shpëtuan jetën nga nazistët gjermanë, të cilët do të na kishin therur. Kështu këta njerëz tani janë bërë një pengesë kundër synimeve imperialiste të qarqeve neofashiste italiane që nuk i heqin nga mendja synimet e vjetra kundër vendit tonë.

**EQREM GJATA:** Tani mua më falni që Ju hëngra kaq kohë se Ju keni punët e gjithë popullit dhe të mos Ju pengoj më. Ju falemnderit!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura gjatë  
këtij takimi që gjenden në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# FJALA NË MBLEDHJEN E KOMISIONIT INISIATOR PËR KREMTIMIN E 45-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

[Tetor] 1957

Ne na ka ngarkuar Komiteti Qendror i Partisë të marrim inisiativën, bashkë me ju, të dashur shokë, vëllezër e patriotë, për të vendosur mbi disa çështje që kanë një rëndësi të madhe për popullin tonë. Çështja është në lidhje me 45-vjetorin e ditës së pavarësisë së Shqipërisë, të ngritjes së flamurit shqiptar në Vlorë. Sikundër e dimë dita e 28 Nëntorit 1912 është një ditë me shumë rëndësi në historinë e popullit tonë, sepse në atë ditë delegatët e popullit shqiptar kishin ardhur nga të gjitha anët e vendit për të përfaqësuar vullnetin dhe dëshirën e zjarrtë të popullit shqiptar. Në ta shprehej dufi, mëria kundër okupatorëve që kishin robëruar vendin tonë. Patriotët shqiptarë donin ta bënë Shqipërinë një shtet të pavarur, sovran dhe të shpëtonin një herë e mirë nga zgjedha e imperialistëve dhe e okupatorëve.

Kjo inisiativë e madhe e popullit shqiptar dhe e delegatëve të tij, në krye të të cilëve qëndronin plaku patriot Ismail Qemali, patrioti Luigj Gurakuqi dhe të

tjerë (dhe në këtë mbledhje që po bëjmë sot kemi pjesëmarrës të asaj dite të shënuar të popullit tonë), bëri që të korret sukcesi dhe të shpallet pavarësia e Shqipërisë, të ngrihet flamuri në Vlorë. Me këtë akt iu bë e njohur gjithë botës dëshira e popullit tonë për liri e pavarësi dhe shteteve imperialiste, të cilët ishin bërë zotër në vendin tonë e që nuk e llogaritnin popullin shqiptar, por e shtypnin, e shfrytëzonin, e vrisnin. Populli shqiptar është një popull i fortë, ai nuk e ka ulur kurrë shpinën para armiqve, por ka luftuar në shekuj me pushkë në dorë, është mundur, po nuk është zhdukur dhe në çdo moment është gati të luftojë për lirinë e vet. Këtë, populli shqiptar e tregoi edhe nëpërmjet delegatëve më 28 Nëntor 1912.

Është fakt se dita e flamurit për ne të brezit të ri ka qenë një ditë mobilizuese në luftën e popullit, të patriotëve dhe të komunistëve tanë kundër regjimit feudal të Zogut e më vonë edhe kundër okupatorëve italianë e gjermanë. Në saje të luftës së tij, të udhëhequr nga Partia e lavdishme Komuniste Shqiptare, tani Partia e Punës e Shqipërisë, populli ynë luftoi me heroizëm të paparë ndonjëherë në historinë e tij, ai fitoi lirinë e dëshiruar nga gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë që kanë luftuar me heroizëm me të gjitha mjetet, ashtu si e kuptonin ata. Por gjëja kryesore që ata kuptonin ishte që Shqipëria duhet të jetë e lirë dhe populli zot i vendit dhe i jetës së tij.

Pavarësisht se pas ngritjes së flamurit u luajtën shumë intriga në kurriz të popullit, iu shkaktuan atij shumë vuajtje dhe shumë njerëz u lëkundën, populli nuk u lëkund asnjëherë në idealet e tij të mëdha, në



çështjen e çlirimit të vet. Ai e tregoi vendosmërinë në momentet më të rënda, më të vështira, kundër italinëve, gjermanëve, feudalëve; ai u ngrit, mori armët, luftoi dhe i mundi armiqtë. Kjo u bë se populli shqiptar është një popull i fortë, që çështjen e lirisë e ka vënë kurdoherë në plan të parë. Kjo vendosmëri dhe ky besim në popull u forcuan edhe për arsye se në Luftën nacional-çlirimtare u formua Partia Komuniste, marksiste-leniniste, Parti besnike e interesave jetësore të popullit shqiptar. Ndryshe, do të ishte e zorshme që Shqipëria të çlirohej, që ajo të bëhej një vend i pavarur, sovran, të fitonte të drejtat e saja në lëmin ndërkombëtar dhe të zhdukte gjakpirësit e jashtëm dhe të brendshëm. Kjo fitore që u korr ishte pra vepra e popullit. Pa popullin këto gjëra nuk bëhen dot dhe Partia jonë është një me popullin. Në Parti janë djemtë dhe vajzat e popullit. Partia jonë përfaqëson traditat më të mira të popullit: besën, nderin, trimërinë, guximin, mençurinë e popullit tonë. Partia i mëson anëtarët e saj se për të qenë të denjë të kryejnë detyrën e rëndë që u ka vënë populli, duhet të përvetësojnë çdo ditë e më shumë vetitë e larta të popullit, të mos shkëputen kurrë nga populli, se po u shkëputën Partia nuk mund të rrojë.

Është fakt se Partia e Punës e Shqipërisë lufton dhe punon në gjirin e popullit në mënyrë të tillë që populli e do Partinë me gjithë shpirt, sepse ai e sheh se në saje të udhëheqjes së saj ne u çliruam. Shqipëria e re, demokratike, popullore, e krijuar nëpërmjet luftërave shekullore të popullit tonë dhe Luftës nacional-çlirimtare, luftëra këto që janë të lidhura ngushtë, që

janë një zinxhir, sot jeton e lirë, e pavarur dhe populli ndërton jetën e re. Populli shqiptar tani po ecën përpara, drejt lulëzimit, përparimit e bollëkut. Vështirësi ne kemi pasur shumë, po ato nuk na kanë trembur. Popullin tonë nuk e ka trembur lufta e jo më vështirësitë. Këto vështirësi pas çlirimit, natyrisht janë të mëdha, por kur vihet në balancë jeta e popullit, vështirësitë kalohen lehtë.

Është fakt se drejtësia e popullit, mençuria e tij, e bënë popullin që t'i kalojë vështirësitë dhe të ecë përpara me sukses. Ndryshimi që është bërë në jetën e popullit tonë është i madh. Por megjithatë ne nuk mund të themi se jeta e popullit tonë është në lartësinë e duhur. Ne e kuptojmë se një përmirësim i madh i jetës së popullit nuk bëhet menjëherë. Por, po t'i mendojmë vështirësitë që kemi pasur, ne e ndjejmë veten të lumtur. Megjithkëtë niveli aktual i jetës në Shqipëri si në ekonomi dhe në kulturë mund të themi se është i mirë. Kundër vendit tonë është drejtuar veprimtaria armiqësore e vendeve kapitaliste, po ata në këtë punë të ndyrë nuk kanë pasur, nuk kanë dhe nuk do të kenë kurrë sukses se Shqipëria, shokë e vëllezër, nuk mund të preket në asnjë mënyrë. Kush prek Shqipërinë duhet të mendohet mirë dhe të llogaritet se këtu do të bëhet luftë e madhe e po të bëhet një luftë e tillë imperialistët me siguri nuk do të fitojnë.

Shokë, është detyrë patriotike e ne të gjithëve që 45-vjetorin e shpalljes së pavarësisë në Vlorë ta festojmë me madhësi. Ne propozojmë, në qoftë se jeni dakord edhe ju, që të krijojmë një komision inisiator për të drejtuar të gjitha pregatitjet e festës së këtij

përvjetori. Gjithashtu propozojmë që të fillojë në të gjithë Shqipërinë, në fshatra, qytete, qendra pune dhe shkolla një aktivitet i gjerë propagandistik, të bëhet akoma më e gjallë dhe e njohur historia e kaluar dhe e tanishmja e popullit tonë, sidomos momentet dhe rrethanat që e sollën 28 Nëntorin 1912. Njëkohësisht të mobilizohen të gjithë punonjësit në fabrika dhe fshatra që për nder të 45-vjetorit të pavarësisë të realizojnë dhe të tejkalojnë planet ekonomike, të bëhen mbjelljet sa më shpejt etj., d.m.th. gjatë kësaj kohe që na ndan nga 28 Nëntori i gjithë populli shqiptar duhet të mobilizohet për nder të këtij përvjetori në të gjitha aktivitetet ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Natyrisht, në këtë aktivitet propagandistik ne duhet të aktivizojmë gjithë ç'kemi, që nga gazetarët, institucionet shkencore, shkrimtarët, poetët, skulptorët, njerëzit patriotë, të vjetër e të rinj, që të mbajnë konferenca.

Në datën 27 nëntor propozojmë që të bëhet në Tiranë një mbledhje solemne ku të flitet për rëndësinë e kësaj dite të shënuar. Pastaj 28 Nëntorin duhet ta festojmë me madhësi në Vlorë ku të vejë qeveria dhe Komiteti Qendror; të thërriten që të vijnë edhe patriotët e vjetër, në rast se do të kemi fatin të kemi shumë prej tyre, që kanë marrë pjesë në ngritjen e flamurit dhe jetojnë akoma. Ky do të ishte një gëzim i madh.

Në Vlorë mendojmë të organizohet një miting i madh i popullit, pastaj të bëhen nderime në varrin e Ismail Qemalit. (Ne do të bëjmë përpjekje për të sjellë eshtrat e Luigj Gurakuqit nga Italia). Pastaj, sigurisht, do të vemi të shohim vendin ku është ngritur flamuri.

Shtypi do të përgatitë biografite e patriotëve të vjetër, do të bëhen pllakata për ata që kanë marrë pjesë në ngritjen e flamurit, duke filluar që nga Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi etj. Këto gjëra ne duhet t'i organizojmë sa më parë.

Ne propozojmë që fushata të hapet me një deklaratë të Frontit Demokratik, ku të flitet për rëndësinë e kësaj dite. Të marrim të gjitha masat që ky dokument i 45-vjetorit të ngritjes së flamurit, të shkojë në të gjithë Shqipërinë që të ngrihet i gjithë populli dhe të vemë në festën e 28 Nëntorit duke realizuar të gjitha këto gjëra që thamë.

Këto janë çështje që propozojmë. Në qoftë se jeni dakord të marrim masat që thamë, ndryshe të diskutojmë që të thoni edhe ju mendimin tuaj. Ndoshta ne disa gjëra nuk i kemi parë si duhet, prandaj kërkojmë ndihmën tuaj se ju të vjetrit i njihni më mirë këto çështje se i keni jetuar, dhe shoku Aleks Buda që është historian do të na ndihmojë shumë në këtë drejtim. Prandaj duhet të na sugjeroni dhe të na ndihmoni që kjo punë të dalë sa më mirë se është një datë e rëndësishme dhe i shërben çështjes së socializmit, ndërtimit të jetës së lumtur të popullit tonë.

Si mendoni atëhere për këtë iniciativë?

*Të gjithë anëtarët e komisionit inisiator u shprehën njëzëri se janë dakord e thanë: «Nuk ka më mirë, të bëhen këto gjëra».*

**SHOKU ENVER:** Atëhere jeni dakord që të ngrihet një komision për drejtimin e të gjitha punëve të festës? Ky komision kemi menduar të përbëhet nga: Aleks Buda, Zylyftar Veleshnja, Haxhi Llcshi, Mehmet Shehu,

Enver Hoxha, Jorgji Pano, Pilo Peristeri, Medar Shtylla, Myslym Peza, Aleks Lubonja, Shefqet Peçi, Sterjo Spasse, Simon Rrota, Riza Spahiu, patrioti i vjetër Hafëz Qazimi, Sofron Borova.

Po mundet ju të na bëni edhe propozime të tjera, në rast se e shihni me vend që komisioni të jetë akoma më i gjerë.

*U propozua e u aprovua futja edhe e patriotit të vjetër e baba dëshmori, Musa Demi, dhe pastaj u kalua në çështje konkrete për përgatitjen dhe ndjekjen e programit të punës e të festës.*

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë mbledhje që gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË NË  
QARQE E NË RRETHE LIDHUR ME REZULTATET  
E ARRITURA NË PËRMIRËSIMIN E RACËS  
SË DHENVE**

**2 nëntor 1957**

**KOMITETEVE TË PARTISË TË QARQEVE ELBASAN,  
SHKODËR, KORÇË, GJIROKASTËR DHE RRETHEVE  
VLORË, FIER, LUSHNJË, BERAT, SKRAPAR, DURRËS,  
TIRANË, KUKËS DHE PESHKOPI**

Vendimet e Kongresit III të Partisë dhe vendimi i Plenumit të Shkurtit të Komitetit Qendror të PPSH mbi përmirësimin e racës së dhenve, ushtruan kudo dhe qysh në fillim një influencë dhe interesim të madh në masat e fshatarësisë sonë punonjëse e në mënyrë të veçantë në blegtorët e ndërmarrjeve tona bujqësore e blegtorale dhe të kooperativave bujqësore. Kjo bëri që, me gjithë vështirësitë tekniko-organizative që paraqiste ky aksion që ndërmorën Partia jonë dhe pushteti ynë, ndërzimi artificial u realizua me sukses duke e tejkaluar planin e caktuar në 23,4 për qind.

Kjo tregon edhe një herë drejtësinë e vendimeve

dhe të vijës së Partisë sonë, forcën e saj bindëse dhe të lidhjeve të saja me masat punonjëse. Kjo tregon nga ana tjetër se organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit, specialistët dhe gjithë punonjësit e bujqësisë u mobilizuan me të gjitha forcat për t'iu përgjegjur me nder thirrjes që bëri Partia.

Komiteti Qendror shpreh përgëzimet e tij për këtë sukses të arritur në fillimin e punës për përmirësimin e racës së dhenve dhe ka bindje se ky fillim i mirë është garancia më e madhe për tejkalimin e detyrës së caktuar nga Plenumi i Shkurtit i Komitetit Qendror të Partisë.

Ne përshëndesim përzemërsisht, për punën e vullnetshme e të palodhur, për përgatitjen e fushatës dhe zhvillimin e saj me sukses, të gjithë barinj të dhe brigadierët e ndërmarrjeve bujqësore të shtetit dhe të kooperativave bujqësore, si dhe teknikët e ndërzimit artificial, veterinerët dhe zooteknikët. Përgëzojmë gjithashtu gjithë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive që realizuan dhe tejkaluan planin dhe sidomos ato të rrethit të Fierit, të qarkut të Elbasanit, të rrethit të Durrësit dhe të Beratit që u dalluan për realizimin e për tejkalimin në një masë të konsiderueshme të planit, përkatësisht 155,8 për qind, 153 për qind, 149,4 për qind dhe 147,6 për qind.

Përpara organizatave të Partisë dhe organeve të pushtetit, tani shtrohen detyra edhe më të mëdha në rrugën për shtimin dhe përmirësimin e bagëtisë si kusht i domosdoshëm për shtimin e prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e jetesës së punonjësve.

Në lidhje me përmirësimin e racës së dhenve, një

kujdes i madh duhet të tregohet për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e shëndetit të deshëve të racës, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit. Gjithashtu të merren masa që të organizohet mirë dhe dimërimi i gjithë gjësë së gjallë si dhe fushata e pjelljeve.

Për arritjen e rezultateve përfundimtare sa më të mira në përmirësimin e racës së dhëve, duke filluar nga viti 1958, çdo vit do të bëhet zgjedhja (bonitimi) e dhëve të përmirësuar. Organet e pushtetit dhe organizatat e Partisë në rrethe si dhe në bazë të japin gjithë ndihmën e tyre për t'u kryer me sukses ky aksion nga ana e ndërmarrjeve shtetërore dhe e kooperativave bujqësore, sipas udhëzimeve të specialistëve bonitorë.

Që të çohet përpara me sukses puna e ndërzimit artificial dhe që të arrihen çdo vit rezultate sa më të mira e më të mëdha, një rëndësi të madhe ka përgatitja dhe perfeksionimi i kuadrit e në radhë të parë i kuadrit të vetë kooperativave bujqësore. Për këtë qëllim komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të organizojnë si duhet kurset 2-3-mujore që do të zhvillohen me teknikët e ndërzimit artificial, të cilët do të pajisen me njohuritë e domosdoshme zooveterinere.

Rezultatet e arritura gjatë këtij viti të parë në ndërzimin artificial të dhëve janë shumë të mira dhe inkurajuese për një punë më të madhe e më të guximshme në të ardhshmen. Komiteti Qendror u bën thirrje gjithë komiteteve dhe organizatave të Partisë, punonjësve të ndërmarrjeve blegtorale shtetërore, kooperativistëve dhe blegtorëve individualë, teknikëve dhe specialistëve të blegtorisë të mobilizojnë të gjitha for-



cat për realizimin dhe tejkalimin e planit të ndërzimit artificial që parashikohet për vitin 1958. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka bindje se kuadrot e Partisë dhe të pushtetit, specialistët, komunistët dhe në shembullin e tyre gjithë masat punonjëse të fshatit, do t'i përgjigjen me entuziazëm si kurdoherë thirrjes së Partisë për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe blegtorisë në vendin tonë, për tejkalimin e detyrave që shtron plani i dytë pesëvjeçar.

Për Komitetin Qendror të PPSH  
Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 266 (2853), 5 nëntor 1957*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## REVOLUCIONI I TETORIT U HAPI POPUJVE RRUGËN E MIRËQENIES DHE TË LUMTURISË<sup>1</sup>

5 nëntor 1957

Gjithë njerëzimi përparimtar po feston me madhësi 40-vjetorin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, e revolucionit që tronditi nga themelet botën kapitaliste dhe hapi një epokë të re, epokën e triumfit të shoqërisë socialiste, të lirisë shoqërore e nacionale, të mirëqenies, të paqes. Historia e këtyre 40 vjetëve, pas kësaj ngjarjeje historike, është zhvilluar nën influencën e drejtëpërdrejtë të Revolucionit të Tetorit. Gjatë gjithë historisë, asnjë revolucion nuk ka pasur një rëndësi kaq të madhe ndërkombëtare, asnjë revolucion nuk ka ushtruar një influencë kaq të thellë mbi fatet e njerëzimit sa Revolucionit i madh socialist i Tetorit.

Tani socializmi është bërë një sistem botëror. Bashkë me Bashkimin Sovjetik, nën flamurin e ideve të Revolucionit të Tetorit, ndërtojnë socializmin popujt e vendeve të Evropës dhe të Azisë: Kina, Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Republika Demokratike e Vietnamit,

---

<sup>1</sup> Artikulli i botuar në gazetën «Pravda».

Republika Demokratike Gjermane, Republika Demokratike Popullore e Koresë, Mongolia, Polonia, Rumania, Çekosllovakia.

Idetë e marksizëm-leninizmit po bëjnë për vete me miliona punonjës në të katër anët e botës. Mjaf-ton të përmendim se ndërsa më 1917 në të gjitha vendet kishte pak më tepër se 250 000 komunistë, tani ata bëjnë një armatë madhështore prej më tepër se 33 000 000 vetësh.

Nën influencën e ideve të Tetorit është zhvilluar me hov të paparë lëvizja çlirimtare e popujve të shtypur; 1 miliard e 300 milion njerëz të shtypur kanë fituar lirinë dhe sot në rendin e ditës është zhdukja e plotë e sistemit të turpshëm e të egër kolonial.

S'ka forcë që të ndalojë triumfin e socializmit, ashtu si nuk ka forcë të ndalojë lindjen e diellit dhe rrotullimin e tokës rreth tij.

Gjatë këtyre 40 vjetëve është treguar në mënyrë të shkëlqyer epërsia e padiskutueshme e sistemit socialist ndaj atij kapitalist.

Bashkimi Sovjetik realizoi me sukses planin leninist të ndërtimit të socializmit, i cili parashikonte transformimin e Bashkimit Sovjetik në një vend socialist të fuqishëm industrial e kolkozian.

Bashkimi Sovjetik hapi i pari rrugët deri atëhere të panjohura të ndërtimit të socializmit. Ai s'kishte nga të merrte ndihmë e eksperiencë, përkundrazi, duhej të përballonte luftën me të gjitha mjetet dhe format që i bënte borgjezia ndërkombëtare, klasat e shpronësuara dhe agjenturat e tyre, trockistët, buharinistët, nacionalistët borgjezë dhe armiqtë e tjerë të so-

cializmit. Bashkimi Sovjetik bëri sakrifica kolosale për të shpëtuar gjithë njerëzimin nga invazorët nazistë e militaristët japonezë. Por Bashkimi Sovjetik i kaloi të gjitha këto, e ndërtoi socializmin dhe po shkon me sukses drejt komunizmit.

Në saje të mobilizimit të masave punonjëse dhe të ndihmës së pakursyer të Bashkimit Sovjetik, vendet e demokracisë popullore kanë arritur suksese të rëndësishme në ndërtimin e socializmit. Gjatë këtyre viteve, pas Luftës së dytë botërore, në të gjitha këto vende janë bërë ndryshime të mëdha shoqërore dhe ekonomike. Partitë komuniste dhe punëtore janë bërë forca drejtuese e vendeve të tyre, pushteti demokratik popullor i ka forcuar shumë pozitat e tija dhe tani kryen funksionet e diktaturës së proletariatit.

Mjetet kryesore të prodhimit në vendet e demokracisë popullore janë bërë pronë e përbashkët shoqërore. Edhe në industri, edhe në tregëti, në vendet e demokracisë popullore sektori socialist zë vend dominues e vendimtar, duke hapur horizonte të pafund për zhvillimin e forcave prodhuese.

Ritmet e zhvillimit të industrisë në vendet e demokracisë popullore rriten pa u ndalur. Në periudhën 1950-1955 ritmet vjetore të rritjes së prodhimit industrial kanë qenë: Kina 24,9 për qind, Shqipëria 24,2 për qind, Polonia 16,2 për qind, Rumania 18,7 për qind, Hungaria 13,5 për qind, RD Gjermane 13,1 për qind, Çekosllovakia 10,8 për qind etj. Ritme të tilla të shpejta të zhvillimit të prodhimit industrial kanë pasur dhe vendet e tjera të demokracisë popullore. Në të njëjtën periudhë ritmi vjetor i rritjes së prodhimit në Francë

ka qenë 6,3 për qind, në SHBA — 4,2 për qind, në Danimarkë — 3,5 për qind, në Angli — 3,4 për qind, në Suedi — 2,1 për qind.

Zhvillimi i industrisë me ritme të shpejta u lejoi vendeve të demokracisë popullore që brenda një kohe të shkurtër të tejkalojnë nivelin e paraluftës. Në krahasim me paraluftën, vëllimi i prodhimit industrial në fillim të 1957-s u rrit më se 6 herë në Bullgari, — 5 herë më tepër në Poloni, — 3,3 herë në Rumani, — 3,2 herë në Hungari, — 2,7 herë në Çekosllovakia, — 2,2 herë në RD Gjermane. Shumë është rritur prodhimi edhe në vendet e tjera të demokracisë popullore.

Këto shifra dëshmojnë se kurrë, gjatë gjithë historisë së tyre, vendet e demokracisë popullore nuk kanë pasur aq suksese të mëdha në zhvillimin e industrisë sa pas çlirimit të tyre.

Vitet e fundit në vendet e demokracisë popullore po zhvillohet në baza vullnetare e me sukses të madh kolektivizimi i bujqësisë. Sektori kooperativist i bujqësisë në RP të Kinës tani zë 97 për qind të të gjitha ekonomive fshatare; sektori socialist në Bullgari përfshin rreth 85 për qind dhe në RDP të Koresë — mbi 88 për qind të sipërfaqes së punueshme. Suksese të konsiderueshme po korrin edhe vendet e tjera të demokracisë popullore në drejtim të kolektivizimit të bujqësisë.

Me hapa të shpejtë po zhvillohet nga viti në vit edhe mekanizimi i bujqësisë. Vetëm Bullgaria, RD Gjermane, Hungaria, Polonia, Rumania, Çekosllovakia dhe Shqipëria në vitin 1956 kishin më tepër se 260 000 traktorë (me 15 kuaj fuqi).

rezultat, popullsia fitoi 2 miliard e 500 milion lekë.

Në saje të shtimit të prodhimit industrial e bujqësor dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik, disa kohë më parë u hoqën plotësisht triskat e artikujve ushqimorë (ato të artikujve industrialë u hoqën më 1.I.1956).

Ç'konkluzione mund të nxirren nga të gjitha këto? Ritmet e zhvillimit të vendeve socialiste janë shumë më të shpejta nga ato të vendeve kapitaliste më të përparuara. Ne jemi të sigurtë se socializmi do ta fitojë me sukses dhe në një kohë historikisht të shkurtër garën me kapitalizmin. Nga pikëpamja e ritmeve të zhvillimit të industrisë e bujqësisë, gjatë këtyre 40 vjetëve të garës me kapitalizmin, socializmi ka dalë tanimë fitues.

Rëndësi të madhe kanë në këtë drejtim sukseset e shkencës sovjetike. Bashkimi Sovjetik ndërtoi centralin e parë elektrik me energji atomike, aeroplanin e parë reaktiv për pasagjerë «Tu 104», sinkrofazonin më të fuqishëm të botës, raketën e parë balistike ndërkontinentale dhe më 4 tetor lëshoi Satelitin e parë Artificial të Tokës. Akoma shumë njerëz nuk janë të ndërgjegjshëm plotësisht për rrjedhimet e mëdha që do të ketë ky zbulim i mrekullueshëm për zhvillimin e shkencës dhe për përparimin e gjithë njerëzimit.

Sukseset që kanë arritur deri tani vendet e kampit të socializmit rrjedhin nga zbatimi praktik i ideve fitimtare të Revolucionit të madh socialist të Tetorit.

Ato janë, së pari, rezultat i marrjes së pushtetit politik nga klasa punëtore, rezultat i vendosjes në këto vende të diktaturës së proletariatit, ku rolin udhëheqës e luan partia marksiste-leniniste. Populli punëtor është

tani zot i fateve të tij. Ai vetë me gjeninë, mendjen dhe talentin e tij, punon dhe krijon për të ardhshmen e tij më të lumtur, më të begatshme.

Nuk është vështirë të kuptohet pse në propagandën e tyre ideologët e borgjezisë mundohen të dobësojnë diktaturën e proletariatit. Për vendet e kampit të socializmit çështja e forcimit të shtetit socialist është një nga çështjet kryesore. Shteti socialist është i fortë kur në të sigurohet me të vërtetë roli udhëheqës i partisë marksiste-leniniste të klasës punëtore. Kështu na mëson ne Lenini i madh, kështu na mëson eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e krijuar nga ai.

Fitoret e vendeve socialiste janë rezultat i vendosjes së pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, i vendosjes së marrëdhënieve të reja socialiste në prodhim.

Ky është faktori kryesor, pa të cilin nuk mund të mendohet për industrializimin socialist të vendeve socialiste, për zhvillimin e bujqësisë apo për revolucionin kultural në këto vende. Vetëm vendosja e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit krijoi mundësitë e drejtimit të centralizuar të ekonomisë, që e ka justifikuar plotësisht veten në shembullin e zhvillimit të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Vendet e socializmit kanë arritur suksese të mëdha në punën e tyre për ndërtimin socialist, sepse ato ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse midis tyre janë vendosur marrëdhënie të një tipi të ri, marrëdhënie të tipit socialist. Këto marrëdhënie bazohen në idetë e internacionalizmit proletar, në miqësinë e bashkëpunimin e

ngushtë e vëllazëror, në ndihmën reciproke të pakursyer dhe pa interes që i japin ato njëri-tjetrit. Ndihma që u jep Bashkimi Sovjetik vendeve të kampit të socializmit, si nga ana materiale, ashtu edhe me eksperiencën e tij, shpejtojnë së tepërmi ritmet e ndërtimit të socializmit dhe e lehtësojnë fitoren e tij.

Forcimi i bashkëpunimit midis vendeve të kampit të socializmit, i unitetit të tyre të çelniktë, është faktori vendimtar për triumfin e kauzës së socializmit në këto vende. Kampi i socializmit, forca dhe uniteti i tij, pa dyshim e shqetëson pa masë imperializmin. Prandaj borgjezia imperialiste, ashtu siç ka bërë deri tani, edhe në të ardhshmen do të bëjë të gjitha përpjekjet, me qëllim që të dobësojë kampin tonë dhe unitetin e tij. Por çdo përpjekje e tyre është destinuar të dështojë dhe do të dështojë me siguri, sepse vendet e kampit të socializmit janë lidhur ngushtë njëri me tjetrin.

Bashkëpunimi i ngushtë i vendeve socialiste dhe forcimi gjithnjë e më i madh i tij do të shpejtojë fitoren e garës ekonomike paqësore të sistemit tonë mbi sistemin kapitalist.

Tani me fatet e njerëzimit nuk mund të luhet lirisht. Në mbrojtje të paqes dhe të sigurisë së popujve është kampi socialist, që bashkon 900 milion njerëz. Politika paqësore e vendeve socialiste ka fituar simpatinë dhe përkrahjen e popujve dhe të gjithë njerëzve të ndershëm, të cilët çdo ditë e më tepër shohin se socializmi mbjell paqen dhe miqësinë midis popujve, ndërsa imperializmi është burim luftërash shkatërruese.

Në rrugën e tyre të ndërtimit të socializmit, vendet



e demokracisë popullore, nën drejtimin e partive të tyre komuniste e punëtore, janë frymëzuar e frymëzohen kurdoherë nga mësimet ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit. Ato kanë mësuar dhe mësojnë nga eksperiencia e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Markëzizëm-leninizmi na mëson se për të gjitha vendet që ndërtojnë socializmin ka disa ligje të domosdoshme, disa karakteristika të përbashkëta, të zbatueshme në çdo kohë dhe në çdo vend, pavarësisht se ky është i madh apo i vogël, i zhvilluar apo i prapambetur. Kjo është provuar edhe në eksperiencën e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik edhe në vendet e demokracisë popullore.

Partitë komuniste e punëtore të vendeve socialiste, besnike ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit, kanë pasur dhe kanë parasysh gjithashtu edhe kushtet konkrete të çdo vendi, prandaj ato, si në zbatimin e teorisë marksiste, si edhe në atë të eksperiencës sovjetike, janë treguar krijuese dhe jodogmatike.

Në të njëjtën kohë partitë komuniste e punëtore kanë luftuar me rreptësi e vendosmëri tendencat antimarksiste të clementëve revizionistë dhe oportunistë në radhët e lëvizjes komuniste, të cilët, duke mohuar karakteristikat e përgjithshme të domosdoshme për të gjitha vendet, janë përpjekur të ngrenë në qiell veçantitë kombëtare dhe të kultivojnë ndjenjat e nacionalizmit borgjez dhe të shovinizmit. Besnikëria e partive komuniste e punëtore ndaj ideve të marksizëm-leninizmit, ndaj ideve të internacionalizmit proletar, besnikëria ndaj miqësisë me Bashkimin Sovjetik është garan-

cia e ndërtimit me sukses të socializmit në vendet e demokracisë popullore dhe në të gjitha vendet e tjera.

Duke ecur në rrugën e hapur nga Tetori i madh dhe duke vënë në jetë idetë e tija, vendet e kampit të socializmit kanë arritur rezultate të mrekullueshme, të cilat kanë ndryshuar faqen e këtyre vendeve.

Në këtë mënyrë vendet e kampit të socializmit janë bërë kështu një shembull i madh për të gjithë popujt e botës, që dëshmon për forcën transformuese të ideve të marksizëm-leninizmit, për madhështinë e ideve fitimtare të Revolucionit socialist të Tetorit, për vitalitetin e rendit socialist, të cilit i përket e ardhshëmja.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Pravda», Nr. 309 (14338), 5 nëntor 1957*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 267 (2854), 6 nëntor 1957*

**NGA FJALA NË SEANCËN E PARË TË KONSULTËS  
SË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE  
TË VENDEVE SOCIALISTE MBAJTUR  
NË MOSKË MË 14-16 NËNTOR 1957**

14 nëntor 1957

Të dashur shokë.

Delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi u njoh me projektin e parë të Deklaratës së paraqitur nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe nga Partia Komuniste e Kinës, është dakord me të.

Delegacioni ynë gjithashtu është dakord me projektin e dytë të Deklaratës, me ndryshimet që janë bërë në të dhe e konsideron atë si një dokument shumë të rëndësishëm politik, teorik dhe organizativ që do të shërbejë për të gjitha partitë komuniste dhe punëto-re të kampit socialist që kryesohet nga Bashkimi Sovjetik.

Ne jemi të mendimit se ky dokument ka rëndësi të madhe dhe është një udhëheqje e sigurtë dhe shumë e rëndësishme për të gjithë komunistët në mbarë botën, për partitë komuniste dhe punëto-re në çështjen e forcimit të unitetit të kampit tonë socialist dhe të

luftës për paqen, demokracinë dhe socializmin në botë, si dhe për veprimtarinë e këtyre partive në zgjidhjen e çështjeve të tyre dhe të problemeve me karakter të ndryshëm në praktikë dhe në punën e përditshme.

Si është theksuar në Deklaratë, sikurse foli për këtë edhe shoku Mao Ce Dun, gjithë bota është duke jetuar çaste të rëndësishme dhe me shumë përgjegjësi, në një kohë kur imperialistët po përgatitin një luftë të re botërore, kur ata po përgatitin një luftë bërthamore. Popujt e botës janë kundër luftës dhe, natyrisht, si dje ashtu dhe sot luftën për mbrojtjen e paqes, luftën kundër luftës që po përgatitin qarqet imperialiste e reaksionare amerikane, luftën për paqe të të gjitha vendeve tona socialiste, e kryeson Bashkimi Sovjetik, e kryesojnë partitë tona komuniste të udhëhequra nga marksizëm-leninizmi dhe të frymëzuara nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Populli i vogël shqiptar ka vuajtur shumë nga imperialistët dhe ka luftuar vazhdimisht kundër tyre. Sikurse gjithë popujt e tjerë, populli shqiptar nuk mund në asnjë rast të dobësojë vigjilencën e vet kundrejt imperialistëve, kundrejt planeve të tyre djallëzore dhe veprimeve të fshehura ose të hapura që kanë për qëllim shkatërrimin e kampit të socializmit dhe robërimin e popujve tanë.

Populli shqiptar me luftën e tij heroike, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, çliroi vendin e vet. Por në luftën e tij për çlirim u ndihmua edhe nga lufta heroike e popullit sovjetik, të cilin e udhëhoqi Partia e madhe e Leninit.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe delegacioni i saj

janë plotësisht dakord me tezat që shtrohen në Deklaratë, sipas të cilave popujt tanë dhe vendet tona duhet të shtojnë vigjilencën dhe të bëjnë një luftë të pareshur kundër luftës së re që po përgatitin imperialistët.

Ne jemi plotësisht dakord me tezat shumë të rëndësishme që përmban Deklarata mbi rolin e partisë së proletariatit në revolucionin socialist dhe në ndërtimin socialist, mbi rolin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, mbi rolin udhëheqës të partisë marksiste-leniniste, mbi diktaturën e proletariatit, si dhe për të gjitha parimet e tjera marksiste-leniniste, dhe duhet të luftojmë pa mëshirë kundër revizionistëve të marksizëm-leninizmit që përpiqen të shtrembërojnë këto parime themelore të marksizëm-leninizmit.

Të gjitha partitë tona marksiste-leniniste kanë zbatuar vazhdimisht në jetë parimet e mëdha marksiste-leniniste, sepse pikërisht në saje të zbatimit të këtyre parimeve partitë tona kanë arritur këto fitore kolosale dhe do të arrijnë fitore edhe më të mëdha në rrugën e tyre të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit.

Delegacioni i Partisë sonë gjithashtu mendon se përcaktimet në lidhje me rreziqet e dogmatizmit, oportunizmit dhe revizionizmit që janë theksuar në Deklaratë, janë plotësisht të drejta dhe shumë drejt është përcaktuar rrezikshmëria e tyre. Partitë tona, kush më shumë e kush më pak, kanë lejuar gabime, dhe ne kurdoherë jemi përpjekur dhe do të përpiqemi që të mos përsëriten të tilla gabime, dhe në qoftë se ka akoma të tilla, duhet t'i korrigojmë, t'i likuidojmë.

Partia jonë dhe delegacioni i saj mendojnë se në

kohën e tanishme rreziku kryesor është revizionizmi dhe oportunizmi, natyrisht duke mos harruar në këtë rast edhe dogmatizmin. Eksperienca e Partisë sonë na ka treguar se elementët e lëkundshëm dhe oportunistë janë përpjekur, por pa sukses, të minojnë bazat marksiste-leniniste të Partisë sonë, të dobësojnë diktaturën e demokracisë popullore, të dobësojnë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Partia jonë do të luftojë për ruajtjen e pastërtisë së doktrinës sonë marksiste-leniniste dhe të unitetit monolit të Partisë.

Përsa i përket çështjes në lidhje me këmbimin e eksperiencës dhe me ndihmën reciproke, kjo është një çështje shumë e rëndësishme, jetike për vendet tona të kampit socialist.

Partia jonë i është mirënjohëse Bashkimit Sovjetik për ndihmën bujare që i ka dhënë atdheut tonë që nga koha e çlirimit e deri sot. Gjithashtu populli ynë është ndihmuar dhe nga vendet e tjera të kampit socialist.

Atdheu ynë, nga një vend jashtëzakonisht i prapambetur ekonomikisht, është transformuar. Ai tani ka industrinë e vet. Bujqësia jonë po ecën me sukses në rrugën e kolektivizimit. Jeta e popullit tonë po bëhet më e bukur dhe çdo ditë e më e mirë.

Partia jonë është e mendimit se Deklarata e parqitur pasqyron jetën, veprimtarinë, nevojën e luftës së partive tona dhe të vendeve tona kundër luftës, për mbrojtjen e paqes, për socializmin. Partitë tona, popujt tanë dhe gjithë popujt e botës duhet të kenë të qartë çdo gjë dhe t'u thuhet ashtu si është realiteti. Gjuha e komunistëve duhet të jetë si kurdoherë e qartë, dhe të prekë thellë zemrat e popujve, në mënyrë që njerëzit

të kuptojnë ku është e mira e ku qëndron e keqja, të njohin rreziqet, që të mund t'i përballojnë ato me sukses. Këtë gjuhë të qartë dhe këto ndjenja të larta fisnike ka Deklarata që ne po diskutojmë dhe që duhet ta pranojmë unanimit. Uniteti i kampit tonë të socializmit, rreziku i revizionizmit dhe i dogmatizmit, rreziku i përgatitjes së luftës bërthamore nga qarqet sunduese imperialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lufta e vendosur që duhet t'i bëhet këtij rreziku, janë absolutisht të domosdoshme të mbeten ashtu si janë përcaktuar në Projektdeklaratën e Konsultës.

Delegacioni ynë shpreh aprovimin e vet unanimit dhe të plotë për pranimin e Deklaratës së paraqitur dhe konsideron se kjo do të jetë një vërtetim tjetër i unitetit të partive tona marksiste-leniniste, i kampit tonë socialist, vërtetim i faktit që kampi ynë do të arrijë fitore edhe më të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, në rrugën e paqes.

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga protokollu i mbajtur në  
këtë konsultë që gjendet në  
AQP*

## NGA INTERVISTA DHËNË MANOLIS GLEZOS<sup>1</sup> PËR GAZETËN «AVJI» TË EDA-S<sup>2</sup>

22 nëntor 1957

**PYETJE:** Si e shikoni ju në përgjithësi normalizimin e marrëdhënieve në mes të Shqipërisë dhe Greqisë? Çfarë masash quani të nevojshme të merren për përmirësimin e këtyre marrëdhënieve?

**PËRGJEGJE:** Ne mendojmë se ka ardhur koha që marrëdhëniet në mes të RP të Shqipërisë dhe Greqisë të normalizohen. Të dy vendet tona, pavarësisht nga forma e regjimeve të tyre të ndryshme, duhet të rrojnë në fqinjësi të mirë, të vendosin marrëdhënie diplomatike, të fillojnë shkëmbimet tregëtare në mes tyre, të krijojnë gjithashtu mundësitë për marrëdhënie kulturore.

Ne mendojmë se pengesave artificiale dhe pa baza që janë ngritur kundër këtij normalizimi të marrëdhë-

---

<sup>1</sup> Kjo intervistë i është dhënë M. Glezos në Moskë.

<sup>2</sup> EDA — Partia e bashkuar demokratike e së majtës, parti politike në Greqi. U krijua në vitin 1951. Përfaqësonte interesat e shtresave të gjera të punonjësve të qytetit dhe të fshatit. Organ i saj ishte gazeta «Avji».



nieve në mes të dy vendeve, duhet t'u jepet fund dhe këtë e lypin interesat e përbashkëta të popullit shqiptar dhe të popullit grek, si edhe interesi i paqes në Ballkan e në Evropë. Fashizmi italian dhe ai gjerman robëruan të dy popujt tanë, por si populli shqiptar ashtu dhe populli grek luftuan kundër të njëjtit armik dhe fituan lirinë. Të përpiqesh ta mbash larg popullin grek nga populli shqiptar, jo vetëm që është një gabim i madh, por është edhe e pamundur. Populli shqiptar dhe populli grek, me gjithë përpjekjet e atyre elementeve që përpiqen ta thellojnë artificialisht përçarjen me pretendime absurde, kanë qenë kurdoherë miq dhe kanë luftuar kurdoherë së bashku kundër të njëjtëve armiq. Tok, të dy popujt tanë, kanë luftuar kundër otomanëve që na kishin robëruar, që kërkonin të na zhduknin si popull etj. Populli shqiptar ushqen një simpati të madhe për popullin grek, pse ai është një popull punëtor, i zgjuar, trim dhe liridashës. Ne e dimë se edhe populli grek ushqen të tilla ndjenja për popullin shqiptar. Prandaj s'ka asnjë arsye që të pengohen marrëdhëniet e mira në mes të dy vendeve tona. Ne nga ana jonë kemi bërë përçapje në këtë drejtim. Ne riatdhesuam grekët që ndodheshin te ne dhe na vjen keq që, në lidhje me këtë çështje, një pjesë e shtypit grek, flas për atë reaksionarin, i shtrembërojnë faktet. Ne kemi propozuar rregullimin e piramidave të kufirit, ne së bashku me qeverinë greke kemi vendosur të spastrojmë kanalin e Korfuzit nga minat eventuale që mund të gjenden, ne jemi gati dhe dëshirojmë të kemi marrëdhënie tregëtare me Greqinë. Ne jemi optimistë, se retë, që mbulonin vendosjen e marrëdhënieve nor-

male në mes të dy vendeve tona, kanë filluar të shpërndahen. Shpresojmë që me vullnetin e mirë të të dy palëve, t'i zhdukim krejtësisht.

**PYETJE:** Midis Greqisë dhe RD Gjermane nuk ka lidhje diplomatike, megjithatë ekzistojnë marrëdhënie ekonomike. A e quani ju se vendosja e marrëdhënieve reciproke ekonomike midis Greqisë, Gjermanisë e Shqipërisë do të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve? Në këtë rast çfarë mallrash do të ishte e dëshirueshme t'i ofronte Shqipëria Greqisë dhe çfarë mallrash do t'i ofronte Greqia Shqipërisë?

**PËRGJEGJE:** Ne mendojmë se mund dhe duhet të fillojmë me Greqinë shkëmbime tregëtare. Unë mund të them se, pavarësisht se ne s'kemi marrëdhënie diplomatike, një gjë e tillë mund të fillojë, ashtu siç ekzistojnë këto marrëdhënie në mes Greqisë dhe vendeve me të cilat ajo s'ka marrëdhënie diplomatike. Unë mund të them se firma tregëtare greke na kanë shkruar se duan të bëjnë tregëti me ne. Organet tona tregëtare u janë përgjegjur pozitivisht. Ne mund t'u shesim grekëve naftë, bitum, krom e shumë sende të tjera industriale dhe të blejmë nga grekët prodhime industriale, blegtorale etj.

Sigurisht kontaktet më të ngushta në mes të firmave tregëtare do të hapin perspektiva të mira dhe të leverdisshme për tregëtinë në mes të dy vendeve tona. Kjo do të bëjë gjithashtu që të njihet më mirë zhvillimi ekonomik dhe kultural i të dy vendeve tona, do të hapë rrugën për shkëmbime delegacionesh kulturele. Ne dëshirojmë që të njihet nga populli vëlla grek realiteti në vendin tonë dhe kemi shpresa se përfaqësues të

opinionit progresist grek do të vijë në Shqipëri dhe përfaqësues të organizatave shoqërore e kulture shqiptare do të venë në Greqi për të njohur punën dhe kulturën e njëri-tjetrit.

Populli shqiptar është një popull liridashës që ka luftuar kurdoherë për lirinë, sovranitetin dhe integritetin tokësor të vendit të tij. Ai sot ka fituar lirinë dhe ndërton socializmin me sukses. Ai është një luftëtar i vendosur i paqes.

**PYETJE:** Cila është pozita e Shqipërisë ndaj problemit të Qipros?

**PËRGJEGJE:** Populli shqiptar, duke e çmuar lart çështjen e lirisë së popujve, është për çlirimin e popullit të Qipros nga sundimi i kolonizatorëve anglezë.

Populli shqiptar i uron popullit vëlla grek një jetë të lumtur dhe të begatshme!

*Botuar për herë të parë në gazetën greke «Avji», 18 dhjetor dhe në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 305 (2892), 20 dhjetor 1957*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# PUNA E PARTISË TË NDËRTOHET NË PËRSHTATJE ME RIORGANIZIMIN E ORGANEVE LOKALE TË PUSHTETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 dhjetor 1957

Çështja kryesore që po shqyrtojmë në këtë mbledhje të Byrosë Politike është riorganizimi i organeve lokale të pushtetit dhe, në përshtatje me të, ndërtimi i punës së Partisë, pastaj thjeshtësimi i aparateve administrative shtetërore, të Partisë e të organizatave të masave.

Problemi i parë që del është nëse do të vazhdojnë të ekzistojnë qarqet, apo do të shkrihen. Në qoftë se mendohet që qarqet nuk duhet të jenë, atëherë ka dy propozime: njëri për krijimin e komiteteve ekzekuti-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua mbi thjeshtësimin e aparateve shtetërore, të Partisë dhe të organizatave të masave.

ve të këshillave popullore të lokaliteteve dhe tjetri për krijimin e selsovjetëve<sup>1</sup>.

Unë nuk jam dakord për ngritjen e selsovjetëve, ne nuk duhet të kopjojmë Bashkimin Sovjetik, Rumaninë dhe Bullgarinë. Sot është e parakohshme që ne t'i krijojmë këta selsovjetë, sepse aktualisht mungojnë kushtet e nevojshme objektive dhe subjektive. Cilat janë këto kushte? Në radhë të parë është e domosdoshme të shohim gjendjen ekonomike të fshatit tonë dhe stadin e zhvillimit të kolektivizimit të bujqësisë. Si mund të kemi këshill për disa fshatra bashkë kur kooperativat bujqësore janë në përgjithësi në bazë fshati? Nuk është i drejtë mendimi që na transmeton këtu Liria [Belishova] se në Vlorë e në Shkodër paska propozime për krijimin e selsovjetëve, të cilët «nuk kanë përgjegjësi për kooperativat bujqësore, zgjidhin vetëm çështje administrative, sepse çështjet ekonomike i zgjidh rrethi». Ky mendim është i shtrembër, sepse i heq pushtetit në bazë funksionin ekonomik, e zhvesh atë nga detyrat e mëdha që ka për zhvillimin dhe përparimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe të kolektivizimit të mëtejshëm të saj. Do të vijë dita kur të krijohen këshilla për disa fshatra, por kjo mund të ndodhë kur zhvillimi ekonomik i fshatit tonë do të shpjerë në bashkime kooperativash bujqësore, të cilat të përfshijnë disa fshatra. Atëhere mund të mos jetë nevoja të ekzistojnë komitetet ekzekutive të këshillave popullore të lokaliteteve, sepse do të jetë këshilli

---

<sup>1</sup> Selsovjeti do të ishte një këshill, që do të përfshinte disa fshatra dhe do të lidhej direkt me rrethin.

i fshatrave që do të bashkohen në një kooperativë të madhe<sup>1</sup>.

Ne kemi vërtet suksese në ngritjen e kooperativave bujqësore, por nga pikëpamja e ndërgjegjes së fshatarit jemi prapa. Kjo është e natyrshme, sepse ekonomia zhvillohet më shpejt se ndërgjegjia e njeriut. Jeta tregon se nuk ka ardhur koha për bashkimin e kooperativave, sepse, përveç arsyes që shumë ekonomi bujqësore janë të dobëta nga pikëpamja ekonomiko-organizative, një pjesë e fshatarëve qëndrojnë akoma jashtë tyre, pra nuk janë kooperativistë. Për këto arsye, sot nuk mund t'u themi kooperativave të bashkohen. Me forcimin e tyre ekonomiko-organizativ, vetë kooperativistët do të thonë: «Ja sa të mira na solli kooperativa bujqësore, atëhere pse të mos bashkoemi?». Kjo do të lehtësojë pastaj çështjen e grumbullimit, të tatimeve etj.

Përveç këtyre ne sot kemi nevojë që t'i vemë sa më afër në ndihmë popullit të fshatit, gjë që do ta arrijmë në qoftë se këshillin popullor e kemi në fshat, bile ta forcojmë atë. Po kështu, sot ne kemi nevojë të ndieshme për kuadro. Këta kuadro të paktë duam që të lidhen mirë me prodhimin, prandaj duke krijuar komitetet ekzekutive të këshillave popullore të lokaliteteve, mund të dërgojmë atje të paktën një

---

<sup>1</sup> Ky parashikim i shokut Enver është bërë realitet sot, kur janë krijuar këshillat popullore të fshatrave të bashkuara sipas kooperativave bujqësore. Në këto kushte të reja që u krijuan u shkrinë edhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të lokaliteteve.

agronom. Më vonë ne do të luftojmë që të ketë edhe më shumë se një agronom në çdo kooperativë. Pra në kushtet tona, jo selsovjeti, por komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të lokalitetit do të zgjidhë shumë çështje të zhvillimit të kooperativave bujqësore, ai do të zgjidhë edhe çështje të karakterit administrativ.

Është e qartë se ne duhet të pranojmë variantin që të kemi komitete ekzekutive në lokalitete, por del çështja sa të tilla do të jenë. Ajo që ka rëndësi është që komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të lokalitetit të bëhet me të vërtetë një qendër me rëndësi e pushtetit dhe të merret me kryerjen e detyrave kryesore që na preokupojnë në bazë. Po të kuptohet nevoja dhe rëndësia e krijimit të kësaj hallke të pushtetit në lokalitet si një domosdoshmëri objektive në kushtet e sotme, nuk është zor të caktohet edhe numri i tyre<sup>1</sup>. Të mbajmë parasysh atë që tha shoku Mehmet për të mos krijuar shumë lokalitete, sepse, siç thashë, kemi edhe mungesë kuadrosh. Në një lokalitet që ka shumë fshatra, të dërgojmë një kryetar të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor që të jetë i përgatitur, i zoti, duke i dhënë edhe rrogë më të madhe.

Krijimi i komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të lokaliteteve kërkon edhe adaptimin e punës së Partisë. Këtu lind pyetja: a duhet të kemi komitete të Partisë në lokalitete? Ashtu si dhe shokët e tjerë të Byrosë, edhe unë kam mendimin se nuk duhet të kemi. Çështja është që të studjojmë se si do të orga-

---

<sup>1</sup> Byroja Politike vendosi që t'i rekomandojë Presidiumit të Kuvendit Popullor për të krijuar deri në 220 lokalitete.

nizojmë punën e Partisë në lokalitet. Unë mendoj që, për të ndihmuar efektivisht bazën, të kemi instruktorë të aftë, midis të cilëve të bëhet një ndarje territoriale, sipas lokaliteteve. Çdo instruktor të ketë një lokalitet, ose kur lokaliteti është i madh, mund të ketë edhe dy instruktorë<sup>1</sup>. Ka rëndësi të veçantë që instruktori të përgjigjet për të gjithë aktivitetin e jetës së Partisë në lokalitet: për bujqësinë, për çështjet organizative, për propagandën, për pushtetin, për artizanatin etj. Ne duhet të ecim me guxim drejt kësaj pune, duke ndihmuar që instruktorët të kualifikohen vazhdimisht.

Duke organizuar kështu zbatimin e detyrës së instruktorëve, është e nevojshme të mendohet edhe për ndarjen e punës midis sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve. Mendoj se ndarja profesionale midis tyre mund të mos jetë aq e theksuar, e prerë si me thikë. Nuk ka nevojë për një ndarje shumë profesionale. Profili kryesor i kuadrove të aparateve të Partisë në rrethe është ai i punëtorit të Partisë. Ata instruktorë që njohin më mirë industrinë, mund të caktohen për këtë sektor; ata që njohin më mirë bujqësinë, mund të caktohen me fshatin sipas lokaliteteve dhe të lidhen me sekretarin e komitetit të Partisë që ka bujqësinë etj. Por në kushtet e tanishme, kur në bazë ka shumë probleme, të cilat në të ardhshmen kolektivizimi i bujqësisë do t'i zgjidhë më mirë dhe kuadro do të kemi më shumë, është e nevojshme që midis sekretarëve të komiteteve të Partisë të ketë edhe ndarje

---

<sup>1</sup> Numri i instruktorëve për çdo rreth u vendos të jetë sipas normativës: 1 instruktor për 8-14 organizata bazë partie.



territoriale. Në qoftë se rrethi ka 2 sekretarë, atëhere njëri prej tyre të marrë lokalitetin kryesor, që mund të jetë lokaliteti i qytetit. Ky do të ketë në lidhje instruktorët e lokalitetit të qytetit dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet. Ndërsa, kur rrethi është i madh dhe komiteti i Partisë ka 3-4 sekretarë, atëhere secili prej tyre ka 2-3 lokalitete dhe përgjigjet për të gjitha problemet në territorin që përfshijnë këto lokalitete. Kjo ndarje pune e lidh më mirë me bazën sekretarin e komitetit të Partisë, i cili vjen në qendër të rrethit atëhere kur është e domosdoshme, kur ka mbledhje të byrosë ose ndonjë seminar në shkallë rrethi etj.

Deri sot në komitetet e Partisë të rretheve ne kemi seksione, ndërsa tani mendohet që këto seksione të shkrihen dhe të mbeten vetëm dy bërthama: njëra e seksionit të organizimit dhe tjetra e agjit-propit. Ky organizim do ta bëjë më operativ aparatit e Partisë, veç të mbajmë parasysh se tani del nevoja që instruktorët e komitetit të Partisë të mbajnë lidhje të ngushta me këto bërthama, t'i ndihmojnë ato me të dhënat që kërkojnë sepse kështu do të ndihmohen edhe vetë instruktorët.

Vërejtjet që u bënë në këtë mbledhje të Byrosë Politike, s'ka dyshim se do të ndihmojnë në forcimin e punës së pushtetit dhe të Partisë në rrethe e në bazë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**MBI RUAJTJEN E PRONËS SOCIALISTE NË  
EKONOMI NGA PËRVETËSIMET, DËMTIMET  
DHE SHPËRDORIMET**

*Letër dërguar komiteteve të Partisë në qarqe  
e në rrethe*

**6 janar 1958**

**KOMITETEVE TË PARTISË NË QARQE E NË RRETHE**

Për njoftim:

**KRYEMINISTRISË  
GJITHË DIKASTEREVE E ORGANIZATAVE EKONOMIKE  
KËSHILLIT QENDROR TË BPSH  
KOMITETIT QENDROR TË BRPSH  
KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË BGSH**

Komiteti Qendror i PPSH ka theksuar vazhdimisht se forcimi, ruajtja dhe administrimi i mirë i pronës socialiste janë kusht i domosdoshëm për ecjen tonë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit. Të udhëhequra nga kjo porosi, organizatat e Partisë, organet e

shtetit dhe të ekonomisë, kanë marrë një sërë masash të rëndësishme me karakter edukativ dhe administrativ. Është forcuar puna ideo-politike e Partisë me komunistët dhe me punonjësit pa parti, janë marrë masa për pastrimin e aparateve e të ndërmarrjeve ekonomike, shtetërore dhe kooperativiste nga elementët e padëshirueshëm dhe për zëvendësimin e personave me përgjegjësi materiale që kanë rezultuar me deficite e suficite; janë nxjerrë vendime dhe rregullore të veçanta mbi ruajtjen dhe administrimin e pronës socialiste, është përmirësuar puna e organeve të punëve të brendshme e të drejtësisë, si organe të diktaturës së proletariatit, në drejtim të zbulimit dhe të goditjes së elementit shpërdorues. Si rezultat i kësaj pune janë arritur përmirësime të dukshme në ruajtjen dhe në administrimin më të mirë të pronës socialiste në ndërmarrjet shtetërore dhe në organizatat ekonomike kooperativiste.

Por, me gjithë këtë, Komiteti Qendror i PPSH konstaton se puna e Partisë dhe e organeve shtetërore për ruajtjen dhe administrimin e mirë të pronës socialiste nuk është në nivelin e duhur. Akoma nuk u është bërë e qartë të gjitha masave punonjëse se prona socialiste mbi mjetet dhe veglat e prodhimit është baza e fuqisë ekonomike të shtetit tonë socialist dhe e rritjes së nivelit material e kultural të popullit, se çdo punonjës duhet të jetë i interesuar për forcimin e pronës socialiste, pasi sa më i pasur të jetë shteti ynë, aq më e lartë do të jetë mirëqenia e çdo qytetari. Prandaj, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë popullore si në industri, tregëti, bujqësi etj. vërehen akoma raste të shëmtuara të vjedhjeve e të abuzimeve të pronës socialiste, një pjesë e

mirë e të cilave është zbuluar dhe goditur me vonesë. Vetë fakti që gjatë 9 muajve të vitit 1957 në sektorët ekonomikë janë marrë masa kundrejt mjaft personave, që kanë përvetësuar një shumë prej 20 milion lekësh, tregon se elementi armik dhe i pandërgjegjshëm ka mundur të përfitojë nga dobësitë tona dhe të na dëmtojë. Ai ka përdorur në këtë drejtim forma dhe metoda të ndryshme për të përvetësuar dhe dëmtuar pronën socialiste, duke komprometuar në këtë punë edhe njerëz me përgjegjësi, por të mbarsur me mbeturina mikroborgjeze, duke krijuar çrregullime në dokumentacionet kontabël, duke shkaktuar konfuzion dhe anomali në punë, me anë të ryshfeteve e të familjaritetit të sëmure për të dobësuar vigjilencën etj.

Karakteristikë e vjedhjeve dhe e shpërdorimeve të zbuluara dhe të goditura kohët e fundit është organizimi i elementëve vjedhës e shpërdorues në formë grupi me rreze të gjerë veprimi, me vleftë të madhe të përvetësuar e të shpërdoruar. Kështu në sektorin e lëndës djegëse të Kooperativës së kombinuar autonome të artizanatit në Krujë u zbulua një grup i organizuar vjedhësish prej 20 vetësh, që ushtronte veprimtari në pesë ndërmarrje dhe organizata ekonomike: në Kooperativën e Artizanatit në Krujë, në Kooperativën e Konsumit në Mamurras, në NIL-Prodhome Durrës, në NTLUS-in dhe në Kooperativën e Punim-drurit në Tiranë, duke përvetësuar mallra që arrijnë vleftën 1,5 milion lekë. Po kështu në rrethin e Lushnjës, në vjedhje të ndryshme, ndër to edhe në formë grupi, janë implikuar 25 vetë. Raste të tilla të përvetësimeve në formë grupi ka pasur edhe në rrethe të tjera.

Përveç përvetësimeve, ka edhe raste të dëmtimeve të pasurisë socialiste nga qëndrimet e pandërgjegjshme, nga çrregullimet në proceset teknologjike etj., të cilat u krijojnë terren dhe kushte të favorshme për shpërdorime njerëzve të pandërgjegjshëm dhe armiq. Raste të dëmtimit të mallrave vërtetohen në shumë ndërmarrje industriale si në NISH-Cigare në Durrës, në Fabrikën e Qelqit në Korçë, në NISH-Tulla dhe në NTLAU në Tiranë etj.

Përvetësimet dhe shpërdorimet e pronës socialiste janë aspekt i luftës së klasave, e cila në periudhën e kalimit nga shoqëria feudoborgjeze në shoqërinë socialiste nuk shuhet, por vazhdon të ekzistojë dhe të shfaqet në forma të ndryshme edhe në sektorin e ekonomisë. Ato janë shfaqje të mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve. Komitetet e Partisë nuk i kanë pasur kurdoherë parasysh këto rreziqe që e kërcënojnë pronën tonë socialiste. Ato nuk kanë bërë një punë të vazhdueshme dhe sistematike me komunistët dhe punonjësit pa parti për edukimin e tyre, për të ngjallur te ata ndjenjën e mbajtjes lart të emrit të qytetarit të ndershëm dhe të anëtarit të Partisë. Organet shtetërore, me masat administrative që kanë marrë, nuk kanë mundur të kufizojnë dhe të mbyllin të gjitha shtigjet e vjedhjeve dhe të abuzimeve.

Komiteti Qendror i PPSH e quan të domosdoshme të ritheksojë dhe t'u tërheqë vëmendjen komiteteve dhe organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe ekonomike, mbi rëndësinë e madhe që duhet t'i kushtojnë luftës kundër dëmtimit të pasurisë socialiste, luftë që duhet të jetë e vazhdueshme, e ashpër dhe kë-

mbëngulëse. Të kuptohet drejt dhe të bëhet e qartë për të gjithë se çdo dëmtim i pronës socialiste, sado i vogël që të jetë, e dobëson ekonominë tonë popullore, pengon përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies materiale e kulturele të popullit.

Për këtë qëllim të forcohet puna edukative e Partisë me komunistët, me punonjësit në organizatat e masave dhe me të gjithë popullin, për të mbajtur gjallë dhe për të zhvilluar te ata ndjenjën e nevojës për mbrojtjen dhe ruajtjen e pronës socialiste, për të formuar dhe forcuar ndërgjegjen e tyre me tiparet dhe me normat e moralit komunist.

Të mbahet vazhdimisht parasysh se çdo anomali dhe çrregullim që ekziston në punën tonë përdoret dhe shfrytëzohet nga elementi armik dhe i pandërgjegjshëm për të dëmtuar pronën socialiste. Prandaj, rritja e përgjegjësisë personale të komunistët dhe të punonjësit pa parti kundër çrregullimeve, zhvillimi i kritikës dhe i autokritikës për t'i vënë ata në pozita luftarake kundër çdo neglizhence që shfaqet në këtë drejtim, duhet të jenë në qendër të vëmendjes së punës së Partisë.

Organizatat e Partisë, duke aktivizuar më shumë organizatat e masave dhe kolektivat punonjëse, të organizojnë në ndërmarrjet dhe qendrat e punës kontrolle shoqërore dhe gjyqë shoqërore, të krijojnë një ambient mbytës e përbuzës për të gjithë personat që vjedhin, dëmtojnë e shpërdorojnë pasurinë e përbashkët. Rastet e vjedhjeve, të shpërdorimeve dhe të dëmtimeve, sado të vogla që të jenë, të bëhen objekt i një diskutimi të gjallë në të gjithë punonjësit. Të luftohet tendenca e disa drejtuesve të ekonomisë për t'ia referuar rastet e

dëmtimeve të pasurisë socialiste prokurorisë dhe organeve të drejtësisë pa i bërë këto, krahas kësaj, probleme të të gjithë kolektivit, me qëllim që të nxirren mesimet e duhura.

Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar punës me kuadrin. Të mbahet vazhdimisht parasysh porosia e Partisë që në vendet me përgjegjësi materiale të vihen njerëz që e kanë treguar me punë ndershmërinë e tyre dhe të mos mbahen në vende të tilla ata që kanë dalë me suficite e deficite dhe që kanë dëmtuar pasurinë socialiste.

Është e nevojshme që organizatat e Partisë të forcojnë kontrollin mbi aktivitetin e organeve shtetërore dhe ekonomike në drejtim të forcimit të vigjilencës, të ushtrimit të kontrolleve dhe të inventarizimeve të befasishme, të vendosjes së rregullit në mbajtjen dhe në azhurnimin e kontabilitetit dhe të kërkojnë zbatimin me rreptësi të të gjitha rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi në drejtim të dokumentimit të gjendjes dhe të qarkullimit të mallrave etj.

Organet e shtetit dhe të ekonomisë të kërkojnë dhe të kontrollojnë zbatimin e plotë nga ana e ndërmarrjeve dhe e organizatave ekonomike të rregulloreve dhe të udhëzimeve që janë lëshuar në drejtim të ruajtjes dhe administrimit të mirë të pronës socialiste, të shumëfishojnë dhe të shpejtojnë kontrollet financiare të ndërmarrjeve, të forcojnë sektorin e llogarisë në mënyrë që azhurnimi i llogarive të bëhet në afatet e caktuara.

Kjo letër të punohet brenda muajit shkurt 1958 në byrotë e komiteteve të Partisë në qarqe e në rrethe, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në kolegjumet e

dikastereve dhe në këshillat e bashkimeve profesionale, me qëllim që të merren masat e duhura.

Mbi përmbajtjen e kësaj letre të vihen në dijeni edhe kolektivat punonjëse të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore dhe kooperativiste.

Komiteti Qendror i PPSH është i bindur se me një mobilizim më të madh të organizatave të Partisë, të organeve ekonomike dhe të shtetit, do të forcohet edhe më mirë puna për ruajtjen dhe për administrimin e pronës socialiste.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



**LETËR DËRGUAR BYROSE POLITIKE TË KQ  
TË PPSH ME ANËN E SË CILËS I KËRKON  
NDËRRIMIN E EMRIT TË HIDROCENTRALIT  
MBI LUMIN E MATIT**

7 janar 1958

**BYROSE POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH**

Të dashur shokë,

Më 11 janar do të inaugurohet një nga veprat më të mëdha të planit tonë të dytë pesëvjeçar, hidrocentrali «Enver». Kjo vepër e mrekullueshme u ndërtua nga klasa jonë punëtore heroike e udhëhequr nga Partia jonë e dashur e me ndihmën e Bashkimit Sovjetik.

Kjo fitore e madhe u arrit, si të gjitha fitoret e tjera që ka korrur populli ynë, për arsye se Partia jonë, Parti e tipit të ri leninist, është udhëhequr në çdo hap nga doktrina e pavdekshme e marksizëm-leninizmit. Partia jonë në ndërtimin e hidrocentraleve ka pasur kurdoherë parasysh fjalët e Leninit të madh:

*«Komunizmi është Pushteti Sovjetik plus elektrifikimi i të gjithë vendit. . .»<sup>1</sup>.*

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 480.

Ky hidrocentral i madh, që ne do të inaugurojmë më 11 janar 1958, është quajtur që në fillim me emrin tim. Ky është një nder shumë i madh që më është bërë nga ana e Partisë sonë të dashur, për të cilën kam shkri-  
rë dhe do të shkrij të gjitha energjitë e mia.

Me këtë letër unë vij t'ju lutem, të dashur shokë, që të ndryshohet emri i hidrocentralit të Ulzës, ai të mos quhet më me emrin tim dhe i propozoj Byrosë Politike të Komitetit Qendror që kësaj vepre madhështore t'i vërë emrin e themeluesit dhe mësuesit të lavdishëm të komunizmit ndërkombëtar, Karl Marks.

Unë falenderoj me mirënjohje të pafund Partinë tonë, Komitetin Qendror të saj dhe gjithë punëtorët heroikë, teknikët dhe inxhinierët shqiptarë si dhe ata sovjetikë, që, duke punuar kaq vjet me radhë, i dhanë popullit tonë këtë vepër të madhe, e cila, bashkë me hidrocentralin e parë në Shqipëri me emrin «Lenin», janë një bazë e shëndoshë elektrike, që i hapin rrugën ndërtimit të hidrocentraleve të tjera në vitet e ardhshme dhe elektrifikimit të të gjithë Shqipërisë në perspektivë, i hapin popullit tonë rrugën e begatisë dhe të lumturisë.

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 10 (2911), 12 janar 1958*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 10 (2911), 12 janar 1958*

---

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSII mori parasysh kërkesën e shokut Enver Hoxha dhe vendosi që hidrocentrali mbi lumin e Matit të quhet me emrin e themeluesit dhe mësuesit të lavdishëm të komunizmit ndërkombëtar, Karl Marks.

## MË TEPËR KUJDES PËR CILËSINË E PUNËS NË FORMAT E ARËSIMIT POLITIK TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 janar 1958

Edukimi marksist-leninist i komunistëve është problem i madh dhe duhet të preokupojë gjithë Partinë. Nga informacioni që na u dha rezulton se sasia e temave që zhvillohen në format e arësimit politik është e mirë, po ajo që kërkon më shumë vëmendje është nevoja për të përmirësuar cilësinë e tyre dhe për të shtuar pjesëmarrjen në këto forma.

Nevoja për një cilësi më të lartë në format e arësimit të Partisë diktohet nga disa arësye. Tani ne nuk jemi më si në vitet e para të pasçlirimit. Njerëzit që marrin pjesë në format kanë një eksperiencë të pasur në jetën dhe luftën e Partisë, ata nuk janë më analfa-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth informacionit «Mbi fillimin e vitit arësitor 1957-1958 në Parti», paraqitur nga Drejtorja e Agjitacionit dhe e Propagandës pranë KQ të PPSH.

betë dhe niveli i tyre vjen gjithmonë duke u rritur. Shumica kanë mundësi t'i studjojnë individualisht materialet dhe të përfitojnë prej tyre. Prandaj, në përputhje me kushtet e reja, edhe cilësia e punës në forma duhet të jetë më e lartë. Veç këtyre edhe kërkesat e ndërtimit socialist të vendit e bëjnë të domosdoshme ngritjen e nivelit ideologjik të komunistëve.

Çështja e pjesëmarrjes në forma ka gjithashtu rëndësi të madhe. Përse nuk ndiqen si duhet format? Kryesorja është mosinteresimi sa duhet i organizatave bazë të Partisë dhe i komiteteve të Partisë në rrethe. Është e domosdoshme që për mbarëvajtjen e formave të arësimit politik të interesohen më tepër komitetet e Partisë, veçanërisht sekretari i parë dhe sekretari i komitetit që merret me propagandën. Është fakt se sekretari i parë i komitetit të Partisë nuk interesohet sa duhet për këtë problem. Ai di se viti arësitor në Parti ka filluar, se propagandistët e formave janë caktuar, ndonjëherë thërrret edhe përgjegjësin e propagandës, por më tepër s'kujdeset. Ai nuk njeh konkretisht, për shembull, ç'program ka, si zhvillohen temat, në ç'nivel janë ato dhe diskutimet etj. Kjo situatë duhet të ndryshojë.

Në radhë të parë duhet organizuar ndihma e propagandistëve për të cilët nuk mjafton vetëm interesimi i sekretarit të komitetit të Partisë që ka propagandën, por duhet direkt kujdesi i sekretarit të parë, i cili me aftësinë dhe eksperiencën e Partisë që ka, t'u vejë në ndihmë propagandistëve për përgjegjësinë e madhe që kanë përpara Partisë, të ndihmohen këta efektivisht, për ta kryer sa më mirë detyrën. Prandaj herë pas here, sekretari i parë t'i mbledhë propagandistët dhe, duke

genë vetë i përgatitur, t'u shtrojë atyre gjendjen në format e arësimit, eksperiencën e mirë, dobësitë në punë, në pjesëmarrje etj. Në këto mbledhje, ai dhe shokë të tjerë të zhvillojnë edhe tema në nivel të lartë, me qëllim që propagandistët të ndihmohen për të përmirësuar përmbajtjen e punës ideologjike në forma, të ndihmohen edhe nga pikëpamja metodike. Kur është nevoja, për këto çështje të kërkohet edhe ndihma e Komitetit Qendror të Partisë.

Ka rëndësi që nga disa komunistë të hiqet frika se filozofia marksiste është e zorshme të kuptohet. Edhe shokë që kanë eksperiencë të madhe në ndërtimin ekonomik të vendit tonë kanë frikë të venë në leksionet e ekonomisë politike, të cilën ata e zbatojnë në jetë. Të krijohet te të gjithë besimi i patundur se me përpjekje mësohet gjithshka. Por frika për të mësuar filozofinë marksiste nuk hiqet vetëm me fjalë. Ajo që duhet arrihur është që leksionet të bëhen të kuptueshme për masën e Partisë. Natyrisht, për propagandistët e formave të arësimit, bile dhe për ata që kanë mbaruar për filozofi, nuk është aq e lehtë që temat filozofike të zërthehen e të lidhen me kushtet e vendit tonë, me problemet dhe detyrat tona. Prandaj, udhëheqja e Partisë, duke filluar që nga Komiteti Qendror e deri në rrethe e në bazë, të ndihmojë që propagandistët të përgatiten e të zhvillojnë leksione sa më të kuptueshme, të luftohet kundër shpjegimit të teorisë në mënyrë dogmatike, të evitohen frazat e termat e errëta që edhe njerëz me nivel të ngritur i kuptojnë me vështirësi. Ndryshe nuk ka se si t'u dalë frika disa njerëzve të thjeshtë të Partisë, për të mësuar marksizëm-leninizmin.

Edhe pyetjet që bëhen në forma disa herë i frikësojnë dëgjuesit, sidomos kur nuk kanë kuptuar leksionin dhe nuk janë përgatitur mirë për të. Shumë propagandistë përpiqen dhe punojnë që temat t'i zhvillojnë mirë, pyetjet t'i bëjnë të kuptueshme, po ka edhe të tjerë që, në emër të thjeshtimit të çështjeve, thonë vetëm fjalë, që shpeshherë s'kanë brumë. Pra, zhvillimi i leksionit me cilësi, i bën njerëzit që t'i kuptojnë mirë çështjet e të mësojnë dhe kështu do të jenë në gjendje të orientohen në jetë. Thjeshtimi i leksionit dhe konkretizimi i tij, i tërheq shumë dëgjuesit, por kjo s'do të thotë që të mos jepen parimet kryesore të teorisë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Komunistëve duhet t'u futet dëshira që të mësojnë dhe të ngrenë kurdoherë nivelin e tyre teorik.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# KRIKA NË POPULL E GABIMEVE TË BËRA PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË, NUK NA DOBËSON, POR NA FORCON AKOMA MË TEPËR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 janar 1958

Është fakt që puna e Partisë në Shkodër ka ecur përpara. Shkodra ka dalë nga gjendja e vështirë në të cilën ka qenë më parë dhe ka arritur rezultate të mëdha politike dhe ekonomike<sup>2</sup>. Ajo është e lidhur ngushtë me Partinë, megjithëse armiku nuk e ka pushuar punën e tij. Sukseset në Shkodër i detyrohen udhëheqjes së drejtë të Partisë, mobilizimit të popullit të të gjithë ven-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga një ekip i KQ të Partisë dhe të qeverisë «Mbi disa të meta në punën e Partisë dhe organeve shtetërore për kolektivizimin e bujqësisë në qarkun e Shkodrës».

<sup>2</sup> Atëhere në qarkun e Shkodrës kishte 136 kooperativa bujqësore, që përfshinin 68,6 për qind të ekonomive bujqësore me 70,9 për qind të tokës së punueshme të zonës fushore.

dit dhe të vetë qarkut. Këto rezultate u detyrohen dhe shokëve drejtues të këtij qarku, të cilët, mendojmë ne, të mos dehen nga sukseset që kanë korrur dhe të mos lejojnë gabime të tilla, si këto që po analizojmë sot.

Kolektivizimi i bujqësisë te ne nuk shkon keq, por ka edhe gabime serioze si në Shkodër, gabime të cilat na pengojnë në forcimin dhe zgjerimin e kooperativave bujqësore, në shtimin e tyre me kooperativistë të rinj. Këto gabime krijojnë edhe një terren të përshtatshëm për armikun, i cili i shfrytëzon për llogari të tij. Po të mos ndreqen gabimet e vërtetuara, ne do të kemi një humbje të madhe, pse njerëzit do të vazhdojnë të jenë të pakënaqur, nuk do të punojnë me zell, do të vonohet hyrja në kooperativë e anëtarëve të tjerë. Prandaj këto gabime të shihen me sy politik. Unë kam përshtypjen se përgjegjësia për këtë gjendje është kuptuar, kjo është pozitive dhe na siguron që gabimet do të korrigjohen në rrugë të drejtë siç na mëson Partia. Zbulimi dhe kritika e gabimeve nuk na dobëson, por na forcon, nuk ul autoritetin e Partisë dhe të drejtuesve të saj, përkundrazi e ngre atë më tepër, na afron me masat, të cilat dinë çdo gjë që bëjmë ne, dinë sukseset dhe gabimet tona. Prandaj të njohim gabimet para popullit, kjo është gjë e mirë.

Ç'gabime duhen njohur në popull?

Së pari, nga ju si drejtues<sup>1</sup> dhe të tjerë në qark, në rreth e deri në bazë, t'i thuhet Partisë dhe masave fsha-

---

<sup>1</sup> U drejtohet shokëve të Komitetit të Partisë të qarkut dhe të rrethit të Shkodrës që janë thirrur në Sekretariatit e KQ të PPSH.



tare se ç'gabime janë bërë, kush ka gabuar për shembull duke bërë spostime tokash në shkallë kaq të gjerë<sup>1</sup>, kush ka shkëlur direktivën e Partisë dhe urdhërin e qeverisë për këtë çështje dhe të shpjegohet pse Partia nuk lejoi të bëhen spostime kaq të shumta siç ka ndodhur në Shkodër. Kjo nuk do të thotë të mos bëhen fare spostime, por ato të jenë me vend, sipas kritereve dhe të bazohen në rregullat e caktuara. Disa spostime mund të bëhen, por pa e cënuar interesin e kooperativistëve dhe të fshatarëve. Atë që akoma nuk ka hyrë në kooperativën bujqësore të mos e prekim në interesin e tij, por si kooperativist i ardhshëm ta ndihmojmë që të shohë forcën e kooperativës bujqësore, sepse nesër do të jetë anëtar i saj. Kur gjysma e fshatit është jashtë kooperativës, t'i spostosh tokën, kjo është e dëmshme. Spostime mund të bëhen kur jashtë kooperativës bujqësore qëndrojnë akoma 4-5 vetë, pra në spostimin e tokës të veprohet në mënyrë të kufizuar dhe me bindje.

Nga ana tjetër, të veprohet mirë në verifikimin e spostimeve që ato të jenë të drejta dhe në përputhje me vijën e Partisë dhe me udhëzimet e qeverisë.

Së dyti, atje ku janë bërë gabime, këto të mos lihen pa u korrigjuar. Në mënyrë të veçantë këtë ta ketë parasysh Komiteti i Partisë i rrethit të Shkodrës, i cili nuk

---

<sup>1</sup> Në atë kohë në qarkun e Shkodrës ishin bërë 1033 propozime për spostime tokash, nga të cilat ishin aprovuar 479. Vetëm në 5 fshatra të rrethit të Shkodrës ishin bërë, me iniciativën e kryesive të kooperativave bujqësore, 25 spostime të tilla, pa prituri aprovimin e komisionit të çështjeve agrare.

ka punuar si duhet që vetë organizata bazë ta mbrojë deri në fund vijën e Partisë. Vija e Partisë nuk mbrohet vetëm nga shokët kryesorë, atë duhet ta mbrojë baza, e cila, po t'i njohë mirë direktivat e Partisë, kur të bëhen gabime, do të reagojë, do të sinjalizojë dhe nuk do të pranojë të veprohet në kundërshtim me vijën e Partisë.

Mund të ndodhë që baza e njeh një vendim, megjithatë ai nuk zbatohet si duhet. Atëhere çështja duhet parë më thellë, sepse komunistët në fshat, njohin vërtet luftën e Partisë, dinë në përgjithësi që kolektivizimi është e ardhshmeja, po të mos harrojmë se ata vijnë nga shtresat e borgjezisë së vogël, te ata ekzistojnë mbeturinat e psikologjisë mikroborgjeze, që e kanë rrënjën te prona private. Këtu e ka burimin fakti që, edhe kur bëhet ndonjë spostim i drejtë, fshatarit nuk i vjen mirë, pse ajo është prona private e tij. Kur një punëtor hyn në Parti i duket sikur në ndërgjegjen e vet lulëzon diçka e fjetur dhe sheh se të gjitha aspiratat e tija janë të natyrshme. Ai e di se do të ndeshet në luftë me një armik, me armikun e klasës, sepse brenda në ndërgjegje ai është më i pastër. Kurse ndryshe ndodh me fshatarin, atë e brejnë nga brenda mbeturinat e ideologjisë mikroborgjeze. Prandaj, kur ai hyn në Parti, ndeshet në luftë me dy armiq: me armikun e klasës dhe me mbeturinat e brendshme në ndërgjegjen e tij. Ne e ndërtojmë punën tonë të Partisë duke i mbajtur parasysht këto veçori dalluese dhe nuk veprojmë shkëputur prej tyre. Por në këtë rast, në Shkodër nuk është punuar kështu, ky është edhe një shkak që janë bërë gabime.

Së treti, duke u marrë me kuptimin e këtyre gabi-

meve që janë bërë në qarkun tuaj, me kritikën dhe autokritikën për to, kini parasysh që të mos u heqë zvarrë kjo punë dhe të lini pasdore problemet dhe detyrat e tjera. Ka rëndësi të madhe që të forcohen kooperativat ekzistuese dhe të ngrihen kooperativa të reja. Ky është një program i tërë, që nuk realizohet me masa, me presione, por me punë edukative, që masat në fshat të binden për drejtësinë e vijës së Partisë, për të mirat që u sjell atyre kolektivizimi i bujqësisë.

Lidhur me masat që propozohen, ato mund t'i vendosim, se janë edukative dhe me siguri shokët do t'i shlyejnë me punë<sup>1</sup>. Këta dhe shokët e bazës që kanë gabuar të bëjnë autokritikë në popull dhe të kenë kujdes që të mos bien përsëri në gabime të tilla. Të nxirren mësim për të forcuar punën ideo-politike dhe organizative, të zhvillohet drejt lufta e klasës, të mos bjerë ndonjë në oportunitizëm, duke pranuar në kooperativë armiq, ndonjërit mund t'i jepet dora, sidomos fëmijëve të tyre, por ndaj armikut të mbahen qëndrime të prera; gjithashtu të ruhen shokët që të mos bien në sektarizëm, duke arritur deri aty sa t'i hiqet triska e Frontit ndonjërit që s'hyn në kooperativë, siç ka ndodhur në Grykë-Manati. Gabime të tilla dëmtojnë rëndë vijën e Partisë, i bëjnë masat të pakënaqura.

Ne jemi të bindur se shokët e Shkodrës do t'i kuptojnë drejt këto gabime. Me siguri, edhe ju, si të gjithë, do të mobilizoheni për t'i kryer me sukses detyrat që

---

<sup>1</sup> Është fjala për masat ndaj drejtuesve kryesorë të Partisë e të pushtetit të qarkut e të rrethit të Shkodrës për gabimet e bëra në çështjen e kolektivizimit.

shtron Partia, jo vetëm në fshat, por dhe në qytet, ku keni punëtorë dhe artizanë të mirë. Puna në Shkodër është në rrugë të drejtë, mos u dëshpëroni nga këto gabime, ndreqini ato si komunistë dhe nxirrni prej tyre mësim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## PROBLEME ME RËNDËSI TË PLANIT TË DYTË PESËVJEÇAR QË DUHET TË RISHIKOHEN

*Shënime mbi bazën e të cilave u fol në mbledhjen  
e Byrosë Politike të KQ të PPSH*

[Janar] 1958

### **Në industri-miniera**

Çështja e kromit. Prodhimi të mos ulet, të paktën të qëndrojmë në shifrat e planit të dytë pesëvjeçar.

Çështja e qymyrgurit. Gjithashtu edhe në këtë duhet të qëndrojmë në shifrat e planit të dytë pesëvjeçar. Të studjojmë seriozisht përdorimin e qymyrgurit për ngrohje. Të pakësohen distancat e transportit për drutë e zjarrit dhe të studjojmë përdorimin e gazit për ngrohje në disa qytete kryesore, si në Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier dhe në qendrat vajguore.

Çështja e lëndës së drurit. Mund dhe duhet të bëjmë ekonomi, por prodhimi i lëndës së drurit për mobileri, të mos ulet dhe unë jam i mendimit që ky plan duhet të shtohet.

Problemi i zdrukthtarive dhe i fabrikimit të mobiljeve nuk është në rrugë të drejtë, ato janë shumë të pamjaftueshme si për qytetin ashtu edhe për fshatin.

Për çështjen e tullave dhe të tjegullave. Mendoj të merren masat që parashikohen në këtë drejtim, por ne nuk duhet të heqim dorë nga tregëtimi i tjegullave dhe i tullave për fshatin, se kjo është një tregëti e dobishme dhe e nevojshme. Vlen të studjohet një organizim më rentabël i punës dhe sa më afër fshatrave me perspektivë ndërtimi në shkallë të konsiderueshme.

Çështja e uljes së prodhimit të çimentos është mjaft serioze. Prandaj ta diskutojmë këtë më mirë në mbledhjen e ardhshme të Byrosë Politike.

Paraqitet nevojë e madhe, mendoj unë, dhe e vlen barra qiranë, të mekanizojmë disa ndërmarrje nacionale ose lokale, si edhe punishte të artizanatit dhe të fabrikojmë mallra të konsumit të gjerë për popullin, të cilat tani i sjellim nga jashtë, ose i fabrikojmë në vend, por sipas një standardi të vjetëruar, gjë që e mban shijen e popullit në vend. Mendoj se industria dhe artizanati duhet të dalin nga lëvozhga ku janë mbyllur, nga kënaqësia në vetëvete për disa prodhime gjoja të reja, por që në fakt janë të vjetra. Këto duhet të kenë më shumë shpirt krijues dhe të adaptojnë e të kopjojnë nga modellet e jashtme ato që fare lehtë mund të përvetësohen.

Veçanërisht problemi i poçerisë më duket se duhet të shikohet që të zhvillohet në një shkallë më të gjerë dhe më të kulturuar. Ky sektor i prodhimit të sendeve të konsumit të gjerë, është shumë interesant, shumë i nevojshëm, i kulturuar dhe ndihmon në higjienën e popullit.

Çështja e industrisë së qelqit dhe e prodhimeve të qelqit gjithashtu duhet të zhvillohet me një ritëm të shpejtë. Mendoj se në ato qendra ku ne kemi fabrika konservash për fruta dhe perime duhet të ngremë nga një punishte të vogël qelqi si ajo e Korçës. Unë mendoj se ajo e Korçës duhet të zgjerohet në perspektivë, me zhvillimin e frutave.

Industrië ushqimore duhet t'i vëmë rëndësi të madhe dhe të jemi krijues në këtë drejtim.

Përsa u përket bimëve mjekësore ose materialeve të tjera që ne eksportojmë, si shqopë etj., mendoj se duhet brenda mundësive, të gjejmë një rrugëzgjdhje për përpunimin e tyre në vend. Të ngremë disa laboratore ose punishte për këto. Pse Çekosllovakia të shesë llulla me shqopën tonë, kur ne, me porosi dhe duke adoptuar modelet më të mira të jashtme, mund të fabrikojmë vetë pipa e çibuqe?

Industrinë e peshkut duhet ta vëmë në rrugë më të drejtë, të edukojmë shijen e popullit, duke manevruar sidomos me çmimet, të cilat tani janë shumë të larta.

Industrinë e qumshtit duhet ta ngremë në një nivel më të lartë si nga ana teknike, ashtu dhe nga ana e kuadrit. Baxhot tona janë shumë primitive dhe baxhoxhinjtë s'kanë asnjë farë kulture teknike. Duhet të pregatitim kuadro. Të përmirësojmë teknikën, të përmirësojmë cilësinë, t'i shtojmë llojet, të përmirësojmë transportin e ambalazhin. Çështja e dyqaneve baxho duhet të shikohet mirë sepse për këto momente ato janë të domosdoshme. Duhet të mendohet mirë puna e përpunimit të qumshtit në kooperativat dhe në fermat blegtorale.

Unë jam i mendimit që industrinë e gomës ta zhvillojmë, por jo të përhapemi në shumë artikuj dhe të harxhojmë kauçukun. Prodhimin e çizmeve nuk më duket e drejtë që ta eliminojmë, pse ne kemi shumë nevojë për to, jo vetëm për punonjësit e industrisë, por edhe për ata të fshatit. Ne duhet të përvetësojmë teknikën e përgatitjes së tyre, që t'i bëjmë ato të forta. Të zëvendësojmë shuallin me gomë dhe të riparojmë gomat e automobilave. Lidhur me këtë duhet të marrë fund çështja e prodhimit të përshtatshëm të nero-fumos (blozës).

Ngritja e mirëqenies së popullit nuk qëndron vetëm në atë që të depozitojë të holla në arkat e kursimit, por në rritjen e prodhimit, që këto të holla ai t'i shpenzojë dhe të përmirësojë jetën, sepse të kesh të holla në bankë, natyrisht i shërben shtetit, por kjo nuk do të thotë se niveli i jetesës së punonjësve ngrihet. Ai që bën kurtime dëshiron edhe të kënaqë nevojat e tija, por ose s'i gjen ato që i duhen ose i gjen por janë shumë të shtrenjta. Fakt është se nevojat për sende shtëpiake janë të mëdha. Të mëdha janë gjithashtu nevojat për shtresa dhe mbulesa. Vata nuk duhet të eksportohet, por të organizohen punishte grash për konfeksione, në seri dhe me porosi, të jorganëve ose të mbulesave të holla për verë me pak vatë, në vend të batanieve të leshta. Këto të konfeksionohen me copat stoqe, ose me mbeturinat e copave të kombinatit të tekstileve.

Industria jonë mekanike gati ka hequr dorë nga prodhimi i veglave bujqësore dhe nuk interesohet nëse bëhen apo jo përpjekje për fabrikimin e disa gjërave të nevojshme dhe praktike për bujqësinë tonë ose për



konsumin e gjerë të popullit. Kjo më duket se duhet parë më seriozisht.

Fabrikat tona të sapunit dhe të artikujve kozmetikë duhet të dalin nga primitiviteti dhe jo vetëm të koncentrohen e të modernizohen, por të përgatitin edhe kuadrot e nevojshëm teknikë për to.

Çështja e kripës duhet të rishikohet, pse kështu kemi mbetur në mëshirën e diellit dhe nganjëherë e importojmë në vend që ta shohim atë si një material eksporti ose shfrytëzimi tjetër kimik, në rast se ka mundësi.

Kuadrot e naftës duhet të studjojnë me kujdes të madh dhe të marrin masa drejt shtimit dhe perfeksionimit tekniko-profesional të tyre të lidhur me perspektivën. Problemi i dublimit të specialistëve sovjetikë me shqiptarë në ekipet gjeologjike dhe gjatë duhet parë mirë.

## Bujqësia

Në asnjë mënyrë të mos ulet sasia e qumështit si edhe e produkteve të tij, gjalpfit dhe djathit, por të punohet për forcimin e organizimit të grumbullimit e të përpunimit të tij. Për çështjen e rritjes së yndyrës në qumësht as që bëhet fjalë në raport. Më duket se në këtë drejtim ne duhet të nxitim fshatarësinë që ajo të marrë nga blegtoria qumësht me sasi sa më të lartë yndyre.

Ne duhet të rishikojmë problemin e rritjes së dërrit në sektorin shtetëror dhe koston e tij. Ne duhet të kemi parasysh më realisht konsumimin e tij nga populli që

qmimi të jetë mjaft i leverdisshëm, ndryshe duhet hequr dorë nga gjithë ai subvencion i shtetit për mish që s'hahet shumë nga populli.

Për ullirin unë nuk jam dakord me pikëpamjen e Ministrisë së Bujqësisë, për të ulur planin që kemi. Përkundrazi ne duhet të organizohemi më mirë që ta realizojmë. Përsa u përket drurëve frutorë, unë jam i mendimit të mos pranojmë shifrat e Komisionit të Planit, por shifrat e bazës. Natyrisht, ne duhet të bëjmë shumë kujdes, që këta jo vetëm të zënë dhe të rriten, por të jenë nga asortimentet e mira dhe jo ngul për të ngulur drurë frutorë ose pjergulla për uthull.

Perimet në përgjithësi duhet të shtohen dhe veçanërisht prodhimi i patates. Zarzavatja kryesore sot për fshatarin është fasulja, kështu duhet të bëhet edhe patatja e perime të tjera. Ngrënia e patates do të na ekonomizojë dhe bukën, po në këtë drejtim duhet të zhvillojmë dhe gështenjën.

Çështja e ujitjeve me anë barazhesh të vogla të ndërtuara nga vetë fshatarët nuk po ndihet, prandaj këtë duhet ta ngremë edhe një herë në plenum. Fshatari pret vetëm nga shteti, po ashtu edhe kooperativat në përgjithësi.

Çështja e kulakëve, nuk duhet lëvizur nga përcaktimi i deritanishëm, sepse ashtu si është shtruar në raport nuk është mirë, në radhë të parë s'është e vërtetë se kulakët janë likuiduar, ata janë kufizuar, por ekzistojnë në fshat dhe na dëmtojnë. Çështja e tyre mund të shikohet më vonë, jo vetëm kur të mbarojë kolektivizimi, por pasi të forcohen dhe kooperativat. Ne, gojarisht, mund t'u themi shokëve në rrethe që t'i shi-

kojnë pak më lehtë ata në drejtim të kufizimit të tyre ekonomik.

Problemi i forcimit organizativ të kooperativave bujqësore me kuadro udhëheqës, me teknikë etj. është një nga problemet më të rëndësishme dhe kyçe të kësaj periudhe. Duhet të rishikohen planet në këtë drejtim qoftë në numrin e kuadrove, qoftë në orientimet e studimit sipas rretheve dhe sipas kulturave. Është e zorshme të zbatohet ajo që thuhet në raport që nxënësit të venë në teknikume bujqësore vetëm pasi të kenë bërë ushtrinë. Teknikumi bujqësor është një shkollë e mesme. Duhet, gjithashtu, të merret një vendim nga ana e qeverisë që studentët, të cilët mbarojnë studimet, të shkojnë të punojnë në terren jo dy vjet, por më shumë dhe të kthehen të punojnë në zyra vetëm pas këtij afati, bile pasi të kenë punuar mirë, domethënë të kenë forcuar njohuritë e tyre teorike me një praktikë të shëndoshë.

Kolektivizimi i kafshëve është një nga problemet më të mëdha të ekonomisë sonë kooperativiste. Ai është shumë prapa kolektivizimit të tokave, prandaj ky raport duhet të ndryshojë krejtësisht. Oborret kooperativiste kanë një sasi të madhe bagëtish të imta që më të shumtat e herës e tejkalojnë tufën e kooperativës. Kjo duhet të ngushtohet shumë dhe në një periudhë të shkurtër, por jo me shitjen jashtë kooperativës ose therjen, veçanërisht të ndaloher shitja e viçave femra jashtë kooperativës. Duhet të shtohet numri i gjësë së gjallë në kooperativa dhe sidomos i lopës në kooperativat e fushës. Para hyrjes në kooperativë janë shitur dhe janë therur bagëti, kjo duhet të na bëhet mësim, sepse akoma s'ka mbaruar kolektivizimi dhe pra, therjet dhe

shitjet jashtë kooperativës duhet të luftohen me ashpërsinë më të madhe.

### **Komunikacioni**

Grumbullimi i maqinave si dhe përqëndrimi e pajisja më e plotë e ofiçinave duhet të jetë në dorën e Ministrisë së Komunikacioneve. Ministrisë së Ndërtimit t'i lihet një kontingjent i mirë, por transportin e materialeve të ndërtimit në distanca të largëta ta marrë komunikacioni. Dikasteret e tjera kanë mjaft maquina që nuk i shfrytëzojnë racionalisht.

Nuk jam në dijeni tani si po shkon çështja e ekonomizimit të veglave të ndërrimit, por di që më parë abuzohej jashtëzakonisht me to. Nuk di çfarë regjimi e çfarë kontrolli ekziston në import, në shitjen e konsumin e tyre dhe çfarë stimulimi ekziston për zgjatjen e jetës së këtyre veglave që na kushtojnë një valutë të madhe dhe çmimet e tyre jashtë i paguajmë jo me çmime eksporti, por me çmimet e brendshme të vendit nga i marrim.

Transporti i rëndë me automobil në rrugët ku kalon hekurudha, mendoj se duhet të ndalohet krejtësisht dhe jo vetëm për mallrat e rënda, por edhe për ato të lehta si për zarzavate etj., nga feramat në qytete ose nga një qytet në tjetrin.

## Ndërtimet

Unë mendoj se disa nga objektet që do të ndërtohen, ne duhet t'i rishikojmë se mund të jenë shumë të kushtueshme dhe jo aq urgjentisht të nevojshme siç paraqiten.

Disa çështje për sqarim:

1. — Në lidhje me dy hidrocentralet e rinj, d.m.th. kur do të fillojnë e kur do të mbarojnë, sa do të kushtojë njëri dhe sa tjetri, a ekzistojnë projekte për ta? Çfarë fuqi punëtore dhe çfarë kuadro të rinj duhen? Maqineri e re për ndërtim duhet apo jo?

2. — Pse të bëhet rindërtimi në një kohë i fabrikave të duhanit në Durrës dhe në Shkodër? Mendoj të fillojmë më parë nga Durrësi dhe ta stabilizojmë tregun e cigareve. Përsa u përket uzinave të fermentimit ato të bëhen. Në rast se ne adaptojmë monopolin e duhanit sipas kushteve të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë atëhere mund të rindërtojmë dhe atë të Shkodrës. Unë mendoj se ne mund ta adaptojmë monopolin e duhanit.

3. — Bazat e peshkimit në Vlorë e në Shëngjin më duket se janë vepra shumë të kushtueshme, prandaj të mos u futemi këtyre, por të rregullojmë strehimin e peshkatarëve në disa vende provizore dhe me më pak shpenzime.

4. — Pse të bëhet krejt e re godina e fabrikës së gomës në Durrës, që do të na kushtojë jo 35 milion lekë, por nja 50 milion? Unë mendoj se me 10-15 milion mundet të bëjmë me bollëk zgjerimin e saj atje ku është dhe të mos harxhojmë për lukse.

5. — Çfarë fabrike është ajo e niseshtes në Kavajë

që në projekt na kushton 20 milion, por në realitet do t'i shtojmë dhe 5 në mos më shumë? Këtu, siç po shoh unë, ne po ngremë vetëm godina, bile për të bërë edhe niseshte, që unë mendoj se mund ta bëjmë edhe gjatë dhe më me pak shpenzime.

6. — Përse ky park automobilistik në Vlorë prej 20 milion lekësh dhe ofiçina e lokomotivave dhe e vagonave në Durrës prej 30 milion?

Në përgjithësi unë mendoj se duhet të jemi ca më të shtërnguar në aprovimin e kërkesave të shumta për ndërtime nga ministritë. Në dukje kërkesat e tyre mund të paraqiten të arësyeshme, me vend, të nevojshme, por po të shikohen më nga afër do të dalë ndryshe. Mendoj gjithashtu që për ndërtimet në ekonomi të enteve të ndryshme duhet të ushtrohet një kontroll më i madh para se të fillohen punimet dhe të rekomandohet thjeshhtësi e madhe, të luftohet luksi dhe ndërtimi i objekteve të kota e të pamenduara mirë.

Ministria e Ndërtimit duhet të mendojë seriozisht për përgatitjen e kuadrit dhe sa të jetë e mundur me perspektivën e ndërtimeve të mëdha, për stabilizimin e tij. Gjithashtu asaj duhet t'i vendosën masa rigoroze në përdorimin e kësaj maqinerie të madhe që i japim për shfrytëzim.

Përsa i përket importit unë mendoj se ministritë kërkojnë shumë dhe nuk kanë kontroll të rreptë në kërkesat që u vijnë nga ndërmarrjet e tyre. Ato nuk i njohin si duhet mjetet e punës së ndërmarrjeve, jetën e këtyre mjeteve etj. Importi, vetëm i këtij viti paraqitet shumë i madh, po sa do të jetë ai i viteve të tjera? Kjo nuk e zvogëlon fare disbalancin e madh të tregëtisë

së jashtme. Unë mendoj që ky vit kaloi si kaloi, por për të dy vitet e ardhshme, duhet t'u ngarkojmë ministrive dhe Komisionit të Planit, që jo vetëm asnjë shtesë importi për maqineri etj., të mos i shtohet këtij plani pesëvjeçar, përkundrazi ne duhet ta ulim importin.

Më vonë ne duhet t'i përcaktojmë më afërsisht afatet e disbalancit në tregëtinë e jashtme dhe të ecim drejt këtij plani, se përndryshe çdo vit do të na marrin kërkesat zvarrë, do të justifikojmë vazhdimisht mosrealizimet e eksportit dhe do të kërkojmë vazhdimisht që miqtë të na shtyjnë kontratat etj., gjëra këto të palejueshme dhe të padrejta.

Çështja e projekteve. Mua më duket se ne tani jemi në gjendje të fillojmë dhe të bëjmë vetë disa projekte, në vend që t'i bëjmë jashtë me valutë. Unë kam shënuar me të kuqe disa objekte të listës Nr. 20, për projektet e të cilave kam menduar, në qoftë se s'gabohem, që t'i bëjmë me forcat tona. Projektet e hekurudhave të ardhshme mund t'i bëjmë edhe këtu, mendoj unë, duke kërkuar disa ndihma nga jashtë. Kështu edhe për projektet që kam nënvizuar.

### Disa çështje të ndryshme

Për çështjen e uljes së çmimeve. Së pari, meqenëse në plenum do të jenë shumë pjesëmarrës mendoj se nuk duhet të zihen në gojë shifra. Së dyti, mua më duket se sasia prej 1 miliard e gjysmë mund të jetë shumë. Mund të mendojmë për ca më pak dhe t'i shtojmë këto në

investime me karakter shoqëror, si kopshte, çerlthe dhe banesa për punëtorët.

Çështja e rrugëve pyjore dhe sasia e lëndës së drurit që duhet prerë. Dyshoj në studimin e drejtë të këtij problemi kaq delikat dhe të kushtucshëm për ne. As Byroja Politike dhe as qeveria nuk e kanë marrë ndonjëherë seriozisht studimin në kompleks të këtij problemi të madh. Ç'duhet bërë? Duhet të dimë mirë gjendjen e pyjeve ekzistuese, sasinë e lëndës industriale, pyllëzimet e reja, natyrale dhe artificiale. Duhet të rihartojmë një plan të madh të pyllëzimeve me një afat të gjatë prej 40-50 vjetësh, përmirësim pyjesh me një afat 10-15 vjetësh dhe rrugët pyjore që ne kemi ndërtuar, që ndërtojmë dhe që do të ndërtojmë në të ardhshmen të shërbejnë për gjithnjë për këtë çështje, të ndërtohen mirë dhe të vendoset dhe një plan për mirëmbajtjen e tyre. Duhet të ngarkojmë njerëz të na përgatitin një plan të tillë të madh perspektiv, se kështu si po ecim, do të qajmë ne dhe brezat e ardhshëm të vendit për këtë lëndë të parë kaq të nevojshme për çdo kohë.

Grumbullimet e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, si ato të detyrueshme ashtu edhe tepricat e tyre, tani e tutje duhet të sistemohen shumë më mirë se ç'janë sot.

Organet udhëheqëse të kooperativave duhet të kontribuojnë shumë për ndihmë reale dhe të drejtë enteve të grumbullimit, jo vetëm për detyrimet si kooperativë, por edhe si oborre kooperativiste. Shlyerja të bëhet praktikë dhe jetë e rregullt në kooperativat.

Në raportin e paraqitur çështja e import-eksportit



është kaluar lehtë, duhet të flitet për rëndësinë dhe detyrat e tija për këtë vit.

Çështja e të plotfuqishmëve të varur nga Kryeministria për kontrollin e standardeve më duket se është e tepërt.

Berati ka arritur një kolektivizim më të madh nga ai që është shënuar në raport.

Pambuku është realizuar vetëm 98,09 për qind, prandaj të jepet shifra e raportit.

Të theksohen gabimet e Shkodrës në spostimet që kanë bërë në plan.

Çështja e tregëtisë dhe kërkesat e saja duhet të rishikohen në drejtim të nevojave të popullit dhe jo vetëm në leverdinë e tij.

Çështja e mekanizimit të sharrave në drejtim të sigurimit me traktorë, vinça etj. duhet parë mirë.

*Botohen për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **TË VËMË TË GJITHA FORCAT PER REALIZIMIN ME SUKSES TË PLANIT TË DYTË PESËVJEÇAR**

*Fjala e mbylljes në Plenumin VIII të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 shkurt 1958

## **I. Disa vërejtje mbi rishikimin e planit të dytë pesëvjeçar**

Më parë se të kalojmë në aprovimin e rezolucioneve dëshiroj të flas për disa çështje që u ngritën edhe në mbledhjen e Byrosë Politike e që u paraqitën për aprovim këtu në plenum dhe u theksuan në diskutimet e tyre edhe nga shumë anëtarë të Komitetit Qendror e shokë të tjerë të Partisë dhe të pushtetit në bazë<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Ky plenum dëgjoi dhe aprovoi raportet: «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit të shtetit për vitin 1957 dhe detyrat e planit të vitit 1958», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu; «Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 1957 dhe detyrat për realizimin e plotë të buxhetit për vitin 1958», mbajtur nga shoku Abdyl Këllezi; «Mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH», mbajtur nga shoku Spiro Koleka.

<sup>2</sup> Në plenum merrnin pjesë edhe sekretarët e parë të ko-

Tani, siç shihet, propozimet e Byrosë Politike janë të pranueshme nga Plenumi i Komitetit Qendror, d.m.th. është i pranueshëm rishikimi i planit të dytë pesëvjeçar, në drejtim të shtimit të prodhimit, si në sektorin e industrisë ashtu edhe në atë të bujqësisë. Investimet e reja që iu shtruan plenumit për aprovim, në përgjithësi janë të drejta. Kështu më duket sikur u shpreh plenumi.

Të gjithë shokët që diskutuan bënë vërejtje të ndryshme kritike, që janë të nevojshme të bëhen, të cilat do t'i shërbejnë jo vetëm gjithë Partisë, po edhe neve udhëheqësve, si të qendrës ashtu edhe të bazës. Është fakt se ne kemi përmirësime në realizimin e planeve, po kemi edhe shumë të meta akoma, të cilat duhet t'i pastrojmë me punën tonë të organizuar më mirë. Kritikën që u bënë këtu për organet qendrore ishin të nevojshme, bile ato mund të bëheshin edhe më haptazi, edhe më të ngjeshura. Po sidoqoftë ato qenë të mira.

Të gjithë shokët theksuan se punimet e këtij plenumi kanë një rëndësi të madhe, sepse këtu ne rishikuar planin e dytë pesëvjeçar, duke shtruar njëkohësisht edhe detyrat e vitit 1958. Ne kemi rishikuar edhe planin e parë pesëvjeçar në vitin 1953, po për gabimet që kishim bërë në drejtim të forcimit të sektorit të bujqësisë, i cili në atë kohë ishte lënë ca pasdore. Mirëpo tani, pas një periudhe prej rreth 4 vjetësh edhe në sektorin e bujqësisë kemi arritur rezultate të kënaqshme dhe dalim përpara popullit jo vetëm me planin

---

miteteve të Partisë e kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve e të qarqeve, kuadro drejtues të dikastereve qendrore, punonjës të aparatit të KQ të PPSH etj.

që ishte hartuar dhe ishte i realizueshëm, por edhe me propozime që plani të shtohet akoma. Këtë ne e bëjmë sepse Partia tani ka fituar një eksperiencë akoma më të madhe, u ka hyrë mirë problemeve si atyre të ekonomisë ashtu edhe atyre të drejtimit dhe janë hapur perspektiva më të mëdha në përmirësimin e punës dhe të ekonomisë sonë. Nga ana tjetër investimet që u bënë gjatë këtyre viteve dhanë rezultatet e tyre dhe tani u shtuan mundësitë për të bërë shtesa. Pra, këto shtesa bëhen së pari me përpjekjet e brendshme të Partisë dhe të popullit tonë dhe së dyti në saje të ndihmës që na jep BS.

Sikurse u tha nga të gjithë shokët plani është mjaft i ngjeshur, por i realizueshëm dhe sikurse doli qartë këtu, kemi besim se do të realizohet.

Të marrim planin e vitit 1957, ai në përgjithësi është realizuar në mënyrë të kënaqshme dhe nga ana tjetër tani shohim se kemi siguri në realizimin e tij, se baza është treguar e gatshme ta realizojë planin qoftë edhe më i madh. Kjo është diçka shumë pozitive për Partinë, d.m.th. që baza ka arritur t'u futet çështjeve të ndërtimit të socializmit çdo vit e më mirë. Baza duhet të ketë inisiativë dhe tani ajo po bën propozime të tilla që e kanë ndihmuar jashtëzakonisht udhëheqjen në këtë drejtim. Dhe vetë ky rishikim i planit duhet të konsiderohet si një përpjekje jo vetëm e disa kuadrove ose e institucioneve, po e gjithë Partisë, e gjithë popullit tonë. Kjo është një siguri e madhe për realizimin e këtij plani.

Disa mund të na thonë përse të bëjmë sforco kaq të mëdha, përse ta ngjeshim kaq shumë planin? Plani është me të vërtetë i ngjeshur sidomos me investime të reja

për naftën, në radhë të parë në përmirësimin e zgjerimin e industrisë ekzistuese, pastaj në hedhjen e themeleve të disa objekteve të reja në industri, si edhe në bujqësi. Një pjesë e këtyre investimeve do të na japë frutet e veta që këtë pesëvjeçar, kurse pjesa tjetër më vonë, d.m.th. në pesëvjeçarin e tretë.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm për realizimin e këtyre investimeve dhe të këtij plani. Tani ne duhet të ecim medoemos me ritme të tilla që të jenë të shpejta dhe të mos kënaqemi me ritme të ngadalshme, ashtu sikurse kemi ecur, sepse këtë e kërkon nevoja e ngritjes së nivelit të jetesës së popullit. Kjo çështje është pasur shumë në kujdes nga ana e Byrosë Politike, d.m.th. që jo vetëm të ruhej niveli i jetesës së punonjësve të qytetit dhe të fshatit gjatë planit të dytë pesëvjeçar siç ishte parashikuar, po me këto investime të mëdha që bëhen të merren masa që niveli i jetesës të ngrihet edhe më shumë. Në fakt, siç e patë, niveli i jetesës së punonjësve të fshatit dhe të qytetit me shtesat që bëhen parashikohet të ngrihet.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që ky plan i ngjeshur duhet të realizohet medoemos. Prandaj realizimi i tij kërkon nga organet e Partisë dhe të pushtetit një mobilizim të madh. Ta organizojmë më mirë nga sa e kemi bërë deri tani punën tonë dhe të mos harrojmë objektivin kryesor që është ngritja e nivelit të jetesës së popullit tonë. Në krahasim me të kaluarën, rezultatet në këtë çështje janë të mëdha, kudo ka përmirësime. Megjithatë ne nuk duhet ta fshehim realitetin e vendit tonë, sepse niveli ekzistues i jetesës, megjithëse më i madh në krahasim me të kaluarën, nuk është ai që

duam ne. Ne kemi akoma nevoja shumë më të mëdha që nga ushqimi e veshmbathja e deri te nevojat e tjera të popullit. Prandaj duke pasur parasysh këto dhe faktin se shteti ynë ka hyrë në vitin e 14-të të jetës së tij, ne duhet t'i shpejtojmë ritmet tona të prodhimit, të shfrytëzojmë sa më shumë të gjitha mundësitë që kemi, qofshin këto të brendshme ose të jashtme, me qëllim që popullit t'i përmirësohet jetesa me një ritëm më të madh. Kjo detyrë është e domosdoshme të kryhet nga ana jonë. Prandaj u vihet detyrë e madhe Partisë dhe të gjitha organeve shtetërore që ta realizojnë plotësisht dhe ta tejkalojnë planin e vitit 1958, duke pasur parasysh që i gjithë plani pesëvjeçar të realizohet sipas shifrave që aprovuam këtu, jo në pesë vjet, po brenda një kohe më të shkurtër, brenda katër vjetëve e gjysmë. Në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje dhe atëhere suksesi ynë do të jetë shumë i madh.

Shokët që diskutuan vunë në dukje shumë suksese që kemi pasur dhe kjo është e drejtë dhe e ligjshme. Por, në realizimin e planeve tona, ne kemi edhe shumë të meta, në radhë të parë në bujqësi, po edhe në industri. Shumë rrethe e qarqe që i kanë realizuar planet në shumë sektorë si p.sh. në atë të pambukut, panxharit e prodhimeve të tjera, pas këtyre realizimeve fshehin edhe mosrealizime të mëdha, ashtu sikurse tha shoku Hysni. D.m.th. me mijëra ekonomi nuk i kanë realizuar planet dhe nga ky shkak shumë rrethe nuk kanë arritur suksese. Natyrisht, ato heshtën dhe janë turpëruar, po kjo çështje duhet bërë mësim, në mënyrë që në vitin 1958 në të gjitha rrethet e vendit tonë të realizohen suksese si në bujqësi ashtu edhe në të gjitha

ndërmarrjet tona, siç janë realizuar në vitin 1957 në rrethet dhe në ndërmarrjet më të përparuara. Kështu plani i vitit 1957 të na shërbejë për t'i organizuar më mirë forcat për vitin 1958 dhe ata që nuk i kanë realizuar planet, të bëjnë përpjekje që të mbushin deficitet që kanë krijuar në vitin 1957.

Desha të theksoja disa çështje edhe *përsa i përket industrisë*. Këtij sektori ne duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, ta shfrytëzojmë atë në maksimum. Për këtë qëllim t'i vëmë rëndësi përgatitjes së kuadrove tanë. Ne kemi organizuar një sërë shkollash e kursesh ku mësojnë njerëzit tanë. Tani e kemi fjalën që nga ana e Partisë të tregohet kujdes akoma më i madh që këto shkolla dhe kurse të zhvillojnë si duhet programet e tyre dhe të bëjnë që kuadrot tanë të ekonomisë të përfitojnë sa më shumë. Puna është që këto çështje të mos i shohim edhe aq ngushtë se pastaj kur të na dalin punët përpara do ta humbasim toruan. Prandaj, të bëjmë përpjekje që tani për t'i përgatitur me kohë kuadrot që na duhen se kjo punë s'bëhet brenda një afati të shkurtër.

Nuk është e drejtë ajo që u tha këtu në lidhje me vështirësitë që kemi ne për kuadrot e naftës tani pas shpërthimit fontan të naftës në Pusin 542, se gjoja vetëm tani na u hapën perspektiva të mëdha për naftën. Komiteti Qendror dhe qeveria kurrë nuk e kishin humbur shpresën në lidhje me perspektivat e naftës. Ne ishim të bindur se kemi perspektiva të mëdha në naftë, prandaj edhe investimet i harxhonim me besim të plotë. Kështu në fakt nafta doli. Por nga dikasteri përkatës duhej të ishte punuar sipas këtij orientimi që kuadrot

tani të ishin gati dhe të mos ndodheshim në një situatë të tillë jo të mirë siç ndodhemi tani për këtë çështje. Kjo na vë detyrë që sa më parë të zgjerojmë shkollat që kemi, si Teknikumin e Naftës ashtu edhe degët përkatëse në universitet, gjithashtu të shtojmë kontingjentet në këtë sektor për të dërguar në BS dhe në vendet e demokracisë popullore njerëz që të mësojnë për naftë; gjithashtu të dyfishojmë ose të trefishojmë kuadrot specialistë sovjetikë që do të duhen për shfrytëzimin e naftës. Por kjo punë duhet të bëhet me seriozitetin më të madh dhe të ushtrohet kontroll i fortë i Partisë që detyrat të realizohen. Në këtë drejtim janë marrë vendime, po puna tani është se ato duhen zbatuar. Për këtë çështje i janë vënë detyra jo vetëm Ministrisë së Industrisë, por njëkohësisht edhe dikasterëve të tjera. Po të vijë koha që të kërkohet llogari, do të dalin shumë arësye për të cilat plani nuk u realizua, po që të mos ndodhë kjo duhet të merren masa me kohë.

Prandaj duhet kuptuar mirë kjo çështje, në radhë të parë nga Partia, si dhe nga kuadrot udhëheqës të dikasterit, në mënyrë që përgatitja e kuadrove të naftës të realizohet shumë mirë e më me cilësi.

Pastaj është edhe çështja e interesimit të Partisë për mbarëvajtjen e këtyre kurseve dhe shkollave, interesim ky që deri tani ka qenë i dobët.

Ne duhet t'i japim rëndësi më të madhe nxjerrjes më shumë të prodhimit të kromit. Sikurse u theksua edhe këtu kromi është një nga mineralet më të vlefshme për ekonominë tonë, të cilin na e kërkojnë shumë, si miqtë ashtu edhe vendet e tjera. Po neve na duket se përsa i përket kromit ka pasur lëkundje d.m.th. jo kemi,



jo nuk kemi krom, jo ka, jo nuk ka front, pra, na jepen gjëra jo të sigurta, ndërsa shoku i Tropojës na tha se Partia atje nuk ka parë aktivizimin e duhur të organeve përkatëse për këtë çështje dhe këtu ai mund të ketë edhe të drejtë. Prandaj, kërkimet për kromin të shpejtohen dhe të bëhen përpjekje që ai të jetë i cilësisë së mirë, si p.sh. në Batër të Martaneshit duhet të intensifikohen punimet dhe të nxirret sa më parë krom që është aq i vlefshëm për ekonominë tonë.

Një çështje tjetër me rëndësi që është ngritur në Byronë Politike është ajo e *elektrifikimit*. Ne po ecim në rrugë të mirë në këtë drejtim. Më 1951 ngritëm Hidrocentralin «Lenin» dhe tani së fundi Hidrocentralin «Karl Marks», pastaj kemi edhe gjithë këto termocentrale. Prandaj, duhet të punojmë mirë për shfrytëzimin e këtyre burimeve dhe rezervave në energji elektrike për të cilat në kushtet e vendit tonë të varfër kemi bërë investime kaq të mëdha. Investimet, Ministria e Industrisë duhet t'i ketë shumë të vogla me qëllim që t'u afrohem normave ndërkombëtare. Në rast se ne do të lëmë rezerva kaq të mëdha pa i shfrytëzuar do të thotë që të mos nxjerrim në kohën e duhur të gjitha këto shpenzime të mëdha që kemi bërë, jo vetëm kaq, por do të kemi dëme, do të rëndojmë shumë ekonominë tonë. Unë mendoj se shfrytëzimin e energjisë nuk duhet ta bëjmë me hope dhe në mënyrë të rastit. Ministria e Industrisë duhet të mendojë thellë për këtë çështje dhe sa më parë të veprohet. Nuk është e nevojshme që një anëtar i Byrosë Politike ose ndonjë shok tjetër t'i rekomandojë Ministrisë së Industrisë se ç'do ta bëjë energjinë, ose t'i

thotë që të hiqen të gjithë motorët diezel që janë gjatë linjës së tensionit të lartë dhe të çohen për dritë atje ku nuk ka energji elektrike. Shokët folën këtu se ku ka nevojë. Prandaj masat që do të merren të bëhen me llogari se ç'duhet të sjellim për këtë qëllim dhe të mos lëmë gjithë këtë energji që prodhojmë të na shkojë kot. Përveç kësaj, Ministria e Industrisë të bëjë një plan më të gjerë për të elektrifikuar mjaft procese pune në industrinë tonë ekzistuese. Ne kemi një industri të vogël që, po t'i bëhen disa ndryshime, mund të punojë me energji elektrike, në mënyrë që kur të vijë koha e dimrit, kur ne do të kemi më shumë energji, kjo industri e lehtë të punojë me energji elektrike. D.m.th. Ministria e Industrisë duhet të marrë masa për shfrytëzimin e rezervave të energjisë elektrike për të vënë në lëvizje me këto rezerva shumë punë dhe procese pune të industrisë sonë të lehtë.

Megjithëse u fol edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, po dua të theksoj edhe një herë detyrën e Ministrisë së Industrisë, e cila duhet të mendojë seriozisht për përtëritjen e industrisë sonë të lehtë të vjetër, d.m.th. ta bëjmë këtë industri pak më të re. Për të përmbushur nevojat e mëdha që ka populli për artikuj të konsumit të gjerë nuk mund të ecet dhe nuk i dilet dot me këto poçeri, zdrukhtari etj. që kemi ne ose me një artizanat që e kemi akoma primitiv. Në këto kushte ne nuk i plotësojmë dot nevojat e popullit, jo vetëm si sasi, po as si cilësi. Ne kemi p.sh. Zdrukhtarinë «Misto Mame» që konsiderohet si fabrikë, po që, sipas mendimit tim, nuk është fabrikë. Atje ne kemi disa sharra që ua kemi konfiskuar disa privatëve 10 vjet më

parë dhe tani me ato po vërtitemi. Ne kemi shtuar atje gjithë ato ndërtesa, kemi gjithë ata punëtorë, po nuk kemi një oficinë. Me këto mjete që ekzistojnë atje, ta merr mendja që artikujt e prodhuar kushtojnë sa qimet e kokës. Por po të mendojmë pak më mirë, punën në këtë ndërmarrje jo vetëm që mund ta organizojmë me dy turne, po edhe të shtojmë kapacitetin e maqinerisë, të sjellim disa maqineri, në mënyrë që gjithë këtë punë të madhe që bëjnë tani punëtorët me dorë ta zëvendësojmë me korent elektrik. Në këto kushte të reja do t'i jepnin popullit mobilje më të bukura, më të lira dhe në sasi më të madhe.

Një problem tjetër që ne duhet ta kemi parasysh është edhe *ruajtja e shëndetit të punonjësve*. Ne nga klasa punëtore duhet të kërkojmë të bëjë përpjekje, të punojë edhe me turne, po të vëmë rregulla dhe kushte që edhe shëndetin e punëtorëve ta ruajmë, sepse shëndeti, po humbi, është diçka që nuk vihet lehtë në vend. Dua të them që, kur kemi mundësi, edhe të prodhojmë më shumë, edhe punëtorët t'i lodhim më pak. Këto masa që thamë duhet, pra, t'i marrim. Me gjithë këto maqineri kaq të mëdha që kemi sjellë, po të kishim sjellë edhe disa gjëra për industrinë e lehtë, ne do të kishim shtuar edhe më shumë prodhimin. Ashtu si për Zdrukthtarinë «Misto Mame» që mora si shembull, mund të themi edhe për të gjitha sharrat dhe shumë punishte të tjera të vogla që ne nuk po i përtërijmë e nuk po i perfeksionojmë. Përse çekët të marrin shqopën tonë, ta bëjnë pipa dhe t'i eksportojnë këta artikuj me fitime të mëdha në Francë, në Itali etj? Nuk mund t'i bëjmë vetë ne këto gjëra? Unë mendoj se po, mjafton

të na vijnë disa maqineri të vogla, disa teknikë çekë, të marrim modelet e tyre dhe kësisoj të mbushim me pipa tregjet perëndimore që i kërkojnë këto. Veç kësaj ne a nuk mund të prodhojmë krëhëra, kopsa e artikuj të tjerë të vegjël për të cilët lëndën e parë e sigurojmë në vend? Po, ne mund t'i bëjmë, mjafton të sjellim disa maqineri të vogla për prodhimin e tyre.

Partia jonë nuk duhet të kënaqet vetëm me të filluarit nga prodhimi të një artikulli dhe pastaj të lihet për gjysmë. Ka ardhur koha që t'u vihemi dhe t'i ndjekim çështjet deri në fund. Partia me të drejtë i ka nxitur dhe i ka perfeksionuar kërkesat e shijen e popullit, po kjo nuk mjafton. Brenda mundësive tona duhet që edhe t'ia plotësojmë këto kërkesa, sepse mundësitë ekzistojnë, vetëm se nuk ekziston sa duhet shpirti i inisiativës, shpirti krijues të kuadrot dhe sidomos të ata të dikastereve tona. Këta, disa herë, i qepen një gjëje të vjetër dhe me zor ecin përpara. Prandaj industria jonë duhet të bëjë përpjekje në këtë drejtim.

*Në sektorin e bujqësisë* rëndësi të madhe ka përgatitja e kuadrove, e cila zë një nga vendet kryesore. Kuadrot teknikë dhe gjysmë teknikë të të gjitha llojeve duhet të përgatiten me kohë sepse tani me kolektivizimin në shkallë të gjerë do të na dalë përpara çështja e forcimit të kooperativave bujqësore, e organizimit më të shëndoshë të punës së tyre. Ne shohim se rezultatet e kooperativave kanë ndryshim të madh me ekonomitë individuale, po ne nuk duhet të kënaqemi me këtë. Ky do të ishte një gabim shumë i rëndë. Prandaj duhet të marrim në dorë që tani çështjen e përgatitjes së kuadrove

të sektorit socialist në fshat dhe jo vetëm të kryetarëve e të llogaritarëve, po edhe të brigadierëve, teknikëve e deri te fshatari i thjeshtë. Kjo punë duhet të merret mirë në dorë nga ana e Partisë dhe të mendohet mirë për përgatitjen e gjithë këtyre kuadrove të shumtë që do të na duhen në të ardhshmen e që tani nuk mund ta imagjinojmë. Këtë punë ne duhet ta bëjmë me doemos, në rast se duam të kemi prodhime më të mëdha, rendimente më të larta dhe të gjitha ato që thamë këtu në drejtim të planit.

Edhe problemin e kolektivizimit gjithashtu Partia duhet ta marrë seriozisht. Në rast se kemi arritur 60 për qind në kolektivizimin e ekonomive fshatare, me blegtorinë jemi shumë prapa. Mirëpo bujqësi pa blegtori nuk mund të ketë. Për këtë problem e vlen që ne të bëjmë edhe një plenum të veçantë, jo vetëm për kolektivizimin e blegtorisë, por edhe për problemin e mishit, të qumshtit dhe të gjalpit.

Një problem tjetër që dëshiroj të thëksoj është pjesëmarrja e fshatarësisë në bonifikimet e mëdha. Partia në bazë të mos mendojë se kjo është një punë e lehtë. Me fshatarësinë duhet të organizohet një propagandë e mirë, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fshatarësisë në këto punë kaq të mëdha dhe që ajo të kuptojë se ky kontribut që duhet të japë nuk është diçka sa për të shkuar radhën, po është për të mirën dhe në interesin e saj, prandaj edhe ajo duhet të ndihmojë në këto bonifikime. Pra, fshatari duhet ta ndiejë këtë punë që do të bëjë, jo se nuk ia prish dot Partisë, po se është për të mirën e tij. Tani ka ardhur koha që fshatarësia të kuptojë drejt se ka detyrime shumë të mëdha

për ndërtimin e socializmit. Ndihmë shteti do t'i japë fshatarësisë edhe në të ardhshmen, po jo të jemi edhe kaq shumë hovardarë që çdo gjë ajo ta kërkojë nga shteti. Këtë çështje ta sqarojmë mirë dhe fshatarësia të kuptojë se këtë gjë nuk e bën vetëm se ia ngarkon Partia, por se ajo ka fitime nga kjo punë dhe prandaj si puna e saj, ashtu edhe ndihma që do t'i japë shteti të shkojnë paralel. Partinë duhet ta preokupojë shumë çështja e pjesëmarrjes së fshatarësisë në punët e bonifikimit. Këtu disa folën se në këtë drejtim do të gjejmë pengesa në stinën e verës, kur fshatari ka shumë punë. Kjo sigurisht do të ndodhë dhe në rast se Partia nuk i planifikon mirë këto punë, atëhere nuk do t'ia dalë mbanë. Prandaj këto vështirësi duhen parashikuar dhe Partia t'i propagandojë mirë këto gjëra te fshatari, siç thashë, që ai t'i konsiderojë si detyra të tija të dorës së parë.

Për të evituar gabimet në drejtim të kolektivizimit shokët folën, por duhet të kihen parasysh këto gjëra për më vonë që të mos ketë gabime të tilla si jo «ti hyrë e ti mos hyrë», jo «ti ke qenë ballist, prandaj mos hyrë, se nuk kemi nevojë për ty» dhe «ikë nga kjo tokë të të jap tokë atje» etj. Një qëndrim i tillë do të ishte gabim i madh. Prandaj në drejtim të kolektivizimit duhet të mbahet parasysh orientimi i Partisë për të hyrë vullnetarisht në kooperativë. Për këtë qëllim duhet punuar me kujdes nga Partia që familjet, të cilat nuk kanë hyrë, të hyjnë tani dhe të mos luftohet për të ngritur kooperativa bujqësore në majë të malit vetëm sa për të shtuar numrin. Dëshirën edhe malësorëve nuk mundet të mos ua plotësojmë, po Partia të ketë parasysh mirë që kooperativave bujqësore malore t'u japë orientimin e duhur për

zhvillimin e kulturave të përshtatshme në to dhe të organizohet puna që shumë fshatarë të mos punojnë vetëm në kooperativë, po forcat e punës që teprojnë të kalojnë për të punuar në sektorin shtetëror. D.m.th. kjo çështje të mos lihet sipas qejfit të kooperativave. Ndryshe anëtarët e këtyre kooperativave me të ardhura të vogla nuk do të jenë të kënaqur, ose do të shpërndahen vetë për punë në mënyrë të pakontrolluar, sepse të ardhurat që do të kenë nuk do t'u dalin. Prandaj le të ngrihen kooperativa bujqësore edhe në malësi, po t'u jepet atyre orientimi i drejtë për organizimin e mirë të punës dhe të fuqisë punëtore, një pjesë e së cilës, kur të teprojë, të kalojë për të punuar në ndërmarrjet shtetërore.

Siç u tha edhe në raport *çështja e pyjeve* është një problem shumë i madh për vendin tonë. Përveç dëmeve që na kanë shkaktuar okupatorët edhe shfrytëzimi i vazhdueshëm i disa zonave e rëndon shumë gjendjen e pyjeve për ekonominë tonë. Partia megjithkëtë po hesht për çështjen e pyllëzimeve, nuk thotë asgjë se ç'po bëhet në këtë sektor. Këtu unë nuk po flas për pemët frutore, por për pyjet, për të cilat nuk ka një interesim po aq të madh sa edhe për sektorët e tjerë të bujqësisë. Ky është një gabim i madh që në të ardhshmen do të na kushtojë shumë. Ne pa lëndë druri nuk mund të ecim përpara. Çështja e lëndës së drurit është njësoj si buka. Tani ne po investojmë me miliona në majë të maleve për të çarë rrugë të reja, për të arritur zonat e pashfrytëzuara pyjore. Prandaj Partia duhet ta marrë në dorë mirë çështjen e pyllëzimeve dhe të bëhet një fushatë jashtëzakonisht e madhe, bile unë propozoj që të hartojmë një plan të madh pyllëzimesh në malet

tona me afat të gjatë për 40-50 vjet, me qëllim që brezat e ardhshëm të kenë pyje. Duhet një plan i gjatë, sepse, siç dihet, drurët nuk rriten për 2 ose për 5 vjet, prandaj duhet filluar me kohë për mbjelljen e tyre, sepse që tani po bëhen plane të sjellim nga jashtë dru lisi për të bërë voza, sikur nuk mjafton maqinaria dhe buka që po sjellim! Por, po të mos i marrim këto masa, situata jonë për lëndë druri do të bëhet shumë e rëndë, prandaj duhet ta studjojmë që tani këtë problem dhe të bëjmë një plan. Po kjo nuk do të thotë që të flemë derisa të përgatitet ai, sepse për pyllëzimet një plan ne e kemi, prandaj Partia duhet të shkundet dhe të mobilizohet për ta realizuar planin ekzistues të pyllëzimeve derisa të përgatitet një plan tjetër më i gjerë për këtë çështje. Përveç kësaj në çdo drejtim kujdesi për kursimin e lëndës së drurit duhet të jetë në rendin e ditës për Partinë.

*Për sektorin e ndërtimeve* doja të theksoja çështjen e projekteve. Në këtë drejtim ne vuajmë shumë se nuk kemi një plan. Kjo bën që kur mbaron një objekt na kushton 2-3 fish nga parashikimi. Kështu, në qoftë se një objekt parashikohet të kushtojë 100 milion, pasi mbaron dhe bëhen llogaritë del se ka kushtuar 300 milion, ose një fabrikë që na thuhet se kushton 60 milion del 200 e kështu me radhë. Atëhere ku mund të dalim ne me këto projekte? Ne kemi caktuar një fond për investime, p.sh. kaq miliard kemi për bonifikime, fjala vjen 1,6 miliard. Po këto janë projektide dhe në qoftë se vazhdohet kështu dhe parashikimet na dyfishohen është e kuptueshme se këto objekte ne nuk i realizojmë dot. Tani nuk mund të dalë Ministria e Ndërtimeve dhe të



thotë se ky objekt u realizua me atë fond që u parashikua në fillim. Diferenca midis projektit dhe realizimit nuk është e mundur të mos ketë, po ne duhet të marrim masa që këto diferenca të mos jenë kaq të mëdha. Për këtë duhet të ketë një kujdes më të madh dhe një kontroll më të fortë nga ana e ministrisë, si edhe nga enti punëdhënës. Kështu, ne duhet ta ngushtojmë këtë diferencë të madhe që ekziston sot. Tani nuk jemi më si në kohët e para kur na mungonin inxhinierët, projektuesit, teknikët, kemi përparime në këtë drejtim. por mund të themi se këto nuk ecin paralel me humbjet që kemi nga projektet.

.Tani ne bëmë një riorganizim dhe e shkrimë Ndërmarrjen «Projekti» me qëllim që të kemi rezultate më të mira. Prandaj Ministria e Ndërtimit ka përgjegjësi të madhe që kolektivin e Ndërmarrjes «Projekti» ta përdorë më mirë dhe të mundë që nga të gjithë kuadrot e saj të ndërtimit dhe të projektit t'u japë kuadro edhe ndërmarrjeve të tjera shtetërore, sidomos ndërmarrjeve të mëdha të fillojë t'u japë teknikë të kualifikuar për të hedhur bazat e një seksioni projektimi. Kështu të lehtësojmë një çikë barrën e rëndë që ka në këtë drejtim Ministria e Ndërtimit. Mirëpo punëdhënësit e bëjnë shumë keq këtë punë. D.m.th. interesimi i dikastereve, enteve ose komiteteve ekzekutive që kërkojnë t'u mbarohen objekte ndërtimi mund të themi se është zero. Kjo duhet ndryshuar. Dikasteret tona, të cilave shteti u ka caktuar kaq shumë të holla për këto objekte, t'u qëndrojnë në kokë Ministrisë së Ndërtimit dhe ndërmarrjeve zbatuese. Po një gjë e tillë nuk bëhet dhe kjo është shumë e dëmshme. Është lehtë të mos interesohen

ata, po është shumë e rëndë të mos u përgjigjesh kërkesave të popullit.

Shumë shokë bënë këtu propozime dhe kërkesa për të mirën e popullit. Këto nuk janë të këqia, por të tëra nuk kemi mundësi t'i bëjmë dhe t'i futim në plan. Po pse? Për të gjitha ato që thamë. Por, po ta shtojmë kontrollin, t'i bëjmë njerëzit të ndërgjegjshëm për këto çështje, ne do të kemi mundësi shumë të mëdha, që jo vetëm t'i japim 5 milion Gjirokastrës për rezervuarin e Viroit, po edhe më shumë për të bërë hidrocentralin. Po çështja është se po t'i jepen 5 milion, sa ka kërkuar, do të duhen 20 milion. Kështu këto ndërtime bëhen një varr i madh lekësh. Prandaj në këtë drejtim, duhet të bëjnë kujdes të madh si ministria, organet e projektit ashtu edhe punëdhënësit.

Dua të ritheksoj atë që thanë të gjithë që Ministria e Ndërtimit duhet ta organizojë mirë punën, cilësinë e ndërtimeve ta bëjë të mirë, objektet t'i dorëzojë në kohë dhe të bëjë përpjekje për uljen e kostos, se ndërtimet neve na kushtojnë shumë, ndërsa tani ky sektor merr një maqineri të madhe, prandaj them se ulja e kostos në ndërtime është shumë e vogël në krahasim me mundësitë. Në këtë drejtim duhet të bëhen më shumë përpjekje e veç asaj ndërtimi i objekteve të bëhet edhe shpejt e me cilësi. Ministria e Ndërtimit duhet të bëjë luftë të madhe për cilësinë dhe uljen e kostos. Përveç kësaj, shokëve të ndërtimit u rekomandojmë ta mbajnë mirë maqinerinë, se në duart e tyre po përqëndrohet maqineri kolosale, shumë kamiona dhe më shumë buldozerë etj. do të vijjnë.

Por, si të tjerat, dhe kjo ministri nuk ka menduar

si duhet për kuadrot, se të gjitha këto maqineri duan njerëz të aftë, këto gjëra nuk bëhen kështu fët e fët dhe duhet ditur se planet e ardhshme pesëvjeçare do të kenë investime akoma më të mëdha. Në të ardhshmen nuk mund t'i themi Komitetit Qendror që këto nevoja tani po na dalin, prandaj s'kemi si t'i përgatitim kuadrot. Pra, masat duhet të merren që tani, sidomos në ata sektorë ku ka investime kolosale dhe më duket se aty ka shumë pak kuadro, kështu që Ministria e Ndërtimit tani për të përballuar nevojat merr kuadro nga janë e nga s'janë nga të gjithë sektorët. Është fakt se tani disa specialistë po largohen nga ndërmarrjet shtetërore për t'u marrë me punë private. Mirëpo këta janë nga ata që kanë mësuar në kurset tona. Prandaj duhet të bëhet një plan i shëndoshë nga Ministria e Ndërtimit për përgatitjen e specialistëve, duke filluar që nga përgatitja e muratorëve, karpentierëve, njerëzve për shfrytëzimin e maqinerive etj.

Përveç kësaj Ministria e Ndërtimit duhet të ketë më shumë inisiativë, përse u përket shfrytëzimit të materialeve më të lira në vend. Ja p.sh. për pupulitin ka dy-tre vjet që po flitet dhe vetëm tani ai me vështirësi ka hyrë një çikë në ndërtimet. Ne duhet të trefishojmë kapacitetin e prodhimit të pupulitit dhe për këtë duhet të bëjmë disa maqineri që edhe në vend mund të përgatiten. Prandaj inisiativat e mira t'i marrim se ka nevojë urgjente për ndërtim shtëpish.

Në ndërtime ne duhet të shfrytëzojmë edhe eksperiencën e artizanatit. Këtë ne duhet ta zgjerojmë. Të gjithë profesionistët që enden nëpër fshatra për ndërtime t'i organizojmë në kooperativa artizanati dhe këto

forca pastaj të dimë mirë ku t'i caktojmë dhe të mos i lëmë të përdoren sipas qejfit të fshatarëve dhe të kooperativistëve. Në radhë të parë në fshat të ndërtojmë objekte të tilla që shtojnë prodhimin dhe në rast se një fshatar ka shtëpi, po do të bëjë një më të madhe ta lëmë të presë edhe dy ose tre vjet. Përveç kësaj këto lloj kooperativash do të ndihmojnë edhe në qytete, sidomos për riparimin e shtëpive. Me ngritjen e ndërmarrjeve zonale, Ministria e Ndërtimit të ketë kujdes se do të na ndodhë, në rast ngushtice, kur është çështja për t'u dërguar lëndë objekteve të komitetit ekzekutiv, që ajo do t'u presë këtyre furnizimin, po t'i duhet ndërmarrjes nacionale. Kështu mund të ndodhë edhe me kooperativat e artizanatit të ndërtimit. Prandaj Partia të ketë kujdes që këto të kryejnë në kohën e caktuar ndërtimet në zona dhe të mos i përdorë ministria për të plotësuar boshllëqet e ndërmarrjeve nacionale për mungesë të organizimit të punës. Unë mendoj t'u ngarkojmë Byrosë Politike dhe qeverisë të marrin masa për meremetimin e shtëpive private. Ç'do të bëjmë ne me këto shtëpi? Qiraja është e ulët. Në rast se ngremë qiranë kjo nuk do të ishte mirë nga ana politike. Këtu nuk është puna se e ngrite qiranë 50 lekë dhe pronari do ta meremetojë shtëpinë. Meremetimi kushton qimet e kokës. Çështja shtrohet kështu: Do t'i lëmë këto shtëpi të shkatërrohen, të rrëzohen dhe punonjësit të mbeten jashtë, apo në vend që të mos lëmë jashtë këta të ngremë shtëpi që nga themelet? Mua më duket se do të jetë më mirë t'u japim kredi privatëve për të meremetuar dhe ndrequr shtëpitë e tyre të vjetra, që t'u zgjatet jeta dhe këto kredi t'ia kthejnë shtetit me afat të gjatë për

20-30 vjet. Ndryshe ne do t'i humbasim shtëpitë e tyre. Këtë problem unë mendoj ta zgjidhim se është bërë urgjent.

Shumë drejt e ngriti problemin një shok dhe ky ka qenë edhe preokupacioni ynë, që ndërtimi i fabrikave ose i objekteve me rëndësi të mos zgjatë shumë, prandaj të bëhet çmos që të shkurtohen afatet. Mund të ketë edhe disa gjëra që na kanë shpëtuar, këto raste duhen parë, po ka edhe disa objekte që zgjatin, sepse çështja e tyre është e lidhur me projektet, me maqineritë. Për këtë arsye janë lënë të përfundojnë pas 2 ose edhe pas 3 vjetësh. Po çështjen që të shkurtohen afatet e ndërtimeve ne e kemi pasur parasysh.

Shumë gjëra janë të nevojshme të bëhen, jo vetëm për tani, po edhe për të ardhshmen. Duhet ta fillojmë që tani ndërtimin e dy hidrocentraleve në një kohë, ndryshe nuk do të kemi energji. Po të bëjmë njërin më vonë nuk ka mundësi se nuk ka front pune për ta përfunduar më shpejt të parin. Prandaj, ne duhet t'i bëjmë në një kohë të dy. Gjëra të tilla ka shumë dhe është e vërtetë se zgjatja e kohës së ndërtimit të një objekti do të thotë shumë harxhime, ngrihet kostoja, nuk merret prodhimi në kohë dhe kështu nënvleftësohet monedha. Nga kjo, pra, ka shumë rreziqe që duhet t'i kemi parasysh në ndërtimet që bëjmë. P.sh. hoteli turistik në Durrës duhet të ishte bërë që vjet, ku të vinin edhe turistë, po ka rrezik që edhe sivjet të mos shfrytëzohet dhe e shohim se ç'humbje të mëdha kemi.

Problemin e tullave e kemi diskutuar shumë herë në Byronë Politike. Artizanati ato nuk duhet t'i lëshojë se në fshatra kemi nevoja të mëdha dhe tullat janë

artikull me rëndësi tregëtie për t'i tërhequr fshatarit të holla, po duhet që me këta artikuj të mos veprohet si deri tani. Materialet t'u shkojnë fshatarëve sa më afër, d.m.th. kumitë të ngrihen afër konsumatorëve. Kjo nuk përjashton që kooperativat bujqësore t'i bëjnë vetë tullat, prandaj as këtë të mos e neglizhojmë.

Kisha edhe një *vërejtje për tregëtinë* në drejtim të furnizimit sa më të mirë të fshatit. Kuadrot e tregëtisë kujtojnë sikur i dinë mirë nevojat e popullit. Punonjësit e tregëtisë së brendshme të ulen një çikë nga fiku, kjo nuk do të thotë që ata të mos kenë parasysh cilësinë e mallit që marrin nga organet e industrisë, por edhe disa veprime të tregëtisë nuk janë të lejueshme. Ç'janë ato mobilje që duan ata për treg vetëm prej arre? Të shkosh tani në «Misto Mame» do të gjesh të punohen vetëm mobilje prej arre, që porositen për shtëpitë ku presim miqtë e huaj që na vijnë ose për disa zyra e institucione shtetërore, kështu atje nuk bëhen fare mobilje për popullin. Po na thonë se mobiljet prej druri tjetër nuk i merr populli. Po të punohen më mirë e më bukur të shohësh se si do t'i blejnë. Mua më duket çudi që fshatari të mos marrë një sepete të lustruar. Kjo nuk është kështu. Kjo ndodh ndofta sepse ato ose mund të jenë të shtrenjta, ose nuk janë të një cilësie të mirë. Po në rast se fshatari i do bojra-bojra, si qëmoti, ashtu le t'i bëjnë si i do ai. Po mua më duket se çështja nuk qëndron këtu, po te ajo që shokët e tregëtisë nuk i njohin shijet e popullit. Në këtë drejtim duhet të bëhet shumë kujdes nga ana e tyre.

Ato që tha Vasili [Kati] në lidhje me tregëtinë e jashtme, janë shumë serioze dhe ai i shtroi drejt. Mirëpo

këto gjëra duhet t'i dijë e gjithë Partia se ne çojmë shumë gjëra jashtë. Në rast se p.sh. marmalata jonë shkon në Moskë dhe blerësi në të gjen bërthama, atë marmalatë nuk ta merr më njeri. Tjetri të jep paranë, atëhere t'i jepi mallin e mirë, ndryshe i thuaj më mirë që s'mund të të jap dhe mbaroi puna. Prandaj këtu duhet shumë kujdes.

Çështjen e stimulacioneve duhet ta studjojmë, prandaj këtu të mos nxitohemi. Për këtë ne do të konsultohemi edhe me bazën. Në momentet kur e vendosëm këtë çështje ishim shumë dakord, po edhe tani duhet ta shohim sepse duhet të kursejmë bukën. Por ajo nuk mund të kursehet në rast se popullit tonë nuk do t'i japim të hajë më shumë patate, sepse tani ai ha shumë pak, mesatarisht 60 gram në ditë. Po kështu edhe perime. Në rast se populli nuk ha patate, perime, mish, atëhere ç'janë dy kuintalë bukë në vit që i kemi lënë çdo fryme në fshat? Këto lloj ushqimesh fshatari ynë nuk i ka, prandaj duhet t'i zëvendësojë të paktën me bukë. Kështu edhe çështjen e perimeve duhet ta shohim mirë, sidomos pataten. Në Shishtavec të Kukësit dhe në disa zona të tjera malore patatet bëhen shumë, mirëpo duhet të bëhen përpjekje që ato të shpërndahen edhe në krahina të tjera dhe jo vetëm në kryeqytet, pra, të bëhet e mundur që ato të shkojnë edhe në fshat që të marrin për të ngrënë edhe fshatarët në zona ku nuk bëhen patatet. Në këtë mënyrë kemi për të ekonomizuar bukën.

Edhe çështjen e derrit duhet ta shikojmë. Byroja Politike konstaton se derri na kushton shtrenjtë. Pra të rritim derrin me çmime kaq të mëdha dhe nga ana

tjetër populli të mos e hajë kjo do të ishte një punë e kotë dhe me dëme. Përveç kësaj mishin e derrit as jemi në gjendje ta eksportojmë dot. Ekonomitë private dhe kooperativat bujqësore, përkundrazi, duke rritur derra, kanë leverdi, prandaj nuk e heqim dot fare derrin, siç mund të na thotë ndonjë, sepse do të kemi humbje. Prandaj edhe këtë çështje duhet ta shohim, si në drejtim të përpunimit të mishit të derrit, të shkëmbimit me vende që e hanë më shumë etj.

Sikurse e patë bilanci i tregëtisë sonë të jashtme nuk është në rregull, aty ne kemi deficite të mëdha, prandaj Partia duhet të bëjë shumë përpjekje për shtimin e eksporteve tona dhe për pakësimin e importit. Këtë e themi vazhdimisht, po kur vjen puna në fund asnjë nuk tërhiqet. Ne importojmë gjëra që nuk i shfrytëzojmë dhe i lëmë kështu të na prishen. Në këtë drejtim Partia duhet të bëjë një punë shumë të madhe dhe ministritë të kontrollojnë rreptë kërkesat e ndërmarrjeve, sepse nga kërkesat e pavend harxhohet shumë devizë dhe pengohet sjellja e mallrave të konsumit të gjerë për popullin, siç janë djathi, vaji, gjalpi etj. ashtu sikurse importojnë edhe vendet e tjera. Ne, çdo devizë të lirë që mund të sigurojmë, na është bërë zakon që të marrim me të vetëm maqineri. Kështu nuk të mbetet asnjë majë gjilpëre për të blerë ndonjë artikull shumë të nevojshëm për popullin. Prandaj duhet të zvogëlohet diçka importimi i maqinerive në favor të mallrave të konsumit për popullin. Nga ato që janë caktuar të vijnë për vitin 1958 qeveria duhet të hedhë dorën dhe një sasi prej tyre t'i bëjë rezerva shtetërore, t'i ruajë për vitet e ardhshme për të mundur që të bëhen me to



shkurtime në vitet e tjera. Po ku do të venë këto? Ne nuk kemi paraparë pajisje me maqineri moderne për të gjithë industrinë, por do të biem më pak pleh kimik, më pak maqineri e sende të tjera, që të sjellim pajisjet e nevojshme, p.sh. për zdrukthtarinë etj. Me këto kursime ne duhet të investojmë në disa gjëra që na japin më shpejt prodhim dhe plani të mos priset. Ne p.sh. mund të bëjmë edhe pa na ardhur 40 vettura të reja se edhe tani kemi plot vettura, bile aq sa shumë prej tyre shpërdorohen dhe nuk shfrytëzohen në drejtimin që janë caktuar. Por, po të ketë më tepër kontroll për këto çështje, plani do të realizohet dhe ekonomi do të bëjmë më tepër.

## II. Mbi edukimin marksist-leninist të kuadrove

Ju e dini që ne bëmë thjeshtime në aparatet e Partisë dhe të shtetit. Kjo është një gjë pozitive se do ta forcojë akoma më shumë punën tonë. Përsa i përket pushtetit qarqet do të shkrihen<sup>1</sup>. Kjo do të ndihmojë që njerëzit, të cilët do të venë poshtë, të kenë më shumë inisiativë në punë, më shumë besim dhe t'i zbatojnë mirë detyrat. Ata duhet të kenë mirë parasysh se do të kenë lidhje direkt me qendrën, por qendrës i shtohen shumë lidhjet, prandaj çështjet që janë në kompetencën e tyre shokët e bazës duhet t'i zgjidhin vetë, pavarë-

---

<sup>1</sup> Me dekret Nr. 2593, të Presidiumit të Kuvendit Popullor datë 6 shkurt 1958, ndarja administrative e RPSH u bë në bazë rrethi, lokaliteti dhe fshati.

sisht se në ndonjë rast mund të bëjnë edhe gabime. Ndryshë, mungesa e inisiativës nga ana e tyre, do ta vështirësojë shumë punën e qendrës. Por vështirësi mendoj se nuk duhet të ketë sepse rezultatet deri tani janë të kënaqshme. Kjo masë d.m.th. shkrirja e qarqeve u muar që të sjellë akoma më tepër të mira në dobi të punës dhe jo ta vështirësojë gjendjen.

Edhe në aparatet e Partisë u bënë thjeshtime. Kjo masë do ta shkundë Partinë nga burokracia. Tani vetë sekretarët dhe instruktorët e Partisë do të punojnë me zona. Kjo kërkon që instruktorëve t'u jepet përgjegjësi e plotë, po edhe duhet të ndihmohen. Edhe Komiteti Qendror nga ana e tij këta shokë do t'i ketë kurdoherë në kujdes për t'i ndihmuar, sepse tani instruktorët dhe sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të përgjigjen për të gjithë jetën dhe aktivitetin e Partisë që përfshin numri i organizatave bazë të zonës së tyre. Prandaj duhet të tregohet kujdes për këta njerëz nga ana e udhëheqjes së çdo komiteti partie, sidomos tani në fillim. Kjo nuk do të thotë t'u pritet njerëzve inisiativa. Ata duhet të kujdesen për të gjitha çështjet sepse ka mundësi që të interesohen vetëm për bujqësinë, ndërsa arësimin, shëndetësinë etj. t'i lënë pasdore. Kjo do të na dëmtonte shumë. Këtu u ngritën me të drejtë të gjitha problemet që na interesojnë e që duan zgjidhje. Është e vërtetë se edhe pa bukë ose pa mish nuk jetohej, por edhe i sëmurë dhe pa arësim nuk bëhet. Prandaj të gjitha problemet janë të rëndësishme dhe po të mos kujdeset Partia për të gjitha, puna do të çalojë.

Tani ku do të venë të gjithë këta njerëz që do të

mbeten jashtë organikave? Në prodhim, në bazë dhe këtu Partia duhet të bëjë një punë të madhe që njerëzve t'u kthejë fytyrën drejt prodhimit dhe fshatit se nuk është aq e shëndoshë kjo çështje. Një ditë në shëtitje, takova disa studentë dhe në bisedë më thanë: «Tani që do të mbarojmë shkollën të shohim ku do të na caktojnë». D.m.th. ata kishin frikë se mos shkojnë nga Lushnja ose Zagoria, presin të zënë ndonjë vrimë në zyrë dhe të rrinë në Tiranë. Dhe të mos harrojmë se këta janë kuadrot tanë të rinj që duhet të venë në punë. Por, punë do të ketë nga të katër anët e Shqipërisë, prandaj duhet të shkojnë deri në lokalitete e në fshatra dhe jo vetëm afër vendit të tyre, po edhe më larg. Në këtë drejtim ne do të kemi luftë, po një luftë shumë të ashpër ideologjike kundër mbeturinave të mëdha mikroborgjeze që ekzistojnë te njerëzit tanë bile dhe te anëtarët e Partisë, sidomos te intelektualët dhe nëpunësit, te të cilët, të rinj ose të vjetër, mbeturinat e së kaluarës rëndojnë në shumë prej tyre. Çështja e individualizmit te intelektualët, e pikëpamjes që «unë bëj pjesë në radhët e njerëzve të mësuar, në njerëzit e elitës» i bën ata që të harrojnë shumë herë detyrat e Partisë. Partia duhet të bëjë përpjekje të mëdha në këtë drejtim. Çështja e ndarjes së punës mendore nga puna fizike nuk mund të themi se te ne është zhdukur. Kjo është një çështje e vjetër, duke filluar që nga antikiteti, ku njerëzit ndaheshin në klasa të privileguara dhe në skllëvër. Kështu reflektohet kjo edhe në veprat e Platonit që në krye të «shtetit» të tij vë njerëzit e mendjes. Kështu ndodh edhe në mesjetë kur nga një anë ke zotërinjtë feudalë bashkë me klerikët që ishin njerëzit

e pendës dhe të mendjes, filozofët, dhe nga ana tjetër popullin, fshatarësinë bujkrore. Kur erdhi kapitalizmi krijoi kuadrot e vet, nëpunësit e vet duke filluar që nga oficerët, gjykatësit, inxhinierët e deri te profesorët, mësuesit, artistët etj. që të punonin për borgjezinë, bile borgjezia i la inteligjencies edhe pushtetin në dorë. Shumë prej tyre, siç janë inxhinierët p.sh. në ndërmarrjet kapitaliste, kanë poste me rëndësi. Inxhinieri aty ka jo vetëm çështjen e drejtimit të prodhimit, por edhe atë të kuadrit. Prandaj në kapitalizëm inxhinierët kanë një pozitë të privilegjuar, ata janë larg masave të proletariatit. E ç'mund të themi pastaj për oficerët, gjykatësit e prokurorët që mbrojnë klerin dhe borgjezinë, po kështu për mësuesit dhe profesorët që mbrojnë dhe përhapin ideologjinë borgjeze? Por në vendet kapitaliste tani, natyrisht, ka filluar procesi i zhvillimit të ndjenjës kombëtare e përparimtare edhe në radhët e inteligjencies. Edhe këta tani po kuptojnë se borgjezia po shkon drejt degjenerimit, rritet në ta ndërgjegjia nacionale e masave kur shohin se atdheu është nën imperializmin amerikan. Intelektualët në vendet kapitaliste kanë filluar të mendojnë se borgjezia nuk është tani e denjë për të drejtuar dhe fillojnë të shkëputen gradualisht prej saj. Po kjo punë bëhet me zor.

Një proces i tillë para çlirimit, në një shkallë të vogël, kishte filluar edhe te ne, po Lufta nacional-çlirimtare u vuri thikën shumë gjërave. Në vendet kapitaliste pushteti nuk është në duart e masave, mjetet e prodhimit janë në duart e kapitalistëve, kështu edhe policia, ushtria përdoren si mjete për të shtypur shumicën. Mirëpo Lufta jonë nacional-çlirimtare e ndryshoi

këtë situatë, te ne shteti dhe mjetet e prodhimit u bënë të popullit, u vendos demokracia popullore si formë e diktaturës së proletariatit. Po edhe te ne ka funksionarë, oficerë, gjykatës, mësues, profesorë, inxhinierë etj., por ndryshe është kuptimi i këtyre kategorive te ne dhe ndryshe në vendet kapitaliste. Njerëzit tanë janë të ndërgjegjshëm se i shërbejnë popullit. Siç thashë, mjetet e prodhimit, ushtria, policia dhe sigurimi janë në duart e popullit për të mbrojtur pushtetin e tij. Kështu edhe mësuesit, profesorët, njerëzit tanë të artit e të kulturës zhvillojnë dhe përhapin ideologjinë marksiste-leniniste. Pra, inteligjencia jonë popullore ka ndryshime rrënjësore nga ajo borgjeze.

Megjithkëtë mbeturinat ekzistojnë akoma në kokën dhe në zemrën e njerëzve. Ne kemi akoma shfaqje të huaja te njerëzit, ka nga ata që thonë se «unë nuk shkoj në prodhim», «nuk shkoj në lokalitet», «nuk vete në Patos, vetëm në Qytetin «Stalin» mund të qëndroj», megjithëse njerëz të tillë kanë mbaruar në shkollat tona.

Përveç këtyre kemi edhe shfaqje që janë të rrezikshme në rast se Partia nuk merr masa që tani. Te intelektualët sidomos, është çështja e ndarjes së punës, e ndarjes së teorisë nga praktika; në dukje nuk shihet, po në pikëpamjet dhe ndërgjegjen e njerëzve ekziston te intelektualët, sidomos te ata që janë bërë miq të zyrave dhe që rrojnë me simbolin e gjërave. Intelektuali që rron vetëm me mësimin, panxharin p.sh. ia mëson nxënësit vetëm në mënyrë simbolike. Prandaj në këto kushte e pikëpamje që ekzistojnë në mentalitetin e intelektualëve të tillë, lindin iluzione idealiste,

sidomos thashë te intelektualët dhe nëpunësit burokratë që mbeten nëpër zyra, që shkëputen nga realiteti, nga kontakti me masat. Ne kemi pasur mjaft shfaqje të huaja te intelektualët. Shumë prej tyre, po të mos i edukojë Partia ideologjikisht dhe në praktikë, do të ndodhë që ta ndjejnë veten në mes të klasave. Le të marrim mësuesin në vendet kapitaliste, ai është edhe afër proletariatit edhe afër borgjezisë. Kështu që ai e ndjen veten në mes të klasave, jo të lidhur me një klasë. Ai mendon se çdo gjë përcaktohet nga gjykimi i tij dhe jo nga lufta dhe përpjekjet e klasave, ai mendon se idetë dhe pikëpamjet e tija e vënë klasën në lëvizje. «Unë jam njeri i mësuar, mendon një intelektual i tillë, unë jam mbi klasën, kam në dorën time teknikën, di filozofinë, prandaj duhet të jem i pavarur nga forcat ekonomike dhe nga klasat». Kjo mund të ndodhë edhe te ndonjë intelektual yni, prandaj nuk duhet ta lëmë pasdore edukimin e vazhdueshëm të tyre. Te intelektualët, te kuadrot tanë, si te të vjetrit ashtu edhe te të rinjtë, ka mbeturina të tilla siç është tendenca e rehatisë që nxitet edhe nga armiku e propaganda e tij. Prandaj, duhet të bëhet një luftë e madhe kundër këtyre mbeturinave në kuadrot tanë sidomos tani me rastin e shkurtimeve, sepse shumë prej tyre do t'u vijë radha të venë në bazë të punojnë bashkë me popullin. Sigurisht, atje mund të kenë më pak komoditet, po puna dhe lufta e popullit do të përmirësojë edhe jetën e popullit dhe jetën e tyre.

Ne duhet të kemi shumë kujdes në edukimin e njerëzve tanë të rinj, sidomos të nëpunësve dhe intelektualëve. E them këtë se edhe disa nëpunës që pu-

nojnë nëpër zyra kanë filluar të marrin ngjyrën e intelektualëve jo të shëndoshë. Lidhur me këtë kam edhe çështjen e individualizmit. Për shkak të individualizmit intelektualët vihen shpeshherë në opozicion me proletariatin. Proletariati ka si armë të vet kazmën, lopatën, çekiçin dhe me to ai punon, kurse intelektualët nuk kanë as armë të punës, prandaj në këtë drejtim ata fare lehtë mund të afrohen me proletariatin. Mirëpo, mënyra e jetesës i bën këta të afrohen më shumë me borgjezinë, të largohen nga proletariati. Këtë ta kemi parasysh se pa një kujdes të veçantë, ata mund të shkëputen nga jeta dhe masat e popullit. Te këta, duke pasur si forcë pune intelektin e tyre, argumentat dhe jo çekiçin si punëtorët, krijohet ideja që për t'iu imponuar masës duhen përdorur vetëm argumenta, pikëpamje, teori. Kjo e shtyn intelektualin të bëhet individualist, të largohet nga masa. Prandaj duhet të bëhet çdo përpjekje që këto pikëpamje të intelektualët dhe nëpunësit t'i luftojmë që tani sa janë të freskëta se pastaj do të na bëhen shumë të rrezikshme. Lenini thotë se proletariati ka vuajtur shumë nga këto pikëpamje, nga mungesa e disiplinës së intelektualëve dhe e nëpunësve burokratë. Intelektuali si kushdo duhet ta ndjejë se vetë s'mund të jetë asgjë, po në kolektiv ai mund të bëhet një forcë shumë e madhe. Po këtë nuk e koncepton dot intelektuali, ai mendon se qëndron mbi klasat dhe pikërisht këtu fillon oportunizmi i tij dhe fillimi i oportunizmit është fillimi i mospranimit të komunizmit. Prandaj këto rreziqe ekzistojnë te intelektualët, duke menduar se ata janë elitë. Ata janë kundër violencës, kundër luftës së klasave, ata duan t'i zgjidhin çështjet

në mënyrë oportuniste, prandaj janë kundër diktaturës së proletariatit. Këto duhet t'i kemi parasysh tani që duam të edukojmë një brez të tërë të rinjsh.

Te njerëzit tanë ka shumë mbeturina. Bile ka edhe gjëra mjaft të rrezikshme, skandaloze. Ka njerëz që, megjithëse kanë luftuar, jo vetëm që kanë arritur të mbajnë qëndrim moral antiproletar, po disa arrijnë deri atje sa të grabitin edhe shtetin. Kjo shtron para Partisë detyra të mëdha për të edukuar shokët në rrugën marksiste-leniniste, d.m.th. të luftohet për ngritjen e ndërgjegjes së njerëzve. Në këtë drejtim kemi bërë një hap të madh përpara. Këtë e tregon edhe puna e madhe që bën Partia për të ndërtuar me sukses socializmin. Po bashkë me zhvillimin e madh të ndërtimit të socializmit, me ngritjen e bujqësisë dhe të industrisë, ne duhet të themi se ngritja teknike e kuadrove tanë dhe e ndërgjegjes së tyre socialiste nuk ecën paralelisht. Prandaj, duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që kjo punë të ecë më mirë.

Arësimi në Parti është zgjeruar shumë. Për këtë ne nuk mund të themi se nuk kemi suksese, po shumë dobët ndiqen format e arësimit nga njerëzit e Partisë. Ka rrethe, pa përjashtim, që kësaj çështjeje nuk i vënë rëndësinë e duhur dhe në shumë forma të edukimit të Partisë mungojnë pjesëmarrës. Pse? Kësaj gjëje i duhet gjetur ilaçi. Filozofia marksiste nuk është një gjë e lehtë, po edhe si e bëjnë shumë shokë sikur kjo është aq e zorshme sa kanë marrë frikë njerëzit, është gabim. Nuk është kështu. Për shokët tanë të Partisë dhe për njerëzit pa parti nuk është e huaj esenca e filozofisë marksiste-leniniste. Është fakt se qindra e mijëra njerëz



në Shqipëri po e zbatojnë si duhet vijën marksiste-leniniste të Partisë. Si e bëjnë ata këtë punë? Si e kuptojnë këtë vijë? Përse ata nuk devijojnë nga vija e Partisë? Kjo ndodh sepse ata i njohin parimet themelore të marksizëm-leninizmit. Pra, çështja është që parimet e filozofisë sonë të përvetësohen nga masat, për këtë duhet që pedagogët dhe propagandistët t'ua bëjnë dëgjuesve ato pak më të thjeshta se sa ua kanë bërë deri tani. Natyrisht, kjo nuk është një punë aq e lehtë. Ne kemi mësuar dhe shumë shokë mësojnë marksizëm-leninizmin. Por këta duhet të bëjnë përpjekje që në radhë të parë teorinë që kanë marrë nëpër shkolla ta lidhin me jetën dhe të shohin konkretisht zbatimin e saj. Unë them pa u gabuar që disa nga pedagogët tanë që japin marksizëm-leninizmin janë në mos fare, po shumë të shkëputur nga jeta. Në qoftë se pedagogu e zotëron mirë çështjen, shpjegon mirë problemin e mbivlerës që është një nga çështjet më esenciale të «Kapitali» i Marksit, në qoftë se ai e lidh mirë me praktikën, atëherë njerëzit tanë në bazë, p.sh. punëtorët e tekstilit, të naftës etj. janë në gjendje ta kuptojnë më mirë se kushdo këtë problem, sepse ata luftojnë përditë me të gjitha çështjet ekonomike. Prandaj ato po t'ua bëjnë pedagogu më të thjeshta, ata do të kuptojnë esencën e teorisë marksiste-leniniste. Natyrisht, një njeri i tillë i thjeshtë nuk është në gjendje që të vejë dhe të bëjë një konferencë mbi këto probleme dhe Partia nuk pretendon që të gjithë të bëhen pedagogë dhe profesorë, po puna është që njerëzit tanë të përvetësojnë marksizëm-leninizmin që t'i orientojë si busull në punën e tyre dhe ta zhvillojnë atë më tej. Përse u përket frazave,

lidhjeve, detyrave këto le t'i dinë mirë pedagogët, punonjësve t'u jepet esenca e teorisë marksiste-leniniste. Në këtë drejtim duhet t'i bëjnë përpjekjet e tyre pedagogët, d.m.th. të shpjegojnë sa më thjeshtë dhe të lidhin mirë teorinë me luftën praktike, me vendimet e Komitetit Qendror dhe me luftën e popullit.

Por është edhe çështja tjetër. Propagandistët, nuk ndihmohen sa duhet nga komiteti i Partisë dhe në këtë drejtim ata nuk kanë faj. Ne kemi krijuar kabinetet e Partisë dhe më duket se sekretari i parë i komitetit të Partisë ia ka varur tërë punën e kabinetit një njeriu. Po ç'ngjet? I shkreti propagandist, me atë nivel që ka, merr librat, i lexon dhe radhit njëra pas tjetrës disa fraza që tingëllojnë rëndë filozofikisht dhe vete për të bërë leksionin në një formë me njerëz që ai as që di se ç'kanë në kokë, ç'mendojnë ata për këtë ose atë problem dhe fillon e u thotë: «Dëgjoni, tani unë do t'ju flas për dialektikën marksiste». Kështu vete ai në formë dhe mësimi bëhet i thatë, dëgjuesit nuk bëjnë pyetje dhe kur bëjnë ka raste që ua marrin ters. Po edhe vetë propagandisti ka frikë nga pyetjet që mund t'i bëjnë dëgjuesit se nuk di si t'u përgjigjet, se edhe ai nuk di më shumë nga sa ka në leksion. Ai i sheh ata vetëm kur bën leksionin. Kështu gjen çdo rast për t'i bërë bisht e për të mos shkuar. Por edhe kur vete leksionin e bën shpejt e shpejt, u jep disa pyetje dhe dëgjuesit japin disa përgjegje të shpejta, po më shumë krijon një ambient që të mos bëhen pyetje dhe në këto kushte njerëzit mërzhiten. Një situatë e tillë ekziston sepse ky njeri nuk udhëhiqet nga ajo se si të bëhet sa më i kuptueshëm e tërheqës leksioni, nuk

njuh njerëzit që e dëgjojnë, nuk është i lidhur me punën dhe shkon si derri në thes. Prandaj një situatë e tillë duhet të ndryshojë. Partia duhet të tregojë kujdes që njerëzit të mos e mësojnë marksizëm-leninizmin vetëm me këto leksione teorike. Marksizëm-leninizmi mësohet me të gjitha mjetet, nëpërmjet shkollave, konferencave, leksioneve e çdo lloj pune tjetër që bën Partia nga të katër anët e vendit. Por Partia, udhëheqja e saj, kabinetet, njerëzit e propagandës nuk interesohen dhe të thonë: «Po bëjmë një leksion këtu ose atje për një çështje të caktuar qoftë kjo mbi moralin proletar, mbi problemin e normave në prodhim etj. dhe këtu të futim njëkohësisht edhe parimet leniniste mbi atë problem». Kështu kuadrot tanë, që dëgjojnë të tilla leksione, pregatiten në mënyrë të vazhdueshme për të kuptuar teknikën dhe teorinë e kësaj çështjeje. Pastaj ata kur të vijnë në leksionin teorik do të jenë në gjendje të bëjnë pyetje dhe t'i kuptojnë leksionet. Po Partia nuk vë fare kujdes, prandaj këto konferenca janë bërë të mërzitshme. Po diçka njerëzve me parti ose pa parti u mbetet, pavarësisht nga niveli i ulët që bëhet kjo punë dhe kësaj ata i realizojnë planet. Po sikur Partia të bëjë një punë më të mirë me njerëzit që kanë mbaruar shkolla, ajo do të bëhet jashtëzakonisht interesante. Ja p.sh. kur bëhen konferenca teorike me inxhinierët ose me mjekët mbi probleme të ndryshme si mbi sputnikët, të rejat e shkencës etj., njerëzit i ndjekin me interes. Po ç'e pengon Komitetin e Partisë të Tiranës që kur mban një referat mbi energjinë atomike një fizikant, ta marrë këtë më parë në kabinetin e Partisë dhe atje një nga specialistët tanë t'i shpjegojë atij parimet tona

filozofike që lidhen me shkencat fizike dhe ai pastaj ta bëjë këtë lidhje në leksionin e tij? Ne kemi mësuar gjithë këta fizikantë të rinj që e kuptojnë teorinë marksiste-leniniste, d.m.th. kemi kush t'i bëjë këto punë. Këtë nuk e bëjnë drejtuesit e Partisë në rrethe për edukimin e njerëzve. Prandaj kjo çështje të mos lihet pasdore, po kuadrot tanë të përgatiten me ideologjinë marksiste-leniniste dhe të jemi të sigurtë se detyrat që na ngarkohen do të kryhen me sukses.

Partia jonë është e fortë, monolite, ajo ka bërë të dështojnë të gjitha përpjekjet e revizionistëve dhe të armiqve të brendshëm, po vigjilencën duhet ta theksojmë kurdoherë. Të mos harrojmë që vigjilenca bëri të dështojnë deri tani të gjitha përpjekjet e brendshme dhe të jashtme për të goditur Partinë dhe unitetin e saj. Prandaj çështjen e luftës kundër elementëve të çdo marke që kërkojnë të godasin forcën dhe unitetin e Partisë ta kemi kurdoherë parasysh, të jemi vigjilentë dhe të pamëshirshëm kundër tyre. Kështu do t'i edukojmë njerëzit me punë dhe me luftë, me ideologjinë marksiste-leniniste, t'u japim në dorë teknikën dhe t'i lidhim me masat. Vetëm duke vepruar kështu do të arrihet që të realizohen këto plane. Këtë Partia e ka pasur dhe do ta ketë në qendrën e vëmendjes së saj. Këtu qëndron edhe garancia e realizimeve të planeve tona.

Derisa të aprovohet plani dhe shtesat e tija në Kuvendin Popullor, Partia dhe masat të mobilizohen në mënyrë të atillë që vrulli i punës të mos ulet asnjëherë që nga fillimi e deri në fund. Të kemi parasysh se si kurdoherë, pas plenumit do të organizojmë puni-

min e rezolucioneve, i cili po u bë mirë do të jetë një ndihmë e madhe për gjithë Partinë. Dihet që organizimi i mirë i punimit të rezolucioneve bëhet vetëm me punë operative dhe jo duke qëndruar gjithë kohën në zyrë. Të mbërthyerit në zyra dhe burokratizmi nuk na kanë dhënë gjë asnjëherë, përkundrazi na kanë penguar, prandaj sa më pak njerëz nëpër zyra dhe sa më shumë luftë burokratizmit.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LEKSIONET PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË RINISË DUHET TË JENË TË THJESHTA, TËRHEQËSE DHE MBI BAZA SHKENCORE

*Vërejtje mbi disa tema të edukimit komunist të rinisë*

7 shkurt 1958

*Mbi temën I. «Ç'do të thotë të jesh patriot i vërtetë»*

Përkufizimi i patriotizmit nuk është zhvilluar drejt, mbi baza marksiste. Pavarësisht se fjala patriot vjen nga fjala frëngjisht «patrie» që do të thotë atdhe, atdheu, dashuria për të, për të gjitha gjërat që e përbëjnë atë, ka ekzistuar në zemrën e popujve edhe para Revolucionit francez. Këtu s'është fjala për të shpjeguar fjalën frëngjisht në vetëvete, por kuptimin e vërtetë marksist të fjalës patriot.

Dashuria për atdheun, ka në vetëvete gjënë kryesore, dashurinë për njeriun, për popullin, ajo ka të bëjë me jetën e tij materiale dhe jo vetëm shpirtërore, siç mendon ai që e ka shkruar atë leksion dhe që e paraqet sikur ato që thotë ai janë fjalët e Leninit (në tekst s'ka as thonjza as referimin përkatës).

Hartimi i leksionit është shumë i çalë nga çdo pikë-pamje. Është rasti, që me këtë temë t'i bësh rinisë një përmbledhje të historisë plot shembuj heroizmi të popullit tonë dhe t'i japësh arsëyet pse populli ynë frymëzohej nga një patriotizëm i madh; kjo nuk del në këtë leksion.

Luftërat e popullit tonë patriot për liri, për pavarësi, për bashkim, për bukë, për dituri, për tokë, për mbrojtjen e grave, të nderit, të zakoneve e të traditave të mira, të gjuhës, të fushave, të pyjeve, të kështjellave etj., etj., s'filluan me njerëzit e Rilindjes, siç mundohet të tregojë lektori. Jo, ato kanë filluar shumë më përpara.

Në çdo etapë të historisë sonë, patriotizmi i popullit shqiptar nuk është i lidhur me ëndërrime, por me çështje jetike, konkrete, materiale të tija. Prandaj dhe tema mbi patriotizmin, duhet të zhvillohet në rrugën e dialektikës materialiste. Rilindasit, gjithashtu, s'kanë qenë ëndërrues të zbrazët, abstraktë dhe ca më shumë komunistët dhe patriotët që bënë Luftën nacional-çlirimtare.

Patriotizmi i popullit tonë nuk është vetëm karakteristikë e dy periudhave të caktuara të historisë sonë dhe pikërisht e periudhës së Rilindjes dhe e Luftës nacional-çlirimtare. Patriotizmi ka një burim të madh dhe të lashtë në popullin tonë. Ky patriotizëm shprehej sipas epokave, kushteve materiale, zhvillohej, bëhej më i fortë, më i ndërgjegjshëm, shfrytëzohej dhe shtrembërohej nga armiqtë e popullit, binte, por nuk shuhej. Patriotizmi në kohën e Rilindjes mori hov të ri, se të tilla ishin rrethanat objektive dhe subjektive të brendshme dhe të jashtme të vendit tonë. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare e sidomos tani në Shqipërinë e lirë, ku ndërtohet socia-

lizmi, natyrisht patriotizmi i masave të gjera të popullit, jo vetëm që ka qenë dhe është i papërshkrueshëm, por edhe i paparë ndonjëherë në historinë e popullit tonë si nga hovi ashtu edhe nga përmbajtja, nga kuptimi i drejtë i tij dhe baza marksiste-leniniste mbi të cilën është ngritur, domethënë baza materialiste e tij dhe jo idealiste ose abstrakte. Sidomos shpjegimi marksist i patriotizmit duhet zhvilluar jo me formula filozofike, por me fjalë të thjeshta.

Që të mundë rinia t'u futet çështjeve teorike të marksizmit militant, nuk është aspak e tepërt që t'i shpjegohet se gjatë etapave të historisë, patriotizmi ka pasur baza idealiste dhe kjo sipas periudhave nuk e ul vlerën e qëllimit të këtij patriotizmi. Patriotët e kohëve të vjetra, qofshin këta klerikë ose laikë, qofshin këta fetarë, ose që nuk besonin te zoti, nuk mundet t'i akuzosh si jopatriotë se patriotizmi i tyre ishte i bazuar në idealizëm. Edhe në Luftën nacional-çlirimtare edhe në kohën tonë, shumica dërmuese e popullit patriot nuk e kuptonte dhe nuk e kupton patriotizmin krejtësisht nga ana filozofike siç e kuptojnë komunistët. Por këtu ka një diçka dhe kryesore: filozofia jonë nuk është as abstrakte as idealiste, por është e lidhur ngushtë dhe buron nga zhvillimi materialist i historisë, prandaj pikëpamjet tona të drejta marksiste-leniniste mbi këtë çështje përputhen ngushtë me pikëpamjet e masave të gjera të popullit, që nuk janë komuniste, por që ndjekin me besnikëri vijën dhe direktivat e Partisë.

Çështja e spekulimit mbi patriotizmin nga armiqtë e popullit, nga tradhëtarët e çdo kohe dhe të çdo etape, duhet zhvilluar natyrisht më gjerë e më mirë, me she-



mbuj konkretë dhe në mënyrë marksiste. Çështja e luftës së klasave duhet të jetë filli orientues në shpjegimin e spekulimit mbi këtë problem, shpjegim që do ta orientojë rininë ku e ka burimin patriotizmi i madh i popullit, i frymëzuar nga Partia jonë marksiste-leniniste dhe ku e ka burimin tradhëtia dhe spekulimi që bëhet me fjalën patriot. Shembujt e ndryshëm të patriotëve të çdo etape duhet jo vetëm të mos paraqiten si ikona të vdekura e pa shpirt, por ato duhet të zgjidhen me kujdesin më të madh, se përfaqësojnë një periudhë, një etapë, një program, një dëshirë të masave të gjera patriotike. Ata s'janë «heronj dhe kordhëtarë» të vetmuar, por luftëtarë që shprehin dëshirat e masave në periudha të caktuara historike.

Lypset që në këtë temë një vend të mirë të zërë çështja e internacionalizmit proletar dhe kjo të ilustrohet me shembuj konkretë. Të shpjegohen shovinizmi, kozmopolitizmi dhe teoritë e tjera idealiste, imperialiste, reaksionare me shembuj gjithashtu konkretë dhe të demaskohen.

### **Mbi temën II. «Pse ekzistojnë disa paragjykime e zakone prapanike dhe si duhen luftuar këto»**

Kjo temë, shumë e rëndësishme nga ana praktike dhe filozofike, është trajtuar nga një frazaxhi, që nuk shpjegon asgjë dhe që nuk ia arrin aspak qëllimit. Ky «leksion» mund ta mërzhitë rininë, ose ta vërë në gjumë në kohën kur ai lexohet, pse rinia di më shumë nga ç'i thuhet në të.

Burimin e këtyre të këqiave në ndërgjegjen e njerëzve, nuk na e shpjegon fare as nga ana e materializmit historik as nga ana e dialektikës materialiste. Nuk mendoj që të rinjve t'u bëhet një leksion thjesht filozofik, por ai nuk mund të ecë përpara në zhvillimin e temës pa u folur të paktën, edhe në gjuhë të thjeshtë, që këto të këqia e kanë burimin në botëkuptimin idealist të shpjegimit të çështjeve, e kanë burimin te feja.

Për të mos u futur thellë, ai në radhë të parë duhet t'u flasë për fenë, por që t'u flasë për këtë, duhet t'u tregojë për perënditë, duhet t'u shpjegojë si dhe pse lindën ato, ç'sollën nga pas teoritë për perënditë dhe perëndinë; si u rrënjosën këto çështje në ndërgjegjen e njerëzve; kujt u shërbenin këto pikëpamje dhe kjo filozofi idealiste; ç'rol ka luajtur dhe luan feja në ndërgjegjen e njerëzve dhe ideologji e kujt është, cilës klase i shërben dhe ç'fshihen e si veprohet nën maskën e rreme të kësaj ideologjie ose të fesë më konkretisht. Të shpjegojë pse Marksisi e ka quajtur fenë «opium për popujt».

Në radhë të dytë, ai duhet të flasë akoma më konkretisht. Në Shqipëri kemi dy besime: kristianizmin (ortodoksët dhe katolikët) dhe muslimanizmin. Është e nevojshme t'u bëhet shkurtimisht historiku kritik këtyre dy besimeve, nga ana filozofike dhe historike. Klasat sunduese dhe kleri, me shekuj e kanë bërë këtë propagandë dhe në ndërgjegjen e njerëzve është futur ku më shumë e ku më pak çështja e Krishtit, e kristianizmit, e Muhametit dhe e muhamedanizmit. Rinia duhet medemos të mësojë nga marksistët si i gjykojnë ata këto çështje, pra, të gjitha këto në radhë të parë, duhet t'i demas-

kojmë teorikisht. Me këto fe, përveç të tjerave, janë lidhur në popull, një sërë çështjesh të praktikës së fesë, që dalëngadalë në shekuj janë bërë jo vetëm zakone, por edhe ligje shteti. Këto ligje ne i kemi shfuqizuar, i kemi zhdukur, por ndikimi i tyre ka mbetur në ndërgjegjen e njerëzve. Kanë ekzistuar në vendin tonë, përveç anës filozofike idealiste të problemit, edhe ligje të kishës, edhe ligje të shariatit. Në këto e kanë burimin të gjitha të këqiat për të cilat flet vetëm titulli i temës, por që as i prek fare zhvillimi i saj. Këto mbeturina fetare, idealiste, që na janë qepur si ferra në ndërgjegje, duhet t'i shkullim nga rrënjët, duke i demaskuar në mënyrë shkencore me armën tonë të materializmit dialektik.

Çdo ferrë që ne do të shkullim nga ndërgjegjia e njerëzve, duhet ta zëvendësojmë me një lule të bukur, me një lule shkencore, materialiste dhe jo me një lule simbolike, se simboli është fillimi i idealizmit. Pra, çdo zakon, çdo bestytini, çdo mbeturinë fetare, ne duhet ta luftojmë me argumenta shkencorë dhe kryesisht të marrura nga jeta dhe lufta e përditshme e njerëzve. Shpjegimi i thjeshtë, por mbi baza shkencore, do të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ndërgjegjia e brezit të ri, e pastër nga çdo e keqe, nga çdo mbeturinë, është mjaft e prekshme dhe fare mirë mund të mbruhet me gjëra të mira, fare lehtë mund të armatoset në luftën që do të bëjë në jetë me këto mbeturina të panumërta që do ta rrethojnë, por ato do t'i zënë këmbët brezit të ri në rast se ne nuk do të kujdesemi shumë për edukimin e drejtë marksist-leninist të tij.

Programet e shkollave, natyrisht, duhet të luajnë një rol të madh dhe vendimtar në edukimin e rinisë. Në

këtë çështje e kam fjalën që mësuesit duhet t'i plotësojnë tekstet e shkollave me njohuri më të gjera nga ana e tyre, me fakte konkrete në përshtatje me vendin ku jetojnë se kështu ata do të mundin t'u shpjegojnë nxënësve dhe rinisë, rrënjën shkencore dhe atë idealiste të çështjeve, që kanë lidhje me temën që bëjmë fjalë. Këtë anë mësuesit nuk duhet ta harrojnë kurrë, të mos shkëputin mësimin që japin nga jeta, nga lufta, nga botë-kuptimet e ndryshme që fillojnë të sulmojnë mendjen dhe ndërgjegjen e njomë të të riut e të së resë.

Prandaj, tema të tilla, natyrisht të trajtuara më mirë dhe mbi baza shkencore duhet të shërbejnë për të gjithë rininë, por në radhë të parë edhe për edukatorët e saj.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**KOMISIONI I KONTROLLIT TË SHTETIT TË BËHET  
NJË MËSUES I MIRË PËR TË GJITHË  
KONTROLLORËT DHE REVIZORËT  
E DIKASTEREVE QENDRORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**8 shkurt 1958**

Është e vërtetë që edhe dikasteret bëjnë kontrolle, por këto kontrolle nuk janë në nivelin e duhur. Ne duhet që, nga njëra anë, të forcojmë organizimin, drejtimin dhe kontrollin e ministrive për zbatimin e vendimeve të qeverisë dhe, nga ana tjetër, të përmirësojmë akoma më tepër punën e Komisionit të Kontrollit të Shtetit. Pra, edhe unë nuk jam dakord që ta suprimojmë Komisionin e Kontrollit. Shkurtime e suprimime të bëjmë aty ku duhet, por jo në këtë organ, punën e të cilit ne duhet

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje, përveç problemeve të tjera, u diskutua edhe ai i shkurtimeve të organikave në aparatet administrative. Ndërmjet mendimeve që shfaqeshin, ishte edhe çështja e shkrirjes së Komisionit të Kontrollit të Shtetit.

ta forcojmë e ta ngremë në një shkallë akoma më të lartë.

Në fakt, Komisioni i Kontrollit të Shtetit u jep një ndihmë të madhe jo vetëm Këshillit të Ministrave, po edhe direkt dikastereve. Kjo duket qartë nga materialet që na dërgon Komisioni i Kontrollit, të cilat janë më të thelluara e më të studjuara se ato të dikastereve. Me sa duket, dikastereve u kanë shpëtuar edhe çështje të pakontrolluara, ndërsa Komisioni i Kontrollit bën një punë më pozitive dhe me cilësi më të mirë. Kjo e ka bërë atë që të fitojë edhe autoritet.

Në punë e sipër, natyrisht, Komisioni i Kontrollit mund të jetë futur dhe në çështje të vogla, por kjo mund të evitohet, megjithëse ka edhe çështje që duken si të vogla, por të japin sinjal për diçka të madhe. Ajo që ka rëndësi është çështja se ç'bëhet me raportet dhe problemet që ngre Komisioni i Kontrollit? Si ndiqen nga ana e Këshillit të Ministrave dhe nga vetë nënkryeministrat propozimet që bëhen në këto raporte? Këtu ka shumë për të bërë.

Dihet se neve na vijnë shumë probleme e sinjalizime nga Komisioni i Kontrollit. Këto probleme e sinjalizime u jepen dikastereve dhe nënkryeministrave. Por ç'ndodh? Shpeshherë ndodh që në rendet e ditës të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave nuk përfshihen sa duhet nga këto probleme dhe, si rrjedhim, nuk vihen mirë përpara përgjegjësisë ministrat përkatës për dobësitë e zbuluara nga kontrolli. Një gjë të tillë nuk e zbatojnë në mënyrë sistematike as nënkryeministrat, të cilët, është e domosdoshme që vërejtjet e Komisionit të Kontrollit t'i bëjnë çështje dhe të nxitin zgjidhjen e

tyre. Pra, nuk shfrytëzohet si duhet puna pozitive që bën Komisioni i Kontrollit, ku kemi kuadro me kapacitet. Prandaj, po të studjohen mirë raportet e Komisionit të Kontrollit, mund të dalin probleme jo vetëm për qeverinë, por edhe për Byronë Politike.

Për të gjitha këto arsye, mendoj se tani për tani Komisioni i Kontrollit është i nevojshëm, sepse ai ndihmon si bazën ashtu dhe qendrën. Shoku Shefqet<sup>1</sup> të kujdeset që Komisioni i Kontrollit, me punën dhe shembullin e tij të bëhet mësues i mirë për të gjithë revizorët dhe kontrollorët e dikastereve qendrore.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

---

<sup>1</sup> Shoku Shefqet Peçi, i cili në atë kohë ishte kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit.

**TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK  
FRANCEZE ME RASTIN E VDEKJES SË SHOKUT  
MARSEL KASHEN**

**13 shkurt 1958**

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE  
FRANCEZE**

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, gjithë Partia dhe populli shqiptar, me pikëllim të thellë mësuan lajmin e hidhur të vdekjes së anëtarit të vjetër dhe njërit nga udhëheqësit e sprovuar të Partisë Komuniste Franceze, birit besnik të popullit francez, militantit të shquar të klasës punëtore franceze dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, mikut të dashur dhe të shtrenjtë të popullit shqiptar, shokut Marsel Kashen.

Vdekja e shokut Marsel Kashen, e këtij marksist-leninisti të shquar, i cili gjithë jetën e tij revolucionare ia kushtoi çështjes së klasës punëtore franceze dhe proletariatit ndërkombëtar, është një humbje e madhe, jo vetëm për Partinë Komuniste dhe klasën punëtore



franceze, por për të gjitha partitë motra dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për të gjithë kampin e paqes dhe të socializmit. Vdekja e shokut Kashen, i cili aq shumë e ka dashur popullin shqiptar dhe Partinë e tij të Punës dhe ka luftuar pa pushim për forcimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe atij francez, është një humbje e rëndë edhe për popullin e Partinë tonë.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të të gjithë komunistëve shqiptarë i shfaqim Partisë Komuniste motër Franceze ngushullimet tona më të thella. Në këto momente të rënda pikëllimi për partinë tuaj, ne, komunistët shqiptarë, e ndjejmë veten shumë afër jush, ne do ta ruajmë me respekt kujtimin e shokut Marsel Kashen dhe lufta, shembulli dhe besnikëria e tij ndaj çështjes së klasës punëtore, ashtu si ju dhe të gjithë komunistët e tjerë të botës, do të na frymëzojë dhe ne, komunistët shqiptarë, në luftën për triumfin e plotë të kauzës së pavdekshme të socializmit dhe të paqes.

Për Komitetin Qendror të PPSH  
Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 38.(2939), 14 shkurt 1958

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## KOLEKTIVIZIMI — E VETMJA RRUGË PËR ZHUKJEN E VARFËRISË E TË PRAPAMBETJES NË FSHAT

*Nga diskutimi në Plenumin e Komitetit të Partisë  
të rrethit të Fierit<sup>1</sup>*

25 shkurt 1958

Mendimi im është se organizata e Partisë e rrethit të Fierit i ka kapur mirë çështjet. Të gjithë sa diskutuan këtu në këtë plenum i ngritën drejt problemet dhe kritikuan me kurajë. Kjo tregon se Partia në rreth është forcuar dhe ka ndryshime të mëdha në krahasim me të kaluarën, kjo tregon gjithashtu se dhe udhëheqja e Partisë në Fier ka punuar mirë, ajo ka marrë masa për ta çuar punën përpara duke luftuar vazhdimisht kundër atyre që nuk punojnë mirë e që bëhen pengesë. Fieri sot për sot është një rreth kryesisht bujqësor, por Komiteti Qendror ka orientuar që Fieri të bëhet edhe një

---

<sup>1</sup> Në këtë plenum u dëgjua raporti i byrosë së komitetit të Partisë «Mbi aktivitetin njëvjeçar të organizatës së Partisë të rrethit», i cili do t'i paraqitej Konferencës së 8-të të Partisë të rrethit të Fierit.

rreth me industri të zhvilluar dhe në të ardhshmen këtu do të fillojnë ndërtimet e objekteve industriale, si rrjedhim edhe klasa punëtore do të rritet dhe Fieri do të bëhet rreth shembullor.

Diskutimin tim do ta përqëndroj lidhur me problemet që kanë të bëjnë me rrugët dhe luftën për forcimin dhe zhvillimin e kooperativave bujqësore. Ky vit duhet të jetë për ju, viti i përfundimit të kolektivizimit. Siç dihet kooperativat nuk janë ngritur, se kështu i është tekur ndonjërit as edhe në formë shablone, por në bazë të rrugës dhe të mësimeve të marksizëm-leninizmit, që ka ndjekur e ndjek Partia jonë, në përshtatje me kushtet konkrete të vendit tonë. Tani fshatarësia dhe kushdo e kupton dhe e shikon qartë se me anën e kolektivizimit po rriten shumë prodhimet bujqësore dhe mirëqenia e popullit po përmirësohet çdo ditë e më shumë, se kolektivizimi është e vetmja rrugë për zhdukjen e varfërisë e të prapambetjes në fshat. Por sot kooperativat bujqësore kanë shumë nevojë për ndihmë në drejtim të forcimit organizativ të tyre dhe pikërisht këtu duhet të përqëndrohet edhe puna e Partisë. Në radhë të parë atyre duhet t'u jepet një ndihmë më e madhe me kuadro që të jenë të aftë të drejtojnë një ekonomi të madhe e me shumë forca pune e familje. Kooperativistët presin nga Partia që t'u dërgojë kuadro të përgatitur, të cilët jo vetëm që duhet të dinë të drejtojnë ekonominë, por të sillen mirë edhe me masat. Puna edukative në bujqësi ka shumë rëndësi, por është mjaft e rëndë, se veç të tjerave mentalitetet e mbeturinat e së kaluarës të fshatari janë më të theksuara se sa të punëtori i fabrikës, prandaj në këtë

drejtim kërkohet një punë bindëse më e madhe nga ana e kuadrove. Kuadrot tanë duhet të jenë të thjeshtë, ta dëgjojnë masën e të mësojnë prej saj dhe të mos u rritet mendja e të mendojnë se, meqë kanë kryer kurse për kryetarë, për llogaritarë ose për agronomë, ata dinë gjithshka, përkundrazi ata duhet të pyesin e të mësojnë edhe nga ai fshatari që, megjithëse nuk ka shkollë, ka eksperiencën e madhe të jetës, të praktikës. Për forcimin ekonomik e organizativ të kooperativave bujqësore duhet të tregohet më shumë kujdes nga ana e Partisë dhe e pushtetit edhe në drejtim të çështjeve të llogarive. Këto çështje të shikohen mirë se po dëmtohet e shpërdorohet pasuria socialiste gjë që shkakton pakënaqësi në kooperativistët.

Po vihen re disa veprime jo të drejta nga ana e disa kooperativave bujqësore, që duhet të luftohen nga Partia. Rëndësi të madhe ka edhe funksionimi në rregull i komisionit të revizionimit në kooperativë dhe nuk është ashtu siç mendojnë disa njerëz të cilët e quajnë atë gjë të kotë. Ata që mendojnë kështu harrojnë se me anën e kontroleve që këto komisione organizojnë po zbulohen mjaft shkelje e shpërdorime të palejueshme të pasurisë socialiste e lloj-lloj dallaveresh. Nën-vleftësimi i kontrollit të revizionimit duket që në fillim në disa kooperativa, ai duket që në zgjedhjen e njerëzve në këtë forum, shumica e të cilëve janë të paaftë, analfabetë e për më keq të pabesuar. Kjo s'është e drejtë. Komisionit të revizionimit i duhet dhënë rëndësia e duhur. Ka disa kooperativa bujqësore që janë në gjendje të mirë nga të ardhurat. Po ç'ndodh? Prodhimet ua ndajnë anëtarëve dhe ata këto prodhime i shesin

me çmime të larta për fitime dhe kur vjen puna vetë kooperativa ndërhyjnë që ata të marrin përsëri nga shteti po nga ai prodhim që ajo u ka dhënë vetë. Edhe për fondin e paprekshëm neglizhohet. Disa kooperativa bujqësore shesin kafshët dhe me të gjitha të ardhurat prej tyre shlyejnë detyrimet, kjo nuk është aspak e drejtë se një pjesë e këtyre të ardhurave duhet të shkojnë medoemos në fondin e paprekshëm me qëllim që të rriten sigurimet shoqërore. Të gjitha këto veprime duhet të luftohen në radhë të parë nga organizata e Partisë në fshat.

Ju, këtu në Fier, natyrisht duhet t'i vini rëndësi të madhe kulturës së pambukut pa lënë mënjanë misrin, në luftën për të siguruar bukën. Por në asnjë mënyrë nuk duhet të nënvleftësoni blegtorinë, veçanërisht lopën, delen dhe zhvillimin e shpendëve, pavarësisht se rrethi juaj është rreth bujqësor. Edhe planifikimi ka difekt në këtë drejtim. Ai nuk po bëhet mbi baza shkencore se dikujt i planifikohet më shumë pambuk dhe dikujt më shumë bagëti pa u thelluar në kushtet konkrete të çdo kooperative. Për këtë faj ka komiteti ekzekutiv, i cili jo vetëm që duhet të bëjë një planifikim më të drejtë, por të organizojë edhe ndihmën e kontrollin se si zbatohet ky plan. Ju, siç e thashë më lart, duhet të shtoni lopën sepse kështu do të kemi më shumë qumësht, yndyrë, djathë, gjizë etj. Merrni shembull nga rrethi i Shkodrës për shtimin e lopës dhe për kujdesin që tregon për të. Partia duhet të punojë që anëtari i kooperativës të mos e shesë në pazar lopën, por në kooperativë e me një vleftë të favorshme, bile edhe në qoftë se kooperativa nuk ka fond ose nuk ia

jep dot lekët në dorë t'ia japë me afat, por për këtë duhet punuar që ai ta kuptojë që e ardhshmja e tij është kooperativa. Për çështjen e lopës duhet punuar edhe në një drejtim tjetër, në drejtim të përmirësimit të racës, për këtë duhet të bëhet ndërzimi artificial i saj, ashtu siç u veprua me delen. Prandaj demat e racës duhet të trajtohen mirë.

Këtë vit numri i lopëve duhet të rritet dhe po që e mundur edhe plani të tejkalohet ashtu siç ka vepruar kooperativa bujqësore e Çiflik-Gremit. Por që të realizohet me sukses kjo detyrë, që shtron Partia, në radhë të parë duhen luftuar të fshatari disa mentalitete të vjetra. Ai është mësuar me delen ose dhinë dhe e ka të vështirë t'i lëshojë ato. Ai nuk është mësuar t'i bëjë mirë llogaritë dhe nuk ia njeh shumë leverdinë lopës. Prandaj, në këtë drejtim duhet luftuar shumë. Lopa do shumë ushqim edhe si sasi edhe si cilësi. Prandaj duhet që tokës t'i marrim dy prodhime, grurë e misër dhe këtë të fundit në mos e marshim kokërr për bukë ta përdorim për silazh se po t'i japësh lopës silazh misri të njomë është njësoj sikur t'i japësh njeriut bukë e gjalpë. Kujdes i veçantë të tregohet për viçat e vegjël. Me këta, në kooperativë dhe në përgjithësi me sektorin e blegtorisë më shumë të merren gratë e të rejat, sepse ato nga vetë natyra janë më të kujdesshme dhe të luftohet që ato të bëhen rritëse të dalluara të viçave.

Fieri ka tradita të mira për rritjen e shpendëve si biba, pula, rosa etj. Për këtë në çdo kooperativë duhet të krijohen ferma, të cilat do të ndihmojnë që jeta e fshatarëve të përmirësohet që edhe ata të rrojnë mirë, të hanë mish herë pas here e të marrin më shumë ka-

lori dhe të luftohet te ata zakoni që mishin e hanë pa e ekonomizuar e me raste. Partisë në fshat i duhet të bëjë një punë më të madhe bindëse me fshatarin që si të përdorë gjerësisht zarravatet, pse ato jo vetëm që janë të domosdoshme e shumë të ushqyeshme për organizmin e njeriut, por, duke i përdorur në një shkallë të gjerë, edhe bukë nuk harxhohet shumë. Për këtë qëllim të luftohet që fshatari edhe tokën e oborrit kooperativist ta mbjellë me zarravate e jo me misër.

Pambukun duhet ta kemi në rendin e ditës pse është një kulturë me leverdi të madhe ekonomike. Në disa ekonomi kooperativiste janë marrë 20-22 kv. pambuk për ha. Kjo tregon se atje ku organizata e Partisë e kooperativa kanë punuar mirë për kultivimin e pambukut kemi pasur edhe rezultate. Kryesorja në drejtim të zhvillimit të pambukut, është se duhet mbajtur shumë parasysh agroteknika.

Partia në rreth duhet të luftojë me këmbëngulje që kooperativat tuaja të bëhen model e të marrin shembull edhe fshatarët e fshatrat që akoma nuk janë kolektivizuar. Ajo duhet të luftojë me forcë kundër të metave subjektive që vihen re kudo në kooperativa, shumica e të cilave vijnë të shtyra nga interesi personal ose nga oportunitizmi si: mbajtja ose lejimi i bagëti mbi sasinë që caktohet në statut, mosndarja drejt e parcelave, mosdëgjimi i zërit të masës etj. Kjo e fundit është më e rrezikshmja.

Shfrytëzimi i kohës së punës në kooperativë nuk bëhet si duhet. Vihet re që disa njerëz sillen vërdallë, këtyre duhet t'u jepet rrugë. Me këta duhet të luftohet që të qëndrojnë në kooperativë, të punojnë atje me të

gjitha forcat, t'u shpjegohet perspektiva e kooperativave, të binden për të mirat e saja e të mos lëvizin poshtë e përpjetë në një kohë kur kooperativa ka aq shumë nevojë për forca pune. Në Fier, si kudo, gratë punojnë më shumë se burrat dhe prandaj ato duhet t'i ngremë në përgjegjësi. Në punën prodhuese duhet të shkojnë rregullisht të gjithë kuadrot që nga kryetari e deri te llogaritarët.

Komitetit Qendror i vijnë shumë letra nga kooperativistë e punonjës të ndryshëm. Në këto ata ankohen se shokët drejtues poshtë në rreth ose në fshat nuk ua zgjidhin problemet. Kjo tregon se këta nuk janë të lidhur e nuk punojnë me masën. Dhe domosdo kështu nuk i zgjidhen hallet popullit as mirë dhe as në kohë. Kjo duhet parë mirë. Në kooperativë veçanërisht ka rëndësi të madhe mbledhja e përgjithshme, dëgjimi seriozisht i diskutimeve të saj, i problemeve që ngre ajo. Praktika ka treguar se ai kryetar që ka dëgjuar asamblenë ka pasur rezultate të mira në punë. Por jo kudo ndodh kështu. Vihet re aty-këtu që disa kuadrove drejtues u rritet mendja dhe më e keqja është se kjo ndodh edhe në disa shokë që kanë luftuar dhe shesin mendje me dekoratat. Lufta, përpjekjet dhe sakrificat e tyre janë një krenari e ligjshme për ata dhe për gjithë shoqërinë tonë, por kjo krenari në asnjë mënyrë nuk duhet t'i çojë ata në vetëmburrje e vetëkënaqësi, t'u rritet mendja e të largohen nga masa. Po ashtu edhe te disa intelektualë vihen re mendime jo të drejta. Ata e heqin veten përmbi klasat, se «janë të zgjuar», se «vetëm ata mund t'i zgjidhin problemet» dhe si ata «s'di njeri tjetër». Partia jonë e lufton si



mendjemadhësinë edhe vetëkënaqësinë, për më tepër kur ato shfaqen te komunistët. Partia jonë këta shokë, që u rritet mendja ose i mbulon vetëkënaqësia, qofshin edhe nga ata që i ka nxjerrë nga gjiri i saj, pavarësisht se mund të rrjedhin nga shtresë e varfër ose janë me origjinë punëtorë, kur i largohen masës dhe fillojnë që t'i shesin mend asaj, duhet t'i kritikojë ashpër e po qe nevoja të marrë dhe masa që të ecin në rrugë të drejtë.

Por shumë njerëz bëjnë dhe gabime, por këto gabime duhen parë mirë, ata shokë që i bëjnë pa qëllim të kritikohen e të ndihmohen, dhe kjo ndihmë duhet të jetë e kualifikuar dhe e shpejtë, ndërsa atyre që i bëjnë me qëllim t'u gjendet vendi. Armiqtë duhen goditur pa mëshirë e në çdo kohë pse ata nuk flenë e sidomos clementët revizionistë që janë shumë të rrezikshëm për Partinë, popullin e për socializmin. Prandaj nuk duhet të ulet kurrë vigjilenca nga ana e Partisë, e pushtetit dhe e gjithë popullit. Partia duhet t'i ketë shumë parasysh elementët e përjashtuar nga radhët e saja dhe të bëjë diferencimin; ndaj atyre që janë përjashtuar për gjëra të vogla të mbahet qëndrim afrues, ndërsa ata që janë armiq të betuar të goditen pa mëshirë. Edhe këtu në Fier ka nga ata që janë goditur nga Partia, p.sh. Nexhip Vinçani, të cilit Partia, disa herë me radhë, i dha dorën, por ai nuk hoqi dorë nga rruga e mëparshme, prandaj kur mbushi kupën iu dha dënimi i merituar. Po mos vallë ky dhe shokët e tij flenë? Jo, ata përpiqen t'i helmojnë njerëzit tanë, t'i çorientojnë. Por nuk u shkon se Partia jonë është e fortë e kurdoherë vigjilente dhe populli ynë është revolucionar. Megjithatë vigjilenca e gjithë komunistëve e sidomos e

Organeve të Sigurimit të Shtetit duhet të rritet.

Tani dy fjalë për gjendjen ndërkombëtare. Siç e dini imperializmi, sidomos ai amerikan, mundohet të përçajë popujt. Këtë ai e bën për t'i shtypur më lehtë ata. Me fjalë imperialistët tregohen se janë për paqe, në fakt me vepra ata bëjnë të kundërtën, po nxitin luftën. Por popujt sot janë ngritur në këmbë dhe po luftojnë me të gjitha forcat, kundër luftës; shtypjes e shfrytëzimit.

Me shtetet përreth ne mundohemi të kemi fqinjësi të mirë. Me udhëheqësit jugosllavë, ne kemi mosmarrëveshje për çështjet ideologjike. Në këtë drejtim ne as u kemi bërë dhe as do t'u bëjmë lëshime, por gjithmonë do t'u japim përgjegjen e merituar. Greqia sikur ka filluar të bëjë një farë ndryshimi në qëndrimin e saj. Ne e kemi thënë dhe e themi se duam të kemi marrëdhënie fqinjësie të mirë me të. Ajo le të bëjë ç'të dojë.

*Pasi foli edhe për disa çështje të tjera të gjendjes ndërkombëtare, ai përfundoi:*

Kaq kisha, shokë, ju uroj sukses në punët tuaja.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i Plenumit të Komitetit të Partisë të rrethit të Fierit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NGA BISEDA ME NXËNËSIT E TEKNIKUMIT BUJQËSOR TË FIERIT

26 shkurt 1958

*Në Fier shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në teknikumin bujqësor. Atje ai vizitoi laboratorin dhe dhomat e mësimit. Në takimin që pati me nxënësit e teknikumit shoku Enver midis të tjerave tha:*

Partia jonë tregon një kujdes të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Në krahasim me të kaluarën në këtë sektor ne kemi ndryshime jashtëzakonisht të mëdha. Por megjithatë na dalin detyra të mëdha për ta çuar atë më përpara. Nuk duhet të harrojmë se bujqësia, në radhë të parë, kërkon drejtim e organizim shkencor. Pikërisht në këtë drejtim ne kemi akoma shumë për të bërë. Për t'ia arritur këtij synimi të caktuar nga Partia, ne duhet të pajisemi me dituri. Është për këtë arsye që shkolla juaj merr sot një rëndësi të posaçme. Prandaj, ju duhet të mësoni më shumë, të shkoni e t'i vini më shumë rëndësi praktikës, sepse edhe vetë teoria ka dalë nga praktika. Të përvetësoni me baza lëndët që ju jepen në shkollë, të dëgjoni dhe të respektoni mësuesit tuaj, sepse kështu bëheni kuadro të vlefshëm për atdheun, popullin e

Partinë dhe në këtë mënyrë ju do t'u shërbeni më mirë.

*Duke folur për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të bujqësisë në vendin tonë, për perspektivat e saja, foli edhe për të mirat e kolektivizimit. Për këtë çështje ndër të tjera ai theksoi:*

Kolektivizimi është kusht i domosdoshëm për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja. Fshatarësia jonë e di që bashkimi bën fuqinë dhe ajo është bashkuar e po bashkohet në kooperativa me vullnet të plotë. Të mirat e kolektivizimit janë të mëdha. Ai është në interesin e vetë fshatarësisë dhe të gjithë shoqërisë sonë.

*Duke përfunduar shoku Enver Hoxha u uroi nxënëseve suksese më të mëdha në mësimet për ta mbyllur vitin shkollor me rezultate sa më të mira.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 49 (2950), 27 shkurt 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 49 (2950), 27 shkurt 1958*

## NGA BISEDA ME KOOPERATIVISTËT E GORISHOVËS E TË VRESHTASIT TË MALLAKASTRËS

28 shkurt 1958

*Shoku Enver bëri një vizitë në kooperativën bujqësore të Gorishovës. Ai i përgëzoi kooperativistët për sukseset e arritura dhe i porositi:*

Ju duhet t'i shtoni akoma më tepër përpjekjet për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të këtij viti, në mënyrë që të shtohen akoma më shumë prodhimet bujqësore e blegtorale, të përmirësohet më shumë jeta. Veçanërisht një punë të madhe duhet të bëjnë kooperativistët për shtimin e gjësë së gjallë dhe sidomos të lopëve.

*Fshatarët premtuan se do t'i plotësojnë me nder porositë e Partisë dhe të shokut Enver, pasi ato janë për të mirën e tyre.*

Perspektiva të mëdha i hapen vendit tonë — *tha ndër të tjera shoku Enver* — si në bujqësi edhe në industri e sidomos në çështjen e shtimit të prodhimit të naftës. Këneta e dikurshme në zonën e Marinëzës nga fole mushkonjash, u kthye në kënetë floriri, flori që do të shkojë për të mirën e popullit, për ndërtimin

e sa më shumë shtëpive, shkollave, kanaleve, gjë që do të bëjë të përmirësohet edhe jeta e fshatarëve.

*Gjatë vizitës në kooperativë shoku Enver Hoxha u takua edhe me nxënësit e shkollës 7-vjeçare, të cilët i porositi që të mësojnë sa më shumë, që t'i marrin të gjitha notat pesa.*

Të doni shokët — u tha shoku Enver — të doni dhe të respektoni prindërit e arësimitarët, të doni sa më shumë Partinë, e cila mendon e punon që t'ua bëjë fëmijëve jetën sa më të lumtur.

*Shumë prekëse qe sidomos biseda me xha Halimin, i cili i ka kaluar të 100 vjetët. Ai, pasi e përqafoi me dashuri shokun Enver, i tha: «Edhe në vdeksha tani shkoj i gëzuar, sepse i lë bijtë dhe nipërit me të gjitha të mirat, sepse arrita të shoh me sytë e mi këtu në fshat birin më të shquar të popullit tonë».*

*Shoku Enver u largua nga Gorishova i përcjellë me përzemërsi nga kooperativistët, të cilët i premtuan se do t'i realizojnë që sivjet detyrat e caktuara për vitin 1960.*

*Me ftesën e kooperativistëve shoku Enver shkoi pastaj për një vizitë në kooperativën e Vreshtasit. Edhe këtu ai bisedoi përzemërsisht me fshatarët, të cilët e vunë në dijeni mbi punën e tyre. Pasi i përgëzoi për sukseset që kanë arritur, shoku Enver i këshilloi:*

Ju, shokë kooperativistë, duhet që t'i shtoni përpjekjet tuaja për të shfrytëzuar sa më mirë rezervat e brendshme, të mbillni sa më shumë ullinj dhe veçanërisht vreshta e pemë frutore që ua do aq shumë klima dhe toka juaj. Të shtoni bagëtinë që është sektor me rëndësi për ekonominë tonë, veçanërisht lopën.

Kështu ju do të rritni të ardhurat tuaja, do të zbukuroni jetën tuaj.

*Para se të largohet nga Vreshtasi, në shenjë kujtimi, shoku Enver Hoxha bëri një fotografi së bashku me kooperativistët.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 51 (2952), 1 mars 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 51 (2952), 1 mars 1958*

## NGA BISEDA ME KOOPERATIVISTËT E ÇAKRANIT TË MALLAKASTRËS

1 mars 1958

*Shoku Enver në bisedën e përzemërt me kooperativistët e Çakranit vuri në dukje luftërat e gjata të popullit të Mallakastrës, për lirinë e pavarësinë e atdheut, në të kaluarën dhe gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Ai përmendi gjithashtu edhe sukseset që mallakastriotët kanë arritur sot në luftën për realizimin e planit të shtetit. Pastaj foli edhe mbi forcimin e Republikës sonë Popullore, mbi rritjen e autoritetit të saj në arenën ndërkombëtare.*

*Duke folur mbi perspektivat që i hapen popullit tonë në të ardhshmen shoku Enver midis të tjerave tha:*

*Zhvillimi i shpejtë i industrisë në vendin tonë, perspektivat e reja e të mëdha të saja kërkojnë që të ecet më me shpejtësi përpara edhe në bujqësi me anë të kolektivizimit. Prandaj, detyra të mëdha u dalin kooperativistëve për përmirësimin e punës në kooperativë. Organizata bazë e Partisë, kryesia e kooperativës dhe gjithë kooperativistët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë organizimit të punës. Është e nevojshme të punohet më shumë nga të gjithë kooperativistët dhe të*



bëhet një ndarje më e mirë e forcave të punës nëpër brigada. Rëndësi ka edhe shfrytëzimi me vend i ditëve të punës dhe për këtë ju duhet të shikoni mirë shfrytëzimin e kohës së punës, cilësinë dhe sasinë e punës. Të luftohet për pakësimin e shpenzimeve administrative. Të luftohet për pjesëmarrjen në punë të të gjitha forcave të kooperativës.

*Pastaj shoku Enver, duke biseduar për problemet e kuadrit, i porositi kooperativistët të dërgojnë sa më shumë të rinj e të reja në shkolla e kurse agroteknike dhe të futin sa më shumë gra në sektorin e blegtorisë, në sektorin e lopëve.*

Gratë — theksoi shoku Enver — janë më të kujdesshme nga vetë natyra e tyre, prandaj ato duhet t'i ngarkoni me rritjen e viçave e me kujdesin për lopët. Kështu ju do të siguronit të ardhura më të mira nga sektori i blegtorisë.

*Biseda e shokut Enver Hoxha u dëgjua me vëmendje dhe u përshëndet herë pas here me duartrokitje entuziaze.*

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 52 (2953), 2 mars 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 52 (2953), 2 mars 1958

## BASHKIMI DO T'JU SJELLË EDHE BEGATINË

*Letër dërguar fshatarëve të Zhavarës me rastin  
e formimit të kooperativës*

2 mars 1958

TË DASHUR SHOKË DHE SHOQE TË KOOPERATIVËS  
BUJQËSORE «BAJRAM CURRI» ZHAVAR<sup>1</sup>

Mora letrën tuaj dhe sihariqin që më jepni se ju formuat kooperativën. Ju them se kam ndjerë një gëzim shumë të madh, kur këndova letrën tuaj, të dashur vëllezër dhe motra; u gëzova pa masë, se tani jeta juaj do të përmirësohet shumë dhe me hapa shumë më të shpejtë. Populli thotë: «bashkimi bën fuqinë» dhe unë shtoj se bashkimi do t'ju sjellë dhe begatinë. E meritoni plotësisht që të rroni të lumtur e të gëzuar ju, bijtë e bijat tuaja si edhe brezat tuaj të ardhshëm.

---

<sup>1</sup> Fshat në rrethin e Fierit, ku ishin vendosur familje të ardhura nga Kosova për shkak të persekutimeve nga qeveria jugosllave.

Ju' jeni bij dhe bija të dashura të popullit tonë heroik. Vëllezërit tanë të Kosovës, gjatë gjithë historisë shekullore të popullit tonë kanë luftuar heroikisht për këtë truall; historia e viteve të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, është mbushur me luftëra legjendare të popullit trim shqiptar të Kosovës, për nënën Shqipëri, për Shqipërinë tonë të përbashkët, që ajo të bëhej e lirë, e pavarur, e popullit.

Ne tani jetojmë të lirë, në atdheun tonë që e çliroam me luftë të përgjakshme. Ne na udhëhoqi në fitore Partia jonë e lavdishme, ne na ndihmoi Bashkimi Sovjetik. Ne tani ndërtojmë socializmin, jetën e begatshme.

Partia dhe qeveria jonë, veçanërisht për ju, të dashur motra dhe vëllezër kosovarë, dëshërojnë që të zhduken krejtësisht hallet nga shtëpitë tuaja, të zhduket errësira, të lulëzojë në vatrat tuaja gëzimi, dashuria, dituria. Ju do të keni çdo ndihmë nga ne. Unë do të jem i lumtur, t'ju përmbush, në rast se ju do të keni ndonjëherë, ndonjë nevojë për mbarëvajtjen e kooperativës suaj.

Sa shumë u gëzova që ju i vutë kooperativës suaj emrin e Bajram Currit, të heroit të lavdishëm të popullit shqiptar, të luanit të pamposhtur të Dragobisë, kujtimin e të cilit çdo shqiptar e mban në zemër.

Pra, të dashurit e mi, mbajeni lart emrin e Bajram Currit dhe me flamurin e Partisë sonë, që ishte dhe flamuri i Bajram Currit, pra, me këtë flamur, që u realizuan ëndrrat e këtij patrioti të madh, ju të ecni përpara në rrugën e begatisë dhe të përparimit.

Unë kam bindjen e plotë se Kooperativa «Bajram

Curri» do të dalë në radhën e parë të kooperativave të rrethit, pse kosovarët janë njerëz të zgjuar, njerëz trimë e punëtorë.

Ju përqafoj me mall ju dhe të gjithë vëllezërit e tjerë kosovarë, që s'janë në kooperativë. U bëni atyre shumë të fala nga unë. Ju këshilloj t'i doni ata, t'i ndihmoni, ani se s'janë futur në kooperativë. Ata janë vëllezërit tanë, nesër dhe ata do ta gjejnë rrugën e kooperativës, ashtu si gjen zogu folenë e tij. Ju uroj me gjithë shpirt suksese të mëdha!

I juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË KOOPERATIVA NUK MUND TË KEMI REZULTATE TË MIRA PA FORCIMIN ORGANIZATIV TË TYRE

*Nga fjala në Konferencën e 8-të të Partisë  
të rrethit të Fierit*

4 mars 1958

Ju transmetoj përshëndetjet e Komitetit Qendror të PPSH dhe ju përgëzoj ju, përfaqësues të organizatës së Partisë të rrethit të Fierit, për punën e mirë që keni bërë për kryerjen e detyrave që ju kanë ngarkuar Partia dhe populli. Rezultatet e punës suaj gjatë vitit 1957 kanë qenë të kënaqshme. Kjo konferencë do të ketë rëndësi jo vetëm sepse u mbledh në kohë për të shtruar vendimet e fundit të Komitetit Qendror të Partisë, analizoi mirë punën që është bërë duke shënë llogari se si janë kryer detyrat, por sepse ajo do të përcaktojë edhe detyra të reja për të ardhshmen. Këtu u shkëmbye dhe eksperiencë. Konferencat kanë karakterin e një shkollë të madhe, prandaj ato duhen pre-gatitur e zhvilluar mirë. Unë përfitova shumë si nga kontaktet që pata me anëtarë partie, punëtorë etj. edhe

nga diskutimet e këtushme, të cilat do të më shërbejnë mjaft në punën time. Punimi i vendimeve të fundit të Komitetit Qendror në këtë konferencë u bë mirë. Prej tyre ju nxorët mësim dhe në bazë të atyre, me diskutimet tuaja, ju hapët perspektiva të reja për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar, duke e parë situatën e tanishme dhe të ardhshmen e vendit tonë me optimizëm.

Partia dhe populli ynë janë në korrent të situatës ndërkombëtare dhe e dinë si përpiqen armiqtë të pengojnë punën tonë, aq më tepër kur përballë popullit tonë qëndrojnë armiq të tërbuar siç janë imperialistët. Kjo s'duhet harruar për asnjë çast. Siç e dini, brenda një periudhe të shkurtër, bota ka kaluar dy luftëra. Me luftë borgjezia kërkon të pasurohet në kurriz të popujve, prandaj dhe i përgatit ato. Pas Luftës së dytë botërore shfrytëzimi i popujve nga imperializmi, kudo që sundon ai, u bë më i rëndë, varfëria dhe papunësia u shtuan, vetëm në SHBA ka sot 6 000 000 të papunë. Shtetëzimet e bëra gjoja pas Luftës së dytë botërore në vendet kapitaliste dhe që propagandohen me aq forcë nga përfaqësuesit e borgjezisë e veglat e saja, disa shokë komunistë i konsiderojnë si masa në favor të popullit, po në fakt nuk është ashtu. Qeveritë borgjeze shtetëzuan ato industri që qenë shkatërruar nga lufta ose që kishin falimentuar qysh më parë, bile edhe këto ua paguan kapitalistëve, mandej u dhanë këtyre koncesione që të ndërtonin fabrika të reja. Kështu ndodhi p.sh. në Francë etj. Po këto fabrika të reja drejtoheshin përsëri nga po ata kapitalistë. Pra këto «shtetëzime» nuk qenë gjë tjetër veçse manevrime për të mashtruar

popullin. Imperialistët përsëri po ecin në rrugën e armatimit e të fashistizimit. Ata e shohin që nuk e shtypin dot lëvizjen revolucionare të popujve dhe mundohen të organizojnë dhe të bien në fuqi përsëri fashizmin duke e inkurajuar e ndërsyer atë kundër vendeve të tjera veçanërisht kundër vendeve socialiste. Imperializmi amerikan, prej kohësh, ka pasur si synim që Gjermaninë ta fuste në kthetrat e veta dhe ta drejtonte nga të donte për qëllimet e tij dhe këtë e ka realizuar sot me Gjermaninë Perëndimore, ku Adenauer<sup>1</sup> është lidhur ngushtë me Amerikën duke e bërë RFGJ vatër lufte kundër socializmit, një vatër të rrezikshme për paqen në botë. Imperializmi amerikan futi nën zgjedhën e tij edhe kapitalet angleze, franceze etj. Ai kërkoi që edhe në Indonezi e gjetkë të krijojë vatra të reja lufte.

Imperializmi, veçanërisht ai amerikan, kudo që sundon ka krijuar baza ushtarake. Ai përdor shuma kolosale për armatime dhe përgatitjet e tija për luftë janë të mëdha. Por imperialistët s'duhet të harrojnë se bombën me hidrogjen e shpiku edhe BS, i cili sot ka edhe raketën balistike ndërkontinentale, sputnikun, të cilin e realizoi me sukses, ndërsa sputniku i tyre dështoi disa herë me radhë. Këto e kanë tronditur imperializmin dhe propagandën e tij, i cili më parë e frikësonte botën me fantazmën e luftës e të armëve atomike.

Në Amerikë propaganda antisocialiste është shtuar

---

<sup>1</sup> K. Adenauer (1876-1967) — Kancelar i RF Gjermane (1949-1963), ndoqi politikën e militarizimit e të revanshizmit dhe e futi Gjermaninë Perëndimore në NATO.

shumë. Kështu p.sh. një gazetë që ka 300 faqe, pothuajse në të gjithë artikujt kryesorë të saj s'ka asgjë tjetër veçse propagandë kundër vendeve socialiste. Punëtori amerikan nuk e lexon dot të gjithë këtë gazetë kaq të madhe, por ai u hedh një sy titujve, të cilët janë plot shpifje, por megjithatë realitetin e vendeve socialiste s'e mbulojnë dot.

Sot imperializmi ndërhyt atje ku gjen pozita të dobëta. Vendet arabe sot janë bërë pikë nevralgjike për imperializmin, sepse ato luftojnë për pavarësi. Në këto vende ka pasuri të mëdha, sidomos naftë, për këtë arsye amerikanët duan që të qëndrojnë vetë atje. Në Algjeri, Franca po bën mizori si Gjermania hitleriane, por algjerianët po luftojnë heroikisht kundër kolonizatorëve francezë.

Uniteti i vendeve arabe ka rëndësi. Naseri etj. janë përfaqësues të borgjezisë, por qëndrimi i tyre është nacionalist. Ata duan të rrojnë në miqësi me vendet socialiste, kjo është progresive. Arabët kanë dominuar shkencën në mesjetë. Më vonë ata patën decadencë. Kur u zhvillua kapitali dhe u kolonializuan, u shtypën dhe u varfëruan, por ata më parë rronin me ëndrrën e së kaluarës, ndërsa sot janë ngritur e po ngrihen për të hequr qafe zgjedhën e huaj.

Imperialistët tani po bëjnë të tjera plane; ata po nxitin Irakun kundër Sirisë dhe Egjiptit.

Qëndrimi i qeverisë sonë, sipas udhëzimeve të Partisë sonë, ka bërë që marrëdhëniet me Greqinë të normalizohen. Nuk është çudi që ne me atë të lidhim edhe marrëdhënie diplomatike. Kur u bë takimi në Korfuz me përfaqësuesit grekë për të shikuar çështjen



e pastrimit të kanalit të Korfuzit ata mbetën shumë të kënaqur nga qëndrimi i njerëzve tanë.

Partia dhe qeveria jonë kanë zbatuar dhe zbatojnë politikën e fqinjësisë e të marrëdhënieve të mira shtetërore edhe me Jugosllavinë. Po kurrë nuk u kemi bërë e nuk do t'u bëjmë asnjë lëshim në parim udhëheqësve revizionistë jugosllavë. Ne u kemi thënë dhe u themi atyre të heqin dorë nga qëndrimi i tyre në dy karrige. Ata kanë marrë shumë borxhe nga Amerika dhe vetëkuptohet që ajo nuk ua ka dhënë qorrazi, por sepse në Jugosllavi ajo ka synimet dhe interesat e saj. Një gjë të tillë vendet me të vërtetë socialiste nuk e pranojnë kurrë, ata nuk kanë nevojë për ndihmën amerikane, ata janë në gjendje ta ndihmojnë vetë njëri-tjetrin.

Sot në Jugosllavi janë krijuar sisteme të ndryshme organizimi. P.sh. në çdo kooperativë apo fshat lejohet të ngrihet një dyqan ose më shumë dhe se kush bën politikën e çmimeve nuk dihet. Atje ngrihen çmimet sa duan dyqanxhinjtë duke spekuluar në kurrizin e popullit. Ata e nisën kolektivizimin, por tani e shkatërruan. Ne nuk jemi të një mendimi me këtë veprim të tyre dhe kjo është çështje parimore. Ata na akuzojnë se gjoja ne i marrim çështjet shablon nga BS, kjo nuk është e vërtetë. Ne nuk i kemi zbatuar e nuk i zbatojmë shablon parimet, por i kemi zbatuar e i zbatojmë ato sipas kushteve tona konkrete duke pasur gjithmonë parasysh edhe eksperiencën e BS.

Propaganda revizioniste vjell vrer kundër vendit tonë, prandaj duhet të hapim sytë. Ndaj elementëve revizionistë etj., që kanë shpresa te Jugosllavia, të jemi vigjilentë. Midis këtyre ka pasur edhe njerëz që janë

gabuar nga ajo, që janë rrëmbyer, prandaj sa më i rrëmbyer të jesh, më keq është, sa më gjakftohtë, më mirë. Me këta të punojmë për t'i bindur që të korrighohen e të kthejnë rrugë, por edhe këta duhet t'i kemi gjithmonë në sy edhe atje ku i ka çuar Partia për të dhënë prova. Disa të tjerë Partia i ka ndihmuar shumë, por ata kohët e fundit e treguan hapët qëllimin e tyre. Ata donin të rrëzonin udhëheqjen e Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë. Armiku Bedri Spahiu është shprehur se «më mirë të mos kishte ekzistuar Partia», por këtij iu dha grushti.

Sot situatat kanë ndryshuar. Revolucioni socialist i Tetorit, që tronditi botën kapitaliste, u mësoi popujve rrugën e luftës për liri.

Vendet socialiste po ecin përpara çdo ditë dhe këtë e tregon faktori ekonomik, i cili luan rol të madh në ndërgjegjen e njerëzve. Politika e kampit socialist është politikë paqeje. Partitë komuniste e punëtore të kampit tonë socialist i udhëheqin popujt e tyre për ndërtimin e socializmit.

Tani imperializmi amerikan është jo vetëm përballë forcës sonë, por ai gjen vështirësi e pengesa të mëdha edhe nga populli i tij në realizimin e qëllimeve të veta. Edhe ndërmjet vendeve kapitaliste ka kontradiktat të mëdha. Kështu p.sh. Italia, Gjermania etj., sado që kanë marrë para nga Amerika, nuk duan që kapitali i tyre të vejë në arkat e kapitalistëve amerikanë; po kështu midis Anglisë dhe Francës ka kontradiktat, sepse secila përpiqet të forcojë pozitat dhe interesat e veta. Edhe qëndrimi ndaj çështjes së konferencës së nivelit të lartë për të cilën, amerikanët heshtin, kurse

anglezët kërkojnë të bëhet, tregon hapur kontradiktat që ekzistojnë midis tyre. Kjo konferencë, ku do të diskutohen probleme me rëndësi që kanë të bëjnë me uljen e tensionit dhe evitimin e luftës, do të bëhet, por se kur nuk dihet, veç një gjë dihet: koha punon për ne. Kampi i imperializmit i shtyrë nga presioni i popujve është i detyruar të shkojë në këtë konferencë. Politika e forcës e ndjekur nga imperialistët do të dështojë. Mao Ce Duni ka thënë se faktet provojnë që nuk është më i fortë ai që ka më shumë çelik; më i fortë është ai që di pse lufton. Kështu shpjegohet lufta në Kore, luftë e ndezur nga imperialistët amerikanë, të cilët u thyen nga populli korean dhe vullnetarët kinezë. Kështu shpjegohet lufta në Egjipt etj., nga ku imperialistët ikën me turp se ndeshën përpara forcës së popullit arab, i cili gëzon përkrahjen e kampit të paqes.

Armiku tani na lufton edhe ideologjikisht. Ai do që ta përçajë Partinë tonë, prandaj duhet të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj imperializmit e revizionizmit që përpiqen t'ia rrëmbejnë fitoret popullit. Ata kanë zhvilluar dhe zhvillojnë propagandë të madhe me shpifje e shantazhe kundër vendit tonë socialist, por ato nuk u pinë ujë dhe kur ata e shohin se nuk fitojnë gjë nga kjo anë, përdorin metoda të tjera si hedhje diversantësh etj., por edhe këta janë zhdukur, ose janë kapur nga vetë populli. Tani ata mundohen të gjejnë forma të tjera ndërhyrjesh dhe një nga këto është përpjekja për të mbjellë te ne ideologjinë e tyre. Ne duhet të jemi vigjilentë ndaj këtyre formave e të jemi të gatshëm që t'i zhdukim menjëherë sëmundjet që mund të shfaqen. Politika e Partisë sonë ka bërë që planet e tyre të dësh-

tojnë, armiqve të popullit t'u këputet koka dhe ne të kemi suksese në planet tona. Por gjithmonë sytë duhet t'i bëjmë katër se imperializmi e revizionizmi nuk pushojnë së kryeri veprime agresive, prandaj duhet të jemi të gatshëm në këtë drejtim për t'iu përgjegjur në çdo moment që ata do të na cënojnë. Luftë e përgjithshme mund të mos pëlcasë, por ne duhet të jemi çdo vit më të fortë, ne duhet të jemi akoma më vigjilentë, kjo ka qenë, është dhe do të jetë edhe në të ardhshmen politika e Partisë sonë.

Plani i vitit 1957 në përgjithësi u realizua në çdo sektor, por duhet të kemi parasysh se ka pasur edhe dobësi, si në mosshfrytëzimin e plotë të mjeteve që disponojmë etj., kjo sepse nuk është organizuar mirë puna. Plani në naftë është realizuar. Sakrificat e punëtorëve nuk kanë shkuar kot megjithëse duhet të kërkonim edhe më. Pusi i Marinëzës realizoi planin e pesëvjeçarit të naftës që më 1957. Ky pus na ka vënë para detyrash të reja. Vendit tonë nga ky pus i vijnë dy të mira: nga njëra anë do të thahet kënetat e Roskovecit dhe nga ana tjetër do të fitohet edhe naftë. Kënetat e Roskovecit do të kthehet në flori. Nafta do të jetë pasuri e madhe dhe si rrjedhim do të rritet mirëqenia e popullit. Sot kemi dy rafineri naftë, më vonë do të kemi edhe të tjera, se ku do të bëhen, kjo nuk ka rëndësi, por Fieri me hovin që ka marrë sidomos me pambukun, nuk do të mbetet pa fabrika. Gazi do të shfrytëzohet, por me kohë, sot kemi halle të tjera dhe nevoja na detyron të mendojmë për çdo gjë, në të ardhshmen mendojmë që me gaz do të punojnë edhe disa fabrika. Ne kemi nevojë për plehra kimike se pa pleh nuk mund të marrim rendimente të

mira në bujqësi si në pambuk etj. Edhe këto do të sigurohen në të ardhshmen. Këto janë perspektiva që na i ka hapur Partia. Ata që nuk na donin janë përpjekur ta pengonin zhvillimin e industrisë në vendin tonë deri në vitin 1948, duke u ndihmuar edhe nga politika armiqësore e Koçi Xoxes etj., të cilët u vunë në shërbim të revizionistëve jugosllavë. Më vonë edhe Tuk Jakova e Bedri Spahiu u munduan të na pengonin me veprimtarinë e tyre armiqësore, por Partia i dënoi veprimet e tyre, çështjeve u dha rrugëzgjdhje, ndërsa atyre u ra kokës.

Industria e kromit, e bakrit etj., janë pasuri e madhe, për këtë të fundit do të ngremë një fabrikë tjetër. Në malet tona të Jugut ne po kërkojmë fosforite dhe po i gjetëm, këto do të jenë një pasuri e madhe se do të plotësojmë nevojat e vendit dhe do të eksportojmë edhe jashtë. Kërkimet dhe studimet e deritanishme tregojnë se kemi rezerva të mira hekuri e nikeli. Në të ardhshmen do të ngremë industrinë e shkrirjes së hekurit dhe fabrikën për të ndarë hekurin nga nikeli. Vendit tonë i duhet energji elektrike, për këtë kemi planifikuar ngritjen e dy hidrocentraleve<sup>1</sup>, një në Jug dhe një në lumin Mat, nën Hidrocentralin «Karl Marks».

Për të realizuar të gjitha këto duhet një organizim më i mirë i punës dhe, veçanërisht me këtë industri që do të ngremë, na duhen shumë kuadro. Kuadrot tanë sot janë të aftë, ata po drejtojnë, po forcohen çdo ditë,

---

<sup>1</sup> Është fjala për hidrocentralet: «J. V. Stalin» dhe «F. Engels».

por këtu duhet ecur krahas me nevojat e kohës, prandaj edukimi dhe zhvillimi akoma më tepër i kuadrit, ka shumë rëndësi sepse me atë do të zgjidhen shumë probleme.

Industria e lehtë si ajo ushqimore, e përpunimit të rrushit, e frutave etj. do të ngrihet brenda tre vjetëve të ardhshëm. Në këtë drejtim del detyrë të punojmë për shtimin e pemëve dhe t'i vlerësojmë si duhet ato. Krahas ngritjes së fabrikave të reja, qeverisë i është dhënë orientim të ndryshojë gjendjen e fabrikave tona ekzistuese nga primitive në moderne. Natyrisht të gjitha këto fabrika ngrihen për të përmirësuar jetesën e popullit.

Planet e ndërtimeve tona janë të mëdha dhe të rënda, këtë e dimë, por me sakrifica me siguri do t'i realizojmë. Fshatarësia duhet të marrë pjesë në këto punë duke dhënë kontributin e saj sidomos në hapjen e kanaleve dhe konkretisht këtu në Fier të punohet për bonifikimin e Hoxharës etj. Po nuk u mbajtën mirë kanalet do të kemi dëme. Le të marrim si shembull Durrësin, i cili përpara merrte rendimente të ulëta, tani me hapjen e kanaleve të reja, ai po merr rendimente të larta në bujqësi. Partia na ka porositur të hapim edhe toka të reja, bile sa më shumë, prandaj të mos lihet mënjane kjo çështje, ndryshe ju do të jeni përgjegjës përpara Partisë për këto gjëra. Populli ynë nuk është kursyer dhe nuk do të kursehet sa herë t'i bëjë thirrje Partia. Suksesi në këtë drejtim varet nga organizimi e drejtimi i punës, nga studimi i çështjes, nga shpërndarja e forcave etj. Të gjithë duhet ta kuptojmë drejt se pa pjesëmarrjen e fshatit ndërtimet nuk arrihen.

Për ndërtim banesash janë planifikuar fonde të mira, por megjithatë strehimi akoma nuk ka gjetur zgjidhje. Kjo ndodh edhe në BS që sot, sipas gazetës, kanë arritur që muret e godinave të bëhen të parafabrikuara. Çështja e strehimit është problem preokupant për Partinë dhe qeverinë, prandaj del detyrë që ndërtimet të bëhen jo vetëm me shumicë, por edhe me cilësi të mirë. Në fshat mirë është që të bëhen banesat me dy kate, për të mos zënë shumë tokë, megjithëse akoma s'ka material ndërtimi. Por duhen shfrytëzuar mirë mbeturinat. Për tavane të përdorin edhe kallamin, sepse atë e përdorin edhe vende ku ai është shumë herë më i hollë se kallami i vendit tonë.

Komiteti Qendror e ka orientuar qeverinë që privatëve t'u japë fonde për të riparuar shtëpitë e tyre sepse janë duke na u dëmtuar banesat. Komiteti ekzekutiv i rrethit të jetë më rigoroz në shpërndarjen e këtij fondi. Një rrugë tjetër për çështjen e strehimit është puna që duhet bërë me disa që të shkojnë në fshat, atje ku çdo ditë e më shumë po shkon përparimi, ndërsa atyre që kanë braktisur fshatin të mos u bëhet pasaportizimi. Kjo politikë, natyrisht duhet të ndiqet me kujdes. Sa për këta të fundit, s'ka diskutim, çdo njeri duhet t'u bindet ligjeve të pushtetit popullor. Me gjithë vështirësitë e mëdha për strehim, të kihet kujdes që njerëzit e sëmurë të strehohen në vende të përshtatshme, të mundohemi t'i shpëtojmë njerëzit, ta ruajmë dhe ta zgjatim jetën e tyre.

Detyra të mëdha na vihen përpara që planet tona të realizohen me sukses. Këto plane jo vetëm që do të përmirësojnë jetën e popullit, por do të krijojnë edhe

bazën për të realizuar plane të tjera perspektive, që kanë parashikuar Partia dhe qeveria.

Partia kujdeset që bujqësia jonë të përparojë, të bëhet një bujqësi moderne, sepse nga ajo varet dhe realizimi i planeve në sektorët e tjerë të ekonomisë. Plani i dytë pesëvjeçar shtron detyra të mëdha për shtimin me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Sipas këtij plani bujqësia ka detyra shumë të mëdha pasi standardi i jetesës brenda këtij pesëvjeçari duhet të ngrihet nga 25 për qind që ishte parashikuar në 35 për qind për punëtorët dhe nëpunësit, ndërsa për fshatarësinë nga 35 për qind në 45 për qind. Kjo bën të nevojshme prodhimin e sendeve ushqimore në sasi të konsiderueshme, pikërisht këtu qëndron një nga detyrat kryesore të bujqësisë. Janë të gjitha mundësitë që këto detyra të kryhen me sukses.

Rrethi i Fierit ka peshë të rëndësishme në ekonominë tonë, veçanërisht për bujqësinë. Partia dhe qeveria si deri sot do t'i japin ndihmë shumë më të madhe Fierit. Rezultatet e vitit 1957 në bujqësi kanë qenë të kënaqshme, në drejtim të prodhimit të pambukut, të grumbullimit të detyrimeve dhe të tepricave, të ndërzimit artificial të dhënve që u realizua 156 për qind si dhe për mbjelljen e pemëve frutore ku ju jeni shembull për rrethet e tjera. Siç konstatohet nga raporti, nga diskutimet në këtë konferencë dhe nga kontaktet që kam pasur me popullin, fshatarësia juaj, me në krye Partinë, është mobilizuar seriozisht në këto drejtime. Këto rezultate kanë ngjallur kudo kënaqësi. Por këtu u vunë në dukje edhe dobësitë e vërtetuara. Sikur rezultatet e kënaqshme të mjaft kooperativave t'i kishin arritur të



gjitha kooperativat, do të kishim rezultate akoma më të mëdha. Kështu ishin të gjitha mundësitë të punonin edhe të tjerët si brigadat e dalluara të Verrisë, të Cakranit etj.

Zotimet këtu u morën me seriozitetin më të madh. Në shtëpitë e atyre që morën këto zotime unë pashë optimizëm të plotë, kjo tregon se ne kemi mundësi për rezultate akoma më të mëdha, në mënyrë të veçantë për pambukun, për të cilin duhet të rritet sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë ashtu edhe rendimenti. Edhe për duhanin janë mundësitë që të shtohet sipërfaqja dhe rendimenti. Kështu p.sh. kooperativistët e Zharrëzës, me gjithë vështirësitë që u dilnin kishin besim se zotimet do t'i realizonin. Unë kudo që vajta e pashë këtë besim. Tani varet nga organizimi, që këto të realizohen. Kështu edhe për kulturat e tjera duhet të shtohet sipërfaqja dhe rendimenti. Por rëndësi të veçantë rrethi juaj duhet t'i kushtojë pambukut, duhanit, misrit, grurit etj.

Pambuku nuk është kulturë e thjeshtë, por mjaft delikate që do shërbim dhe një interesim të madh duke filluar që nga organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth e deri te kultivuesi i thjeshtë. Pa këtë kujdes e interesim nuk mund të kemi rezultate në këtë kulturë. Për këtë duhen njerëz të mësuar dhe këta duhet të nxirren nga praktika, sepse jemi të varfër në këtë drejtim. Ne kemi kryetarë, brigadierë e kooperativistë që drejtojnë e luftojnë me heroizëm, eksperiencën e të cilëve duhet ta përhapim. Gjithashtu duhet të mësojmë nga punonjësit e përparuar siç është p.sh. një brigadier në Cakran, i cili mori 17 kv. pambuk për ha., dhe në

një parcelë, ku siguroi 110 mijë bimë për ha., mori 29 'kv. pambuk për ha. Ai di shumë mirë strukturën e tokës, tregon kujdes në zgjedhjen e farës etj. Ai nxjerr mësim se si dhe kur duhet punuar toka, se si dhe kur e do ujin bima, po kështu edhe për shërbimet e tjera. Te ne ka shumë brigadierë e kooperativistë me eksperiencë të madhe. Por është e nevojshme që kjo eksperiencë të përhapet që të mësojnë edhe të tjerët nga praktika e punës së më të mirëve, nga eksperiencia e bujqve të përparuar, të cilët i kemi të shumtë.

Edhe kultura e misrit nuk duhet nënvleftësuar se ka rëndësi të madhe për shtimin e prodhimit të bukës si dhe për ushqimin e bagëtive. Pa misër e silazh nuk mund të zhvillojmë lopën, derrin, shpendët dhe gjithë blegtorinë. Kjo kulturë është mjaft e lashtë te ne dhe ka një prodhimtari të lartë. Në shumë zona të vendit tonë merren 30-40 kv. misër e më shumë për ha., bile ky rendiment ka mundësi të rritet në qoftë se misrit do t'i bëhen shërbimet e duhura, sidomos prashitjet, për të cilat ka mendime se kjo kulturë s'ka nevojë për to, ose se i mjafton vetëm një prashitje. Sot për sot misri duhet në radhë të parë për ushqimin e popullit dhe pastaj për blegtorinë, e cila, duke pasur këtë si bazë ushqimore, trefishon rendimentin e prodhimit.

Sasi të mëdha prodhimi humbasin çdo vit nga mosorganizimi në shkallë të gjerë i luftës kundër krimbit të misrit. Shkulja ose prerja rrafsh deri në nyjen e fundit të kallamishtes së misrit, sipas urdhëresave në fuqi, për të evituar sëmundjet në këtë kulturë është masë e domosdoshme për luftimin e këtij insekti dëmtes. Prandaj duhet që të punohet me fshatarët për t'i

bindur që të veprojnë kështu. Në Kinë ato i shkulin jo vetëm për të luftuar krimbin, por nga ana tjetër për t'i përdorur edhe për djegie për të kursyer drurin dhe pyjet. Në Kinë partia hedh parulla në këtë drejtim dhe ato përqafohen nga i gjithë populli. Atje plehun e grumbulluar e çojnë në arë, nëpër hauze dhe prej andej ua hedhin me gram bimëve; kjo tregon rëndësinë e madhe që ata i kanë vënë plehërimin të kulturës së misrit dhe të gjitha bimëve.

Prodhim i madh mund të sigurohet edhe nga mbjelljet e dyta, nga mbjellja e misrit hamullor, të cilit duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur dhe të praktikohet sa më gjerë si për misër kokërr edhe për silazh. Për këtë është dhënë direktivë nga Partia dhe kjo çështje ka marrë rrugë të drejtë. Shokët e Kooperativës «Afrimi» më thanë se do të korrnin të lashtat dhe këtë tokë do ta mbillnin të gjithë hamullore. Ky është një sukses.

Edhe NBSH-të duhet t'i ndihmojnë kooperativat dhe t'u tregojnë atyre me fakte epërsinë e tyre, duke mbjellë më shpejt dhe në kushte më të mira.

Duhani ka rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Vendi ynë ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e tij si nga ana klimaterike edhe nga ana pedologjike. Populli ynë e njuh këtë kulturë. Por për kultivimin e tij duhet një kujdes më i madh duke filluar që nga punimi i tokës, mbjellja e deri te vjelja e manipulimi, se nga vetë kushtet e përmendura ne mund të konkurojmë edhe me fqinjët në drejtim të cilësisë. Çështjen e eksportimit të tij do t'ia shtrojmë edhe qeverisë që duhanin ta shesim jashtë cigare, sepse kështu do të kemi më tepër

leverdi ekonomike. Puna është të ndërtojmë fabrika për përgatitjen e tij. Cigaret jashtë kanë çmim të lartë dhe ne do të trefishojmë të ardhurat tona në krahasim me ato që marrim siç e shesim tani, kështu do të sigurojmë edhe punë për shumë gra; një fabrikë do të ngrihet në Durrës dhe cigaret do t'i bëjmë si të duan ata që do t'i blejnë me të cilët do të lidhim kontrata. Prandaj duhet parë kurdoherë edhe leverdia.

Kudo më thanë fjalë të mira për traktoristët. Kjo ne na gëzon. SMT-të janë faktor vendimtar për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, ato luajnë një rol të madh në ndërtimin e socializmit dhe në edukimin e masave fshatare, prandaj Partia dhe pushteti të marrin masa për të ndrequr të metat. Këtyre u takon të punojnë më tepër për forcimin e mëtejshëm të SMT-ve që ato të shfrytëzojnë plotësisht mjetet e shumta e të fuqishme me të cilat janë pajisur dhe të kuptojnë rolin e madh që luan mekanika për bujqësinë. Partia, organet e pushtetit dhe sidomos kuadrot dhe të gjithë punonjësit e SMT-ve të luftojnë akoma më shumë për realizimin e planit në të gjitha llojet e punimeve dhe ato të bëhen me cilësi më të lartë e me kosto sa më të ulët.

Kujdes i veçantë të tregohet për edukimin politik e profesional të traktoristëve. Shumë gjëra u thanë këtu dhe në plenum për traktorët, të cilët duhet të jenë në gatishmëri. Një brigadier i SMT-së në Cakran shumë mirë foli në kryesi për shtimin e mekanizimit dhe rezultatet e tij. Të tria SMT-të dhe fermat kanë kapacitet të tepërt, ato duhet të mos mbajnë shumë rezerva, por këto kapacitete t'i shfrytëzojnë në kooperativat më të largëta.

Lopa duhet të zhvillohet edhe më shumë, krahas me këtë e gjithë blegtoria. Ne duam të zgjerojmë fermat e lopëve në kooperativat tona, kjo do disa vjet. Dëshira për zhvillimin e lopës është e madhe dhe është kuptuar domosdoshmëria e saj si nga Partia dhe nga masat. Ky është sukses për ne, por megjithatë në këtë drejtim jemi prapá pse duhet të shtojmë numrin e tyre jo nga tregu i lirë, vlera e të cilit është rritur shumë, por nga oborret e kooperativistëve. Për këtë duhet të punojë më shumë Partia, ta bindë kooperativistin që t'ia japë viçin së ardhshmes së tij, kooperativës, dhe jo ta shesë në pazar. Populli, kur i ka bërë thirrje Partia, ka bërë sakrifica të mëdha për ndërtimin e Shqipërisë së re dhe këtë e tregojnë faktet. Kur shteti shpalli huatë shtetërore fshatari u tregua i gatshëm, sepse e ka kuptuar që pushteti është i tij dhe i shërben atij. Kështu duhet kuptuar edhe dhënia e viçave nga kooperativistët se kooperativa është e tyre dhe i shërben mirëqenies së tyre, prandaj viçat femra dhe mëshqerrat kooperativistët duhet t'ia shesin kooperativës dhe kjo, po pati fonde, të tejkalojë numrin e lopëve dhe më tutje.

Edhe kujdesi për lopën ka rëndësi. Raca e lopës sonë është e mirë dhe përmirësohet akoma më shumë me ushqime të përshtatshme për të. Por kryqëzimi i saj nuk duhet lënë mënjanë, krahas përmirësimit të kushteve të bëhet edhe përmirësimi i racës. Për lopën në radhë të parë duhet të sigurohet baza ushqimore nga 4-5 ton silazh për kokë. Rëndësi t'i kushtohet dhe strehimit të lopëve, stallat e tyre të jenë të thjeshta, të kushtojnë pak, për këtë shfrytëzoni mençurinë tuaj dhe do të dilni me sukses.

Në qoftë se do të merren këto masa, në konferencën tjetër ju, me siguri do të raportoni se janë marrë mbi 500-600 litra qumësht për çdo kokë dhe jo më pak.

I vini rëndësi çështjes së frutikulturës dhe olivikulturës se duke ua kryer mirë shërbimet këtyre do të ngrini nivelin tuaj ekonomik, kjo është një e ardhur e madhe jo vetëm për ju, por për të gjithë. Të ruhen pemët, Partia ta marrë më mirë në dorë këtë problem, me gjithë punën e madhe dhe sukseset që vihen re në këtë drejtim.

Te ju do të bëhen investime të mëdha. Për vitin 1958 janë parashikuar 12 000 000 lekë investime për ndërtime, ndërsa për vitin 1959 do të ketë akoma më shumë. Komiteti ekzekutiv i rrethit të ketë kujdes dhe të ndërtojë ujësjellësin, këtu parashikohen të ngrihen fabrika vere sidomos në Ballsh. Për shfrytëzimin e ujit të Vjosës duhen motopompa, këtë do ta studjojmë me shokët e Byrosë Politike. Qyteti i Fierit në të ardhshmen do të bëhet qytet i madh. Edhe në Roskovec do të ngrihen ndërtesa të reja, për të cilat janë investuar sasi të mëdha lekësh, po kështu në Levan e gjetkë. Për industrinë lokale të rrethit tuaj do të ketë investime të mëdha, prandaj përveç bujqësisë do të keni ndryshime edhe në këtë sektor, por ju duhet të shfrytëzoni çdo send me leverdi ekonomike deri te zhuga, dafina etj.

Problem tjetër është se ne duhet të mendojmë seriozisht për kuadrot, të cilët sot nuk i kemi të mjaftueshëm. Kuadri është ai që luan një rol kryesor në drejtimin e ekonomisë, prandaj del detyrë të organizohen

kurse dhe konferenca atje ku punojnë ata. Partia të mendojë forma pune dhe t'i përgatitë ata në punë e sipër. Një punë e tillë do të bëjë që ne të kemi rezultate. Ata që vazhdojnë shkollat me korrespondencë të venë rregullisht në to dhe të japin provime dhe jo siç ka ndodhur me disa shokë që e kanë neglizhuar ndjekjen e shkollës. Shembullin e mirë të Baftjar Jonuzit ta ndjekin të gjithë shokët.

Partia t'i japë rëndësi të madhe sidomos edukimit agroteknik të masave të kooperativistëve. Të organizohen e të frekuentohen në rregull kurse të ndryshme pranë kooperativave bujqësore, konsulta në shkallë zone ose rrethi, si dhe konferenca për probleme të veçanta të bujqësisë, blegtorisë, frutikulturës etj. Rëndësi ka që në këto forma të lidhet mirë ana teorike me punët konkrete të praktikës së prodhimit. Të arrijmë të kemi specialistë në çdo kooperativë për kulturën e pambukut, duhanit, misrit, për shfrytëzimin e ujit, për frutikulturën, vreshtat, ullirin, për rritjen e lopëve etj.

*Kam edhe disa këshilla për kooperativat bujqësore:*

Këtë vit kemi shpresa të kolektivizohet i gjithë fshati i Myzeqesë, këtë e morët edhe ju angazhim. Shokët e Drizës dhe të Zhupanit e panë edhe vetë këtu në konferencë se si luftojnë komunistët për të kryer kolektivizimin. Kudo që vajta u vinte keq për punën jo të mirë që bënin shokët e Drizës e të Zhupanit dhe i kritikonin ata pse bëheshin pengesë për kolektivizimin. Unë jam rigoroz për çështje të Partisë. Kur u morën masa nga byroja e Partisë për përjashtimet e shumta unë kam influencuar pranë Byrosë Politike që të kthe-

heshin disa masa sepse ato qenë të shumta, por këto janë çështje partie dhe s'duhën bërë lëshime. Shokët e Drizës ta gjykojnë vetë këtë. Sot në kooperativë hyjnë jo vetëm fshatarët e varfër, por edhe të mesmit, sepse ata të tillë janë bërë në saje të Partisë, e jo më komunistët. Në kooperativë i japim popullit bukë, pemë etj. më shumë se sa i japim individualisht. Prandaj të mos shikohet vetëm interesi i ngushtë personal. Të gjithë e duan delen edhe lopën, por fshatrat fqinje e përqa-fuan fjalën e Partisë, ngritën kooperativat, përmirësuan pyjet dhe kullotat dhe bagëtive po u japin silazhe, kë-shtu duhet të veprojnë edhe shokët e fshatrave që për-menda më lart.

Kujdes i veçantë t'i kushtohet futjes së anëtarëve të rinj në kooperativat ekzistuese.

Ajo që ka shumë rëndësi në kooperativat bujqësore është forcimi organizativ i tyre për të cilin duhet të preokupohet seriozisht Partia. Pa forcimin organizativ të kooperativave nuk mund të kemi rezultate të mira në to. Që të realizohet ky forcim duhet të organizohet më mirë ndarja e punës në brigada dhe skuadra, si dhe në feramat blegtorale të kooperativës; të synohet që gradualisht të zmadhohen brigadat dhe këto të funksionojnë mirë si njësi bazë e prodhimit kooperativist, të luftohet për zbatimin me përpikëri të statutit dhe të rregullores së brendshme dhe të sigurohet pjesëmarrja në punë e të gjithë anëtarëve.

Në kryesi të zgjidhen njerëzit më të mirë, më me inisiativë dhe të provuar në luftën për socializmin, ata që nuk flenë mbi dafina, njerëz me vullnet, të besuar e të ndërgjegjshëm, ata që kryejnë mirë detyrat e më-



dha e shumë të ndërlikuara të ekonomisë së përbashkët, që ndihmojnë kryesinë dhe asamblenë. Të mos nënvlef-tësohet në asnjë mënyrë mbledhja e përgjithshme e kooperativës, por të dëgjohet mirë fjala e saj. Vendimet të merren nëpërmjet saj dhe për zbatimin e këtyre vendimeve të luftojë gjithë Partia, sekretari i organizatës bazë, kryesia dhe kryetari i kooperativës. Sado i zoti të jetë një kryetar, ai do të bjerë shpejt në qoftë se do të veprojë vetëm me kokën e tij, pa përfillur kryesinë dhe mbledhjen e përgjithshme. Kooperativa është një ekonomi e madhe socialiste, e cila duhet zhvilluar në bazë të një plani të studjuar mirë dhe me perspektivë, duke i dhënë rëndësi zhvillimit të gjithanshëm të degëve të ndryshme, në mënyrë që të sigurohen sa më shumë të ardhura jo vetëm nga bujqësia, por edhe nga blegtoria, frutikultura dhe ekonomitë ndihmëse. Prandaj, kërkohet të luftohet për një drejtim me nikoqirllëk, si në planifikimin e ditëve të punës për sektorët dhe kulturat e ndryshme ashtu edhe për shpenzimet e tjera.

Shumë rëndësi ka edhe ana financiare në kooperativë për të cilën duhet të tregohet kujdes i madh dhe të vlerësohet drejt roli që duhet të luajë llogaritari, i cili duhet të jetë njeri i zgjuar, i kujdesshëm dhe dora e djathtë e kryetarit. Nuk mjafton vetëm që ai të shkruajë shifra, por të nxjerrë çështje, konkluzione dhe ato t'ia shtrojë kryesisë për t'i studjuar duke shikuar gjithmonë leverdinë për shtimin e prodhimit e forcimin e kooperativës. Ai ka për detyrë të propozojë për të marrë masa konkrete atje ku punët nuk venë mirë. Për të tillë llogaritarë kanë nevojë kooperativat. Por kjo shpeshherë nuk ndodh kështu edhe për faktin se për llogaritarë,

nuk dërgohen në shkolla, njerëz të përshtatshëm, por ç't'u vijë për mbarë. Kjo duhet të vihet në rrugë të drejtë. Në shkolla, për llogaritarë, duhet të dërgohen njerëz të aftë. Edhe të ardhurat që derdhen në fondin e pandashëm të tejkalohen sepse kjo u lë në dorë kooperativave një shumë të konsiderueshme dhe me leverdi.

Ndërtimet të bëhen të studjuara dhe me llogari. Kryesia, kur harton planet, të mendojë mirë se ç'do të bëjë, duke ia përshtatur shpenzimet gjendjes së kooperativës edhe asaj të anëtarëve.

Detyrimet e shtetit të plotësohen në rregull. Nga të ardhurat e kafshëve që shiten nga kooperativat nuk po derdhet gjë në fondin e pandashëm, kjo nuk është e drejtë, prandaj të respektohen rregullat. Ju duhet të regjistroni më shumë në sigurimet shoqërore.

Kur bëni planet e prodhimit mos lini jashtë asnjë aktivitet të mundshëm duke mos lënë pasdore kështu edhe artikujt e tjerë që do t'ju ndihmojnë shumë në zhvillimin e ekonomisë. Ky zhvillim të shkojë që nga prodhimet bujqësore deri te bleta, pula etj. Bleta është shumë e leverdisshme. Është mirë t'u jepet kalamanëve dhe pleqve më shumë mjaltë sepse ky u forcon organizmin. Këto gjëra t'i diskutoni atje në kooperativë me kalem në dorë duke pasur parasysh interesin tuaj dhe të shtetit.

Të gjitha llojet e punimeve, si prashitja e të tjera duhet t'i mekanizoni sepse do të kenë fitime të mëdha dhe forcat e punës që lirohen t'i planifikoni në sektorët e tjerë ndihmës. Rrethi duhet t'i studjojë me kujdes planet tuaja dhe të orientojë sipas nevojave të vetë rrethit dhe të Republikës. Nga studimet ai duhet të nxjerrë

detyra dhe në fund të dalë me konkluzione për marrjen e masave, për dhënie ndihme etj. vetëm kështu ai do të ndihmojë konkretisht kooperativat.

Plehrave t'u jepet rëndësi me qëllim që asnjë kilogram pleh organik të mos shkojë kot sepse ky do të sigurojë të ardhura të mira për kooperativat.

Shkolla ka rëndësi të madhe që nga fillorja deri te e larta. Prandaj, edukimit të njerëzve t'i vëmë rëndësi. Kujdesi i Partisë dhe i qeverisë në këtë drejtim është i madh, por, ashtu si u tha edhe këtu, mjaft këshilla popullore në fshat nuk kujdesen për shkollat dhe arësimitarët. Pra, në këtë drejtim të jemi më të vëmendshëm se, siç e patë, në fund, duke u folur për këtë problem, shumë prej nesh na dhëmbi koka. Roli i mësuesit nuk çmohet si duhet. Ju nuk u keni siguruar as strehim arësimitarëve, si shpjegohet që Partia të interesohet edhe për derrat dhe ju të mos tregoni kujdes as për fëmijët? Një gjendje e tillë është e pakuptueshme dhe duhet ndryshuar menjëherë. Problemet e ekonomisë janë tani të ndërlikuara dhe nuk mund të zgjidhen pa dije, pa shkollë. Përpjekjet e Partisë dhe të qeverisë për edukimin e kuadrit janë të mëdha, por edhe kooperativat duhet të japin kontributin e tyre. Në radhë të parë fëmijët e kooperativistëve të ndjekin shkollat 7-vjeçare dhe pastaj të dërgohen në teknikumet bujqësore si dhe në shkolla të tjera teknike dhe të arësimit të përgjithshëm. Në këtë mënyrë çdo kooperativë, sipas një plani, të sigurojë, kryesisht, me shpenzimet e saj kuadrin e mesëm të nevojshëm. Njëkohësisht, të dërgohen nga djemtë dhe vajzat më të mira edhe në institutet e larta. Partia dhe organet e pushtetit të interesohen që

të marrin arësim 7-vjeçar dhe më vonë arësim të mesëm pa shkëputje nga puna edhe kuadrot drejtues të kooperativave bujqësore e sekretarët e organizatave bazë të Partisë. Nga ana tjetër një punë e madhe të bëhet për aktivizimin e intelektualëve e në mënyrë të veçantë të mësuesve, në ndihmë të fshatit. Organizata e Partisë dhe kryesia e kooperativës të punojnë me mësuesin e fshatit, ta lidhin atë me ekonominë e fshatit, ta afrojnë atë, ta thërrasin edhe në mbledhjen e asamblesë ose të kryesisë; ai duhet medoemos sepse na edukon brezin e ri, ai duhet të marrë pjesë në këto mbledhje, të njohë edhe problemet ekonomike të kooperativës, pse kështu ai mund t'ua futë më lehtë në shpirt fëmijëve tanë ato çfarë shikon e dëgjon atje.

Mësuesit janë intelektualë, ata duhen ndihmuar, ata nuk dinë se si rron dhe ç'kërkesa ka lopa dhe nuk u flasin konkretisht fëmijëve për të, por ç'kanë lexuar në libër, ndërsa po t'i afrojmë dhe t'i mësojmë, ata do t'u flasin edhe më konkretisht. Mësuesi nga ana e tij duhet të nxitë prirjet dhe dëshirat e nxënësve, dashurinë për kooperativën, veçanërisht për bujqësinë dhe sektorët e saj të ndryshëm dhe kjo bëhet kur lidhet mirë mësimi me praktikën e punës. Nxënësit e fshatit duhet të bëhen specialistët më të mirë të bujqësisë sepse ata janë e ardhshmjat e kooperativës. Por këtë pasion në radhë të parë duhet t'ua edukojë mësuesi, i cili vetë duhet t'ua jetë futur mirë problemeve të ekonomisë kolektive. Dhe mësues të tillë në rrethin tuaj ka shumë si në Zharrëz, Gorishovë etj. që mbajnë lidhje të ngushta me kooperativën.

Të «sulmohet» nga fëmijët e rrethit të Fierit tekni-

kumi bujqësor dhe nga të rriturit, natën dhe me korrespondencë. Studimeve të kulturave t'u vihet rëndësi e madhe. Edukimi marksist-leninist ka rëndësi, por duhet që më me kujdes dhe më me pak frikë t'i futemi këtij problemi. Për komunistët nuk është e rëndë se kanë vullnet të madh dhe se njerëzit e Partisë janë në gjendje t'i kuptojnë këto parime që nuk janë veçse sintezat e luftës së tyre të përditshme.

Sot duhet marrë esenca e mësimit dhe jo t'i marrësh mësimit e Marksit, Leninit etj. shablon dhe të përgatitësh një referat. Prandaj, sektori i agjit-propit t'i përgatitë më mirë materialet për format e edukimit. Disa shokë duan të mësojnë, por mungojnë në format e arësimit, sepse nuk i kuptojnë çështjet dhe kur u bëjnë pyetje nuk u përgjigjen dot sepse nuk studiojnë. Propagandisti duhet të përgatitet mirë, ai duhet të dijë se me cilët njerëz ka të bëjë dhe çfarë kanë ata në kokë, mësimin ta bëjë të thjeshtë, të mos përgatitet dhe të referojë si papagall sepse kështu nuk përfitojmë gjë. Qëllimi i këtyre formave është të përfitojmë sa më shumë. Parimi ynë është e duhet të jetë që propagandisti t'u japë shokëve të Partisë në bazë, por të marrë edhe ai vetë nga ata. Të mos bëhen leksione të gjata, por të shkurtëra dhe të thjeshta. Komiteti Qendror ka dhënë udhëzime për të marrë masa në këtë drejtim. Çështjet ideologjike kanë rëndësi, se lufta ideologjike do të vazhdojë deri në shkatërrimin e imperializmit. Luftën kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja komunistët do ta bëjnë si duhet vetëm me një ngritje të lartë ideologjike.

Kritikat që u bënë këtu mua më pëlqyen, kjo tregon se niveli i organizatës suaj është i mirë. Që të

marrësh rrugë dhe ta vazhdosh atë deri në fund disa duhen shkundur, këtë ta bën kritika dhe autokritika që është parim themelor për komunistët. Por me këtë parim duhet të edukohen të gjitha masat, sepse ato kanë shumë nevojë për të, veçanërisht intelektualët.

Pse them veçanërisht intelektualët? Sepse ata, nga vetë natyra e punës lidhen edhe me borgjezinë edhe me fshatarësinë. Ata nuk e kanë armën materiale që kanë punëtorët, kazmën; arma e këtyre është puna mendore. Punëtorët e fshatarët vlerësohen nga puna në prodhim, por dhe intelektualët kërkojnë që argumentat e tyre të zënë vend. Ndërsa klasa punëtore ka ndjenjën e përbashkët dhe e kupton që forca bën fuqinë, intelektualët e heqin veten të zot, bile dhe e deklarojnë veten mbi klasat e tjera, kjo i bën edhe individualistë. Marksizëm-leninizmi na mëson se, po të mendosh se qëndron mbi klasat dhe nuk je i lidhur me një klasë, do të thotë që s'pranon luftën e klasave, si rrjedhim nuk je për revolucion, por për evolucion. Kjo, do s'do, të çon kundër komunizmit. Prandaj i del detyrë Partisë që çështjen e edukimit të intelektualëve tanë ta ketë shumë parasysh. Partia duhet të shikojë edhe ambientin ku jeton intelektual, fshatari ose punëtori dhe në përputhje me këtë duhet të organizojë edhe punën edukative.

Partia duhet të luftojë me të madhe për ngritjen e ndërgjegjes së masave tona. Kështu p.sh. ne do të kemi suksese akoma më të mëdha në qoftë se do të rritim ndërgjegjen në fshatarësinë e rrethit të Fierit e të gjithë Myzeqesë që para çlirimit ka qenë jashtëzakonisht e shtypur dhe që tani ka e do të ketë zhvillim të paparë. Por kjo bëhet mirë kur Partia armatohet me marksiz-

zëm-leninizmin, pse kështu ajo e ka më lehtë të ndreqë njerëzit e gabuar dhe të bëjë që ata të shohin te Partia vijën e drejtë të saj, të mos ndodhë si në konferencën e Tiranës që u gënjyen disa njerëz, por nuk është më ajo kohë, prandaj duhet kujdes. Të jemi vigjilentë, të kritikojmë hapur dhe pas kritikave të mos mbajmë mëri e të mos krijojmë tarafe.

Konferenca juaj që në lartësinë e duhur, diskutimet qenë të kënaqshme dhe u përqëndruan në çështjet themelore ekonomike, kjo është pozitive. Partia të planifikojë punën e saj ashtu si planifikoni ju planet e prodhimit e të tjera. Rëndësi t'i vërë edukimit si për vete dhe për rininë, për të cilën na kanë zili bota dhe të mos lejojmë që kjo të infektohet nga ideologjia e huaj, kjo punë varet nga ne. Rinisë t'i kushtohet rëndësi, Partia do të rritet me të rinjtë, ky është burimi kryesor i saj, sa më kujdes të kemi për rininë aq më tepër do të forcohet Partia jonë.

Edhe gruas duhet t'i japim dorën, të zhdukim te ajo prapambetjen dhe ta ngremë në nivel të barabartë me burrin, ta ndihmojmë në jetë sepse ajo është forcë kolosale për ndërtimin e socializmit, por atë duhet ta edukojmë, ta ngremë e ta kalitim.

Unë jam i bindur se edhe në të ardhshmen rrethi i Fierit do t'i realizojë planet me sukses.

*Botuar për herë të parë me shkurtime në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 57 (2958),  
8 mars 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i Konferencës së 8-të të Partisë të rrethit të Fierit që gjendet në AQP*

## DISA KONKLUZIONE TË NXJERRA NGA VIZITA NË RRETHIN E FIERIT MBI PROBLEMET E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

[Mars] 1958

Mungon ndihma e shpejtë për organizimin dhe mbajtjen e llogarisë nga ana e komiteteve ekzekutive.

Derdhjet nga të ardhurat në fondin e pandashëm — të ulëta. Në vitin 1955 ishin 41 për qind, kurse në vitin 1956 — 34,7 për qind.

Shiten kafshë prodhimi të mira për shlyerje detyrimesh dhe të hollat nuk derdhen në fondin e pandashëm.

Sigurimet gjithashtu nuk derdhen në fondin e pandashëm.

Komitetet ekzekutive nuk e kontrollojnë këtë fond, kështu më 1956 ai nuk është kontrolluar asnjëherë.

Orientimi i planifikimit të kulturave në kooperativa — jo i drejtë. Komitetet ekzekutive shumë herë bëjnë një punë formale në këtë drejtim. Në Fier foragjeret, më 1956 zinin një sipërfaqe 1,1 për qind.

Më 1956 janë grumbulluar 74 211 ton plehra organike, por mund të grumbulloheshin 120 000 ton.

Ngarkesa për 100 ha. tokë me bagëti sidomos me lopë, derra dhe shpendë është e ulët.



Vlehtë e pjelljes dhe e rritjes së kafshëve zë akoma një vend të vogël.

E keqja qëndron në atë që kooperativat shtimin e bagëtive dhe përmirësimin e racës e mbështetin në blerjen dhe jo në mbarështrimin, në kujdesin për të vegjëlit dhe në bazën ushqimore të tyre.

Ka ekonomi të njëanshme në kooperativa. Të ardhurat dërmuese i kanë nga bujqësia gati 77 për qind, nga blegtoaria — 16 për qind, nga frutikultura pak dhe nga ekonomitë e tjera ndihmëse shumë pak — 2,9 për qind.

Kultura e pambukut, për çdo 1 kv., kërkon 13.2 ditë-punë; kështu shpenzimet janë të larta dhe kjo e ka burimin në mospërdorimin e gjerë të procesit të punimeve me SMT dhe në caktimin e normave të ulëta.

Shpenzimet administrative janë të larta; vetëm shpenzimet e udhëtimit e dietat, vajtje e ardhje në qytete, përbëjnë 4 ose 5 për qind të tyre.

Aprovimi i statutit të ri. Ka anomali në çështjen e oborrit kooperativist — mbahen tepër bagëti personale.

Nuk aktivizohet si duhet mbledhja e përgjithshme e kooperativistëve.

Llogaria e kooperativës është e dobët.

Magazinat nuk janë në rregull.

Llogaritarët e magazinierët duhet të punojnë dhe në fushë.

Komisionet e revizionimeve nuk funksionojnë mirë. Në to janë zgjedhur njerëz të papërshtatshëm, jo të besueshëm, analfabetë. Kjo vjen ngaqë nuk janë bërë propozime të rregullta, veçanërisht në Fier.

Pjesëmarrja në punë nga ana e kooperativistëve

është akoma e dobët. Mesatarja në vitin 1955 ishte 212 ditë-punë, ndërsa më 1956 ishte 162 ditë-punë. Grave nuk u krijohen kushte për të dalë në punë. Mungojnë gerdhet e kopshtet.

Puna e anëtarëve të kooperativës në ndërtime, bërja ose meremetimi i veglave të punës, zënë akoma një vend të vogël.

Ngritja e kooperativave model dhe shpërndarja e eksperiencës së më të mirëve duhet pasur shumë parasysh.

*Probleme lidhur me organizimin dhe shpërblimin*

Shpërblimi jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi — zmadhimi i brigadave. Kufizimi i personelit administrativ, shpërblimi i kuadrit, puna me akorde në bazë familjare, skuadre ose individuale. Stimuli personal në lidhje me interesin. Krijimi i brigadave komplekse etj.

Drejtimi me kompetencë i degëve të ndryshme të prodhimit duhet të praktikohet në kooperativa, të inkurajohet inisiativa e mirë dhe të përhapet e të zbatohet puna shembullore.

Ndarja e mirë e forcave të punës në sektorët e ndryshëm të prodhimit, brigadat e palëvizshme nga parcelat dhe të lidhura me to, studimi i mirë i normave të ndryshme (jo drejt uljes siç e kanë zakon disa kooperativistë përtacë) dhe format e ndryshme të metodave të punës në parcela ashtu si na mëson jeta do të bëjnë që kooperativat të përmirësojnë më shpejt jetën e tyre.

Pastrimi, zgjedhja e farës, dezinfektimi i saj dhe lufta në shkallë të gjerë kundër sëmundjeve të bimëve e të kafshëve, të çojnë në rritjen e prodhimit.

Ngritja e nivelit të teknikës agroteknike, shtimi i prodhimit, ulja e kostos, forcimi i organizimit dhe stimuli i interesit personal lidhur me aktivitetin e përgjithshëm, janë rrugët e forcimit të kooperativave.

Fshatarësia kaloi nga forma feudale ose gjysmëfeudale e shfrytëzimit të tokës në kolektivizim dhe nuk u angazhua në format e zhvillimit kapitalist.

*Të rritet më shumë roli i mësuesit të fshatit në drejtimin që fola në konferencë.*

- a. Mbjajtja shumë afër e tij nga Partia dhe kryesia e kooperativës. Jo formalisht, por ai të lidhet ngushtë me jetën arësimore, kulturalc, politike dhe veçanërisht me atë ekonomike të kooperativës.
- b. Mësuesi të forcojë te nxënësit dashurinë për kooperativën dhe bujqësinë.
- c. Të studiojë me vëmendje dhe të nxitë prirjet dhe dëshirat e nxënësve, veçanërisht për bujqësinë, për sektorët e saj të ndryshëm, të lidhë teorinë me praktikën e punës, që kështu nxënësit të bëhen specialistët më të mirë të bujqësisë dhe të së ardhshmes në fshat.

*Botohen për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PUNA E BASHKIMEVE PROFESIONALE NUK MUND  
TË BËHET VETËM ME FUNKSIONARË, POR NË  
RADHË TË PARË ME AKTIVISTË SHIQËRORË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

14 mars 1958

Fakti që çështjen e bashkimeve profesionale do ta marrë në shqyrtim Plenumi i Komitetit Qendror, tregon se sa rëndësi i jep Partia jonë forcimit të punës në këtë organizatë, e cila luan një rol të madh në edukimin ideo-politik të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse. Nga pikëpamja teorike, roli i bashkimeve profesionale në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, mund të themi se është i qartë, sepse te ne nuk ka shtrembërime e gabime. Por në zbatimin praktik të detyrave për të përmbushur këtë rol që kanë bashkimet profesionale, ka dobësi e të meta.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe u aprovua raporti që do të mbahej në Plenumin e KQ të PPSH «Bashkimet Profesionale të Shqipërisë në luftë për ndërtimin e socializmit».

Partia jonë ka theksuar kurdoherë që bashkimeve profesionale t'u jepet rëndësia e duhur, që ato të bëhen më të afta për të kryer detyrat e ngarkuara. Me gjithë punën e bërë dhe rezultatet e mëdha që kemi, duhet thënë se është e domosdoshme që Partia të interesohet më tepër për bashkimet profesionale, pse siç dihet, kur një çështje e merr në dorë Partia, ajo zgjidhet me sukses. Të marrim çështjen e aksioneve. Organizata e rinisë i organizon mirë aksionet. Shumë herë duket sikur në punën e kësaj organizate ka më shumë bujë se sa aksione, po kjo nuk është e vërtetë. Organizata e rinisë ka suksese në organizimin dhe në kryerjen e mirë të aksioneve, sepse ka udhëheqjen, ndihmën dhe mbështetjen e Partisë, gjë që në bashkimet profesionale nuk e shohim si duhet. Prandaj Partia, ashtu siç vlerëson drejt aksionet e rinisë, duhet t'u japë rëndësi të madhe edhe aksioneve që ndërmerri organizata profesionale.

Një nga çështjet e rëndësishme të organizatës së bashkimeve profesionale është ajo e aktiveve të saj. Këto aktive punojnë, japin një ndihmë të madhe në organizimin e punës për edukimin dhe mobilizimin e njerëzve. Por ka dhe komunistë që nuk marrin pjesë në të gjitha format e punës së tyre, siç janë për shembull mbledhjet e prodhimit etj. Kjo është një dobësi që duhet zhdukur. Komunistët duhet të jenë shembull i mirë në çdo drejtim. Veçanërisht ata që janë të zgjedhur në forumet e bashkimeve profesionale, duhet të dallohen midis shokëve të tjerë të aktivitetit të kësaj organizate.

Forcimi i punës me aktivin, është forcimi i punës së Partisë me kuadrin. Nga ana e Partisë, punës me kuadrin duhet t'i kushtohet rëndësia e duhur; në disa

rrethe kryesore si kryetarë të bashkimeve profesionale mund të merren edhe sekretarë të komiteteve të Partisë, sepse edhe kjo është një detyrë me rëndësi të madhe, që mund të vihet në një radhë me atë të sekretarit të komitetit të Partisë të rrethit. Prandaj, në rrethet kryesore duhet të bëjmë sakrificë duke u dhënë bashkimeve profesionale disa nga kuadrot më të aftë. Po kështu të mendojmë e të veprojmë edhe për klubet e ndërmarrjeve të mëdha, ku duhet të jenë njerëz të përgatitur dhe me autoritet. Theksoj, se në punën e aparateve të bashkimeve profesionale të mos merren inxhinierë, ata mund të aktivizohen edhe duke qerë në ndërmarrjet ekonomike, pse puna në këtë organizatë nuk mund të bëhet vetëm me funksionarë, por në radhë të parë me aktivistë shoqërorë.

Edukimin e kuadrove që punojnë me bashkimet profesionale edhe ne, nga ana e Komitetit Qendror nuk e kemi marrë me seriozitetin e duhur. Ne duhet të dërgonim më shumë nga këta kuadro në Shkollën e Partisë. Duke filluar qysh këtë vit, ne duhet të japim për bashkimet profesionale dhe disa nga kuadrot që do të mbarojnë sivjet Shkollën e Partisë. Kështu të vazhdojmë edhe në vitet e tjera duke përgatitur kuadro të bashkimeve profesionale në Shkollën e Partisë. Gjithashtu të tregojmë më tepër kujdes edhe për kurset e bashkimeve profesionale ku përgatitet dhe edukohet një pjesë e kuadrit. Të kemi parasysh se edukimi komunist nuk bëhet vetëm nëpërmjet punës teorike, por edhe në punë e sipër.

Në parim, çështjet që janë shtruar në këtë raport janë të drejta, por ka edhe ndonjë prej tyre që thuhet

prerë dhe mjaft kategorike, si për shembull «t'i jepem kompetenca ligjore mbledhjes së prodhimit». Kjo nuk duhet kuptuar kështu. Ta kemi mirë të qartë se pengesa e vështirësi do të ketë edhe në të ardhshmen, prandaj nuk mund të thuhet se pas këtij plenumi, në marrëdhëniet e organizatës së bashkimeve profesionale dhe të organeve shtetërore, nuk do të ketë asnjë lloj pengese e vështirësi. Kjo nuk është e mundur, sepse jeta është luftë. Në jetë do të ketë vështirësi, do të ndodhin edhe fërkime, do të ketë debate e mendime të kundërta, të cilat do të sheshohen në frymën e Partisë, në bazë të vijës së saj. Pa vështirësi, kontradikta e debate s'ka zhvillim, s'ka përparim. Veç një gjë të kuptohet mirë: te ne, si shteti ashtu dhe bashkimet profesionale përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e klasës punëtore. Është mirë kur çështjet i ngremë edhe nga ana parimore, por kjo kërkon kujdes të madh, pse mund të bëhen edhe përcaktime subjektive, që, në këtë rast shpien qeverinë t'u japë llogari bashkimeve profesionale, ndërsa është e drejtë të shtrohet çështja që të forcohet bashkëpunimi midis tyre.

Ne të gjithë jemi dakord të forcohen bashkimet profesionale, por jo që të shkelen ligjet e shtetit dhe vendimet e Komitetit Qendror e të qeverisë. Për shembull, ne kemi disa çrregullime në çështjen e pagave, megjithëse tani, me rritjen e rrogave të ulëta dhe me heqjen e triskave, kjo çështje është zbutur deri diku, por çdo rregullim i mëtejshëm duhet bërë me etapa dhe jo menjëherë. Meqenëse ky është një plenum që do të shtrojë edhe detyra perspektive, mund të vihet edhe detyra, natyrisht në formë të përgjithshme, që proble-

mi i pagave të studjohet duke mbajtur parasysh parimet dhe kriteret e caktuara nga ana e Komitetit Qendror.

Çështja e pjesëmarrjes së popullit në diskutimin e planit duhet theksuar që të organizohet më mirë. Në rast se ne do ta forcojmë punën në këtë drejtim, plani do të ecë më mirë, vërejtjet dhe propozimet e punëtorëve do të dëgjohen më tepër.

Me vërejtjet e shokëve jam dakord. Ne duhet të insistojmë që çështjet e vendosura nga Partia të zbatohen drejt dhe, me një punë më të mirë të bashkimeve profesionale do të rritet edhe autoriteti i tyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## MBI INTELEKTUALËT<sup>1</sup>

[Mars] 1958

*Format e para të ndarjes së punës në antikitetin grek:*

Platoni<sup>2</sup> dhe «Republika»<sup>3</sup> e tij ideale.

Puna e dorës dhe aktiviteti mendor.

Puna mendore — privilegj i arhondëve, klasave drejtuese.

---

<sup>1</sup> Teza të përgatitura për diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të qytetit të Tiranës, e cila më 21 mars 1958, do të merrte në shqyrtim raportin: «Mbi punën për edukimin e intelektualëve». Shoku Enver disa nga këto probleme nuk i ezauroi në atë mbledhje.

<sup>2</sup> Platoni (427-347 para e. r.) — filozof idealist i Greqisë së vjetër, ideolog i aristokracisë skllavopronare.

<sup>3</sup> Në traktatin «Republika» Platoni jep idenë e «shtetit ideal» i cili të bazohet në ndarjen e punës midis kasteve të lira qytetare: 1) drejtuesit (filozofët), 2) luftëtarët, 3) zanatçinjtë dhe bujqit. Çdo kastë, sipas Platonit, duhet të kryejë vetëm funksionet e saj dhe të mos ndërhyjë në ato të tjetrës; kastës së luftëtarëve u mohonte edhe të drejtën e pronës private e të familjes me qëllim që ata të merreshin vetëm me mbrojtjen e shtetit.

Vënia e çështjes së shoqërisë mbi baza të tilla të çon në idealizëm, që krijon idenë e pavarësisë së mendimit, se mendimi «mbretëron» mbi realitetin material dhe praktik.

Mendimi është i pari nga materia.

Regjimi feudal i ruajti konceptet idealiste filozofike dhe e përforcoi ndarjen e punës mendore nga puna e dorës.

Zotërinjtë, njerëz të shpatës, komandues, drejtues. Klerikët, inteligjencia e asaj kohe, përfaqësues të mendimit shkencor filozofik.

Bujkrobërit dhe artizanët, punonjësit e dorës.

Regjimi kapitalist bëri që intelektualët të fillojnë të formojnë një shtresë më homogjene dhe funksionet e intelektualit filluan të zgjerohen.

Kategori të ndryshme intelektualësh në shërbim të kapitalit si teknikë, inxhinierë, ekonomistë, gjyqtarë, mësues, profesorë etj. zhvillohen tok me kapitalin, jo vetëm pse shtohen nevojat, por se kapitalistët për t'u lehtësuar për vete, lëshojnë nga vetja e tyre funksionet teknike.

Sa më tepër shtohet numri i intelektualëve aq më tepër bëhen të varur nga ekonomia kapitaliste.

Nga pikëpamja ekonomike, intelektualët mund të grupohen në këto kategori: funksionarë, punonjës me rrogë në ndërmarrje kapitaliste, gjyqtarë, oficerë etj. të këtij lloji; mësues, profesorë, filozofë që përdoren nga regjimi kapitalist për përhapjen e ideologjisë borgjeze, por:

1) dekadencia e borgjezisë;

- 2) maltuzianizmi ekonomik<sup>1</sup> që karakterizon dekadencën;
- 3) shpirti kritik i kategorisë së fundit të intelektualëve, që e bën borgjezinë të sakrifikojë kulturën në interes të ushtrisë, policisë,

rëndojnë gjendjen e intelektualit, e bëjnë këtë të mos e pranojë zgjedhën kapitaliste dhe shteti borgjez të shkëlë gjoja traditat e «lirive universitare».

Borgjezia dekadente dhe ideologjia e saj hedh poshtë racionalizmin, vë nën këmbë nderin nacional. Kjo bën që intelektual i ndërgjegjshëm ta kuptojë më mirë se borgjezia nuk mund të jetë më ajo vetëm drejtuesja e kombit dhe e kulturës.

Karakteristikat e inxhinierëve dhe të teknikëve:

Borgjezia u lë këtyre drejtimin teknik dhe drejtimin e kuadrit d.m.th. edhe drejtimin e komandimit e një pjese të punonjësve. Megjithëse jeta materiale e këtyre është më e favorizuar, shpirtërisht ata afrohen me punëtorët, jetojnë gati si ata.

Teknikët e mesëm jetojnë në kushte materiale më të këqia, janë në kontakt pune të përditshëm me proletariatin, pra, i afrohen më tepër shpirtërisht këtij.

Puna gjoja e pavarur e intelektualëve artizanalë, artistëve etj. i afrohen me borgjezinë, por tregëtimi i vep-

<sup>1</sup> Nga Maltus (1766-1834), teoria antishkencore dhe reacionare, sipas së cilës, varfërimi i punonjësve nuk vjen nga shtypja dhe shfrytëzimi që u bëjnë atyre klasat e pasura, por është rrjedhim gjoja i ligjit të përjetshëm të rritjes progresive aritmetike të mjeteve të ekzistencës dhe të shtimit progresiv gjeometrik të popullsisë.

rave të tyre, që i nënshtrohet spekulimit, i drejton ata nga klasa punëtore.

Karakteristikë e mjekëve është se ata nuk rrjedhin nga zhvillimi kapitalist. Përpigjen të mbajnë statu-kuonë e tyre tradicionale, karakterin e tyre të veçantë. Këto i bëjnë këta si një kastë të mbyllur, që zor se pranon elementë të dalë nga gjiri i proletariatit. Por kontakti me mjerimet e klasës punëtore i bën këta gradualisht të ndërgjegjshëm për situatat aktuale të dekadencës së borgjezisë dhe i afron me klasën punëtore.

Pra, intelektualët, që deri dje borgjezia i mbante dhe i përdorte si vegla të saja, fillojnë të orientohen më drejt.

Disa çështje subjektive e ndalojnë intelektualin të bëhet shpejt i ndërgjegjshëm:

1) Lëkundjet që janë karakteristike për klasën borgjeze të mesme e të vogël, nga ku ai del.

2) Disa iluzione të veçanta.

Abstraksioni, ndarja e punës mendore nga puna fizike e bën të mos jetë në kontakt me gjërat, por me simbolet e tyre. Kjo sjell iluzione idealiste.

Qenia e tij ndërmjet klasave e bën atë të gjykojë se nuk shtyhet nga asnjë interes klase dhe çdo gjë përcaktohet vetëm nga gjykimet dhe nga njohuritë e tija. Këtëj del se «idetë» që e vënë në lëvizje intelektualin janë të pavarura nga raportet e klasave. Ai mendon se qendron mbi klasat dhe përfaqëson një moral të pavarur nga forcat ekonomike dhe antagonizmat e klasave.

Ky mendim, i shkëputur nga puna e dorës, nga jeta, e bën atë të kujtojë sikur ai është forca supreme e rregullit të botës. Kjo e bën intelektualin të dalë nga

sfera reale dhe e bën atë të mendojë që të gjitha kontradiktat, nuk duhet të zgjidhen me violencë, por me pajtim intelektual, me evolucion paqësor.

Këto pikëpamje e predispozojnë për oportunizëm.

Këtu qëndron burimi i mospranimit lehtë të komunizmit, pse koncepti i moralit të pavarur nga raportet e klasave dhe ky objektivizëm abstrakt, janë në antipodë me materializmin historik dhe se oportunizmi pajtues është në kundërshtim flagrant me konceptin revolucionar të luftës së klasave dhe me diktaturën e proletariatit.

Një tjetër iluzion është individualizmi. Intelektuali nuk është në opozicion me proletariatin. Ai nuk është kapitalist. Ai s'ka mjete pune si borgjezi i mesëm ose artizani. Ai është i detyruar të shesë prodhimin e punës së tij dhe mbi të, pra, sundon shfrytëzimi kapitalist. Por nga kushtet e jetës, ai është më afër borgjezisë se sa proletariatit.

- Intelektuali nuk lufton me forcën fizike, por lufton me argumenta. Mjetet e tij të prodhimit janë dituria personale, bindjet e tija personale dhe s'mund të krijojë pozitë veçse me cilësitë e tija personale. Prandaj ai mendon se mund t'ia arrijë qëllimit vetëm duke shprehur individualitetin e tij.

Ai s'do ta njohë disiplinën për veten e tij, por për masën. Ai e vë veten në «elitën» «mbi njeriun e zakonshëm», teoria e Niçes<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Nga F. Niçe (1844-1900), teoria reaksionare borgjeze e fazës së kalimit të kapitalizmit në imperializëm, mbi të cilën u bazua fashizmi. Sipas kësaj teorie, forca përcaktuese në sho-

Leninì thotë se shtresa e intelektualëve karakterizohet nga individualizmi, nga pazotësia për t'u organizuar dhe nga paqëndrueshmëria. Proletariati duhet ta marrë prej dore, ta mësojë kundër individualizmit anarkik, se individualizmi i bën ata të hezitojnë, të lëkunden etj.

Duhet me i shkundë intelektualët nga ideologjia borgjeze dhe me i armatos me ideologjinë marksiste-leniniste.

Kur një punëtor bëhet komunist, ai ndjen se diçka që deri atëhere flinte, lulëzon te ai, ai zbulon një kulturë e cila qartëson atë që ai ndjente në mënyrë të errët, ai gjen në marksizmin konfirmimin e qartë të vetes së tij, bëhet i ndërgjegjshëm për atë që ekzistonte në inkonshiençën e tij. Pra, kur punëtori bëhet komunist, ai në vetëvete ndërton, forcon.

Kur një intelektual bëhet komunist, çështjet nuk zhvillohen si në rastin e parë. Në çdo hap të fitores së ndërgjegjes socialiste, intelektual i detyrohet të shkatërrojë diçka nga e kaluara e tij. Pra, ai shkatërron e ndërton dhe në hapat e parë që bën ai ka përshtypjen jo të krijimit, por të një lufte kundër vetëvetes.

Kur bëhet komunist punëtori, ai e di se do të luftojë, do të bëjë grevë, do të përleshet me kapitalizmin, edhe mund të vritet, por ai ka vetëm një armik dhe ky është armik i jashtëm, kapitalizmi, kurse intelektual

---

qëri është vullneti, se zhvillimi i historisë varet nga vullneti i individit që synon drejt pushtetit, se masat janë «skllevër», «turma» të destinuara të dëgjojnë dhe t'u nënshtrohen përjetë klaseve sunduese.

duhet të përballojë luftën në dy fronte, me vetëveten, domethënë me mbeturinat e tija mikroborgjeze dhe me armikun e jashtëm, me kapitalizmin.

Që intelektuali ta fitojë ndërgjegjen socialiste, duhet të drejtohet, të kalitet në punë praktike, të riedukohet dhe të edukohet me teorinë marksiste-leniniste. Këtë punë të vazhdueshme ndaj tij do ta bëjë klasa punëtore dhe partia e saj.

Lufta jonë nacional-çlirimtare dhe lufta për ndërtimin e socializmit kanë bërë një ndryshim të madh në inteligjencien tonë të vjetër dhe kanë krijuar një inteligjencie të re, të dalë nga klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse, besnike e klasës punëtore dhe e socializmit. Këtë proces e kemi krijuar, e kemi ruajtur dhe zhvilluar. Po e zhvillojmë edhe më tej me sukses.

Por do të jetë gabim dhe kënaqje me vetëveten po të themi se inteligjencia jonë e vjetër dhe ajo e re, u ka shpëtuar, ose është spastruar nga të gjitha mbeturinat mikroborgjeze, nga pikëpamjet që e pengojnë atë të lidhet plotësisht, ose të mos gjejë pengesa në rrugën për formimin e plotë të ndërgjegjes socialiste.

Inteligjencia jonë, në radhë të parë, shpëtoi nga zgjedha kapitaliste, shpëtoi nga shfrytëzimi. Atdheu fitoi lirinë, pavarësinë, sovranitetin, dinjitetin kombëtar dhe udhëhiqet nga klasa përparimtare, nga klasa punëtore. Janë krijuar kushte plotësisht të favorshme për zhvillimin dhe lulëzimin e kulturës, të arësimit etj. në shërbim të popullit punonjës. Pra, janë krijuar kushtet objektive bazë, të plota, për edukimin në rrugë të drejtë

të inteligjencies sonë dhe për zhdukjen e mbeturinave mikroborgjeze në ndërgjegjen e saj.

Këtu synon edukimi marksist-leninist i Partisë sonë.

Në vendet kapitaliste sundon kapitali, kapitalistët, borgjezia, shteti është në duart e borgjezisë, kurse te ne u vendos diktatura e demokracisë popullore, diktatura e proletariatit, shteti udhëhiqet nga Partia e Punës, pushteti është në duart e popullit punonjës, në duart e shumicës. Te ne ekziston shteti, ekzistojnë armët e diktaturës, ekzistojnë klasat mike — punëtore dhe fshatare, ekzistojnë nëpunësit, inxhinierët, teknikët, mësuesit, profesorët, artistët, studentët, ekzistojnë shtresa të pakta të borgjezisë së mesme dhe të vogël të qyteteve, intelektualë të rinj dhe të vjetër, ekzistojnë kulakë e mbeturina të borgjezisë reaksionare si dhe elementë të shpronësuar të klasës së feudalëve.

Por shteti ynë i ri është krejt ndryshe nga shteti i kapitalistëve dhe i borgjezisë dhe për të gjitha këto shtresa ka ndryshuar rrënjësisht gjendja ekonomike, morale, politike. Detyra jonë për edukimin e intelektualëve është që ata jo vetëm ta kuptojnë si u bë ky revolucion, por ta ndjejnë dhe të luftojnë për ta forcuar.

Por ne duhet të bëjmë pyetjen: vallë ka shkuar paralel ngritja e ndërgjegjes së njerëzve dhe spastrimi i mbeturinave mikroborgjeze, me reformat e mëdha që janë bërë në vendin tonë? Përgjegjia duhet të jetë, natyrisht, jo. Por ndryshimet janë të mëdha, në krahasim me vendet ku sundon kapitalizmi, veçanërisht në shtresat e intelektualëve dhe të borgjezisë së vogël. Ndryshimet janë shumë pozitive në rritjen e ndërgjegjes socialiste, në radhë të parë në klasën tonë punëtore, e cila



po kalitet çdo ditë, sepse ajo e forcon ndërgjegjen e saj më shpejt së klasat dhe shtresat e tjera dhe influencon e ndihmon pa masë me rolin e saj drejtues në shtet edhe në shtresat e tjera. Fakt është, nga ana tjetër, se te ne nuk ka ekzistuar në kuptimin e vërtetë të fjalës influenca e një borgjezie të organizuar, me rrënjë të thella në popull, që të kishte krijuar në shkallë të gjerë dhe me sistem, e në të gjitha drejtimet, një klasë intelektualësh që t'i shërbenin si duhej asaj, siç ka ndodhur dhe ndodh në vendet kapitaliste. Kjo inteligjencie gjysmake, në disa drejtime të caktuara, sapo kishte hedhur hapat e parë në jetë dhe këta gjithashtu në luftë të përditshme me mbeturinat e feudalizmit dhe gjysmë-feudalizmit. Nëpunësit e regjimeve të kaluara, shumica ishin pa shkollë ose me shkolla të vjetra turke dhe fare pak me shkolla borgjeze perëndimore. Nga shkollat borgjeze perëndimore sapo kishin filluar të dilnin kuadro, në drejtime të caktuara, veçanërisht në drejtësi, në mjekësi dhe fare pak kuadro për industrinë (se mungonte një industri dhe as që kishte ndonjë perspektivë zhvillimi i saj). Bujqësia natyrisht konsiderohej nga regjimi i feudalëve një sektor pune skllëvërisht dhe për borgjezinë tonë tregëtare e intelektuale, një sektor përçmyes. Shumë të rrallë ishin djemtë e borgjezisë që caktoheshin në shkolla të larta bujqësore ose teknike. Përsa u përket kuadrove të përgatitur për studime të shkencave të natyrës dhe atyre shoqërore mund të themi se numëroheshin me gisht. Pra, këta intelektualë të paktë, me shkolla të larta, destinoheshin t'u shërbenin regjimeve si nëpunës. Shumë nga mjekët, bij të borgjezisë, formonin si të thuash një kastë spekulantësh. Një

grup të mirë intelektualësh e formonin mësuesit dhe profesorët, të cilët shërbenin deri në një farë shkalle sipas kërkesave të regjimit të vjetër. Me përjashtim të disa profesorëve të vjetër, mësuesit bënë një jetë shumë afër popullit dhe gjendja ekonomike e tyre, megjithëse jo shumë e ulët, prapë linte shumë për të dëshiruar. Përsa u përket artistëve, ata ishin shumë të paktë, flas për piktorët, se artistë teatri, muzikantë profesionistë s'kishte fare, ose kishte shumë pak dhe ata ishin bërë mësues shkollë kështu që as mund të bëhej fjalë për profesion të lirë. Siç e shikoni e tillë ishte inteligjencia jonë që trashëguam nga e kaluara dhe e tillë ishte pozita e saj ekonomike dhe shoqërore.

Revolucioni popullor ndërroi formën dhe përmbajtjen e regjimit dhe ndërmori veprën e madhe të zhvillimit të ekonomisë kombëtare në baza të reja, filloi ndërtimin e socializmit. Krahas filloi dhe revolucionin kultural. Në dy drejtime punuam dhe do të punojmë: për krijimin e kuadrove të rinj në të gjithë sektorët dhe për edukimin e kuadrove të vjetër me frymën dhe me ndërgjegjen socialiste. Formimi i kuadrove të rinj të inteligjencies socialiste, po ecën me ritme të mëdha dhe të kënaqshme në të gjitha drejtimet e aktivitetit të jetës dhe riedukimi i kuadrove të vjetër nuk shkon keq.

Por duhet të kemi vazhdimisht parasysh se as inteligjencia e re popullore as ajo e vjetra, nuk janë të paprekshme nga mbeturinat e vjetra borgjeze dhe mikroborgjeze as nga influenca e propagandës së borgjezisë dhe e ideologjisë borgjeze. Këto mbeturina manifestohen në jetë, në punë, si në kuadrot e rinj, ashtu edhe në kuadrot e inteligjencies së vjetër. Në rradhë të parë, ato

manifestohen në metodën dhe në stilin e punës, në mënyrën e jetesës familjare, në qëndrimin ndaj pronës së përbashkët socialiste, në punën kolektive, në mungesën e disiplinës dhe të moralit proletar, në individualizmin, egoizmin dhe fodullëkun, në arrogancën, në pseudoindipendencën, në rutinën e punës, në mungesën e perspektivës dhe të krijimtarisë e shumë shfaqje të tjera.

Pra, duke e njohur një situatë të tillë, duke i ditur këto vështirësi të rritjes dhe të kalitjes, neve nuk na lejohet, as t'i nënvleftësojmë, as t'i zvogëlojmë, as të kënaqemi me kaq dhe as të alarmohemi, por duhet të ndërtojmë një program pune dhe edukimi të tillë për inteligjencien tonë popullore, që të rritë kuadro kurdoherë të rinj të shëndoshë dhe të shëndoshë edhe të tjerët, si dhe të spastrojë vazhdimisht mbeturinat nga të vjetrit e nga të rinjtë.

Edukator i mirë, propagandist i mirë duhet të konsiderohet jo ai që mjaftohet me një leksion teorik mbi marksizëm-leninizmin, duke kopjuar fraza nga tekstet e klasikëve, e duke ua lexuar dëgjuesve, por ai që leksionin mbi marksizëm-leninizmin e bën të gjallë, konkret, i jep jetë dhe ua përshtat njerëzve, kategorive të njerëzve që e dëgjojnë. Të bësh leksione të thata marksiste nuk shërben shumë dhe fakt është se shumë pak frekuentues vijnë të dëgjojnë, se nuk kuptojnë dhe jo se nuk duan. Por dhe ai që bën leksione të tilla, për mua është një njeri i paditur, është një intelektual gjysmak, i shkëputur nga jeta, nga praktika. Ai s'bën gjë tjetër veçse përsërit fraza të klasikëve të marksizmit, të cilat fundi i fundit mund t'i lexojnë edhe vetë dëgjuesit. Gjëja kryesore që nuk di propagandisti ynë i

marksizëm-leninizmit, dhe që pa të nuk mund ta bëjë të gjallë leksionin e tij, është se ai nuk njihet përbërjen e auditorit, çfarë njerëzish janë, ku punojnë, çfarë mendojnë këta njerëz, ç'botëkuptime kanë në kokën e tyre, çfarë kanë të qartë, çfarë kanë të errët ose të gabuar. Të dy palët tremben nga pyetjet e njërit-tjetrit dhe nga diskutimet e lira. Njëri trembet se mund të mos dijë t'u përgjigjet, tjetri se mos merret pyetja e tij për ters.

Pra, të dy palët bëjnë një punë automatike, dëgjuesi shumë herë lë kursin, se nuk gjen dot atë që dëshiron, ndërsa edukatori ose propagandisti, mendon dhe hiqet se është në rregull, letrën e ka përgatitur si thamë më parë, atë e ka në xhep, shkon ta lexojë, por forma dështon.

Për njerëzit me kulturë, studimi i teorisë marksiste-leniniste mund të jetë më i lehtë, mund të jetë dhe i rëndë, mund të bëhet dhe i pakuptueshëm.

Duhet të punojmë që propagandistët tanë të kenë ose të fitojnë kulturë. Ata që kanë kulturë duhet të spastrojnë lakrat e kulturës së vjetër të tyre, domethënë çdo gjëje që ata kanë mësuar, t'i vënë termometrin e marksizëm-leninizmit dhe kur të shohin se kanë zjarr ose ethe si të thuash për disa pikëpamje, duhet t'i shërojnë ato. Ka që i shërojnë dhe marksizëm-leninizmi bëhet për ta busull e vërtetë, ata s'gabohen lehtë, dinë t'ua mësojnë dhe të tjerëve këtë metodë të pagabuar. Atyre që nuk veprojnë kështu, u mbeten mbeturina në kokë, hiqen sikur e kuptojnë marksizmin, mbajnë leksione shablone dhe shumë herë ata, megjithëse flasin për marksizmin, në vetëvete nuk e pranojnë. Natyrisht, në rastin e fundit ata janë të rrezikshëm ose të dëmshëm.

Por propagandistët tanë s'janë të gjithë me kulturë. Ne jemi shumë larg asaj që duhet. Atëhere ç'duhet bërë, të kemi më pak forma edukimi? Jo, por duhet të përgatitim propagandistë, t'u mësojmë këtyre parimet themelore të filozofisë marksiste lidhur ngushtë me jetën, me praktikën. Vetë këta të arrijnë që këto parime të filozofisë, të mos u duken «gogolë», por gjëra që mësohen. Kush do t'ua bëjë këtyre propagandistëve të qarta këto parime? Në radhë të parë jeta, lufta, puna e përditshme.

Krahas formave të edukimit marksist-leninist, bëhet një numër i madh leksionesh dhe bisedash me karakter të ndryshëm politik, teknik, moral etj. Këto bëhen kudo ku punohet, kudo ku krijohet, kudo ku luftohet. Pavarësisht se ka shumë ujë në këto leksione dhe konferenca, këtu duhet të fillojë edukimi marksist-leninist i njerëzve dhe i intelektualëve. Këtu, punën e përditshme në zhvillim, krijimtarinë, dhënien e mësimit në shkollë, operacionin e një të sëmuri, diagnozën e tij, racionalizimin, normën, pagën, luajtjen e një roli në teatër etj. etj. duhet t'i lidhim me parimet e filozofisë sonë marksiste-leniniste. Po të lidhen mirë këto çështje, atëhere forma e edukimit do të jetë një çështje shumë më e lehtë edhe për dëgjuesin, dhe për lektorin. Vetëm se Partia nuk i vë rëndësinë e duhur kësaj çështjeje. Kabinetet e Partisë qëndrojnë shumë larg këtyre problemeve, ato mendojnë se format e edukimit do të zgjidhin çdo gjë dhe në fund japin një raport statistikor. Po kështu dhe propagandistët nuk interesohen si duhet për këtë lloj edukimi paraprak, me bazë dhe nuk interesohen që formulat marksiste që ata kanë arritur t'i

kenë në kokë t'i provojnë në jetë, në praktikën e ndërimit të socializmit. Kjo është jashtëzakonisht serioze. Thuhet se këto konferenca bëhen të mërziishme dhe ka mundësi që të jetë kështu. Duhet, pra, të ndryshojë karakteri i tyre, nga të mërziishme të bëhen interesante. Kush do ta bëjë këtë? Sigurisht, Partia. Jo vetëm njerëzit që s'kanë kulturë, ose që kanë pak kulturë, do ta kenë vështirë në fillim ta kuptojnë filozofinë marksiste-leniniste, por do ta kenë vështirë edhe njerëzit me kulturë. Por po të lidhet teoria me praktikën, me jetën, atëhere kjo s'është e zorshme. Të paktë janë te ne ata që e dinë teorinë marksiste-leniniste me rrënjë dhe me ato formula ashtu si e kanë thënë Marksi, Engelsi, Lenini, Stalini etj., por të shumtë janë ata te ne që punojnë, zbatojnë, krijojnë dhe nuk gabojnë, se udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se Partia i ka mësuar kuadrot me marksizëm-leninizmin, e ka bërë këtë mjetin e vetëm, armën e lavdishme për udhëheqje dhe për aksion. Atëhere kjo do të thotë se këta dhjetëra e qindra mijëra njerëz në Shqipëri, s'janë të huaj për marksizëm-leninizmin, ata e dinë atë, ata udhëhiqen në çdo punë prej tij, ata pa të s'mund të rrojnë, s'mund të ndërtojnë, s'mund të krijojnë. Fakt është se janë bërë gjëra kolosale, fakt është se ne kemi një Parti të fortë, shumë të fortë marksiste-leniniste të tipit të ri, kemi një parti që ka një vijë të drejtë dhe i qëndron besnike marksizëm-leninizmit. Partinë e përbëjnë njerëzit, njerëz të pararojës që s'janë të huaj me marksizëm-leninizmin. Duhet, pra, edukimin marksist-leninist të kuadrove, të inteligjencies sonë ta forcojmë akoma më shumë dhe

këtë edukim marksist-leninist, të mos e kuptojmë shumë ngushtë, domethënë vetëm në format e Partisë, se po e kuptuam kështu, harrojmë jetën, luftën, realizimin dhe mbetemi vetëm në anën teorike. Këtë duhet ta kuptojnë mirë njerëzit që merren me agjitacion e propagandë në Parti, këtë duhet ta kuptojnë mirë drejtuesit e Partisë: në fabrika, në kooperativa, në shkolla, në spitale; këtë duhet ta kuptojnë mirë udhëheqësit e rinisë, kudo ku punohet, ku luftohet, ku krijohet. Atje do të vërtetohet teoria, atje do të jetë ndihma më e madhe që kuadrot të armatosen me teorinë marksiste-leniniste.

Ka shumë mundësi që as doktori as profesori, njëri këta me kulturë, të mos e kuptojnë një leksion teorik mbi materializmin dialektik dhe historik. Follu mbi praktikën e tyre, mbi shkencën e tyre më parë, lidhura me këtë praktikë disa parime bazë të materializmit, ata shumë shpejt do të të kuptojnë. Bëjuni pastaj një leksion thjesht teorik, ata me siguri do të ta kuptojnë këtë herë.

Kështu është dhe me punëtorin e fabrikës, i cili është fare mirë në dijeni të rrogave, të çmimeve, të normave etj. etj. me të cilat dhe për të cilat, ai lufton çdo ditë dhe lufton në rrugë marksiste. Kur ti u bën leksione për këto gjëra, mos harro të lidhësh disa parime të filozofisë marksiste me këto çështje, ata do të të kuptojnë më mirë. Atëhere më vonë folu për teorinë e mbivlerës, të jesh i sigurtë se këtë herë do të të kuptojnë dhe do të të kuptojnë aq mirë, sa që mund të thuash se edhe më mirë nga agjitorit ose propagandisti. Dhe kështu për të gjitha gjërat dhe në të gjithë sektorët.

Ne kemi shokë që kur u flet për çështje teorike ata ngrenë duart dhe s'mungojnë të thonë, «janë të rënda, është e rëndë ekonomia politike, është e rëndë ajo, është e rëndë kjo». Po në realitet s'është kështu. Këta shokë kanë një stazh të madh në drejtim, këta kanë një eksperiencë kolosale në çështjet ekonomike. Këta, në jetë e në praktikë, e dinë ekonominë politike më mirë se në libër, pa le që pedagogun e lënë pas. Por ja ata kanë frikë edhe nga libri, edhe nga pedagogu. Ose më mirë kanë frikë nga fraza. Frazat e bukur i mundon. Partisë i mjafton që njerëzit të dinë esencën, të dinë ta përdorin këtë drejt dhe mirë në jetë. Frazat le t'i mbajë pedagogu. Ai le t'i mbajë mend dhe duhet ta mbajë mend radhitjen e gjërave, se ashtu ia do zanati, por të mos harrojë se zanati ia do që nxënësve t'ua bëjë teorinë të kuptueshme, të thjeshtë, të lidhur me jetën, me praktikën dhe të mos i trembë njerëzit me fraza të rënda filozofike. Unë nuk them se filozofia është një gjë e lehtë, por jo edhe «gogol». Për ne, komunistët, çdo gjë është e kapshme, vetëm duhen përpjekje si në çdo gjë edhe këtu.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



## KALITJA E INTELIGJENCIES NUK BËHET VETËM ME LEKSIONE, POR ME PJESËMARRJEN E SAJ AKTIVE NË GJITHË JETËN E VENDIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e byrosë së Komitetit  
të Partisë të qytetit të Tiranës<sup>1</sup>*

**21 mars 1958**

Ky problem që po shqyrtoni ka rëndësi të madhe dhe bëtë mirë që e analizuat. Ndihma që duhet të jepni për ngritjen e kalitjen ideologjike të intelektualëve të jetë më e mirë. Propagandistët duhet të jenë më të pregatitur. Ne kemi suksese në drejtim të edukimit të intelektualëve. Partia krijoi inteligjencien e re dhe si fillim kemi përparime. Inteligjencia e vjetër e vendit tonë është bashkuar me pushtetin popullor dhe mbështet vijën e Partisë sonë. Acarim midis inteligjencies së re dhe të vjetër te ne nuk ka. Por, megjithatë jemi prapa e akoma duhet kujdes në drejtim të edukimit të tyre. Kalitja e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje byroja e Komitetit të Partisë të qytetit të Tiranës mori në shqyrtim punën që duhej bërë me intelektualët për edukimin marksist-leninist të tyre.

inteligjencies nuk bëhet vetëm me shkolla, me leksione, por në radhë të parë me pjesëmarrjen aktive të saj në të gjitha problemet e vendit. Puna i kalit njerëzit. Pjesëmarrja aktive e intelektualëve në ndërtimin e vendit është kusht i domosdoshëm për kalitjen e tyre. Ka raste që ata duan t'i shmangen realitetit. Ndryshe nga klasa punëtore e fshatare, te ata vihen re tendenca të huaja sidomos individualizmi. Ka nga ata që me vësh-tirësi e pranojnë disiplinën e klasës punëtore. Në qoftë se Partia nuk i kalit intelektualët me ideologjinë e kla-sës punëtore, në qoftë se Partia fle, atëhere ata ka rre-zik të infektohen nga mbeturinat mikroborgjeze dhe ideologjitë borgjeze e revizioniste.

Pozitive është se në të kaluarën në vendin tonë nuk kanë ekzistuar parti të tjera që të mbillin ideologjitë e tyre. Veç kësaj në popull dhe në intelektualët përpa-rimtarë ishte krijuar një urrejtje e madhe për regjimin feudal të Zogut e të pushtuesve. Shumë intelektualë të vjetër: mësues, doktorë, gjykatës etj. kishin rënë në konflikt me atë regjim, sepse ishin krijuar dallime të mëdha midis njerëzve që mendonin e punonin dhe bor-gjezisë e kuadrove që ajo kishte krijuar për t'i shër-byer asaj, ashtu siç ndodh sot në vendet kapitaliste. Kush punon sot për Rokfelerët, për forcimin e pushtetit të borgjezisë? Natyrisht, kuadrot e saj. Po inteligjencia? Ajo është në rënie, gjendja e saj ekonomike po dobë-sohet, prandaj shumë nga shtresat e intelektualëve po braktisin radhët e borgjezisë. Mjaft dijetarë të mëdhenj dhe elementë të tjerë jo komunistë e kanë kuptuar se borgjezisë i ka ardhur fundi e janë radhitur në front me popullin punonjës.

Ndryshe ndodhi e po ndodh sot në vendin tonë. Pushteti ynë krijoi intelektualët e vet, ata janë të popullit, dolën nga gjiri i tij, janë nga ata që u hodhën në Luftën nacional-çlirimtare për krijimin e një shteti të ri të demokracisë popullore. Te ne, sot pushteti është i popullit, pra, edhe i intelektualëve; kjo bëri që edhe intelektualët e vjetër të bashkohen me ne, por kjo nuk do të thotë që ne të flemë, të mos punojmë me ata ose të mendojmë se ata janë jashtë çdo rreziku nga infektimi i huaj. Ka nga ata që flasin në përgjithësi, që duan të bëjnë jetë të rehatshme, që nuk i durojnë përpjekjet dhe sakrificat që bën klasa punëtore, por intelektualët kanë edhe gjëra të përbashkëta me klasën punëtore se të dy palët luftojnë për të siguruar një jetë më të mirë, punëtorët me krahë, intelektualët me mendje. Por intelektualit nga vetë natyra e punës së tij, përpiqet të dallohet në jetë, të tregohet i ditur dhe këto e çojnë në tendenca mendjemadhësie se «unë jam i mësuar». Kjo është traditë e vjetër dhe mbeturinë që nuk është aq e lehtë të luftohet, prandaj, po të mos edukohet nga Partia, inteligjencia del mbi klasat dhe thotë «unë duhet të drejtoj» dhe duke qëndruar mbi klasat nuk pranon luftën e klasave, si rrjedhim kërkon t'i zgjidhë çështjet pa violencë. Por ata që nuk pranojnë luftën e klasave janë liberalë, oportunistë, ata nuk janë as me borgjezinë as me klasën punëtore dhe mund të hidhen edhe kundër komunizmit. Ata gëzohen kur shohin gjithë këto ndërtime, por kur preken vetë menjëherë kthejnë sepse janë mbeturinat e vjetra ato që i shtyjnë. Mjekët p.sh., gjithë jetën kanë qenë si një kastë e privilegjuar më vete. Për këtë arësye edhe te ne vazhdon akoma ten-

denca që të gjithë të bëhen mjekë. Këto mentalitete ekzistojnë te disa mjekë, të cilët duan të jenë të pavarur e mendojnë se «mund të ha bukë në çdo regjim» duke e quajtur këtë si profesion të lirë.

Tendenca të huaja vihen re edhe në disa punonjës të drejtësisë. Studentët e drejtësisë qysh tani janë në merak se ku do t'i hedhin, se duan të rrinë në Tiranë dhe nuk mendojnë se s'është Tirana vetëm që ka nevojë për ta, por gjithë vendi. Këto tendenca duhen luftuar me kohë, njerëzit duhen edukuar, kalitur, ndryshe mund të na krijohen sëmundje të rrezikshme. Te ne po luftohet burokratizmi. Shumë funksionarë që punojnë ose studjojnë në kryeqytet shkojnë edhe në bazë, por nga disa ka rezistencë për të ikur nga Tirana. Kjo s'është e drejtë. Partia duhet të punojë shumë me këta njerëz. U çmobilizuan shumë oficerë, por ata u rregulluan menjëherë dhe nuk u krijua ndonjë situatë e rëndë, megjithatë komiteti i Partisë, instruktorët të kenë shumë kujdes për edukimin e tyre.

Sa për shkrimtarët tanë mund të themi se ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e tyre dhe kanë rezultate, por ata janë akoma të rinj e duhen kalitur. Disa prej tyre duhet të jenë më modestë dhe të lidhen më ngushtë me jetën, për të shprehur si duhet realitetin tonë. Me ëndrra nuk dalin gjëra të mira e të shëndosha dhe është e natyrshme të dalin kështu derisa vetë autori s'e njeh realitetin. Faktet tregojnë se kur bëhen gjërat nga dhoma nuk dalin në rregull. Për shkrimtarët duhet treguar kujdes i madh nga Partia se me një libër të mirë ata mund të edukojnë një brez të tërë, pse njeriu në atë libër shikon shumë gjëra.

Propaganda e armikut synon më shumë në këta njerëz, që t'i komprometojë, bile edhe në shokë të mirë. Partia duhet të tregojë një kujdes të madh për shkrimtarët edhe në një drejtim tjetër: t'i ruajë ata nga mendjemadhësia pse ka ndonjë që thotë «jam Shekspiri» etj. Shkrimtarët tanë nuk përkthejnë vepra klasike, por duan të bëjnë t'u dalë fama. Harrojnë që Fan Noli veç veprave që ka shkruar ka përkthyer shumë kryevepra të letërsisë botërore si të Shekspirit etj. Prandaj duhet luftuar kundër çdo shfaqjeje të huaj me qëllim që ata të pastrohen. Lufta këmbëngulëse e organizatës bazë do të ndihmojë për edukimin e tyre. Nga Partia atyre duhet t'u jepen orientime për të shkruar. Por mbi të gjitha ata duhet të lidhen më shumë me klasën punëtore e me fshatarësinë, të njohin mirë jetën e tyre, të marrin pjesë gjallërisht në preokupacionet e tyre.

Artistët tanë janë të mirë, por duhen edukuar nga Partia, duhen kalitur e në radhë të parë nga ana ideologjike. Rëndësi ka frekuentimi nga ana e tyre i shkollave shtetërore e të Partisë. Shumë intelektualë nuk marrin pjesë në konferenca e biseda, kjo duhet parë mirë se mund të vijë edhe nga të metat në përgatitjen e leksioneve, të cilat ose mund të jenë të rënda, ose mund të jenë boshe. Puna e leksioneve duhet ndrequr seriozisht. Këtë orientim e dhamë dhe në Komitetin Qendror. Leksionet mund të jenë dhe të shkurtëra, po të kuptueshme që/njerëzit të mësojnë se si të mos gabojnë dhe të luftojnë ata që mundohen të na vënë gurë në rrota. Kështu, në fillim të mësojmë gjëra të thjeshta, më vonë të jepen njohuri të një niveli më të lartë. Por kjo të mos merret shablone. Atje ku shihet se leksionet kuptohen

mirë të bëhen në nivel të lartë, pra, ato t'u përshtaten dëgjuesve. Referuesi dhe dëgjuesi duhet të lidhen më shumë me njëri-tjetrin për të pasur mundësi që të sqarohen gjërat e paqarta. Po ç'ndodh? Duke qenë leksioni në hava, i përgjithshëm, njerëzit ose vijnë formalisht se «duhet ardhur» ose nuk vijnë fare se e dinë që nuk do të marrin vesh gjë, ndërsa referuesi, nga ana e tij, duke mos qenë kompetent qëndron larg se ka frikë mos i bëjnë ndonjë pyetje dhe i bie «autoriteti». Referuesi duhet ta njohë gjendjen në qendrën e punës ku do të zhvillojë leksionin, për të qenë më i përgatitur sepse kështu ai do të sqarojë më mirë çështjet që mund të dalin dhe leksioni duke u lidhur me realitetin e qendrës së punës do të jetë më i kuptueshëm. Këto të meta duhen ndrequr, natyrisht menjëherë nuk bëhen, po duhet ecur në këtë rrugë, propagandistët të përgatiten më mirë, të njohin mirë njerëzit që kanë në auditor, të lidhin teorinë me praktikën duke e shoqëruar me shembuj të profilit të punës së dëgjuesve, gjë që do të ndihmojë për ngritjen e kuadrove dhe të masave duke i armatosur ata me teorinë marksiste-leniniste. Këto t'i kenë shumë parasysh ata shokë që përgatitin leksione. Të gjitha këto që thamë, në qoftë se do të zbatohen, do t'i japin një hov akoma më të madh punës së Partisë për edukimin e inteligjencies, për luftën kundër armiqve dhe luftën për realizimin e planit.

Në luftën kundër revizionizmit, Partia jonë nuk ka heshtur kurrë. Një gjë duhet të jetë e qartë, diplomacia — diplomaci dhe ideologjia — ideologji. Ne kurrë nuk do të lejojmë të ngatërrohen këto të dyja. Me jugosllavët ne kemi marrëdhënie diplomatike, por nuk

puqemi me ta në ideologji, sepse ata janë revizionistë në të gjithë vijën, ne bëmë gjithë ato përpjekje, u dhamë dorën, por ata qëndrojnë në të tyren. Ata thonë se «mund të flasësh sa të duash kundër kapitalizmit, por ai po humbet terrenin, në vendet kapitaliste po bëhet nacionalizimi i industrisë prej ku do të kalohet në socializëm», ata nuk e kritikojnë e nuk e demaskojnë kapitalizmin. Përkundrazi, për sistemin tonë shpifin, se gjoja në teorinë marksiste-leniniste ka disa boshllëqe që duhen «mbushur», se gjoja duhet decentralizuar drejtimi i ekonomisë sonë, se gjoja Stalini e ka bërë shtetin padron të popullit. «Kjo në fillim ndodhi edhe te ne — thonë ata — por shpejt klasa punëtore mori drejtimin, pra, edhe te ne janë bërë gabime, por do të ndreqen». Por ç'po ndodh në të vetëquajturin «vend socialist» të tyre? Me sistemin «e ri» që kanë krijuar në ndërmarrje, përgjegjësit marrin nga 17-18 rroga punëtorësh; çdo ndërmarrje bën tregëti sa të dojë dhe si të dojë, ngre çmimet si të dojë, njëmijë dinarëshi nuk është asgjë. Në Slloveni, punëtorët, dy ditë me radhë, bënë greva të mëdha, të cilat i detyruan titistët të nxjerrin edhe një qarkore «me shumë rëndësi». Ata nuk e demaskojnë imperializmin amerikan për krijimin e bloqeve agresive dhe këtë nuk e bëjnë se kanë interesa të ngushta ekonomiko-politike me ta. Materiale demaskuese për rrugën e tyre antisocialiste e revizioniste ne kemi mjaft. Revizionistët jugosllavë flasin kundër nesh në partinë e tyre, bile dhe në gazeta. Partia jonë e di mirë rrezikun e revizionistëve. Ne duhet t'i shfrytëzojmë këto materiale, të flasim me fakte e t'i demaskojmë ata deri në fund.

Rininë tonë e kemi të mirë, të pastër, kurajoze, por duhen pastruar ferrat në rrugën e saj. Organizata e rinisë në shkolla e universitet duhet të punojë më mirë. Rininë, në qoftë se e frenon, e dëmton, por dhe po e le të veprojë si të dojë, të iku, u rrezikua e ardhshmja e vendit. Prandaj, pedagogët, organizatat e rinisë duhet t'i kenë parasysh këto, duhet ushqyer rinia nga ana mendore. Me rininë të bëhen leksione të mira, tërheqëse e me brumë, këtë e them se ka disa leksione që janë fare kashtë. Unë pashë, kohët e fundit, një material të përgatitur për leksion me temë «Mbi bestytnitë», i cili hidhej nga industria të shiu dhe s'kishte asgjë përsa ishte nisur. Lufta kundër besimeve të kota duhet bërë me fakte duke treguar origjinën e pikëpamjeve fetare, duke treguar dëmet e mëdha që i kanë sjellë njerëzimit, lindja e feve, katolicizmi, kristianizmi, muslimanizmi, duke treguar edhe rrugët se si duhen zhdukur, si duhen luftuar. Ose një leksion tjetër ku autori mundohet të flasë për patriotizmin. Sipas këtij «leksioni» fjala patriotizëm na paska dalë nga Revolucioni francez. Më e keqja është se në të nuk flitet fare për patriotizmin në shekuj dhe të sotëm të popullit shqiptar, të rinisë sonë. Veç të tjerave, në një leksion të tillë duhet të flitet se ku konsiston patriotizmi, se ai është i lidhur me çështjen ekonomike etj., se lufta për tokën, për bukën i ka bërë njerëzit që të luftojnë për atdheun. Kur merren shembuj heronjsh të merren ata që përfaqësojnë një epokë të tërë të ngjarjeve të popullit apo të Partisë. Këto duhet t'i kenë shumë parasysh në punët e tyre si shkrimtarët edhe propagandistët tanë.

Byroja Politike ka besim se Komiteti i Partisë i



qytetit të Tiranës do ta kuptojë më mirë çështjen e edukimit të brezit të ri dhe të klasës sonë punëtore. Ajo ka besim se Partia këtu është e fortë, se kuadrot që janë në Tiranë janë kuadro udhëheqës që shpërndajnë rrezet në të gjitha rrethet. Prandaj, ju, shokë të komitetit të Partisë, në këtë drejtim keni përgjegjësi jo vetëm për qytetin tuaj, por për gjithë Shqipërinë. Për këtë edhe Komiteti Qendror duhet t'ju ndihmojë më shumë. Puna juaj për edukimin e intelektualëve duhet të forcohet akoma më shumë dhe, në fund të vitit, kur të bëni raportin vjetor të pasqyroni edhe punën që është bërë në këtë drejtim. Kritikrat që u bëtë shokëve sekretarë do t'u vlejné atyre për një punë më të mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga kopja e  
procesverbalit të mbledhjes së  
byrosë së Komitetit të Partisë  
të qytetit të Tiranës që gjendet  
në AQP*

## FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCËN KOMBËTARE PËR SHITIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E LOPËS

23 mars 1958

Të dashur shokë,

Është një gëzim i madh për ne kur shohim se vija e Partisë, direktivat e saja, përqafohen me kaq entuziazëm nga populli ynë. Natyrisht, ato zbatohen në jetë me luftë dhe përpjekje. Nga lufta dhe përpjekjet e popullit tonë janë arritur rezultate shumë të kënaqshme, që kanë përmirësuar jetën e popullit shqiptar. Kjo ka ngjallur besimin e madh të popullit të Partia jonë. Këtë besim e shprehu kushdo që foli e veçanërisht një njeri i popullit, një ish-oficer i Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare, që është çmobilizuar e që ka shkuar në bujqësi ku ka punuar mirë e kooperativa e Zharrëzës e ka zgjedhur në udhëheqjen e saj. Ai në bashkëpunim me kolektivin ka arritur rezultate shumë të kënaqshme, ata e kanë transformuar bujqësinë, kanë përmirësuar jetën e popullit të atij fshati, kanë zbukuruar jo vetëm fushat, por edhe kodrinat, të cilat tani gjelbërojnë nga gruri.

Ne e dimë se Partia, që është pjella e popullit,

mendon dhe punon për të realizuar qëllimin e madh: rritjen e mirëqenies së popullit tonë; të gjitha këto plane për të cilat u diskutua edhe në këtë konferencë këtu synojnë. Dhe realizimi i këtyre planeve ka bërë që në të vërtetë çdo vit të rrojmë më mirë. Pra, planet tona i shërbejnë mirëqenies së popullit.

Por realizimet tona janë kokëçarje për armiqtë, për radiot armike. Radio Londra flet se «u mbush Shqipëria me plane dhe tani do t'i shtohet edhe një kokëçarje tjetër: konferenca për shtimin e përmirësimin e lopës». Po për popullin tonë kjo konferencë është shumë e dobishme për mjaft arësye. Dhe arësyeja kryesore është që populli të ketë më shumë qumësht, më shumë mish, më shumë yndyrna nga ç'ka pasur deri tani.

### **Kolektivizimi i bujqësisë ka krijuar mundësi të shumta që lehtësojnë zhvillimin e lopës**

Përpara (nuk flas vetëm për periudhën para çlirimit, por edhe pas çlirimit të vendit) kur ekonomitë bujqësore ishin të ndara, nuk mund të bëhej fjalë për një zhvillim të tillë të vrullshëm në gjithë sektorët e bujqësisë. Kolektivizimi, pra, sikurse e shohim në jetë, po jep edhe të ne rezultate të shkëlqyera, ashtu si në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore, ku kjo eksperiencë e vendit të parë të socializmit është përvetësuar. E them këtë se ka nga ata që thonë vetes komunistë dhe mendojnë se mund të ngrihet mirëqenia e popullit, sidomos në fshat, edhe pa kolektivizimin. Ata thonë se «kështu është eksperienca

jonë» dhe kështu na pëlqen neve. Vërtet, kjo është puna e tyre. Por kur ide të tilla përdoren për të goditur sistemin e kolektivizimit, atëhere ne kemi fjalën tonë, sepse këtu preken parimet dhe kërkohet të hidhet poshtë eksperiencia 40-vjeçare e Bashkimit Sovjetik, që ka dhënë kaq prova. Por të shohim ç'tregon edhe eksperiencia jonë.

Pas çlirimit, pushteti popullor u ka dhënë fshatarëve ndihma të mëdha. Mirëpo a ka mundur fshatari ynë që gjatë shtatë apo tetë vjetëve, kur kolektivizimi nuk ishte në këtë shkallë që është sot, të zhvillonte bujqësinë dhe të përmirësonte jetën e tij, siç ndodhi pas hyrjes në kooperativë? Nuk ka mundur. Prandaj, ne mund të themi se, me gjithë ndihmën që ka dhënë shteti ynë, me gjithë kujdesin e qeverisë e të Partisë sonë, prona private nuk ka lejuar një zhvillim me ritëm të shpejtë si tani. Pastaj, për të vajtur në socializëm, nuk është puna vetëm që të krijohen bloqe të mëdha tokash ku të punohet me mjete të mekanizuara bujqësore, duhet të bëhet edhe edukimi i njerëzve, të krijohet një njeri i ri, te i cili të zhvillohet ndjenja e kolektivitetit. Por duke nxitur ndjenjat mikroborgjeze të fshatarit, konkurrencën në treg dhe tendencën e spekulimit, në asnjë mënyrë s'mund të ndërtohet socializmi. Le të marrim si shembull planin për zhvillimin e ullirit, që ka ndër marrë Partia jonë e për të cilin brez pas brezi populli shqiptar do t'i jetë mirënjohës Partisë së tij të Punës, socializmit. Për shekuj me radhë gjyshërit e stërgjyshërit e fshatarëve të Cakranit të Mallakastrës kanë mundur të mbjellin vetëm 16 000 rrënjë ullinj, ndërsa vetëm vjet, në një vit, po ai fshat mbolli 16 000 rrënjë.

Kemi bërë plane të guximshme edhe në lidhje me frutikulturën. Po ç'ndodhi? I thua popullit të rrethit të Fierit ose të një rrethi tjetër të mbjellë 400 mijë rrënjë, ndërsa ai mbjell 2 milion rrënjë. I thua një kooperative të mbjellë 5 hektarë vreshta e ajo mbjell 150 hektarë. Ç'tregon kjo? Kjo tregon drejtësinë e vijës së Partisë, drejtësinë e sistemit tonë socialist, forcën e kolektivizimit.

Pra, edhe eksperiencia jonë e vogël hedh poshtë pretendimet se kolektivizimi nuk ka dhënë frutet e duhura në fshat. Është fakt se te ne, që kur filloi sulmi i kolektivizimit, që kur fshatarësia e kuptoi më mirë se ç'është kolektivizimi dhe u fut në kooperativat bujqësore, në fshatrat tona filluan të ndërtohen aq shumë shtëpi të reja sa habitet çdo njeri; po ndërtohen fshatra të tëra. Kush ia dha këtë forcë fshatarit tonë? Ia dha kolektivizimi, ai e bëri të ngrejë mirëqenien e tij.

Jo vetëm jeta e fshatarit, por jeta e gjithë popullit po përmirësohet me ritëm më të shpejtë tani, me zgjerimin e kolektivizimit. Merreni me mend se ç'bëhet në ato vende ku nxiten tendencat spekulative të fshatarit! Mendoni se ç'bëhet në treg dhe kush vuan nga këto! Natyrisht, vuan klasa punëtore.

Të shohim tani ç'mundësi krijon kolektivizimi në lidhje me shtimin dhe përmirësimin e lopës.

Studimi që i kanë bërë këtij problemi Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria, raporti që paraqiti këtu ministri i bujqësisë dhe diskutimet tuaja, që ishin një aprovim luftarak i vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë e të qeverisë për këtë çështje, treguan qartë se ekzistojnë mundësi të mëdha për të ecur me besim e

kurajë drejt shtimit dhe përmirësimit të lopës. S'ka asnjë dyshim se shifrat e raportit do të kapërcehen. Këtë e ka treguar jeta. Së shpejti këto shifra nuk do të jenë më reale, se forca e Partisë, forca e fshatarësisë sonë dhe e kolektivizimit do t'i kapërcejë. Këtë besim na e japin rezultatet e arritura kohët e fundit në shumë kooperative. Të marrim p.sh., kooperativën e Ajazmës në rrethin e Shkodrës. Ajo u ka shpallur garë të gjitha kooperativave të Shqipërisë dhe është gjë e mirë që kësaj gare iu përgjegjën me qindra kooperative. Do t'i kalojë Ajazma, apo do ta kalojnë, këtë do ta shohim, por shokët e Ajazmës duhet ta dinë mirë se do të kenë konkurrentë të fortë. Shokët e Shkodrës gjithashtu, shpallën këtu një garë të re. Natyrisht, shokët e rretheve të tjera u gjendën pak si të papregatitur për t'iu përgjegjur në çast garës, por me siguri do t'i përgjigjen. Duket qartë se shokët e Shkodrës për shifrat e garës së shpallur nuk kanë menduar në hava, por i kanë studjuar në praktikë të ndihmuar nga Instituti Zooteknik dhe duke u konsultuar me specialistë, prandaj, megjithëse zotimet e tyre janë të mëdha, ato janë të realizueshme.

Po kush i bëri të gjitha këto? Mos vallë u bënë me frymën e shenjtë? Jo, këto i bëri kolektivizimi, forca e Partisë sonë, që ringjalli popullin, që i bëri të mirë edhe njerëzit me mentalitet të vjetër. Ne e dëgjuam këtu Vasfi Samimin. Në jetën e tij ka pasur gjëra të ndryshme, e tillë që edukata, ambienti i regjimeve të vjetra ndikoi në jetën e tij, por Partia i dha dorën, e bëri njeri të ri dhe të gjithë ju e pëlqyet diskutimin e tij. Ai është njeri i vlefshëm për popullin dhe respektohet. Me mijëra njerëz të vjetër e të rinj ka edukuar Partia. Të tillë janë

edhe të rejat si Adile M. dhe Zhaneta P., të cilat folën këtu.

Pra, mundësitë ekzistojnë, shokë, por duhet ta kuptojmë se çështja e shtimit dhe e përmirësimit të lopës nuk është një punë e lehtë. Të gjithë e dimë dhe e shohim se kemi qenë shumë prapa në rritjen e lopës. Sektori i rritjes së lopës është edhe sot akoma shumë i prapambetur. Me gjithë dashurinë që ka populli ynë për gjënë e gjallë, këtij sektori nuk i ka vënë rëndësinë e duhur, prandaj ne duhet të bëjmë, si kemi bërë edhe në sektorët e tjerë, një kthesë rrënjësore, një revolucion, d.m.th. nga kjo prapambetje të arrijmë në një zhvillim të përparuar për rritjen, për mbarështrimin, për prodhueshmërinë e lopës.

Mundësitë janë të mëdha, por çështja nuk është e lehtë.

E para e punës është që të krijohen tufat, të krijohen fermat, se është e padurueshme një situatë e tillë që të ngrihen kooperativat dhe të mos kenë fermën e lopëve. Sot kur në kooperativë shumica dërmuese e tokës është kolektive, numri shumë i vogël i lopëve kolektive ndaj lopëve që kanë anëtarët paraqet një përpjesëtim shumë të parregullt që duhet ndrequr me doemos. Ne shohim që brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër kur Partia dha direktivën për shtimin e lopëve, kur dha direktivën për përgatitjen e kësaj konference kombëtare, me vendosmëri filloi të shtohet lopa në fermat e kooperativave. Ne kemi bindje se shtimi i numrit të lopëve në fermat e kooperativave do të bëhet me shpejtësi, se kooperativistët tanë e kuptojnë këtë problem kaq jetik për ata dhe për vendin tonë dhe nuk u

mungon patriotizmi. Shokët e Shkodrës treguan këtu për patriotizmin e fshatarësisë sonë. Shembuj të tillë ka kudo në fshatrat tona. Duhet të bëhet e qartë se ai që ndihmon kooperativën në forcimin e pasurisë kolektive, ndihmon veten e tij, sepse në kooperativë është e ardhshmja e tij, e ardhshmja e fëmijëve të tij. Pra, anëtar i kooperativës që ka lopë, mëshqerra ose viça të tepërt të bëjë sakrifica dhe t'ia japë kooperativës. Në qoftë se kooperativa ka mundësi që t'ia paguajë në dorë lopën, mëshqerrën ose viçin femër, t'ia paguajë, në qoftë se nuk ka mundësi, le t'ia paguajë me këste. Kjo është një sakrificë tjetër, që duhet ta bëjë medoemos fshatari, por edhe këtë e bëjnë për veten e tij. Në këtë drejtim po ecet, por duhet të punohet edhe më tepër. E rëndësishme është ajo që shumë shokë këtu e thanë me fjalë popullore: nuk është fjala vetëm për të blerë, por kryesorja është mbarështrimi i mirë, d.m.th. të krijojmë kushte të tilla për lopët që t'i shtojmë në radhë të parë nga pjellshmëria. Pra, të punojmë në mënyrë të tillë që çdo vit të marrim nga çdo lopë një viç.

Formimi i fermave, natyrisht, nuk do të shkojë si gjalpë, qoftë me blerjen, qoftë me shtimin e pjellshmërisë, por edhe kjo nuk është e vetmja gjë, sepse lopët duhen mbajtur mirë. Shokët e Lezhës, p.sh. kanë vepruar shumë mirë që vajtën deri në Kukës e në Peshkopi për të blerë lopë, por duhet të mos i lëshojmë këto në kunje dhe në batak. Duhet të kemi dashuri për lopën dhe kjo dashuri duhet treguar jo me fjalime, por duke e mbajtur mirë e pastër dhe duke e ushqyer.



## Sigurimi i bazës ushqimore është kusht i domosdoshëm për shtimin dhe për përmirësimin e lopës

Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria mendojnë se sigurimi i bazës ushqimore është një nga kushtet më të rëndësishme për shtimin dhe për përmirësimin e lopës. Në këtë drejtim duhet të jemi realistë dhe të pranojmë se me rezultatet e deritanishme nuk mund të jemi të kënaqur, prandaj duhet të shkundemi që të mund të arrijmë rezultate më të mira. Çështja e të ushqyerit të lopëve duhet studjuar mirë, sepse sikurse e thanë shumë shokë kooperativistë dhe specialistë që diskutuan në këtë konferencë, ky problem duhet të zgjidhet jo vetëm në mënyrë praktike, por edhe në mënyrë shkencore.

Në radhë të parë duhet të prodhojmë ushqimet që i nevojiten lopës. Për këtë duhet punë, duhet derdhur djersë dhe së dyti duhet menduar për një kombinim më të mirë të këtyre ushqimeve. Në përgjithësi dihet se lopët duhet të ushqehen mirë, por, sikurse e thanë mjaft specialistë në diskutimet e tyre, qumshti përmban shumë lëndë si proteina, yndyrë, laktoze e vitamina, prandaj lopëve duhet t'u sigurohen këto lëndë me anën e ushqimeve të shumëllojshme. E rëndësishme është që qumshti të ketë yndyrë sa më shumë dhe në këtë drejtim duhet punuar. Prandaj, përveç sigurimit të ushqimeve në sasi, duhet të punohet në mënyrë shkencore për të caktuar ushqimet më të përshtatshme për llojet e ndryshme të kafshëve. Rëndësi ka edhe mënyra e përgatitjes dhe e përpunimit të ushqimeve. Lopa, si çdo qenie e gjallë, në fazat e ndryshme të zhvillimit të saj kërkon kujdes dhe trajtim të ndryshëm. Kështu, kur viçi është i porsalin-

dur, ka një trajtim dhe të ushqyer të posaçëm, kur rritet, një trajtim tjetër dhe kur bëhet mëshqerrë e më vonë lopë, kujdesi ndryshon, ndryshojnë edhe kërkesat për ushqim dhe mbarështrim në përgjithësi. Prandaj lopa nuk duhet konsideruar vetëm si një fabrikë qumshti, por, ashtu sikurse është në fakt, një qenie e gjallë, një kafshë me ndjenja, me hujë dhe zakone të saj. Këto duhen pasur parasysh në rritjen e lopës dhe, që ajo të prodhojë sa më shumë qumësht, duhet të zbatohen mirë të gjitha këshillat e specialistëve tanë.

Roli i sasisë dhe i cilësisë së ushqimeve të lopa është i njëjlojtë me sasinë dhe cilësinë e lëndës së parë që përdoret në industri. Për shembull, kur Kombinatit të Tekstileve «Stalin» i jepet lëndë e cilësisë së dytë ose të tretë, edhe stofrat që nxjerr janë të kësaj kategorie, ndërsa kur furnizohet me pambuk të cilësisë së parë ose ekstra, nxjerr stofra të tilla të cilat pëlqehen nga të gjithë. Po kështu, edhe lopa kur ushqehet me ushqime jo të mjaftueshme ose me cilësi të dobët, atëhere do të prodhojë qumësht pak e me shije jo të mirë. E kundërta ndodh kur ajo ushqehet rregullisht dhe me ushqime të përshtatshme.

Shumë mirë e shtroi këtu problemin e të ushqyerit të lopës specialisti ynë Bogdani, duke folur për organizimin e konvejerit të gjelbër në NBSH-në e Sukthit. Eksperienca e kësaj ndërmarrjeje, megjithëse me të meta, ka rëndësi të madhe, prandaj duhet ta vlerësojnë drejt jo vetëm ndërmarrjet bujqësore, por edhe të gjitha kooperativat bujqësore, të cilat përbëjnë pjesën dërmuese në ekonominë tonë bujqësore. Kooperativat tona nga dita në ditë po forcohen dhe po e shtojnë numrin e

lopëve kolektive. Kështu që u del detyra të përvetësojnë dhe të zbatojnë gjerësisht metodat e përparuara në ushqimin e kafshëve, veçanërisht në atë të lopës, me qëllim që nga kjo të merret sa më shumë qumësht.

Mundësitë janë, shokë, por këtë eksperiencë ta studjojmë si duhet dhe me kujdes. Ne jemi realistë dhe nuk themi se këto metoda shkencore do t'i vëmë në jetë brenda tre muajve ose një viti. Por duhet të ecet në këtë rrugë. Këtu u tha se «sikur misrin ta vjelim në fazën e pjekjes së dyllit, atëhere me kashtën akoma të gjelbër mund të bëjmë afro 500 000 ton silazh». Pse të themi «sikur» dhe për çfarë arsye? Një gjë e tillë, përkundrazi, duhet bërë medoemos.

Për të siguruar ushqime të silazhuara, është e domosdoshme që këtë problem kaq të rëndësishëm ta marrin në dorë kryesitë e kooperativave bujqësore dhe organizatat e Partisë. Menjëherë duhet filluar nga zgjedhja e vendeve të përshtatshme, nga çelja e gropave (transheve) dhe nga sigurimi i të gjitha materialeve të nevojshme, në mënyrë që kjo punë të mbarojë deri në muajin qershor. Ministria e Bujqësisë duhet të përgatitë udhëzime të posaçme dhe të marrë të gjitha masat për ta drejtuar këtë problem kaq të madh.

Partia ka punuar në këtë drejtim dhe, kemi përparime, megjithëse plani i silazhimit vitin e kaluar nuk u realizua. Por edhe sikur të qe realizuar plani, ky ishte i pamjaftueshëm. Atëhere përse të ecet me kaq ngadalësi? Objektivisht nuk na pengon asgjë. Natyrisht, këto gjëra nuk mund të bëhen menjëherë, por sidoqoftë ritmi duhet shpejtuar. Kur ne vëmë detyrën që t'i japim popullit sa më shumë qumësht, gjalpë, djathë, gjizë e të

tjera, pse të themi «sikur...»? Jo, nuk duhet të themi kështu. Njerëzit e Shqipërisë së re nuk duhet të thonë «sikur», por të luftojnë që kjo të realizohet.

Silazhimi i kashtës së misrit është njëkohësisht edhe një mjet i mirë për luftimin e krimbit të misrit kur prerja bëhet rrafsh me tokën. Mirëpo kallamishte të gjata akoma shihen në ara. Kjo ndodh se fshatari ose kooperativisti nuk kanë filluar ta kuptojnë rëndësinë e kësaj mase agroteknike. Prandaj ne duhet të punojmë që metodat e përparuara agrozooteknike, eksperiencën e përparuar të Bashkimit Sovjetik dhe të specialistëve tanë, t'i vëmë në jetë me ritëm më të shpejtë, pasi vetëm kështu mund të zgjidhim problemet e rëndësishme dhe vendimtare për zhvillimin dhe përmirësimin e racës së lopëve, e në radhë të parë për të ushqyerit e tyre.

**Strehimi dhe kujdesi për një trajtim më të mirë janë kusht për përmirësimin e lopës dhe për ngritjen e prodhueshmërisë së saj**

Ushqimi është kryesorja, por lopa, si dhe njeriu, ka edhe nevoja të tjera; ajo s'do vetëm ushqim por edhe strehim. Natyrisht, nuk është koha që të ndërtohen stalla moderne sikurse ka ndërtuar kooperativa bujqësore e Cakranit në Mallakastër, por as edhe t'i lëmë lopët pa strehim fare, në mëshirën e natyrës, sidomos tani që ne kemi kooperativa bujqësore, të cilat i kanë mundësitë materiale për të bërë ndërtime. Lopëve duhet t'u ndërtojmë stalla të përshtatshme e higjienike, me materiale që ndodhen në vend. Në drejtim të sigurimit të stre-

himit për gjënë e gjallë duhet të luftohet mentaliteti i vjetër që ekziston si për rastin e lopës ashtu edhe për delen, se këto kafshë mund të jetojnë të lira, pa mbrojtje, sepse «perëndia ua ka bërë rrobat me vete». Ato duhen mbajtur pastër, si njerëzit. Lopët duhet të kashiten, të kontrollohen nga veterineri siç kontrollohen njerëzit nga mjeku, se, siç e thanë këtu edhe shokët, lopa është një kafshë «fisnike» dhe shumë e ndjeshme.

Një kooperativist më thoshte se një burrë që punonte si stallier, nuk e di çfarë hall kishte dhe e goditi lopën. A e dini se ç'ndodhi? Lopa për katër ditë rresht nuk i dha asnjë kovë qumësht. Prandaj, Partia shtron çështjen që të shtojmë kujdesin për lopën dhe këtë punë t'ia besojmë gruas, e në radhë të parë vajzave të reja. Kjo është një gjë me shumë rëndësi, sepse lidhet me karakterin e gruas dhe me natyrën e saj për të qenë më e gatshme në shërbim e më e sjellshme, si dhe më e dhimbsur dhe e durueshme në krahasim me burrat që janë më pak të durueshëm. Del, pra, nevoja që në këtë punë të futim sa më shumë gra dhe të reja dhe do të shohim se kjo do të influencojë në zhvillimin e shpejtë të lopës në vëndin tonë.

Një çështje tjetër që u ngrit këtu e që ne duhet ta kemi parasysh është kujdesi që duhet të tregojmë në kohën e mbarsjes, të tharjes<sup>1</sup> dhe të pjelljes së lopës. Tani që ne shkojmë drejt mbajtjes në stallë të lopëve, kjo nuk do të thotë që t'i mbyllim lopët «në burg», por

---

<sup>1</sup> Kështu quhet periudha para pjelljes kur lopa nuk jep qumësht.

përkundrazi t'u krijojmë kushte për t'i mbajtur sa më gjatë në ajër të pastër e në livadhe, sikurse kanë vepruar Ferma e Sukthit dhe ndërmarrje të tjera duke i mbajtur lopët në çaire, në rreze të diellit dhe në ajër të pastër. Këtë sistem rritjeje duhet ta praktikojë çdo kooperativë, duke siguruar kullota natyrale të pastra dhe të mbajtura mirë, veçanërisht livadhe artificiale dhe gjysm-artificiale, në mënyrë që nga lopa të marrim më shumë qumësht dhe mish, të mirë e të këndshëm, njëkohësisht ta mbrojmë nga sëmundjet, veçanërisht nga tuberkulozi. Prandaj, lopët duhet të nxirren në kullotë, në ajër të pastër gjatë gjithë vitit, duke u siguruar vargun e ushqimeve të gjelbëra (konvejerin e gjelbër) gjatë gjithë stinëve të vitit, që, së bashku me silazhet, t'ua bëjmë lopëve gjithë vitin «prill e maj».

Tuberkulozi në gjedhe duhet të na tërheqë vëmendjen ashtu siç e theksoi shkencëtari Dr. Vavako. Në këtë drejtim po punohet dhe po luftohet për kufizimin e tij, për zhdukjen e tij nga tufat e ndërmarrjeve tona bujqësore. Por, natyrisht, ne u tërheqim vëmendjen shokëve të Institutit Zooteknik në Shkodër që nuk kanë treguar kujdes dhe kanë lejuar që nga një ose dy lopë të infektuara nga tuberkulozi, sëmundja të përhapet në 40-50 krerë të tjerë. Këtu u tha se në ndërmarrjet tona, për arsye të ndryshme, kemi mjaft lopë të prekura nga sëmundja stallore, tuberkulozi, dështimi ngjitës etj. gjë që s'është e pëlqyeshme. Prandaj, duhet të tregojmë kujdes, sidomos për viçat, duke i rritur ashtu si këshillon shkenca veterinare. Këtë çështje duhet ta kenë parasysh Partia dhe udhëheqja e kooperativës, sidomos tani, që po krijohen fermat e lopëve e po shtohen krerët

e tyre. Duhet të marrim të gjitha masat që tuberkulozi të mos hyjë në dyert e stallave të kooperativave.

Shokë, unë nuk dua të zgjatem më tutje, se për këto çështje ju diskutuat shumë dhe raporti që u mbajt këtu i trajtoi hollësisht këto probleme. Por këtyre gjërave ne duhet t'u vëmë rëndësi të madhe, se është direktivë e Partisë që lopën ta shtojmë, ta përmirësojmë dhe ta ruajmë nga sëmundjet.

### **Të shtojmë prodhueshmërinë e lopës nëpërmjet përmirësimit të racës**

Çështja e përmirësimit të racës së lopëve ka një rëndësi të madhe. Është kënaqësi kur specialistët tanë thonë se raca e vendit është një racë e shëndoshë, e durueshme, e ambientuar, e cila, po të trajtohet si duhet, ka mundësi të japë prodhim të mirë. Këtu u dhanë shembuj shumë inkurajues që tregojnë se, kur lopët tona vihen në kushte të mira ushqimi e mbarështrimi, e shtojnë prodhimin. Por ne tani luftojmë që të kemi raca lopësh të tjera jo vetëm të bukura në pamje, por që të japin më shumë qumësht dhe bile me përqindje të lartë nyndyre e më shumë mish. Shumë nga ju janë penduar që nuk i kanë trajtuar mirë demat e racës dhe nuk i kanë shfrytëzuar ata, me qëllim që sot të kishim më shumë lopë të përmirësuara dhe me prodhimtari të lartë. Tani t'i vini gishtin kokës, t'i trajtoni drejt damazët dhe t'i rritni me kujdes të veçantë viçat që lindin nga kryqëzimet, sepse ata janë e ardhshmjia e tufave të lopëve.

Qeveria do të marrë masa dhe do të ndihmojë në

drejtim të përmirësimit të racës së lopës, njëloj sikurse u bë edhe për përmirësimin e deles. Populli e bëri të tijin këtë aksion të madh të Partisë dhe patëm sukses. Po përveç çështjes së përmirësimit të racës me anë të kryqëzimeve dhe të përhapjes së metodës së ndërzimit artificial, Komiteti Qendror i Partisë e ka porositur qeverinë që të shikojë në planet e ardhshme mundësitë e sjelljes nga jashtë të një sasive më të madhe lopësh race, për të zgjidhur sa më shpejt problemin e qumshit për furnizimin e popullit tonë.

### **Më shumë kujdes për kualifikimin dhe përgatitjen e kuadrove të blegtorisë**

Sa thashë deri tani janë njëra anë e çështjes. Që të shtohet lopa dhe të rritet prodhimi i saj duhen kuadro. Për të gjitha gjërat duhen kuadro, sepse kuadri ndikon shumë në zgjidhjen e çështjeve. Prandaj edhe në këtë sektor duhet punuar seriozisht për përgatitjen e kuadrove të lartë e të mesëm. Ne jemi dakord me sa u tha këtu, që numri i kuadrove të lartë e të mesëm teknikë është shtuar shumë pas çlirimit. Ky është një sukses i madh për Partinë tonë. Sot ne kemi jo vetëm numrin e teknikëve që ëndërronin specialistët tanë në të kaluarën, por me krijimin e Institutit të Lartë Bujqësor dhe të teknikumeve çdo vit numri i tyre do të shtohet. Këtë vit do të kemi edhe mbi 70 veterinerë dhe zooteknikë të lartë dhe brenda një kohe të shkurtër ne do të kemi kuadro të lartë në një numër akoma më të madh. Por a do të jenë të mjaftueshëm këta? Jo. Ritmi i shtimit të



kuadrove tanë do të jetë i vazhdueshëm, sepse kemi nevojë të mësojmë armata të tëra njerëzish, që të punojnë në fabrika, në fusha, në stalla, t'u japim atyre diturinë që të prodhojnë për veten e tyre dhe për popullin.

Rëndësi të veçantë ka çështja e krijimit të kuadrove të mesëm zooteknikë dhe veterinerë, si dhe të kuadrove me arsim të ulët teknik, mjelës, brigadierë etj. Ministria e Bujqësisë duhet ta ketë parasysh këtë gjë. Ne, për organizimin e ndërzimit artificial në dhen, përgatitëm një numër të madh teknikësh në kurse të shkurtëra, duke i pajisur pjesëmarrësit me minimumin e njohurive. Këta nuk dolën teknikë të përsosur, por detyrën e ngarkuar e kryen më së miri. Përgatitjes së këtyre kuadrove duhet t'i jepet një rëndësi akoma më e madhe tani që plani i përmirësimit të dhenve dhe lopëve me ndërzim artificial do të dyfishohet. Prandaj kuadrot e përgatitur nuk mjaftojnë, të tjerë duhen përgatitur sa më parë. Veç kësaj në të ardhshmen Ministria e Bujqësisë duhet të organizojë kurse 4-5 mujore për t'u dhënë njohuri më të gjera atyre që kanë dalë nga kurse të shkurtëra dhe për t'i përgatitur që të ndjekin gradualisht shkolla më të larta. Nga këta njerëz, që janë njerëzit e së ardhshmes, ne do të kemi me dhjetëra mijëra në të gjithë sektorët. Prandaj Partia dhe qeveria, nëpërmjet dikastereve përkatëse, duhet të marrin masa për perfeksionimin e vazhdueshëm të tyre. Në fakt kemi përgatitur mjaft kuadro nëpër kurse, mirëpo, nga pakujdesia e dikastereve përkatëse, këta janë larguar dhe kanë zënë punë të tjera. Këtëj e tutje një gjendje e tillë nuk duhet të lejohet.

Çështjes së bujqësisë Partia i vë një rëndësi të ma-

dhe. Pa bujqësinë nuk mund të zhvillohet industria; pa industrinë dhe bujqësinë nuk mund të ndërtohet socializmi. Socializëm do të thotë të ushqehesh, të vishesh mirë dhe të jesh i kulturuar. Por ekzistojnë mentalitete që nënvleftësojnë punën në bujqësi. Fare mirë foli këtu shoqja Zhaneta, së cilës, kur vajti të punojë te viçat, e motra i tha: «Ç'të duhet ty ky zanat»? Sikur kjo të kishte vajtur të bëhej «qatipe» ose një daktilografiste, motra e saj do të ishte jashtëzakonisht e kënaqur, sepse do të mendonte se hyri në radhën e personaliteteve. Por tani puna ka ndryshuar: zyrtar do të thotë shërbëtor i popullit dhe, në qoftë se qepesh vetëm në zyrë, të jesh i bindur se populli nuk të do. Populli do njerëzit që krijojnë në luftë me vështirësitë. Megjithëse puna është çështje nderi, ka nga njerëzit e vjetër, si dhe nga brezi i ri, të atillë që, duke notuar në mbeturinat mikroborgjeze, përpiqen të mënjanojnë nga fronti i punës në prodhim. Të tilla raste vërtetohen në djemtë tanë, djem të partizanëve që kanë mbaruar ose vazhdojnë shkolla të larta dhe molepsen me shfaqje të huaja. Si inxhinier që e ka pregatitur Partia dhe populli dërgohet atje ku e kërkon nevoja, por ai të thotë pa gjë të keq: «Nuk vete në Patos, por dua në Qytetin «Stalin», se atje ka më shumë komoditete»; ose «nuk shkoj në Hidrocentralin «Karl Marks» po në Tiranë, se nuk dëshiron gruaja». Duke biseduar me studentë të fakultetit të drejtësisë, të cilët mbarojnë studimet së shpejti, më thanë se kanë hyrë në merak se nuk dinë ku do të emërohen, pasi të gjithë duan të qëndrojnë në Tiranë. Por Tirana nuk është Shqipëria. Shqipëria është kudo, jeta është kudo, lufta është kudo, nderi është në fushë, në fabrikë, me popullin, në

baltë e në përpjekje, në mundime, atje ku krijohet. Në mënyrë të veçantë kjo duhet pasur parasysh për ata që mësojnë në shkollat bujqësore, që të lidhen sa më shumë me praktikën. Mirëpo nuk po ndodh kështu. Unë këtu kam parasysh Institutin e Lartë Bujqësor. Shoku Mentor Përmeti është njeri i përparuar nga çdo pikëpamje, por studentët e institutit nuk i dërgon në Fermën e Kamzës që është ngjitur me institutin, me qëllim që këta të lidhen me praktikën, me punët bujqësore. Ç'i thonë këtij? Institut bujqësor apo institut jurisprudence? Bile edhe studentët e fakultetit të drejtësisë do të bëhen të aftë për detyrat e tyre vetëm po të mbajnë lidhje të rregullta me jetën, me praktikën, me hallet e popullit. Në goftë se studenti nuk lidhet me praktikën e bujqësisë, ai nuk do të bëhet teknik i mirë dhe nuk do ta dashurojë mjeshtrinë e vet. Kjo ndodh edhe në teknikumet bujqësore. Prandaj puna duhet kapur në rrënjë, qysh në shkollat fillore, veçanërisht në shkollat e fshatrave. Mësuesit duhet t'i edukojnë fëmijët me ndjenjën e dashurisë së madhe për atdheun. Lumturia e atdheut tonë është e lidhur ngushtë me dashurinë e njerëzve për punën, për bagëtinë, për delen, për lopën, për vreshtat dhe për gjithshka që krijon të mirat materiale për popullin tonë. Në këtë mënyrë fëmijët e kuptojnë realisht ç'është atdheu. Njerëzit që dalin nga shkollat e fshatit duhet të lidhen në radhë të parë me punët e bujqësisë. Me këtë nuk dua të them që djemve të fshatit t'u mbyllen dyert e sektorëve të tjerë. Djemtë e fshatarëve do të venë kudo, do të punojnë kudo, por shumica e fshatarësisë duhet të lidhet me fshatin dhe të luftohet tendenca e nënvlefësisimit të punës në fshat, të goditet fryma e ploghshtë

në njerëzit e ardhur në qytet që nuk duan të venë përsëri në fshat, sepse atje duhen më tepër përpjekje, sepse atje mungon kinemaja. Por në fshat do të vejë edhe kinemaja, ashtu sikurse në fakt ka vajtur në mjaft prej tyre. Në fshat duhet të venë, sepse fshati është pjesa më e madhe e Shqipërisë.

Një tjetër këshillë e Komitetit Qendror të Partisë është që kryetarët e kooperativave bujqësore të bëjnë më shumë përpjekje për ngritjen e tyre profesionale, për të mbaruar të paktën teknikumet bujqësore me korrespondencë. Në të njëjtën kohë kryesitë e kooperativave të mendojnë seriozisht për të dërguar sa më shumë njerëz të aftë në kurse dhe në shkolla bujqësore. Ka ardhur koha që për zhvillimin dhe për forcimin ekonomik e organizativ të kooperativave bujqësore duhen njerëz të mësuar, të cilët duhet të dalin nga vetë kooperativat. Në qoftë se nga një kooperativë bujqësore dërgohen 7 deri 10 të rinj për të mësuar dhe shpenzohen disa dhjetëra mijëra lekë, kjo nuk është humbje për kooperativën, por përkundrazi, është fitim i madh, sepse nga organizimi dhe drejtimi më i mirë i ekonomisë kolektive, kooperativa do të ketë të ardhura më të mëdha.

Mentaliteti që të kënaqemi me pak është i gabuar, prandaj për përgatitjen e kuadrit duhet të punohet më shumë. Një barrë e madhe për këtë problem i bie Partisë, që duhet të bëjë një punë akoma më të mirë si dhe Ministrisë së Bujqësisë, e cila duhet të interesohet në mënyrë të veçantë për kuadrot e sektorit të saj.

## Më tepër kujdes për përmirësimin e lopëve personale të anëtarëve të kooperativave bujqësore

Tani, shokë, pas kësaj konference, ne kemi bindje të plotë se lopa do të marrë një zhvillim të mirë në sektorin kooperativist. Por në këtë rast nuk duhet të harrojmë edhe zhvillimin dhe përmirësimin e lopëve në pronësi personale të anëtarëve. Ky vrull i madh të mos bëjë që të harrojmë rritjen e mirë, ushqimin e përshtatshëm dhe kujdesin e veçantë që duhet të tregohet edhe për lopën personale të anëtarit të kooperativës. Kjo lidhet drejtpërdrejt me interesin dhe mirëqenien e familjes. Ju mund të thoni se anëtari i kooperativës e ka vetë merak këtë punë. E ka, por edhe nuk e ka, sepse po ta kishte këtë merak ai vetë, nuk do të merrte 300 deri 400 litra qumësht në vit, ndërsa ne dëshirojmë që ai të marrë të paktën 1000-1200 litra, bile edhe më shumë. Ne dëshirojmë gjithashtu që kooperativisti në zonat fushore të mbajë më mirë një lopë qumshti prodhuese se sa 20 krerë dhen për të cilat, me çeljen e tokave dhe ngushtimin e kullotave, vështirësohet seriozisht mbajtja dhe shfrytëzimi ekonomik.

Kooperativa duhet t'i ndihmojë anëtarët që lopët e tyre t'i rritin mirë, t'i ushqejnë mirë për të marrë sa më shumë prodhime. Në këtë mënyrë qumshti do të jetë më me bollëk në familjet e tyre.

## Mbi disa detyra aktuale për bujqësinë

Unë, shokë, nuk dua të zgjatem shumë për çështjet e bujqësisë sonë, sepse ju i dini direktivat e rëndësishme të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, bujqësisë, shtesat mbi planin, veçanërisht për bujqësinë. Këtë ju vetë e ndjeni, sepse po luftoni për realizimin e këtyre detyrave. Ja, p.sh. fushata e hapjes së tokave të reja pati sukses, sepse në këtë drejtim u mobilizua i gjithë populli e se Partia dhe qeveria morën masa për sjelljen e një shumice tjetër traktorësh dhe maqinerish bujqësore. Por këtej e tutje Ministria e Bujqësisë të ketë parasysh që të sjellë nga jashtë të tilla mjete, traktorë e vegla, që t'u përgjigjen kërkesave të reja të bujqësisë sonë.

Suksese të mëdha janë arritur edhe në çështjen e zgjerimit të frutikulturës. Janë mbjellë deri sot me miliona fidanë dhe të tjera po vazhdojnë të mbillen. Por nuk mjafton vetëm realizimi i planit të mbjelljeve. Duhet marrë masa serioze për ruajtjen e fidanëve të rinj, për mbrojtjen e tyre nga shpërdorimet dhe dëmtimet e njërit ose tjetrit, që, për t'i rënë kafshës, nuk i vjen keq që të thyejë fidanin. Për mirëmbajtjen e pemëve duhet të stërvitim dhe të mësojmë batalione kuadrosh. Këta kuadro masash duhet të njohin teknikën e krasitjes, të shartimeve dhe të shërbimeve të tjera kulturore që u bëhen pemëve frutore në përgjithësi. Këta kuadro duhet t'i krijojmë ne, Partia, Ministria e Bujqësisë, t'i krijojnë vetë kooperativat duke përfitur nga eksperiencia e mrekullueshme e frutikultorëve me ek-

speriencë. Të tillë kemi me qindra dhe mijëra, të cilët e njohin mirë kulturën e ullirit, portokalleve dhe të pemëve frutore të tjera. Pra, kemi mundësi, por duhet vetëm organizim i madh nga Partia për këtë çështje që të marrim frutet e punës sa më parë.

Një problem tjetër që nuk po gjen zgjidhje në kooperativat bujqësore është çështja e plehut. Nga të dhënat që ka Ministria e Bujqësisë për vitin 1957, del se kooperativat bujqësore kanë plehëruar vetëm një pjesë shumë të vogël të sipërfaqeve nën kulturë. Ju e dini se pa pleh nuk mund të merren rendimente të larta dhe të qëndrueshme. Prandaj, del detyrë që kooperativat bujqësore t'i kushtojnë një kujdes të posaçëm grumbullimit dhe përdorimit të plehut organik e të fekaleve, si dhe përdorimit me kriter të drejtë e në mënyrë racionale të plehut kimik. Problemi i grumbullimit dhe i përdorimit racionaal të plehrave të ndiqet me kujdes edhe nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive.

Jemi në kohën e mbjelljeve të pranverës. Sigurisht, moti i keq na ka penguar, prandaj duhet të jemi më të mobilizuar dhe të gatshëm të kryejmë mbjelljet në afa-tet e caktuara agroteknike. Rezultatet e mira që u arri-tën vitin e kaluar në kulturën e pambukut, panxharit të sheqerit, duhanit, misrit e të tjera, treguan se sa rëndësi ka mbjellja me kohë dhe në kushte të mira agro-teknike. Prandaj të vëmë të gjitha forcat për mbjellje të hershme, që të kemi edhe këtë vit një vit më të mbarë bujqësor se ai i kaluari.

## Mbi disa çështje organizative të kooperativave bujqësore

Kooperativat bujqësore duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të futur në gjirin e tyre ekonomitë fshatare individuale, që akoma nuk kanë hyrë në kooperativë. Por kurdoherë në këtë drejtim duhet të ruhem nga gabimet, të ruajmë parimin e vullnetarizmit, t'u rekomandojmë kryesive të kooperativave dhe vetë kooperativistëve që të punojnë me këto ekonomi, sepse ata vetë janë shumë më përpara nga fshatarët që nuk kanë hyrë në kooperativë, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ajo shpirtërore. Prandaj, në këtë punë duhet të jemi shumë të durueshëm dhe zemërgjerë, sepse një pakujdesi, një fjalë e tepruar, një nxitje e zemëron dhe e largon atë, duke bërë që të përfitojë edhe armiku, sepse armiku i ka veshët hapur dhe përpiqet të shfrytëzojë çdo gjë.

Partia jonë, duke udhëhequr me kujdes çështjen e kolektivizimit, i ka kushtuar rëndësi të posaçme forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore. Prandaj ne kemi suksese të mëdha në këtë drejtim dhe këto rezultate kanë qenë shembulli më i mirë, propaganda më konkrete për tërheqjen e fshatarësisë në rrugën e kolektivizimit.

Por unë do të bëj disa vërejtje përsa i përket çështjes së kooperativave. Në kooperativat tona ekzistuese disa herë shkelet statuti. Në kooperativat çështja e punës është çështje nderi: kush punon ha, kush nuk punon nuk ha. Por nga statistikat vjetore të kooperativave, p.sh. në vitin 1957, ne shohim se nuk kanë bërë mini-



mumin e ditëve të punës afro 42 000 vetë dhe nuk kanë bërë fare asnjë ditë-punë afro 16 000 vetë. A mund të lejohet një situatë e tillë? Nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë. Shikoni se ç'forca që nuk shfrytëzohen kemi ne në kooperativa, ose sa vetë hanë në kurriz të njerit apo të tjetrit. Në një kooperativë të rrethit të Fierit pashë një njeri të shëndoshë, që më tërhoqi vërejtjen se rrinte pa punë. E pyeta: «Ç'punë bën?». «Jam kryetar i këshillit» — më tha. «Sa ditë punë ke bërë?» — e pyeta. «Asnjë» — m'u përgjegj. «S'ke turp!» — i thashë. «Ç'e mbani këtë njeri, u thashë shokëve të kooperativës, dhe jo vetëm ç'e mbani si kryetar këshilli, por ç'e mbani edhe në kooperativë?» «Kush të ushqen?» — e pyeta. Më tha se punon gruaja, plaka e të tjera. Të këtillë njerëz parazitë në sistemin tonë socialist nuk duhen.

Në kooperativat bujqësore duhet të shfrytëzohen mirë forcat e punës së kooperativës, që nga kryetari dhe sekretari i organizatës bazë të cilët duhet të jenë shembull në këtë drejtim. Kryetari i kooperativës, llogaritari, sekretari i Partisë duhet të marrin pjesë të gjithë në prodhim. Kjo nuk do të thotë që të braktisin drejtimin dhe organizimin e punës, por ta llogaritin mirë punën dhe një pjesë të kohës së tyre ta përdorin për prodhim. Për shembull, kryetarin e kooperativës së Mëzezit shumë mirë e caktoi Partia edhe si përgjegjës të blegtorisë. Ky duhet të interesohet mirë për sektorin e lopës dhe ta nxjerrë faqebardhë. Ka kryetarë kooperativash dhe sekretarë të organizatave bazë të Partisë të cilëve u jepet një sektor dhe nuk e bëjnë mirë punën. Këta njerëz nuk duhet të rrojnë me të kaluarën. Partia na mëson se njerëzit edukohen, ndryshojnë. Ka njerëz

që, për një arësye ose një tjetër, nga origjina ose pse situata ishte e tillë, nuk punonin, por Partia jonë i korrigjoi e i ndreqi dhe tani ata ecin përpara. Por ka edhe të tjerë që ecin përpara me vrull dhe pastaj mbeten. Këta Partia duhet t'i shtyjë, që të mos bëhen pengesë për të tjerët. Lufta për çlirimin e atdheut ka qenë e madhe dhe heroike, por edhe lufta për ndërtimin e socializmit është po aq e madhe dhe bëhet po aq e rreptë, po aq heroike sa edhe Lufta nacional-çlirimtare. Prandaj ata që bënë Luftën nacional-çlirimtare, që sakrifkuan dhe derdhën gjak, duhet të jenë shembull, të jenë shembull derisa të kenë forca dhe mundësi për të punuar. Kur plaken, atëhere ata zëvendësohen nga brezi i ri, ata ndjejnë kënaqësi kur shohin, se po realizohen dëshirat e tyre. Përse partitë komuniste i quajnë parti të së resë? I quajnë kështu sepse ato janë kurdoherë të reja dhe nuk plaken kurrë, sepse kanë të tilla plane, të tilla programe, kanë burim të pashtershëm popullin, i cili shkon gjithnjë përpara. Në këtë drejtim duhet të punojë Partia në kooperativë dhe njerëzit që dallohen për drejtim të mirë, për punë konkrete dhe që e duan me gjithë shpirt kooperativën të nderohen; ndërsa atyre që u rritet mendja ose që nuk luftojnë sa duhet për realizimin e planeve, t'u tregohet vendi.

Kohët e fundit unë asistova në mbledhjen e një kooperative bujqësore. Pas diskutimeve, kryetari i kësaj kooperative mori zotim për të arritur 14 kv. pambuk për hektar, nga 8 kv. që e kishin. Ndërkaq brigadierët dhe kooperativistët e dalluar që morën fjalën, u zotuan për 16-17 kv. pambuk për hektar. Por pse e bëri kryetari këtë gjë? Sepse këtu ka një farë hileje. Planifikimi

i ulët dhe tejkalimi i planit i siguron kryetarit të ardhura më të mëdha dhe, nga ana tjetër, sepse kryetari e njeh më pak realitetin se sa brigadierët dhe ata që janë më afër prodhimit. Këtu s'jemi në rregull. Në këtë drejtim duhet të luftojnë me forcë të madhe kooperativistët, ndërsa vetë kryetarët duhet të kenë mirë parasysh se edhe sikur të marrin më pak, ata duhet të jenë të gëzuar, sepse fitimet për gjithë kooperativën do të jenë më të mëdha. Tani gjithë kooperativa lufton për 17 kv. pambuk për ha. Tendenca të tilla duhet të luftohen nga Partia dhe nga vetë kooperativistët, sepse një veprim i tillë pengon zhvillimin e kooperativës, rritjen e prodhimit dhe ngritjen e mirëqenies së vetë anëtarëve, dhe nga ana tjetër, krijon edhe pakënaqësi. Po u krijuan pakënaqësi, ato nuk duhen mbuluar, por duhet të sqarohen mirë. Në kooperativë, duhet të thuhet gjithshka. Dhe tani ka ardhur koha që kooperativistët t'ua thonë kryetarëve akoma më me forcë, sepse kritika nuk është e keqe, kritika bën shumë mirë, është si ilaçi që i jep doktori të sëmurit.

Në kooperativat bujqësore, duhet parë mirë edhe çështja e shfrytëzimit të kohës së punës gjatë gjithë vitit dhe jo të veprohet ashtu siç është vepruar deri tani, që punohet vetëm gjatë fushatave, si p.sh. gjatë mbjelljeve, korrjeve, prashitjeve, ndërsa kur vjen stina e dimrit punohet shumë pak, ose nuk punohet fare. Ky problem ka një rëndësi të madhe dhe duhet studjuar nga të gjitha kooperativat bujqësore. Por me këtë nuk dua të them që të krijohen punë vetëm sa për të regjistruar ditë-pune, por punë konkrete, që i sjellin dobi ekonomisë kooperativiste duke ngritur rendimentin e kulturave

bujqësore dhe prodhimtarinë e kafshëve, për t'i siguruar kështu kooperativës të ardhura më të mëdha. Në këtë drejtim duhet t'u japin një ndihmë të madhe kooperativave bujqësore edhe komitetet ekzekutive. Komitetet ekzekutive nuk duhet të lejojnë që t'u shpëtojnë problemet e kooperativave bujqësore, por duhet t'i mbajnë këto në qendrën e vëmendjes së tyre, sepse gati shumica e rretheve tona kanë kryesisht probleme të bujqësisë. Ne kemi përshtypjen, dhe kështu është, se komitetet ekzekutive nuk u japin ndihmën e domosdoshme kooperativave, ndihmën në lidhje me hartimin e planeve, mbajtjen e llogarive, ndarjen e të ardhurave e të tjera. Në bazë të direktivave dhe orientimit që kanë dhënë Komiteti Qendror dhe qeveria, si dhe në bazë të normave që janë caktuar, kjo ndihmë duhet t'u jepet konkretisht. Po kështu, kur bëhet konkluzioni në fund të vitit, domethënë kur kooperativa bën ndarjen e të ardhurave, drejtuesit e Partisë dhe komiteti ekzekutiv në disa rrethe nuk studjojnë me vëmendje eksperiencën e të gjitha kooperativave, duke u mbështetur në të dhënat konkrete dhe vetëm pas një analize të dalin me direktiva dhe detyra të posaçme, bile veças për çdo kooperativë, ku të thuhet se në ç'drejtim duhet forcuar situata, cilat janë mundësitë për shtimin e mëtejshëm të prodhimit (duke e faktuar me shifra), ç'rczerva fshihen akoma në kooperativë, si duhet organizuar më mirë puna etj. Kjo do të jetë një ndihmë shumë e madhe për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore.

Një ndihmë më të madhe në drejtim të kooperativave bujqësore duhet të japë edhe Ministria e Bujqësisë. Kjo duhet të shkulet në këtë drejtim dhe të lidhet më

tepër me bazën, duke i dhënë asaj ndihmë konkrete. Ministrinë e Bujqësisë nuk e nderon aspak fakti që rinisë sonë heroike, në disa vende, nuk i ka dhënë ndihmën konkrete për aksionin e zgjerimit të frutikulturës, që e ka marrë përsipër organizata e rinisë. Këto gjëra nuk duhet të lejohen më në të ardhshmen. Në qoftë se Ministria e Bujqësisë në kohën e fushatave të ndryshme bujqësore nuk gjendet kurdoherë e gatshme për t'i dhënë bazës një ndihmë konkrete me specialistët e saj, atëhere nuk do ta zotërojë situatën. Por me këtë nuk dua të them se Ministria e Bujqësisë nuk ka punuar mirë, sepse bujqësia jonë ka pasur suksese të mëdha. Kjo çështje i vihet në dukje me qëllim që ajo të lidhet akoma më shumë me bazën, sepse problemet janë shumë të mëdha, nevojat akoma më të mëdha dhe detyrat e organizimit edhe më të rënda, prandaj edhe ndihma për bazën duhet të jetë më e madhe.

*Jemi të sigurtë se në rrugën që na udhëheq Partia do të kemi kurdoherë suksese, ashtu siç kemi pasur deri tani.*

Partia jonë është një parti që i ka rrënjët thellë në popull, është një parti monolite, me një unitet të çelniktë, sepse ajo ndjek me besnikëri të madhe marksizëm-leninizmin, se lufton që, duke zbatuar marksizëm-leninizmin në mënyrë krijuese në kushtet e vendit tonë, të krijojë për popullin mirëqenien, bollëkun, me një fjalë të ndërtojë socializmin.

Ne e kemi kurdoherë parasysh se çështja kryesore për Partinë është lidhja me popullin, se Partia, po nuk i pati rrënjët në popull, nuk ka jetë. Partia jonë është e shëndoshë, sepse rrënjët i ka të shëndosha, thellë në popull. Armiqtë tanë të brendshëm dhe të jashtëm për-

piqen t'i dobësojnë këto lidhje dhe për këtë qëllim shpifin kundër Partisë. Ata thonë se vendi ynë gjoja nuk ecën përpara, por shkon prapa se gjoja është varfëruar e plot gjepura të tjera. Por natyrisht, këto nuk zënë vend në masat e popullit. Qëllimi i këtyre armiqve — këtu kam parasysh edhe revizionistët — është të shkatërrojnë Partinë tonë, sepse gjithë përpjekjet e tyre janë përqëndruar në shkatërrimin e partive marksiste-leniniste, për t'i shndërruar ato në parti borgjeze. Revizionizmi, siç e dimë dhe siç u përcaktua në Konferencën e Moskës, ka lidhje të ngushta me punën që bën imperiaлизmi, reaksioni ndërkombëtar, kundër socializmit. Prandaj çështja e mbajtjes pastër të vijës së Partisë është një nga detyrat më të mëdha, në radhë të parë e komunistëve, por edhe e të gjithë njerëzve pa parti, e të gjithë patriotëve që e duan atdheun, që e duan popullin, duan që ai të përparojë dhe të rrojë mirë. Vetëm duke pasur në udhëheqje një parti të fortë marksiste-leniniste dhe një udhëheqje monolite, populli ynë do të përparojë, prandaj duhet ta forcojmë dhe ta ruajmë Partinë.

Ne, komunistët shqiptarë, e kemi thënë dhe e themi se përse i përket mbrojtjes së parimeve të marksizëm-leninizmit nuk bëjmë lëshime. Këtë na e mëson Lenini. Këtë na e kërkon populli ynë. Dhe kur mbrojmë parimet ne nuk kemi frikë nga shantazhet dhe kërcënimet. Pra, shokë, duhet që vijën e Partisë ta mbrojmë, të jemi vigjilentë dhe të forcojmë unitetin tonë, unitetin e Partisë dhe unitetin e popullit me Partinë, se kjo ka rëndësi të madhe. Të gjithë e shikojmë se sado që janë përpjekur armiqtë, s'kanë mundur të gjejnë apo të bëjnë ndonjë të çarë jo vetëm në udhëheqjen tonë, që

është monolite e kompakte, por as në popull; Partia jonë është parti që nuk ka sëmundje.

Përsa u përket mbeturinave mikroborgjeze në ndër-gjegjen e njerëzve, ato duhet t'i spastrojmë rrënjësisht. Ilaçi më i mirë është kritika dhe autokritika, ato e çli-rojnë njeriun, heqin mykun që lë jeta. Ashtu si njeriu shkund rrobat ose pastron këpucët që i zënë pluhur, ashtu duhet ta shkundë e ta pastrojë veten edhe nga mbeturinat mikroborgjeze. Pra, në Partinë tonë situata është e shëndoshë, sepse ajo punon drejt, mbron marksizëm-leninizmin, ka kujdes për kuadrin, dhe jo vetëm për kuadrin e saj, por tregon kujdes të jashtëzakonshëm edhe për kuadrin jo anëtar partie. Kjo është një gjë jashtëzakonisht e rëndësishme, prandaj Partia kujdeset për gjithë njerëzit.

Partia jonë, Komiteti Qendror i saj, janë ekzigjentë dhe kërkojnë nga komunistët që të jenë shembull në çdo gjë, të jenë të sakrificës dhe në vendet më të rëndësishme të japin kurdoherë shembullin. Kjo është e kuptueshme, se komunistët janë ata që kanë kaluar nëpër shumë prova. Cilat janë këto prova? Ato janë lufta për interesat e popullit, gatishmëria për çdo sakrificë, ndershmëria e të tjera. Vetëm duke qenë të tillë komunistët udhëheqin popullin. Kritika dhe autokritika janë ajo armë e shëndoshë që i bën komunistët të jenë gjithmonë të tillë.

Ne, shokë, jetojmë në momente shumë të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme. Gjendja e brendshme karakterizohet nga një hov i madh për ndërtimin e socializmit, për krijimin e bollëkut, në luftë e përpjekje me prapambetjen e të tjera. Dhe kemi suksese

të mëdha. Kurse gjendja e jashtme karakterizohet nga përpjekjet e gjithanshme të Bashkimit Sovjetik e të gjithë kampit socialist, për të forcuar paqen në botë. Këtë politikë të drejtë po e mbështetin me forcë me qindra milion njerëz, jo vetëm në kampin tonë të socializmit, por edhe në vendet kapitaliste. Njerëzit e kulturës, shkencëtarë etj., bile edhe të vendeve kapitaliste e mbështetin një politikë të tillë, por hasin në rezistencën e fortë të qarqeve reaksionare amerikane, në radhë të parë, të cilat bëjnë të gjitha përpjekjet që të vazhdojë «lufta e ftohtë» dhe të përgatitet një luftë e re botërore. Por në qoftë se ata do të shpërthejnë luftën, fitorja do të jetë e jona, e popujve. Kampi ynë është më i fortë. Por ne nuk e nënvleftësojmë armikun, ai është kurdoherë i rrezikshëm; në rast se ti fle, në rast se ti rri, ai të godet. Prandaj, të shtojmë vigjilencën që të mos kemi asnjë pengesë në rrugën e madhe për lumturinë e popujve.

Populli ynë dhe Partia jonë kanë miq të fortë dhe besnikë. Popujt e Bashkimit Sovjetik ne na duan me gjithë shpirt dhe ne i duam ata me gjithë shpirt. Ne kemi miq edhe të gjitha vendet e tjera të socializmit që nga Kina e madhe e deri te Bullgaria fqinjë.

Prandaj, shokë e vëllezër, të punojmë pa u lodhur për ta forcuar ekonominë tonë, të kryejmë detyrat në industri, bujqësi, kulturë e kudo, se kështu forcojmë Republikën tonë Popullore, forcojmë Partinë tonë të Punës, që na udhëheq në socializëm.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 75 (2976), 29 mars 1958*

*Botohet sipas tekstit të steno-grafuar që gjendet në AQP*



**LETËR PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR REDAKSISË  
SË GAZETËS «BASHKIMI» ME RASTIN E  
15-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ**

**25 mars 1958**

**REDAKSISË SË GAZETËS «BASHKIMI»**

*T i r a n ë*

Të dashur shokë,

Me rastin e 15-vjetorit të themelimit të gazetës «Bashkimi», organ qendror i Frontit Demokratik të Shqipërisë, ju përshëndes dhe ju uroj nga zemra suksese të reja në punën tuaj fisnike.

Në kushtet e vështira të Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar, gazeta «Bashkimi», duke zbatuar me besnikëri programin dhe vijën e Frontit Nacional-Çlirimtar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, ka luajtur një rol me rëndësi në mobilizimin dhe në organizimin e masave të gjera të popullit tonë në luftën e shenjtë kundër shkelësve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhëtarëve të vendit, për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore.

Në vitet e para pas çlirimit, gazeta «Bashkimi», si organ qendror i përditshëm i shtypit tonë, ka dhënë një kontribut të madh në përpjekjen vigane të popullit për të rindërtuar vendin e shkatërruar nga pushtuesit fashistë, në organizimin dhe forcimin e pushtetit popullor, në zhvillimin e Shqipërisë në rrugën e revolucionit socialist. Ajo ka luftuar dhe ka demaskuar pa mëshirë synimet dhe veprimtarinë armiqësore të imperialistëve amerikanë, anglezë e të bashkëpunëtorëve të tyre të brendshëm e të jashtëm kundrejt Republikës së re Popullore të Shqipërisë.

Gazeta «Bashkimi», si organ qendror i Frontit Demokratik, vazhdon të kryejë sot një rol shumë të rëndësishëm në forcimin e unitetit moralo-politik të popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë, në mobilizimin e masave të gjera punonjëse në rrugën e ndërtimit të socializmit, në forcimin e pandalshëm të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë. Gazeta «Bashkimi», duke mbështetur politikën e drejtë e paqësore të jashtme të Partisë e të qeverisë sonë, ka dhënë një ndihmë të çmueshme në forcimin gjithnjë e më shumë të miqësisë së popullit shqiptar me popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik dhe me popujt e vendeve të demokracisë popullore që bëjnë pjesë në kampin e fuqishëm socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, në forcimin e miqësisë e të solidaritetit me të gjithë popujt e punonjësit në botë, që luftojnë për paqe, liri e demokraci.

Detyrat e mëdha që ka shtruar Partia e Punës e Shqipërisë përpara popullit shqiptar për zhvillimin me ritëm të shpejtë të vendit drejt socializmit, kërkojnë tani që gazeta «Bashkimi» të forcojë më shumë pro-

pagandën luftarake për zbatimin me sukses të vijës politike të Partisë, të ngrejë më lart cilësinë e shkrimeve, të forcojë lidhjet e saja me masat punonjëse që ndërtojnë jetën e re. Në mënyrë të veçantë gazeta të shpjegojë dhe të luftojë për zbatimin e vendimeve të Partisë në lidhje me fshatin, për kolektivizimin në një kohë sa më të shkurtër të të gjithë bujqësisë së vendit tonë, të popullarizojë në mënyrë konkrete e të kuptueshme të mirat e kolektivizimit, epërsinë e pakundërshtueshme të pronës socialiste mbi atë private.

Shpreh bindjen se gazeta «Bashkimi» edhe në të ardhshmen do të kryejë si kurdoherë me nder detyrat e saja shumë të rëndësishme që i ka ngarkuar Fronti Demokratik dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH  
dhe Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm  
të Frontit Demokratik të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Bashkimi», Nr. 73  
(3940), 27 mars 1958*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# **MBI KOOPERIMIN E ZANATÇINJVE PRIVATË PËR TË PLOTËSUAR MË MIRË NEVOJAT E POPULLIT PËR RIPARIME DHE SHËRBIME**

*Letër dërguar gjithë komiteteve të Partisë në rrethe*

**26 mars 1958**

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE**

Për njoftim:

**KRYEMINISTRISË  
BASHKIMIT QENDROR TË KOOPERATIVAVE TË  
ARTIZANATIT**

Komiteti Qendror i PPSH, duke përqëndruar vëmendjen në zhvillimin e industrisë së rëndë, i ka kush-tuar një kujdes të veçantë edhe transformimit socialist të artizanatit dhe zhvillimit të këtij sektori, i cili si ndihmës i industrisë kombëtare kryen funksione të rëndësishme dhe të shumëllojshme në ekonominë popullore, siç janë prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë kryesisht mbi bazën e shfrytëzimit të lëndëve të para lokale dhe të mbeturinave; plotësimi i nevojave

të përditshme të popullsisë për shërbime, riparime dhe shërbim-ndërtime; prodhimi i artikujve artistikë me motive kombëtare etj.

Zhvillimi me ritme të shpejta i artizanatit të kooperuar u bë i mundur në saje të kooperimit vullnetar të zanatçinjve privatë në kooperativat e artizanatit, të përgatitjes së kuadrove të rinj artizanë si dhe të ndihmës materiale dhe teknike të dhënë nga ana e shtetit. Sektori kooperativist i artizanatit, duke vënë në jetë direktivat e Partisë, ka arritur suksese të mëdha në shtimin e prodhimit dhe përmirësimin e kushteve të punës e të jetës të vetë zanatçinjve të kooperuar.

Por, me gjithë sukseset e arritura në transformimin socialist të artizanatit, duhet vënë në dukje se në vendin tonë ka akoma një numër të konsiderueshëm zanatçinjsh privatë që arrin mbi 4470 vetë, të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në 36 profesione të ndryshme. Kështu, në qytetin e Shkodrës ka afro 330 zejtarë privatë në 27 profesione, në rrethin e Durrësit mbi 260 zejtarë privatë në 28 profesione, në qytetin e Tiranës ndodhen rreth 768 zejtarë privatë në 26 profesione etj.

Duke marrë parasysh faktin se kooperimi i zanatçinjve privatë është pjesë e pandarë e transformimit socialist të vendit tonë, faktor me rëndësi për përmirësimin e kushteve të punës e të jetës të vetë zanatçinjve dhe të shoqërisë dhe në përputhje me detyrat që i ngarkohen artizanatit të kooperuar për t'iu përgjegjur më mirë nevojave gjithnjë në rritje të popullsisë për shërbime e riparime, përpara organizatave të Partisë në rrethe dhe kryesive të kooperativave të artizanatit, shtrohet detyra e kooperimit të këtyre zanatçinjve pri-

vatë. Për këtë, është e nevojshme të forcohet puna e gjallë politike, edukative dhe sqaruese me zanatçinjtë privatë në mënyrë që ata të binden për avantazhet që ka kooperimi i tyre, për kushtet e favorshme që krijohen në organizimin më të mirë të punës, në rritjen e rendimentit dhe uljen e kostos etj. Në këtë drejtim, natyrisht, duhet punuar me takt dhe të mos shkelet në asnjë mënyrë parimi i vullnetarizmit. Organizatat e Partisë kanë grumbulluar një eksperiencë të pasur për kooperimin e prodhuesve të vegjël, por në këtë drejtim duhet punuar me vullnet të madh, ashtu siç po bëhet tani në fshat.

Kooperimi i artizanëve privatë, të cilët sot janë përqëndruar kryesisht në riparime e shërbim-ndërtime, do të ndihmojë për forcimin e këtij sektori ku artizanati i kooperuar, është akoma shumë prapa. Edhe në vitin e kaluar, plani i riparimeve nuk u realizua në asnjë degë; gjithsejt ai është realizuar në masën 73,3 për qind, ndërsa në shërbime të ndryshme 82 për qind. Në artizanatin e kooperuar vazhdojnë të ekzistojnë akoma tendenca të mënjanimit nga detyrat e tija kryesore, që janë shërbimet për popullin dhe prodhimi i artikujve artistikë dhe deficitet e krijuara në këtë sektor të mbulohen me tejkalimet e planit në degët e prodhimit e sidomos të konfeksioneve.

Punonjësit e artizanatit duhet t'i kuptojnë drejt detyrat në rritje për përmirësimin e punës në drejtim të shërbimit më të mirë të popullit, që shtroi Plenumi i Shkurtit i Komitetit Qendror të PPSH. Planit i vitit 1958 në krahasim me realizimin e vitit të kaluar rritet: në riparime gjithsejt 60,2 për qind, në shërbime

43,3 për qind dhe në shërbim-ndërtime 10,5 për qind më shumë. Organet dhe organizatat e Partisë duhet të shtojnë punën e tyre për mobilizimin e artizanëve dhe të luftojnë pikëpamjet e dëmshme se plani është i madh, si dhe të merren masa energjike për realizimin e tij.

Kjo letër të punohet gjatë muajit prill 1958 në mbledhjet e përbashkëta të byrove të komiteteve të Partisë me komitetet ekzekutive të këshillave popullore, në organizatat bazë dhe kryesitë e kooperativave, si dhe në Presidiumin e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit duke na njoftuar dhe masat që do të merrni.

Komiteti Qendror i PPSH ka besim se organizatat e Partisë dhe kooperativat e artizanatit, nën frymën e kësaj letre, do të mobilizohen për të zbatuar detyrat kryesore që i shtrohen artizanatit të kooperuar.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**NDËRTIMI I SOCIALIZMIT KERKON PUNE,  
HEROIZEM DHE NDERGJEGJE TË LARTE  
NGA GJITHË RINIA**

*Fjala e mbajtur në Plenumin V të KQ të BRPSH<sup>1</sup>*

**31 mars 1958**

Shokë të rinisë,

Sigurisht kjo mbledhje e Komitetit Qendror të Rinisë do t'i shërbejë shumë çështjes së përgjithshme të ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë, do t'i shërbejë shumë organizatës suaj të rinisë që është mbështetja nga më kryesoret e Partisë sonë në këtë punë kaq të madhe, kaq me përgjegjësi që ajo ka për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së popullit. Prandaj, Partia ju falënderon ju, të rinjve, për punën e madhe që bëni, për punën e ndërgjegjshme, heroike, për kuptimin drejt të problemeve, për organizimin e mirë të forcave të mëdha të rinisë në luftën për zbatimin e këtyre detyrave si dhe për kuptimin drejt të qëllimeve të Partisë.

---

<sup>1</sup> Plenumi V i KQ të BRPSH dëgjoi dhe diskutoi rreth raportit «Mbi detyrat e rinisë për zbatimin e vendimeve të Plenumit të Shkurtit të KQ të PPSH».



Ju mendoni si njerëz të pjekur dhe fakti është se puna juaj në praktikë ka bërë që t'u imponoheni edhe njerëzve që mund të kenë mendimin se «këta janë të rinj, janë akoma të papjekur». Por ne e shohim çdo ditë se aksionet e rinisë kanë dhënë rezultate aq të shkëlqyera, saqë njerëzit janë bindur se ç'mund të bëjë rinia heroike. Edhe shembujt që na dhanë diskutantët flasin për këto. Sa mirë e tha shoku i ri nga Yzberishi, sekretari i organizatës së rinisë të asaj kooperative: «Në fillim të rinjtë e kooperativës gjetën kundërshtime nga ana e kooperativistëve për silazhimin e misrit hamullor, mirëpo ata e thyen këtë rezistencë të fshatarëve». Mundet që atë vit fshatarët të ishin të pakënaqur që bëhej silazhimi i misrit, por të rinjtë atje e kishin kuptuar shumë mirë direktivën e Partisë. Ata e kishin kuptuar se ç'të mira do të kishte kooperativa në qoftë se misri do të këputej para se të bëhej kokërr e të hidhej në gropë për silazh. Dhe kështu bënë. Më vonë, kur panë rezultatin, fshatarët e Yzberishit i përgëzuan të rinjtë për këtë punë dhe nga kjo ata vendosën që vitin e ardhshëm e gjithë hamullorja të caktohej vetëm për silazh. Ky është një shembull që tregon se rinia vepron jo vetëm me fjalë, por me vepra, me rezultate. Po të njëjtën gjë tha edhe shoku i kooperativës së Libonikut ku të rinjtë dhe të rejat zëvendësuan nëpër stallat disa pleq që nuk e bënin dot këtë punë. Edhe ndaj këtyre të rinjve u shfaqën mosbesime, por më vonë, në mbledhjen e përgjithshme të kooperativës vetë të kaluarit nga mosha i përgëzuan të rinjtë për iniciativën dhe rezultatet e tyre; bile ata propozuan që këtyre të

rinjve t'u shtoheshin edhe ditët e punës. Këtë ata e bënë sepse e panë qartë që të rinjtë i mbajnë më mirë lopët dhe viçat dhe se lopët në duart e tyre dhanë më shumë qumësht. Ka me mijëra shembuj të tillë që tregojnë se rinia jonë është bërë e zonja, është e matur dhe e aftë të kryejë çdo punë, sado e komplikuar që të jetë. Pa rininë nuk mund të kryhen punët aktuale për ndërtimin e socializmit. Kudo, në çdo gjë, kërkohet fjala dhe vepra e rinisë. E dëgjuat se ç'tha ndihmë-ministri i tregëtisë? Që nga fillimi e deri në fund ai kërkoi ndihmën e rinisë. Po, ai ka të drejtë, sepse në tregëti ka shumë të meta, shumë dobësi. Dhe ai e ndjen se po vuri dorën rinia si duhet në këtë sektor, shumë të meta do të eliminohen, do të zhduken dhe tregëtia do të shkojë më mirë si në qytet ashtu edhe në fshat.

Meqenëse shumë në gojë tregëtinë, po them edhe disa fjalë për tregëtinë në fshat, se në këtë drejtim rinia mund të bëjë më shumë. Dyqanet e kooperativave të konsumit, dyqanet-shtëpi që po ngrihen tani, ose baxhot-shtëpi, luajnë një rol jashtëzakonisht të madh në fshat. Popullsia shqiptare në shumicën dërmuese është në fshat, nevojat më të mëdha të popullit, pra, janë në fshatra. Fshati ynë i ka rritur kërkesat, ai dëshiron të ketë mallra, por jo çfarëdo mallrash dhe jo ta furnizojnë në mënyrën e vjetër. Fshati ynë ka ndryshuar dhe do të ndryshojë çdo ditë. Por këto kooperativa të konsumit, këto dyqane-shtëpi nuk funksionojnë si duhet. Prandaj, duhet rinia, rinia që punon atje të ndërrojë metodën e punës, të vendosë rregullin dhe disiplinën. Tani kemi një rini të kulturuar që mund ta bëjë këtë. Shikoni ç'na thoshte ministri i tregëtisë që kishte

genë në një fshat: «Mallra kishte boll, një depo të tërë ku s'kishe nga të vije rrotull, por ai shoku i depos nuk kishte asnjë defter për të mbajtur shënime». Kur e pyeti ministri se si e bënte furnizimin e këtyre dyqaneve (ai furnizonte 4-5 dyqane) iu përgjegj: «Unë i di të gjitha, i mbaj mend çmimet, mbaj mend dhe sa jap». Po a bëhet puna kështu? Si mund t'i mbash mend të gjitha këto mallra, të gjitha këto çmime të ndryshme, të gjitha këto furnizime nga një dyqan në tjetrin? Natyrisht, atje patjetër ka edhe vjedhje, ka humbje qoftë me dashje, qoftë pa dashje. Kur vepron kështu, të rrish e të mbash mend çfarë ke në depo, çfarë çmimesh kanë ato, sa furnizon një dyqan dhe sa një tjetër, natyrisht mund të jesh shumë i ndershëm, por mund të biesh dhe brenda. Ne tani kemi plot të rinj që kanë mbaruar shkollën 7-vjeçare, që dinë të organizojnë punën dhe që janë të zot. Ata, pra, duhet ta ndryshojnë këtë situatë në fshat. Nuk do të zgjatem në këtë çështje sepse kjo ishte në të kaluar e sipër, mbasi objekti i fjalës sime nuk është tregëtia.

Mendimi im është se në këtë plenum ju i rrahët dhe i shtruat fare mirë disa probleme shumë të rëndësishme të bujqësisë. Natyrisht, ka edhe probleme të tjera. Disa shokë i trajtuan edhe ato. Problemet janë të shumta dhe, si thashë, rinia preokupohet dhe lufton për zgjidhjen drejt të tyre ashtu siç mëson Partia. Ju këtu kapët disa probleme që janë aktuale dhe që i ka ngritur edhe Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë. Mendimi im është se ju, problemeve ekonomike, veçanërisht atyre të bujqësisë, u jeni futur mirë, u jeni futur thellë si njerëz të pjekur. Këtë bindje ka Komiteti

Qendror i Partisë për ju. Dhe këtë nuk e themi që t'ju bëjmë qejfin se jeni të rinj e duhet t'ju inkurajojmë. Natyrisht ne, patjetër, edhe duhet t'ju inkurajojmë, por çështja nuk është vetëm këtu. E vërteta është se kur të rinjtë e marrin një punë përsipër, ata e çojnë atë deri në fund, se kështu i ka edukuar Partia. Ajo, pra, i edukon të rinjtë në mënyrë të tillë që problemeve t'u futen e t'i zgjidhin drejt, sepse i zgjidhin për veten e tyre, për popullin e tyre, për të ardhshmen e tyre.

Shumë aksione ka ndërmarrë rinia në të gjithë sektorët. Ne mund të themi se ato ju i keni realizuar me sukses. Ju tani keni marrë përsipër aksione të reja me shumë rëndësi për bujqësinë që do ta përmirësojnë jetën e popullit dhe do ta rritin mirëqenien e tij me ritme shumë më të shpejta nga ç'është menduar kur u hartua plani i dytë pesëvjeçar. Dhe pa hyrë në hollësi ne shikojmë që rezultatet e deritanishme të këtyre aksioneve janë të kënaqshme. Rinia i kapi mirë këto probleme, të misrit dhe të grurit në radhë të parë, si dhe problemin e bagëtisë, problemin e lopës, çështjen e frutikulturës, të ullinjve, të vreshtave, çështjen e bimëve industriale etj., për të cilat Partia ka folur vazhdimisht. Pra, këto probleme rinia i ka kapur mirë dhe nën udhëheqjen e Partisë po korr suksese. Ne kemi rezultate shumë të kënaqshme dhe inkurajuese në këta sektorë, të cilat janë garanci për plotësimin dhe tejkalimin e planeve që caktoi Plenumi i fundit i Shkurtit i Komitetit Qendror të Partisë. Fakti është se aksionet që ka marrë rinia për çështjet bujqësore dhe të frutikulturës i ka realizuar me sukses dhe i ka thyer të gjitha rekordet.

Tani të marrim çështjen e lopës. Në një periudhë

kaq të shkurtër që kur Komiteti Qendror i Partisë dha direktivën për përmirësimin e racës së lopës, ju, rinia, nën udhëheqjen e Partisë, u përgatitët shumë bukur dhe morët masat e duhura. Dhe këtë ne e shohim nga shifrat shumë të larta që ju dhatë këtu, megjithëse s'ka shumë kohë që është mbajtur konferenca kombëtare për përmirësimin e lopës. Kjo tregon përpjekjet e Partisë, të popullit dhe të rinisë për shtimin e lopëve, për krijimin e fermave të lopëve. Tani kjo punë duhet vazhduar. Unë këtu nuk dua të zgjatem sepse ju jeni në dijeni të raportit për çështjet bujqësore që mbajti ministri i bujqësisë si dhe të diskutimeve që u mbajtën në atë konferencë e që u botuan në shtyp. Por unë dëshiroj të theksoj një gjë, çështjen e silazhit. Ju këtë e keni kapur, por puna është që duhet të bëhet më mirë. Silazhi kërkon disa kushte që ta bësh. Kjo bile është gjëja kryesore, parapërgatitja për silazhin, se mund të flasësh shumë «silazh, silazh, silazh», por akoma nuk di se ku e si do ta bësh këtë silazh. Ikën prilli, vjen maji, vjen dhe qershori dhe akoma nuk ke bërë transhenë ose gropën ku do ta hedhësh silazhin dhe e gjithë puna, pra, vete kot. Prandaj, kjo çështje duhet marrë me seriozitetin më të madh. Çdo kooperativë duhet të bëjë planin për silazh në mënyrë që ky t'u jepet në radhë të parë lopëve dhe të gjitha kafshëve të tjera si edhe lopëve të oborreve. Dhe këtë çdo kooperativë duhet ta bëjë me kohë që më vonë të mos ketë kokëçarje. Kështu, pra, duhet të parashikohen këto plane që tani, shpejt e shpejt, dhe krahas me këto duhet të mendojmë se sa metra kub transe do të bëhen, se në ç'formë do të jenë tranшетë,

me se do të bëhen, me çimento, me mure, do të lyhen me harasan apo me baltë, do të bëhen nën tokë apo mbi tokë. Për të gjitha këto duhet menduar që më parë. Për këtë gjë Komiteti Qendror ka ngarkuar dhe Ministrinë e Bujqësisë, e cila do të organizojë dhe do të ngarkojë një grup inxhinierësh që të përcaktojnë forma të ndryshme transhesh. Parulla ka qenë: «Hap tokën, hidh brenda ç'ke për të hedhur dhe mbuloje». Nga një veprim i këtillë i nxituar e pa kujdes humbasim shumë, sepse shpesh silazhi priset. Transhetë ose gropat për silazh duhet patjetër të bëhen me mure ose me çimento, sepse ndryshe, në mos gabohem, humbasim gati 30 për qind të silazhit, sepse hyn lagështia brenda dhe kështu silazhi priset. Prandaj, ky grup inxhinierësh do të mendojë dhe do të caktojë disa forma të përshtatshme sipas rajoneve: atje ku ka gurë transhetë dhe gropat do të bëhen me mure, diku do të bëhen me gardhe të lyera me baltë siç bëhen disa shtëpi në fshat ose furrat e gëlqeres përmbi tokë dhe diku do të bëhen me çimento. Së shpejti do të bëhet një demonstrim këtu në Tiranë, afër Fermës së Kamzës, ku të gjitha rrethet do të dërgojnë specialistët e tyre, të cilët do të shikojnë e do të zgjedhin formën më të përshtatshme, do të marrin udhëzime nga grupi i inxhinierëve, në mënyrë që kur të kthehen në rrethet e tyre të fillojnë ndërtimin e transheve. Nuk mbetet, pra, përveç se prilli dhe maji, ato në qershor duhet të jenë gati. Nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë që fshatarët të dëshpërohen dhe të pengohet ai hov i madh heroik i të rinjve e i fshatarëve, të cilët me gëzim po i japin kooperativës mëshqerrat e tyre, viçat ose po i shesin asaj lopët. Të mos ngjasë,

pra, që ata të shohin se lopët, në vend që të japin qumësht më shumë, të mbahen mirë e të majmen, dalin të dobëta sepse kooperativa, Partia dhe rinia nuk morën masa me kohë që të siguronin ushqimin e tyre. Prandaj, çështjes së ndërtimit të këtyre transheve duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, të mos lëmë të na ikë koha kot.

Tani edhe dy fjalë përsa i përket çështjes së përgatitjes së silazhit d.m.th. të prerjes. Këtu duhet të mobilizohen mirë Partia dhe rinia, në mënyrë që të gjitha ato maqina që neve na kanë ardhur e do të na vijnë nga jashtë dhe që duhet të shërbejnë për prerjen e silazhit të shfrytëzohen në maksimum; gjithashtu të shfrytëzohen edhe ato që bën uzina jonë këtu në Tiranë ose disa gjëra që i kanë shpikur vetë kooperativistët, p.sh. havanet e duhanit. Kur mbarojnë së griri duhanin, fshatarët t'i përdorin ato edhe për të prerë kash-tën. Po ka edhe shumë gjëra të tjera që mund të përdoren në këtë drejtim. Prandaj, çdo gjë duhet ta vëmë në lëvizje. Qëllimi është ky: të sigurojmë ushqimin për bagëtinë gjatë gjithë vitit, të arrijmë dhe të realizojmë planet që kemi vendosur.

Përsa i përket çështjes së kuadrove, unë nuk kam se ç'të shtoj, se ju këtë çështje e ngritët vetë. Unë kisha shënuar shumë çështje që t'i ngrija këtu, por ju i trajtuat vetë. Vetëm unë them këtë gjë: është në dorën tuaj që të përgatitni specialistë jo vetëm për rritjen e bagëtive e të lopës, por edhe për panxharin, për pambukun e për kultūra të tjera. Dhe këtë duhet ta marrë në dorë rinia për të zbatuar direktivat e Partisë. Partia e udhëheq dhe e ndihmon rininë dhe rinia

e ndihmon Partinë. Prandaj, rinia duhet të shkojë në komitetet e Partisë dhe të kërkojë me këmbëngulje ndihmën e tyre. Këtë gjë duhet ta praktikojë rinia. Unë kam përshtypje se disa sekretarë rinie bëjnë përpjekje të mëdha, shkojnë në komitetet e Partisë, në byrotë e Partisë dhe atje i shtrojnë çështjet, kërkojnë që ato të zbatohen, kërkojnë pse nuk zbatohet kjo ose ajo çështje etj. Por ka disa të tjerë që nuk shkojnë ose venë të drojtur në Partinë e tyre, shkojnë sikur kërkojnë lëmoshë, tregohen nganjëherë të ngathët, nuk i shtrojnë problemet dhe nuk i vënë përpara përgjegjësisë shokët e komitetit të Partisë në mënyrë që ata të shkunden dhe të vihen para përgjegjësive që kanë, të shkojnë me ritmin që thotë Partia. Vullneti i madh dhe heroizmi i të rinjve, njerëzit e ngathët do t'i fshijnë nga rruga. Prandaj, rinia do ta marrë medoemos në dorë çështjen e edukimit të vetëvetes në të gjithë këta sektorë dhe kur ajo ta bëjë këtë, do të kryejë një vepër shumë të madhe. Kështu do të përmirësohet situata rrënjësisht dhe me ritme të shpejta. Tani Partia ka dhënë direktivën që të rinjtë të shkojnë në kurse të ndryshme. Në rast se rinia këtë e merr në dorë, e zbërthen konkretisht në organizatën bazë të rinisë, punon me të rinjtë veçanërisht, dhe i bind ata për rëndësinë e madhe të këtij ose atij kursi, problemi zgjidhet. Dhe nuk janë 10 mijë kuadro si u tha në raport, sepse raporti bënte fjalë vetëm për një sektor, për atë të bujqësisë, por janë me qindra mijëra kuadro, shumica dërmuese e të cilëve janë të rinj. Ne mendojmë se nevojën e ngritjes ideologjike e arësimore të kuadrove rinia e ka kuptuar fare mirë, se vetëm ashtu ata do të zgjidhin probleme më



të komplikuar nga ato që janë tani. Më vonë do të kemi, natyrisht, probleme më të koklavitura, sidomos në bujqësi, pasi bujqësia do të ketë një punë intensive; nga ajo do të kërkohen prodhime akoma më të mëdha, të cilat duhet t'i merren tokës jo vetëm me një empirizëm, me një praktikë të thjeshtë, por me dituri. Këtë dituri duhet ta fitojmë nëpër shkolla, nëpër kurse, nëpër konferenca, vetëm kështu do t'i kryejmë detyrat mirë dhe me ndërgjegje të lartë. Ne nuk pretendojmë që qysh tani t'i mbushim fushat tona me agronomë, me zooteknikë, me veterinerë etj., por çështja është që ata që kemi tani të punojnë me ndërgjegje të lartë dhe të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat e rëndësishme që kanë dhe eksperiencën e tyre t'ua japin edhe të tjerëve; atëhere do të shohim se sa lart do të ngrihet ekonomia e vendit tonë. Këto dy çështje ju i trajtuat mirë këtu dhe nuk është nevoja të zgjatemi, por duhet ditur që këto janë probleme shumë të rëndësishme.

Dy fjalë edhe për çështjen e pemëve frutore. Në këtë sektor ju po e ceni gjithnjë përpara, ju e keni kuptuar mirë leverdinë e këtij sektori, ju i vini pemët për veten tuaj, bashkë me ju rriten dhe fidanet. Tani ju e bëni këtë punë me këngë, sepse në të shihni të ardhshmen tuaj, sepse kjo do t'ju japë frutet.

Por, shokë, kuadrot e rinj, sidomos ata që merren me pemët, me viçat, me lopët, barinj të, organizatat e rinisë duhet t'i ndihmojnë shumë, sepse ata hasin në shumë vështirësi. Të marrim p.sh. bariun; mirë tha një shok këtu se bariu ka vështirësi të mëdha. Edhe ai do të shikojë filma herë pas here, të shkojë në koncert, të dëgjojë një konferencë. Ai gjithë ditën e gjithë natën

është me bagëti, prandaj duhet që KQ i Rinisë, rinia, komitetet ekzekutive të interesohen për një trajtim më të mirë të barinjve dhe të stallierëve të ndryshëm, sepse ekziston mentaliteti i vjetër i përcmimit të zanateve. Këto, natyrisht, janë mbeturina të së kaluarës. Ja, mua më pëlqeu demonstrimi që bëri një shok për fekalet. Kjo ka shumë rëndësi sepse do të sjellë 2-3 kv. misër dhe grurë më shumë. Por duhet menduar që shfrytëzimi i fekaleve nuk është një gjë që e shpikëm ne, të gjitha shtetet e bëjnë këtë gjë në mënyrë të organizuar. Nuk mund të ecet më si në shumë fshatra të Tiranës ku nevojtoret janë krejt të hapura, në ballkon ose në prak të derës së shtëpisë gjë që është jo vetëm antihigjienike, por edhe antiekonomike. Ne duhet t'i luftojmë në mënyrë revolucionare dhe t'i çrrënjosim mbeturinat e së kaluarës që pengojnë futjen e metodave të reja që ndihmojnë në shtimin e prodhimeve tona bujqësore dhe që i shërbejnë mirëqenies së popullit.

Përveç kësaj nuk duhet të harrojmë dhe çështjet e kulturave të tjera. Dhe këtu duhet të vëmë tërë forcat tona, në zhvillimin e bimëve industriale siç janë pamuku, panxhari, duhani. Në të gjitha këto rinia duhet të marrë pjesë. Në qoftë se rinia nuk merr pjesë gjallërisht, në qoftë se nuk fut shpirtin e saj heroik, iniciativën e saj, atëherë nuk do të ecë asnjë sektor ashtu si dëshirojmë ne. Prandaj duhet që, kur shtrohen probleme të tilla, organizata e rinisë, ashtu si na mëson Partia, të dijë t'i shpërndajë forcat e saja, të dijë se cilat janë problemet më të rëndësishme, të dijë në ç'momente duhet të sulmojë dhe atje të çojë forcat kryesore, pa harruar dhe të tjerat. Pra, të gjitha pro-

blemet kërkojnë punën, heroizmin, ndërgjegjen e rinisë sonë. Rinia duhet të zbatojë kudo direktivat e Partisë dhe të jetë në ballë kudo nën shembullin e anëtarëve të Partisë, jo vetëm në sektorin e bujqësisë, por në çdo sektor, sepse të rinjtë janë kudo në industri, në shkolla etj.

Klasën punëtore ne e kemi të re, d.m.th. në radhët e saja kemi edhe të rinj, të cilët, nën udhëheqjen e Partisë, realizojnë normat, shtojnë prodhimet, bëjnë përpjekje për uljen e kostos. Natyrisht, këto përpjekje të rinisë do të sjellin rezultate akoma më të mëdha në të ardhshmen për arësye të teknikës, d.m.th. të perfeksionimit teknik të tyre. Prandaj, së bashku me punën duhet dhe mësimi, edukimi. Organizata e rinisë edhe në këtë fushë duhet të luajë një rol të madh për të zbatuar direktivat e Partisë, në mënyrë që të rinjtë tanë nëpër fabrika të mos kënaqen me punën e deritanishme në këtë drejtim, por të zgjerojnë njohuritë e tyre, të perfeksionohen, se vetëm kështu ata do të shfrytëzojnë maqineritë në maksimum. Kështu rendimenti do të ngrihet, mallrat do të lirohen, jeta e popullit tonë do të përmirësohet. Dhe kjo do të bëhet në qoftë se klasa punëtore, rinia jonë do ta kuptojnë më mirë këtë çështje. Prandaj një rol të madh ka edukimi edhe te punëtorët.

Janë hapur sektorë të mëdhenj pune në vendin tonë. Këtu u fol edhe për ndërtimin. Ndërtimi është një gjë kolosale në vendin tonë dhe çdo vit, çdo 5-vjeçar do të vazhdojë ndërtimi me ritme të mëdha. Prandaj, këtu nevojiten kuadro të mësuar. Janë hapur kurse, shkolla të tjera do të hapen në të ardhshmen. Dhe këtu duhet

të sulmojë rinia. Organizata e rinisë duhet të zbatojë direktivën e Partisë që edhe këtu ta edukojë rininë me frymën e re, të mos e lërë atë që të kapet nga mbeturinat e vjetra, nga rehatllëku, nga burokratizmi, nga pikëpamjet jo të drejta e mikroborgjeze ndaj zanateve. Ka të rinj që thonë: «Dua të bëhem mjek, ose dua të bëhem jurist»; arësyeja është se në këto profesione i duket se ka më pak vështirësi. Pra, Partia dhe rinia, duhet të luftojnë në ndërgjegjen e këtyre njerëzve këto pikëpamje të gabuara. Po nuk dite t'i luftosh këto, atëhere me siguri të zënë në grykë. Mbi të gjitha, pra, duhet shikuar puna që jep frute. Dhe frute merr ai që prodhon. Direktiva e Partisë që rinia të vejë në prodhim duhet të vihet në jetë nga organizata e rinisë. Prodhimi në vendin tonë nuk është vetëm në Tiranë, por është kudo në Shqipëri. Natyrisht, kushtet e disa qyteteve nuk u përngjasin kushteve të Tiranës, por edhe ato do të përmirësohen. Ja, shikoni, që tani janë përmirësuar disa. Përpara te ne nuk kishte kinema në të gjitha qytetet, tani ato i kemi. Do të vijë koha që edhe teatro do të ndërtohen nëpër qytete. Këto do të ndërtohen edhe nëpër vende banimi ku ka filluar të grumbullohet punëtorja. Do të vijë koha, dhe jo larg bile, që edhe grupe kooperativash, në mos çdo kooperativë, të kenë kinemanë e tyre. Por këto nuk do të bëhen menjëherë. Pra, kushtet në qytetet e tjera nga disa anë janë më të vështira në krahasim me Tiranën, por kush do t'i eliminojë këto kushte të vështira? Do t'i zhdukim ne. Disa mendojnë se çdo gjë do të kalohet duke ndernjur në Tiranë. Këta janë në rrugë të gabuar dhe ne e kemi për detyrë t'i rregullojmë ata. Pra, ndaj këtyre

gjërave ne duhet të mbajmë qëndrim, t'i bindim të rinjtë; t'i ndihmojmë që ata të rregullohen. I riu është si ai filizi i ri e i njomë që po e lidhe në një dru të drejtë e të gjatë rritet gjithnjë drejt, por, po nuk e rregullove këtë mund të shtrembërohet e të thyhet. Për shtrembërimin e këtij filizi punojnë shumë armiqtë. Ata duan të godasin lidhjet e shëndosha, të çelnikta që ekzistojnë në mes të Partisë dhe të rinisë sonë heroike. Por deri sot nuk kanë arritur, as nuk kanë për të arritur ndonjë rezultat. Përpyjekjet e tyre qoftë nga ana ideologjike, qoftë me anë të radios etj. për të futur në rininë tonë dëfrimin e shthurur, veshjen pa gusto e të tjera, nuk kanë zënë dhe nuk do të zënë vend. Rinia jonë është një rini e shëndoshë, e thjeshtë, një rini e popullit, e edukuar me frymën e drejtë të popullit, me teorinë marksiste-leniniste të Partisë sonë, ajo është në gjendje ta shqelmojë propagandën e armiqve ashtu siç e ka shqelmuar deri tani. Por rreziku ekziston kurdoherë, se armiku përpiqet të krijojë pakënaqësi ndërmjet njerëzve. Prandaj, rinia duhet të jetë kurdoherë e gatshme për të luftuar armikun e për të kryer si kurdoherë detyrat e mëdha që i ka ngarkuar Partia.

Rëndësi të madhe organizata e rinisë duhet t'u kushtojë SMT-ve. Në qoftë se dëshirojmë që bujqësia jonë të shkojë përpara, të kemi grurë, misër, silazhe, duhet që SMT-të të punojnë më mirë. Mirëpo në to kemi akoma mjaft dobësi. Organizata e rinisë duhet t'i edukojë mirë, në frymën e Partisë të rinjtë traktoristë për të forcuar lidhjet e shëndosha të klasës punëtore me fshatarësinë, se kjo është baza e bazave të pushtetit tonë popullor, pavarësisht se këtë gjë revii-

zionistët e mohojnë, ose në këtë çështje i hedhin verës shumë ujë. Për ta, kjo aleancë «është një gjë që ka pasur rëndësi përpara, por tashti jo, sepse situata ka ndryshuar». Kurse nuk është kështu. Në çdo kohë kjo aleancë është vendimtare. Traktoristët duhet të kenë njohuri mbi agroteknikën. Ata, së pari, duhet të njohin mirë traktorin, armën e tyre, që të mos u priset kurrë ose që edhe po të priset të dinë ta rregullojnë. Dhe kjo detyrë nuk është vetëm e traktoristëve që kanë mësuar nëpër kurse, por sidomos e atyre që mbarojnë shkollën, teknikumet. Duhet të merren masa, pra, në teknikume që ata traktoristë që dalin andej ta dinë traktorin në praktikë, të dinë ta mbërthejnë e ta zbërthejnë. Unë kam parë në qendra SMT-je djem të rinj që kanë mbaruar teknikumet dhe që nuk dinin të zinin me dorë traktorët. Ata janë futur në SMT-të, në ofiçinat e SMT-ve dhe atje për herë të parë fillojnë të marrin mësimë në praktikë se ç'është traktori, si ndreqet etj. Traktoristët duhet ta njohin mirë këtë armë të tyren. Traktoristi duhet të njohë edhe bujqësinë, agroteknikën, sepse, po nuk e njohu atë, nuk ka se si ta njohë punën e tij konkrete. Prandaj, organizata e rinisë duhet që traktoristët t'i edukojë me këtë frymë.

Pak më lart fola për ndërtimin. Nëpër kurset duhet të venë jo vetëm të rinj, por edhe të reja, bile edhe gra për t'u bërë punëtore ndërtimi. Për këtë duhet të bëhet një propagandë e madhe. Ne nuk themi që gruaja e Tiranës të ngrihet e të punojë në një vend larg banesës, por meqenëse kërkojnë të sigurojnë vetë jetën e tyre, ato duhet të marrin kurajë dhe të bëjnë çdo punë, jo vetëm punën e zyrave. P.sh. në Tiranë kemi rreth 800 kërkesa

të grave për punë. Ne disponojmë 1000 vende ku të futen, d.m.th. më shumë, por halli është se ato nuk duan, sepse ne kemi punë atje ku bëhet llaçi, kemi punë në kombinat, kemi edhe gjetskë, por nuk duan. Gratë duan të bëhen shitëse, por shitëse kemi aq sa kemi vende dhe ato janë zënë, prandaj ato duhet të bëjnë edhe punë të tjera, në ndërtim, në bujqësi etj. Në këtë rrugë dhe në këtë drejtim duhet të luftojë edhe rinia se ajo ka një influencë të madhe te baballarët, te motrat, te nënat etj. Në të vërtetë nuk ka ndonjë papunësi të madhe përse u përket grave, por thamë se edhe gruaja dëshiron ta fitojë vetë jetën e saj. Tani për tani këto fronte pune kemi, më vonë do të hapen punë nëpër fabrika, do të marrim masa pastaj që edhe nëpër kooperativat e artizanatit të lehtësohet puna që në to të futen sa më shumë gra; veç kësaj në artizanat do të krijohen mundësi të prodhohen disa gjëra të mundshme, p.sh. gjëra që italianët i prodhonin me lëndën tonë të parë. Ne, natyrisht, do të kemi parasysh kurdoherë që gratë të mos futen në punë të rënda, por jo edhe ku dëshirojnë ato, se atje nuk ka. Kushdo duhet të punojë atje ku është nevoja dhe ku e dërgon shoqëria.

Duhet të kemi parasysh pjesëmarrjen e rinisë edhe në kanalizimet, në bonifikimet. Ne kemi caktuar që 25 për qind e këtyre kanalizimeve të bëhen nga fshatarësia. Kjo është një detyrë me shumë leverdi por e rëndë. Ajo do të kërkojë forca edhe në kohën kur do të ketë shumë punë nëpër fusha. Prandaj, rinia duhet ta organizojë punën sa të jetë e mundur më mirë lidhur me bonifikimet. Kjo të bëhet në formë të organizuar. P.sh. rinia e 5-6 kooperativave të punojë së bashku 5-6

ditë, në mënyrë të organizuar në skuadra se vetëm kështu do të dalë një punë e përsosur. Nga kjo punë e rinisë duhet të përfitojë edhe Partia për të mobilizuar fshatarësinë. Ndryshe nuk mund të realizohen në kohën e duhur investimet që kemi caktuar për bonifikimet. Kjo do të ndihmojë që disa dhjetëra milion lekë të hidhen në sektorë të tjerë.

Dy fjalë për çështjen e gjeologjisë. Në gjeologji, që është një sektor me rëndësi të madhe dhe me perspektivë, ka shumë të rinj. E vërteta është se nga ana e Partisë dhe nga ana e rinisë ky sektor është neglizhuar. Atje nuk ka pak njerëz që punojnë, ka me qindra, por ata janë lënë si barinj të për të cilët na foli ai shoku. Gazeta atje vete rrallë, kinema ka pak, shokët venë te ata shumë rrallë etj. Ata i kanë bërë një letër Komitetit Qendror, i cili do të marrë masa, por dhe nga ana juaj duhet të tregohet një interesim më i madh. Puna e tyre ka rëndësi të madhe, sepse nga ata bëhen zbulime të naftës, të bakrit, të kromit, të hekurit, të fosfateve etj. Ata mund të zbulojnë gjëra që kanë rëndësi të jashtzakonshme për ekonominë tonë, rëndësi edhe më të madhe se nafta e kromi sepse nëntoka jonë është e pasur dhe e pazbuluar. Kështu, pra, perspektivat në këtë sektor janë shumë të mira, prandaj duhet t'i ndihmojmë gjeologët, jo vetëm për nevojat që kanë, por, për të zbatuar si duhet direktivën e Partisë, kurset për kualifikimin e tyre të merren nën patronazhin e rinisë ashtu si bëhet në sektorët e tjerë.

Që të realizohen të gjitha këto, duhet që organizatat e rinisë të kenë kurdoherë parasysh dhe të luftojnë që BRPSH të bëhet një organizatë e fortë, e pastër, e



shëndoshë, jo e mbyllur në guaskën e saj. Organizata e rinisë nuk vuan nga ndonjë sëmundje dhe nuk do të vuajë kurrë, derisa Partia jonë i qëndron besnike marksizëm-leninizmit. Ajo lufton pa mëshirë gjithë tendencat antimarksiste dhe përpjekjet e armiqve që kërkojnë ta dobësojnë Partinë tonë. Pra, në Partinë tonë pasqyrohet edhe rinia. Prandaj, shokë, duhet që komitetet e rinisë ta vlerësojnë si duhet detyrën e madhe të organizatës së rinisë. Unë jam interesuar për këtë dhe më duket se komitetet e rinisë nuk plotësojnë si duhet një detyrë të madhe që kanë ndaj Partisë dhe anëtarëve të tyre. Në Statutin e Partisë ekziston një pikë ku thuhet se komitetet e rinisë mund t'i rekomandojnë Partisë anëtarë të BRPSH për t'i futur në Parti. Këtë gjë e bëjnë pak komitetet e rinisë. Ju e dini që Partia ka thënë dhe thotë kurdoherë se burimi kryesor i forcave të saja është rinia. Nga rinia do të vijnë njerëzit më të mirë në Parti dhe këtë nuk e luan as topi. E vërtetë është se në Parti vijnë nga rinia, por kjo punë u është lënë vetëm njerëzve të Partisë që janë në kontakt me të rinjtë, ndërsa nga organizata e rinisë, së cilës Partia ia ka dhënë të drejtën në Statut, nuk bëhet sa duhet. Prandaj, organizata e rinisë duhet të bëjë që të hyjnë në Parti sa më shumë të rinj dhe sidomos të reja, se për të rinjtë s'kemi frikë, ata vijnë, kurse të reja vijnë pak, gra vijnë edhe më pak. Kjo gjë nuk është e mirë. Ne nuk themi që të hapim tani një fushatë për të mbushur Partinë me gra, por të vijnë ato që e meritojnë dhe të tilla ka me qindra, me mijëra, që tregohen të vendosura dhe heroike për Partinë dhe për punën që u ka ngarkuar populli. Prandaj, në këtë drejtim ju duhet të puno-

ni pak më mirë, që t'i jepni Partisë në mënyrë të organizuar gjak të ri. Pse e ka vënë Partia në Statut një gjë të tillë? Sepse ka besim më shumë te një komitet rinie që udhëheq gjithë rininë e një qarku se sa te një komunist ose te dy komunistë që bëjnë rekomandime. Komunisti mund ta ketë bërë rekomandimin të mirë, por mund ta ketë bërë edhe duke u influencuar nga disa mbeturina të së kaluarës si hatër etj., ndërsa një komitet rinie mund të influencohet shumë më pak në këtë drejtim.

Ju keni dalë nga ai sektarizmi i parë, ju futni në organizatën e rinisë më shumë të rinj, ju futni të reja më tepër se përpara, por akoma nuk jeni në atë rrugë që ju cakton Partia. Akoma te ju ka sektarizëm, veçanërisht në punën me të rejtat. Në udhëheqjen tuaj të rinisë të mos vihen vetëm komunistë, atje duhet të vihen edhe njerëz që nuk janë komunistë, por që janë thjesht anëtarë të organizatës së rinisë. Dhe fakti është se njerëz të tillë që nuk janë komunistë dhe që janë në udhëheqje të rinisë kanë dhënë prova, janë treguar besnikë, bolshevikë, që e duan Partinë me gjithë shpirt dhe që kanë punuar shumë mirë në udhëheqje të organizatës suaj. Ky është orientimi që e keni pasur edhe më parë dhe që rinia jonë duhet ta ketë vazhdimisht, sepse ajo këtë karakter ka, të punojë dhe të ecë në rrugën e Partisë për mobilizimin e rinisë për ndërtimin e socializmit, për të kryer me nder këtë revolucion të madh popullor qoftë në industri, qoftë në bujqësi, në arësim e kulturë. Këtu duhet të mobilizohen të gjitha forcat e shëndosha të popullit tonë. Në këtë drejtim duhet akoma që çdo ditë t'i kalitim më shumë lidhjet e organizatave tona me

popullin, qoftë të organizatës së Partisë, qoftë të organizatës së rinisë, duhet që forcimi i lidhjeve të rinisë me Partinë tonë të jetë në vëmendjen e përditshme të anëtarëve të Partisë dhe të anëtarëve të rinisë. Kjo përbën një forcë vendimtare që atdheu ynë të përparojë. Ndaj kësaj situatë, shokë, armiq të punojnë. Ju jeni në korrent të situatave të vështira ndërkombëtare. Imperialistët përpiqen të organizojnë një luftë të re. Mirëpo, natyrisht, dhe forcat tona nuk janë të pakta, ato janë të mëdha, bile dhe më të mëdha nga të imperializmit. Kampi ynë i socializmit është shumë i fortë nga të gjitha pikëpamjet. Politika e kampit tonë është një politikë e tillë që gjen përkrahjen e miliona e miliona njerëzve të tjerë, jo vetëm të vendeve tona, por edhe të vendeve ku sundojnë kapitalistët ose të vendeve asnjane. Por në këtë situatë duhet të jemi vigjilentë sepse dobësimi i kampit tonë, i forcave tona, i partive tona shfrytëzohet nga ana e armikut në dëmin tonë. Ai kërkon të godasë komunizmin, marksizëm-leninizmin dhe vendet ku është ndërtuar socializmi. Këtë punë imperializmi e bën me armë dhe njëkohësisht edhe ideologjikisht me anën e propagandës.

Ju e dini se armiku bën një propagandë të shfrenuar shpifjesh kundër vendit tonë, kundër rritjes së mirëqenies së popullit tonë, kundër sukseseve në vendin tonë. Ai, pra, punon dhe ideologjikisht. Dhe ideologët më të rrezikshëm të marksizëm-leninizmit janë revizionistët, oportunistët e djathtë, ata bëjnë punën e imperializmit, bëjnë punën e armikut brenda në radhët e partive komuniste e punëtore, ata hiqen «neomarksistë». Lenini thoshte se neomarksizëm do të thotë revizioniz-

zëm, prandaj kundër revizionistëve partitë tona komuniste dhe punëtorë t'i mbajnë armët kurdoherë ngrehur. Ne mendojmë se revizionistët duhen luftuar konkretisht, jo me parulla, por në gjithë veprimtarinë e tyre shkaktërrimtare. Një lëshim i vogël që mund t'u bëhet revizionistëve shkakton situata të rënda për kampin tonë si dhe për vendet tona veç e veç.

Po kush janë këta revizionistë? Partisë ne nuk ia kemi fshehur ndonjëherë se kush janë revizionistët. Ne i kemi kritikuar hapur ata dhe kemi thënë se udhëheqësit jugosllavë janë revizionistë të rrezikshëm. Këtë e kemi thënë dhe nuk e kemi fshehur ndonjëherë. Ne kemi deklaruar se kemi mosmarrëveshje të mëdha, të thella ideologjike me udhëheqjen jugosllave dhe se ne nuk lëshojmë në këto çështje asnjë grimë. Ne dëshirojmë të jemi në miqësi me popujt e Jugosllavisë, të kemi marrëdhënie ekonomike, kulturele. Përsa u përket divergjencave ideologjike ne nuk jemi dakord me ta dhe nuk mund të lëshojmë asnjë grimë. Natyrisht edhe ata nuk lëshojnë. Fakti është se ata po bëjnë një kongres, Kongresin VII të tyre. Ata kanë shpallur edhe një program, një program të gjatë, 300 faqesh. Parimet tona janë këto: të mos ndërhyjmë në punët e njëritjetrit, dhe ne as nuk kemi ndërhyrë kurrë në punët e jugosllavëve, ndërsa ata kanë ndërhyrë në punët tona. Natyrisht, ne nuk i kemi lënë që të bëjnë pazar me interesat e popullit dhe të Partisë sonë dhe nuk kemi fjetur. Mirëpo mund të thotë ndonjëri: pse po ndërhyni tani në punët e tyre? Ne ndërhyjmë sepse ato që ngrihen në programin e tyre nuk janë çështje vetëm të jugosllavëve. Aty sulmohen çështje të përgjith-

shme të marksizëm-leninizmit, në këtë program të tyre nuk u jepen udhëzime vetëm «komunistëve» jugosllavë, por i jepen «udhëzime» gjithë komunizmit ndërkombëtar. Në parathënien e këtij programi ata shkruajnë se gjoja shkencën marksiste-leniniste, pasardhësit e Marksit, Engelsit dhe Leninit, nuk kanë mundur ta zhvillojnë në situata të veçanta, se gjoja kanë mbetur boshllëqe, të cilat medoemos duhen ndrequr dhe thonë se vetëm komunistët jugosllavë do t'i plotësojnë këto boshllëqe. Natyrisht, ata do t'i mbushin me mënyrat e tyre që ne i quajmë revizioniste. Pse i quajmë revizioniste? I quajmë kështu sepse ata akuzojnë sistemin tonë socialist për të këqia të mëdha. Ata thonë se sistemi aktual i vendeve socialiste është një sistem gjoja burokratik, etatist ku shteti është bërë aq i plotfuqishëm sa u përngjet shteteve borgjeze kapitaliste dhe në vend që të vihet në shërbim të popullit, ai gjoja i ka hypur popullit në qafë, d.m.th. shtyp popullin, dhe se ky sistem, thonë ata, duke futur këtu Stalinin, ka shkaktuar gjithë këto të këqia andej e këtej. Prandaj gjoja këtë rrezik të madh që i turrej socializmit komunistët jugosllavë e kanë parë që më 1948 dhe për këtë arsëye ata kanë marrë masa dhe shtetin e kanë dobësuar (në fakt nuk e kanë dobësuar, por thonë dobësojeni ju!) edhe rolin e partisë gjithashtu se edhe kjo paskej qenë e domosdoshme dhe kështu pra, që më 1948 ata ua dhanë administrimin «punëtorëve» në të famshmet «këshilla të punëtorëve» dhe siç thonë ata filluan të bëjnë «një revolucion» në bazë të mësimëve të Marksit, Engelsit dhe Leninit që kanë thënë se shteti në komunizëm do të shuhet. Kjo sipas tyre ishte «një gjë e domosdoshme»

që nuk u bë në Bashkimin Sovjetik, por që u bë në Jugosllavi dhe meqë nuk u bë në Bashkimin Sovjetik, kjo gjë ngjall dhe ka ngjallur dhe kundërshtimin në mes të masave punonjëse dhe udhëheqjes politike. Pra, sipas tyre, te ne «çdo ditë masat e popullit po ngrihen në kundërshtim të hapur me udhëheqjen politike», për arsye se nuk kemi shkuar në rrugën që na kanë thënë ata. Mirëpo kjo është një teori e tërë e shtrembër. Në këtë rrugë harron ç'është diktatura e proletariatit dhe ç'është partia. Për partinë dhe diktaturën e proletariatit flitet në programin e tyre, por flitet me fjalë dhe terma të atilla që bën pyetjen: ç'është kjo parti? Kudo gjendet dhe gjëkundi s'gjendet.

Po kështu edhe për diktaturën e proletariatit. Për çfarë diktature të proletariatit bëhet fjalë derisa në tërë atë program nuk përmendet rreziku i rrethimit kapitalist? Jo vetëm që në program ky rrezik nuk ekziston, por ai arrin deri aty saqë kur flet për luftën, për paqe, lexuesi bën pyetjen: kush e rrezikon paqen? Ata thonë se paqen e rrezikojnë që të dy bloqet ushtarake. Kjo është vija oportuniste e djathtë, është vija që të rrih në mes të dy karrikeve edhe andej edhe këtej. Më jep ti dollarët, i thotë Amerikës (dhe Amerika i ka dhënë Jugosllavisë 2 miliard dollarë që bëjnë afër 8 miliard rubla), më jep edhe ti rubla, i thotë pastaj Bashkimit Sovjetik. Dhe ku je? S'jam asgjëkundi. E, pra, a mund të ekzistojë sot në këto momente kaq të rrezikshme për njerëzimin, për botën, një shtet i vetëquajtur «komunist» që të qëndrojë asnjans përpara agresionit të madh amerikan që po pregatit luftën dhe që kërkon të zhdukë sistemin komunist? A mundet, pra,

që një komunist ta bëjë një gjë të tillë? Jo, kurrë! Natyrisht, është në interesin tonë që një Nehru, një U Nu, një Sukarno, një Naser të jenë asnjans. Kjo është pozitive për njerëzimin. Por të mbajë një shtet, që e quan veten komunist, qëndrimin që mban Nehru etj. kjo nuk është marksiste. Pra, në 300 faqe program, nuk ka asnjë fjalë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kundër imperializmit amerikan. Atëhere si është e mundur që ky program të mos jetë revizionist? Ai është revizionist fund e krye.

E tillë është dhe teoria mbi partinë, teoria mbi rolin e partisë. Atje thuhet: «as shumë parti, as një parti, në asnjë mënyrë nuk duhet të dominojë në udhëheqjen e popullit», gjë që është e pamundur. Edhe partisë komuniste ia kanë hequr rolin udhëheqës. Por me këto «shpikje» ne nuk mund të jemi dakord, se këto nuk janë çështje vetëm të jugosllavëve, por të të gjithëve dhe për këtë arsye ne do t'i luftojmë, u pëlqen ose jo krerëve revizionistë jugosllavë. Ne nga shantazhet s'kemi frikë. Ne kemi përkrahjen e gjithë njerëzve të ndershëm që e shikojnë këtë çështje ashtu si duhet. Uniteti ynë është një unitet i fortë. Këtë e tregoi edhe Mbledhja e Moskës ku gjithë partitë tona komuniste dhe punëtore ishin blok kundër revizionizmit, të cilin do ta luftojmë në çdo mënyrë dhe në çdo formë që do të paraqitet. Edhe në Moskë ju e dini fare mirë se si u demaskuan ata. Kjo sepse ata nuk kishin mosmarrëveshje vetëm me Bashkimin Sovjetik, me Bullgarinë, me Shqipërinë, me Çekoslovakinë ose me Rumaninë, por ata kishin mosmarrëveshje për gjëra kryesore dhe vendimtare të marksizëm-leninizmit

me të gjitha partitë komuniste dhe punëtoze motra.

Këto gjëra kanë shkaktuar vështirësi të mëdha edhe brenda në Jugosllavi, sepse programi përmban elementë të theksuar revizionistë e fare të qartë. Prandaj ndaj këtyre «udhëzimeve» Partia jonë duhet të mbajë kurdoherë qëndrim të paepur, vendimtar, marksist-leninist, për të ruajtur Partinë dhe popullin tonë nga përpjekjet e këtyre elementëve. Krerët revizionistë jugosllavë le të thonë në fjalimet e tyre: «ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të të tjerëve». Por nuk është kështu, as në teori as në praktikë. Ata përzihen në punët tona që ç'ke me të.

Sulme të tilla të hapëta, direkt kundër parimeve të marksizëm-leninizmit, kundër vendeve tona socialiste janë të shumta në programin e komunistëve jugosllavë. Por edhe ne nuk hamë bar dhe nuk do të heshtim, nuk kemi fjetur dhe nuk do të flemë kurrë. Partia jonë është e fortë si çeliku, ajo këto gjëra i kupton, i ka luftuar, i lufton dhe do t'i luftojë që ato të mos qasen jo vetëm në shtëpi, por as te praku, dhe bile me qindra kilometra larg. Në këtë çështje janë varur interesat e popullit, e ardhshmja e popullit, e ndërtimit të socializmit, e pavarësisë dhe e sovranitetit të atdheut tonë, për të cilat ka luftuar me shekuj populli ynë, për këto ka luftuar me vite të tëra Partia jonë. Prandaj me plot sukses do t'i bëjë ballë çdo tentative, të kujtdo që do të tentojë të peshkojë në ujëra të turbullta.

Por sidoqoftë, shokë, ne do t'i kuptojmë e do t'i luftojmë më mirë këto gjëra duke mësuar. Edukimin marksist-leninist nuk duhet ta lëmë pasdore. Ky duhet



të jetë ushqimi ynë kryesor, i përditshëm. Në të gjitha format e Partisë e të rinisë ku zhvillohet mësimi marksist-leninist duhet të merrni pjesë. Mos keni frikë se nuk i kuptoni menjëherë këto gjëra dhe nuk do t'u përgjigjeni dot pyetjeve. Maksim Gorki ka thënë:

« — Ti lexo! Po të mos e kuptosh librin, këndoje edhe një herë, në mos e kuptofsh shtatë herë atëhere këndoje dymbëdhjetë herë»<sup>1</sup>. Prandaj të mos dëshpërohemi nga momentet e para kur nuk i kuptojmë disa gjëra se filozofia nuk është aq e lehtë dhe sidomos kur nuk shpjegohet mirë. Është vështirë, shokë, për disa që t'i kuptojnë më shpejt parimet e marksizëm-leninizmit, por megjithatë ato do të bëhen të kuptueshme. Veç asaj do të merren disa masa që të lehtësohet programi i formave, të thjeshtësohen leksionet dhe të lidhen më mirë ato me praktikën e profesioneve të ndryshme, sepse parimet e marksizëm-leninizmit kuptohen më mirë të lidhura me jetën praktike. Por dhe nga ana juaj duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme. Siç sulmoni për të vënë në jetë direktivat e KQ të Partisë për bujqësinë dhe për sektorë të tjerë, ashtu duhet të sulmoni dhe për ushqimin me teorinë e marksizëm-leninizmit, se dhe ajo nuk është e lehtë. Atëhere do të shikoni se do t'u hapen horizonte të reja në punën tuaj, do të gjeni sa më shpejt zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Ju mendoni se nuk e dini marksizëm-leninizmin. Jo, nuk është ashtu. Ju e kuptoni marksizëm-leninizmin, se direktivat e Partisë dhe lufta që ju bëni ju kanë armatosur me parimet the-

<sup>1</sup> M. Gorki. «Për bukën e gojës», f. 91. Tiranë, 1953.

melore të marksizëm-leninizmit, por ju nuk jeni në gjendje që ato t'i formuloni ashtu siç i formulon një pedagog. Mos kini frikë nga kjo gjë. Ju tani, po t'i viheni mirë punës, do t'i kuptoni lehtë, sepse ju jeni njerëz me eksperiencë të madhe praktike në problemet e bujqësisë, industrisë, sepse ju keni fabrikat në dorë, ju dini proceset e ndryshme të punës, ju luftoni atje me normat, rendimentet, çmimet, me këto që përbëjnë probleme të teorisë marksiste-leniniste dhe kështu do t'i kuptoni më mirë mësimet e Marksit, që janë të lidhura me këto probleme. Po të mësoni mirë marksizëm-leninizmin dhe të kuptoni se ç'është revizionizmi dhe si maskohen revizionistët nën parullat marksiste-leniniste do të dini edhe si ta luftoni. Ja p.sh. po ta lexosh programin e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë pa kujdes dhe po të mos i njohësh problemet e marksizëm-leninizmit mundet edhe të gabohesh, se ata, revizionistët, janë njerëz mjaft dinakë dhe me qëllim, mendoj unë, e kanë bërë këtë program kaq të gjatë që të hutojnë mendjet e njerëzve, që të fshehin të vërtetën, që të mos duken gabimet e tmerrshme teorike të tyre.

Projektprogrami i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë, është fund e krye dokumenti më i fëlliqur anti-marksist i kohëve tona, njëkohësisht dhe dokumenti më i rrezikshëm për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, se ai është platforma e re e antimarksistëve, revizionistëve, trockistëve të rinj e të vjetër, e nxjerrë nga një grup njerëzish, që maskohen me emrin e lavdishëm të komunistit dhe e hartuar në atë mënyrë që t'u përshtatet kohës, metodave dhe propagandës imperialiste dhe

sulmit të tij të tërbuar kundër komunizmit ndërkom-  
 bëtar, kundër Bashkimit Sovjetik, kampit të socializmit,  
 kundër gjithë partive marksiste-leniniste. Udhëheqja  
 antimarksiste dhe revizioniste e Lidhjes së Komunistëve  
 të Jugosllavisë me nxjerrjen e këtij projektprogrami,  
 që e ka zbatuar me kohë në jetë dhe që do ta sanksio-  
 nojë Kongresi i saj VII, u vetafirmua si udhëheqja më  
 e kualifikuar dhe më agresive e revizionizmit ndërkom-  
 bëtar. Programi i Lidhjes së Komunistëve të Jugos-  
 llavisë, qëllimisht shqelmon dhe injoron gjithë teorinë  
 marksiste-leniniste për të qenë më «origjinalë» nga  
 revizionistët dhe oportunistët e vjetër, që i ka bërë  
 pluhur e hi Lenini i madh.

Revizionistët jugosllavë, duke u përpjekur që revi-  
 zionizmin e tyre ta veshin gjoja me petka të reja, kanë  
 dalë me perifrazat e teoricienëve të rinj antimarksistë  
 për të zhvilluar të njëjtat teza e pikëpamje antisocialiste  
 dhe antikomuniste duke ecur në gjurmët e teoricienëve  
 të njohur të imperializmit. Ata ekzaltojnë dhe predi-  
 kojnë për komunistët e botës një rrugë të tretë, rrugën  
 jugosllave. Kjo është e poshtër, kjo është armiqësore.  
 Revizionistët mendjemëdhenj jugosllavë gjoja duke plo-  
 tësuar boshllëqet e teorisë marksiste-leniniste, ekzal-  
 tojnë «këshillat popullore të tyre» trockiste, të djegura  
 në zjarr dikur nga Lenini, sulmojnë sistemin socialist  
 duke e akuzuar atë me të gjitha epitetet e urrejtshme  
 dhe si burim i të gjitha të këqijave. Në këtë projekt-  
 program të jugosllavëve, ku të gjitha tezat janë revi-  
 zioniste, likuidohet roli i partisë, i diktaturës së prole-  
 tariatit, predikohet shuarja e luftës së klasave në etapën  
 aktuale, jo vetëm në vendet socialiste, por edhe në

ato kapitaliste, zbutet dhe gati zhduket rreziku kapitalist dhe imperialist. Partia jonë është në kundërshtim të hapët me këto teza antimarksiste e likuidatore dhe do të luftojë pa mëshirë, duke mbrojtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit që udhëheq Partinë tonë në çdo gjë. Programi thotë se «kapitalizmi nuk është më ai i pari», d.m.th. nuk është më kapitalizëm klasist, se «tani kapitalizmi shtetëror po forcohet gjithnjë më tepër dhe kjo është një gjë pozitive, sepse po kufizon pronën private» (po e kufizon pronën e të mjerit Rokfeler!) dhe «kështu — vazhdon ai — krijohen elementë të socializmit brenda në të, bëhen shtetëzime» etj. Shteti kapitalist, pra, tani që sheh se forca e klasës punëtore po bëhet e madhe e mund ta përpijë, merr fuqi më shumë në dorë, merr drejtimin ekonomik të të gjithë popullit, kufizon pronën private dhe fillon nga shtetëzimet. Kështu, shtetëzimet qenkan vdekja e kapitalizmit. Në këtë mënyrë dhe spontaneisht — thonë revizionistët jugosllavë — klasa punëtore do të vijë në fuqi, do të marrë në dorë drejtimin ekonomik të ndërmarrjeve të shtetëzuara, nuk do të ketë më përpara armikun e saj të betuar kapitalistin dhe, avash-avash në mënyrë spontane, me qetësi të madhe, një mëngjez çdo gjë e marrin punonjësit në dorë dhe shkojnë në socializëm (!). Edhe kur vjen fjala për ndërtimin e socializmit në disa vende ai ta bën sistemin tonë njëlloj me kapitalizmin shtetëror, sikur shteti të ne luan po atë rol si në vendet kapitaliste.

Çështja e të mësuarit të marksizëm-leninizmit ka rëndësi të madhe, se kështu ju do t'i kuptoni hilet e revizionistëve. Të marrim çështjen e shtetëzimeve në

vendet kapitaliste që ata ngrenë me aq forcë, por që në mënyrë të plotë nuk qëndron kështu: ato mund të bëhen një element i socializmit, po si mund të bëhen? Ja ç'ngjau në Francë: atje pas luftës, shteti kapitalist shtetëzoi disa industri, i bëri këto shtetërore. Cilat industri? Të gjitha ato që kishte shkatërruar lufta. Të kujt ishin ato? Ato ishin të kapitalistëve. Atëhere kishte edhe ministra komunistë në qeverinë franceze. Mirëpo qeveria franceze mori urdhër nga Amerika dhe menjëherë i përjashtoi komunistët nga qeveria. Ato që u shtetëzuan, ishin fabrika ose miniera të shkatërruara nga lufta. Pra, qeveria ua bleu këto kapitalistëve, pastaj u tha atyre, se i duheshin maqineri për të rregulluar këto fabrika të shkatërruara që ajo shtetëzoi. Dhe fabrikantët, të cilët kishin kushedi sa fabrika të tjera, i shitën shtetit edhe maqineritë. Pra, siguruan edhe fitime të tjera. Natyrisht ata e bënë si Thoma Turtulli në Korçë që i thoshte Ahmet Zogut «do t'ju bëj një spital peshqesh», dhe me këtë rast sillte kontrabandë me dhjetëra mijë ton çimento dhe hekur për veten e tij. Kështu, edhe kapitalistët francezë morën koncesione të mëdha: tarifat për trenat që transportonin lëndën e parë, ishin me çmime të lira, elektrikun, në qoftë se qiraja e dritës në shtëpi ishte njëzet franga, kapitalisti e paguante një frang, mirëpo për kapitalistët këto ishin miliarda franga që i fitonin. Pra, kështu ia rindërtuan shtetit kapitalist fabrikat (!) Vihet pyetja: Kush fitoi? Kapitalistët që morën me miliarda franga. Tani vjen dhe çështja tjetër: Kush do t'i administronte këto fabrika? Domosdo kapitalistët, me anën e këlyshëve të tyre. Pse kë do të sillnin për të administruar, punëtorin? Jo! Është

e qartë, pra, se t'i thuash botës se shtetëzimet nga qeveritë kapitaliste janë elementë të socializmit dhe në mënyrë spontane duke ecur në këtë rrugë klasa punëtore do ta marrë fuqinë në dorë, kjo është një nga format për ta vënë në gjumë klasën punëtore, për ta gënjyer atë. Që të bëhet ajo, d.m.th. që klasa punëtore të marrë fuqinë në dorë, do t'i duhet violencë, luftë me gjak. Në qoftë se asaj ia thua këtë dhe i shpjegon se vetëm në raste të veçanta mund të luftohet dhe për rrugë parlamentare për në socializëm, atëhere jemi dakord që të luftohet edhe për çështjen e shtetëzimeve.

Pse në Francë dhe në Itali, si dhe në disa vende të tjera klasa punëtore ka fituar disa të drejta? Sepse ka luftuar, ua ka rrëmbyer kapitalistëve me forcë ato pak të drejta ekonomike. Mirëpo për revizionistët jugosllavë nuk është kështu. Për ata këto pak të drejta që kanë fituar punëtorët në ato vende «janë lëshime të kapitalizmit». Kujt ia kanë bërë kapitalistët këto lëshime? Lëshime u kanë bërë partive socialiste, socialdemokracisë, si grevëthyesë, të cilave ata u kanë vënë për detyrë të mbajnë në drejtimin e tyre klasën punëtore, por jo klasës punëtore. Dhe nuk është ashtu, shokë, siç thonë krerët jugosllavë se gjoja ato janë lëmosha që kapitalizmi ia ka dhënë klasës punëtore. Jo, këto liri dhe të drejta të kufizuara janë si rezultat i luftës së klasës punëtore. Kapitalizmi vërtet paguan, ka nën influencën e dollarit, të frangut e të liretës socialdemokracinë, sidomos atë të djathlën, të gjitha partitë socialiste e demokristiane që hiqen si parti social-politike etj., që në fakt janë të lidhura e shërbëtore të kapitalizmit. Por klasën punëtore nuk e fut dot kurrë në këto influen-

ca. Të drejtat klasa punëtore i ka fituar me luftë, me grevë, me përpjekje, duke u gjakosur gjithmonë. Kështu, pra, me këto pikëpamje të revizionistëve jugosllavë nuk mund të jemi kurrësi dakord as ne as partitë e tjera komuniste e punëtore. Dhe për këto gjëra ne nuk mund të heshtim. Pse të heshtim? Ne, si marksistë-leninistë të vërtetë, nuk mund të konfundojmë kurrë politikën shtetërore, ekonomike dhe diplomacinë me parimet. Me parimet e marksizëm-leninizmit nuk bëhet as diplomaci as politikë. Ti revizionist jugosllav lufton komunizmin, atëhere pse mos të të luftoj edhe unë ty? Ti thua se ne jemi dogmatikë, sektarë, se ne forcojmë shtetin dhe bën shpifje të ulëta kundër Stalinit në lidhje me ekzistencën e shtetit. Dhe ne s'paskemi të drejtë të të kundërpërgjigjemi? Stalini e ka thënë tamam teorinë mbi shtetin i bazuar në Marks, Engels, Lenin dhe e ka përcaktuar mirë se kur duhet të shuhet shteti. Po Stalini nuk ka thënë kurrë se tani shtetin duhet ta dobësojmë e ta shuajmë. Ata i veshin fjalët e tyre me citate të Marksit mbi shtetin, i cili ka thënë se shteti do të vijë duke u shuar. Por kur, si e tek do të bëhet kjo? Vetëm shkenca marksiste-leniniste, praktika revolucionare mund t'i përgjigjen kësaj. Ajo nuk mund të bëhet as duke bashkuar në një mënyrë, qoftë fjalën popull me fjalën shtet, qoftë dhe si avancim që t'i përngjasë kërcimit të një pleshti. Këtë «kërcim pleshti» që ka kritikuar Marks tentojnë ta bëjnë revizionistët jugosllavë. Fshati jugosllav, thonë ata, mund të qëndrojë ashtu si është, d.m.th. s'është nevoja të kryejmë kolektivizimin. Dhe po t'i thuash që je kundër kolektivizimit, ai të thotë: «jo shok, ja shiko më poshtë,

do të shkojmë drejt shoqërizimit të ekonomisë në fshat», pastaj të thotë se «fshatari jugosllav ka pak tokë, ka aq sa mund të jetojë» (15 hektarë, ata i quajnë pak!), «prandaj ai mund të jetojë në mënyrë individuale dhe me ndihmën teknike që i jep shteti të zhvillohet». Atje s'ka as kolektivizim as hiç gjë.

Sipas tyre, «fshatin jugosllav nuk e kërcënojnë as mbeturinat e brendshme» (ato qenkan zhdukur!), «atë nuk e kërcënon as armiku i jashtëm». D.m.th. për ta nuk ekziston as rrethimi kapitalist as lufta e klasave brenda vendit dhe as rreziku i burokratizmit të aparatit shtetëror (që e paskan zhdukur që më 1948!). Jugosllavët mund të thonë: Këto janë për vendin tonë. Po, por ju i propagandoni ato edhe për të tjerët dhe ne kemi të drejtë të themi se s'është ashtu, se e vërteta është ndryshe, se ekziston rreziku kapitalist. Brenda në Jugosllavi, më tepër se kudo gjetkë mbeturinat e kapitalizmit janë shumë të mëdha dhe po ta lësh kështu, kulaku do të bëhet zot i fshatit. Praktika e vendit tonë ka treguar se kur kryhet kolektivizimi, jeta e popullit, bujqësia përparojnë mjaft. Kjo është çështje e brendshme mund të thotë ndonjëri. Mirë! Por parimet tona dhe ndërtimi ynë socialist janë të tilla dhe ne kemi të drejtë të propagandojmë dhe të luftojmë që këto parime të triumfojnë. Në program ata bëjnë ndërhyrje të hapur, ata i bëjnë thirrje gjithë komunizmit ndërkombëtar që të ecë në rrugën e tyre.

Jeta, shokë, është luftë. Përse na quajnë ne Parti marksiste-leniniste? Sepse mbrojmë parimet e marksizëm-leninizmit, se ato do t'i sigurojnë popullit mirë-



qenien, socializmin, lirinë, pavarësinë dhe unitetin e pathyeshëm të tij me Partinë.

Ç'ndryshime të mëdha po bëhen në fshatin tonë socialist! Krejt e kundërta ngjet me fshatin jugosllav ku dominon kulaku, ku dominon prona e vogël private, interesat mikroborgjeze, ku mbretëron spekulimi. Shteti jugosllav i jep maqineri bujqësore atij që është i fortë, që ka 40 hektarë tokë, d.m.th. kulakut, i cili ka vënë dhjamë, ndërsa fshatari i varfër s'ka mundësi të marrë maqineri nga shteti. Pra, këto që po bëhen në Shqipëri do ta forcojnë akoma më shumë bujqësinë tonë, do ta demokratizojnë akoma më tepër vendin. Natyrisht, këtu flasim për një demokratizim të vërtetë dhe jo për atë demokratizim që thonë jugosllavët. Demokratizimi i revizionistëve jugosllavë është të futet jeta amerikane, të futet propaganda amerikane që të demoralizohet rinia. Vetë Titua tha para disa muajsh se «e humbëm rininë», «na iku rinia nga duart». Pse? Sepse me të tilla pikëpamje e kanë ushqyer ata, të tillë propagandë përdorin në rininë. S'ka vend ku nuk varet buletini i ambasadës amerikane me fotografi etj. Atje, i teket një grupi të rinjsh që të bëjnë qejf në ndonjë shtëpi, i telefonojnë ambasadës amerikane dhe i thonë se duan të dëfrenjë... Dhe, menjëherë vijnë «miqtë» që sjellin manjetofonin dhe ia fillojnë muzikës amerikane, ose u sjellin edhe filma gangsterësh, pllaka etj. Ata janë në çdo kohë të gatshëm që të demoralizojnë rininë. Me këtë propagandë e demoralizim humbet jo vetëm rininë, po dhe punëtorin.

Në Jugosllavi bëhen greva, e ku? Pikërisht atje ku është vënë gjoja në zbatim teoria e Marksit dhe e

Engelsit mbi shtetin. Kështu, në Slloveni dy ditë punëtorët vazhduan grevën dhe megjithëse atje shkuan dhe Kardeli me Rankoviçin, punëtorët nuk e pushuan grevën, bile nuk i lanë as të hynin në fabrikë e të bisedonin. Gratë e minatorëve varën nëpër penxhere pulovrat e tyre me kartela: «Ky pulovër kushton sa një rrogë mujore e burrit tim që është nën dhe». Greva të tilla përhapen si rrufe, por krerët jugosllavë i paraqitin këto greva sikur punëtorët i bëjnë kundër disa elementëve që janë burokratizuar, kundër disa kryetarëve sindikatash, kundër klikës së fabrikës që merr 17-18 rroga në vit, ndërsa punëtorët nuk marrin hakun e tyre. Fillojnë të bëjnë gjoja autokritikë titiste. Por kjo është për të hedhur hi syve. Ku ngjasin gjëra të këtilla? Në atë vend ku gjoja të gjitha gjërat janë në rregull, ku nga ana teorike janë të përsosur etj.

Prandaj, shokë, neve na bie detyra që planet tona t'i realizojmë dhe të mos influencohemi nga parullat e armikut, por të luftojmë me forcë çdo shfaqje që na pengon në punën tonë.

Rinia jonë është rini heroike që ka dhënë prova, që ka besimin e plotë të Partisë e të popullit, që ndjek me besnikëri Partinë tonë. Partia e Komiteti Qendror janë të bindur se rinia, të gjitha detyrat që ka marrë dhe që do të marrë do t'i kryejë me sukses. Këto kisha, shokë. Ju uroj nga zemra punë të mbarë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të marrë me stenogram  
që gjendet në AQP*

## **PARTIA TË MERRET MË SHUMË ME EDUKIMIN DHE FORCIMIN E BASHKIMEVE PROFESIONALE**

*Fjala e mbylljes në Plenumin IX të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

2 prill 1958

Unë nuk do të zgjatem lidhur me problemin që po shqyrtojmë sot në këtë Plenum të Komitetit Qendror, sepse shokët që morën fjalën, diskutuan shumë mirë. Mendoj se punimet e këtij plenumi do të na ndihmojnë shumë për të përmirësuar punën tonë me bashkimet profesionale. Por unë dua të theksoj, ashtu sikurse tha shoku Mehmet, se për të metat që ekzistojnë në bashkimet profesionale, Partia, duke filluar nga baza deri në udhëheqje, duhet që t'i ndihmojë ato akoma më shumë se ç'i ka ndihmuar deri tani. Mund të mos gabohem po të them se Partia e ndihmon më mirë organizatën e rinisë dhe në formë të organizuar e bën atë të mobilizohet në drejtime të caktuara, kurse, si-

---

<sup>1</sup> Ky plenum, që zhvilloi punimet nga 1-2 prill 1958, dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi masat për përmirësimin e mëtejshëm të punës së Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Pilo Peristeri.

kurse doli këtu, në bashkimet profesionale nënvleftësohen këto forma të organizuara që ka caktuar Partia për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të punëtorëve në të gjitha hallkat, prandaj këtu duhet të bëhet një kthesë. Organizatat e Partisë në bazë dhe udhëheqja e komitetit të Partisë duhet t'i shikojnë bashkimet profesionale si levat më të rëndësishme. E vërteta është se Partia jonë i ka caktuar drejt funksionin dhe rolin e bashkimeve profesionale, dhe se në këtë drejtim ne nuk bëjmë ndonjë gjë «të re», siç po bëjnë tani revizionistët, të cilët e kanë bërë të modës të flasin me fraza bombastike për «specifikën» e tyre. Ata thonë se gjoja i kanë dhënë pushtetin klasës punëtorë dhe se atje nuk ekzistojnë greva. Por ja që në vendet e tyre ekzistojnë greva të tilla që tronditin të ashtuquajturin regjim të demokracisë direkte, qoftë në Poloni ose në Jugosllavi. Kurse në vendet tona, ku sipas tyre është vendosur «sistemi autokratik», greva nuk ka. Këto gjëra i thonë vetëm ata që mund të dëgjojnë radio Londrën, që thotë se gjoja në Elbasan po bëhen greva nga punëtorët etj. Derisa ata thonë se «pushteti i tyre është i punëtorëve», pse atëhere i detyrojnë punëtorët me bajoneta për të vajtur në punë. Një gjë e tillë te ne nuk ngjet, sepse Partia drejton shtetin, bashkimet profesionale dhe të gjithë jetën e vendit në rrugën e vërtetë leniniste. Ndërsa ata s'janë në rrugën leniniste, por në rrugën antileniniste.

Revizionistët thonë se gjoja po u japin fuqinë bashkimeve profesionale, d.m.th. po i heqin partisë funksionet e saj dhe po ua «japin» bashkimeve profesionale, por këto janë fjalë, sepse në fakt bashkimeve

profesionale ata u japin biberonin. Teoritë e revizionistëve kanë për qëllim që të dobësojnë partinë dhe pushtetin e klasës punëtore, për të likuiduar partinë, për të lëkundur pozitën e socializmit e për ta shkatërruar atë.

Partia jonë është në rrugën e drejtë leniniste në të gjitha çështjet, ashtu si edhe për bashkimet profesionale në veçanti. Grumbullimi i klasës punëtore në bashkimet profesionale luan një rol të madh. Me anën e kësaj organizate klasa punëtore jo vetëm që edukohet, por zgjidh edhe mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë me administratën shtetërore, duke ia parashtruar ato Partisë, pararojës së saj. Në këtë mënyrë janë zgjidhur dhe do të zgjidhen interesat e klasës punëtore dhe jo si po bëhet në Jugosllavi.

Por, që ka të meta në punën tonë, ka. Kemi edhe vështirësi. Kjo dihet. Shfaqje burokratike ka qoftë nga ana e Partisë, qoftë nga ana e ndërmarrjeve shtetërore. Ka gjithashtu fërkime që nuk zgjidhen në kohën e duhur. Por kjo nuk do të thotë se te ne është puna si te ata. Çështja është që ne kemi caktuar forma të drejta leniniste dhe duke i zbatuar ato drejt, do t'i zhdukim të metat tona dhe do të ecim kurdoherë përpara.

Ne kemi bindje se ky plenum do të na shkundë të gjithëve, vendimet e tij do të mobilizojnë Partinë, organet e pushtetit dhe klasën punëtore për të realizuar me sukses detyrat e mëdha që kemi përpara, të cilat janë në interes të klasës punëtore dhe të forcimit të pushtetit të saj.

Duke u mobilizuar për zbatimin e këtyre detyrave,

si kurdoherë, nuk duhet të harrojmë që të jemi vigjilentë. Vigjilenca e Partisë duhet të jetë e fortë sepse kështu mbrojmë pushtetin tonë, mbrojmë kampin tonë socialist, mbrojmë leninizmin.

Këto kisha për të thënë sepse po të zgjatem nuk do të bëj gjë tjetër veçse të përsërit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i Plenumit IX të KQ  
të PPSH që gjendet në AQP*

## FORCIMI I PËRBËRJES SË PARTISË DHE I FORUMEVE TË SAJ ME PUNËTORË — NJË NGA PROBLEMET JETIKE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 prill 1958

Çështjet organizative janë mjaft të rëndësishme jo vetëm për bazën, por edhe për udhëheqjen, pse sa më e fortë dhe e shëndoshë të jetë Partia, aq më mirë do të ecin edhe punët. Prandaj, për t'i shtruar edhe një herë këto çështje, në muajin që vjen të organizohet një seminar në Komitetin Qendror, pas të cilit këto studime t'i paraqiten Byrosë Politike.

Këtu ka shumë probleme, por të marrim disa nga çështjet që janë ngritur edhe në materialet e paraqitura nga aparati.

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua problemi «Mbi përbërjen, shtrirjen dhe shpërndarjen e forcave të Partisë, zhvillimin e mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat bazë si dhe mbi punën e kuadrit për vitin 1958».

Në pranimet që bëhen të ruajmë e të zbatojmë më mirë kriteret e shëndosha që janë caktuar. Pranimet nuk duhet të shpien ndonjë komitet partie të dalë me plan për të shtuar radhët e komunistëve, por kjo s'do të thotë që këtë çështje ta lëmë të ecë vetë, spontanisht. Komitetet e Partisë të rretheve duhet të preokupohen më shumë dhe të bëjnë një punë të studjuar për të forcuar kurdoherë përbërjen e Partisë, duke pasur parasysh perspektivat e zhvillimit të industrisë, të bujqësisë e të sektorëve të tjerë dhe në bazë të gjendjes konkrete, të japin një orientim të drejtë për të shtuar radhët e Partisë. Për shembull, çështja e pranimet të punëtorëve në Parti, do të ecë më mirë, kur ne, të konsultohemi qysh më parë, ta zëmë me komitetin e Partisë të Qytetit «Stalin», të cilit mund t'i caktojmë që të pranojë 70 për qind punëtorë. Edhe sikur të mos pranojë kaq, por për shembull 60 për qind, dhe këta janë elementë të shëndoshë, atëhere unë them se komiteti i Partisë dhe organizatat bazë në Qytetin «Stalin», kanë bërë një punë të mirë. Prandaj, që komiteti i Partisë të japë një orientim të drejtë për pranimet në Parti, ai duhet të studjojë zhvillimin e rrethit dhe në bazë të kësaj të caktojë proporcionet e pranimeve. Pa pranime të reja sidomos me punëtorë, Partia nuk përtërihet, por vyshket.

Elementët e klasës punëtore që pranohen në Parti duhen parë edhe sipas stazhit dhe vështirësive të punës. Duke u nisur edhe nga këto rrethana konkrete komiteti i Partisë duhet të japë orientim të veçantë për çdo repart. Por duhet mbajtur parasysh gjithashtu se mund të ketë punëtorë që kanë pesë vjet stazh në



punë, të cilët nuk dallohen, kurse një që ka tre vjet dallohet më tepër, prandaj këto gjëra duhet t'i shikojnë mirë organizatat bazë dhe komitetet e Partisë. Pra, orientimet e Partisë për pranime, të jenë të bazuara dhe të shihen në praktikë.

Po kështu edhe në fshat të punohet për të shtuar radhët e Partisë, por këtu të mbështetemi sidomos te rinia. Komitetet dhe organizatat e rinisë t'u rekomandojnë përkatësisht komiteteve dhe organizatave të Partisë se cilët janë ata që mund të pranohen në Parti. Kjo nuk do të thotë që të mos pranohen njerëz me moshë të madhe, që nuk kanë qenë në organizatën e rinisë, por burimi kryesor i pranimeve në Parti është rinia. Gjithashtu, të mbahet parasysh se ka raste që një njeri, i cili ka qenë fshatar dhe tani është bërë arësimitar, nuk mund të konsiderohet më me gjendje shoqërore fshatar, por nëpunës.

Edhe çështja e pranimit të grave duhet parë më mirë. Edhe këtu duhen ruajtur kriteret. Çështja është që të kuptohet thellë se derisa gruaja luan një rol të madh në fshatin tonë, në familje e në shoqëri, më të dalluarat ne duhet t'i pranojmë në Parti.

Me komunistët duhet të bëhet një punë e mirë për edukimin ideo-politik të tyre. Për ngritjen e nivelit arësimitar, shkollat nuk mungojnë, por duhet që komunistët t'i ndjekin ato me rigorozitet, pse ndryshe socializmi nuk ka si ndërtohet. Nga ana tjetër, atyre që kërkojnë të pranohen në Parti, mund t'u vihet si kusht që të jenë me shkollë fillore, të cilën në qoftë se nuk e kanë, ta kryejnë. Po të mos veprohet kështu,

do të rritet numri i atyre që pranojmë në Parti, të cilët nuk kanë arësim.

Një shpërndarje më e drejtë e forcave të Partisë nuk mund të bëhet menjëherë, sepse ka shumë komunistë, të cilët nuk kanë ndonjë profesion. Prandaj, kjo shpërndarje do të bëhet duke dërguar komunistë në shkolla e kurse. Por në këtë drejtim puna duhet përmirësuar nëpërmjet shtimit të radhëve të Partisë, duke pranuar në radhë të parë njerëz të prodhimit dhe atje ku shtrirja e Partisë është e dobët.

Një çështje me rëndësi është edhe ajo që në udhëheqjet e Partisë nuk ngrihen sa duhet elementë punëtorë. Në to zgjidhen njerëz që kanë disa funksione. Duhet parë praktika që ndiqet sot, ku në byrotë e komiteteve të Partisë zgjidhen: sekretari i parë i komitetit të rinisë, përgjegjësja e gruas, kryetari i degës së punëve të brendshme etj. Një gjë e tillë s'është e domosdoshme, prandaj në vend të tyre mund të sjellim në këto organe të Partisë njerëz që punojnë direkt në prodhim e në radhë të parë nga klasa punëtore. Kështu do të revolucionarizohen ato. Drejtues të ndryshëm të rrethit që sot janë në byro, kur është nevoja, mund të thërriten edhe pa qenë anëtarë të saj. Pra, çështja e forcimit të përbërjes së Partisë, të forumeve e të aparateve të saj, duhet parë më mirë në të ardhshmen.

Të gjitha këto çështje, pasi të studjohen, duhet t'ia paraqitim Byrosë Politike dhe, ndoshta vitin tjetër, mund të shtrohen edhe në një mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror, se janë çështje jetike për Par-

tinë. Edhe shokët e ushtrisë duhet të reflektojnë në këto çështje, sepse edhe atje ka shumë për të bërë në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**NGA BISEDË ME KOOPERATIVISTËT E  
KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË BASHKUAR  
TË VISHOCICË-KAPSHTICË-KURILËS  
TË KORÇËS**

**23 prill 1958**

*Në shtëpinë popullore të leximit të Vishocicës shoku Enver Hoxha u takua me shumë kooperativistë të Vishocicës, Kapshticës e Kurilës. Në bisedën që pati me ta tha se kooperativa e Vishocicës është një nga më të vjetrat jo vetëm në rrethin e Korçës, por edhe në Shqipëri.*

Unë pashë këtu — *tha ai* — dhe kryesia e kooperativës më informoi për sukseset që keni arritur ju në kooperativë. Ju përshëndes në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe ju uroj që të arrini suksese akoma më të mëdha në të ardhshmen. Këto suksese në asnjë mënyrë nuk duhet t'ju dehin, ju nuk duhet të kënaqeni vetëm me këto që keni arritur. Detyra edhe më të mëdha ju dalin përpara që këto suksese të jenë gjithnjë në rritje. Ju tani jeni para mbjelljeve pranverore, të bëni çmos që këto të kryhen sa më shpejt dhe në kushte të mira agroteknike. Kujdes të veçantë duhet të tregoni për bimën e panxhar sheqerit, mbje-

llja e së cilës është prapa për shkak të kohës së keqe, që ka bërë deri tani, por, në qoftë se do të mobilizoni të gjitha forcat dhe mjetet, me siguri do ta përfundoni mbjelljen e kësaj bime brenda 3-4 ditëve.

*Shoku Enver Hoxha i porositi gjithashtu kooperativistët që t'i kushtojnë një rëndësi të madhe zhvillimit të lopës. Ai foli për mundësitë e mëdha që janë në kooperativë për shtimin e mëtejshëm të numrit të krerëve të lopëve dhe të prodhimit të tyre.*

Një nga këto mundësi — *tha ai* — është kontraktimi që duhet të bëni ju me kooperativën për t'i shitur asaj lopët dhe viçat e tepërt, ndërsa për shtimin e prodhimit të lopëve duhet të bëhet një punë më e madhe për sigurimin e bazës ushqimore e sidomos të ushqimeve të gjelbërta për stinën e dimrit.

Shfrytëzimi i kohës me punë prodhuese është një rezervë e madhe për shtimin e prodhimeve, prandaj ju duhet të ushtroni një kontroll të vazhdueshëm në kryesinë e kooperativës për të mënjeluar forcat e tepërta joprodhuese në administratë e gjetkë. Komunistët — *tha ai* — të vendosen në sektorët më të vështirë dhe më të rëndësishëm të kooperativës dhe të mos qëndrojnë nëpër zyra.

*Pastaj ai u ndal në çështjen e sigurimit të kuadrit të aftë për të gjithë sektorët e kooperativës.*

Nuk duhet vetëm djersë — *tha ai* — por edhe dituri e zotësi për të drejtuar prodhimin e madh kooperativist. Dhe janë të gjitha kushtet për të siguruar kuadro të specializuar. Mos kurseni në këtë drejtim, se do t'i shikoni të mirën në të ardhshmen, kur ju të keni specialistë të ndryshëm.

*Në fund shoku Enver Hoxha i këshilloi kooperativistët të jenë të bashkuar midis tyre dhe rreth Partisë.*

*Partia — përfundoi shoku Enver — edhe në të ardhshmen do t'u japë një ndihmë akoma më të madhe kooperativave për forcimin e ekonomisë së përbashkët dhe për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së kooperativistëve dhe të gjithë punonjësve të vendit tonë. Për këtë punon Partia me të gjitha forcat e saja.*

*Shoku Enver Hoxha u largua nga kooperativa i përcjellë me dashuri nga të pranishmit.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 97 (2998), 24 prill 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 97 (2998), 24 prill 1958*

## SHËNIME MBI BAZËN E TË CILAVE U FOL NË AKTIVIN E BASHKIMEVE PROFESIONALE TË KORÇËS

25 prill 1958

Bashkimet profesionale — levë e fuqishme e Partisë. Klasa punëtore — forca kryesore udhëheqëse e shoqërisë sonë.

Fytyrën nga prodhimi. Bashkimet profesionale për administrimin e ekonomisë së vendit.

Influenca e bashkimeve profesionale në zgjidhjen e problemeve të prodhimit dhe në përmirësimin e punës së ndërmarrjeve duhet të jetë më e madhe dhe të ushtrohen të gjitha të drejtat e tyre.

Larg formave të përgjithshme të punës nga ana e bashkimeve profesionale dhe e udhëheqjes së tyre.

Për problemet e bashkimeve profesionale nuk duhet të interesohen vetëm ata që paguhen për këtë punë.

Nuk tregohet kujdes i duhur si nga komiteti i Partisë e nga komunistët ashtu edhe nga organet drejtuese shtetërore të ekonomisë për forcimin e organizatave profesionale.

*Emulacioni socialist* — zhvillimi i inisiativës krijuese të masave. Ai është forcë e madhe për rritjen

e prodhimit, mjet edukimi për qëndrime socialiste ndaj punës dhe pronës socialiste.

Të ndiqet shembulli i më të mirëve.

Të luftohen pengesat dhe mungesat në organizimin e punës.

Puna individuale me njerëzit të jetë në qendër të vëmendjes. Të mbahen parasysh nevojat e punëtorëve, vështirësitë dhe ndihma e vazhdueshme për kapërcimin e tyre.

Treguesit cilësorë të prodhimit: rendimenti-kostoja.

Përhapja e eksperiencës së përparuar — detyrë e rëndësishme e bashkimeve profesionale.

### **Roli i mbledhjeve të prodhimit:**

Për projektplanet, rendimentin-koston;  
për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, veçanërisht të maqinerive;

për edukimin e punëtorëve etj.

Mbledhjeve të prodhimit nuk u vihet rëndësi e madhe — neglizhohen, sidomos organizimi i konsultave të prodhimit për shkëmbimin e eksperiencës së më të mirëve si ajo e parkut automobilistik që shkon mirë.

Në mbledhjet e prodhimit drejtorët duhet të raportojnë seriozisht.

*Kontratat kolektive* të hartohen njëkohësisht me projektplanin e ndërmarrjes.

### **Respektimi i normave të punës:**

Të forcohen lidhjet e ministrive e të drejtorive të



ndërmarrjeve ekonomike me bashkimet profesionale për normimin e punës.

Pregatitja më e mirë e kuadrove.

### **Përmirësimi i kushteve të jetesës:**

Ndahen formalisht detyrat e prodhimit nga problemet e jetës së punëtorëve.

Të mos lejohet zgjatja e orarit të punës, kur bie në kundërshtim me ligjet.

Ndërtimi i banesave individuale.

Luftë kundër epidemive, aksidenteve etj.

Paaftësia e përkohshme në punë dhe masat për të evituar këtë çështje neglizhohen.

Sigurimi teknik i punëtorëve çalon.

Problemi i antidoteve, i rrobave të punës dhe çështja e lejeve të zakonshme.

Shumat financiare të përdoren të gjitha dhe me vend.

Lëvizja për kursime shoqërore.

Ekonomitë ndihmëse.

Kontrolli shoqëror mbi rrjetin e tregëtisë, të men-save, të depove.

### **Çështje organizative:**

Organizata bazë (edukimi i kryetarëve të komite-teve profesionale).

Aktivi — udhëheqja.

## **Edukimi i klasës punëtore:**

Sqarimi politik ditor.

Edukimi politik dhe ideologjik i punëtorëve nuk është bindës as i diferencuar dhe as i lidhur sa duhet me problemet ekonomike.

Shpjegimi i marksizëm-leninizmit.

Aktivizim jo i mirë i intelektualëve dhe i drejtorëve të ndërmarrjeve.

Pushime të shumta nga puna në konsumin e rrethit.

Vjedhjet, shpërdorimet, abuzimet. Të luftohet tendenca e disa punonjësve të fabrikës së qelqit për t'i marrë shtetit më shumë se sa i japin.

Miniera e qymyrit të Mborje-Drenovës e vuri në vijë punën për arsye se organizata profesionale dhe Partia treguan interesimin e duhur. Por kjo punë nuk është bërë në fabrikën e në ndërmarrjen ushqimore, prandaj edhe të metat atje janë të theksuara.

Organizimi i mbrëmjeve e i mbledhjeve me pyetje dhe përgjegje.

Lëvizja artistike dhe kulturele në zhvillim të mirë.

Ndihma e madhe e arësimtarëve në drejtim të ngritjes arësimore e kulturele të punëtorëve dhe të fshatarëve.

Shkollat e natës — fillore dhe 7-vjeçare shkojnë jo keq. Në qytete të bëhet i detyrueshëm jo vetëm arësimi fillor, por dhe ai 7-vjeçar.

### **Ngritja tekniko-profesionale e punëtorëve:**

Leximi i librave teknike — i dobët.  
Ngritja e nivelit tekniko-profesional.  
Mësimi i dy-tre mjeshtërive.

### **Gjendja politike e jashtine dhe e brendshme:**

Kongresi VII i jugosllavëve.  
Gjendja ekonomike në vendin tonë dhe perspektivat  
e tija.

### **Teza në kundërshtim me marksizëm-leninizmin:**

- a. Zhvillimi ndërkombëtar i sotëm i dy sistemeve.
- b. Eksperienca e ndërtimit socialist në BS dhe në vendet e demokracisë popullore.
- c. Shteti socialist.
- ç. Internacionalizmi proletar.
- d. Marrëdhëniet reciproke midis vendeve socialiste.
- dh. Kuptimi i revizionizmit dhe i dogmatizmit.
- e. Roli i partisë marksiste-leniniste.

*Botohen për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## NGA BISEDË ME ANËTARËT E KOOPERATIVËS BUJQËSORE «RRUGA E BOLLËKUT» TË LIBONIKUT TË KORÇES

26 prill 1958

*Pasi u takua me kooperativistët, shoku Enver Hoxha pati me ta një bisedë të përzemërt. Ai i përshëndeti ata në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe i përgëzoi për sukseset e mëdha që kanë arritur në marrjen e rendimenteve të larta dhe në forcimin ekonomik e organizativ të kooperativës së tyre.*

*Shoku Enver Hoxha u foli kooperativistëve edhe mbi perspektivat e mëdha që i hapen vendit tonë. Për këtë çështje midis të tjerave ai tha:*

*Në të ardhshmen do të ndërtohen shumë fabrika e kombine, do të vihen në shfrytëzim shumë miniera, do të kryhen punime të mëdha për zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë etj.*

*Pastaj foli mbi detyrat që u dalin kooperativistëve për realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar, për të prodhuar sa më shumë bukë dhe sa më shumë bimë industriale. Ai i porositi në mënyrë të veçantë ata për mbjelljen e pemëve:*

*Ju duhet të mbillni sa më shumë pemë frutore*

— *tha ndër, të tjera* — për furnizimin e fabrikave të konservave që janë ngritur dhe për ato që do të ngrihen. Por ju në radhë të parë duhet të tregoni kujdes të madh për zbatimin e një agroteknike më të përparuar në të gjitha punimet bujqësore.

*Duke folur për rëndësinë e madhe që ka problemi i përgatitjes së kuadrove këshilloi:*

Të tregoni kujdes të madh për sigurimin e kuadrove, për t'i bërë ata më të aftë që të shërbejnë sa më mirë në të gjithë sektorët e ekonomisë kooperativiste. Për këtë problem edhe shteti ka krijuar të gjitha mundësitë me qëllim që të sigurohet përgatitja sa më parë e këtyre kuadrove.

*Kooperativistët e dëgjuan shokun Enver Hoxha me vëmendje të madhe dhe e duartrokitën nxehëtishtë.*

*Pasi vizitoi familjen e një kooperativisti, i cili kohët e fundit kishte hyrë në shtëpi të re, shoku Enver u largua nga kooperativa e Libonikut i përcjellë me dashuri të madhe nga të gjithë kooperativistët.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 100 (3001), 27 prill 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 100 (3001), 27 prill 1958*

## JU MINATORËT JENI ELEMENTI MË I FUQISHËM I KLASËS PUNËTORE

*Nga fjala në takimin me minatorët e Mborje-Drenovës*

28 prill 1958

*Pas një takimi të shkurtër me drejtuesit e minierës, ku u interesua për çështjet e prodhimit, për sigurimin teknik dhe jetën e punëtorëve, shoku Enver Hoxha pati në kinoklubin e minierës një bisedë shumë të përzemërt me minatorët, ku midis të tjerave u tha:*

Ju përshëndes në emër të Partisë dhe të qeverisë dhe ju përgëzoj për sukseset e arritura në realizimin e detyrave të planit. Partia dhe qeveria kanë treguar dhe tregojnë vazhdimisht kujdes të madh për minatorët. Ne e çmojmë shumë punën tuaj, sepse ju punoni në kushte të vështira në thellësitë e nëntokës, sepse prodhimi që nxirrni ju i shërben shumë zhvillimit të ekonomisë sonë, ndërtimit të socializmit. Në të ardhshmen jeta juaj do të përmirësohet akoma më shumë, sepse te ju, minatorët, me fytyra të nxira nga qymyri, por me zemër të bardhë, Partia jonë ka mbështetjen e saj kryesore. Sepse ju jeni elementi më i fuqishëm i klasës punëtore. Është caktuar një fond për ndërtimin

e një qyteti për minatorët, miniera juaj do të pajiset me mekanizma të reja, të cilat jo vetëm që do ta shtojnë shumë prodhimin, por do ta lehtësojnë shumë edhe punën. Detyra të mëdha u dalin minatorëve për realizimin e planit në mënyrë ritmike, për t'i dhënë popullit sa më shumë qymyrguri, për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, për ta bërë atdheun më të begatshëm e më të fortë. Ju uroj punë të mbarë dhe suksese të mëtejshme!

*Shoku Enver Hoxha u interesua nga afër për jetën e minatorëve, vizitoi fjetoren, banjon, mensën dhe disa fronte pune.*

*Pasi u largua nga miniera, i përcjellë me dashuri nga të gjithë minatorët, u ndal në rrugë nga fshatarët e Drenovës, të cilët kishin marrë vesh për vizitën e tij në minierë dhe kishin dalë për ta përshëndetur. Pioneerët i dhuruan lule të freskëta. Shoku Enver u përshëndet me kooperativistët e fshatarët dhe pati edhe me ata një bisedë të përzemërt.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 101 (3002), 29 prill 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 101 (3002), 29 prill 1958*

## NË KUNDËRSHTIM ME TEORINË DHE PRAKTIKËN E MARKSIZËM-LENINIZMIT<sup>1</sup>

4 maj 1958

Këto ditë zhvilloi punimet Kongresi VII i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Siç dihet, qysh përpara kongresit u botua projektprogrami i LKJ, i cili përmbante mjaft teza që janë në kundërshtim të hapur me teorinë dhe praktikën e marksizëm-leninizmit, teza të cilat revizionojnë çështjet themelore të teorisë revolucionare të klasës punëtore, marksizëm-leninizmit, dhe që kanë për qëllim të përçajnë unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në projektprogramin e LKJ u grumbulluan teoritë e kalbura të rrymave të ndryshme antimarksiste, të vjetra dhe të reja, duke u paraqitur këto si «marksizëm krijues». Projektprogrami është një sulm kundër dokumentave historike të Moskës<sup>2</sup>, në të cilat u shprehën pikë-

---

<sup>1</sup> Artikull i botuar në gazetën «Zëri i Popullit» lidhur me Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë si dhe të programit që adoptoi ai.

<sup>2</sup> Është fjala për Deklaratën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste që u mbajt



pamjet e përbashkëta të të gjitha partive marksiste-leniniste të botës, uniteti i kampit të socializmit dhe i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partitë komuniste dhe punëtore të të gjitha vendeve, duke përfshirë edhe Partinë e Punës të Shqipërisë, pa ndërhyrë në çështjet e brendshme të LKJ, meqë në projektprogram prekeshin çështje të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, qysh në fillim u shprehën kundër përmbajtjes së tij. Prandaj ato nuk pranuan njëzëri të dërgojnë delegatët e tyre në Kongresin VII të LKJ.

Mënyra si u përgatit kongresi përcaktoi, siç parashikohej, edhe vetë karakterin e punimeve të tij. Ai pati më shumë qëllime politike dhe ideologjike. Në raportet dhe diskutimet që u bënë qenë të shumta sulmet nervoze kundër vendeve socialiste dhe partive të tyre marksiste dhe polemikat e ashpra me to, që nuk u përngjasin aspak «kritikave shoqërore dhe konstruktive» që udhëheqësit jugosllavë predikojnë aq shumë. Në të njëjtën kohë, në kongres u dëgjuan gjithfarë arësytimesh për të mbrojtur «teoritë» jugosllave të formuluar në program mbi vijën e re që duhet të ndjekë LKJ dhe komunizmi ndërkombëtar. Kësisoj kongresi tregoi qartë se sa shumë janë larguar udhëheqësit jugosllavë nga teoria dhe praktika e marksizëm-leninizmit.

---

në Moskë prej 14-16 nëntor 1957 si dhe për Manifestin e paqes aprovuar nga mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore që u mbajt në Moskë prej 16-19 nëntor 1957.

Çështja kryesore që frymëzoi raportet dhe diskutimet që u zhvilluan në kongres, ishte aprovimi i programit të LKJ. Çështë në të vërtetë ky program? Në të janë shprehur më qartë, duke u veshur edhe me petkun teorik, të gjitha pikëpamjet e mëparshme oportuniste e revizioniste që kanë shfaqur udhëheqësit jugosllavë. Në programin e LKJ shprehet këmbëngulja për të ecur në këtë vijë, për të mos lëvizur prej saj, për të mos njohur asnjë gabim, për të vazhduar edhe në të ardhshmen të njëjtën rrugë. Kjo u tha hapur në kongres: «...çdo pritje, nga cilado anë qoftë, se ne do të largohemi nga qëndrimet tona parimore si në çështjet ndërkombëtare ashtu edhe në çështjet e brendshme, përfaqëson vetëm një humbje kohe...» Në programin e LKJ dhe në punimet e kongresit synohet që teorive antimarksiste e revizioniste t'u njihet, si të thuash, «e drejta e qytetarisë» në teorinë marksiste-leniniste dhe në praktikën e ndërtimit të socializmit. Në këtë mënyrë, sipas programit të LKJ, mbushet «boshllëku» që ekziston dhe «pasurohet» e «zhvillohet» në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmi. Programi i LKJ, në thelb, mbyl frymën revolucionare të klasës punëtore në luftën e saj kundër kapitalit, në luftën e saj për ndërtimin e socializmit. Kjo duket qartë në shumë pjesë të programit, por veçanërisht në tezat e mëposhtme.

Në programin e LKJ thuhet se sistemi shoqëror kapitalist, në formën e tij klasike, i përket së kaluarës, kurse kapitalizmi i sotëm paraqitet si një rend gati jokapitalist. Kjo ndodh, sipas tij, për shkak të zhvillimit të kapitalizmit shtetëror dhe të rritjes së rolit

të shtetit borgjez në jetën ekonomike të vendeve kapitaliste. Sektorin shtetëror të ekonomisë në vendet kapitaliste programi i LKJ e paraqet si një sektor që s'është kapitalizëm «i zakonshëm», por si «një hap përpara drejt socializmit», kurse shteti borgjez paraqitet sikur qëndron mbi klasat, sikur qëndron mbi kapitalin dhe e kontrollon, e rregullon, e kufizon, e planifikon atë etj., sikur në shtetin e sotëm borgjez monopolet kapitaliste e humbin pavarësinë e tyre të dikurshme. Dhe këtej del përfundimi se kapitalizmi i sotëm po shndërrohet vetëvetiu e me shpejtësi në socializëm. Po detyra e klasës punëtore? Sipas programit, detyra e saj është «të futet gjithnjë e më shumë në procesin e rritjes së forcave socialiste të ndërgjegjshme, në procesin e luftës për përforcimin e influencës shoqërore të klasës punëtore dhe për rolin e saj udhëheqës në sistemin e pushtetit». Për domosdoshmërinë e revolucionit socialist dhe të rolit udhëheqës të proletariatit e të partisë së tij në këtë revolucion, për shkatërrimin e aparatit të vjetër të shtetit borgjez dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit ose të formave të ndryshme të saja, për zëvendësimin e pronës kapitaliste me pronën e përbashkët të popullit mbi mjetet kryesore të prodhimit, për të cilat mëson si teoria ashtu edhe praktika e marksizëm-leninizmit, flitet jo si i kupton këto marksizëm-leninizmi, por në mënyrë antimarksiste e revizioniste. Përfundimi që del nga programi i LKJ, si dhe nga fjalimet e udhëheqësve jugosllavë, është se nga kapitalizmi në socializëm mund të kalohet në mënyrë spontane, me evolucion. Sikur klasa punëtore e vendeve kapitaliste të ndjekë këto këshilla, atëhere del se ajo

duhet të heqë dorë nga lufta e klasave, sepse armiku i klasës nuk ekziston, të heqë dorë nga revolucionin socialist, dhe bile edhe nga nevoja e partisë revolucionare marksiste-leniniste. Pikërisht këtë kërkojnë edhe kapitalizmi e borgjezia ndërkombëtare, teoricienët e së cilës, duke i shprehur më hapur pikëpamjet e tyre, thonë se «proletariati e kërkon, por nuk e gjen më armikun e tij tradicional, kapitalizmin». Marksistët dhe klasa punëtore këtë rrugë e hedhin poshtë si revizioniste dhe që ka për qëllim të mbytë hovin revolucionar të klasës punëtore në luftë kundër kapitalizmit, për socializmin.

Në goftë se teza e mësipërme mbi kalimin e kapitalizmit në socializëm në rrugën evolucionare në të vërtetë çarmatos klasën punëtore në vendet ku sundon akoma kapitali dhe e largon atë nga rruga revolucionare, teza mbi «liberalizimin» e diktaturës së proletariatit, duke «zbutur» fuqinë e saj kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, çorienton klasën punëtore në vendet e socializmit dhe hap rrugën për rivendosjen e kapitalizmit. Në programin e LKJ dhe në disa diskutime në kongres çështja e shuarjes së shtetit socialist paraqitet si detyrë kryesore dhe e ngutshme e ditës. Në këtë shprehet pikëpamja oportuniste mbi luftën e klasave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, mbi kontradiktat e periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm. Sipas programit të LKJ dhe disa diskutantëve në kongres, kontradikta themelore e kësaj periudhe nuk është lufta midis socializmit që rritet dhe mbeturinave kapitaliste që po vdesin, të cilën Lenini

e ka përmbledhur në «kush do ta fitojë», por janë kontradiktat që lindin nga format dhe metodat e drejtimit të ekonomisë në mënyrë të centralizuar nga ana e shtetit, nga aspiratat e aparatit të shtetit dhe të partisë për t'u imponuar si forcë mbi shoqërinë. Dhe, sipas programit, kjo kontradiktë zgjidhet duke shuar shtetin. Pra, sipas programit të LKJ, diktatura e proletariatit duhet të dobësohet, të «demokratizohet», d.m.th. të ecim me shpejtësi drejt «demokracisë direkte» e «vet-administrimit të prodhuesve» etj. etj. Në këtë artikull nuk do të ndalemi për të treguar se sa të gabuara dhe antimarksiste janë këto pikëpamje teorikisht, as edhe se sa të pathemelta janë novacionet mbi «burokratizmin etatist», që, sipas udhëheqësve jugosllavë, përbëjnë të keqen e sistemit shtetëror të vendeve socialiste. Ne duam të theksojmë vetëm një gjë: pikëpamjet mbi nevojën e shuarjes së shtetit, pra, të dobësimit të diktaturës së proletariatit, të «liberalizimit» të saj i kemi dëgjuar shumë herë gjatë vitit 1956. Atëhere ato u propaganduan me të madhe nga shumë gazeta, fjalime dhe radiostacione. Ato u përvetësuan edhe nga klubi «Petëf» dhe Imre Nagi në Hungari. Dhe e gjithë bota e pa fare qartë se ku e çuan Hungarinë ato. Në raportin e Kardelit në Kongresin VII të LKJ theksohet se «praktika është gjykatësi i drejtësisë së tezave ideologjike dhe teorike». Plotësisht e drejtë. Jeta dhe praktika në Hungari treguan se pikëpamjet mbi dobësimin e diktaturës së proletariatit dhe shuarjen e vigjilencës revolucionare kundër armiqve të klasës dhe imperializmit ndërkom-bëtar nuk i shërbejnë forcimit të socializmit, por dobësimit të tij. Këto «receta» u bënë parullat e ditës në

duart e forcave kundërrevolucionare dhe propagandistëve të borgjezisë në luftën e tyre kundër komunizmit dhe pushtetit popullor. Ngjarjet e Hungarisë qenë një mësim i madh për të gjithë popujt. Ato na mësuane edhe në praktikë se kërkesa për të dobësuar diktaturën e proletariatit është e rrezikshme, është revizioniste dhe antimarksiste.

Në Kongresin VII të LKJ, në raportet që u mbajtën atje dhe në shumë diskutime u formuluan edhe më mirë disa pikëpamje antimarksiste që në projektprogram ishin disi të errëta.

Në fjalimet dhe diskutimet e ndryshme çështjes së situatës ndërkombëtare iu kushtua një vend i rëndësishëm. Që në fillim duhet theksuar se në kongres, ashtu si edhe në programin e LKJ, nuk bëhet asnjë dallim midis politikës që ndjek kampi socialist dhe kampi imperialist. Bile askund në fjalime dhe në program nuk të zë syri fjalën «imperializëm amerikan». Shkaqet e tensionit ndërkombëtar nuk shihen në politikën agresive të fuqive imperialiste, ashtu siç mëson marksizëm-leninizmi dhe siç tregojnë praktika, por në ekzistencën e bloqeve ushtarako-politike. Në kongres u shkua edhe më tej. Atje u deklarua se «arësyeja themelore për krijimin e Paktit të Atlantikut» është politika e jashtme «staliniste» e Bashkimit Sovjetik. Se sa antimarksiste dhe e pathemeltë është kjo deklaratë, as nuk është nevoja të provohet, sepse e gjithë bota e di se Pakti i Atlantikut, ashtu si edhe bazat e ndryshme ushtarake, u krijuan jo si përgjegje e politikës «staliniste», por si logjikë konsekuente e politikës së luftës

që kanë ndjekur dhe ndjekin shtetet imperialiste, me SHBA në krye, që veprojnë nën presionin e monopolistëve, të cilët nga gara e armatimit, nga luftërat e gjaku i popujve kërkojnë të nxjerrin fitime kolosale. Është e çuditshme se si nuk e kanë të qartë një gjë të tillë udhëheqësit jugosllavë. Pak muaj më parë ata, pa ua imponuar kush, morën pjesë në përpunimin dhe firmuan në Moskë Manifestin e paqes, ku thuhet: «Nga u vjen kërcënimi çështjes së paqes dhe sigurimit të popujve? Për luftën janë të interesuar dhe për luftën ëndërrojnë monopolistët, kapitalistët, të cilët u pasuruan në mënyrë të pashembullt gjatë dy luftërave botërore dhe në garën e sotme të armatimeve». Po kështu, në manifest theksohet: «Në të gjitha vendet socialiste nuk ka klasa ose shtresa shoqërore të popullsisë të interesuara për luftë. Në pushtet këtu janë punëtorë dhe fshatarë, të cilët në të gjitha luftërat pësuan humbjet më të mëdha». Në Kongresin VII të LKJ u bënë edhe deklarata të tjera, të cilat nuk i përgjigjen realitetit dhe janë antimarksiste. Udhëheqësi i LKJ, J.B.Tito, në fjalimin e tij foli edhe për planin Marshall, me anën e të cilit SHBA «dhe në mënyra të tjera të ndryshme dhanë mjete të mëdha jo vetëm për pjesëtarët e Paktit të Atlantikut, por edhe në vendet e tjera, për forcimin ekonomik dhe ndalim të tronditjeve të ndryshme ekonomike dhe politike». Si ta kuptojmë këtë kur as vetë vendet që kanë marrë «ndihmën amerikane» nuk guxojnë të flasin për planin Marshall, sepse për të gjithë është e qartë se ky plan lidhi ekonominë e tyre pas qerres amerikane dhe i çoi në një vartësi ekonomike e politike përherë më të madhe nga SHBA? Gjithë bota

e di, nga ana tjetër, se SHBA, për të dhënë ndihmën e tyre, i vunë si kusht Indisë, Egjiptit, Sirisë apo Indonezisë hyrjen në paktet ushtarake të Bagdatit apo të SEATO-s. Dhe kur këto vende vendosën të mbrojnë me këmbëngulje pavarësinë e tyre dhe të mos i nënshtrohen diktatit amerikan, SHBA jo vetëm refuzuan ndihmën për to, por veçanërisht në Egjipt, Siri e Indonezi, me njëmijë mënyra, u përpoqën dhe po përpiqen të organizojnë komplete kundër lirisë dhe pavarësisë së tyre. Është e pakuptueshme se si udhëheqja e një vendi që e quan veten socialist mund të lavdërojë në këtë mënyrë ndihmën amerikane dhe të justifikojë politikën agresive të kampit imperialist, ndërsa në të njëjtën kohë të sulmojë politikën paqësore të kampit tonë socialist.

Në Kongresin VII të LKJ shumë sulme u bënë kundër vendeve socialiste dhe partive të tjera marksiste nga sekretari i KQ të LKJ, A. Rankoviç. Ne kemi ndërmend të ndalemi vetëm në një çështje. Rankoviçi në fjalimin e tij, u përpoq të krijojë përshtypjen se nga ana e partive të tjera po i bihet në qafë LKJ, për arësye se kjo mbron pavarësinë e vendit, se përsëri po «mprehen armët e vjetra të Kominformit», siç u shpreh ai, dhe se po ndërhyhet përsëri në punët e brendshme të Jugosllavisë. Bile lidhur me këtë, në kongres u theksua se «askujt nuk mund t'ia njohin të drejtën që të përcaktojë çfarë është në këtë program marksiste, çfarë nuk është». Këtu ka dy gjëra që duhen sqaruar. Së pari, çështja e ndërhyrjes në punët e brendshme të LKJ. Është për t'u çuditur se sa herë që ndonjë nga partitë tona kritikon në mënyrë shoqërore e me të



drejtë këtë ose atë qëndrim të LKJ, kjo konsiderohet ndërhyrje në punët e brendshme, polemikë e paparim etj., kurse kur ndërhyjnë udhëheqësit ose shtypi jugosllav në punët e brendshme të vendeve të tjera, bile duke sugjeruar se cili udhëheqës është «i mirë» e duhet rehabilituar ose është «stalinist» e duhet hequr, kjo, nga ana e tyre, quhet «kritikë shoqërore». E ku është këtu barazia dhe respekti reciprok për të cilat u fol kaq shumë në kongresin e LKJ? Kësaj i thonë demagogji. Ose, sipas udhëheqësve jugosllavë, LKJ paska të drejtë, dhe është «shoqërore» e «konstruktive» (bile «kontribut» në thesarin e marksizëm-leninizmit) që të flasë në programin e në kongresin e saj për veprimtarinë e partive komuniste e punëtore, të sulmojë hapur, të polemizojë e të kritikojë këto parti, të shtrembërojë të vërtetën përse u përket marrëdhënieve që ekzistojnë midis tyre, të shfaqë gjithfarë pikëpamjesh e «vlerësimesh», të cilat janë në kundërshtim me teorinë dhe praktikën e marksizëm-leninizmit, ndërsa partitë tona, të cilat i shpjeguan botërisht arësyet përse nuk morën pjesë në Kongresin VII të LKJ, përse ato nuk ishin dhe nuk janë dakord me vlerësimet që jepen në program për lëvizjen ndërkombëtare punëtore, për situatën dhe marrëdhëniet midis popujve, për disa çështje teorike etj., nuk kanë të drejtën të thonë fjalën e tyre dhe akuzohen se në këtë mënyrë ndërhykan në punët e brendshme të Jugosllavisë. Është e qartë se një pretendim i tillë, edhe pas gjithë përpjekjeve nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera për të përmirësuar marrëdhëniet, është pa baza dhe udhëheqësve të LKJ u duhet për të luajtur rolin e «viktimës së pafaj-

shme». Askujt nga ne nuk i ka vajtur në mend dhe as i vete që të përzihet në punët e brendshme as të Jugosllavisë as edhe të ndonjë vendi tjetër. Por asnjë marksist, nuk mund të heshtë, nuk mund të pajtohet me idenë e bashkëjetesës së marksizmit me revizionizmin në fushën ideologjike. Çdo komunist e ka për detyrë të denoncojë me forcë, hapur, pa ngurrim çdo pikëpamje revizioniste e antimarksiste, kushdo qofshin autorët e saj, dhe aq më shumë kur të tilla pikëpamje, për të parën herë në histori, formulohen në programin e një partie që është në fuqi dhe që i ka vënë vetes detyrë të ndërtojë socializmin. Duke i denoncuar këto pikëpamje si të rrezikshme për teorinë dhe praktikën e socializmit, askush nuk u imponon mbajtësve të tyre që të ndryshojnë mendimin që kanë në qoftë se ata duan ta ruajnë atë. Së dyti, mbi mprehjen e armëve të Kominformit. Kur kritikojmë pikëpamjet antimarksiste që përmban programi apo fjalimet që u mbajtën në Kongresin VII të LKJ, s'është puna as «për të përsëritur 1948-n», as «për të mprehur armët e vjetra të Kominformit» dhe as «për të vazhduar presionet», por është fjala për të mbrojtur marksizëm-leninizmin. Në qoftë se shumë nga çështjet parimore kundër të cilave drejtohet kritika jonë janë po ato çështje për të cilat janë bërë kritika edhe më 1948, kjo nuk është «përsëritje e 1948-s». Kjo tregon se për ato çështje LKJ qëndron në të njëjtat pozita me të cilat kanë qenë dhe janë në kundërshtim partitë komuniste e punëtore.

Në raportin që iu paraqit kongresit u tha se «marrëdhëniet me Shqipërinë janë gjithnjë jonormale» dhe për këtë çështje u paraqit sikur fajin e ka gjoja vendi

ynë. Tanimë dihet nga të gjithë se kjo deklaratë nuk i përgjigjet së vërtetës. Qeveria jonë, duke u udhëhequr nga vendimet e Kongresit III të Partisë, kurdoherë ka ndjekur dhe ndjek politikën e fqinjësisë së mirë dhe të marrëdhënieve miqësore edhe me RFP të Jugosllavisë, por ka kërkuar dhe kërkon që këto marrëdhënie të bazohen në respektimin reciprok, në barazinë, në mosndërhyrjen në punët e brendshme dhe t'i përgjigjen fqinjësisë së mirë. Për cilindo është e qartë se veçanërisht për ne, një vend i vogël, i cili i është përveshur punës me të gjitha forcat për ndërtimin e socializmit, çështja e fqinjësisë së mirë dhe e marrëdhënieve miqësore me të gjithë popujt, pra edhe me popujt e Jugosllavisë, me të cilët kemi luftuar së bashku për t'u çliruar nga fashizmi, është shumë e rëndësishme. Bile çështja e përmirësimit të marrëdhënieve është edhe në interesin e vetë RFP të Jugosllavisë. Mosmarrëveshjet ideologjike që ekzistojnë midis nesh dhe lufta për të mbrojtur parimet e marksizëm-leninizmit, nga të cilat ne nuk heqim dorë, nuk duhet të pengojë marrëdhëniet e bazuara në respektin reciprok të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të secilës palë.

Në këtë artikull ne u ndalëm vetëm në disa nga çështjet që preken në programin e LKJ dhe në raportet e diskutimet e mbajtura në Kongresin VII të saj. Kryesisht këto çështje kanë të bëjnë me problemet e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe disa çështje të politikës së jashtme. Siç u pa më sipër, pikëpamjet që u trajtuan në kongres lidhur me këto çështje, si edhe për shumë çështje të tjera, tregojnë se

këtu nuk është fjala për disa mosmarrëveshje të vogla, siç duan ta paraqitin udhëheqësit e LKJ, po për një platformë të plotë antimarksiste, revizioniste, nga e cila udhëheqësit jugosllavë, siç e deklaruan vetë, nuk duan të lëvizin dhe që synon të përçajë unitetin e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare në luftën për socializmin.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 106 (3007), 4 maj 1958*

*Botohet me ndonjë shkurtim sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 106 (3007), 4 maj 1958*

## **DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS SË PARTISË NË USHTRI**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**10 maj 1958**

Jam dakord me raportin që na është paraqitur. Shokët e ushtrisë të kenë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e bëra në këtë mbledhje të Byrosë Politike për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë dhe të komandave në repartet ushtarake.

Një nga detyrat kryesore të Partisë në ushtri është që të punojë për të afruar akoma më tepër komandantët me trupat. Kjo çështje na preokupon shumë, sepse ka të bëjë me forcimin e lidhjeve të komandave me ushtarët, me çelnikosjen e unitetit midis tyre, me lartësimin gjithnjë e më shumë të gjendjes moralo-politike të trupës, me njohjen e ushtarëve nga komandantët dhe me edukimin e oficerëve. Prandaj, çdo komandant ta kuptojë mirë se afrimi i tij me trupën është faktor me rëndësi për të forcuar punën në ushtri. Kjo do t'u japë më shumë mundësi kuadrove ushtarakë të hyjnë

në botën e brendshme të çdo ushtari dhe të fitojnë besimin, dashurinë e respektin e tyre të plotë.

Këtu u ngrit edhe çështja e zotërimit të teknikës luftarake. Kjo është gjithashtu një detyrë me rëndësi të madhe, që kërkon një kujdes të veçantë. Njeriu në luftë luan vërtet një rol vendimtar, por kjo nuk do të thotë që të lihet pasdore përvetësimi i teknikës. Sot lufta bëhet me armët më moderne, të cilat është e domosdoshme t'i mësojmë mirë, të perfeksionohemi vazhdimisht. Prandaj, të punohet kurdoherë që ushtarakët të bëhen mjeshtër të teknikës së komplikuar, të zotërojnë armët e llojeve të ndryshme, t'i ruajnë e t'i mirëmbajnë ato me kujdesin më të madh.

Motori i punës në ushtri është organizata bazë e Partisë. Prandaj Drejtoria Politike e Ushtrisë Popullore të nxjerrë mësimet e konkluzione se si të gjallërohen më tej organizatat bazë në ushtri, si të forcohet kritika e autokritika në rrugë të drejtë të Partisë. Të mësohen komunistët se si të përdoret kjo armë e rëndësishme në duart tona për të përmirësuar punën. Mund të zhvillohen për këtë edhe leksione konkrete, të ilustruara me shembuj pozitivë e negativë nga jeta e organizatave bazë të Partisë në ushtri. Për të forcuar e revolucionarizuar më tej jetën e Partisë në ushtri një interesim më të madh duhet të tregojnë Drejtoria e organeve të Partisë dhe ajo e agjit-propit, të cilat, me eksperiencën e madhe të Partisë, të ndihmojnë më tepër Drejtorinë Politike pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore.

Lidhur me këtë Drejtoria Politike duhet të insistojë shumë që komandantët të interesohen më tepër për

punët e Partisë, që ata të mos kujdesen vetëm për çështjet ushtarake, por edhe për ato ideo-politike. Forcimi i udhëheqjes politike dhe ideologjike nga ana e Partisë është faktor vendimtar për mbarëvajtjen e punës, sepse Partia është truri dhe zemra e Ushtrisë sonë Popullore.

Nga të dhënat që kemi rezulton se përqindja e komunistëve në radhët e nënoficerëve është e vogël. Duke marrë parasysh faktin se nënoficerët janë të lidhur shumë ngushtë me ushtarët, jam i mendimit që të punohet më shumë për të pranuar prej tyre në Parti.

Problemi i kuadrit për ushtrinë është serioz dhe duhet zgjidhur. Në këtë drejtim ka vështirësi, por nuk mungojnë edhe mundësitë për t'i kapërcyer ato. Cilat janë disa nga këto mundësi që mund të shfrytëzohen më mirë? Të kihen parasysh oficerët e çmobilizuar, sepse midis tyre ka edhe njerëz të rinj, që janë të pajisur me arësim e kulturë, të mos mbështetemi vetëm në ata që porsa kanë mbaruar 7-vjeçaren. Kështu do të kemi një kontingjent shumë të mirë kuadrosh për nevojat aktuale të ushtrisë. Në rast se për ushtrinë kërkojmë njerëz nga gjimnazet, do të gjejmë vështirësi t'i bëjmë oficerë. Mua më duket se Shkolla «Skënderbej» duhet të jetë një bazë e mirë, sepse atje grumbullohen dhe përgatiten për oficerë bij të punëtorëve dhe të fshatarëve. Mund të studjohet se sa vjeçare duhet të jetë kjo shkollë, ose si të ulim shpenzimet e saj, si të pakësojmë kuadrot që punojnë për përgatitjen e oficerëve të rinj etj. Prandaj, Ministria e Mbrojtjes Popullore të na paraqitë një studim mbi çështjen e kuadrove dhe

të shkollave ushtarake, të cilin ta shqyrtojmë në Byrosë Politike.

Ne duhet të kemi edhe një kontingjent kuadrosh rezervë për disa specialitete ushtarake më të rëndësishme. Veç kësaj, të ngremë edhe kurse pa shkëputje nga puna, në të cilat të pregatiten kuadro nga pikëpamja ushtarake.

T'u vihet fre lëvizjeve pa vend e paralele të kuadrove ushtarakë. Edhe unë jam i mendimit si shokët që, me përmirësimin e kushteve ekonomike të vendit, të shohim edhe përmirësimin e mëtejshëm të ushqimit në ushtri, të rishikohen pagat e kuadrit, natyrisht brenda limiteve që kemi caktuar etj.

Jam dakord që arma e artilerisë të sigurohet me maqina sipas nevojave që ka. Natyrisht, këtë ta bëjmë pa varfëruar transportin civil ekonomik, ndryshe do të kemi dëme të mëdha. Prandaj kjo të shihet me kujdes. Gjithashtu jam dakord për përforcimin e aviacionit edhe me helikopterë etj.

Si përfundim mund të themi se shokët e ushtrisë punojnë pa u lodhur, në punën e tyre ka suksese e përparime, por duhet pranuar se ekzistojnë edhe të meta, që shokët i vunë në dukje me anë të diskutimeve të tyre. Prandaj, të mbahen mirë parasysh e të zbatohen detyrat që dolën nga kjo mbledhje e Byrosë Politike.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## POZITAT TONA JANË TË FORTA, VIJA E PARTISË SONË ESHTË E DREJTË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 maj 1958

Siç e dini, prej datës 20-24 maj 1958, u zhvillua në Moskë mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë të vendeve socialiste. Rendi i ditës përmbante këto çështje: Mbi bashkëpunimin ekonomik midis vendeve pjesëmarrëse në Këshillin e Ndhmës Ekonomike Reciproke; mbi koordinimin e prodhimit të industrisë së mbrojtjes dhe furnizimeve reciproke të teknikës luftarake; mbi parimet e përcaktimit të çmimeve në tregëtinë midis vendeve socialiste; mbi punën e organeve shtetërore të planifikimit të vendeve socialiste për përpunimin e planeve perspektive të zhvillimit të degëve kryesore të ekonomisë popullore të lidhura në mënyrë reciproke.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje, shoku Enver, raportoi në emër të delegacionit që mori pjesë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë të vendeve socialiste, që u zhvillua në Moskë prej datës 20-24 maj 1958.

Diskutimi i këtyre çështjeve në këtë mbledhje, ishte i domosdoshëm, sepse praktika e deritanishme ka treguar se shumë nga vendimet që janë marrë në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke nuk janë zbatuar si duhet. Prandaj u vendos edhe një herë që zbatimi i këtyre vendimeve dhe hartimi i planeve ekonomike të vendeve tona të koordinohen më mirë se përpara.

Në lidhje me çështjet ushtarake, nga ana jonë nuk kishte ndonjë gjë për të diskutuar, prandaj dhe nuk folëm, sepse atje u bë fjalë për çështje që neve nuk na përkisnin. Megjithatë edhe për këtë çështje pati diskutime nga të tjerët përkatësisht për vendet e tyre.

Përshtypja jonë e përgjithshme në këtë mbledhje të nivelit të lartë ishte se atje u manifestua një solidaritet i madh i të gjitha vendeve socialiste, megjithëse u bënë edhe vërejtje për disa probleme ekonomike dhe ushtarake.

Për Republikën Demokratike Gjermane u tha se ajo ka kërkuar një ndihmë të veçantë për forcimin e mëtejshëm të situatës që ekziston atje. Shokët e Gjermanisë Demokratike e shtronin çështjen në mënyrë të tillë që vendi i tyre të bëhet vitrinë për Gjermaninë Perëndimore. Për këtë qëllim ata kërkuan të ndihmohen. Duke iu përgjegjur kësaj kërkesë, shoku Hrushov tha se Bashkimi Sovjetik është plotësisht dakord që të ndihmohet Gjermania Demokratike dhe jo vetëm ajo, po edhe Shqipëria, për arsye se këto dy vende mike janë në kufi të kampit tonë, ballë për ballë imperializmit, prandaj e para duhet të bëhet pasqyrë për Gjermaninë Perëndimore, ndërsa Shqipëria duhet të bëhet pasqyrë

për vendet arabe. Me këtë mendim u shpreh dakord edhe shoku Todor Zhivkov, ndërsa përfaqësuesit e partive të tjera nuk thanë ndonjë fjalë.

Pas këtyre çështjeve shoku Hrushov mbajti dhe një fjalë prej rreth 20 minutash. Ai foli në përgjithësi për unitetin e vendeve tona dhe për politikën ekonomike që ndjek Bashkimi Sovjetik. Ne të tjerët mendonim se do të thoshte ndonjë gjë edhe për Jugosllavinë, por ai nuk tha asgjë. Bile, kur u paraqit rendi i ditës bëmë pyetjen nëse në këtë mbledhje të nivelit të lartë do të kishte edhe ndonjë pikë për çështje ideologjike, por na u tha se nuk do të ketë, ndërsa përsa i përket çështjes jugosllave, Andropovi tha se ajo është e qartë. Megjithatë, vazhdoi ai, rendi i ditës do të shtrohet në mbledhje për t'u aprovuar dhe aty mund të bëhen propozime. Pra, në mbledhje nuk u prek fare çështja jugosllave në kuptimin që të gjitha partitë komuniste e punëtore të vendeve socialiste të mbanin një qëndrim. Vetëm se, kur foli Hrushovi për çështjen e misrit, tha se do të polemizonte me jugosllavët, pasi Rankoviçi ishte shprehur kundër atyre udhëheqësve që merren vetë me çështje praktike dhe harrojnë çështjet e mëdha politike dhe ideologjike duke bërë aluzion për mua, por unë, tha Hrushovi, mburrem, që thuhet për mua se i shoh çështjet nga ana praktike.

Gjatë fjalës së tij Hrushovi zuri në gojë edhe emrin e Stalinit e të Molotovit. Për Stalinin ai tha se e kemi dashur dhe e duam, e kemi qarë dhe e qajmë, se ishte një njeri shumë i fortë kundër imperialistëve, por këtë ashpërsi ai e kaloi pastaj edhe në kuadrot e partisë. Ndërsa për Molotovin ai tha se nuk kishte

fare haber nga praktika e zhvillimit të ekonomisë në Bashkimin Sovjetik, se ishte i shkëputur nga çështjet ekonomike, të cilat i shihte nëpërmjet mitingjeve, por megjithatë të thuash se Molotovi është armik, do të ishte e gabuar.

Në drekën e fundit që u shtrua për përfaqësuesit e partive komuniste e punëtorë të vendeve socialiste, ne u çuditëm që merrte pjesë edhe Miçunoviçi, ambasadori jugosllav. Në këtë drekë Hrushovi në fillim ngriti dollinë për forcimin e kampit socialist, pastaj për Kinën dhe për Vietnamin, por në fund dhe për Jugosllavinë, duke thënë afërsisht kështu: «Jemi të lumtur që numërohem 13 shtete socialiste. Me Jugosllavinë ne kemi mosmarrëveshje, dhe këtë nuk e fshehim, po me popullin jugosllav ne jemi miq. Prandaj, ta pimë dollinë për popullin heroik të Jugosllavisë dhe për Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, për Komitetin Qendror të LKJ si dhe për shëndetin e shokëve Tito dhe Miçunoviç».

Nesti Nase në një drekë të shtruar nga Gromikua me ambasadorët e vendeve të kampit të socializmit i tha këtij se përse ishte ftuar Miçunoviçi, por Gromikua u përgjigj edhe një herë se ne duhet të bëjmë kurdoherë përpjekje pasi ka shpresa që t'i afrojmë shokët jugosllavë. Pra, fryma e Hrushovit dhe e Gromikos ishte që të bëhen përpjekje për afrimin e Jugosllavisë. Sipas tyre «kjo është një taktikë», por siç kuptohet dhe nga dollia që u ngrit, ky qëndrim del nga kuadri shtetëror e kalon në marrëdhënie partie dhe ideologjike.

Më pas ne nuk u takuam me shokët sovjetikë, ashtu siç bënë shumë nga përfaqësuesit e tjerë të

partive motra, sepse nuk kishim ndonjë problem me ta. Ne çdo gjë e kishim të qartë. Shokët e tjerë u takuan. Për shembull shokët bullgarë u takuan për arësye se Hrushovi do të shkojë në Kongresin VII të Partisë Komuniste Bullgare.

Është fakt se qëndrimi i Partisë sonë dhe i vijës së saj veçanërisht ndaj Jugosllavisë aprovohej nga të gjitha partitë e tjera, përveç polakëve me të cilët nuk patëm rast të bisedonim. Të gjithë të tjerët kishin një konsideratë të lartë për Partinë tonë.

Si konkluzion mund të themi se pozitat tona në këtë mbledhje kanë qenë të forta dhe ky qëndrim i partive të tjera motra ndaj Partisë sonë tregon se rruga që kemi ndjekur dhe ndjekim ne ka qenë dhe është e drejtë.

*Në fund shoku Enver i propozoi Byrosë Politike një sërë masash, për t'ia rekomanduar Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për zbatimin në praktikë të vendimeve që mori mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste që u zhvillua në Moskë.*

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **PARTIA E POPULLI TE NE JANË NJË E TË LIDHUR PËRJETË**

*Fjala e mbajtur para zgjedhësve të zonës  
elektorale Nr. 158 të Tiranës*

29 maj 1958

Të dashur shokë dhe shoqe,

Më lejoni së pari t'ju falenderoj me gjithë zemër për besimin dhe nderin e madh që më bëtë, duke më propozuar kandidat për deputet në organin më të lartë të shtetit tonë, në Kuvendin Popullor. Besimin që ju po tregoni ndaj meje unë e konsideroj si një shprehje të mirënjohjes së thellë dhe të dashurisë së madhe që ushqeni për Partinë tonë heroike të Punës, farkëtuesen e të gjitha fitoreve të popullit tonë, që e ka udhëhequr atë kurdoherë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

Unë ju siguroj, të dashur shokë dhe shoqe, si komunist dhe qytetar i Republikës se nuk do t'i kursej forcat e mia dhe si kurdoherë edhe në të ardhshmen, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Partisë sonë të dashur do të punoj pa u lodhur për t'i shërbyer me

besnikëri popullit dhe atdheut që të meritoj kështu plotësisht besimin tuaj.

Fushata e zgjedhjeve për në Kuvendin Popullor, që tani është nga mbarimi i saj, po zhvillohet në atmosferën e një entuziazmi dhe mobilizimi të madh të masave punonjëse të popullit tonë për realizimin e detyrave historike që vuri përpara Kongresi III i Partisë dhe Plenumi i Shkurtit i Komitetit Qendror të Partisë sonë. Populli ynë, ditën e zgjedhjeve të reja, 1 qershorin, po e pret me ndjenjën e një gëzimi të papërskruar dhe, duke bërë bilancin e punës së tij 4-vjeçare që nga zgjedhjet për legjislaturën e tretë, me krenari të ligjshme mburret për sukseset madhështore që ka arritur në të gjitha fushat e jetës së tij në Shqipërinë e lirë, të pavarur e sovrane.

Zgjedhjet në vendin tonë, në regjimin e demokracisë popullore, kanë qenë kurdoherë një shprehje e gjallë e bashkimit moral dhe politik të popullit dhe e lidhjeve të tija të ngushta me Partinë e tij të lavdishme të Punës, ato kanë shërbyer kurdoherë për zhvillimin dhe për forcimin gjithnjë më të madh të Republikës sonë Popullore, të demokracisë sonë socialiste.

Zgjedhjet e reja për në Kuvendin Popullor kanë një rëndësi shumë të madhe për jetën e vendit, pasi populli do të dërgojë në organin më të lartë të pushtetit bijtë dhe bijat e tija nga më të mirët, luftëtarët më të vendosur dhe të sprovuar për të mbrojtur me nder çështjen e popullit dhe të Partisë, njerëzit që punojnë pa u lodhur për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit tonë shtetëror demokratik dhe për ndërtimin e socializmit, ata që nuk kursejnë asgjë për forcimin e miqësisë me

Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe me vendet e tjera, që bëjnë pjesë në kampin e fuqishëm të socializmit dhe të paqes.

Marrja e pushtetit në duart e popullit është një nga fitoret më të mëdha që ai ka korrur nën udhëheqjen e urtë të Partisë së tij të Punës. Por që të jetonte ky pushtet, që ai të bëhej një armë e mprehtë në duart e popullit për ndërtimin e një jete më të mirë e më të lumtur, për ta forcuar atë dita-ditës, për ta bërë më të përsosur, më demokratik dhe një armë të sigurtë për të dërmuar çdo përpjekje të armiqve të jashtëm e të brendshëm u desh dhe u vunë në jetë mësimet e Partisë.

Populli ynë, i edukuar nga Partia, ka pasur kurdoherë parasysh që në pushtet të sillte njerëzit më të mirë, të zgjedhur nga radhët e klasës sonë heroike punëtore, të fshatarësisë patriote dhe të inteligjencies të dalë nga radhët e popullit. Kjo është një çështje e dorës së parë. Prandaj, fushata për zgjedhjet në Kuvendin Popullor është një aksion i madh politik që do të ndihmojë me siguri në zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë sonë socialiste, në forcimin e Republikës sonë Popullore. Kjo fushatë e madhe po zhvillohet në atmosferën e një veprimtarie të madhe politike dhe të një mobilizimi të gjerë të masave punonjëse për arritjen e rezultateve akoma më të mëdha politike, ekonomike e kulturele.

Shokë dhe shoqe,

Në pushtetin popullor, vendi ynë brenda këtyre 14 vjetëve ka bërë ndryshime të mëdha dhe përparime të shkëlqyera në të gjitha fushat e jetës së tij. Veprat që



ka ndërtuar pushteti popullor gjatë këtyre 14 vjetëve dëshmojnë realizimin në praktikë të politikës së drejtë të Partisë sonë. Zhvillimi me ritme shumë të shpejta i industrisë dhe i minierave, përparimet në lëmin e bujqësisë, lulëzimi i arësimit dhe i kulturës, rritja e vazhdueshme e nivelit material dhe kultural të popullit, tregojnë se sa shumë ka ndryshuar vendi ynë nga e kaluara plot vuajtje dhe mjerime.

Përparimet e pashembullta që janë bërë në Shqipëri u realizuan në sja të unitetit të çelniktë moral e politik të popullit tonë që, duke u udhëhequr nga Partia e Punës, u mobilizua plot besim dhe entuziazëm për të vënë në jetë mësimet e saja të urta. I frymëzuar nga këto mësimet, populli ynë u ngrit i tëri në luftë për të ndërtuar atdheun e tij të bukur, jetën e tij të re, lumturinë për vete dhe për brezat e ardhshëm. Kështu, gjatë kësaj periudhe të shkurtër 14-vjeçare, Shqipëria, nga një vend shumë i prapambetur nga ana ekonomike dhe kulturele, u kthye në një vend të përparuar agraro-industrial, që ka zhdukur analfabetizmin për moshat nën 40 vjeç, që ka zënë vendin e merituar në arenën ndërkombëtare, që është i lidhur në miqësi të ngushtë me popujt e lavdishëm sovjetikë dhe me popujt e tjerë që ndërtojnë socializmin dhe që gëzon simpatinë dhe përkrahjen e të gjithë popujve të botës. Këto janë fitore historike që populli ynë do t'i ruajë si sytë e ballit dhe do t'i forcojë dita-ditës më shumë.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Qëllimi më i lartë i Partisë sonë është rritja e vazhdueshme dhe e pandërprerë e mirëqenies së masave

punonjëse. Për të realizuar këtë qëllim të lartë punojnë pa pushim Partia dhe pushteti ynë, për këtë qëllim të lartë janë mobilizuar masat punonjëse të vendit tonë.

Duke bërë bilancin e sukseseve në ndërtimin e ekonomisë dhe të kulturës, populli ynë shikon me krenari rezultatet e punës së tij, të djersës së derdhur për lulëzimin e atdheut, për lumturinë, për begatinë.

Si ishte vendi ynë përpara 13-14 vjetësh? Koha nuk është shumë e gjatë, bile edhe zgjedhësit e rinj akoma mund t'i mbajnë mend plagët e rënda që trashëguam nga lufta, ekonominë e prapambetur e të shkatërruar, analfabetizmin, mungesën e bukës dhe të shkollave, varfërinë, mjerimin dhe sëmundjet. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër, në saje të mobilizimit dhe të entuziazmit të madh që karakterizon popullin tonë punëtor, nën udhëheqjen e Partisë, Shqipëria është ndryshuar që nga themeli.

Përparime të mëdha janë bërë në zhvillimin e industrisë që pothuajse s'ka ekzistuar fare në të kaluarën në vendin tonë. Në fund të vitit 1957 industria jonë është rritur 14,6 herë më shumë se në vitin 1938. Vepra të mëdha moderne që janë bërë krenaria e vendit tonë janë ndërtuar pas çlirimit. Ato e kanë forcuar shumë ekonominë tonë popullore. Kombinati i madh i Tekstileve «Stalin», hidrocentralet «Karl Marks» dhe «Lenin», Fabrika e Sheqerit «8 Nëntori» në Korçë, Fabrika e Çimentos në Vlorë, Uzina «Enver», Fabrika e Këpucëve, fabrikat e fermentimit të duhanit në Shkodër dhe Elbasan, ato të zhveshjes së pambukut në Fier e Brogoshinë, Rafineria e Naftës në Cërrik dhe Kombinati

i Drurit në Elbasan, Fabrika e Konservave të Peshkut e Perimeve në Vlorë, minierat si ato të kromit, bakrit, hekurit, bitumit, zgjerimi i madh i industrisë së naftës e shumë e shumë objekte të tjera, ngrihen sot madhështore në të katër anët e atdheut. Këto vepra të shumta e të rëndësishme nuk janë më pronë për pasurimin e disa njerëzve ose grupe njerëzish, por pronë e gjithë popullit, të ardhurat e të cilave shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës të të gjithë punonjësve tanë.

Si rezultat i ndërtimit të të gjitha këtyre veprave, është rritur shumë klasa punëtore e vendit tonë, shtylla vertebrale e pushtetit tonë popullor, që me heroizëm të pashoq. nën udhëheqjen e Partisë, lufton për lulëzimin dhe begatinë e atdheut. Nga gjiri i klasës sonë punëtore të re dhe të popullit tonë punëtor kanë dalë dhe punojnë me mijëra teknikë dhe specialistë të rinj në të gjitha fushat e ekonomisë, që po drejtojnë me zotësi maqineritë moderne që kemi marrë nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe nga vendet e tjerë vëllezër të demokracisë popullore. Nga gjiri i popullit tonë punëtor, Partia rriti dhe edukoi, gjatë kësaj periudhe të shkurtër, një brez të tërë njerëzish të rinj, me cilësi të larta morale që janë gati të sakrifikojnë dhe jetën për kauzën e popullit. Një armatë e madhe kuadrosh të dalë nga radhët e punëtoreve dhe të fshatarësisë sonë patriote, në punë e sipër, në luftë me vështirësitë, janë kalitur, kanë fituar eksperiencë të madhe dhe nga njerëz të thjeshtë, sot drejtojnë sektorë të rëndësishëm të prodhimit. Të tjerë bij dhe bija të thjeshta punëtorësh e fshatarësh, populli i dërgoi në

shkolla të mësojnë dhe me qindra e qindra kanë mbaruar universitetet brenda e jashtë vendit dhe krah për krah me punëtorët e me shokët e tyre që vijnë nga radhët e inteligjencies së vjetër patriote po punojnë me zell në miniera, fabrika, uzina, ferma e kooperativa, në parqe e kantiere ndërtimi, në shkolla e spitale; kanë marrë në duart e tyre drejtimin e të gjithë sektorëve të ndryshëm të jetës së vendit dhe me zotësi e besnikëri i shërbejnë popullit dhe atdheut. Nga gjiri i popullit punëtor në shumë vende të atdheut tonë populli ka propozuar si kandidatë të vet për deputetë në Kuvendin Popullor njerëz të dëgjuar për punën e tyre siç janë Halil Kraja, Maqo Dhosi, Xhel Jakupi, Sali Vata, Shaqir Koni, brigadieri i shquar i Minierës së Kërrabës Rakip Shiba dhe shumë të tjerë. Këta shokë dhe qindra e mijëra shokë të tjerë punëtorë të pararojës, minatorë, shoferë, muratorë, karpentierë, teknikë, specialistë e inxhinierë të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, të frymëzuar nga mësimet e Partisë sonë dhe nga dashuria e madhe për popullin e atdheun, në të katër anët e vendit janë mobilizuar dhe me shembullin e tyre, frymëzojnë gjithë klasën tonë heroike punëtoresh për realizimin e detyrave që vihen përpara, për forcimin e ekonomisë popullore, për zbukurimin e atdheut, për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së popullit.

Kujdes të madh kanë treguar vazhdimisht Partia dhe pushteti për zhvillimin e bujqësisë, në radhë të parë për ta nxjerrë atë nga prapambetja. Janë rritur rendimentet e kulturave bujqësore në krahasim me të kaluarën, është shtuar sipërfaqja e mbjellë, janë hapur e po hapen toka të reja, janë ndërtuar kudo kanale

vaditëse e kulluese. Një sukses shumë i madh për përparimin e bujqësisë sonë është rritja e pashembullt e mekanizimit në punimet bujqësore. Në fushat tona buçasin sot traktorët, kombajnët dhe maqinat e tjera moderne bujqësore, të cilat më përpara as që ekzistonin. Si rezultat i këtyre përparimeve dhe i shumë masave të tjera të marrura për zhvillimin e bujqësisë, prodhimi bujqësor në vitin 1957 është rritur 182 për qind në krahasim me vitin 1938.

Një kthesë historike është bërë vitet e fundit në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë, e vetmja rrugë e drejtë për ta nxjerrë fshatarësinë një herë e përgjithmonë nga varfëria dhe nga prapambetja. Nga 129 kooperativa bujqësore që kishim në vitin 1953, deri në 1 maj të këtij viti numri i tyre ka arritur në 1 912, duke përfshirë 69,6 për qind të sipërfaqes së tokës së punueshme të vendit tonë. Kështu është duke u realizuar pothuajse që tani detyra e vënë në Kongresin III të Partisë për vitin 1960. Tani një nga detyrat më me rëndësi të sektorit të bujqësisë është forcimi i gjithanshëm i kooperativave bujqësore. Tani që kolektivizimi ka marrë përpjesëtime kaq të gjera bëhet e mundshme që bujqësia të zhvillohet me hapa më të shpejtë. por kjo kërkon një mobilizim të gjithanshëm të punonjësve të bujqësisë.

Në radhë të parë tani shtohen mundësitë për të futur në shkallë akoma më të gjerë mekanizimin në fushat tona, prandaj SMT-të duhet të organizojnë punën në mënyrë që ta kryejnë si duhet rolin e tyre dhe të krijohen mundësitë që të zbatohen mirë metodat agroteknike, të rriten gjithnjë më shumë rendimentet,

të lehtësohet mjaft krahu i punës në fshat, gjë që do t'u lejojë kooperativistëve të merren edhe me punë të tjera bujqësore, siç janë zhvillimi i vreshtave, i pemëve frutore, rritja e mirë e bagëtisë, shtimi i shpendëve, i bletëve etj. Zhvillimi i blegtorisë dhe shtimi e përmirësimi i racës së deleve dhe të lopës duhet të jetë në qendrën e vëmendjes dhe të kujdesit të vazhdueshëm të drejtuesve e të punonjësve të bujqësisë. Një rol vendimtar në këtë çështje, siç dihet, luan sigurimi i silazhit dhe i ushqimeve të tjera për bagëtinë.

Tani fshatarësia e vendit tonë është mobilizuar për realizimin e detyrave të stinës, për të shfrytëzuar sa më mirë gjendjen e favorshme të krijuar pas shirave që ranë ditët e fundit. Në ballë të fshatarësisë qëndrojnë punëtorët e SMT-ve që po e bëjnë natën ditë, pa kursyer asgjë për të realizuar brenda afateve sa më të shkurtëra punimet e prapambetura të penguara në një shkallë të gjerë nga kushtet jo të mira atmosferike. Kooperativistët dhe gjithë fshatarësia jonë patriotë tani duhet të mobilizohen për t'i kryer plotësisht detyrat aktuale urgjente që i dalin bujqësisë.

Përparime të dukshme janë bërë te ne edhe në sektorët e ndërtimit, të transportit, të tregëtisë etj.; punonjësit e këtyre sektorëve të rëndësishëm po punojnë për të realizuar detyrat që u ngarkon atyre plani i shtetit.

Si rezultat i zhvillimit të gjithanshëm ekonomik të vendit tonë është rritur vazhdimisht niveli i jetesës së masave punonjëse. Populli është furnizuar më shumë me ushqime, veshmbathje, ai ka marrë vazhdimisht më shumë banesa dhe jeta e tij është bërë nga viti në vit

më e mirë. Vetëm nga viti 1956 e këtej janë bërë 4 ulje çmimesh dhe nga ulja e fundit që u bë para festës së 1 Majit, pa llogaritur uljen e çmimeve që u bë në janar të vitit 1958 për energjinë elektrike, populli do të fitojë rreth 1 miliard e 300 milion lekë në vit. Tani populli blen më lirë se dy vjet më parë, sheqerin nga 200 lekë kilogramin në 110 lekë, orizin nga 135 në 90 lekë, sapunin nga 135 në 90 lekë, vajin e ullirit nga 280 në 230 lekë, gjalpin nga 600 në 450 lekë kilogramin, bezen nga 150 lekë metrin në 100 lekë, kadifen nga 960 në 480 lekë metrin, penjët nga 53 lekë në 23 lekë rodhanin, stofat e leshta mesatarisht nga 1300 lekë metrin në 900 lekë etj. Përveç këtyre janë rritur rrogat dhe pensionet e ulëta dhe fshatarësisë i janë falur tatimet e prapambetura. Fitore e madhe ishte vitin e kaluar heqja e plotë e sistemit të triskëtimit që u bë në kushte shumë të favorshme për punonjësit. Tani populli blen lirisht ç'të dojë dhe kur të dojë.

Një zhvillim shumë të madh kanë marrë arësimi, kultura dhe mbrojtja e shëndetit të popullit në vendin tonë. Tani çdo fshat ka shkollën e vet fillore dhe një rrjet i gjerë shkollash 7-vjeçare e të mesme mbushin të gjithë vendin. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë, u ngrit vjet Universiteti Shtetëror i Tiranës. Me mijëra nxënës e studentë ndjekin kurset, teknikumet dhe shkollat e larta brenda dhe jashtë atdheut.

Përparime të mëdha janë bërë edhe në fushën e artit e të kulturës. Sot në Shqipëri kemi Teatrin e Operës e të Baletit, Teatrin Dramatik, Filarmoninë Shqiptare, Estradën e Shtetit, Teatrin e Kukullave si dhe shumë teatro e estrada në rrethe të ndryshme të

vendit që nuk ekzistonin në të kaluarën. Kinema, klube, biblioteka, shtëpi kulture e salla leximi, që janë bërë vatra të rëndësishme kulture për edukimin dhe dëfrimin e masave punonjëse, ka në të gjitha anët e vendit.

Për mbrojtjen e shëndetit të popullit është bërë një punë e madhe. Me dhjetëra institucione shëndetësore janë hapur në të tëra anët e vendit si spitale, ambulanca, sanatoriume, maternitete, ku masat punonjëse mjekohen falas. Sot në Shqipëri ka gati tri herë më shumë mjekë se në të kaluarën.

Një kujdes shumë të madh i ka kushtuar vazhdimisht Partia forcimit dhe modernizimit të ushtrisë, duke e pajisur me të gjitha armët moderne të nevojshme, për të mbrojtur punën paqësore të popullit. Me nder po e kryejnë detyrën edhe Organet e Sigurimit të Shtetit, të policisë popullore dhe organet e tjera të diktaturës së proletariatit.

Si kudo përparime të mëdha janë bërë edhe në kryeqytetin e bukur të vendit tonë, në Tiranë. Kryeqyteti ynë është bërë sot qendra më e madhe industriale dhe kulturele e vendit, ai është zmadhuar e zbukuruar shumë me ndërtesa të shumta banimi, me rrugë e bulevardë, parqe e lulishte, me kinema, teatro e shtëpi kulture, me kombinatin e tekstilëve, me fabrika e uzina. Vetëm shkolla fillore, 7-vjeçare e të mesme ka sot 70 në Tiranë, me 21 141 nxënës, pa llogaritur Universitetin shtetëror me 3 559 studentë. Gjithashtu Tirana ka 6 institucione mjekësore të specializuara, nga një spital që kishte para çlirimit dhe përveç poliambulancës, janë hapur edhe 5 ambulanca nëpër lagje. Në kryeqytet punojnë sot aq mjekë sa kishte e gjithë Shqipëria më



1938. Gjatë 4 vjetëve që nga zgjedhjet e kaluara, në Tiranë janë ndërtuar me qindra apartamente banimi, po kjo punë, duke filluar që sivjet do të ecë me ritme më të shpejta. Kështu deri në vitin 1960 do të ndërtohen edhe 2000 apartamente të tjera, nga 4000 që janë ndërtuar që pas çlirimit.

Në Tiranë, sikurse e keni marrë vesh gjatë këtij pesëvjeçari do të ndërtohen një kombinat i madh ushqimor, kombinati i mishit, frigoriferi, centrali automatik, parku zoologjik etj. dhe qysh këtë vit do të ndërtohen fabrika e bukës, banjo e lavanderi, 2 shkolla, 2 kopshte e 4 çerdhe, rrugë të reja, kanale, lulishte dhe do të hapen me dhjetëra mijëra gropa në parkun e madh për mbjellje pemësh.

Në saje të faktorëve të brendshëm e të jashtëm, në vendin tonë u bë e mundur që plani i dy viteve të para të pesëvjeçarit të dytë jo vetëm të realizohet me sukses, po edhe të merren masa për shtimin e tij. Plenumi i Shkurtit i këtij viti i Komitetit Qendror të Partisë dhe sesioni i fundit i Kuvendit Popullor aprovuan shtesat e bëra në planin e dytë pesëvjeçar, gjë që do të bëjë të mundshëm zhvillimin e mëtejshëm të industrisë dhe të bujqësisë dhe si rrjedhim përmirësimin e nivelit të jetesës së popullit më shumë nga sa ishte parashikuar. Kështu në vitin 1960 do të prodhohen deri në 2 milion ton naftë, d.m.th. 9 herë më shumë, një herë e gjysmë qymyr më shumë dhe dy herë e gjysmë sheqer dhe krom më tepër në krahasim me 1955. Gjatë viteve të ardhshëm do të ndërtohen objekte të tilla të rëndësishme siç janë hidrocentralet e Bisticës dhe të Shkopetit, fabrika e pasurimit të bakrit në Kurbnesh, fabrika e

alkoolit në Maliq, uzina e fermentimit të duhanit në Durrës etj. Gjithashtu një sërë objektesh të tjera ekzistuese do të rindërtohen dhe do të ndërtohen për të shtuar akoma më shumë kapacitetin e tyre prodhues.

Me masat që do të merren parashikohet që në sektorin e bujqësisë në vitin 1960 të prodhohen rreth 59 për qind më shumë drithëra buke, 109 për qind pambuk, 103 për qind duhan dhe 30 për qind panxhar sheqeri më shumë se në vitin 1955 si dhe të hapen 164 mijë hektarë toka të reja. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të frutikulturës dhe do të hidhen bazat që në pesëvjeçarët e ardhshëm vendi ynë të kthehet me të vërtetë në një kopësht të lulëzuar. Gjatë pesëvjeçarit të dytë do të mbillen gjithsejt 18 milion rrënjë pemë frutore, 3 milion rrënjë ullinj, 23 milion pjergulla, 14 mijë hektarë vreshta dhe afër 700 000 rrënjë agrume.

Është e natyrshme se një zhvillim i tillë i ekonomisë së vendit tonë do të sjellë si pasojë që të ardhurat kombëtare të rriten 73 për qind më shumë se në vitin 1955, si pasojë të rritet paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve deri në 35 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë 45 për qind më shumë. Kështu populli do të jetë në gjendje të blejë më shumë se tani sheqer, yndyrna, bulmetra, mish, perime, fruta, veshmbathje etj.

Me gjithë ndërtimet e mëdha që janë bërë në qytete e qendra pune, detyrë e ngutshme qëndron tani përpara organeve të ndërtimit shpejtimi i ndërtimit të banesave për punonjësit. Vetëm gjatë këtij pesëvjeçari, përveç shtëpive që do të ndërtojnë vetë populli me kredi të shtetit, do të ndërtohen edhe 730 000 m<sup>2</sup> ndërtesa banimi për nevojat e punonjësve. Kjo detyrë ka mundësi të reali-

zohet jo vetëm në kohën e duhur, por duhet të bëhen përpjekje që ajo të tejkalohet dhe të sigurohet kështu një numër më i madh punonjësish me strehim.

Partia jonë e ka zakon që të mos kënaqet me sukseset e arritura. Sigurisht sukseset tona të deritanishme janë shumë të mëdha, po vendit tonë tani i janë krijuar mundësitë për të ecur përpara me ritme akoma më të shpejta. Garanci për këtë është populli ynë, i udhëhequr nga Partia dhe ndihma e miqve tanë.

Shokë dhe shoqe,

Gjatë këtij pesëvjeçari dhe në pesëvjeçarët e ardhshëm një punë shumë e madhe do të bëhet për përparimin dhe për modernizimin e bujqësisë me mjete të fuqishme, duke tharë kënetë, duke hapur kanale vaditëse e kulluese, duke mekanizuar në shkallë të gjerë punimet bujqësore dhe do të merren masa të tjera që do të ndihmojnë shumë për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, për sigurimin e bukës në vend, për shtimin e prodhimit të kulturave industriale, frutave, rrushit, agrumeve, ullinjve etj. Qysh këtë pesëvjeçar dhe në të ardhshmen e mëtejshme një punë e madhe do të bëhet për zhvillimin e përmirësimin e gjendjes së blegtorisë, veçanërisht të deleve dhe të lopës, në mënyrë që në treg të ketë me bollëk mish, qumësht, gjalpë, vezë dhe prodhime të tjera.

Perspektivë e madhe i hapet ekonomisë sonë popullore, sidomos në zhvillimin e industrisë dhe të minierave, veçanërisht me zgjerimin e fushave të naftës. Kërkimet gjeologjike, që po bëhen në vendin tonë, tre-

gojnë se në nëntokën tonë fshihen pasuri të mëdha siç janë nafta, kromi, bakri, hekuri, nikeli e minerale të tjera të vlefshme, zbulimi dhe shfrytëzimi i të cilave do të forcojnë ekonominë e vendit tonë dhe do të rritin vazhdimisht nivelin e jetës së popullit. Por këto perspektiva të shkëlqyera kërkojnë përpjekje të vazhdueshme për përgatitjen e kuadrove të nevojshëm të mesëm e të lartë që do të drejtojnë objektet e reja. Sukses është për vendin tonë përgatitja e një numri kaq të madh kuadrosh pas çlirimit, i arritur në saje të etjes së madhe që ka populli ynë për dituri, për të kapur të renë dhe për të fituar aftësi që t'i shërbejnë lulëzimit të atdheut. Sot ne kemi mundësi të mëdha që të përgatitim kuadro të mesëm e të lartë brenda vendit, ndërsa për ato degë e specialitete që nuk i kemi në vend mund të dërgojmë jashtë. Por kjo punë duhet studjuar e duhet zgjidhur me kujdesin më të madh, me laps në dorë, sepse çështja e kuadrove është një problem i dorës së parë. Por paralelisht me punën për përgatitjen e kuadrove të rinj një detyrë me shumë rëndësi është edukimi i vazhdueshëm teknik i të gjithë kuadrove ekzistues të ekonomisë, kualifikimi i tyre i vazhdueshëm, në mënyrë që maqineritë moderne që kemi e do të kemi, të shfrytëzohen me kapacitet të plotë. Përvetësimi i teknikës dhe i metodave të reja në punë, ngritja e vazhdueshme e rendimentit dhe ulja e kostos, përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe ruajtja e pronës socialiste, janë probleme nga më të rëndësishmet që duhet të na preokupojnë dhe që kërkojnë të zgjidhen sistematikisht nga drejtuesit e ekonomisë sonë dhe nga të gjithë punonjësit e Shqipërisë.

Nuk ka dyshim se këto detyra populli ynë do t'i realizojë me siguri, se atë e udhëheq si kurdoherë drejt fitoreve të reja Partia e tij e lavdishme e Punës, sepse populli ka pushtetin në duart e veta.

Shokë dhe shoqe,

Kuvendi Popullor është organi më i lartë i pushtetit shtetëror të Republikës sonë Popullore, prandaj kuptohet vetëvetiu se sa e rëndësishme është fushata e zgjedhjeve të deputetëve për në këtë organ, sa të interesuara janë masat tona punonjëse për këtë çështje kaq të rëndësishme.

Pjesëmarrja e gjerë e masave punonjëse në çështjet e pushtetit është një nga karakteristikat kryesore të demokracisë sonë socialiste. Te ne të gjithë qytetarët në moshë madhore, pa dallim seksi, kombësie, race ose pozite shoqërore, kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e pushtetit. Sistemi i zgjedhjeve u siguron zgjedhësve jo vetëm të drejtën që votën t'ia japin përfaqësuesit më të mirë, por edhe të drejtën e kontrollit mbi deputetin që kanë zgjedhur dhe, kur ai nuk punon mirë, të kërkojnë heqjen e tij dhe zgjedhjen e një tjetri që punon më mirë.

Pushteti i demokracisë sonë socialiste është pushteti i shumicës dërmuese të popullit. Baza e tij ekonomike është prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit. Të gjitha pasuritë janë pronë e përbashkët e popullit, gjë që zhduk mundësinë e çfarëdo forme shfrytëzimi, lejon vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis punonjësve, garanton lirinë e

fjalës, të mbledhjeve, siguron të drejta të tilla që vetëm i ëndërrojnë punëtorët në vendet kapitaliste. Shumica nga ne të rriturit i kemi të freskëta kujtimet e hidhura të së kaluarës, mungesat e mëdha dhe vuajtjet e punëtorëve e të fshatarëve tanë. Punëtori, përveç që paguhej shumë pak, edhe punë nuk gjente vazhdimisht, kurse shumica dërmuese e fshatarëve të varfër nuk kishin tokë të vetën dhe me mjetet primitive nuk siguronin as bukën e gojës. Shkollat ishin shumë të pakta, kurse në shkollat e larta dërgoheshin vetëm bijtë e pasanikëve pa bërë fjalë këtu për pensione për punëtorët, sigurime shoqërore, shtëpi pushimi dhe shërbimin shëndetësor falas.

Por ato kohë perënduan një herë e përgjithmonë. Kushtetuta e Republikës sonë Popullore u garanton punë të gjithë qytetarëve. Punonjësit tani gëzojnë të drejtën e pushimit të paguar, shërbimet mjekësore dhe arësimin falas, sigurimet shoqërore, pensionet e pleqërisë etj. Populli, me punën e tij, punon dhe ndërton dhe të mirat që rrjedhin nga puna e tij i kthehen përsëri në gjithfarë formash.

Ndryshe është puna në vendet kapitaliste. Atje punonjësit vuajnë sikurse ndodhte te ne në të kaluarën. Ata, duke mos pasur në dorë pushtetin politik, nuk mund të realizojnë në praktikë as ato pak të drejta formale që mund t'u jenë njohur me ligj, duke u vënë lloj-lloj pengesash.

Megjithëse ideologët e rendit kapitalist dhe revisionistët, për t'i zgjatur jetën kapitalizmit, mundohen ta paraqitin këtë me veshje që i ka dalë boja prej kohësh, populli ynë, që ka vuajtur nga regjimet anti-

popullore, e hedh poshtë propagandën e mbrojtësve të kapitalizmit dhe e ruan si gjënë më të shenjtë pushtetin e vet popullor, forcimi i mëtejshëm dhe demokratizimi i të cilit është një detyrë e përhershme e organizatave të Partisë dhe e vetë masave punonjëse.

Por duhet thënë se me gjithë eksperiencën e fituar, në aparatet e pushtetit tonë vërehen akoma një sërë të metash e dobësish. Prandaj, një luftë e vazhdueshme duhet t'i bëhet burokratizmit, shkresave të shumta që disa kujtojnë se vetëm ato i zgjidhin çështjet. Për të zgjidhur shpejt problemet që dalin vazhdimisht përpara duhet shkuar sa më afër popullit, atje ku punonjësit luftojnë dita-ditës me vështirësitë dhe i kapërcejnë ato me këmbëngulje për realizimin e plotë të detyrave. Një nga detyrat më të rëndësishme të pushtetit tonë është edhe forcimi i ligjshmërisë socialiste. Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve tona duhet të jetë kurdoherë në qendrën e vëmendjes së organeve të pushtetit tonë popullor.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Republika Popullore e Shqipërisë, si shtet i pavarur dhe sovran, ka luajtur dhe luan rolin që i përket në arenën ndërkombëtare. Për të parën herë në historinë e tij, populli shqiptar fitoi plotësisht të drejtën të thotë lirisht fjalën e vet në çështjet që preokupojnë tani botën, pavarësisht se ai është i vogël në numër. Erdhën të atilla kohë që zëri i një populli në arenën ndërkombëtare, qoftë ky i vogël ose i madh, nuk mund të mbytet se ashtu dashkan ose nuk dashkan disa fuqi imperialiste

dhe kolonialiste. Këto të drejta dhe këtë prestigj Republikës Popullore të Shqipërisë ia siguroi populli, me luftën e tij heroike, nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Roli i Republikës sonë Popullore në arenën ndërkombëtare është një rol paqeje. Baza e politikës sonë të jashtme është paqja, mbrojtja e saj, lufta e vendosur për një bashkëjetesë paqësore me të gjitha shtetet dhe popujt, në bazë të pesë parimeve të njohura të respektit reciprok të integritetit tokësor dhe sovranitetit, mos-sulmimit, mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, të barazisë dhe përfitimit reciprok. Popujt, qofshin të vegjël ose të mëdhenj, duan dhe luftojnë për një jetë paqësore, por mjerisht akoma nuk e kanë hedhur poshtë të gjithë zgjedhën kapitaliste, burimin e luftërave të përgjakshme.

Sistemi shoqëror ekonomik i një vendi ose grupi vendesh, përcakton edhe karakterin e politikës së tij. Baza e politikës së jashtme të vendeve socialiste është paqja, kurse baza e politikës së jashtme të vendeve imperialiste, që kanë në krye imperializmin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka qenë dhe është lufta. Kjo është një e vërtetë e madhe, e pamohueshme, jo pse e themi dhe e duam ne komunistët, por ky është një ligj objektiv, që rrjedh nga vetë natyra e rendit shoqëror dhe ekonomik që ekziston në këto vende dhe që e ka vërtetuar dhe e vërteton jeta.

Në historinë e tyre popujt janë hedhur në përleshje të përgjakshme nga klikat sunduese që kërkonin të grabitnin pasurinë dhe djersën e popujve, për të forcuar pushtetin e tyre mbi ta. Imperialistët dhe kolonia-



listët kanë spekuluar me gjakun e popujve, me ndjenjat e tyre, kanë sulmuar popuj dhe shtete dhe e kanë ndarë botën sipas dëshirës, në koloni. Mirëpo të gjitha mjerimet dhe luftërat nuk e kanë shuar ndjenjën e lirisë në zemrat e popujve. Kjo bëri që të vijë koha dhe ajo filloi në ditët e Revolucionit të madh të Tetorit, kur popujt e Rusisë u çliruan të parët nga zgjedha kapitaliste dhe themeluan shtetin e parë socialist. Kjo ngjau pas Luftës së parë botërore imperialiste. Në Luftën e dytë botërore, Bashkimi Sovjetik, dërmoi agresorët hitlerianë me aleatët e tij. Në një sërë vendesh të Evropës Juglindore triumfuan idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, populli erdhi në fuqi dhe u zhdukën shkaqet që krijonin shtypjen dhe nxitnin luftërat. Pra, vendet e kampit të socializmit janë për paqen, nuk kanë asnjë arësye të nxitin e të shpërthejnë luftëra, të sulmojnë ushtarakisht vende të tjera, të pushtojnë toka të huaja. Në këtë kamp bën pjesë dhe vendi ynë. Kjo është një fitore e shkëlqyer e popullit shqiptar, që i siguron pavarësinë, sovranitetin, jetën e begatshme dhe paqësore.

Vendet e kampit të socializmit kanë një unitet të çelniktë mendimi dhe veprimi, që buron nga qëllimet e përbashkëta të ndërtimit të socializmit dhe të ruajtjes së paqes, nga idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe nga fryma e internacionalizmit proletar, që udhëheqin e frymëzojnë partitë tona dhe shtetet tona sovranë. Këtë unitet të vendeve tona jo vetëm nuk mund ta kuptojnë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, por ata përpiqen me të gjitha forcat ta shkallmojnë, pse është bërë një kërcënim jashtëzakonisht serioz për veprimet e tyre djallëzore.

Lufta madhështore e kampit të socializmit, në të dy frontet, në atë të mbrojtjes së paqes dhe në atë të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, që do të thotë ngritje e mirëqenies materiale e kulturele të popujve tanë, ka tronditur nga themelet politikën e luftës, të mjerimit dhe të papunësisë të kampit imperialist me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.

Po shkatërrohet përfundimisht regjimi i turpshëm dhe barbar kolonialist. Popujt e shtypur kolonialë po zgjohen dhe fitojnë lirinë, po digjet toka nën këmbët e imperialistëve në Amerikën Latine, Algjeri, Jemen, Oman, Qipro dhe në vetë metropolet e tyre. Ushtria e të papunëve është bërë një gangrenë e tmerrshme për regjimin gjakpirës të monopoleve, ku kriza ekonomike po zhvillohet me ritme shqetësuese, ku grevat kanë shpërthyer me forcë në të gjithë sektorët e ekonomisë, prandaj forcat shtypëse dhe fashiste janë hedhur në sulm, për të shtypur në gjak zemërimin e masave punonjëse kundër kapitalistëve, monopoleve dhe imperializmit amerikan që kërkon t'i hedhë në greminë.

Popujt e mbarë botës e shohin tani fare qartë se për luftën janë të interesuar dhe ëndërrojnë vetëm monopolistët dhe kapitalistët, që u pasuruan në mënyrë të pashembullt gjatë dy luftërave botërore dhe vazhdojnë të pasurohen edhe gjatë garës së sotme të armatimeve. A mund të bëjë efekt propaganda shpifëse imperialiste, kur thotë se veprimet paqësore të vendeve socialiste s'janë tjetër veçse propagandë, kur gjithë popujt shohin se ato dalin me propozime konkrete për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe për vendosjen e

pages në botë? Sigurisht, këto nuk mund të gënjejnë njeri dhe të kenë efekt.

Në një kohë kur imperialistët amerikanë, anglezë dhe francezë, po armatosen dhe ndërtojnë buxhete kolosale lufte dhe me vendimet e fundit të Këshillit të NATO-s vendosën të shtojnë forcat e tyre të armatosura, vendet socialistë, kanë pakësuar në mënyrë të njëanshme forcat e armatosura në 2 477 000 vetë. Disa ditë më parë këto vende vendosën përsëri shkurtimin e efektiveve të tyre ushtarake në 419 000 vetë. Është kjo propagandë apo çarmatim efektiv dhe i njëanshëm? Do të dëshironin shumë popujt që imperialistët amerikanë, anglezë, francezë të bënin edhe ata një propagandë të tillë. Po ata bëjnë të kundërtën.

Në një kohë kur imperialistët amerikanë kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë baza ushtarake në të gjitha vendet e huaja ku sundon kapitali, me qëllim sulmi kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore, Bashkimi Sovjetik, me kërkesën e RP të Kinës, prishi të vetmet baza ushtarake që kishte në Port-Artur e Dalni si dhe atë të Porkkala Ud-it.

Në një kohë kur imperialistët armatosin fashistët gjermanë në Republikën Federale Gjermane dhe mbajnë e shtojnë forcat e tyre të okupacionit, Bashkimi Sovjetik, në mënyrë të njëanshme, tërhoqi trupat e veta nga Austria dhe një pjesë të madhe nga Gjermania Lindore, Polonia, Hungaria dhe tani në fund vendosi të tërheqë të gjitha trupat e tij nga Rumania dhe s'ka asnjë ushtar sovjetik në Çekosllovakia, Shqipëri, Bullgari, Kinë e gjetkë.

Në një kohë kur imperialistët amerikanë dhe anglezë po prodhojnë me shumicë bomba atomike dhe me

hidrogjen, Bashkimi Sovjetik, jo vetëm që ndaloi në mënyrë të njëanshme provat në fjalë, por është i gatshëm të studjohet edhe propozimi amerikan për kontrollin teknik të ndalimit të provave të bombave atomike dhe me hidrogjen.

Bashkimi Sovjetik, në unitet të plotë me vendet e demokracisë popullore, në OKB dhe organet e saj, ka bërë dhe bën propozime të vazhdueshme, për zgjidhjen e problemit të çarmatimit dhe të bashkimit të të dy Gjermanive.

Ai ka propozuar të përfundohet një marrëveshje mossulmimi midis shteteve anëtare të Paktit të Atlantikut dhe të Traktatit të Varshavës, si dhe përfundimin e një pakti të sigurimit midis BRSS dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por, gjithë këto propozime kanë gjetur refuzimin më këmbëngulës dhe në radhë të parë nga imperialistët amerikanë. Të njëjtin fat ka pasur edhe propozimi polak, i njohur me emrin «Plani Rapacki», për krijimin e një zone të lirë nga armët atomike në qendër të Evropës, propozimi sovjetik për krijimin e një zone të paqes në Lindjen e Afërme dhe të Mesme, si dhe propozimi kinez për zonën e paqes në Lindjen e Largme. Imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, në vend që të shkojnë në rrugën e uljes së tensionit ndërkombëtar, zgjerojnë dhe aktivizojnë «luftën e ftohtë» në shkallë të gjerë. Por sigurisht, kjo nuk frikëson, as trondit njeri dhe në radhë të parë kampin e socializmit.

Është e qartë për të gjithë se çështja e çarmatimit dhe ulja e tensionit ndërkombëtar u shkakton humbje imperialistëve në fitimet kolosale që kanë nga shitja e

armëve, punë kjo që shoqërohet edhe me një psikozë të theksuar lufte. Është aq e madhe urrejtja dhe frika e kapitalistëve kundër popujve dhe komunizmit, sa arrijnë deri në atë shkallë që të thonë hapur se duan më mirë zhdukjen e gjysmës së botës me një luftë bërthamore që komuniteti i vogël i «botës së lirë» të mundë pastaj të fillojë përsëri të ndërtojë, se sa të jetojnë «robër të komunizmit».

Po, kundër vullnetit të imperialistëve luftënxitës, lufta për mbrojtjen e paqes, për qafimi i politikës paqësore të vendeve të kampit socialist është zgjeruar shumë dhe ka gjetur përkrahjen nga të gjithë popujt e botës. E vetmja rrugë shpëtimi për njerëzimin nga zgjedha kapitaliste është revolucioni socialist. Poli i vetëm tërheqës i gjithë njerëzimit përparimtar dhe shpresa e tij e çlirimit është socializmi. Është për këtë arsye që në kohët tona, shtete që nuk bëjnë pjesë në kampin socialist, që as e simpatizojnë komunizmin, duke parë kërcënimin e madh të imperializmit amerikan, e mbështetin dhe janë solidarë me politikën e vendeve socialiste.

Ne jetojmë sot në një kohë kur vihet re një fenomen shumë pozitiv për të ardhshmen e njerëzimit. Shumë shtete të Azisë, Afrikës dhe të kontinenteve të tjera, jo vetëm që qëndrojnë jashtë bloqeve ushtarake por hedhin poshtë me neveritje edhe propozimet e Shteteve të Bashkuara për t'i futur në bloqet e tyre agresive. Kjo tregon qartë drejtësinë e politikës leniniste të bashkekzistencës dhe demaskon çdo ditë e më shumë egërsinë e kapitalizmit, armik i betuar i miqësisë dhe i vëllazërimit të popujve. Në këtë drejtim imperializmi ka pësuar një disfatë të tmerrshme. Brenda

vetë gjirit të vendeve që bëjnë pjesë në paktet agresive ekzistojnë dhe thellohen vazhdimisht kontradikta dhe grindje në mes imperializmit amerikan, nga njëra anë, dhe partnerëve të tij më të dobët, nga ana tjetër. Uniteti i fasadës që ata përpiqen të trumbetojnë, tregon të çara të mëdha, që janë pasojë e grindjeve brigandeske në mes monopoleve dhe sidomos e presionit dhe e luftës së masave punonjëse që ata përpiqen t'i shtypin e t'i shfrytëzojnë.

Raporti i forcave në arenën ndërkombëtare sot anon nga forcat e socializmit, ndërsa politika agresive luftënxitëse e imperializmit amerikan po demaskohet dhe pëson disfata. Thirrja për një mbledhje të nivelit të lartë, e bërë nga Bashkimi Sovjetik për uljen e tensionit ndërkombëtar, ka gjetur një jehonë të madhe në botë dhe imperialistët përpiqen më kot të nxjerrin një sërë pengesash. Ata më në fund do të jenë të detyruar të bisedojnë. Forcës paqësore krijuese të vendeve të kampit socialist nuk mund t'i rezistojë asnjë dredhi e imperialistëve. Sistemi socialist po tregon epërsinë e vet mbi sistemin e kalbur kapitalist në të gjitha fushat. Bashkimi Sovjetik ka bërë përparime të tilla kolosale sa që në vitin 1958 çelik dhe metale të petëzuara do të prodhojë aq sa ka qenë prodhimi i 17 vjetëve të para të pushtetit sovjetik. Tani Bashkimi Sovjetik është në gjendje të prodhojë në një vit artikuj industrialë aq sa përpara i duhej t'i prodhonte në 15-20 vjet. Vetëm në dy vjetët e fundit vëllimi i investimeve kapitale në ekonominë kombëtare ka arritur në 400 miliard rubla. Vendet kapitaliste të Evropës prej kohësh janë lënë shumë prapa nga përparimet kolosale të

Bashkimit Sovjetik. Edhe bujqësia sovjetike po zhvillohet me ritme shumë të shpejta dhe së shpejti do të plotësohet detyra e madhe e tejkalimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në qumësht, gjalpë e mish për frymë të popullsisë.

Realizimet e mrekullueshme të Bashkimit Sovjetik në lëmin e shkencës tani i njejnë gjithë bota. Bashkimi Sovjetik shpiku i pari raketën balistike ndërkontinentale, aeroplanët turboreaktivë më modernë e më të perfeksionuarit dhe hodhi në det të parën anije akullthyesë atomike. Ai hodhi sputnikët e parë të famshëm të tokës dhe tani së fundi sputnikun e madh prej 1 327 kg. Bashkimi Sovjetik po e përdor në shkallë të gjerë energjinë atomike për qëllime paqësore, atje po merren inisiativa të guximshme për zbulime dhe shpikje të mrekullueshme, krijohen mundësi të pakufishme për zhvillimin e arësimit, kulturës, shkencës etj. Të gjitha këto bëhen për lulëzimin e jetës së njerëzve, dhe jo vetëm të Bashkimit Sovjetik, por edhe të vendeve të demokracisë popullore. Sukseset e Bashkimit Sovjetik janë edhe suksese të të gjithë njerëzimit përparimtar.

Në vendet e demokracisë popullore bëhet i njëjti proces i zhvillimit me ritme të shpejta të ekonomisë. Kina e madhe po ecën me hapa viganë në zhvillimin e industrisë së saj të fuqishme të rëndë, atje sot po ndërtohen kombinatë metalurgjike kolosale, prodhohen maqina të fuqishme nga më të ndërlikuarat dhe modernet, traktorë, aviona dhe automobila, atje ka mbaruar kolektivizimi i bujqësisë dhe jeta e popullit heroik vëlla kinez po lulëzon nga çdo pikëpamje. Republika Popullore e Kinës, një nga fuqitë e mëdha të botës

është bërë jo vetëm një shembull i shkëlqyer për të gjithë botën aziatike, por edhe ndihmëse e fuqishme e çlirimit të popujve të atij kontinenti dhe të kontinentit afrikan. E njëjta gjë ngjet në Republikën Popullore të Çekoslovakisë. Bullgaria, Rumania, Republika Demokratike Gjermane, Hungaria, Polonia, Republika Demokratike Popullore e Koresë, Mongolia dhe Republika Demokratike e Vietnamit, po lulëzojnë çdo ditë e më shumë, po zhvillojnë me ritme të shpejta si asnjëherë ekonominë popullore, shkencën, artin dhe kulturën për mirëqenien e popujve.

Vendet tanë vëllezër ecin krah për krah njëri-tjetrit në rrugën që na kanë ndriçuar Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Është një fat i madh për popullin shqiptar që nxori nga gjiri i tij Partinë e lavdishme të Punës, e cila e udhëhoqi në rrugën e Luftës heroike nacional-çlirimtare, i dha fitoren, lirinë, i siguroi miq kaq të shtrenjtë e besnikë dhe e udhëheq në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Republika Popullore e Shqipërisë, si vend socialist dhe pjesëtar i kampit të socializmit, që ka në krye Bashkimin Sovjetik, ka qenë dhe do të jetë kurdoherë plotësisht solidare me politikën dhe me veprimtarinë e kampit tonë në të gjitha fushat, pse ato janë për paqen, lirinë, sovranitetin, socializmin dhe komunizmin. Partia e Punës dhe qeveria jonë kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë plotësisht dakord me të gjitha iniciativat dhe qëndrimet e urta të Bashkimit Sovjetik në lëmin e politikës së jashtme, pse kjo është politika leniniste paqësore, kundër luftës dhe për bashkëjetesën paqësore në mes të dy sistemeve.



Një miqësi gjithnjë e më e ngushtë po kalitet midis popullit tonë dhe Kinës së madhe e vendeve të tjerë vëllezër të demokracisë popullore. Populli ynë, pjesëtari më i vogël i familjes së madhe të socializmit, është krenar dhe ushqen një dashuri vëllazërore për miq të tillë të dashur e të shtrenjtë siç janë populli i madh kinez dhe popujt e Bullgarisë, Çekoslovakisë, Republikës Demokratike Gjermane, Hungarisë, Republikës Demokratike Popullore të Koresë, Mongolisë, Polonisë, Rumanisë dhe Republikës Demokratike të Vietnamit. Kjo miqësi dhe uniteti i çelniktë i vendeve tona e kanë burimin në parimet e lavdishme të marksizëm-leninizmit, në internacionalizmin proletar dhe në fitoren historike botërore të Revolucionit të madh të Tetorit. Garancia e këtij uniteti të çelniktë dhe e miqësisë së popujve tanë janë partitë tona marksiste-leniniste. Vendet tona, pa marrë parasysh numrin e popullsisë, janë plotësisht të barabarta midis tyre, eksperiencia e njërit bëhet pronë e përbashkët, sukseset e secilit janë një kontribut i vlefshëm në forcimin e kampit tonë të fuqishëm të socializmit. Fitorja e sistemit popullor në vendet tona, bashkëpunimi dhe ndihma reciproke vëllazërore, barazia e të drejtave, mbrojtja e pavarësisë kombëtare dhe e fitoreve revolucionare në secilin vend dhe në të gjitha vendet socialiste, lufta e vendosur për paqe dhe socializëm, ja baza e pathyeshme e miqësisë së çelniktë që bashkon popujt tanë vëllezër. Populli ynë gëzohet dhe kënaqet për miqtë e tij kaq të sinqertë, me të cilët ecën krah për krah për realizimin e qëllimeve fisnike të përbashkëta. Nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës ai edhe në të

ardhshmen do të punojë pa u lodhur për kalitjen e miqësisë me popujt e vendeve vëllezër të demokracisë popullore, nën flamurin e internacionalizmit proletar, i mbështetur si kurdoherë mbi parimet marksiste-leniniste.

Deklarata e përbashkët e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste që u bë në Moskë nëntorin e kaluar, ishte një shprehje e fortë e kompaktësisë së vendeve të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye, shprehje e unitetit të çelniktë të të gjitha partive motra të vendeve tona për të ecur krahas krahas përpara, në mbrojtje të fitoreve historike në ndërtimin e socializmit, të pastërtisë së ideologjisë sonë të lavdishme, marksizëm-leninizmit dhe të paqes në botë. Populli dhe Partia jonë e aprovuan njëzëri Deklaratën e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste, si dhe Manifestin historik të paqes të të gjitha partive komuniste e punëtore.

Në kohën e sotme, kur imperialistët po vënë në rrezik paqen botërore, popujt duhet të forcojnë bashkëpunimin e tyre për të mbrojtur paqen dhe të shtojnë vigjilencën kundër intrigave dhe planeve luftënxitëse të imperialistëve e veglave të tyre, t'i zbulojnë e t'i demaskojnë me forcë planet e tyre agresive.

Që të realizojnë planet e tyre për përgatitjen e një lufte të re imperialistët janë orvatur vazhdimisht të përçajnë unitetin e vendeve socialiste, për t'i ndarë këto nga shteti më i fuqishëm socialist, Bashkimi Sovjetik, për t'i shpartalluar pastaj një nga një. Për të arri-

tur qëllimet e tyre ata sulmin e drejtojnë në radhë të parë kundër Bashkimit Sovjetik.

Po çojnë ujë në mullirin e imperialistëve edhe revizionistët e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, të cilët kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin dhe përpiqen të përçajnë vendet që bëjnë pjesë në kampin e socializmit. Udhëheqësit revizionistë jugosllavë nga njëra anë shpifin në mënyrë të ulët për marrëdhëniet midis vendeve socialiste, kur ato janë në baza marksiste-leniniste, vëllazërore e internacionaliste dhe, nga ana tjetër, ata u thurin lavdi marrëdhënieve «të barabarta» të Jugosllavisë me shtetin më agresiv imperialist, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto qëndrime janë antimarksiste, antisocialiste, antiproletare.

Pikëpamjet antimarksiste-revizioniste të udhëheqësve jugosllavë, nuk mund të gënjejnë asnjëri. Çdo njeri i ndershëm e ka për detyrë t'i dënojë dhe t'i luftojë pa mëshirë, sepse ato e pengojnë dhe e dobësojnë luftën tonë për ndërtimin e socializmit, unitetin e pathyeshëm të vendeve të kampit të socializmit. Më kot udhëheqësit revizionistë jugosllavë mundohen ta çarmatosin klasën punëtore ndërkombëtare duke u përpjekur ta zhveshin marksizmin nga pjesët e tija më esenciale, ta lënë pa shtabin e saj udhëheqës, pa partitë marksiste-leniniste dhe atje ku klasa punëtore është në fuqi, pa diktaturën e proletariatit. Të tilla pikëpamje nuk mund të vënë njeri në gjumë, megjithëse ato sot po ngrihen në qiell nga të gjithë armiqtë e betuar të socializmit dhe të komunizmit.

Të gjitha partitë marksiste-leniniste në konferencën e Moskës e cilësuan revizionizmin e sotëm, si rre-

zikun kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare që paralizon energjinë e saj revolucionare. Edhe Partia jonë, që ka dënuar kurdoherë çdo shmangie nga marksizëm-leninizmi, do të ecë me vendosmëri edhe në të ardhshmen në rrugën e lavdishme për mbrojtjen e partitërisë së ideologjisë sonë. Ajo do të punojë pa u lodhur në frymën e Deklaratës historike të Moskës të partive komuniste dhe punëtoare.

Vendi ynë, si deri tani, do të ndjekë pa u lodhur politikën e tij paqësore. Politika e shtetit dhe e Partisë sonë ndaj Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë dhe partisë së saj, ka qenë kurdoherë e drejtë dhe e bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit. Kjo politikë ka synuar dhe do të synojë në marrëdhënie fqinjësie të mirë në bazë të pesë parimeve të njohura të bashkekzistencës paqësore.

Më parë ne kemi pasur edhe marrëdhënie partie, që degjeneruan në një punë antimarksiste, në një politikë nacionaliste borgjeze shoviniste dhe jomiqësore nga ana e udhëheqjes së ish-Partisë Komuniste Jugosllave, tani Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. Njihen plotësisht lufta e vendosur heroike e Partisë dhe e popullit tonë kundër asaj veprimtarie djallëzore dhe asgjësimi i plotë i punës armiqësore kundër Partisë sonë. Në dritën e këtyre veprimeve të faktuara dhe të shumë veprimeve të tjera të mëvonshme, Partia jonë kishte plotësisht arësye ta aprovonte, ta konsideronte e ta konsiderojë plotësisht edhe sot të drejtë kritikën parimore, marksiste-leniniste që i bëri Byroja Informativ Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1948. Jeta tregoi se Partia jonë kishte të drejtë.

Partia jonë ishte një nga ato Parti që, megjithëse kishte vuajtur më tepër se çdo parti tjetër nga veprimtaria e revizionistëve jugosllavë, deklaroi sinqerisht se ishte gati të përmirësonte marrëdhëniet me Jugosllavinë në bazë të marksizëm-leninizmit. Ju jeni në dijeni të të gjitha përpjekjeve dashamirëse të Partisë dhe të qeverisë sonë, qoftë në lëmin tregëtar, qoftë në marrëdhëniet kulturalo-artistike të bëra nga ana jonë në drejtim të Jugosllavisë. Udhëheqja jugosllave, jo vetëm që bëri vazhdimisht veshin e shurdhër, jo vetëm që vazhdoi me të gjitha mënyrat sulmet ndaj vendit, Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj, por u përpoq me çdo mjet të na gjunjëzonte. Natyrisht, ajo kishte gabuar adresën, se kjo praktikë s'ka qenë kurrë zakon i popullit shqiptar gjatë gjithë historisë së tij dhe as i Partisë së tij e i anëtarëve të saj që kanë dalë nga gjiri i këtij populli dhe që janë mburrur me teorinë e marksizëm-leninizmit. Kërcënimet e udhëheqjes jugosllave ndaj Partisë sonë, natyrisht, i mori era. Partia jonë qëndroi e fortë si graniti në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, në mbrojtjen e atdheut, në mbrojtjen e kampit të socializmit.

Fjalimi i Josif Broz Titos në Pula, jo vetëm që mbrojti kundërrevolucionin në Hungari, mbrojti haptas tradhëtarin e popullit hungarez dhe të komunizmit, Imre Nagin dhe bandat e tija, por sulmoi dhe paralajmëroi edhe sulme të tjera kundër marksizëm-leninizmit dhe kampit të socializmit, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore e veçanërisht kundër vendit dhe Partisë sonë. Këto sulme arritën kulmin në Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugoslla-

visë. Dhe kjo ngjau, siç dihet mirë prej të gjithëve, pas takimit të Bukureshtit, kur edhe një herë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, partitë komuniste e punëtore dhe Partia jonë u përpoqën sinqerisht të merreshin vesh në rrugën marksiste-leniniste dhe të zhduknin mosmarrëveshjet. Po me kë të merreshe vesh? Udhëheqja e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë me projektprogramin e vet dhe me Kongresin VII e tregoi përfundimisht që është në rrugë të plotë antimarksiste, revizioniste. Ata vetë u afirmuan si udhëheqësit më të vendosur të revizionizmit modern.

Partia jonë mendon se me revizionizmin dhe revizionistët nuk mund të ketë pajtim kurrë. Revizionizmi duhet demaskuar dhe duhet luftuar pa mëshirë. Kjo është abc-ja e marksizmit. Lenini i pavdekshëm dhe i lavdishëm na mëson se revizionizmin duhet ta urresh dhe ta luftosh. Këtë bën Partia jonë dhe për këtë jemi të bindur plotësisht se jemi në rrugë të drejtë.

Por mos do të thotë kjo që, meqë revizionizmi modern u shfaq në një mënyrë të tillë në Jugosllavi, kjo duhet të shpjerë në keqësimin e marrëdhënieve miqësore me popujt e Jugosllavisë në radhë të parë dhe në keqësimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me shtetin jugosllav?

Ne për çështjen e parë mendojmë se me popujt vëllezër të Jugosllavisë kemi qenë dhe do të mbetemi miq, se tok kemi luftuar e kemi derdhur gjak, i kemi lidhur plagët shoqi-shoqit në luftën e madhe antifashiste, kur rrezikohej jeta e popujve dhe luhej me fatin e lirisë e të pavarësisë së popujve dhe të vendeve tona.

Ne do ta ruajmë dhe do ta zhvillojmë miqësinë me popujt e Jugosllavisë me gjithë vështirësitë dhe pengesat që janë krijuar. Ne me popujt e Jugosllavisë kurrë nuk do të armiqësohemi, por do të mbetemi vëllezër.

Përsa i përket pikës së dytë, mendojmë se marrëdhëniet në rrugën shtetërore duhet të zhvillohen normalisht, në bazë të fqinjësisë së mirë, të mosndërhyrjes në punët e njëri-tjetrit, në përfitimet reciproke dhe në frymën e barazisë. Ne mendojmë se kjo është në interesin e të dy popujve e të dy vendeve. Nga ana jonë, nuk do të ketë asnjë pengesë në këtë drejtim në frymën që përmendëm më lart. Por grupi revizionist jugosllav kundërshtimet e papajtueshme ideologjike që ne kemi me të kërkon t'i spostojë e t'i shtrijë edhe në marrëdhëniet vëllazërore në mes të popujve tanë dhe arrin sa të deklarojë sikur ne me këto kundërshtime duam të fyejmë popullin jugosllav. Kjo është një shpifje pa baza. Kjo nuk na ka shkuar dhe nuk do të na shkojë kurrë ndërmend. Kundërshtimet tona me udhëheqësit jugosllavë kanë qenë dhe mbeten parimore dhe të papajtueshme. Miqësia dhe dashuria me popujt e Jugosllavisë janë për ne gjithashtu çështje parimore që ne i kemi mbrojtur dhe do t'i mbrojmë.

Vendi ynë ka bërë dhe vazhdon të bëjë përpjekje për normalizimin e marrëdhënieve me fqinjën tjetër tonën, Greqinë. Është në interesin e përbashkët të të dy vendeve dhe të ruajtjes së paqes në Ballkan që marrëdhëniet tona të ecin përpara dhe të vendosen lidhje të rregullta diplomatike dhe të fqinjësisë së mirë. Në lidhje me Greqinë ne shohim një zbutje në marrëdhë-

niet në mes të dy vendeve tona dhe jemi të dispozuar, në bazë të pesë parimeve të njohura prej të gjithëve, të zhvillojmë marrëdhëniet dhe miqësinë në mes të dy vendeve, të zhvillojmë sidomos tregëtinë që mund të jetë me shumë interes për të dy palët. Ne jemi të gatshëm në këtë drejtim, sepse populli ynë ushqen simpati për popullin fqinj grek dhe dëshiron të ketë me të marrëdhënie miqësie.

Marrëdhëniet e vendit tonë me Republikën Italiane, sidomos pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes për zbatimin e Traktatit të Paqes, janë duke u zgjeruar. Republika jonë do të punojë që këto marrëdhënie në të ardhshmen të zhvillohen akoma më shumë, sepse mjaft mundësi ka në këtë drejtim, sidomos në fushën ekonomike, ku palët tona mund të nxirrnin përfitime reciproke.

Ne dëshirojmë gjithashtu të forcojmë marrëdhëniet edhe me Republikën Franceze. Zhvillimi i lidhjeve tregëtare, kulturele etj. me Francën do t'i shërbente forcimit të miqësisë së popujve tanë dhe forcimit të paqes. Ne me admirim e shikojmë luftën heroike të Partisë Komuniste Franceze dhe të popullit të Francës për t'i prerë rrugën fashizmit në Francë.

Me simpati të veçantë i ndjekin populli dhe Partia jonë përpjekjet e vendosura të popujve të Republikës Arabe të Bashkuar për ruajtjen dhe për forcimin e pavarësisë së fituar dhe përkrahin luftën heroike të patriotëve të Algjerisë, Omanit, Libanit dhe vendeve të tjera kundër kolonizatorëve gjakpirës për lirinë dhe për pavarësinë kombëtare. Populli shqiptar është i lidhur me një miqësi të vjetër me popujt vëllezër arabë, por



tani, kur në botë janë bërë ndryshime të mëdha, janë krijuar kushte që midis vendit tonë dhe vendeve arabe të zhvillohen dhe të forcohen marrëdhënie të tilla në bazë të parimeve të mirënjohura të bashkëjetesës paqësore.

Themelimi kohët e fundit i Shoqatës së miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe është një ngjarje e rëndësishme politike që do të kontribuojë së tepërmi në forcimin akoma më shumë të miqësisë midis vendeve tona. Kohët e fundit, me vizitat reciproke të delegacioneve, popujt tanë kanë filluar ta njohin më nga afër njëri-tjetrin. Shkëmbimi i më shumë delegacioneve në të ardhshmen do të kontribuojë së tepërmi në forcimin e vazhdueshëm të miqësisë dhe të bashkëpunimit në mes të vendeve tona në fushën tregëtare, kulturele etj.

Popujt arabë, te populli shqiptar, do të kenë kurdoherë një mik të sigurtë e besnik. Popujt vëllezër arabë mund të shikojnë në Shqipërinë e re se si një popull i vogël, që ka aq shumë gjëra të përbashkëta me ta, ka hyrë në rrugën e socializmit dhe duke gëzuar përkrahjen bujare, vëllazërore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjerë vëllezër të kampit socialist, jo vetëm ka garantuar lirinë dhe pavarësinë kombëtare, por ka siguruar edhe një zhvillim të vrullshëm ekonomik e kultural. Populli ynë është i bindur se të gjithë popujt arabë do ta fitojnë lirinë dhe pavarësinë e tyre kombëtare, do ta zhdukin sundimin e urryer imperialist dhe do të vihen në rrugën e begatisë e të përparimit. Në këto përpjekje fisnike ata do të gëzojnë kurdoherë simpatinë dhe solidaritetin e popullit tonë.

Politika e jashtme e ndjekur vazhdimisht nga Re-

publika Popullore e Shqipërisë, vërtetohet se me ç'forcë lufton ajo për ruajtjen e paqes, se si zbaton me besnikëri parimin e bashkëjetesës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore. Si rrjedhim i kësaj politike është rritur prestigji ndërkombëtar i vendit tonë që sot ka marrëdhënie të rregullta diplomatike me shumë shtete në Evropë, Azi dhe Afrikë. Gjatë vitit të kaluar janë forcuar e zgjeruar si asnjëherë marrëdhëniet e vendit tonë me botën e jashtme. Vjet në Shqipëri kanë ardhur e kanë dalë me dhjetëra delegacione parlamentare etj., përfaqësues të shkencës, artit, kulturës, arësimit, sportit, shtypit etj., si dhe shumë turistë. Gjatë këtij viti këto marrëdhënie do të zgjerohen akoma më tepër. Ne duam të jetojmë në paqe dhe të kemi marrëdhënie të mira me të gjithë popujt e botës, prandaj nuk do të kursejmë forcat për forcimin dhe sigurimin e paqes, miqësisë dhe të bashkëpunimit midis popujve.

Shokë dhe shoqe, sukseset e shkëlqyera të popullit tonë, të tanishmet dhe ato të ardhshmet, i detyrohen drejtësisë së vijës së Partisë sonë të lavdishme, besnikërisë ndaj ideologjisë sonë fitimtare, marksizëm-leninizmit, luftës së saj të vendosur kundër revizionizmit dhe oportunitizmit si dhe eksperiencës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë, që në fillim të jetës së saj, e ka udhëhequr kurdoherë popullin në rrugë të drejtë. Ajo, në çastet më të vështira, e mobilizoi dhe e drejtoi atë në Luftën nacional-çlirimtare, e mësoi atë të dallojë mirë armiqtë dhe të gjithë ata që, me anë të demagogjisë dhe të mashtrimit, kërkonin ta gënjenin dhe ta futnin edhe një herë në kurth, ashtu siç

kishin bërë kurdoherë. Partia, që në fillim, i tregoi popullit tonë të shikonte nga Moska, sepse andej do t'i vinte çlirimi dhe e ardhshmja e lumtur dhe kur, në saje të luftës së tij heroike dhe të fitores legjendare të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, populli ynë u çlirua përgjithmonë dhe mori për herë të parë pushtetin në duart e veta, Partia e udhëhoqi atë në rrugën e lavdishme të ndërtimit të socializmit. Rruga që ka bërë populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, është një rrugë plot fitore të shkëlqyera për popullin dhe disfata të njëpasnjëshme për armiqtë tanë. Prandaj, me plot të drejtë populli thotë se Partia e Punës është organizatorja, frymëzuesja dhe udhëheqësja e të gjitha fitoreve të tija. Partia është siguria e lirisë, e pavarësisë dhe e sovranitetit të atdheut, ajo është garancia e demokracisë së vërtetë për masat e gjera punonjëse dhe grusht i rëndë për të gjithë armiqtë e popullit tonë.

Që në kohën e luftës Partia e Punës e Shqipërisë farkëtoi unitetin e çelniktë të popullit tonë në Frontin Nacional-Çlirimtar, tani Fronti Demokratik. Ajo u bë frymëzuesja dhe udhëheqësja e lavdishme e Bashkimeve Profesionale, e Bashkimit të Rinisë së Punës, e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Partitë e popull sot janë të lidhur ngushtë më shumë se kurdoherë tjetër, sepse populli ynë trim, i zgjuar e punëtor e di mirë se pa Partinë e tij të dashur nuk mund të kishte mposhtur armiqtë e tij të betuar dhe të ndërtonte jetën e re.

Politikës së urtë të Partisë sonë i detyrohet forci mi i unitetit të popullit, edukimi politik dhe ideologjik i tij, ngritja e patriotizmit dhe e entuziazmit të madh

të masave, forcimi dhe zhvillimi i traditave dhe i zakoneve të mira dhe luftimi i atyre të këqia, respektimi i ndjenjave të popullit, edukimi i njerëzve të hutuar dhe të çoroditur nga situatat e turbullta të së kaluarës.

Ishte Partia jonë ajo që vuri në vend dhe nxori si duhet në dritë të kaluarën e lavdishme të popullit, luftën e patriotëve tanë të mëdhenj, që vuri në vend vlerat e njerëzve dhe i lidhi këta më shumë me atdheun, me punën krijuese. Partia i përkrahu dhe u dha dorën të gjithë njerëzve që mund të bënin diçka në të mirën e atdheut dhe të popullit. Ajo asnjëherë nuk e humbi durimin me njerëzit kokëfortë dhe më në fund i bindi e i edukoi ata duke i bërë të vlefshëm për shoqërinë.

Në saje të politikës së urtë të Partisë, në radhët e popullit tonë sot mbretëron gëzimi, harmonia, vëllazërimi, qetësia, siguria për të ardhshmen e lumtur. Në vendin tonë zien puna ndërtimtare, krijuese, solidariteti dhe besimi i plotë se nga viti në vit jeta e popullit bëhet gjithnjë më e mirë. Njerëzit e vendit tonë, kudo që punojnë, e ndejnë veten solidarë me njëri-tjetrin për veprën e madhe të përbashkët, lulëzimin dhe përparimin e vrullshëm të atdheut tonë dhe i këndojnë hymne Partisë, zemrës së çelniktë të tyre. Sot, në saje të Partisë, çdo njeri e ndjen forcën krijuese të kolektivit, e ndjen se bashkimi dhe shumica sjellin forcën dhe mirëqenien dhe se në çështjen e përbashkët secili jep kontributin e vet me diturinë, zotësinë dhe forcën e tij për të mirën e përgjithshme dhe për të mirën personale e të familjes së tij.

Partia jonë karakterizohet nga një unitet i çelniktë dhe s'ka pasur e s'do të ketë forcë në botë që ta dëm-

tojë sado pak këtë unitet. Partia është e lidhur si mishi me koskën me popullin e vet dhe besnike deri në fund e interesave të larta të tij. Partia e populli te ne janë një dhe të lidhur përjetë. Çdo armik, nën çdo maskë që të fshihet, do të thyejë kokën përpara forcës, unitetit, vigjilencës së Partisë dhe të popullit.

Partia jonë gëzon sot besimin e plotë të popullit, sepse ajo punon dhe do të punojë me të gjitha forcat për begatinë dhe lumturinë e tij, për lulëzimin dhe përparimin e atdheut tonë socialist, për mbrojtjen dhe zhvillimin e të gjitha fitoreve të tija. Prandaj, populli ynë e do me gjithë shpirt Partinë e vet, e ruan atë si gjënë më të shtrenjtë dhe ka besim të pakufishëm ndaj saj, sepse ajo është gjithshka për të, jeta e tij, liria, pavarësia e atdheut, e ardhshmja e lumtur, socializmi dhe komunizmi.

Populli ynë, që e do si veten Partinë e tij, zbaton me këmbëngulje mësimet dhe direktivat e Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror leninist dhe shqelmon me përbuzje çdo propagandë të armiqve të brendshëm e të jashtëm, të imperialistëve e revizionistëve që luftojnë ta denigrojnë rolin udhëheqës të Partisë sonë.

Me një besim të madh te Partia e Punës, me një unitet të çelniktë rreth Partisë së tij heroike, do të shkojnë të votojnë njerëzit e Shqipërisë së re për atdheun e dashur, për Shqipërinë e lulëzuar, për të ardhshmen e begatshme, për bollëkun, për paqen, socializmin dhe komunizmin ku i udhëheq Partia e tyre e dashur e Punës.

Më 1 qershor, i gjithë populli ynë, si një trup i

vetëm, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, do të tregojë edhe një herë bashkimin e tij të çelniktë rreth Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe do të votojë qind për qind për kandidatët e Frontit, për fitoret e tija të shkëlqyera, për të ardhshmen e tij të lumtur, për socializmin. Votimet do të vërtetojnë edhe një herë në mënyrë të shkëlqyer drejtësinë e rrugës sonë të lavdishme drejt socializmit.

Rroftë populli shqiptar!

Të rrojë dhe të lulëzojë Republika jonë Popullore!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë, frymëzuesja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Rroftë uniteti i çelniktë i familjes së madhe socialiste, me Bashkimin Sovjetik në krye!

Rroftë paqja në të gjithë botën!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 128 (3029), 30 maj 1958*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## FJALA E PËRSHËNDETJES NË KONGRESIN VII TË PK TË BULLGARISË

3 qershor 1958

Të dashur shokë,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Komitetit Qendror të saj, në emër të të gjithë popullit shqiptar, ju sjell përshëndetjet juve, përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Bullgarisë, e nëpërmjet jush të gjithë popullit vëlla bullgar dhe ju uroj, me gjithë zemër, punë të mbarë e të frutshme, për suksese gjithnjë më të mëdha në luftën për ndërtimin e socializmit, për përparimin dhe begatinë e Bullgarisë motër.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe i gjithë populli shqiptar, kanë ndjekur dhe ndjekin me admirim dhe gëzim të veçantë zhvillimin e përparimin e vrullshëm të popullit vëlla bullgar, sukseset dhe realizimet tuaja të mëdha, që ia kanë ndërruar pamjen Bullgarisë, e kanë bërë atë një vend me një industri të zhvilluar, me bujqësi të përparuar dhe me një kulturë të lartë socialiste. Ne përshëndesim rezultatet e punës heroike të punonjësve të talentuar bullgarë, që realizuan para afatit detyrat e planit të dytë pesëvjeçar, që e rriti prodhimin e përgjithshëm industrial mbi 7 herë më shumë se para

vetëm, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, do të tregojë edhe një herë bashkimin e tij të çelniktë rreth Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe do të votojë qind për qind për kandidatët e Frontit, për fitoret e tija të shkëlqyera, për të ardhshmen e tij të lumtur, për socializmin. Votimet do të vërtetojnë edhe një herë në mënyrë të shkëlqyer drejtësinë e rrugës sonë të lavdishme drejt socializmit.

Rroftë populli shqiptar!

Të rrojë dhe të lulëzojë Republika jonë Popullore!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë, frymëzuesja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Rroftë uniteti i çelniktë i familjes së madhe socialiste, me Bashkimin Sovjetik në krye!

Rroftë paqja në të gjithë botën!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 128 (3029), 30 maj 1958*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## FJALA E PËRSHËNDETJES NË KONGRESIN VII TË PK TË BULLGARISË

3 qershor 1958

Të dashur shokë,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Komitetit Qendror të saj, në emër të të gjithë popullit shqiptar, ju sjell përshëndetjet juve, përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Bullgarisë, e nëpërmjet jush të gjithë popullit vëlla bullgar dhe ju uroj, me gjithë zemër, punë të mbarë e të frutshme, për suksese gjithnjë më të mëdha në luftën për ndërtimin e socializmit, për përparimin dhe begatinë e Bullgarisë motër.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe i gjithë populli shqiptar, kanë ndjekur dhe ndjekin me admirim dhe gëzim të veçantë zhvillimin e përparimin e vrullshëm të popullit vëlla bullgar, sukseset dhe realizimet tuaja të mëdha, që ia kanë ndërruar pamjen Bullgarisë, e kanë bërë atë një vend me një industri të zhvilluar, me bujqësi të përparuar dhe me një kulturë të lartë socialiste. Ne përshëndesim rezultatet e punës heroike të punonjësve të talentuar bullgarë, që realizuan para afatit detyrat e planit të dytë pesëvjeçar, që e rriti prodhimin e përgjithshëm industrial mbi 7 herë më shumë se para

luftës. Ne përshëndesim fitoren e shkëlqyer të transformimit socialist të fshatit, ku më se 90 për qind e tokave të punueshme janë kolektivizuar. Punonjësit dhe komunistët shqiptarë, si vëllezërit dhe miqtë tuaj të vërtetë, gëzohen pa masë për fitoret tuaja të mëdha.

Kështu si te ju, edhe në Shqipëri, punohet me entuziazëm për ndërtimin e socializmit, për ta bërë jetën e njerëzve më të mirë. Shqipëria, dikur e prapambetur, është kthyer tani në një vend agraro-industrial me një industri që prodhon 14,6 herë më shumë se para luftës. Bujqësia jonë po mekanizohet dhe po transformohet në një bujqësi të përparuar socialiste si rezultat i kolektivizimit, i cili qysh tani përfshin mbi 70 për qind të sipërfaqes së tokave të punueshme. Në vendin ku më parë 80 për qind e popullsisë ishte analfabete, tani po zhvillohet me shpejtësi arësimi e kultura dhe në çdo 5 qytetarë njëri mëson në shkollë ose kurs. Shtesat që iu bënë planit të dytë pesëvjeçar dhe plani perspektiv 15-vjeçar që ne kemi përgatitur, i hapin popullit shqiptar perspektiva të mëdha për zhvillimin e industrisë, sidomos të industrisë së naftës, të elektrifikimit, të rritjes së hovshme të prodhimit bujqësor, të frutikulturës, blegtorisë etj.

Socializmi dhe miqësia me Bashkimin Sovjetik e vendet e tjerë vëllezër të demokracisë popullore mundën ta nxirrnin Shqipërinë nga gjendja ku e kishin lënë pushtuesit e huaj dhe feudoborgjezia e vendit. Për këtë populli shqiptar është i ndërgjegjshëm dhe prandaj ai i ka qëndruar dhe do t'i qëndrojë kurdoherë besnik socializmit e internacionalizmit proletar. Këtë e provuan edhe një herë zgjedhjet për në Kuvendin Popullor të

Republikës Popullore të Shqipërisë që u bënë pardje në vendin tonë, ku 99,98 për qind e zgjedhësve morën pjesë në votimet dhe 99,97 për qind votuan për kandidatët e Frontit Demokratik, d.m.th. vetëm 261 vetë votuan kundër. Nuk ka dhe nuk do të ketë forcë që ta largojë popullin tonë nga kjo rrugë, sepse Partia jonë e Punës do të qëndrojë gjithmonë e patundur në pozitën e marksizëm-leninizmit.

Miqësia jonë me Bashkimin Sovjetik është e lidhur dhe e pandarë me fitoret më të mëdha historike të popullit tonë, me Luftën nacional-çlirimtare dhe me luftën për ndërtimin e socializmit, me lirinë dhe pavarësinë tonë, me daljen e popullit tonë nga errësira mesjetare në dritë, me kombinatet dhe fabrikat, me lulëzimin e fushave, me shkollat dhe përparimin tonë. Prandaj, miqësinë tonë me Bashkimin Sovjetik, besnikërinë dhe dashurinë e pakufishme të Partisë dhe të popullit tonë për Bashkimin Sovjetik dhe Partinë e Leninit, nuk ka forcë në botë që t'i cënojë e t'i dëmtojë, ato me shekuj do të rrojnë e do të forcohen. Garanci për këtë është populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Të dashur shokë,

Miqësia që lidh popullin shqiptar me popullin bullgar është shumë e lashtë dhe ka rrënjë të thella. Historia tregon se kurrë popujt tanë nuk kanë luftuar kundër njëri-tjetrit, se gjithmonë ne kemi pasur armiq dhe miq të përbashkët, gjithnjë ne e kemi ndihmuar njëri-tjetrin, kemi vuajtur dhe kemi gëzuar së bashku. Shumë herë si vëllezër armësh, krahas njëri-tjetrit, shqiptarë e bull-

garë, kanë luftuar kundër pushtuesve otomanë dhe pushtuesve fashistë. Patriotët shqiptarë të Rilindjes kurdoherë kanë gjetur strehë e përkrahje te populli bullgar dhe në Sofje janë krijuar shoqëritë e para të patriotëve shqiptarë, që luftonin për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha turke. Lufta nacional-çlirimtare e popujve tanë e përtëriu dhe e forcoi më shumë miqësinë tonë. Ne u lidhëm përjetë si miq, si vëllezër dhe si shokë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e paqes. Populli vëlla bullgar e ka ndihmuar vendin tonë me kredi, me eksperiencën e vlefshme, sidomos në lëmin e zhvillimit të bujqësisë, në përgatitjen e kuadrove, me specialistë të ndryshëm, të cilët kanë punuar për përparimin e vendit tonë me vetëmohim, na kanë ndihmuar si ndihmon vëllai i vërtetë vëllanë. Ne gjithmonë kemi gjetur te populli bullgar dashuri e simpati të madhe për popullin tonë, gatishmëri për të na ndihmuar kurdoherë pa u kursyer. Në emër të Partisë së Punës dhe të popullit shqiptar, unë ju falenderoj me gjithë zemër ju, të dashur shokë, partinë motër të Bullgarisë dhe gjithë popullin vëlla bullgar për ndihmën e madhe e vëllazërore që na keni dhënë.

Besnikë të traditave tona më të mira, të qëllimeve tona të njëjta dhe të internacionalizmit proletar, ne e kemi forcuar dhe e çelnikosim përherë e më shumë miqësinë tonë. Në 1947 ne përfunduam Traktatin e miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke; në 1955 nënshkruam së bashku Traktatin e Varshavës; në nëntorin e vitit që shkoi partitë tona nënshkruan së bashku Deklaratën dhe Manifestin e paqes dhe tani së fundi dokumentat e tjera të mbledhjeve të Moskës. Të gjitha

këto tregojnë se ne ecim në një rrugë të përbashkët dhe, duke i qëndruar besnikë marksizëm-leninizmit, kemi qenë kurdoherë plotësisht dakord, kemi pasur gjithmonë pikëpamje të njëjlojta mbi gjendjen ndërkombëtare, ndërtimin e socializmit dhe zhvillimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

I shtrenjti dhe i paharruari Gjergj Dimitrov, duke folur për miqësinë tonë, me rastin e nënshkrimit të Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke midis vendeve tona, ka thënë:

*«Sot ne jemi lidhur dhe më ngushtë dhe më thellësisht nga zemra, nga shpirti dhe prej interesit për të ndjekur të njëjtin qëllim, në ditët e mira dhe të këqia, në gëzime dhe në hidhërime. S'ka dhe s'ka për të pasur asnjë forcë në të ardhshmen që të na ndajë».* Jeta e vërtetoi dhe do ta vërtetojë në shekuj këtë thënie të birit të madh të popullit vëlla bullgar dhe mikut të dashur të popullit tonë. Partia jonë e Punës dhe populli ynë ju sigurojnë, të dashur shokë, se sa të jetë jeta ne do të jemi miqtë tuaj të besës.

Qysh nga kohët e lashta, populli ynë, atyre që janë trima, të fortë dhe të patundur u thotë se kanë «kokë bullgari», kurse këtu në Bullgari thonë «kokë shqiptari». Po, shokë vëllezër, bullgarët dhe shqiptarët kanë një kokë e një zemër, ata janë të vendosur e të patundur si shkëmbi dhe armiqtë tanë le ta kenë këtë parasysh.

Të dashur shokë! Uniteti i vendeve të kampit socialist, siç u shpreh edhe në Deklaratën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores të vendeve të kampit të socializmit, në nëntor të vitit të kaluar në Moskë, si dhe në mbledhjen e fundit të për-

faqësuesve të partive komuniste e punëtorë të vendeve pjesëmarrëse në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke, është sot i pathyeshëm. Ai forcohet dhe çelnikohet në luftën e përbashkët për të mbrojtur fitoret socialiste dhe paqen nga orvatjet e imperialistëve luftënxitës dhe në përpjekjet e përbashkëta për të zhvilluar me ritëm të shpejtë ekonominë e kulturën tonë socialiste.

Imperialistët luftënxitës me ata amerikanë në krye, po e rrezikojnë seriozisht paqen. Ata sabotojnë propozimet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste që kanë për qëllim uljen e tensionit ndërkombëtar, ndërsa vendet tona japin shembullin duke shkurtuar forcat ushtarake, ata ndjekin garën e shfrenuar të armatimeve, krijojnë baza të raketave në vendet e NATO-s, armatosin me armë atomike bundesverin e Gjermanisë Perëndimore etj. Komploti fashist që ka për qëllim të vendosë diktaturën ushtarake në Francë, rrezikon jo vetëm rendin republikan në Francë, po përbën edhe një kërcënim serioz për paqen sepse, siç tregon eksperiencia historike, aktivizimi i fashizmit afron rrezikun e luftës, i hap rrugën luftës. Në këto kushte, të gjitha forcat përparimtare e paqedashëse të botës shohin në kampin e socializmit fuqinë kryesore që mund t'u ndalë dorën luftënxitësve dhe shtërngojnë radhët në lëvizjen e madhe të mbrojtjes së paqes. Prandaj, uniteti i kampit të socializmit është sot vendimtar jo vetëm për ruajtjen e pavarësisë dhe ndërtimin me sukses të socializmit në vendet tona të demokracisë popullore, por edhe garancia më e madhe për mbrojtjen e paqes, për fatet e të ardhshmen e njerëzimit.

Pikërisht, pse në unitetin tonë shohin pengesën

kryesore për realizimin e planeve të tyre, imperialistët përdorin të gjitha mjetet për të përçarë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Në këtë drejtim një shërbim të madh i sjell imperializmit revizionizmi modern. Grupi revizionist i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë tradhëtoi marksizëm-leninizmin dhe lufton për të likuiduar rolin udhëheqës të partisë, të diktaturës së proletariatit; ai i ka vënë detyrë vetes të luftojë unitetin e kampit tonë të lavdishëm të socializmit.

Partitë tona komuniste e punëtore me durim kanë bërë çdo gjë të mundur që të ndihmojnë udhëheqësit e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë për t'u larguar nga rruga e tyre antimarksiste, e cila është jo vetëm në dëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, por është gjithashtu në dëm të vetë interesave të popujve jugosllavë. Por ata i përbuzën këto përpjekje dhe e gjithë veprimtaria e tyre, ngjarjet e Hungarisë dhe së fundi projektprogrami e Kongresi VII i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë që ishin një sulm armiqësor kundër kampit të socializmit dhe marksizëm-leninizmit, treguan qartë se ata janë krejtësisht në pozita antimarksiste e revizioniste. Rruga që po ndjekin udhëheqësit e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë nuk u shërben aspak interesave të socializmit, po çon ujë në mullirin e imperializmit.

Pretendimi i udhëheqësve jugosllavë se kritika e drejtë e partive tona kundër pozitave antimarksiste të udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë drejtohet kundër popujve të Jugosllavisë, është një shpifje dhe një orvatje për të armiqësuar këta popuj me miqtë

e tyre të vërtetë, me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera socialiste. Partitë tona gjithmonë kanë luftuar e do të luftojnë për forcimin e miqësisë me popujt e Jugosllavisë; ato gjithashtu janë përpjekur e po përpjekin që të përmirësojnë marrëdhëniet shtetërore midis vendeve tona e Jugosllavisë në bazë të pesë parimeve të bashkekzistencës paqësore. Por çdo marksist-leninist nuk mund të mos luftojë pa asnjë lëshim kundër revizionizmit dhe të pranojë bashkekzistencën ideologjike të revizionizmit me marksizëm-leninizmin, nuk mund të mos luftojë me vendosmëri kundër përhapjes së konfuzionit ideologjik, kundër përçarjes së kampit të socializmit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, nuk mund të lejojë që të hidhet baltë kundër Bashkimit Sovjetik, partive komuniste e punëtore dhe marksizëm-leninizmit.

Revizionizmi në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare paraqit sot, rrezikun kryesor, prandaj ai duhet të demaskohet e të luftohet pa lëkundje dhe deri në fund. Marksi dhe Lenini janë treguar të pamëshirshëm kundër oportunistëve dhe revizionistëve që janë përpjekur të çorientojnë klasën punëtore dhe ta largojnë atë nga rruga revolucionare.

Marksizëm-leninizmi ka triumfuar kurdoherë mbi armiqtë. Nën flamurin e tij, sot, të bashkuar si një trup i vetëm me Bashkimin Sovjetik në krye, ecin popujt e vendeve të kampit socialist dhe të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës. Armiqtë e marksizmit do të dështojnë në përpjekjet e tyre. Forcës kolosale të ideve të marksizëm-leninizmit dhe rritjes së pandërprerë të socializmit nuk ka forcë në botë që t'u bëjë ballë.

Edhe një herë, të dashur shokë e shoqe, më lejoni



t'ju sjell përshëndetjet e zjarrra vëllazërore të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të gjithë popullit shqiptar dhe t'i uroj kongresit tuaj të zhvillojë punimet e tij me sukses.

Rroftë Partia e lavdishme Komuniste Bullgare!

Rroftë Kongresi VII i Partisë Komuniste të Bullgarisë!

Rroftë miqësia e përrjetshme midis popullit shqiptar dhe popullit bullgar!

Rroftë kampi i fuqishëm i socializmit dhe uniteti i tij i çelniqtë me Bashkimin e madh Sovjetik në krye!

Rroftë Partia e lavdishme e Leninit!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 132 (3033), 4 qershor 1958*

*Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## FJALA PARA PUNONJESVE TË QYTETIT TËRNOVO TË BULLGARISË

11 qershor 1958

Të dashur shokë e miq, vëllezër,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të të gjithë popullit shqiptar ju sjell përshëndetjet më të përzemërta vëllazërore juve, banorëve të Tërnovos, qytetit të lashtë e historik, të njohur për luftërat kundër pushtuesve të huaj që shpunë në fitoren e pavarësisë së popullit vëlla bullgar, ku filloi luftën revolucionare marksisti i shquar dhe luftëtari i vendosur për çështjen e klasës punëtore të Bullgarisë, Dhimitër Bllagojevi.

Ne erdhëm në vendin tuaj të bukur për të marrë pjesë në punimet e Kongresit VII të Partisë Komuniste të Bullgarisë, ku mësuam shumë gjëra të vlefshme dhe u njohëm më mirë me sukseset e mëdha që ka arritur Bullgaria motër e aleate, u njohëm me perspektivat e shkëlqyera që hap para jush plani i tretë pesëvjeçar.

Kongresi VII i Partisë suaj që një manifestim i fuqishëm i unitetit të çelniktë të partisë dhe shprehu më së miri lidhjet e saja me popullin. Të gjithë ne, që morëm pjesë në këtë kongres, admiruam bindjen dhe vendosmërinë që shprehën delegatët për ta çuar gjithmonë

përpara çështjen e madhe të socializmit, çështjen tonë të përbashkët. Një parti e tillë heroike siç është Partia Komuniste e Bullgarisë, një parti e dalë nga luftëra të gjata revolucionare kundër fashizmit dhe kundër oportunistëve të të gjitha ngjyrave, partia e Bllagojevit dhe e Dimitrovit është e fortë si çeliku.

Të dashur shokë,

Populli shqiptar vazhdimisht ka ndjekur me interesim të madh sukseset që kanë arritur nga viti në vit punonjësit e Bullgarisë. Ne gëzohemi për fitoret tuaja të deritanishme dhe për perspektivat e shkëlqyera që janë hapur para vendit tuaj, sepse fitoret tuaja janë edhe tonat, ato janë fitore për të gjithë kampin tonë të madh socialist. Qëllimi ynë i përbashkët, idetë e lavdishme të marksizëm-leninizmit, lufta për socializmin dhe për paqen i kanë bashkuar vendet tona socialiste në një familje të madhe e të fuqishme, në kampin e socializmit që ka në krye Bashkimin Sovjetik. Sa më shumë përparon ekonomia dhe kultura e çdonjërit nga pjesëtarët e kësaj familjeje, sa më i fortë është secili nga ne, aq më i fuqishëm bëhet kampi i socializmit.

Populli shqiptar dhe populli bullgar janë lidhur midis tyre me një miqësi të lashtë dhe të singertë. Në të kaluarën na kanë bashkuar fatet dhe luftërat e përbashkëta kundër të njëjtëve armiq. Por miqësia jonë është çelnikosur akoma më shumë në Luftën nacional-çlirimtare kundër fashizmit dhe në luftën për ndërtimin e socializmit nën udhëheqjen e partive tona komuniste. Themele të shëndosha prej graniti i vuri kësaj

miqësie Traktati i miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke, që u nënshkrua në dhjetor të vitit 1947 në mes të vendeve tona. Kanë kaluar njëmbëdhjetë vjet që atëhere dhe jeta vërtetoi se për popullin tonë të vogël ai ka pasur një rëndësi të madhe, jetike. Traktati i Varshavës që u nënshkrua më vonë, ku bëjnë pjesë të dy vendet tona, bëri që armiqtë të mendohen mirë përpara se të vënë në veprim planet e tyre grabitqare kundër cilitdo nga vendet socialiste.

Miqësia jonë sot është më e fortë se kurrë, ajo do të rrojë në shekuj sa malet tona të larta. Rruga e për-bashkët drejt socializmit dhe komunizmit, e ndriçuar nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit na ka lidhur përjetë. Një bashkëpunim i ngushtë vëllazëror i të dy popujve tanë, që ndihmojnë reciprokisht njëri-tjetrin, është duke lulëzuar çdo ditë e më shumë. Kjo u shpreh me forcë në fillim të vitit që shkoi, kur delegacioni qeveritar i Republikës Popullore të Bullgarisë, me shokun Anton Jugov në krye, vizitoi Shqipërinë. Njerëzit tanë, punëtorë, fshatarë e intelektualë, pleq e të rinj, u folën me dorë në zemër shokëve dhe miqve bullgarë se ne e duam popullin tuaj si vëlla, se ne jemi lidhur me ju me besa-besën për jetë e për vdekje dhe se ne do t'i qëndrojmë besnikë deri në fund kampit të socializmit dhe miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Të njëjtat ndjenja të miqësisë së thellë po i shprehen kudo këto ditë edhe delegacionit tonë nga populli bullgar. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë, se ne jemi të vendosur të ecim së bashku për fitoren e socializmit dhe të komunizmit.

Populli vëlla bullgar, Partia Komuniste dhe qeve-

ria e tij nuk kanë kursyer asnjëherë ndihmën bujare për popullin tonë. Ne e vlerësojmë ndihmën tuaj që së bashku me atë të vendeve të tjera socialiste, në radhë të parë të Bashkimit Sovjetik, e ka shpejtuar nxjerrjen e vendit tonë nga prapambetja e madhe e së kaluarës dhe i ka dhënë mundësi të zhvillojë me ritëm të shpejtë ekonominë dhe kulturën popullore. Për këtë ne ju jemi shumë mirënjohës.

Atdheu ynë ka vuajtur shumë në të kaluarën. Pa industri, me një bujqësi të prapambetur dhe me shumicën dërmuese të popullsisë analfabete — ja kjo ishte Shqipëria kur sundonin pushtuesit e huaj dhe klasat feudale e borgjeze. Kurse tani Shqipëria është një vend i pavarur që ndërton socializmin. Jeta e popullit përmirësohet çdo ditë. Shumë u përpoqën imperialistët t'i rrëmbonin popullit tonë pavarësinë dhe fitoret e tija socialiste, por të gjitha u shkuan kot. Mund të bëhet pyetja: pse ndodhi kështu këtë radhë, a s'kishte luftuar edhe më parë populli ynë? Po kishte luftuar, por këtë radhë ai luftoi nën udhëheqjen e Partisë së tij të lavdishme. Kjo ndodhi sepse populli ynë e mbrojti me heroizëm atdheun e tij, kjo ndodhi edhe sepse Shqipëria tani nuk ishte më vetëm, ajo mbrohej me vendosmëri nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e tjera të kampit të socializmit.

Të dashur shokë dhe miq,

Imperialistët kërkojnë të hedhin botën në një luftë tjetër, në një luftë atomike. Gara e armatimeve, krijimi i bazave ushtarake dhe vendosja e raketave në shumë

vende, si dhe vazhdimi i «luftës së ftohtë» tregojnë qartë qëllimet e tyre. Detyra e gjithë partive komuniste e punëtore, e punonjësve të të gjitha vendeve dhe e forcave demokratike e paqedashëse të botës është të ngrenë lart vigjilencën e tyre për të mos u mashtruar nga gënjeshttrat e imperialistëve dhe t'ua ndalin dorën nxitësve të luftës. Garancia më e madhe për largimin e rrezikut të luftës është kampi i socializmit, uniteti i pathyeshëm dhe fuqia e tij e madhe.

Armiqtë e pavarësisë dhe të lirisë së popujve, armiqtë e socializmit, imperialistët e dinë që, në qoftë se kampi i socializmit është i bashkuar dhe në qoftë se uniteti i lëvizjes komuniste ndërkombëtare është i fortë, planet e tyre, për ta hedhur botën në një luftë tjetër, nuk mund të realizohen. Tani gjithë vëmendjen ata e kanë përqëndruar në luftën për të përçarë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Imperialistët kurrë nuk do të mund të realizojnë qëllimet e tyre për të skllavëruar kampin socialist dhe për të rivendosur sistemin e tyre të urryer kapitalist. Nuk do të mundin sepse kampi ynë është i bashkuar, uniteti ynë është i çelniktë dhe forcohet përditë e më shumë. Ne jemi të ndërgjegjshëm që në unitetin e kampit tonë socialist qëndron forca jonë, prandaj me të gjitha fuqitë ta ruajmë atë dhe ta forcojmë.

Veprimtaria minuese e revizionistëve të sotëm jugosllavë, është drejtpërsëdrejti në interes të imperialistëve dhe përbën rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste dhe punëtore ndërkombëtare. Partitë komuniste dhe punëtore të të gjitha vendeve janë të vendosura të luftojnë hapur, pa mëshirë e deri në fund kundër reviz-

zionizmit. Këtu s'është puna për ndonjë rol të veçantë të kësaj apo të asaj partie, siç shkruan shtypi jugosllav dhe përsërit propaganda imperialiste. Ruajtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit është detyra kryesore e çdo partie, e çdo komunisti, prandaj edhe lufta kundër revizionizmit të sotëm është detyrë e çdo komunisti, kudo qoftë ai, në çdo vend të botës.

Nuk ka dyshim, se revizionizmi i sotëm do të pësojë disfatë të plotë dhe idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit do të triumfojnë. Këtë e ka vërtetuar gjithë historia e luftës kundër armiqve të marksizëm-leninizmit, këtë e ka vërtetuar në mënyrë të gjithanshme historia e luftës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kundër të gjitha rrymave antimarksiste që janë shfaqur të maskuara nën emra të ndryshëm ose me fraza pseudomarksiste. Këtë e vërtetoi më së miri mbledhja e të gjitha partive komuniste dhe punëtore në Moskë, në nëntor të vitit të kaluar, ku u shpreh edhe një herë uniteti i plotë i të gjitha partive komuniste e punëtore në luftën kundër revizionizmit.

Shokë e vëllezër,

Ndjenjat e larta të miqësisë dhe të dashurisë që tregoni ndaj vendit tonë na forcojnë dhe na rritin besimin për të ecur me vendosmëri përpara. Ne ju falenderojmë me gjithë zemër për pritjen e ngrohtë vëllazërore dhe ju urojmë fitore akoma më të mëdha në rrugën tuaj të lavdishme. Sukseset tuaja janë të mëdha. Këtë ne e pamë në qytetet dhe në fshatrat tuaja, në shtëpitë e bukura që të bien në sy kudo, e pamë në fytyrat e qe-

shura e të shëndetshme të njerëzve të qytetit e të fshatit. Unë kam qenë në vendin tuaj njëmbëdhjetë vjet më parë. Dhe, t'ju them të drejtën, tani që erdha rishitas, duke kaluar nëpër vendet që vizitova atëhere, nuk u orientova dot sepse fushat janë kthyer në kopshte të lulëzuara, industria dhe bujqësia kanë bërë ndryshime të mëdha. Por ç'do të bëhet pas pesë vjetëve? Ne do të vijmë përsëri dhe jo një herë e do të shohim se ndryshimet do të jenë akoma më të mëdha. Garanci për këtë është dashuria juaj për punën, vendosmëria juaj për të ecur përpara në rrugën e socializmit.

Rroftë miqësia midis popujve shqiptar dhe bullgar!  
Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 139 (3040), 12 qershor 1958*

*Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## NË POPULLIN BULLGAR NE KEMI NJË MIK SHUMË TË NGUSHTË DHE BESNIK

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**13 qershor 1958**

Dëshiroj t'ju informoj shkurt mbi zhvillimin e punimeve të Kongresit VII të Partisë Komuniste Bullgare. Ju i keni parë materialet që janë botuar për këtë kongres, po sigurisht nuk i keni studjuar ato me hollësi. Ne kemi marrë me vete edhe raportet që u mbajtën në kongres, prandaj kush dëshiron mund t'i studjojë ato.

Mendimi i delegacionit të Partisë sonë është se Kongresi VII i Partisë Komuniste Bullgare u zhvillua në lartësinë e duhur. Raportet që u paraqitën ishin të mira dhe konkrete. Plani i tretë pesëvjeçar është një plan i madh.

Në periudhën midis dy kongreseve Bullgaria ka arritur suksese të mëdha në sektorin e industrisë, bujqësisë dhe të kulturës. U theksua se në Bullgari, në vija të përgjithshme janë ndërtuar bazat e socializmit dhe tani punohet për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë socialiste.

Në raportin që mbajti shoku Anton Jugov theksoi

se industria po zhvillohet dhe shkon përpara me hapa të shpejtë. Në industrinë e rëndë dhe të lehtë ka pasur rezultate të mëdha. Plani i dytë pesëvjeçar i aprovuar në Kongresin VI të Partisë është tejkaluar në shumë drejtime.

Në sektorin e bujqësisë, me përjashtim të mishit, detyrat e caktuara janë realizuar. Arësimi dhe kultura gjithashtu kanë marrë një zhvillim të madh. Në arësimin e lartë janë plotësuar detyrat, bile në disa degë si në mjekësi ka më tepër kuadro se sa duhen.

Plani i ardhshëm pesëvjeçar përmban shifra më të mëdha. Investime të konsiderueshme parashikohen për industrinë e rëndë dhe për ngritjen e fabrikave të mëdha. Do të shtohet prodhimi i plehut kimik, i çimentos, i nxjerrjes së qymyrgurit; do të zgjerohet industria e rëndë e nikelit, plumbit, bakrit dhe xingos. Rëndësi të madhe do t'i kushtohet industrisë ushqimore për konservat, perimet, frutat etj. Do të shtohen akoma më shumë fabrikat e trikotazhit etj.

*Shoku Enver pasi foli për objektivat kryesore të pesëvjeçarit të tretë të RP të Bullgarisë, vazhdoi:*

Ne pamë qytetin e Sofjes dhe vumë re se tregu ishte plot me prodhime të vendit.

Fshati na bëri shumë përshtypje. Kudo gjelbëronin fushat dhe kopshtet. Pamë dhe faqe të maleve të pyllëzuara.

Kudo që shkuam na u bë një pritje shumë e ngrohtë dhe e përzemërt. Duhet thënë se Partia dhe populli bullgar kanë një dashuri shumë të madhe për Partinë dhe popullin tonë. Në popullin bullgar ne kemi një mik shumë të ngushtë dhe besnik. Shokët udhëhe-

qës na thonin hapur se pas Bashkimit Sovjetik ne duam Shqipërinë, prandaj delegacioneve të tjera, të mos u vijë keq.

Ju e keni parë si u shtrua në Kongresin VII të Partisë Komuniste Bullgare çështja jugosllave. Në këtë çështje ata kanë pasur parasysh që kongresi të mos kalojë në një kongres antijugosllav. Por në diskutimet që u bënë nga shokët udhëheqës e të bazës, u duk se janë kundër revizionistëve jugosllavë.

Fjalimi i shokut Hrushov që më i hapur se më parë. Ju e dini se kur Titua ishte në Moskë, Hrushovi ngrihti dollinë për «shokun» Tito etj., kurse fjalimi që mbajti në këtë kongres ishte më i fortë kundër revizionistëve jugosllavë. Fjalimi i tij u prit mirë dhe bëri përshtypje në popull. Kur dolëm ai ishte pranë meje dhe tha: «Ja, Enveri nuk është akoma i kënaqur», kurse unë u përgjigja «pse jo...?».

Në darkën që u shtrua nga shokët bullgarë, shoku Hrushov, pasi foli për vijën e përgjithshme të Bashkimit Sovjetik, për deviacionet etj., tha se udhëheqësit jugosllavë janë revizionistë të marksizëm-leninizmit dhe kjo as që diskutohet. Këtë nuk e them vetëm unë, por e thonë të gjithë. Aty ishin edhe disa përfaqësues të partive të reja komuniste si për shembull ata të Sudanit. Hrushovi shtoi se po të them unë për Partinë Komuniste të Kinës se ajo është revizioniste, do të më çonin në spital. Ndërsa për revizionistët jugosllavë, të gjithë jemi të një mendimi se ata nuk janë gjë tjetër, veçse agjenturë e imperializmit amerikan. «Sa për Titon, tha Hrushovi, ai është një megaloman i madh. Kur ishte në Moskë, fryhej si gjel, pse kujtonte se populli sovjetik

do ta priste si hero. Por shpejt ra nga dega. Unë i dhahë të kuptojë se këtë pritje e kemi organizuar ne, ndryshe populli sovjetik do ta priste me vërshtëllima. Kur doli nëpër rrugët e Moskës Titua kishte për qëllim që, nga njëra anë t'i jepte të kuptonte popullit tonë se udhëheqësit e tij janë të shkëputur nga masat, dhe, nga ana tjetër, donte të thirrej «Tito! Tito!», por asnjë nuk thirri kështu».

Patëm edhe biseda të tjera. Shokët bullgarë treguan shumë kujdes e dashamirësi për delegacionin tonë. Një ditë të diel, pas kongresit, bashkë me ta dhe Hrushovin, shkuam për të ngrënë drekë në një vend një orë larg Sofjes. Këtu morëm vesh lajmin se Bashkimi Sovjetik kërkonte kredi nga Amerika. Me këtë rast unë i thashë Hrushovit se si do të kuptohej një gjë e tillë, ndërsa ai u përgjegj se nuk do të kuptohej mirë, por kërkojmë kredi nga Amerika, për arsye se ka oferta nga trustet e saj, të cilët janë në krizë dhe se qeveria amerikane nuk i lë të japin kredi, prandaj ne i kërkojmë qeverisë amerikane që të na jepen kredi, me qëllim që ata të hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin. Rezultatin do ta shikojmë më vonë, tha Hrushovi. Po si do të bëhet më vonë, kush e merr vesh?!

Përsa i përket ardhjes së Hrushovit në Shqipëri, ia përsërita edhe një herë kërkesën tonë. Ai më tha se u bëra si arixhinjtë, po bredh nga të katër anët, dhe se këtë çështje ia ka lënë në dorë Sekretariatit që të bëjë një plan se ku do të vejë dhe kur.

Në Kongresin VII të Partisë Komuniste të Bullgarisë kishte unitet dhe entuziazëm. Vëllko Çervenkovi, i cili u ngrit dhe foli në kongres, u duartrokit me shumë

entuziazëm dhe u dëgjua me shumë vërejtje. Por unë pata përshtypjen se ai sikur s'mbahej aq afër. . .

Në bisedën që pata me Todor Zhivkovin, ai më tha se traktorët do të fillojnë t'ua shesin kooperativave, por natyrisht më parë do të marrin masa që të shtohet fondi i paprekshëm i tyre. Deri tani ishte thënë që të ardhurat të përdorëshin për ngritjen e mirëqenies së kooperativistëve, kurse tani parrulla e tyre është «sa më shumë në fondin e paprekshëm».

Shoku Zhivkov më hodhi fjalën se kanë nevojë për më shumë bitum se ç'kemi kontraktuar, sa për transportimin e marrin nga Jugosllavia me automobila dhe fuçitë i kthejnë përsëri. Unë nuk ia dhashë fjalën, por i thashë se do ta shikojmë çështjen. Prandaj, jam i mendimit që shokët ta shqyrtojnë këtë çështje dhe nëse ka mundësi t'u japim shokëve bullgarë 5000-6000 ton bitum mbi kontraktimin.

Shkurtimisht këto kisha lidhur me qëndrimin tonë në Bullgari.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR PUNONJËSVE TË  
SHTYPSHKRONJAVE «K. MARKS» DHE «A. NEKSE»,  
KU I FALENDERON PËR SHTYPJEN NË SHQIP  
TË VEPRAVE TË ZGJEDHURA TË MARKSIT  
E ENGELSIT DHE TË LENINIT**

**17 qershor 1958**

**KOLEKTIVAVE PUNONJËSE TË SHTYPSHKRONJAVE  
«KARL MARKS» TË POSNEKUT DHE «ANDERSEN NEKSE»  
TË LAIPCIGUT**

Të dashur shokë e vëllezër,

Kemi mbetur jashtëzakonisht të kënaqur nga puna e pastër dhe me cilësi shumë të lartë që ju keni bërë në shtypjen e *Veprave të zgjedhura* të K. Marksit e F. Engelsit dhe të *Veprave të zgjedhura* të V. I. Leninit në gjuhën shqip. Në emër të komunistëve shqiptarë, të punonjësve të vendit tonë dhe timin personal ju falenderoj nga zemra dhe ju shpreh përgëzimet e mirënjohjen më të thellë për punën tuaj fisnike.

Kjo është një dëshmi tjetër e gjallë e miqësisë dhe e lidhjeve vëllazërore midis punonjësve të Republikës Demokratike Gjermane dhe të Republikës Popullore të

Shqipërisë, të cilët i bashkon qëllimi dhe lufta e përbashkët për socializmin dhe paqen.

Ndihma shumë e çmueshme që u dhatë ju punonjësve të vendit tonë duke shtypur në gjuhën shqip veprat e mësuesve të mëdhenj të proletariatit, Marksit, Engelsit dhe Leninit do të shërbejë si një mjet për forcimin akoma më shumë të miqësisë edhe të lidhjeve vëllazërore midis republikave tona motra në gjirin e kampit të fuqishëm socialist. Këto libra do të shërbejnë gjithashtu si shembull i punës suaj të shkëlqyer për punonjësit tipografë të Republikës Popullore të Shqipërisë, të cilët duhet të përfitojnë nga eksperiencia juaj e madhe.

Ju uroj me gjithë zemër suksese gjithnjë më të mëdha për lulëzimin e atdheut tuaj në rrugën e socializmit!

Rroftë dhe u forcoftë miqësia midis punonjësve të Republikës Demokratike Gjermane dhe Republikës Popullore të Shqipërisë!

Përshëndetje revolucionare  
Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*





## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 15 ..... V—VII

1957

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VI TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH (12 korrik 1957) .....	1—22
LETËR URIMI DËRGUAR AMBASADORIT TË RP TË KINËS NË TIRANË ME RASTIN E 8-VJETORIT TË SHPALLJES SË RP TË KINËS (1 tetor 1957) ....	23—24
MBI DISA NGA PROBLEMET QË DALIN ME HEQJEN E PLOTË TË SISTEMIT TË TRISKËTIMIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 tetor 1957) .....	25—29
INFLUENCA E REVOLUCIONIT TË MADH SOCIALIST TË TETORIT NË SHQIPËRI (Tetor 1957) ....	30—94
LETËR PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PK TË BS ME RASTIN E LËSHIMIT ME SUKSES TË SATELITIT TË PARË ARTIFICIAL TË TOKËS (19 tetor 1957) .....	95—96
SHËNIME TË NXJERRA NGA TAKIMI ME NJË SHQIPTAR TË KTHYER NGA AUSTRALIA (31 tetor 1957) .....	97—106
FJALA NË MBLEDHJEN E KOMISIONIT INISIA-TOR PËR KREMTIMIN E 45-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË (Tetor 1957)	107—113

LETËR DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË NË QARQE E NË RRETHE LIDHUR ME REZULTATET E ARRITURA NË PËRMIRËSIMIN E RACËS SË DHENVE (2 nëntor 1957) .....	114—117
REVOLUCIONI I TETORIT U HAPI POPUJVE RRU- GËN E MIRËQENIES DHE TË LUMTURISË (5 nëntor 1957) .....	118—128
NGA FJALA NË SEANCËN E PARË TË KONSULTËS SË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE MBAJTUR NË MOSKË MË 14-16 NËNTOR 1957 (14 nëntor 1957) .....	129—133
NGA INTERVISTA DHËNË MANOLIS GLEZOS PËR GAZETËN «AVJI» TË EDA-s (22 nëntor 1957) .....	134—137
PUNA E PARTISË TË NDËRTOHET NË PËRSHTA- TJE ME RIORGANIZIMIN E ORGANEVE LOKALE TË PUSHTETIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 dhjetor 1957) .....	138—143

## 1958

MBI RUAJTJEN E PRONËS SOCIALISTE NË EKO- NOMI NGA PËRVETËSIMET, DËMTIMET DHE SHPËRDORIMET — Letër dërguar komiteteve të Par- tisë në qarqe e në rrethe (6 janar 1958) .....	144—150
LETËR DËRGUAR BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH ME ANËN E SË CILËS I KËRKON NDËRRI- MIN E EMRIT TË HIDROCENTRALIT MBI LUMIN E MATIT (7 janar 1958) .....	151—152
MË TEPËR KUJDES PËR CILËSINË E PUNËS NË FORMAT E ARËSIMIT POLITIK TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 janar 1958) .....	153—156

- KRITIKA NË POPULL E GABIMEVE TË BËRA PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË, NUK NA DO-BËSON, POR NA FORCON AKOMA MË TEPËR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 janar 1958). . . . . 157—162:
- PROBLEME ME RËNDËSI TË PLANIT TË DYTË PESEVJEÇAR QË DUHET TË RISHIKOHEN — Shënime mbi bazën e të cilave u fol në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (Janar 1958) . . . . . 163—175:
- TË VËMË TË GJITHA FORCAT PËR REALIZIMIN ME SUKSES TË PLANIT TË DYTË PESEVJEÇAR — Fjala e mbylljes në Plenumin VIII të KQ të PPSH (5 shkurt 1958). . . . . 176—211:
- LEKSIONET PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË RINISË DUHET TË JENË TË THJESHTA, TËRHEQËSE DHE MBI BAZA SHKENCORE — Vërejtje mbi disa tema të edukimit komunist të rinisë (7 shkurt 1958) 212—218:
- KOMISIONI I KONTROLLIT TË SHTETIT TË BËHET NJË MËSUES I MIRË PËR TË GJITHË KONTROLLORËT DHE REVIZORËT E DIKASTEREVE QENDRORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 shkurt 1958) . . . . . 219—221:
- TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK FRANCEZE ME RASTIN E VDEKJES SË SHOKUT MARSEL KASHEN (13 shkurt 1958) . . . . . 222—223:
- KOLEKTIVIZIMI — E VETMJA RRUGË PËR ZHDUKJEN E VARFËRISË E TË PRAPAMBETJES NË FSHAT — Nga diskutimi në Plenumin e Komitetit të Partisë të rrethit të Fierit (25 shkurt 1958) . . . . . 224—232:
- NGA BISEDA ME NXËNËSIT E TEKNIKUMIT BUJQËSOR TË FIERIT (26 shkurt 1958) . . . . . 233—234:
- NGA BISEDA ME KOOPERATIVISTËT E GORISHO-

VËS E TË VRESHTASIT TË MALLAKASTRËS (28 shkurt 1958) .....	235—237
NGA BISEDA ME KOOPERATIVISTËT E ÇAKRA- NIT TË MALLAKASTRËS (1 mars 1958) .....	238—239
BASHKIMI DO T'JU SJELLË EDHE BEGATINË — Letër dërguar fshatarëve të Zhavarës me rastin e formimit të kooperativës (2 mars 1958) .....	240—242
NË KOOPERATIVA NUK MUND TË KEMI REZUL- TATE TË MIRA PA FORCIMIN ORGANIZATIV TË TYRE — Nga fjala në Konferencën e 8-të të Partisë të rrethit të Fierit (4 mars 1958) .....	243—269
DISA KONKLUZIONE TË NXJERRA NGA VIZITA NË RRETHIN E FIERIT MBI PROBLEMET E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE (Mars 1958) .....	270—273
PUNA E BASHKIMEVE PROFESIONALE NUK MUND TË BËHET VETËM ME FUNKSIONARË, POR NË RADHË TË PARË ME AKTIVISTË SHOQËRORË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 mars 1958) .....	274—278
MBI INTELEKTUALËT (Mars 1958) .....	279—294
KALITJA E INTELIGJENCIES NUK BËHET VE- TËM ME LEKSIONE, POR ME PJESËMARRJEN E SAJ AKTIVE NË GJITHË JETËN E VENDIT — Nga diskutimi në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të qytetit të Tiranës (21 mars 1958) .....	295—303
FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCËN KOMBË- TARE PËR SHTIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E LO- FËS (23 mars 1958) .....	304—334
LETËR PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR REDAKSISË SË GAZETËS «BASHKIMI» ME RASTIN E 15-VJE- TORIT TË THEMELIMIT TË SAJ (25 mars 1958) ..	335—337

- MBI KOOPERIMIN E ZANATÇINJVE PRIVATË PËR  
TË PLOTËSUAR MË MIRË NEVOJAT E POPULLIT  
PËR RIPARIME DHE SHËRBIME — Letër dërguar  
gjithë komiteteve të Partisë në rrethe (26 mars 1958) 338—341
- NDËRTIMI I SOCIALIZMIT KËRKON PUNË, HE-  
ROIZËM DHE NDËRGJEGJE TË LARTË NGA GJI-  
THË RINIA — Fjala e mbajtur në Plenumin V të KQ  
të BRPSH (31 mars 1958) ..... 342—376
- PARTIA TË MERRET MË SHUMË ME EDUKIMIN  
DHE FORCIMIN E BASHKIMEVE PROFESIONALE  
— Fjala e mbylljes në Plenumin IX të KQ të PPSH  
(2 prill 1958) ..... 377—360
- FORCIMI I PËRBËRJES SË PARTISË DHE I FO-  
RUMEVE TË SAJ ME PUNËTORË — NJË NGA PRO-  
BLEMET JETIKE — Nga diskutimi në mbledhjen e  
Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1958) ..... 331—385
- NGA BISEDA ME KOOPERATIVISTËT E KOO-  
PERATIVËS BUJQËSORE TË BASHKUAR TË VI-  
SHOCICË—KAPSHTICË—KURILËS TË KORÇËS  
(23 prill 1958). ..... 386—388
- SHËNIME MBI BAZËN E TË CILAVE U FOL NË  
AKTIVIN E BASHKIMEVE PROFESIONALE TË  
KORÇËS (25 prill 1958). ..... 389—393
- NGA BISEDA ME ANËTARËT E KOOPERATIVËS  
BUJQËSORE «RRUGA E BOLLËKUT» TË LIBONI-  
KUT TË KORÇËS (26 prill 1958) ..... 394—395
- JU MINATORËT JENI ELEMENTI MË I FUQISHËM  
I KLASËS PUNËTORE — Nga fjala në takimin me  
minatorët e Mborje-Drenovës (28 prill 1958). ..... 396—397
- NË KUNDËRSHTIM ME TEORINË DHE PRAKTI-  
KËN E MARKSIZËM-LENINIZMIT (4 maj 1958) .. 398—410

DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS SË PARTISË NË USHTRI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 maj 1958) .....	411—414
POZITAT TONA JANË TË FORTA, VIJA E PARTISË SONË ËSHTË E DREJTË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 maj 1958) .....	415—419
PARTIA E POPULLI TE NE JANË NJË E TË LIDHUR PËRJETË — Fjala e mbajtur para zgjedhësve të zonës elektorale Nr. 158 të Tiranës (29 maj 1958) ..	420—460
FJALA E PËRSHËNDETJES NË KONGRESIN VII TË PK TË BULLGARISË (3 qershor 1958) .....	461—469
FJALA PARA PUNONJËSVE TË QYTETIT TËRNOVO TË BULLGARISË (11 qershor 1958) .....	470—476
NË POPULLIN BULLGAR NE KEMI NJË MIK SHUMË TË NGUSHTË DHE BESNIK — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 qershor 1958) .....	477—481
LETËR DËRGUAR PUNONJËSVE TË SHTYP-SHKRONJAVE «K. MARKS» DHE «A. NEKSE» KU I FALENDERON PËR SHTYPJEN NË SHQIP TË VEPRAVE TË ZGJEDHURA TË MARKSIT E ENGELSIT DHE TË LENINIT (17 qershor 1958) .....	482—483

